

ZHUAN FALUN

Duke Kthyer Rrotën e Ligjit

(VERSIONI SHQIP)

LI HONGZHI

Version Interneti

Edicioni i Parë i Përkthimit (Prill 2004)



Kjo emblemë Faluni është universi në miniaturë. Ai ka gjithashtu formën e vet të ekzistencës dhe proceset e zhvillimit në gjithë dimensionet e tjera; prandaj unë e quaj atë botë.

Li Hongzhi

LUNYU¹

“Buddha Fa”² është kaq e thellë; ndërmjet të gjitha teorive në botë, ajo është shkenca më komplekse dhe më e jashtëzakonshme. Në mënyrë që të eksplorojë këtë fushë, njerëzimit i duhet të ndryshojë thelbësisht të menduarit e vet konvencional. Përndryshe, e vërteta mbi universin do të mbetet një mister i përhershëm për njerëzimin dhe njerëzit e zakonshëm do të zvarriten përjetësisht brënda kufijve të kushtëzuara nga padija e tyre.

Por çfarë është “Ligji i Buddhës” në të vërtetë? Është fe? Është filozofi? Ky është vetëm të kuptuarit e “dijetarëve Budhistë të modernizuar”, të cilët vetëm studjojnë teori. Ata e konsiderojnë atë si kategori filozofike për studime kritike dhe të ashtuquajturin kërkim shkencor. Në fakt, “Ligji i Buddhës” nuk është vetëm ajo pjesë e vogël e dokumentuar në shkrimet e shenjta, sepse ajo është thjesht “Ligji i Buddhës” i nivelit elementar. “Ligji i Buddhës” është dritë mbi të gjitha misteret. Ai përfshin çdo gjë dhe nuk lë jashtë asgjë—që nga grimcat e vogla dhe molekulat deri tek universi, që nga më të voglat deri tek më të mëdhatë. Ai është shprehje e karakteristikës së universit, “Zhen-Shan-Ren”³, e shprehur në nivele të ndryshme me nënkuptime të ndryshme. Ai është gjithashtu ajo që Shkolla Tao e quan “Tao”⁴ apo ajo që Shkolla Buddhës e quan “Fa”⁵.

Pamvarësisht sa e përparuar që ka arritur të jetë shkenca njerëzore e sotme, ajo është akoma veçse një pjesë e mistereve të gjithësisë. Sa herë që përmendim fenomene specifike të “Ligjit të Buddhës”, dikush do të pretendojë: “Kjo është tashmë epoka e elektronikës dhe shkenca ka përparuar kaq shumë. Anijet kozmike kanë fluturuar tashmë në planete të tjera, megjithatë ju akoma nxirrni këto paragjykime që i ka ikur koha.” Ta themi hapur, sado i përparuar të jetë kompjuteri, as që krahasohet me trurin njerëzor, që dhe sot e kësaj dite mbetet një enigmë e padepërtueshme. Sado larg të fluturojë një anije kozmike, ajo nuk mund të kalojë përtej këtij dimensionit fizik në të cilin ekziston rracja njerëzore. Ajo që mund të kuptohet me njohuritë njerëzore moderne është jashtëzakonisht e cekët dhe e pjesëshme; ajo është tepër larg të kuptuarit të vërtetës së universit. Disa njerëz as që guxojnë të ballafaqohen me këtë, të trajtojnë apo të pranojnë faktet e fenomeneve që ekzistojnë objektivisht, sepse ata janë tepër konservatorë e nuk duan të ndryshojnë të menduarit e tyre konvencional. Vetëm nëpërmjet “Ligjit të Buddhës” mund të zbulohen plotësisht misteret e universit, të kohë-hapësirës dhe të trupit të njeriut. Ai është i aftë që me të vërtetë të dallojë të virtytshmen nga e liga, të mirën nga e keqja dhe t’i japë fund ideve të gabuara duke dhënë pikëpamjet e sakta.

Parimi udhëheqës i shkencës së sotme njerëzore është i kufizuar vetëm në këtë botë fizike gjatë kërkimit dhe zhvillimit të saj, sepse një subjekt nuk studjohet derisa të pranohet që ekziston—pra ndjek këtë rrugë. Përsa i përket fenomeneve që janë të paprekshme e të padukshme në dimensionin tonë, por që ekzistojnë objektivisht dhe reflektohen në dimensionin tonë fizik si manifestime konkrete, njerëzit nuk guxojnë t’i studjojnë ato duke i përjashtuar si fenomene të panjohura. Njerëzit kokëfortë përpiqen të arsyetojnë pa baza se ato janë fenomene natyrore, ndërsa ata me motive të fshehta, në kundërshtim me vetë ndërgjegjen e tyre, i emërtojnë ato thjesht si paragjykime. Ata që nuk duan t’ja dijnë, thjesht i rrinë larg çështjes me

¹ Lunuy (lë-niu)—parathënie; koment.

² Buddha Fa—parimet dhe ligjet e universit; thelbi i gjithësisë. Që këtej e tutje do t’i referohemi me “Ligji i Buddhës”.

³ Zhen-Shan-Ren—Zhen (vërtetësi, ndershmëri); Shan (zemërmadhësi, mëshirë, mirësi); Ren (tolerancë, durim).

⁴ Tao(dao)—1. shkruhet dhe Dao, term Taoist për “thelbin e natyrës dhe univesit”; 2. qenia e lartësuar shpirtërisht që ka arritur Taon.

⁵ Fa—ligjet dhe parimet e Shkollës Buddhës. Që këtej e tutje do t’i referohemi me “Ligj”.

pretekstin se shkenca nuk është akoma e zhvilluar aq sa duhet. Nëse njerëzit janë të aftë t'i hedhin një shikim të ri vetes dhe gjithësisë dhe të ndryshojnë mentalitetet e tyre të ngurta, njerëzimi do të bënte një hap të madh përpara. “Ligji i Buddhës” e bën njerëzimin të aftë të kuptojë botët e pamatshme dhe të pafundshme. Gjatë gjithë epokave, vetëm “Ligji i Buddhës” ka qënë i aftë të japë një shpjegim të qartë të njerëzimit, të çdo dimensionit të ekzistencës materiale, jetës dhe të gjithë universit.

Li Hongzhi
2 qershor 1992

PËRMBAJTJA

LUNYU.....	I
PËRMBAJTJA	III
LEKSIONI I PARË.....	1
DUKE UDHËHEQUR ME VËRTETËSI NJERËZIT DREJT NIVELEVE MË TË LARTA.....	1
NIVELE TË NDRYSHME KANË LIGJ TË NDRYSHËM	4
ZHEN-SHAN-REN ËSHTË KRITERI I VETËM PËR TË DALLUAR NJERËZIT E MIRË NGA NJERËZIT E KËQINJ	6
QIGONG ËSHTË KULTURË PARAHISTORIKE	8
QIGONG ËSHTË PRAKTIKË KULTIVUESE.....	11
PSE NUK RRIETET GONGU JUAJ NGA PRAKTIKA?	13
KARAKTERISTIKAT E FALUN DAFËS	18
LEKSIONI I DYTË.....	23
ÇËSHTJA E SYRIT QIELLOR.....	23
AFTËSIA SUPERNORMALE E SHIKIMIT NË DISTANCË	30
AFTËSIA SUPERNORMALE E PARASHIKIMIT TË FATIT	31
KALIMI PËRTEJ PESË ELEMENTEVE DHE TRE HAPËSIRAVE	34
ÇËSHTJA E DËSHIRËS PËR TË PËRFITUAR	37
LEKSIONI I TRETË	43
UNË I TRAJTOJ GJITHË PRAKTIKUESIT SI DISHEPUJT E MI.....	43
QIGONGU I SHKOLLËS SË BUDDHËS DHE BUDDHIZMI.....	43
PRAKTIKIM I NJË MËNYRE TË VETME KULTIVIMI.....	46
AFTËSITË SUPERNORMALE DHE FUQIA GONGUT.....	48
KULTIVIMI I ANASJELLTË DHE MARRJA HUA E GONGUT	49
ZOTËRIMI NGA SHPIRTRAT APO KAFSHËT	53
GJUHA KOZMIKE	57
ÇFARË I JEP MËSUESI PRAKTIKUESVE?	58
FUSHA ENERGJISË	63
SI DUHET TA PËRHAPIN PRAKTIKËN PRAKTIKUESIT E FALUN DAFËS.....	63
LEKSIONI I KATËRT	66
HUMBJA DHE FITIMI	66
TRANSFORMIMI I KARMËS.....	67
PËRMIRËSIMI I KARAKTERIT.....	73
GUANDING	76
VENDOSJA E KALIMIT TË FSHEHTË.....	79
LEKSIONI I PESTË	84
EMBLEMA E FALUNIT	84
SHKOLLA QIMEN	85
TË PRAKTIKOSH NJË PRAKTIKË TË LIGË.....	87
KULTIVIMI I DYFISHTË MASHKULL–FEMËR	89
KULTIVIMI I MËNDJES DHE I TRUPIT	90
FASHEN	91
CEREMONIA E BEKIMIT	91
DISIPLINA E MAGJISË	96
LEKSIONI I GJASHTË	98
MARROSJA NGA KULTIVIMI.....	98
NDËRHYRJA DEMONIKE NË KULTIVIM	104
NDËRHYRJA DEMONIKE NGA VETË MËNDJA E NJERIUT.....	108

NDËRGJEGJA KRYESORE DUHET TË MBIZOTËROJË	111
MËNDJA JUAJ DUHET TË JETË E PASTËR	111
QIGONGU I ARTEVE MARCIALE.....	116
MENTALITETI PËR T'U DUKUR	118
LEKSIONI I SHTATË.....	122
ÇËSHITJA E VRASJES	122
ÇËSHITJA E NGRËNIES SË MISHIT	124
ZILIA	128
ÇËSHITJA E TRAJTIMIT TË SËMUNDJEVE.....	132
TRAJTIMI NË SPITAL DHE TRAJTIMI I QIGONGUT	135
LEKSIONI I TETË	139
VJEDHJA E QI-SË	140
MBLEDHJA E QI-SË.....	142
KUSH PRAKTIKON KULTIVIM DO TË MARRË GONG.....	144
QARKU QIELLOR	148
VESI I ZELLIT TË TEPRUAR	154
KULTIVIMI I TË FOLURIT	155
LEKSIONI I NËNTË.....	157
QIGONGU DHE USHTRIMET FIZIKE	157
MËNDIMET	158
NJË MËNDJE E KTHJELLËT DHE E PASTËR	162
CILËSIA E LINDUR	165
NDRIÇIMI DHE LARTËSIMI SHPIRTËROR	167
NJERËZIT ME CILËSI TË LINDUR TË MADHE	171
PËRMBJEDHJE E TERMAVE	178

LEKSIONI I PARË

Duke Udhëhequr me Vërtetësi Njerëzit Drejt Niveleve më të Larta

Gjatë gjithë kohës së leksioneve të mia mbi Ligjin dhe praktikën kultivuese, unë kam qënë i përgjegjshëm ndaj shoqërisë dhe praktikuesve. Rezultatet që kemi arritur kanë qënë të mira dhe efekti mbi tërë shoqërinë ka qënë gjithashtu tepër i mirë. Disa vjet më parë kishte shumë mjeshtër *qigongu*¹ të cilët jepnin mësim në qigong. Gjithshka që mësonin ata i përkiste nivelit të shërimit nga sëmundjet dhe mbajtjes së trupit në formë. Sigurisht, unë nuk po them se mënyrat e tyre të praktikës nuk janë të mira. Unë vetëm po vë në dukje atë që ata nuk jepnin mësim të një niveli të lartë. Po ashtu, unë e njoh situatën e qigongut në tërë vendin. Tani për tani, unë jam i vetmi person që me të vërtetë po jap mësim qigongu drejt niveleve të larta brenda vendit dhe jashtë tij. Pse nuk e ka bërë asnjëri një gjë të tillë si dhënien e mësimit të qigongut të niveleve të larta? Sepse kjo lidhet me çështje të një rëndësie të madhe, arsye të thella historike, një tërësi çështjesh dhe shumë arsye serioze. Ajo nuk është diçka që kushdo mund ta bëjë, sepse ka lidhje me praktikën e shumë shkollave qigong. Në veçanti, shumë nga praktikuesit tanë të cilët studjojnë një praktikë sot e një tjetër nesër i kanë bërë lëmsh trupat e tyre. Kultivimi i tyre është i destinuar të dështojë. Ndërsa të tjerët përparojnë duke marrë rrugën kryesore në kultivim, këta individë marrin rrugë anësore. Kur ata praktikojnë një mënyrë, mënyra tjetër u ndërhyr. Kur praktikojnë mënyrën tjetër, kjo praktikë u ndërhyr. Çdo gjë u ndërhyr atyre dhe ata nuk do mundën që të kenë sukses në praktikën kultivuese.

Ne do i ndreqim të gjitha këto gjëra dhe duke ruajtur pjesën e mirë dhe hequr të keqen, do të sigurojmë që ju të jeni të aftë të praktikoni kultivim më vonë. Por ju duhet të jeni këtu me qëllim të pastër për të mësuar këtë Dafa². Nëqoftëse mbani dëshira të ndryshme dhe vini për të përfituar aftësi mbinatyrale, kuruar sëmundje, dëgjuar disa teori, apo vini me qëllime të këqija, kjo nuk do t'ju ecë. Siç e thashë, kjo ndodh për shkak se unë jam i vetmi person që po e bën një gjë të tillë. Nuk ka shumë mundësira për diçka si kjo dhe unë nuk do të jap mësim në këtë mënyrë përgjithmonë. Mendoj se ata që mund të dëgjojnë leksionet e mia duke qënë vetë të pranishëm, do të thoja, me ndershmëri ... ju do e kuptoni në të ardhmen se kjo periudhë është jashtëzakonisht e çmuar. Sigurisht, ne besojmë në lidhje të paracaktuara nga fati. Secili këtu është i pranishëm vetëm për shkak të një lidhjeje të paracaktuar nga fati.

Pa mendojeni pak: Çfarë çështje është të japësh mësim drejt niveleve të larta? A nuk është kjo t'i afrosh shpëtim njerëzimit? T'i afrosh shpëtim njerëzimit do të thotë që ti do të praktikosh me të vërtetë kultivim dhe jo thjesht kurosh sëmundjet e të mbash trupin në formë. Kështu, praktika kultivuese e vërtetë ka kërkëse *xinxing*³-u më të lartë për praktikuesit. Të gjithë ata që janë këtu, rrinë që të mësojnë këtë Ligj të Lartë, kështu ju duhet të silleni si praktikues të vërtetë dhe të hiqni dorë nga përndjekjet e qëllimshme. Nëqoftëse vini për të mësuar praktikën dhe këtë Ligj të Lartë me qëllime të caktuara, ju nuk do të mësoni asgjë. Që t'ju them një të vërtetë, i tërë procesi i kultivimit për një praktikues është proces i heqjes dorë nga dëshirat njerëzore. Në shoqërinë njerëzore, njerëzit konkurojnë, mashtrojnë dhe dëmtojnë njeri-tjetrin për pak fitim personal. Të gjitha këto mentalitete duhet të hiqen. Sidomos për personat që po fillojnë praktikën sot, këto mentalitete duhet të hiqen akoma dhe më shumë.

¹ *qigong* (çi-gong)—formë ushtrimi tradicional kinez që kultivon qi (çi) apo “energji jetësore”.

² Dafa— Fa do të thotë Ligj i Universit, Dafa do të thotë Ligj i Lartë, parime. Që këtej e tutje do t'i referohemi me Ligj i Lartë.

³ *xinxing* (shin-shing)—term kinez që do të thotë cilësi e mendjes dhe e zemrës; karakter, moral. Për thjeshtësi do t'i referohemi këtu gjithmonë me karakter.

Unë nuk flas për kurim sëmundjesh këtu dhe as nuk do të kurojmë ne sëmundje. Por si praktikues i vërtetë ti nuk mund të kultivosh me trup të sëmurë. Unë do e pastroj trupin tënd. Pastrimi i trupit do të bëhet vetëm për ata që vijnë me të vërtetë për të mësuar praktikën dhe Ligjin. Ne theksojmë një pikë: Nëqoftëse nuk heq dorë nga dëshira për shërim apo merakun për sëmundjen, ne nuk mund të bëjmë dot asgjë dhe nuk mundemi të të ndihmojmë. Pse ndodh kjo? Sepse ekziston një parim i tillë në univers: Gjërat që i ndodhin njerëzve të zakonshëm, sipas Shkollës Buddhës, kanë të gjitha lidhje të paracaktuara nga fati. Lindja, plakja, sëmundjet dhe vdekja ekzistojnë si të tilla për njerëzit e zakonshëm. Për shkak të *karmës*⁴ së grumbulluar nga veprimet e këqija të mëparshme, njeriu ka sëmundje apo fatkeqësi; vuajtja është shpagim i borxhit karmik dhe për rrjedhojë askush nuk mund ta ndryshojë këtë sipas dëshirës. Ta ndryshosh këtë do të thotë që dikujt nuk do i duhet të paguajë borxhin pasi të jetë në borxh dhe kjo nuk mund të bëhet sipas dëshirës. Të bësh këtë është njësoj sikur të kryesh një vepër të keqe.

Disa njerëz mendojnë se të kurosh pacientë, të kurosh sëmundjet e tyre dhe t'u përmirësosh atyre shëndetin janë vepra të mira. Sipas mendimit tim, ata nuk i kurojnë sëmundjet me të vërtetë. Në vend që t'i eliminojnë ato, ata ose i kanë shtyrë për më vonë ose i kanë transformuar sëmundjet e tyre. Që fatkeqësira të tilla t'i zhdukësh me të vërtetë, duhet të eliminohet karma. Sikur dikush të mund të kuronte me të vërtetë një sëmundje dhe të hiqte plotësisht një karmë të tillë, niveli i tij duhej të ishte shumë i lartë. Ai do të kish kuptuar një fakt: Parimet e shoqërisë së zakonshme njerëzore nuk mund të shkelen sipas dëshirës. Gjatë periudhës së praktikës kultivuese, një praktikues, nga zemërmirësia e tij apo e saj, mund të kryejë vepra të mira duke ndihmuar në kurimin e sëmundjeve dhe të kurojë sëmundjet e të tjerëve, apo të ruajë shëndetin e tyre—këto lejohen. Megjithatë, ai nuk mund t'i shërojë plotësisht sëmundjet e të tjerëve. Sikur shkakun e sëmundjes së një njeriu të zakonshëm të eliminohej me të vërtetë, një njeri që nuk praktikon do të shpëtonte pa sëmundje. Sapo ky person të dilte prej dere, ai do të mbetej një njeri i zakonshëm. Ai do të vazhdonte të konkuronte për përfitim personal si njerëzit e zakonshëm. Si t'ju eliminoka karma atij kështu? Është absolutisht e ndaluar.

Pse mund të bëhet kjo për një praktikues atëhere? Sepse një praktikues është shumë i çmuar, sepse ai apo ajo dëshiron të praktikojë kultivim. Prandaj, shfaqja e këtij mendimi është shumë e çmuar. Në Buddhizëm, flitet për natyrën e Buddhës. Kur dikush fillon të shfaqë natyrë Buddhe, Qëniet e Shumëlartësuara mund ta ndihmojnë atë. Çfarë do të thotë kjo? Po të më pyesni mua, meqenëse unë po jap mësim praktike të niveleve të larta, kjo ka të bëjë me parime të niveleve të larta si dhe me çështje të një rëndësie të madhe. Ne dimë që në këtë univers jeta e njeriut nuk krijohet në shoqërinë e zakonshme njerëzore; krijimi i jetës së vërtetë të dikujt ndodh në hapësirën e universit. Meqenëse ekzistojnë plot materie të llojeve të ndryshme në këtë univers, kjo materie mund të prodhojë jetë nëpërmjet ndërveprimeve të saj. Me fjalë të tjera, jeta më e hershme e dikujt vjen nga universi. Hapësira e universit është pikë së pari mëshirëplotë dhe përmban karakteristikën Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Në lindje, ai i asimilohet karakteristikës së universit. Por ndërsa numri i jetëve rritet, një formë kolektive marëdhëniesh shoqërore krijohet në të cilat disa mund të zhvillojnë egoizëm dhe gradualisht niveli i tyre bie. Nëqoftëse nuk mund të qëndrojnë në këtë nivel, ata duhet të bien më poshtë. Por edhe në këtë nivel, ata përsëri mund të bëhen jo aq të mirë dhe nuk mund të qëndrojnë as aty. Ata do të vazhdojnë të bien poshtë e më poshtë derisa, në fund, ata arrijnë këtë nivel të qënieve njerëzore.

E tërë shoqëria njerëzore është në të njëjtin nivel. Nga pikëpamja e aftësive mbinatyrale apo e Qënive të Shumëlartësuara, këto jetë duhet të ishin zhdukur me të rënë në këtë nivel. Megjithatë, nga zemërmirësia mëshirëplotë e tyre, Qëniet e Shumëlartësuara u dhanë atyre dhe një mundësi dhe ndërtuan këtë mjedis dhe dimension të veçantë. Të gjitha jetët në këtë dimension janë të ndryshme

⁴ *Karmë(a)*—një substancë e zezë në trup me ekzistencë materiale në një dimension tjetër që mblidhet nga veprimet e këqija të personit.

nga ato të dimensioneve të tjera të universit. Jetët në këtë dimension nuk mund t'i shohin jetët e dimensioneve të tjera apo të vërtetën e universit. Kështu, qëniet njerëzore janë në fakt të humbura si në labirinth. Në mënyrë që të shërojnë sëmundjet apo zhdukin fatkeqësitë dhe karmën, njerëzit duhet të praktikojnë kultivim dhe të kthehen në origjinë, në veten e tyre të vërtetë. Kështu e shohin këtë çështje të gjitha shkollat e ndryshme kultivuese. Njeriu duhet të kthehet në origjinë, në veten e vet të vërtetë; ky është qëllimi i vërtetë i të qenit njeri. Prandaj, sapo një person dëshiron të praktikojë kultivim, kjo konsiderohet si shfaqje e natyrës së Buddhës. Një mendim i tillë është shumë i çmuar, sepse ky njeri dëshiron të kthehet në origjinë, në veten e vet të vërtetë dhe të dalë nga niveli njerëzor.

Mbase të gjithë e kanë dëgjuar këtë thënie në Buddhizëm: “Kur dikujt i shfaqet natyra e Buddhës, kjo trondit *botën e dhjetë drejtimeve*⁵.” Kushdo që e shikon këtë do të vijë të kontribojë e ta ndihmojë këtë person pa kushte. Kur i afron shpëtim njerëzimit, Shkolla Buddhës nuk vë kushte apo kërkon ndonjë shpërblim dhe do të ndihmojë pa u kursyer. Prandaj, ne mund të bëjmë shumë gjëra për praktikuesit. Por për një njeri të zakonshëm i cili vetëm don të mbetet njeri i zakonshëm dhe të shërojë sëmundjen e tij, kjo nuk bëhet. Disa njerëz mund të mendojnë, “Do të praktikoj kultivim pasi të më shërohet sëmundja.” Nuk ka kushte për praktikën kultivuese dhe personi duhet të praktikojë kultivim sepse ashtu dëshiron. Por trupat e disave kanë sëmundje dhe trupat e disa të tjerëve përmbajnë mesazhe të çrregullta. Disa njerëz nuk kanë praktikuar kurrë qigong. Ka gjithashtu njerëz të cilët e kanë praktikuar atë për dekada të tëra dhe akoma sillen në nivelin e *qi*⁶-së, pa bërë përparim në kultivim.

Çfarë duhet bërë për këtë? Ne do t'i pastrojmë trupat e tyre dhe do t'i aftësojmë ata të praktikojnë kultivim drejt niveleve të larta. Ekziston një periudhë kalimtare në nivelin më të ulët të praktikës kultivuese dhe ky është pastrimi i plotë i trupit tuaj. Të gjitha gjërat e këqija në mendjen tuaj, fusha karmike që rrethon trupin dhe elementet që e bëjnë trupin tuaj të pashëndetshëm do të pastrohen. Po të mos pastrohen, si mundeni ju, me një trup të tillë të papastërt e të errët dhe me një mendje të keqe, të praktikoni kultivim drejt niveleve të larta? Ne nuk praktikojmë qi këtu. Ju nuk do të keni nevojë të praktikoni gjëra të një niveli kaq të ulët dhe ne do t'ju shtyjmë përtej tyre, duke e bërë trupin tuaj të arrijë një gjendje të çliruar nga çdo sëmundje. Ndërkohë, ne do të vendosim në trupin tuaj një sistem mekanizmash të gatshëm të nevojshëm për hedhjen e themelit në nivel të ulët. Në këtë mënyrë ju do të praktikoni kultivim në nivel shumë të lartë.

Sipas rregullave të praktikës kultivuese, ekzistojnë tre nivele kur përfshijmë qi-në. Por në praktikën e vërtetë kultivuese, janë gjithsej dy nivele kryesore (duke përjashtuar praktikimin e qi-së). Njeri është praktikë kultivuese e Ligjit-Në-Botën-Trefishe⁷ (*Shi-Jian-Fa*), ndërsa tjetri është praktikë kultivuese e Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe (*Chu-Shi-Jian-Fa*). Praktika kultivuese e Ligjit-Në-Botën-Trefishe dhe Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe është e ndryshme nga ato të “përtej-botës” dhe “në-botë” në tempuj, të cilat janë terma teorike. Praktika jonë është transformimi i vërtetë i trupit njerëzor nëpërmjet praktikës kultivuese në dy nivele kryesore. Meqenëse gjatë praktikës kultivuese në Ligjin-Në-Botën-Trefishe trupi i njeriut do të pastrohet në mënyrë të vazhdueshme, ai do të zëvendësohet plotësisht me materie energjie të lartë kur personi arrin fazën më të lartë të Ligjit-Në-Botën-Trefishe. Praktika kultivuese e Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe është në fakt kultivim i një trupi Buddhë. Ky trup përbëhet prej materie energjie të lartë dhe të gjitha fuqitë supernormale do të rihvillohen. Këto janë dy nivelet kryesore të cilave u referohemi ne.

Ne besojmë në lidhje të paracaktuara nga fati. Unë mund ta bëj këtë gjë për secilin që është këtu. Tani kemi pak më shumë se dy mijë veta. Unë mund ta bëj këtë edhe për disa mijëra vetë apo më shumë, madje dhe për më shumë se dhjetë mijë vetë. Kjo do të thotë që ju nuk keni nevojë të

⁵ *bota e dhjetë drejtimeve*—sipas konceptit Buddhist universi ka dhjetë drejtime.

⁶ *qi*(çì)—në kulturën kineze besohet të jetë “energji jetësore”; në krahasim me gongun është formë më e ulët energjie.

⁷ Ligj-Në-Botën-Trefishe—sipas Buddhizmit dikush duhet t'i nënshtrohet samsarës (ciklit të ringjalljes) nëse ai nuk ka arritur kultivimin në Ligj-Përtej-Botës-Trefishe.

praktikoni në nivel të ulët. Me të pastruar trupat tuaj dhe shtyrë ju lart, unë do të instaloj një sistem të plotë praktike kultivuese në trupin tuaj. Menjëherë ju do të praktikoni kultivim në nivele të larta. Por kjo do të bëhet vetëm për praktikuesit që vijnë të praktikojnë kultivim me ndershmëri; të qenit ulur këtu nuk do të thotë që ju jeni praktikues. Këto gjëra do t'ju jepen nëqoftëse ju do të ndryshoni thelbësisht të menduarit tuaj dhe nuk kufizohet vetëm me këto. Më vonë ju do të kuptoni çfarë i kam dhënë secilit. Ne nuk flasim për shërim sëmundjesh këtu. Përkundrazi, ne flasim për balancim të gjithanshëm të trupit të praktikuesve që t'ju bëjmë juve të aftë të praktikoni kultivim. Me një trup të sëmurë ju nuk mund të zhvilloni aspak *gong*⁸. Prandaj, ju nuk duhet të vini tek unë për të shëruar sëmundje dhe as do e bëj unë një gjë të tillë. Qëllimi kryesor i daljes sime në publik është të udhëheq njerëzit drejt nivelesh të larta, më të vërtetë të udhëheq njerëzit drejt niveleve të larta.

Nivele të Ndryshme Kanë Ligj të Ndryshëm

Në të kaluarën, shumë mjeshtër qigongu thonin se qigongu ka të ashtuquajturit nivel fillestar, nivel të mesëm dhe nivel të përparuar. Kjo ishte e tëra qi dhe vetëm diçka në nivelin e praktikimit të qi-së, megjithatë ishte klasifikuar si qigong i nivelit fillestar, nivelit të mesëm dhe nivelit të përparuar. Përsa i përket gjërave të niveleve me të vërtetë të larta, shumica e praktikuesve të qigongut nuk kishin dijeni, sepse ata thjesht nuk i njihnin fare ato. Që tani e tutje, të gjitha gjërat që ne do trajtojmë do të jenë Ligj i niveleve të larta. Gjithashtu unë do të rehabilitoj emrin e praktikës kultivuese. Në leksionet e mia unë do të flas për disa fenomene të pashëndetshme në komunitetin e kultivuesve. Po ashtu do të diskutoj si duhet t'i trajtojmë dhe konsiderojmë këto fenomene. Para së gjithash, të japësh mësim në sistem kultivimi dhe Ligj të niveleve të larta, lidhet me shumë aspekte dhe çështje të një rëndësie shumë të lartë, disa prej të cilave janë madje shumë serioze; unë dëshiroj t'i vë dhe këto në dukje. Disa ndërhyrje në shoqërinë e zakonshme njerëzore, sidomos në komunitetin e kultivuesve, vijnë nga dimensione të tjera. Do doja po ashtu t'i bëja këto të njohura. Në të njëjtën kohë, do t'i zgjidh këto probleme për praktikuesit tanë. Nëqoftëse këto probleme do liheshin të pazgjidhura, ju nuk do të ishit në gjendje të praktikoni kultivim. Në mënyrë që t'i zgjidhim përfundimisht këto probleme, ne duhet të trajtojmë secilin si praktikues të vërtetë. Sigurisht, nuk është e lehtë që ju të ndryshoni të menduarit tuaj menjëherë; ju do e transformoni të menduarit tuaj gradualisht gjatë leksioneve që vijnë. Gjithashtu, unë shpresoj që të gjithë do e kenë mendjen tek ato që dëgjojnë. Mënyra si unë jap mësim mbi praktikën kultivuese është e ndryshme nga ajo e të tjerëve. Disa e japin duke folur shkurtimisht mbi teorinë e metodat e praktikës së tyre. Pastaj ata lidhin mesazhet e tyre me ju dhe ju mësojnë një grup ushtrimesh dhe kjo do të ishte e tëra. Njerëzit tashmë janë mësuar me këtë mënyrë të mësimi të praktikës.

T'u japësh njerëzve mësim të vërtetë në një sistem kultivimi kërkon t'u mësosh atyre Ligjin apo Taon. Në dhjetë leksione unë do të bëj të njohura të gjitha parimet e nivelit të lartë në mënyrë që ju të mund të praktikoni kultivim. Përndryshe, ju nuk mundeni aspak të praktikoni kultivim. Të gjitha ato që kanë dhënë mësim të tjerët, janë në nivelin e shërimit e mbajtjes së trupit në formë. Nëse ju dëshironi të praktikoni kultivim drejt niveleve të larta, ju nuk do të keni sukses në kultivim pa udhëheqjen e Ligjit të niveleve të larta. Kjo ngjan me të shkuarit në shkollë: Po shkove në universitet me tekste të shkollës fillore, ti do të mbetesh nxënës i shkollës fillore. Disa njerëz mendojnë se kanë mësuar shumë praktika, si këtë apo atë praktikë dhe kanë një piring me çertifikata mbarimi, por gongu i tyre nuk ka bërë ndonjë përparim. Ata mendojnë se ato janë thelbi i vërtetë i qigongut dhe e tëra ajo çfarë është qigongu. Jo, ato nuk janë veçse një pjesë e përciptë e qigongut dhe diçka e nivelit më të ulët. Qigongu nuk kufizohet tek këto gjëra, sepse është praktikë kultivuese si dhe diçka shumë e gjërë

⁸ *gong*—1. energji e kultivuar; 2. praktikë që kultivon këtë energji.

dhe e thellë. Po ashtu, në nivele të ndryshme ekziston Ligj i ndryshëm. Kështu, ai është i ndryshëm nga ato praktikat e qi-së që ne njohim tani që mbeten të njëjta pamvarësisht sa shumë i mësoni. Për shembull, megjithëse keni studjuar tekste të shkollës fillore britanike, tekste të shkollës fillore amerikane, tekste të shkollës fillore japoneze e tekste të shkollës fillore kineze, ju përsëri mbeteni nxënës i shkollës fillore. Sa më shumë mësim qigongu të nivelit të ulët që keni marrë dhe sa më shumë keni përvetësuar prej tyre, aq më shumë dëm do të pësoni—trupi juaj tashmë është ngatërruar.

Unë duhet të theksoj dhe një çështje tjetër: Praktika jonë kultivuese kërkon mësimin si të metodës kultivuese ashtu dhe të Ligjit. Disa murgj në tempuj, sidomos ata të sektit Zen, mund të kenë opinione të ndryshme. Sapo ata dëgjojnë për mësimdhënien e Ligjit, ata nuk duan të dëgjojnë për të. Pse ndodh kjo? Sekti Zen beson që Ligji nuk duhet të mësohet, se Ligji nuk është Ligj po u mësu dhe se nuk ka Ligj që është i mësueshëm; dikush mund të kuptojë diçka vetëm nëpërmjet zemrës dhe shpirtit. Për pasojë, deri më sot sekti Zen nuk ka mundur të mësojë asnjë Ligj. Patriarku Bodhidharma i sektit Zen e dha mësimin e tij kështu duke u bazuar në një thënie të Sakyamunit⁹ i cili pat thënë: “Asnjë Dharma¹⁰ nuk është përfundimtare.” Ai themeloi sektin Zen duke u bazuar në këtë thënie të Sakyamunit. Ne e konsiderojmë këtë mënyrë kultivimi “të gërmosh në bririn e demit”¹¹. Pse themi që është si të gërmosh në bririn e demit? Kur Bodhidharma filloi të gërmojë në të, ai ndjeu që ish shumë i gjërë. Kur Patriarku II gërmoi, ai ndjeu që nuk ish dhe aq i gjërë. Prap se prap ishte i kalueshëm në kohën e Patriarkut III, por për Patriarkun IV ishte tashmë i ngushtë. Nuk mbeti pothuajse fare hapësirë për të ecur më tutje për Patriarkun V. Në kohën e Huineng, Patriarkut VI, kishte arritur një fund pa krye dhe nuk mund të shkonte më tutje. Po të shkosh sot tek një i sektit Zen për të studjuar Dharmën, nuk duhet të bësh asnjë pyetje. Po të bësh ndonjë pyetje, ai apo ajo do të kthehet dhe godasë me shkop në kokë, që quhet “paralajmërim me shkop”. Kjo do të thotë që ti nuk duhet të pyesësh por të bëhesh i vetëdijshëm ndaj kuptimit vetë. Ti do të thoje, “Unë erdha të studjoj sepse nuk di gjë. Për çfarë të bëhem i vetëdijshëm? Pse më godet me shkop?!” Kjo tregon që sekti Zen ka arritur fundin e bririt të demit dhe nuk ka se çfarë mëson më. Edhe Bodhidharma pat thënë që mësimet e tij mund t’i kaloheshin vetëm gjashtë brezave, pas së cilës ato nuk do të shërbenin më për asgjë. Disa qindra vjet kanë kaluar. Megjithatë ka njerëz sot që akoma mbahen fort pas doktrinës së sektit Zen. Kush është kuptimi i vërtetë i thënies së Sakyamunit, “Asnjë Dharma nuk është përfundimtare”? Niveli i Sakyamunit ishte Tathagata¹². Shumë murgj pas tij nuk arritën nivelin e Sakyamunit, të menduarit e sferës së tij të mendimit, kuptimin e vërtetë të Dharmës së shpallur prej tij, apo të kuptimit të vërtetë të asaj që ai tha. Prandaj, njerëzit pas tij e interpretuan atë në këtë apo atë mënyrë me interpretime shumë të ngatërruara. Ata menduan se “Asnjë Dharma nuk është përfundimtare” do të thoshte se ajo nuk duhej mësuar dhe se nuk do të ishte Dharma po të mësohej. Në fakt, nuk është ky kuptimi. Kur Sakyamuni arriti pikën përfundimtare të kultivimit dhe u lartësua shpirtërisht nën një pemë Bodhi, ai nuk arriti nivelin e Tathagatës menjëherë. Ai vazhdimisht përmirësonte veten gjatë dyzet e nëntë viteve të mësimdhënies së Dharmës së tij. Sa herë që ai ngrihej në një nivel më të lartë, ai shikonte të kaluarën dhe kuptonte se Dharma që sapo kish mësuar ishte e tëra e gabuar. Kur bënte përparim më tej, zbulonte përsëri se Dharma që sapo kish mësuar ishte e gabuar. Ai vazhdimisht përparoi kështu gjatë gjithë dyzet e nëntë viteve të tij. Sa herë që arrinte një nivel më të lartë, ai do të zbulonte se kuptimi i Dharmës që kish dhënë mësim më parë ishte e një niveli shumë të ulët. Gjithashtu ai zbuloi se Dharma e çdo niveli është gjithmonë manifestim i Dharmës në atë nivel, se ekziston Dharmë për çdo nivel dhe se asnjëra prej tyre nuk

⁹ Sakyamuni (sakyamuni)—Buddha historik, Guatama Siddhartha.

¹⁰ Dharma—mësimet e Buddhës Sakyamuni.

¹¹ “të gërmosh në bririn e demit”—një shprehje kineze që do të thotë të shkosh drejt një fundi pa krye apo një qorrrokaku.

¹² Tathagata—një qenie e lartë me Shkallë Arritjeje të Shkollës Buddhës i cili është më lart se nivelet e Bodhisattvës dhe Arhatit.

ishite e vërteta absolute e universit. Dharma e niveleve të larta është më afër karakteristikës së universit sesa ajo e niveleve më të ulta. Prandaj, ai tha: “Asnjë Dharma nuk është përfundimtare”.

Në fund, Sakyamuni gjithashtu deklaroi, “Nuk kam mësuar ndonjë Dharma gjatë jetës sime.” Sekti Zen përsëri e keqkuptoi këtë sikur do të thoshte se nuk ka Dharma që mund të mësohet. Në vitet e fundit të tij, Sakyamuni kish arritur nivelin e Tathagatës. Pse tha ai që nuk kish mësuar ndonjë Dharma? Çfarë çështje ngrinte ai në të vërtetë? Ai donte të thonte se “Dhe në nivelin tim të Tathagatës, unë nuk pashë as të vërtetën përfundimtare të universit e as kush ishte Dharma përfundimtare.” Kështu, ai u kërkoi njerëzve më vonë të mos i merrnin fjalët e tij si të vërtetën absolute apo të pandryshueshme. Përndryshe, kjo do t’i kufizonte njerëzit më vonë tek apo më poshtë nivelit të Tathagatës dhe ata nuk do të mundnin të arrinin nivele më të larta. Më pas njerëzit nuk mundën ta kuptonin kuptimin e vërtetë të fjalëve të tij dhe menduan se po të mësohej, Dharma nuk është Dharma—ata e kuptuan atë në këtë mënyrë. Në fakt, Sakyamuni pat thënë se ekziston Dharma në nivele të ndryshme dhe se Dharma e çdo niveli nuk është e vërteta absolute e universit. Megjithatë Dharma e një niveli të caktuar merr rol udhëheqës në atë nivel. Në fakt ai shpjegoi këtë parim.

Në të kaluarën, shumë njerëz, sidomos ata të sektit Zen, kishin një paragjykim dhe pikëpamje tej mase të shtrembëruar. Si mund të praktikosh dhe të kultivosh veten pa të të mësuar dhe udhëzuar? Ka shumë historira në Buddhizëm. Disa njerëz mund të kenë lexuar për njerin që shkoi në qiell. Me të arritur në një mbretëri qiellore, ai zbuloi se çdo fjalë në *Sutrën Diamant*¹³ atje ishte e ndryshme nga ajo këtu dhe se kuptimi ishte komplet i ndryshëm. Si mund të ishte kjo e ndryshme nga ajo në botën e zakonshme njerëzore? Ka gjithashtu njerëz që thonë: “Shkrimi i shenjtë në Parajsën e Lumturisë Absolute është tërësisht i ndryshëm nga ai këtu tek ne dhe nuk është aspak e njëjta gjë. Jo vetëm fjalët që janë të ndryshme, por dhe nënkuptimet e kuptimet janë të ndryshme sepse ato kanë ndryshuar.” Në fakt, kjo ndodh për shkak se i njejt Ligj ka transformime dhe forma manifestimi të ndryshme në nivele të ndryshme dhe se ajo mund të luajë rol udhëheqës të ndryshëm për praktikuesit në nivele të ndryshme.

Dihet që në Buddhizëm ekziston një libër i quajtur *Udhëtim për në Parajsën e Lumturisë Absolute*. Aty thuhet se një murgu ndërsa rrinte ulur në meditim, i shkoi Shpirti Primordial¹⁴ (*yuanshen*) në Parajsën e Lumturisë Absolute dhe pa skenat e saj. Ai kaloi atje një ditë; kur u kthye në botën njerëzore kishin kaluar gjashtë vjet. A e pa ai atë? Ai e pa, por ajo që ai pa nuk ishte pamja e saj e vërtetë. Pse? Sepse niveli i tij nuk ishte shumë i lartë dhe ajo që ju paraqit ishte vetëm manifestimi i Ligjit të Buddhës në nivelin e tij. Meqenëse një parajsë si ajo është manifestim i përmbajtjes së Ligjit, ai nuk mund të shihte pamjen e saj aktuale. Ky është kuptimi i “Asnjë Dharma nuk është përfundimtare”.

Zhen-Shan-Ren është Kriteri i Vetëm për të Dalluar Njerëzit e Mirë nga Njerëzit e Këqinj

Në Buddhizëm njerëzit diskutojnë çfarë është Ligji i Buddhës. Po ashtu ka njerëz që besojnë se Dharma e shprehur në Buddhizëm është Ligji i plotë i Buddhës. Në fakt, nuk është kështu. Dharma që Sakyamuni shpalli 2500 vjet më parë ishte vetëm për njerëzit në një nivel shumë të ulët; ju mësua atyre që sapo kishin dalë nga një shoqëri primitive dhe akoma kishin mëndje shumë të thjeshta. Tani

¹³ *Sutra Diamant* —një shkrim i shenjtë i lashtë në Buddhizëm.

¹⁴ Shpirti Primordial—ky ndahet në Shpirtin Kryesor (*zhu yuanshen*) dhe Shpirtin Ndihmës (*fu yuanshen*). Në mendimin tradicional kinez, besohet se shumë shpirta ekzistojnë në trupin e njeriut dhe janë përgjegjës për funksione e procese të caktuara (psih. shumë besonin se një shpirt qëndron në mëlçë dhe rregullon funksionet e saj).

është Periudha e Fund-Dharmës¹⁵ siç i referohej ai. Tani njerëzit nuk mund të praktikojnë kultivim më me atë Dharmë. Në Periudhën e Fund-Dharmësh, edhe murgjit në tempuj kanë vështirësi të shpëtojnë veten le pastaj t'u afrojnë shpëtim të tjerëve. Dharmë që përhapit Sakyamuni në atë kohë mori parasysh gjendjen e atëherëshme dhe ai nuk e shpalli të tërë Ligjin e Buddhës që ai kuptoi në nivelin e vet. Gjithashtu është e pamundur ta mbash atë të pandryshuar përgjithmonë.

Me përparimin e shoqërisë, mëndja e njeriut bëhet më e sofistikuar duke e bërë jo të lehtë për njerëzit që të praktikojnë akoma në atë mënyrë. Dharmë në Buddhizëm nuk mund të përmbledhë të gjithë Ligjin e Buddhës dhe është vetëm një pjesë tepër e vogël e Ligjit të Buddhës. Ka shumë mënyra të tjera të mëdha kultivimi në Shkollën e Buddhës që i transmetohen njerëzve. Gjatë gjithë historisë ato i janë kaluar një dishepulli të vetëm. Nivele të ndryshme kanë Ligj të ndryshëm dhe dimensione të ndryshme kanë Ligj të ndryshëm, të gjitha këto përbëjnë manifestimet e shumëllojshme të Ligjit të Buddhës në dimensione të ndryshme dhe në nivele të ndryshme. Sakyamuni pat përmendur gjithashtu se janë tetëdhjetë e katër mijë mënyra kultivimi për kultivim Buddhë. Megjithatë, Buddhizmi përfshin vetëm mbi dhjetë mënyra kultivimi, si sektin Zen, Tokën e Pashkelur, Tiantai, Huayan dhe Tantrizmin; këto nuk mund të përfaqësojnë të gjithë Ligjin e Buddhës. Vetë Sakyamuni nuk e bëri të njohur të gjithë Dharmën e tij; ai vetëm mësoi atë pjesë të saj nga e cila mund të përfitonin njerëzit me aftësinë kuptuese të asaj kohe.

Çfarë është Ligji i Buddhës atëhere? Karakteristika më thelbësore e këtij universi, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), është manifestimi më i lartë i Ligjit të Buddhës. Është Ligji i Buddhës më i qenësishëm. Ligji i Buddhës manifeston forma të ndryshme në nivele të ndryshme dhe merr role të ndryshme udhëheqëse në nivele të ndryshme. Sa më i ulët niveli aq më kompleks është ai. Kjo karakteristikë, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), gjendet në grimcat mikroskopike të ajrit, gurit, drurit, tokës, hekurit dhe çelikut, trupit të njeriut, si dhe në të gjithë materien. Në kohët e lashta thuhej se çdo objekt dhe materie në univers përbëhet nga Pesë Elementet¹⁶; edhe ato e kanë këtë karakteristikë, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Një praktikues mund të kuptojë vetëm manifestimin specifik të Ligjit të Buddhës në nivelin që ka arritur kultivimi i tij apo i saj që është Shkalla e Arritjes¹⁷ dhe niveli i tij apo i saj i kultivimit. Në përgjithësi, Ligji është i pakufi. Nga pikëpamja e niveleve më të larta, është shumë i thjeshtë sepse Ligji i ngjan një piramide në formë. Në pikën më të lartë mund të përmblihet në tre fjalë: Zhen, Shan, Ren. Ai është shumë kompleks kur manifestohet në nivele të ndryshme. Të marrim një qenie njerëzore si shembull. Shkolla Tao e konsideron trupin njerëzor një univers të vogël. Njeriu ka trupin fizik, megjithatë një person nuk është i plotë vetëm me trupin fizik. Ai duhet gjithashtu të ketë temperament, personalitet, karakter dhe Shpirt Primordial në mënyrë që të konsiderohet një person i plotë dhe i pavarur me individualitet. E njejtja gjë është e vërtetë dhe për universin tonë, i cili ka Kashtën e Kumtrit, galaksitë e tjera, si dhe jetë dhe ujë. Të gjitha objektet dhe materia në këtë univers janë aspekte të ekzistencës materiale. Por në të njëjtën kohë ajo gjithashtu përmban karakteristikën Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Të gjitha grimcat mikroskopike të materies e manifestojnë këtë karakteristikë—madje edhe grimcat jashtëzakonisht mikroskopike e kanë këtë veti.

Kjo karakteristikë, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), është kriteri për të matur të mirën dhe të keqen në univers. Çfarë është e mirë apo e keqe? Kjo gjykohet prej kësaj karakteristike. *De*¹⁸ që përmendet në të kaluarën përdoret gjithashtu për të njejtin qëllim. Sigurisht, standarti moral në shoqërinë e sotme ka ndryshuar tashmë dhe është shtrembëruar. Tani, kur dikush

¹⁵ Periudha e Fund-Dharmës—sipas Buddha Sakyamunit, kjo periudhë do të fillonte 500 vjet pasi ai të kish ndrruar jetë dhe Dharmë e tij nuk mund t'i shpëtonte më njerëzit.

¹⁶ Pesë Elementet—metali, druri, uji, zjarri dhe dheu.

¹⁷ Shkalla e Arritjes—niveli i arritjes së individit në kultivim në Shkollën e Buddhës, psh. Arhat, Bodhisattva, Tathagata, etj.

¹⁸ *de* (dë)—“virtyt,” “meritë”; një substancë e çmuar e bardhë. Këtu ne do t'i referohemi gjithmonë me virtyt.

mëson nga Lei Feng¹⁹, ai apo ajo mund të damkoseshin si të sëmurë mendore. Por kush në vitet 1950 apo 1960 do thoshte se ky person është i sëmurë mendor? Standarti moral njerëzor po bie në mënyrë të jashtëzakonshme dhe vlerat morale njerëzore po keqësohen për ditë. Njerëzit vetëm ndjekin interesin personal dhe do të dëmtonin të tjerët për pakëz fitim personal. Ata konkurojnë dhe luftojnë kundër njeri tjetrit duke përdorur të gjitha mënyrat. Mendojeni pak secili: A do të lejohej kjo të vazhdonte? Kur dikush kryen një vepër të keqe, ai nuk do e besonte po t'ja vije në dukje se po bën një veprim të keq. Ai person me të vërtetë nuk do e besonte se po bën diçka të keqe. Disa njerëz e vlerësojnë veten me standartin e rënë moral. Meqenëse kriteri i vlerësimit ka ndryshuar, ata e konsiderojnë veten më të mirë se të tjerët. Pamvarësisht sa ndryshon standarti i moralit njerëzor, kjo karakteristikë e universit mbetet e pandryshuar dhe është kriteri i vetëm që dallon njerëzit e mirë nga njerëzit e këqinj. Si praktikues, ju duhet të silleni në përputhje me këtë karakteristikë të universit e jo sipas standartit të njerëzve të zakonshëm. Nëqoftëse don të kthehesh në origjinë, në veten tënde të vërtetë dhe të përparosh në praktikën kultivuese, ti duhet të sillesh sipas këtij kriteri. Si qenie njerëzore, ti je një person i mirë vetëm po ndoqe karakteristikën e universit të Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Një njeri që devijon nga kjo karakteristikë është me të vërtetë një person i keq. Në vendin e punës apo në shoqëri, disa njerëz mund të thonë që ti je i keq, megjithatë nuk është e thënë që ti të jesh i keq. Disa njerëz thonë që ti je i mirë, por ti mund të mos jesh me të vërtetë i mirë. Si praktikues, po e asimilove veten në këtë karakteristikë ti je një njeri që ka arritur Taon—parimi është kaq i thjeshtë.

Në praktikimin e Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), Shkolla Tao thekson kultivimin e Zhen. Prandaj, Shkolla Tao beson në kultivimin e Zhen për të ushqyer natyrën e njeriut; njeriu duhet të thotë të vërtetën, të bëjë gjërat me vërtetësi, të bëhet njeri i ndershëm, të kthehet në origjinë, në veten e vet të vërtetë dhe në fund të bëhet një Njeri i Vërtetë nëpërmjet kultivimit. Megjithatë, ajo përfshin dhe Ren e Shan, por me theks në kultivimin e Zhen. Shkolla Buddhës thekson Shan të Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Meqenëse kultivimi i Shan mund të zhvillojë zemërmirësi mëshiruese të madhe dhe kur zemërmirësia zhvillohet njeriut i duket se të gjitha qëniet vuajnë, Shkolla Buddhës zhvillon kështu dëshirën për t'u afruar shpëtim të gjitha qënieve. Ka gjithashtu dhe Zhen dhe Ren, por me theks në kultivimin e Shan. Falun Dafa jonë bazohet në standartin më të lartë të universit, Zhen, Shan dhe Ren, të gjitha këto ne i kultivojmë në të njëjtën kohë. Sistemi që kultivojmë ne është i pamasë.

Qigong Është Kulturë Parahistorike

Çfarë është qigong? Shumë mjeshtër qigongu flasin për këtë. Ajo që them unë është e ndryshme nga ajo që thonë ata. Shumë mjeshtër qigongu flasin për të nga niveli i tyre, ndërsa unë flas mbi kuptimin e qigongut nga një nivel më i lartë që është plotësisht i ndryshëm nga të kuptuarit e tyre. Disa mjeshtër qigongu thonë se qigong ka një histori prej dy mijë vjetësh në vendin tonë. Ka gjithashtu njerëz që thonë se qigong ka një histori prej tre mijë vjetësh. Disa njerëz thonë se qigong ka një histori prej pesë mijë vjetësh, që i afrohet asaj të qytetërimit tonë kinez. Akoma të tjerë thonë se bazuar në gërmimet arkeologjike, ai ka një histori prej shtatë mijë vjetësh dhe kështu e tejkalon historinë e qytetërimit tonë kinez. Por pamvarësisht si e kuptojnë ata, qigongu nuk do të ekzistonte shumë më herët se historia e qytetërimit njerëzor. Sipas teorisë së evolucionit të Darvinit, njerëzit evoluon nga bimë ujore në kafshë ujore. Më pas, ata kaluan të jetojnë në tokë dhe mbi pemë. Në tokë, ata u shndërruan në majmunë dhe së fundi evoluon në njerëzit modernë me kulturë dhe mendim. Në bazë të kësaj llogaritjeje, nuk kanë kaluar as dhjetë mijë vjet që nga dalja e qytetërimit njerëzor. Duke

¹⁹ Lei Feng—shembull i një personi me moral të lartë në vitet 1960 në Kinë.

parë akoma më herët, nuk kish as shkrim nëpërmjet lidhjes së nyjeve. Këta njerëz visheshin me gjethe pemësh dhe hanin mish të gjallë. Duke parë akoma dhe më herët, ata ishin plotësisht njerëz të egër dhe primitivë. Ata nuk do dinin as të përdornin zjarrin.

Megjithatë konstatojmë një problem. Plot relike kulturore në shumë vende të botës datojnë shumë më herët se historia e qytetërimit tonë njerëzor. Këto gjetje antike kanë një nivel relativisht të përparuar punimi. Përsa i përket vlerës artistike, ato janë mjaft të përparuara. Njerëzimi modern thjesht po imiton artet e popujve të vjetër dhe këto arte të tyre janë me vlerë të madhe artistike. Megjithatë ato janë relike nga më shumë se njëqind mijë vjet më parë, disa qindra mijra vjet më parë, disa miliona vjet, apo dhe mbi njëqind milion vjet më parë. Mendojeni pak: A nuk e bëjnë ato qesharake historinë e sotme? Në fakt nuk është për të qeshur sepse njerëzimi vjen duke e përmirësuar dhe rizbuluar veten. Kështu zhvillohet shoqëria. Të kuptuarit fillestar mund të mos jetë plotësisht i saktë.

Shumë njerëz kanë dëgjuar për “kulturën parahistorike”, gjithashtu e njohur si “qytetërim parahistorik”. Le të flasim për qytetërimin parahistorik. Në këtë tokë, kemi kontinentet e Azisë, Evropës, Amerikës së Jugut, Amerikës së Veriut, Oqeanisë, Afrikës dhe Antarktikës. Gjeologët i quajnë këto pllaka kontinentale. Që nga formimi i pllakave kontinentale deri më sot, kanë kaluar disa dhjetëra milionë vjet. Me një fjalë, shumë kontinente kanë dalë nga fundi i oqeanëve dhe gjithashtu shumë kontinente janë fundosur në fund të tyre. Kanë kaluar mbi dhjetëra miliona vite që kurse ato u stabilizuan në gjendjen e tanishme. Nën ujën e shumë oqeanëve janë zbuluar disa objekte arkitekturore të lashta, të larta e të mëdha. Këto ndërtesa janë punuar shumë bukur dhe nuk janë trashëgim kulturor i njerëzimit tonë modern. Atëhere ato duhet të kenë qenë ndërtuar para se të fundoseshin në fundin e oqeanit. Kush i krijoi këto qytetërimet dhjetëra milionë vite më parë? Në atë kohë, raca jonë njerëzore nuk ishte as majmunë. Si mund të krijonim ne gjëra me kaq mençuri? Arkeologët në botë kanë zbuluar një organizëm të quajtur trilobit që pat ekzistuar ndërmjet 600 dhe 260 milionë vjet më parë. Ky lloj organizmi u zhduk 260 milionë vjet më parë. Një shkencëtar amerikan ka zbuluar një fosil trilobiti me një gjurmë njeriu mbi të; duket qartë se gjurma ishte vënë mbi fosil nga një njeri me këpucë. A nuk i qesh kjo historianët? Sipas teorisë së evolucionit të Darvinit, si mund të kishte njerëz 260 milionë vjet më parë?

Në muzeun e Universitetit Kombëtar të Perusë gjendet një shkëmb i skalitur me një figurë njeriu. Pas investigimit ishte përcaktuar se kjo figurë njerëzore ishte skalitur tridhjetë mijë vjet më parë. Megjithatë, kjo figurë njeriu është e veshur me rroba, kapele dhe këpucë, me një teleskop në dorë dhe ai po vëzhgon trupat qiellorë. Si mund të tjerënin pëlhurë dhe bënin robe njerëzit tridhjetë mijë vjet më parë? Akoma më e papërceptueshme, ai po vëzhgonte trupat qiellorë me teleskop dhe kishte një fare njohurie astronomike. Ne kemi menduar gjithmonë se ishte Galileo, një Evropian, ai që zbuloi teleskopin, duke i dhënë një histori prej vetëm më shumë se treqind vjetësh. Atëhere kush e zbuloi teleskopin tridhjetë mijë vjet më parë? Ka akoma shumë të panjohura të pazgjdhura. Për shembull, ka piktura të gdhendura në shumë shpella të Francës, Afrikës Jugut dhe të Alpeve që duken shumë reale dhe si të gjalla. Figurat e gdhendura aty janë jashtëzakonisht të bukura dhe janë të ngjyrosura me një lloj boje minerali. Të gjithë këta njerëz kanë veshur rroba bashkëkohore që duken pak si veshje perëndimore dhe ata kanë veshur pantallona të ngushta. Disa njerëz mbajnë diçka të ngjashme me llullat, ndërsa të tjerë mbajnë bastonë dhe kanë kapele. Si mundën majmunët e disa qindra mijra viteve më parë të arrijnë një nivel artistik të përparuar të tillë?

Le të japim një shembull tjetër të një kohe më të largët, Republika Gabonit në Afrikë ka mineral uraniumi. Ky vend është relativisht i pazhvilluar. Ai nuk mund të prodhojë uranium vetë dhe e eksporton mineralin në vendet e zhvilluara. Në vitin 1972, një prodhues francez importoi mineralin e tyre të uraniumit. Pas testimesh në laborator, minerali uraniumit doli që kish qenë gërmuar dhe përdorur më parë. Atyre ju duk kjo mjaft e pazakontë dhe dërguan shkencëtarë për ta studjuar këtë. Shkencëtarë nga shumë vende të tjera shkuan atje të investigonin. Në fund, kjo minierë uraniumi u

verifikua të ishte një reaktor nuklear i përmasave të mëdha me një shtrirje shumë racionale. Edhe njerëzit modernë nuk do të mund ta krijonin atë. Atëhere kur ishte ndërtuar ajo? Ishte ndërtuar dy miliard vjet më parë dhe kish qënë në operim për 500 mijë vjet. Këto janë thjesht numra astronomikë dhe nuk mund të shpjegohen aspak me teorinë e evolucionit të Darvinit. Ka shumë shembuj të tjerë të ngjashëm. Ato që ka zbuluar komuniteti shkencor dhe teknologjik i sotëm janë të mjaftueshme të ndryshojne tekstet tona aktuale. Kur të menduarit konvencional të njerëzimit formon një mënyrë sistematike të punës dhe të të menduarit, idetë e reja e kanë shumë të vështirë të pranohen. Kur e vërteta del në pah, njerëzit nuk guxojnë ta pranojnë dhe instinktivisht e refuzojnë atë. Për shkak të ndikimit të marreveshjeve tradicionale, asnjë sot nuk i ka përmbledhur në mënyrë sistematike këto gjetje. Kështu, konceptet njerëzore gjithmonë mbetin prapa zhvillimeve. Sapo të flasësh për këto gjëra, ka njerëz që i quajnë ato paragjykime dhe i refuzojnë ato pamvarësisht nga fakti që ato janë zbuluar tashmë. Ato veçse nuk janë publikuar gjërësisht.

Shumë shkencëtarë të guximshëm jashtë vendit e kanë pranuar publikisht tashmë këtë si kulturë parahistorike dhe një qytetërim para këtij tonit. Me fjalë të tjera, kanë ekzistuar më shumë se një periudhë qytetërimi para qytetërimit tonë. Nëpërmjet relikeve të nxjerra nga toka, kemi gjetur prodhime që nuk janë vetëm prej njëres nga periudhat e qytetërimit. Kështu besohet se pas çdo here kur qytetërimet njerëzore u zhdukën, vetëm një numër i vogël njerëzish mbijetuan dhe ata bënë një jetë primitive. Më pas, ata gradualisht u rritën në numër dhe krijuan racën e re njerëzore, duke filluar një qytetërim të ri. Më vonë, ata përsëri u zhdukën dhe përsëri krijuan një racë të re njerëzore. Historia kalon thjesht përmes këtyre ndryshimeve në perudha të ndryshme. Fizikantët thonë se lëvizja e materies ndjek ligje të caktuara. Gjithashtu edhe ndryshimet e gjithë universit tonë ndjekin ligje.

Është e pamundur që planeti jonë Tokë, në këtë gjithësi të pamasë dhe në Kashtën e Kumtrit, të jetë rrotulluar në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha kohët. Mund të jetë përplasur me ndonjë planet tjetër apo të ketë pasur probleme të tjera që çuan në shkatërrime të mëdha. Nga pikëpamja e aftësive tona mbinatyrale, ishte planifikuar në atë mënyrë. Unë bëra një investigim të kujdesshëm një herë dhe gjeta se njerëzimi ka kaluar zhdukje të plota tetëdhjetë e një herë. Me pak mbetje nga qytetërimi i mëparshëm, vetëm një numër i vogël njerëzish mbijetonin dhe hynin në periudhën tjetër, duke bërë përsëri një jetë primitive. Me rritjen e popullsisë, qytetërimi do të lindte përsëri. Njerëzimi ka kaluar ndryshime të tilla nga koha në kohë tetëdhjetë e një herë dhe akoma nuk i kam zbuluar deri në fund. Kombi kinez flet për kohë kozmike, kushte të favorshme të tokës dhe harmoni njerëzore. Transformime të ndryshme kozmike dhe kohëra të ndryshme kozmike mund të sjellin kushte të ndryshme në shoqërinë njerëzore. Sipas fizikës, lëvizja e materies ndjek ligje të caktuara dhe kjo është e vërtetë edhe për lëvizjen e universit.

Referenca e mësipërme për kulturën parahistorike në radhë të parë tregon se qigong nuk u zbulua nga ky njerëzimi jonë. Ai u trashëguar nga një epokë shumë e largët dhe është gjithashtu një lloj kulture parahistorike. Nga shkrimet e shenjta Buddhiste mund të gjejmë disa thënie në lidhje me këtë. Sakyamuni pat thënë një herë se ai e kish përfunduar praktikën kultivuese disa qindra milionë *kalpa*²⁰ më parë. Sa vjet ka një kalpa? Një kalpa është numër për qindra milionë vjet. Një numër kaq i madh është thjesht i pa përceptueshëm. Nëse është e vërtetë, a nuk përkon kjo me historinë e njerëzimit dhe ndryshimet e tokës? Po ashtu, Sakyamuni përmend se kanë ekzistuar gjashtë Buddha primitivë para tij, se ai kishte mësues etj., të cilët kishin përfunduar të gjithë praktikën kultivuese disa qindra milionë kalpa më parë. Nëqoftëse e gjitha kjo është e vërtetë, a ka lloje praktikash nga ato praktika tradicionale dhe mësimet të vërteta që mësohen në shoqërinë tonë sot? Po të më pyesni mua, sigurisht që ka, por ato shihen rrallë. Në kohën tonë, qigongu i rremë e mashtrues dhe njerëz të zotëruar nga shpirtrat kanë shpikur gjëra nga vetja që të gënjejnë njerëzit dhe numri i tyre e tejkalon

²⁰ *kalpa*—periudhë që zgjat dy miliard vjet; këtu termi është përdorur si numër.

shumë herë atë të praktikave të vërteta të qigongut. Të dallosh të vërtetën nga gënjeshtria është e vështirë. Një praktikë qigongu e vërtetë nuk është e lehtë të dallohet dhe as e lehtë që të gjehet.

Në fakt, nuk është vetëm qigong që ka ardhur këtu nga një epokë e largët, por edhe Taiji²¹, Hetu, Luoshu²², *Libri i Ndryshimeve*²³, Tetë Triagramet²⁴ etj., të gjitha këto janë trashëguar nga parahistoria. Kështu, po t'i studjojmë dhe t'i kuptojmë ato nga pikëpamja e njeriut sot, ne nuk do të mundim t'i kuptojmë ato aspak. Nga niveli, perspektiva dhe pikëpamja e njeriut të zakonit, ti nuk mund të kuptosh gjëra të vërteta.

Qigong Është Praktikë Kultivuese

Përderisa qigong ka një histori kaq të gjatë, për çfarë është ai atëhere? Më lejoni t'ju them të gjithëve se përderisa ne jemi nga një mënyrë e lartë kultivimi në Shkollën e Buddhës, ne sigurisht që kultivojmë Buddha. Në Shkollën Tao, sigurisht kultivohet Tao që të arrihet Tao. Më lejoni t'ju them të gjithëve se “Buddha” nuk është supersticion. Është fjalë nga Sanskrit, një gjuhë e lashtë indiane. Kur arriti në Kinë, quhej “Fo Tuo”²⁵. Kishte po ashtu njerëz që e përkthyen atë “Fu Tu”²⁶. Ndërsa fjala qarkullonte, kinezët lanë jashtë një karakter dhe e quajtën “Fo”. Çfarë do të thotë në gjuhën kineze? Do të thotë “një njeri i lartësuar shpirtërisht,” një njeri që është lartësuar nëpërmjet praktikës kultivuese. Çfarë është supersticion këtu?

Mendojeni pak: Njeriu mund të zhvillojë aftësi supernormale nëpërmjet praktikës kultivuese. Në botë sot, njihen gjashtë aftësi supernormale, por në fakt ka më shumë. Unë do thoja se ekzistojnë mbi dhjetë mijë aftësi supernormale të vërteta. Ndërsa një njeri rrin ulur aty, pa lëvizur as këmbë as dorë, ai është i aftë të bëjë atë që të tjerët nuk e bëjnë dot as me këmbë e duar dhe mund të shikojë të vërtetën e çdo dimensionit në univers. Ky person mund të shohë të vërtetën e universit dhe gjëra që një njeri i zakonshëm nuk mundet t'i shohë. A nuk është ai një njeri që ka arritur Taon duke praktikuar kultivim? A nuk është ai një person i lartësuar shpirtërisht? Si mund të quhet ai i njejtë me një njeri të zakonshëm? A nuk është e saktë ta quajmë atë një njeri të lartësuar shpirtërisht? Në gjuhën e lashtë indiane ai quhet Buddha. Në fakt kjo është, kjo është ajo për të cilën shërben qigongu.

Me që flasim për qigong, disa njerëz mund të thonë, “Pa sëmundje kush do të praktikonte qigong?” Kjo nënkupton se qigong është për shërim sëmundjesh. Ky është një të kuptuar shumë, shumë i cekët. Ky nuk është faji juaj sepse shumë mjeshtër qigongu me të vërtetë bëjnë gjëra të tilla si shërime sëmundjesh dhe ruajtje të trupit. Ata të gjithë flasin për shërim dhe mbajtje të trupit në formë. Asnjëri nuk u mëson njerëzve ndonjë gjë drejt niveleve të larta. Kjo nuk do të thotë se praktikatat e tyre nuk janë të mira. Misioni i tyre është të mësojnë gjëra në nivelin e shërimit e mbajtjes së trupit në formë dhe të bëjnë publik qigongun. Ka shumë njerëz që do të donin të praktikonin kultivim të niveleve të larta. Ata kanë këto mendime dhe dëshira, por ata nuk kanë marrë metodat e duhura të kultivimit, prandaj kanë shumë vështirësi e probleme. Sigurisht, të mësosh vërtetësisht një praktikë të niveleve të larta lidhet me shumë çështje thelbësore. Prandaj ne kemi qënë të përgjegjshëm ndaj njerëzve dhe shoqërisë dhe rezultati i përgjithshëm i mësimdhënies së praktikës ka

²¹ Taiji (tai-çi)—simboli i Shkollës Tao, që njihet gjërësisht në Perëndim si “simboli yin-yang” (jin-jang).

²² Hetu, Luoshu—diagrame parahistorike që u shfaqën në Kinë e lashtë dhe mendohet të tregojnë të vërtetën e ndryshimeve të kursit të natyrës.

²³ *Libri i Ndryshimeve*—libër profecie i lashtë kinez që daton në Dinastinë Zhou (1100 - 221 p.e.r.).

²⁴ Tetë Triagramet—nga *Libri i Ndryshimeve*, një diagram parahistorik që mendohet të tregojë të vërtetën e ndryshimeve të kursit të natyrës.

²⁵ Fo Tuo—term klasik kinez për “Buddha.”

²⁶ Fu Tu—term klasik kinez për “Buddha.”

qënë i mirë. Disa nga gjërat janë me të vërtetë shumë të thella dhe, kur diskutohen, ato duken si paragjykim. Megjithatë, ne do bëjmë ç'është e mundur t'i shpjegojmë ato me shkencat moderne.

Sapo flasim për këto gjëra, disa njerëz do t'i quajnë ato paragjykime. Pse ndodh kjo? Kriteri i këtij personi është se ai quan paragjykime dhe idealiste të gjitha ato çfarë nuk janë njohur nga shkenca, çfarë ai nuk e ka provuar, apo çfarë ai mendon se nuk mund të ekzistojë—ky është mentaliteti i tij. A është ky mentaliteti i saktë? Duhet t'i vëmë etiketën e paragjykimit dhe idealizmit gjithë atyre gjërave që shkenca nuk i ka njohur apo çfarë janë përtej zhvillimit të saj? Atëhere, a nuk është vetë ky person supersticioz dhe idealist? Me këtë mentalitet, si mund të zhvillohet dhe përparojë shkenca? As shoqëria njerëzore nuk do të mund të ecte përpara. Çdo gjë që ka zbuluar komuniteti jonë shkencor dhe teknologjik ishte e panjohur për njerëzit në të kaluarën. Po të ishin konsideruar të gjitha këto gjëra si paragjykime, sigurisht që nuk do të kishte ekzistuar nevoja për zhvillim. Qigong nuk është diçka idealiste. Ka shumë njerëz që nuk e kuptojnë qigongun dhe kështu e quajnë qigongun gjithmonë idealizëm. Në kohën tonë, me anë të aparaturave shkencore ne kemi zbuluar në trupin e një mjeshtri qigongu valë infrasonike, valë supersonike, valë elektromagnetike, rreze infra të kuqe, ultraviolette, gama, neutrone, atome, gjurmë elementesh metalike etj. A nuk janë këto diçka me ekzistencë materiale? Edhe ato janë prej materie. A nuk është çdo gjë e përbërë prej materies? A nuk janë dhe kohë-hapësirat e tjera gjithashtu të përbëra prej materies? Si mund të quhet qigongu “paragjykim”? Përderisa përdoret për të kultivuar Buddhë, do të ketë të bëjë me shumë çështje thelbësore dhe ne do t'i trajtojmë ato të gjitha.

Përderisa qigong i shërben një qëllimi të tillë, pse e quajmë atë qigong? Në fakt, ai nuk quhet “qigong”. Çfarë quhet ai? Quhet “praktikë kultivuese” dhe është thjesht praktikë kultivuese. Sigurisht ka dhe emra të tjerë, por kur flasim në përgjithësi quhet praktikë kultivuese. Atëhere pse quhet qigong? Dihet se qigong u përhap në shoqëri për më shumë se njëzet vjet. Së pari u shfaq në mes të Revolucionit të Madh Kulturor²⁷. Më vonë arriti kulmin e popullaritetit. Mendojeni pak të gjithë: Ideologjia e majtë ishte shumë mbisunduese në atë kohë. Ne nuk do të përmendim çfarë emrash ka pasur qigong në qytetërimet parahistorike. Gjatë zhvillimit të tij, ky qytetërim njerëzor kaloi periudhën feudale. Prandaj, qigong ka zakonisht emra me nuanca feudale. Ato praktika të lidhura me fetë zakonisht kanë emra me nuanca të theksuara fetare. Për shembull, e ashtuquajtura “Mënyra e Madhe Kultivuese e Taos”, “Meditimi Vajra”, “Mënyra e Arhatit”²⁸, “Mënyra e Madhe Kultivuese e Dharmës Buddhës”, “Alkemia e Brendshme Nëntëfishe” etj. Po të ishin përdorur këto emra gjatë Revolucionit të Madh Kulturor, a nuk do ishit kritikuar ju? Megjithëse dëshira e këtyre mjeshtërve të qigongut për të përhapur qigongun ishte e mirë dhe ata donin të ndihmonin njerëzit të shëronin sëmundjet, të mbanin trupin në formë dhe përmirësonin kushtet e tyre fizike. Sado e mirë të ishte kjo, ajo nuk do të lejohej. Njerëzit thjesht nuk kishin guxim të përdornin emra të tillë. Prandaj, me qëllim që të përhapnin qigongun, shumë mjeshtër qigongu nxorrën dy fjalë nga tekstet e *Librit të Elikzirit* dhe *Kanunit Taoist*²⁹ dhe e quajtën atë “qigong”. Disa njerëz madje e përqëndrojnë kërkimin e tyre në terminologjinë e qigongut. Nuk ka asgjë aty për t'u studjuar. Në të kaluarën, quhej thjesht praktikë kultivuese. “Qigong” është vetëm një term i krijuar rishtas që përputhet me mëndjen e njeriut modern.

²⁷ Revolucionit të Madh Kulturor—një lëvizje politike komuniste në Kinë që dënonte vlerat dhe kulturën tradicionale (1966-1976).

²⁸ Arhat—qënie e lartësuar me Shkallë Arritjeje në Shkollën e Buddhës dhe një që është jashtë “Tre Sferave”.

²⁹ *Libri i Elikzirit, Kanuni Taoist*—tekste klasike kineze për praktikë kultivuese.

Pse nuk Rritet Gongu Juaj nga Praktika?

Pse nuk rritet gongu juaj nga praktika? Shumë njerëz mendojnë kështu: “Unë nuk kam marrë mësim të vërteta. Nëse një mjeshtër më mëson disa aftësi të veçanta dhe disa teknika të përparuara, gongu im do të rritet.” Sot për sot, 95 përqind e njerëzve mendojnë kështu dhe mua më duket mjaft qesharake. Pse është për të qeshur? Sepse qigong nuk është një teknikë e njerëzve të zakonshëm. Është diçka krejtësisht supernormale. Kështu, duhet ta shqyrtojmë atë duke aplikuar parime të niveleve të larta. Më lejoni t’ju bëj të ditur të gjithëve se arsyeja kryesore për paaftësinë e individit për të rritur gongun është kjo: Nga dy fjalët “kultivim” dhe “praktikë”, njerëzit i kushtojnë vëmendje vetëm praktikës dhe harrojnë kultivimin. Nëqoftëse e kërkoni diçka jashtë vetes, ju nuk do e arrini atë në asnjë mënyrë. Me trupin e një njeriu të zakonshëm, me duart e një njeriu të zakonshëm dhe me mendjen e një njeriu të zakonshëm, a mendoni se mund të transformoni materie energjie të lartë në gong apo të rritni gongun? Si mund të ishte kaq e lehtë? Sipas mendimit tim është qesharake. Është njësoj si të ndjekësh diçka jashtë vetes dhe të kërkosh diçka jashtë vetes. Ju nuk keni për ta gjetur atë asnjëherë.

Ai nuk është si aftësitë e njerëzve të zakonshëm që ju mund t’i merrni duke paguar pak para apo duke mësuar disa teknika. Nuk është njësoj, sepse është diçka jashtë nivelit të njerëzve të zakonshëm. Kështu ju duhet të ndiqni parime supernormale. Çfarë kërkohet nga ju atëhere? Ju duhet të kultivoni veten tuaj të brendshme dhe të mos ndiqni gjërat jashtë vetes. Kaq shumë njerëz i kërkojnë gjërat jashtë vetes. Ata ndjekin një gjë sot dhe një tjetër nesër. Po ashtu, ata janë të dhënë tej mase ndaj ndjekjes së aftësive supernormale dhe kanë gjithë llojet e synimeve. Ka njerëz që madje duan të bëhen mjeshtër qigongu dhe të bëjnë pasuri duke shëruar sëmundje! Në mënyrë që të praktikoni kultivim me të vërtetë, ju duhet të kultivoni mendjen tuaj. Ky quhet kultivim i karakterit. Për shembull, në një konflikt me të tjerët, ju duhet të mos i kushtoni rëndësi ndjenjave dhe dëshirave tuaja personale. Duke konkuruar për përfitim personal, ju doni të përmirësoni gongun tuaj—si mund të jetë e mundur kjo? A nuk jeni ju pastaj të njejtë me njerëzit e zakonshëm? Si mund të rritet gongu juaj? Për këtë arsye, vetëm duke theksuar kultivimin e karakterit mundet të rritet gongu juaj e mund të ngrihet niveli juaj.

Çfarë është karakteri? Ai përmban virtyt (një lloj materie), tolerancë, cilësi ndriçimi shpirtëror, sakrificë, heqje dorë nga dëshirat e përndjekjet e ndryshme të një njeriu të zakonshëm, të qenit të aftë të durosh vështirësi e të tjera. Ai përfshin shumë gjëra. Çdo aspekt i karakterit duhet të përmirësohet që ju të bëni përparim të vërtetë. Ky është faktori thelbësor për të përmirësuar fuqinë e gongut (*gongli*).

Disa njerëz mund të mendojnë: “Çështja e karakterit që përmende është diçka filozofike dhe aspekt i vetëdijes së personit. Nuk ka fare të bëjë me gongun që ne kultivojmë.” Pse nuk qenka e njejtja gjë? Gjatë gjithë historisë, çështja nëse materia përcakton mendjen apo anasjelltas është diskutuar e debatuar vazhdimisht në botën e filozofisë. Në fakt, më lejoni t’ju them të gjithëve se materia e mendja janë e njejtja gjë. Në fushën e kërkimit shkencor të trupit të njeriut, shkencëtarët e sotëm thonë se mendimi i prodhuar nga truri njerëzor është një substancë. Nëqoftëse qenka diçka me ekzistencë materiale, a nuk është ajo gjithashtu diçka prej mendjes njerëzore? A nuk janë ato e njejtja gjë? Po kështu dhe universi që përshkrova, nuk ka vetëm ekzistencën materiale, por në të njejtën kohë edhe karakteristikën e vet. Një njeri i zakonshëm nuk mund ta dallojë ekzistencën e kësaj karakteristike, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), në univers sepse njerëzit e zakonshëm janë të gjithë në të njejtin nivel. Kur ti ngrihesh mbi nivelin e njeriut të zakonshëm, ti do të jesh në gjendje ta dallosh atë. Si e dallon ti atë? E gjithë materia në univers, duke përfshirë dhe të gjitha substancat që e përbëjnë universin, janë qenie të gjalla me mendje që mendojnë dhe të gjitha ato janë forma ekzistence të Ligjit të universit në nivele të ndryshme. Ato nuk të lënë ty të ngjitesh në nivele. Megjithëse ti don të ngjitesh, ti nuk mundesh. Ato thjesht nuk të lejojnë të ngjitesh lart. Pse nuk të lejojnë të ngjitesh lart? Sepse karakteri jot nuk është përmirësuar. Çdo nivel ka kriteret e veta.

Nëqoftëse dëshiron të ngjitesh në një nivel më të lartë, ti duhet të braktisësh mendimet e këqija dhe të pastrosh gjërat e tua të papastërta që t'i asimilohesh kërkesave të standartit në atë nivel. Vetëm duke bërë këtë mundesh ti të ngjitesh.

Me të përmirësuar karakterin, trupi juaj do të pësojë një ndryshim të madh. Me përmirësimin e karakterit, materia e trupit tuaj është e garantuar që do të transformohet. Çfarë ndryshimesh do të ndodhin? Ti do të heqësh dorë nga ato gjëra të këqija pas të cilave ti je i dhënë. Për shembull, nëse një shishe e mbushur me gjëra të papastra është e mbyllur fort dhe hedhur në ujë, ajo do të fundoset direkt e në fund. Ti nxjerr jashtë disa nga përmbajtjet e pista. Sa më shumë që e zbraz ti shishen, aq më lart do notojë ajo mbi ujë. Po të boshatiset plotësisht, ajo do të notojë plotësisht mbi sipërfaqe. Gjatë kohës tënde të praktikës kultivuese, ti duhet të pastrosh shumë gjëra të këqija në trupin tënd në mënyrë që të ngjitesh lart. Kjo karakteristikë e universit luan pikërisht këtë rol. Nëqoftëse ti nuk kultivon karakterin tënd, nuk përmirëson standartin tënd moral, apo nëse mendimet e substancat e tua të këqija nuk janë hequr, ajo nuk do të të lejojë që të ngjitesh. Si mund të thoni që ato nuk janë e njëjta gjë? Më lejoni të them një shaka. Nëqoftëse një person do të lejohej të ngjitej dhe bëhej një Buddha me gjithë llojet e ndjenjave dhe dëshirave njerëzore që kanë njerëzit—mendojeni pak—a do të ishte kjo e mundur? Atij mund t'i vinte një mendim imoral kur të shihte një Bodhisattva³⁰ aq të bukur. Ky person mund të fillonte një sherr me një Buddha sepse xhelozia e tij nuk është zhdukur. Si mund të lejohen të ndodhin këto gjëra? Çfarë duhet bërë për këtë atëhere? Ju duhet të eliminoni të gjitha mendimet e këqija të njerëzve të zakonshëm—vetëm atëhere do mundeni ju të ngjiteni lart.

Me fjalë të tjera, ju duhet t'i kushtoni vëmendje kultivimit të karakterit dhe të praktikoni kultivim në përputhje me karakteristikën e universit, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Ju duhet të zhdukni plotësisht dëshirat e zakonshme të njerëzve, mendimet imorale dhe qëllimet për të bërë keq. Me çdo përmirësim në cilësinë e mendjes suaj, disa gjëra të këqija do të eliminohen nga trupi juaj. Ndërkohë, ju gjithashtu duhet të vuani pak dhe duroni vështirësi që të zvogëloni karmën tuaj. Atëhere ju mund të ngjiteni pak lart; domethënë karakteristika e universit nuk do t'ju kufizojë aq shumë. Kultivimi varet nga përpjekjet e secilit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri juaj. Mjeshtri ju jep mekanizmin e gongut që zhvillon gongun tuaj dhe ky mekanizëm gongu do të veprojë mbi dhe transformojë substancën e virtutit jashtë trupit në gong. Ndërsa ju vazhdimisht e përmirësoni veten dhe ngjiteni lart në praktikën kultivuese, edhe kolona juaj e gongut (*gongzhu*) vazhdimisht do të arrijë të depërtojë drejt niveleve të larta. Si praktikues, ju duhet të kultivoni dhe kalitni veten në ambjentin e njerëzve të zakonshëm dhe gradualisht të hiqni dorë nga përndjekjet dhe dëshirat e ndryshme. Shpesh, çfarë quhet e mirë nga njerëzimi jonë është zakonisht e keqe nga pikëpamja e niveleve të larta. Kështu, atë që njerëzit e quajnë të mirë për një njeri është përmbushja e interesave personale në shoqëri, duke jetuar kështu një jetë më të mirë. Për Qëniet e Shumëlartësuar, ky person është në disavantazh. Çfarë të keqe ka këtu? Sa më shumë që dikush merr, aq më tepër ai i hyn në pjesë të tjerëve. Ai do të marrë gjëra që nuk i takojnë. Ky person do të jepet pas famës dhe fitimit, kështu do të humbë virtut. Nëqoftëse doni që të rrisni gongun pa theksuar kultivimin e karakterit, gongu juaj nuk do të rritet aspak.

Komuniteti i kultivuesve beson se Shpirti Primordial i njeriut nuk zhduket. Në të kaluarën, njerëzit mund ta konsideronin si paragjykim diskutimin mbi Shpirtin Primordial të njeriut. Dihet se kërkimi mbi trupin e njeriut në fizikë ka zbuluar molekula, protone, elektrone e deri poshtë tek kuarket, neutrino etj. Në këtë pikë, mikroskopi nuk mund t'i dallojë më ato. Megjithatë këto grimca janë larg origjinës së jetës dhe origjinës së materies. Të gjithë e dinë se duhet një sasi e konsiderueshme fërkimi energjie dhe një sasi e madhe nxehtësie që të bëhet e mundur bashkimi apo ndarja e bërthamës. Si munden bërthamat e një trupi të zhduken pasi dikush vdes? Prandaj, ne kemi parë se kur një njeri vdes, vetëm elementet molekulare më të mëdha në këtë dimensionin tonë vdesin,

³⁰ Bodhisattva—Qënie e Shumëlartësuar me Shkallë Arritjeje në Shkollën e Buddhës dhe një që është më lart se Arhati dhe më poshtë se një Tathagata.

ndërsa trupat në dimensionet e tjera nuk degjenerojnë. Mendojeni pak të gjithë: Si duket trupi i njeriut nën mikroskop? I gjithë trupi i njeriut është në lëvizje. Ndërsa ju rrii aty pa lëvizur, i tërë trupi juaj është në lëvizje. Qelizat molekulare janë në lëvizje dhe i gjithë trupi është i palidhur sikur të ishte i përbërë prej rëre. Një trup njerëzor duket pikërisht kështu nën mikroskop dhe kjo është shumë e ndryshme nga si duket ai me sy. Kjo ndodh sepse këta dy sy njerëzorë krijojnë një pamje të rreme për juve dhe nuk ju lejojnë që t'i shikoni këto gjëra. Kur dikujt i hapet Syri Qiellor³¹ (*tianmu*), ai mund t'i shikojë gjërat duke i zmadhuar ato; kjo është në fakt një aftësi e lindur njerëzore që tani quhet aftësi supernormale. Nëqoftëse dëshironi të zhvilloni aftësi supernormale, ju duhet të ktheheni tek origjina, vetja juaj e vërtetë dhe të ktheheni nëpërmjet kultivimit.

Le të flasim për virtytin. Çfarë lidhje të veçantë ka ai? Ne do e analizojmë atë në detaj. Si qenie njerëzore, ne kemi një trup në secilin nga dimensionet e shumta. Kur e examinojmë trupin e njeriut, elementet më të mëdha janë qelizat dhe ato përbëjnë trupin fizik të njeriut. Po të mund të hynit në hapësirën ndërmjet qelizave e molekulave apo në hapësirën ndërmjet molekulave, juve do t'ju duket se jeni në një dimension tjetër. Kujt i ngjan ajo formë ekzistence e trupit? Sigurisht ju nuk mund të përdorni konceptet e këtij dimensionit që ta kuptoni atë dhe trupi juaj duhet të përputhet me kërkesat e formës së ekzistencës së atij dimensionit. Së pari trupi në një dimension tjetër mund të bëhet i madh apo i vogël. Në atë kohë juve do t'ju duket gjithashtu një dimension i pafund. Kjo është një formë e thjeshtë si dimensionet e tjera ekzistojnë njëkohësisht në të njejtin vend. Çdo njeri ka një trup të veçantë në secilin nga dimensionet e shumta. Në një dimension të caktuar ekziston një fushë që rrethon trupin e njeriut. Çfarë lloj fushe është ajo? Kjo fushë është virtyti që e përmendëm më parë. Virtyti është një substancë e bardhë dhe jo siç besonin në të kaluarën diçka shpirtërore e abstrakte—ajo absolutisht ka një formë ekzistence materiale. Kështu në të kaluarën, të moçmit flisnin për akumulim apo humje të virtytit dhe ata flisnin me shumë mençuri për këtë. Ky virtyt formon një fushë që rrethon trupin e njeriut. Në të kaluarën, Shkolla Tao besonte që mjeshtri zgjedh dishepullin dhe jo dishepulli zgjedh mjeshtrin. Çfarë do të thotë kjo? Një mjeshtrë do të kontrollonte nëse trupi i atij dishepulli përmbante një sasi të madhe virtyti. Nëqoftëse ky dishepull kishte shumë virtyt, do të ishte më e lehtë për të të praktikonte kultivim. Përndryshe, ai nuk do e kishte të lehtë dhe ai do të kishte mjaft vështirësi të zhvillonte gong drejt niveleve të larta.

Në të njejtën kohë, ekziston një lloj substance e zezë që ne e quajmë “karma” dhe që Buddhismi e quan “karmë mëkatore”. Këto substanca të zeza dhe të bardha ekzistojnë njëkohësisht. Çfarë lloj lidhjeje kanë këto dy substanca? Ne e marrim virtytin nëpërmjet vuajtjeve, duke duruar vështirësi dhe duke kryer vepra të mira; substanca e zezë mblidhet nga kryerja e veprave të këqija dhe nga trajtimi keq i njerëzve. Sot disa njerëz jo vetëm që e kanë mëndjen vetëm tek fitimi por ata shkojnë deri aty sa kryejnë të gjitha të këqijat. Ata bëjnë çdo lloj të keqe për para deri tek kryerja e vrasjeve, paguajnë dikë që të vrasë, praktikojnë homoseksualitet dhe përdorin drogë. Ata bëjnë gjithë llojet e gjërave. Njeriu humb virtyt kur ai bën keq. Si e humb njeriu virtytin? Kur dikush ofendon dikë, ai mendon se ja kaloi tjetrit dhe ndjehet mirë. Ekziston një parim në këtë univers që quhet “pa humbje nuk ka fitim”. Që të fitosh duhet të humbësh. Po nuk deshe të humbësh ti do të detyrohesh të humbësh. Kush e luan këtë rol? Është pikërisht karakteristika e universit që e merr këtë rol. Kështu, është e pamundur që ti të duash vetëm të marrësh gjëra. Çfarë do të ndodhte atëhere? Kur dikush ofendon apo kërcënon një person tjetër, ai i jep virtyt atij personi. Përderisa personi tjetër është pala që keqtrajtohet dhe ka humbur diçka e vuan, ai kompensohet siç duhet. Ndërsa një person është këtu duke sharë, me të dalë ofendimi nga goja e tij, një copë virtyti nga fusha e tij dimensionale largohet e i shkon personit tjetër. Sa më shumë që ai e shan tjetrin, aq më shumë virtyt ai i jep atij. Kjo është e vërtetë dhe kur dikush rreh apo kërcënon të tjerët. Ndërsa dikush godet apo shkelmon një person tjetër, ai do t'i japë atij virtyt nga vetja në varësi nga sa keq ai e rreh tjetrin. Një njeri i zakonshëm

³¹ Sy Qiellor—gjithashtu i njohur si “syri i tretë” i ndodhur në mes të ballit pak sipër vetullave.

nuk e shikon këtë parim në këtë nivel. Ngaqë ndjehet i përlur, ai nuk mund ta durojë këtë dhe mendon, “Përderisa ti më godite, unë duhet të ta kthej me të njejtën mënyrë.” “Bam”, ai i jep atij personi një të goditur mbrapsht dhe i kthen atij virtyt. Asnjëri nuk fitoi apo humbi ndonjë gjë. Ai mund të mendojë, “Ti më godite një here, kështu unë duhet të të godas dy herë. Përndryshe, unë nuk mora hak.” Ai do e godasë atë përsëri dhe një copë tjetër nga virtyti i tij do t’i jepet personit tjetër.

Pse vlerësohet kaq shumë virtyti? Çfarë lloj lidhjeje ekziston në transformimin e virtytit? Fetë thonë: “Me virtyt njeriu do të fitojë diçka në jetën tjetër në mos në këtë jetë.” Çfarë do të fitojë ai? Me shumë virtyt, njeriu mund të bëhet zyrtar i një rangu të lartë apo të bëjë pasuri të madhe. Ai do të arriente çfarë të donte dhe ato shkëmbehen me këtë virtyt. Fetë gjithashtu thonë se nëse dikush nuk ka virtyt, si trupi ashtu dhe shpirti i tij do të eliminohen. Shpirti Primordial i tij do të eliminohet dhe kur të vdesë ai do vdesë plotësisht e nuk do t’i mbetet asgjë. Në komunitetin tonë të praktikuesve, ne besojmë se virtyti mund të transformohet direkt në gong.

Ne do të flasim si transformohet virtyti në gong. Komuniteti i kultivuesve ka një thënie: “Kultivimi varet nga përpjekjet e individit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri”. Megjithatë disa njerëz flasin për “krijimin e një mbajtëse dhe furre trupore për të prodhuar *dan*³² duke përdorur barëra mjekësore të mbledhura”³³ dhe aktivitete mendore dhe ata i konsiderojnë këto shumë të rëndësishme. Më lejoni t’ju them se ato nuk janë aspak të rëndësishme dhe kthehen në dëshirë po të mendoni shumë për to. A nuk je ti i dhënë pas ndjekjes së diçkaje nëse mendon shumë për të? Kultivimi varet nga përpjekjet e secilit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri. Mjafton që ti të kesh këtë dëshirë. Është në fakt mjeshtri që e bën atë, sepse ti je thjesht i paaftë ta bësh këtë gjë. Me një trup njeriu të zakonshëm si juaji, si mundet ju ta transformoni atë në një trup të një jete më të lartë të përbërë prej materie energjie të lartë? Është absolutisht e pamundur dhe duket si shaka. Proçesi i transformimit të një trupi njerëzor në dimensione të tjera është tepër i vështirë dhe kompleks. Ju nuk mund t’i bëni aspak gjëra të tilla.

Çfarë ju jep mjeshtri juve? Ai ju jep mekanizmin e gongut që zhvillon gongun tuaj. Virtyti ekziston jashtë trupit të njeriut dhe gongu i vërtetë i tij krijohet nga virtyti. Si lartësia e nivelit të personit ashtu dhe forca e fuqisë së gongut të tij krijohen nga virtyti. Mjeshtri transformon virtytin tënd në gong që rritet lart në formë spirale. Gongu që me të vërtetë përcakton nivelin e dikujt rritet jashtë trupit dhe rritet në formë spirale duke krijuar kështu një kolonë gongu që del mbi kokë. Vetëm me një shikim të lartësisë së kolonës së gongut të këtij personi, dikush mund të dallojë nivelin e gongut të tij. Ky është niveli dhe Shkalla e Arritjes së individit siç përmendet në Buddhizëm. Ndërsa rrin ulur në meditim, Shpirti Primordial i disa njerëzve del nga trupi dhe arrin në një nivel të caktuar. Edhe sikur të përpiqet, Shpirti i tij Primordial nuk mund të ngjitet më shumë dhe nuk guxon të ngjitet më shumë. Meqenëse lëviz lart duke qëndruar mbi kolonën e tij të gongut, ai mund të arrijë vetëm këtë nivel. Për arësyje se kolona e tij e gongut është veçse kaq e lartë, ai nuk mund të ngjitet më tepër. Kjo është çështja e Shkallës së Arritjes e përmendur në Buddhizëm.

Ekziston gjithashtu dhe një matës që mat nivelin e karakterit. Matësi dhe kolona e gongut nuk ekzistojnë në të njejtin dimension por ato ekzistojnë njëkohësisht. Kultivimi i karakterit tuaj ka bërë përparim nëqoftëse, për shembull, kur dikush të ofendon ti nuk thua asnjë fjalë dhe ndjehesh shumë i qetë; apo kur dikush të godet me grusht, ti nuk thua asgjë dhe e kalon me një buzëqeshje. Niveli juaj i karakterit është atëhere shumë i lartë. Kështu si praktikues, çfarë duhet të fitoni ju? A nuk do të merrni ju gong? Kur niveli juaj i karakterit përmirësohet, gongu juaj do të rritet. Niveli i gongut të personit është aq i lartë sa dhe niveli i tij i karakterit dhe kjo është një e vërtetë absolute. Në të kaluarën, nëse njerëzit praktikonin qigong në parqe apo në shtëpi, ata e bënin atë me shumë përpjekje e dedikim dhe praktikonin shumë mirë. Sapo dilnin nga dera, ata vepronin ndryshe dhe ktheheshin në

³² *dan*—grumbull energjie në trupin e një kultivuesi i mbledhur nga dimensione të tjera.

³³ “Krijimin e një mbajtëse dhe furre trupore për të prodhuar *dan* duke përdorur barëra mjekësore të mbledhura”—metaforë Taoiste për alkiminë e brendshme.

mënyrën e tyre, duke konkuruar dhe luftuar me të tjerët për famë e fitim në mes të njerëzve të zakonshëm. Si mund të rrisin ata gongun? Nuk do rritej aspak dhe për të njëjtën arsye dhe sëmundjet e tyre nuk do të shëroheshin. Pse disa njerëz nuk mundin të shërojnë sëmundjet e tyre pas një periudhe të gjatë praktike? Qigongu është praktikë kultivuese dhe diçka supernormale në krahasim me ushtrimet fizike të njerëzve të zakonshëm. Njeriu duhet të përqëndrohet në përmirësimin e karakterit në mënyrë që të shërojë sëmundje e rrisë gongun.

Disa njerëz besojnë në krijimin e një mbajtëse dhe furre trupore për të bërë dan nga barërat e mbledhura mjekësore dhe mendojnë se ky dan është gong. Nuk është ashtu. Ky dan vetëm grumbullon një pjesë të energjisë dhe nuk përfshin të gjithë energjinë. Çfarë lloj materie është dan-i? Dihet se ne kemi gjithashtu disa gjëra të tjera për të kultivuar jetë dhe se trupat tanë do të zhvillojnë aftësi supernormale dhe shumë aftësi të tjera; shumica janë të kyçura dhe nuk do të lejohen të përdoren. Ekzistojnë shumë aftësi supernormale—deri në dhjetë mijë. Sapo njëra të zhvillohet, do të kyçet. Pse nuk lejohen të manifestohen ato? Qëllimi është që të mos lejohet njeri që t'i përdorë ato në shoqërinë njerëzore për të përfutuar gjëra. Ti nuk mund të lejohesh të shqetësosh sipas dëshirës shoqërinë njerëzore dhe as nuk lejohesh të shfaqësh sipas dëshirës aftësitë e tua në shoqërinë njerëzore. Kjo ndodh sepse po të lejoheshin ato, kjo mund të shqetësonte formën e shoqërisë së zakonshme njerëzore. Shumë njerëz praktikojnë kultivim duke u mbështetur në aftësinë e të kuptuarit pa i parë gjërat. Po t'i demonstrosh atyre gjithë aftësitë e tua, ata do e kuptojnë që çdo gjë është e vërtetë dhe do të vijnë të praktikojnë kultivim. Edhe njerëz të cilët kanë kryer të këqija të pafalshme do të vinin të praktikonin kultivim dhe kjo nuk lejohet. Ju nuk lejoheni të mburreni në këtë mënyrë. Po ashtu, ju mund të kryenit vepra të këqija meqenëse ju nuk mund t'i shihni marëdhëniet e paracaktuara nga fati dhe natyrën e vërtetë të gjërave. Ti mendon se po bën një gjë të mirë por ajo mund të jetë një vepër e keqe. Prandaj, ti nuk lejohesh t'i përdorësh ato, sepse me të kryer një vepër të keqe, niveli jot do të bie dhe kultivimi jot do të shkojë kot. Prandaj shumë aftësi supernormale janë të mbydhura. Çfarë do të ndodhë? Kur dikush arrin stadin e Gongut të Çbllokuar (*kaigong*) dhe lartësimin shpirtëror final, ky dan do të jetë si një bombë që shpërthen dhe çliron të gjitha aftësitë supernormale, tërë pikat kyçe në trup dhe qindra kanale energjie. “Bum” çdo gjë do të hapet. Për këtë përdoret dan-i. Pasi një murg digjet pas vdekjes, atij i mbetet *sarira*. Disa njerëz pretendojnë se ato janë kocka dhe dhëmbë. Pse nuk paskan sarira njerëzit e zakonshëm atëhere? Ato janë thjesht dan-i i plasur dhe energjia e tyre është çliruar. Ato përmbajnë në vetvete shumë substanca nga dimensione të tjera. Në fund të fundit ato janë gjithashtu diçka me ekzistencë materiale por pa ndonjë përdorim të madh. Njerëzit tani i marrin ato si diçka shumë të vyer. Ato përmbajnë energji dhe janë të ndryshme dhe të forta. Ja çfarë janë ato.

Ka akoma dhe një arsye tjetër që gongu nuk mund të rritet. Më një fjalë, pa njohur Ligjin e niveleve të larta, personi nuk mund të ngjitet në praktikën kultivuese. Çfarë do të thotë kjo? Siç e përmenda, shumë njerëz kanë praktikuar shumë ushtrime qigongu. Më lejoni t'ju them se pamvarësisht nga sa shumë të tjera që do të mësoni, është përsëri pa dobi. Ju mbeteni vetëm një nxënës i shkollës fillore—një nxënës i shkollës fillore në praktikën kultivuese. Ato janë të gjitha parime të një niveli të ulët. Parime të një niveli kaq të ulët nuk mund të luajnë ndonjë rol në udhëheqjen e praktikës suaj të kultivimit drejt niveleve të larta. Po të mësoni nga tekste të shkollës fillore në shkollë të lartë, ju mbeteni nxënës të shkollës fillore. Pamvarësisht sa shumë që studjoni prej tyre, do të jetë pa rezultat. Në të kundërtën, do të jetë më keq për ju. Nivele të ndryshme kanë Ligj të ndryshëm dhe Ligji merr role të ndryshme udhëheqëse në nivele të ndryshme. Kështu, parime të nivelit të ulët nuk mund të udhëheqin praktikën tuaj kultivuese drejt niveleve të larta. Ato që do të diskutojmë më tutje janë të gjitha parime për praktikë kultivuese të niveleve të larta. Unë do të ndërthur gjëra të niveleve të ndryshme në dhënien e mësimit. Ato do të luajnë kështu gjithmonë një rol udhëheqës në praktikën tuaj të ardhshme kultivuese. Unë kam disa libra, kaseta e video kaseta. Ju do të shikoni se pasi i keni parë e dëgjuar njëherë, ato përsëri ju udhëheqin ndërsa ju i shikoni dhe

dëgjoni përsëri pas ca kohe. Ju gjithashtu përmirësoni veten në mënyrë të vazhdueshme dhe ato vazhdimisht ju udhëheqin juve—sepse ky është Ligji. Këto që thamë më sipër janë dy arsytet për mos rritjen e gongut. Pa njohur Ligjin e niveleve të larta, dikush nuk mund të praktikojë kultivim. Pa kultivuar veten dhe karakterin e vet, askush nuk mund të rrisë gongun. Këto janë dy arsytet.

Karakteristikat e Falun Dafës

Falun Dafa jonë është një nga tetëdhjetë e katër mijë mënyrat e kultivimit në Shkollën e Buddhës. Gjatë periudhës së historisë të këtij qytetërimi njerëzor, nuk është bërë kurrë e njohur më parë në publik. Megjithatë, në një periudhë parahistorike, u përdor gjërësisht për t’i afruar shpëtim njëjërëzimit. Në këtë periudhë përfundimtare të Shkatërrimit të Fundit³⁴, unë po e bëj atë publike përsëri. Prandaj, është jashtëzakonisht e çmueshme. Fola më parë si virtyti transformohet drejtpërdrejt në gong. Gongu në fakt, nuk arrihet nëpërmjet praktikës. Ai arrihet nëpërmjet kultivimit. Shumë njerëz përipiqen të rrisin gongun e tyre dhe vetëm i kushtojnë vëmendje praktikës pa e vrarë mendjen si të bëjnë kultivim. Në fakt, gongu arrihet plotësisht nëpërmjet kultivimit të karakterit. Pse atëhere ne mësojmë dhe ushtrime këtu? Së pari, le të flas pse një murg nuk praktikon ushtrime. Ai thjesht rri ulur në gjendje të pavetëdijshe, këndon shkrimet e shenjta, kultivon karakterin dhe gongu i tij rritet. Ai rrit gongun që ngre nivelet e tij. Mëqenëse Sakyamuni i mësoi njerëzit të hiqnin dorë nga çdo gjë në botë, duke përfshirë dhe trupat e tyre, atëhere ushtrimet fizike u bënë të panevojshme. Shkolla Tao nuk i afron shpëtim të gjitha qënieteve. Ata me të cilët ka të bëjë nuk janë nga të gjithë llojet e njerëzve me mentalitete dhe nivele të ndryshme, disa prej të cilëve janë më egoistë e të tjerë më pak. Ajo i për zgjedh dishepujt e vet. Nëqoftëse tre dishepuj janë për zgjedhur, vetëm njeri prej tyre do të marrë mësimet e vërteta. Duhet të sigurohet që ky dishepull është i virtytshëm, shumë i mirë dhe nuk do të shkojë dëm. Kështu kjo shkollë thekson mësimin e gjërave teknike për të kultivuar jetë dhe për të kultivuar fuqitë dhe aftësitë supernaturale, etj. Që të arrihet kjo duhen disa ushtrime fizike.

Falun Dafa është gjithashtu praktikë kultivuese e mendjes dhe e trupit dhe kërkon ushtrime. Nga njëra anë, ushtrimet përdoren për të forcuar aftësitë supernormale. Çfarë do të thotë “forcim”? Do të thotë përforcim i aftësive të tua supernormale me anë të potencialit të gongut tënd të fuqishëm, duke i bërë ato kështu gjithnjë e më të forta. Në anën tjetër, shumë qenie të gjalla duhet të zhvillohen në trupin tuaj. Në praktikë kultivuese të nivelit të lartë, Shkolla Tao kërkon lindjen e Foshnjës së Pavdekshme (*yuanying*), ndërsa Shkolla Buddhës kërkon trupin e pashkatërrueshëm të *Vajrës*³⁵. Po ashtu, shumë aftësi mbinaturale duhet të zhvillohen. Këto gjëra duhet të zhvillohen nëpërmjet ushtrimeve fizike dhe këto janë ato që kultivohen me ushtrimet tona. Një praktikë kultivuese e plotë e mendjes dhe e trupit i kërkon të dyja si kultivimin ashtu dhe praktikën. Mendoj se tashmë të gjithë e kuptojnë si krijohet gongu. Gongu që me të vërtetë përcakton nivelin tënd të arritjes nuk zhvillohet aspak nga praktika, por nga kultivimi. Duke përmirësuar karakterin tënd dhe duke u asimiluar në karakteristikën e universit në kultivimin tënd në mes të njerëzve, karakteristika e universit nuk do të të kufizojë më; atëhere ti lejohesh të ngjitesh lart. Virtyti jot do të fillojë atëhere të transformohet në gong. Me t’u rritur standarti jot i karakterit, po ashtu rritet dhe gongu jot. Kjo është lidhja ndërmjet tyre.

Kjo praktika jonë është praktikë kultivuese e vërtetë e mendjes dhe e trupit. Gongu që ne kultivojmë ruhet në çdo qelizë të trupit dhe ky gong me energji të lartë ruhet madje dhe në grimcat

³⁴ Shkatërrimi i Fundit—komuniteti i kultivuesve beson se universi ka tre faza evolucioni, (Shkatërrimi i Fillestar, Shkatërrimi i Mesëm, Shkatërrimi i Fundit) dhe se tani është periudha përfundimtare e Shkatërrimit të Fundit.

³⁵ *Vajra*—një fjalë e papërkthyeshme nga Sanskrit që do të thotë diamant, i pandryshueshëm, i pathyeshëm dhe fuqi madhore. Në Buddhizëm është simbol i një mirësie të madhe dhe i fuqisë më madhore në univers dhe i referohet trupit hyjnor që kultivohet apo ndryshe trupit të një Buddhë.

më të vogla të origjinës në një nivel jashtëzakonisht mikroskopik. Ndërsa potenciali i gongut tënd rritet, dendësia dhe fuqija e gongut gjithashtu rriten. Një lëndë energjie kaq e lartë ka inteligjencë. Meqenëse ruhet në çdo qelizë të trupit të njeriut deri tek origjina e jetës, ajo do të marrë gradualisht të njëjtën formë si dhe qelizat e trupit tuaj, duke marrë të njëjtin kombinim molekular dhe formë të bërthamave. Esenca e trupit ka ndryshuar tashmë sepse ky trup nuk është më i përbërë nga qelizat fizike origjinale. A nuk je ti përtej Pesë Elementeve? Sigurisht praktika jote kultivuese nuk ka mbaruar dhe ti akoma duhet të praktikosh kultivim në mes të njerëzve. Prandaj, në sipërfaqe ti përsëri do të dukesh si njeri i zakonshëm. I vetmi ndryshim është se ti dukesh më i ri sesa ata të moshës tënde. Sigurisht, gjërat e këqija në trupin tënd, duke përfshirë dhe sëmundjet, duhet të hiqen në fillim, por ne nuk kurojmë sëmundje këtu. Ne po e pastrojmë trupin tuaj dhe termi nuk është “kurojmë sëmundje”. Ne e quajmë thjesht “pastrim të trupit” dhe ne pastrojmë trupat e praktikuesve të vërtetë. Disa njerëz vijnë këtu vetëm për t’ju shëruar sëmundjet. Përsa i përket pacientëve të sëmurë rëndë, ne nuk i lejojmë ata të marrin klasat tona sepse ata nuk mund të heqin dorë nga dëshira për të kuruar sëmundjet apo nga idea e të qenit sëmurë. Kur dikush ka një sëmundje të rëndë dhe ndjehet shumë keq, a mund ta lërë ai këtë të kalojë? Ky person nuk është në gjendje të praktikojë kultivim. Ne e kemi theksuar herë pas here që ne nuk pranojmë pacientë me sëmundje të rënda. Kjo këtu është praktikë kultivuese, që është shumë larg nga çfarë mendojnë ata. Ata mund të gjejnë mjeshtër qigongu të tjerë që i bëjnë këto gjëra. Sigurisht shumë praktikues kanë sëmundje. Meqenëse ti je praktikues i vërtetë, ne do i rregullojmë këto gjëra për ty.

Pas një periudhe praktike kultivuese, praktikuesit tanë të Falun Dafës duken shumë ndryshe nga pamja. Lëkura tyre bëhet delikate dhe e shëndetshme. Për të moshuarit, rrudhat bëhen më të rralla madje shumë të rralla, gjë që është një fenomen i zakonshëm. Unë nuk flas këtu për diçka të pakonceptueshme, sepse shumë nga praktikuesit tanë veteranë e dinë këtë gjë. Po ashtu, grave të moshuara do t’u rikthehen menstruacionet meqenëse një praktikë kultivuese e mëndjes dhe e trupit kërkon menstruacionet të kultivojnë trupin. Periodat do t’u kthehen, por rrjedhja nuk do jetë e madhe. Tani për tani, aq pak është e mjaftueshme. Ky është gjithashtu një fenomen i zakonshëm. Përndryshe si mund t’i kultivojnë ato trupat e tyre pa to? E njehta gjë është e vërtetë për burrat: Të moshuarit dhe të rinjtë do të ndjejnë që i tërë trupi do të bëhet i lehtë. Përsa i përket praktikuesve të vërtetë, ata do të pësojnë këtë transformim.

Kjo praktika jonë kultivon diçka shumë kolosale, në krahasim me shumë praktika që imitojnë kafshët në ushtrimet e tyre. Kjo praktikë kultivon thjesht diçka shumë të pamatshme. Të gjitha parimet që Sakyamuni dhe Lao Zi³⁶ diskutuan në kohën e tyre ishin të kufizuara në parimet brenda Kashtës sonë të Kumtrit. Çfarë kultivon Falun Dafa jonë? Praktika jonë e kultivimit bazohet në parimet e evolucionit të universit dhe udhëhiqet nga standarti i karakteristikës më të lartë të universit, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Ne kultivojmë diçka kaq të madhe sa që barazohet me kultivimin e universit.

Falun Dafa jonë ka gjithashtu dhe një tipar jashtëzakonisht unik dhe të veçantë që është i ndryshëm nga çdo praktikë tjetër. Në kohën tonë, të gjitha praktikat popullore qigong në shoqëri marrin rrugën e kultivimit të dan apo praktikojnë dan. Në praktikat e qigongut që kultivojnë dan, është shumë e vështirë që dikush të arrijë shkallën e Gongut të Çbllokuar dhe të arrijë përfundimin e kultivimit dhe lartësimin shpirtëror kur është në mes të njerëzve të zakonshëm. Falun Dafa jonë nuk kultivon dan. Praktika jonë kultivon një Falun në pjesën e poshtme të barkut. Unë personalisht e vendos atë tek praktikuesit në klasë. Ndërsa unë po ju mësoj Falun Dafën, unë e vendos atë tek secili me rradhë. Disa njerëz e ndjejnë atë ndërsa të tjerë nuk e ndjejnë; shumica e njerëzve e ndjejnë. Kjo ndodh sepse njerëzit kanë gjendje të ndryshme fizike. Ne kultivojmë Falun në vend të da-nit. Falun është një univers në miniaturë që ka të gjitha aftësitë e universit dhe mund të operojë dhe rrotullohet

³⁶ Lao Zi—themelues i Shkollës Tao dhe autor i *Tao Te Ching (Dao De Jing)*, që mendohet të ketë jetuar dhe dhënë mësim në Kinë rreth shekullit të V apo IV p.e.r..

automatikisht. Ai do të rrotullohet përgjithmonë në pjesën e poshtme të barkut tuaj. Me t'u vendosur në trupin tuaj, vit pas viti ai nuk do të ndalojë dhe do të rrotullohet ashtu pafundësisht. Ndërsa rrotullohet në drejtim të akrepave të orës, mund të marrë energji automatikisht nga universi. Po ashtu, mund të transformojë vetë energji për të prodhuar energjinë e nevojshme për transformimin e çdo pjese të trupit tuaj. Gjithashtu, lëshon energji ndërsa rrotullohet në drejtim të kundërt të akrepave të orës, duke lëshuar elementet e padëshiruar që do të shpërndahen rreth trupit. Kur lëshon energji, energjia mund të arrijë distancë të konsiderueshme dhe pastaj sjell përsëri energji të re. Njerëzit rreth jush mund të përfitojnë nga energjia e lëshuar. Shkolla Buddhës mëson vetshpëtim dhe shpëtim të të gjitha qënieve të gjalla. Personi nuk kultivon vetëm veten, por i afron gjithashtu shpëtim të gjitha qënieve të gjalla. Të tjerët gjithashtu mund të përfitojnë dhe ti pa dashje i ndreq trupat e tyre, shëron sëmundje dhe kështu me radhë. Sigurisht, energjia nuk humbet. Kur Falun rrotullohet sipas akrepave të orës, mund të mbledhë mbrapsht energjinë meqenëse rrotullohet pa ndalim.

Disa njerëz mund të habiten, “Si rrotullohet pa ndalim ky Falun?” Ka njerëz që gjithashtu më pyesin mua, “Si mund të rrotullohet? Kush është arsyeja?” Qenka e lehtë të kuptohet që dan-i mund të formohet kur mblidhet energji por qenka e pakonceptueshme që Falun rrotullohet. Le t'ju jap një shembull. Universi është në lëvizje dhe të gjitha Kashtat e Kumtrit të universit dhe galaksitë janë po ashtu në lëvizje. Nëntë planetet rrotullohen rreth diellit dhe Toka gjithashtu bën rrotullim rreth vetes. Pa mendojeni të gjithë: Kush i shtyn ato? Kush u jep atyre forcë? Ju nuk mund ta kuptoni me mentalitetin e një njeriu të zakonshëm, sepse është pikërisht ky mekanizëm rrotullimi. E njejta gjë është gjithashtu e vërtetë me Falun tonë, sepse ai thjesht rrotullohet. Duke rritur kohën e ushtrimit, ai ka zgjidhur për çdo njeri problemin e praktikës kultivuese në kushtet normale të jetesës. Si rritet koha? Meqenëse rrotullohet pandalim, ai thith dhe transformon vazhdimisht energji nga universi. Kur ju shkoni në punë, ai ju kultivon. Sigurisht përveç Falun, ne do të vendosim në trupin tuaj edhe shumë sisteme energjie dhe mekanizma që së bashku me Falun rrotullohen dhe ju transformojnë juve automatikisht. Prandaj, ky gong i transformon njerëzit plotësisht automatikisht. Kështu, kryhet ajo që “gongu kultivon praktikuesit”, që do të thotë gjithashtu “Ligji kultivon praktikuesit”. Gongu të kultivon kur ti nuk je duke praktikuar, ashtu siç të kultivon kur ti je duke praktikuar. Ndërsa je duke ngrënë, duke fjetur, apo duke punuar, ju jeni gjithmonë duke u transformuar nga gongu. Pse bëhen ushtrimet? Ju bëni ushtrime që të forconi Falun dhe përforconi të gjitha këto mekanizma dhe sisteme energjie që ju kam dhënë. Kur dikush praktikon kultivim në nivele të larta, kjo duhet të jetë plotësisht në gjendje *wuwei*³⁷ dhe lëvizjet e ushtrimeve gjithashtu ndjekin mekanizmat. Nuk ka udhëheqje nga mëndja dhe as nuk duhet të përdorni ndonjë metodë frymëmarrjeje, etj.

Ne praktikojmë pa ndonjë kërkesë të veçantë për kohën dhe vendin. Disa njerëz pyesin, “Cila është koha më e mirë për praktikë? Mesnatë, agim apo mesditë?” Ne nuk kemi ndonjë kërkesë për kohën e ushtrimit. Kur ju nuk praktikoni në mesnatë, gongu ju kultivon juve. Kur ju nuk praktikoni në agim, gong gjithashtu ju kultivon. Kur jeni në gjumë, gong po ashtu ju kultivon. Kur jeni duke ecur, gong ju kultivon përsëri. Gong ju kultivon dhe kur jeni në punë. A nuk e ul ai kohën e praktikës suaj kultivuese në mënyrë të konsiderueshme? Shumë prej jush e keni në zemër që me të vërtetë të arrini Taon që, sigurisht, është qëllimi i praktikës kultivuese. Qëllimi final i praktikës kultivuese është të arrini Taon dhe përfundoni kultivimin. Megjithatë disa njerëz e kanë të kufizuar kohën që ju ka mbetur në jetë. Vitet që do jetojnë janë me numërim dhe mund të mos jenë të mjaftueshme për kultivim. Falun Dafa jonë mund ta zgjidhë këtë problem dhe shkurtojë periudhën e praktikës. Ndërkohë, ajo është një praktikë kultivuese e mëndjes dhe e trupit. Kur ju vashdimisht praktikoni kultivim, ju vashdimisht do e zgjatni jetën tuaj. Me praktikë të pandërprerë, jeta juaj do të zgjatet vazhdimisht. Ata njerëz të moshuar me cilësi të mirë të lindur do të kenë kohë të mjaftueshme për praktikë. Megjithatë, ka një kriter, që jeta e zgjatur përtej kohës suaj për të jetuar e paracaktuar nga

³⁷ *wuwei* (uu-uei)—“pa veprim”, “pa qëllim”, duke ndjekur rrjedhën e natyrshme të gjërave.

fati është plotësisht e rezervuar për praktikën. Nëqoftëse mëndja juaj devijon sadopak, jeta juaj do të jetë në rrezik sepse jeta juaj duhet të kish përfunduar me kohë. Ju do të keni këtë kufizim derisa të arrini kultivimin në Ligj-Përtej-Botës-Trefishe. Pas kësaj, ju do të jeni në një stad tjetër.

Ne nuk kërkojmë kthim me fytyrë në drejtime të caktuara gjatë praktikës apo mënyra të caktuara për ta përfunduar atë. Meqenëse Falun rrotullohet papushim, ai nuk mund të ndalet. Po patët një telefonatë apo dikush troket në derë, ju mund të vazhdoni të merreni me to pa ju dashur të mbaroni ushtrimet. Kur ndaloni të bëni diçka, Falun menjëherë do të rrotullohet në drejtim të akrepave të sahatit dhe do të marrë mbrapsht energjinë e lëshuar rreth trupit tuaj. Për ata që me qëllim mbajnë qi dhe e derdhen në kokë, ata përsëri do ta humbin atë, pamvarësisht si e mbajnë. Falun është diçka me inteligjencë dhe din ç'të bëjë. Ne nuk kërkojmë as drejtime sepse i gjithë universi është në lëvizje. Kashta e Kumtrit është në lëvizje dhe nëntë planetet rrotullohen rreth diellit. Toka po ashtu rrotullohet rreth vetes. Ne praktikojmë sipas këtij parimi të madh të universit. Ku është lindja, jugu, perëndimi apo veriu? Askund. Të praktikosh në çdo drejtim do të thotë të praktikosh në të gjitha drejtimet dhe të praktikosh në çdo drejtim është si të praktikosh në lindje, jug, perëndim dhe veri në të njëjtën kohë. Falun Dafa jonë do t'i mbrojë praktikuesit nga devijimi. Si të mbron ajo ty? Po qe se ti je një praktikues i vërtetë, Falun i jonë do të të mbrojë. Unë jam i rrënjësuar në univers. Nëqoftëse dikush mund të të dëmtonte ty, ai apo ajo do të mund të më dëmtonte mua. E thënë thjesht, ai person do të mund të dëmtonte këtë univers. Këto që po them mund të duken shumë të pakonceptueshme. Ju do ta kuptoni më vonë pasi të studjoni më thellë. Ka gjithashtu gjëra të tjera që janë tepër të thella që unë t'i bëj të njohura. Ne vazhdimisht do ta zgjerojmë Ligjin e niveleve të larta, nga më e thjeshta deri tek më e thella. Nuk do kishte rezultat po qe se karakteri juaj nuk është i virtutshëm. Po patët paramendime, ju mund të keni probleme. Unë kam konstatuar se Falun i shumë praktikueve veteranë është deformuar. Pse? Ju keni përzjerë gjëra të tjera me praktikën tuaj dhe keni pranuar gjëra nga të tjerë. Pse nuk ju mbroi Falun juve atëhere? Kur ai të është dhënë ty, është i joti dhe diktohet nga mëndja juaj. Ka një parim në këtë univers, që askush nuk mund të ndërhyjë me atë çfarë dëshironi ju. Nëqoftëse nuk doni të praktikoni kultivim, askush nuk mund t'ju detyrojë—kjo do ishte njësoj sikur të bënim një gjë të keqe. Kush mund t'ju detyrojë juve të ndryshoni zemrën? Ju duhet të ushtroni disiplinë mbi veten. Të marrësh më të mirat e çdo shkolle është të pranosh gjëra nga të gjithë. Po qe se praktikoni një praktikë qigongu sot dhe një tjetër nesër për të shëruar sëmundjet tuaja, është shëruar sëmundja juaj në fakt? Jo. Ju vetëm mund ta shtyni atë. Të praktikosh kultivim të niveleve të larta kërkon prej secilit që të përqëndrohet në një shkollë dhe të qëndrojë me të. Po ndoqe një praktikë, ju duhet t'ja jepni zemrën asaj derisa të lartësoheni shpirtërisht plotësisht në atë shkollë. Vetëm atëhere mundeni ju të praktikoni kultivim në një shkollë tjetër dhe ai do të jetë një sistem tjetër. Meqenëse një sistem mësimesh të vërteta është kaluar prej një epoke shumë të largët, ajo do të ketë kaluar në një proces transformimi mjaft kompleks. Disa njëzëz shkojnë sipas asaj që ndjejnë kur praktikojnë. E për çfarë shërbejnë ndjenjat tuaja? Ato nuk janë asgjë. Proçesi aktual i transformimit ndodh në dimensione të tjera dhe është jashtëzakonisht kompleks e i komplikuar. Nuk mund të ketë vend për asnjë gabim sado të vogël. Është si një instrument precizioni që do të prishej sapo t'i shtojë një pjesë të huaj. Trupi juaj në çdo dimension po ndryshon; kjo është jashtëzakonisht preçize dhe nuk mund të shkojë gabim as edhe një çikë. Jua kam thënë tashmë se kultivimi varet nga përpjekjet e secilit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mësuesi. Nëqoftëse ju, pa e vrarë mëndjen, merrni gjëra nga njerëzit e tjerë dhe i shtoni ato në praktikën tuaj, mesazhet e huaja do të ndërhyjnë në gjërat e kësaj shkolle kultivimi dhe ju do të shkonit dëm. Po ashtu, kjo do të reflektohej në shoqërinë njerëzore dhe do t'i sillte probleme njerëzve. Kjo u shkaktua nga përndjekja jote dhe të tjerët nuk mund të ndërhyjnë. Kjo është çështje e cilësisë së ndriçimit tënd shpirtëror. Në të njëjtën kohë ajo që shtove do të prishte gongun dhe ti nuk do të mund të praktikojë më kultivim. Ky problem do të ndodhë. Unë nuk po them që të gjithë duhet të studjojnë Falun Dafën. Nëqoftëse ju nuk studjoni Falun Dafa dhe keni marrë mësim të vërteta nga praktika të tjera qigongu, unë do ta pranoja atë. Më

lejoni t'ju them megjithatë, në mënyrë që me të vërtetë të praktikoni kultivim të niveleve të larta, ju duhet të jeni vetëm me një praktikë. Kam dhe një gjë tjetër që dua t'ja u vë në dukje: Në kohën e tanishme, asnjë njeri tjetër nuk po mëson njerëzit me të vërtetë drejt niveleve të larta si unë. Në të ardhmen ju do e kuptoni çfarë kam bërë për ju. Kështu, shpresoj që të mos keni cilësi të ulët ndriçimi shpirtëror. Shumë njerëz kanë dëshirë të praktikojnë kultivim drejt niveleve të larta. Ajo ju është vënë tashmë përpara dhe ju përsëri mund të mos e dini këtë. Ju keni kërkuar gjithandej për një mësues dhe keni harxhuar shumë para, e megjithatë nuk e keni gjetur. Sot, ju ka ardhur tek pragu dhe mbase nuk e keni kuptuar këtë! Kjo është çështje ndriçimi shpirtëror apo ndryshe nëse ju mund të jeni i shpëtueshëm.

LEKSIONI I DYTË

Çështja e Syrit Qiellor

Shumë mjeshtër qigongu kanë folur mbi Syrin Qiellor. Por Ligji ka manifestime të ndryshme në nivele të ndryshme. Një praktikues, kultivimi i të cilit ka arritur një nivel të caktuar, mund të shikojë vetëm manifestimet e atij niveli. Ai nuk mund të shikojë të vërtetën përtej nivelit të tij dhe as që ka për ta besuar atë. Prandaj, ai konsideron si të saktë vetëm atë që ai sheh në nivelin e tij. Para se kultivimi i tij të arrijë një nivel më të lartë, ai mendon se ato gjëra nuk ekzistojnë dhe nuk janë të besueshme; kjo përcaktohet nga niveli i tij dhe mendja e tij nuk mund të lartësohet. Me fjalë të tjera, mbi çështjen e Syrit Qiellor, disa njerëz flasin për të në një mënyrë dhe të tjerë flasin në një mënyrë tjetër. Si rezultat, ata e kanë ngatërruar çështjen dhe së fundi asnjë nuk mund ta shpjegojë atë qartë. Syri Qiellor, në fakt, është diçka që nuk mund të shpjegohet qartë në nivel të ulët. Në të kaluarën, struktura e Syrit Qiellor i përkiste sekretit të sekreteve dhe njerëzit e zakonshëm ishin të ndaluar ta dinin atë. Kështu, gjatë gjithë historisë askush nuk fliste për të. Por këtu ne nuk e trajtojmë atë në bazë të teorive nga e kaluara. Ne përdorim shkencën moderne dhe gjuhën më të thjeshtë të kohës së sotme për ta shpjeguar atë dhe ne do të shtjellojmë çështjet kryesore të tij.

Syri Qiellor për të cilin po flasim është i vendosur pak më sipër dhe në mes të vetullave dhe lidhet me gjendrën pineale të trurit. Ky është kanali kryesor. Trupi njeriut ka shumë sy të tjerë. Shkolla Tao thotë se çdo hapje është sy. Shkolla Tao quan një pikë akupunkte në trup “hapje” ndërsa mjekësia kineze e quan atë pikë akupunkte. Shkolla Buddhës beson se çdo pore djerse është sy. Prandaj disa njerëz mund të lexojnë me veshë dhe disa mund të shikojnë me duar apo nga mbrapa kokës; akoma të tjerë mund të shikojnë me këmbë apo bark. Është plotësisht e mundur.

Me që po flaim për Syrin Qiellor, do flasim së pari për këta palë sy fizikë njerëzore. Në kohën tonë, disa njerëz mendojnë se këta palë sy mund të shikojnë çdo materie apo objekt në këtë botë. Prandaj, disa njerëz kanë zhvilluar nocionin kokëfortë se vetëm çfarë mund të shihet me sy është e vërtetë dhe konkrete. Ata nuk besojnë atë që nuk e shohin. Në të kaluarën, këta njerëz konsideroheshin të kishin cilësi të ulët ndriçimi shpirtëror, megjithëse njerëzit nuk mund ta shpjegonin qartë pse cilësia e ndriçimit shpirtëror të këtyre njerëzve ishte e varfër. Po nuk e pashë, nuk e besoj. Kjo mund të duket shumë e arsyeshme. Megjithatë nga pikëpamja e një niveli më të lartë, nuk është e arsyeshme. Çdo kohë-hapësirë është e përbërë prej materie. Sigurisht, kohë-hapësira të ndryshme kanë struktura fizike të ndryshme dhe forma të shumta manifestimi jetësh të ndryshme.

Le t'ju jap një shembull. Në Buddhizëm, thuhet se çdo fenomen në shoqërinë njerëzore është vegim dhe jo i vërtetë. Si janë ato vegime? Objekte të vërteta dhe konkrete janë të vendosura tamam para jush, pra kush do të pretendonte që janë të rreme? Forma fizike e paraqitjes së objektit duket ashtu, por mënyra e vërtetë e ekzistencës së tij nuk është ashtu. Sytë tanë kanë aftësinë të stabilizojnë objekte fizike në dimensionin tonë fizik në formën që ne i shikojmë tani. Objektet nuk janë në fakt në këtë gjendje dhe ato nuk janë në atë gjendje madje edhe në dimensionin tonë. Për shembull, si duket njeriu nën mikroskop? I tërë trupi i tij është i përbërë nga molekula të lira dhe të vockla, tamam si kokrrizat e rërës që janë në lëvizje. Elektronet rrotullohen rreth bërthamës dhe i tërë trupi është në lëvizje. Sipërfaqja e trupit nuk është as e lëmuar e as e rregullt. Çfarëdo materie në univers, si çeliku, hekuri dhe shkëmbinjë janë po ashtu në lëvizje dhe brenda tyre të gjitha elementet molekulare të tyre janë në lëvizje. Njeriu nuk mund ta shikojë formën e tyre të plotë dhe ato nuk janë në fakt në qetësi. Kjo tavolinë po ashtu është në lëvizje, megjithatë sytë tuaj nuk mund ta shikojnë këtë të vërtetë. Këta palë sy mund të na japin përshtypje të rreme si kjo.

Nuk është se ne nuk mund të shikojmë gjërat në nivelin mikroskopik, apo që njerëzit nuk e kanë këtë aftësi. Njerëzit lindin me këtë aftësi dhe ata mund të shikojnë gjërat në një nivel të caktuar

mikroskopik. Pikërisht pse në këtë dimension fizik ne kemi këto palë sy, njerëzit marrin përshtypje të rreme dhe i ndalohet të shikojnë gjërat. Kështu, në të kaluarën thuhej se kur njerëzit nuk besonin ato gjëra që nuk mund t'i shikonin, këta njerëz konsideroheshin nga komuniteti i kultivuesve se kishin cilësi ndriçimi shpirtëror të varfër, se ishin të gënjer nga pamjet fallso të njerëzve të zakonshëm dhe se ishin të humbur në mes të njerëzve të zakonshëm. Kjo është thënie e bërë historikisht nga fetë. Aktualisht, ne gjithashtu kemi konstatuar të jetë shumë e arsyeshme.

Këto palë sy mund të stabilizojnë gjërat në dimensionin tonë fizik në gjendje të tillë. Përveç kësaj, ata nuk kanë ndonjë aftësi tjetër të rëndësishme. Kur dikush shikon diçka, imazhi nuk formohet direkt në sy. Sytë janë si lentet e aparatit fotografik, ato veprojnë vetëm si përçues. Kur shikon nga larg, lentja zmadhohet; sytë tanë po ashtu marrin këtë funksion. Kur shikon në errësirë, bebet e syrit zmadhohen. Kur një aparat merr një foto në arrësirë, objektivi i tij po ashtu zmadhohet. Përndryshe, foto do të ishte e errët me ekspozim drite të pamjaftueshme. Kur ti del në një vend shumë të ndritshëm jashtë, bebet e tua zvogëlohen menjëherë. Përndryshe sytë e tu do të verboheshin nga drita dhe ti nuk do të mund të shikoje qartë. Një aparat punon mbi të njëjtin parim dhe objektivi po ashtu duhet të zvogëlohet. Syri mund të kapë vetëm pamjen e një objekti dhe kështu është thjesht një vegël. Kur ne shohim gjëra aktualisht, një person apo kur shohim formën e ekzistencës së një objekti, imazhet formohen në tru. Domethënë, çfarë shohim me sy dërgohet në gjendrën pineale në fund të trurit nëpërmjet nervit optik dhe pastaj reflektohet si pamje në atë pjesë. Kjo është si të thuash që pamjet aktuale të reflektuara shihen në gjendrën pineale të trurit. Mjekësia moderne gjithashtu e ka pranuar këtë.

Hapja e Syrit Qiellor që ne po trajtojmë shmang përdorimin e nervit optik njerëzor dhe hap një kalim ndërmjet vetullave kështu që gjendra pineale e trurit mund të shikojë direk jashtë. Kjo quhet hapje e Syrit Qiellor. Disa njerëz mund të gjykojnë: “Kjo nuk është realiste. Mbi të gjitha, këta palë sy prapëprap mund të shërbejnë si mjet dhe ata mund të kapin pamjet e objekteve, diçka e pamundur pa sytë.” Anatomia e mjekësisë moderne, ka zbuluar tashmë se pjesa ballore e gjendrës pineale të trurit është e pajisur me një strukturë të plotë të një syri njerëzor. Meqenëse rritet brenda kafkës, thuhet se është sy rudimentar. Nëse është sy rudimentar apo jo, komuniteti i kultivuesve ka rezervime. Megjithatë mjekësia moderne ka pranuar mbi të gjitha se ekziston një sy në mes të trurit njerëzor. Kalimi që ne hapim synon pikërisht atë vend dhe kjo është në përputhje të plotë me të kuptuarin e mjekësisë moderne. Ky sy nuk krijon imazhe fallco si pala e syve tanë fizikë, sepse shikon si natyrën e materies ashtu dhe esencën e materies. Prandaj, një person me Sy Qiellor të nivelit të lartë mund të shikojë përtej dimensionit tonë në kohë-hapësira të tjera dhe mund të shikojë skena të cilat njerëzit e zakonshëm nuk mund t'i shohin. Një person me Sy Qiellor të nivelit të ulët mund të ketë shikim penetrues e mund të shikojë gjëra përtej një muri apo shikojë brenda trupit të njeriut. Ai ka pikërisht këtë aftësi supernormale.

Shkolla Buddhës flet për pesë nivele të shikimit: Shikim Mishtor, Shikim Qiellor, Shikim Mençurie, Shikim Ligji dhe Shikim Buddha. Këto janë pesë nivelet kryesore të Syrit Qiellor dhe secili ndahet në nivel të sipërm, mesëm dhe ulët. Shkolla Tao flet për nëntë herë nëntë apo tetëdhjetë e një nivele të Shikimit të Ligjit. Ne po hapim Syrin Qiellor për secilin këtu, por ne nuk e hapim atë tek apo më poshtë se Shikimi Qiellor. Pse? Megjithëse ti je këtu dhe ke filluar të praktikosh kultivim, ti je, mbi të gjitha, duke e filluar nga niveli i njeriut të zakonshëm me shumë nga dëshirat e njeriut të zakonshëm akoma të pabraktisura. Nëqoftëse Syri jot Qiellor hapet poshtë Shikimit Qiellor, ti do të kesh atë që njerëzit e quajnë aftësi supernormale, sepse ti mund të shikosh tej përtej murit dhe trupit të njeriut. Po ta shpërndanim këtë aftësi supernormale gjërisht dhe nëqoftëse Syri Qiellor i të gjithëve do të hapesh në këtë nivel, kjo do të shqetësonte në mënyrë serioze shoqërinë njerëzore dhe do të prishte gjendjen e zakonshme të shoqërisë njerëzore: sekretet shtetërore do të viheshin në rrezik; do të ishte njësoj sikur njerëzit të ishin pa rroba veshur, ti mund të shikoje njerëzit brenda në shtëpi që nga jashtë; ndërsa shëtit në rrugë, ti mund të kapje çmimet fituese të llotarisë me një shikim. Kjo nuk

mund të lejohet! Mendojeni pak, secili: A do të ishte kjo akoma shoqëri njerëzore nëqoftëse Syri Qiellor i të gjithëve do të hapej në Shikimin Qiellor? Të shqetësosh seriozisht gjendjen e shoqërisë njerëzore është absolutisht e ndaluar. Po t’ja u hapja Syrin Qiellor në atë nivel, ju mund të bëheshit mjeshtër qigongu menjëherë. Disa njerëz endërronin më parë të bëheshin mjeshtër qigongu. Nëqoftëse Syri tyre Qiellor do hapesh papritmas, ata do të ishin të aftë të kuronin pacientë. A nuk do t’ju çoja unë në një rrugë të keqe në këtë rast?

Atëhere, në cilin nivel ja u hap unë Syrin Qiellor juve? Unë do t’jua hap Syrin Qiellor direkt e në nivelin e Shikimit të Mençurisë. Po të hapej në një nivel më të lartë, karakteri juaj nuk është i përshtatshëm. Po të hapej në një nivel më të ulët, kjo do të shqetësonte seriozisht gjendjen e shoqërisë njerëzore. Me Shikim Mençurie, ju nuk keni aftësinë të shikoni gjërat përmes murit apo shikoni brenda trupit të njeriut, por ju mund të shikoni skena që ekzistojnë në dimensione të tjera. Çfarë përfitimi ka kjo? Ajo mund të përforcojë besimin tuaj tek praktika. Kur ju me të vërtetë shikoni diçka që njerëzit e zakonshëm nuk mund ta shikojnë, ju do të mendoni që ekziston me siguri. Pamvarësisht nëse mund të shikoni qartë tani, Syri juaj Qiellor do të hapet në këtë nivel dhe kjo është mirë për praktikën tuaj. Një praktikues i vërtetë i Dafës mund të arrijë të njejtin rezultat duke lexuar këtë libër, me kusht që të jetë i rreptë me veten në përmirësimin e karakterit.

Çfarë e përcakton nivelin e Syrit Qiellor të personit? Nuk është e thënë që me t’u hapur Syri juaj Qiellor, ju do të mund të shikoni çdo gjë—nuk është ashtu. Ekziston edhe një klasifikim nivelesh. Atëhere çfarë i përcakton nivelet? Janë tre faktorë. I pari është që Syri Qiellor i dikujt duhet të ketë një fushë që shkon nga brenda jashtë dhe ne e quajmë këtë esenca e qi-së. Për çfarë shërben ajo? Është si ekran televizori: Pa fosfor, pasi një televizor ndizet, ai është akoma një llampë drite. Do të ketë vetëm dritë, por jo pamje. Pamjet dalin në sajë të fosforit. Sigurisht, ky nuk është shembull shumë i përshtatshëm sepse ne i shikojmë gjërat direkt ndërsa një televizor i paraqet pamjet nëpërmjet ekranit. Kjo është idea në vija të gjëra. Kjo pjesë esence qi-je është jashtëzakonisht e çmuar dhe përbëhet nga një substancë tej e imët që përpunohet nga virtyti. Normalisht, esenca e qi-së e çdo personi është e ndryshme. Mbase dy në dhjetë mijë veta janë në të njejtin nivel.

Niveli i Syrit Qiellor është manifestim direkt i Ligjit të universit tonë. Është diçka supernormale dhe e lidhur ngushtë me karakterin e personit. Nëqoftëse niveli i karakterit të një personi është i ulët edhe niveli i tij është i ulët. Për shkak të nivelit të ulët të karakterit, shumica e esencës së qi-së së këtij personi ka humbur. Nëqoftëse niveli i karakterit të personit është i lartë dhe në shoqërinë njerëzore ai që nga feminija deri në moshë të rritur nuk është dhënë pas famës, fitimit, konflikteve me njerëzit, fitimit personal dhe ndjenjave e dëshirave të ndryshme njerëzore, esenca e tij e qi-së mund të jetë ruajtur relativisht më mirë. Prandaj, pasi Syri i tij Qiellor hapet, ai mund t’i shikojë gjërat më qartë. Një fëmijë nën moshën gjashtë vjeç mund të shikojë shumë qartë sapo t’i hapet Syri Qiellor. Është gjithashtu e lehtë të hapesh Syrin e tij Qiellor. Po të them unë një fjalë, do të hapesh.

Për shkak të ndotjes nga korrupsioni i shoqërisë njerëzore, gjërat që njerëzit i quajnë të drejta janë, në fakt, shpesh të gabuara. A nuk duan të gjithë të jetojnë një jetë të mirë? Dëshira për një jetë të mirë mund t’i hyjë në pjesë interesave të të tjerëve, të stimulojë interesat e tua egoiste, të marrë fitimet e të tjerëve apo të çojë në dominimin dhe dëmtimin e të tjerëve. Njeriu konkuron dhe lufton për fitim personal mes njerëzve të zakonshëm. A nuk është kjo të shkosh në drejtim të kundërt me karakteristikën e universit? Kështu, ajo që njerëzit e konsiderojnë të drejtë mund të mos jetë e drejtë në të vërtetë. Kur edukon fëmijën, një i rritur shpesh e mëson atë, “Mësohu të bëhesh i zoti,” kështu që në të ardhmen ai të ecë më i sigurtë në shoqërinë njerëzore. Nga pikëpamja e universit tonë, “të jesh i zoti” është gabim, sepse ne kërkojmë ndjekjen e rrjedhës së natyrisht të gjërave dhe të mos merakosesh për fitim personal. Duke qënë i zoti, ai do të ndjekë interesin personal. “Kushdo që të rrahë, shko tek mësuesi i tij dhe gjeja prindët.” “Merri lekët që gjen në rrugë.” Fëmija mësohet në këtë mënyrë. Nga feminija deri në moshë të rritur, ndërsa ai merr gjithnjë e më shumë gjëra, ai do

bëhet gradualisht gjithnjë e më shumë egoist në shoqëri. Ai do të përfitojë nga të tjerët dhe do të humbë virtyt.

Kjo substancë, virtyti, nuk zhduket pasi dikush e humb atë. Ajo transferohet tek një person tjetër. Ndërsa kjo esencë qi-je mund të zhduket. Nëqoftëse dikush është shumë dinak nga feminija deri në moshë të rritur, me një dëshirë të fortë për interes vetjak dhe vetëm kërkon fitim, Syri Qiellor i këtij personi nuk do të funksionojë normalisht apo shohë gjërat qartë pasi të hapet. Megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk do të funksionojë kurrë më. Pse? Sepse gjatë kursit të praktikës kultivuese ne përpiqemi të kthehemi në origjinë, në veten tonë të vërtetë dhe nëpërmjet praktikës këmbëngulëse ne do të jemi të aftë ta kompensojmë vazhdimisht dhe ta rifitojmë atë. Prandaj, njeriu duhet t'i kushtojë vëmendje karakterit. Ne theksojmë përmirësim të gjithanshëm dhe ngritje të gjithanshme. Po të ngrihet karakteri, çdo gjë tjetër do të ndjekë atë. Nëqoftëse karakteri nuk ngrihet, as ajo pjesë e esencës së qi-së nuk do të rikuperohet. Ky është parimi.

Faktori i dytë është se kur një person praktikon qigong vetë, Syri tij Qiellor mund të hapet nëqoftëse cilësia e tij e lindur është e mirë. Shpesh, disa njerëz frikësohen në momentin kur u hapet Syri Qiellor. Pse frikësohen ata? Sepse njerëzit zakonisht praktikojnë qigong në mesnatë, kur është errët dhe qetësi. Ndërsa personi praktikon, ai mund të shikojë papritmas një sy të madh para syve të tij, që e frikëson atë menjëherë. Kjo frikë është jashtëzakonisht e madhe dhe ai nuk do të ketë guxim të praktikojë qigong pas kësaj. Sa e frikëshme! Një sy që hapet e mbyllet që është aq i madh të shikon dhe është shumë i qartë. Për pasojë, disa njerëz e quajnë atë syri demonit, ndërsa të tjerë e quajnë syri Buddhës etj. Në fakt, është syri jot. Sigurisht, kultivimi varet nga përpjekjet e secilit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri. I tërë procesi i transformimit të gongut është shumë kompleks dhe ndodh në dimensione të tjera. Trupi nuk ndryshon vetëm në një dimension, por në të gjitha dimensionet e ndryshme. A mund ta bësh ti këtë vetë? Ti nuk mundesh. Këto gjëra janë rregulluar nga mjeshtri dhe kryhen nga mjeshtri. Prandaj, thuhet se kultivimi varet nga përpjekjet e secilit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri. Ju mund të keni vetëm dëshirën dhe të mendoni për të, por është mjeshtri i cili i bën në fakt këto gjëra.

Disa njerëz e hapin Syrin Qiellor vetë nëpërmjet praktikës së tyre. Ne e konsiderojmë atë si syrin tënd, por ti nuk je në gjendje ta zhvillosh atë vetë. Disa njerëz kanë mjeshtër të cilët, me të parë që Syri i tyre Qiellor është hapur, do të transformojnë një për ta. Ky quhet syri i vërtetë. Sigurisht disa njerëz nuk kanë mjeshtër, por mund të jetë ndonjë mjeshtër që enkas kalon andej. Shkolla Buddhës thotë: "Buddhat janë të gjithëpranishëm." Ata janë kaq të shumtë sa gjenden kudo. Disa njerëz thonë: "Gjenden shpirta tre pëllesh sipër kokës njerëzve", që do të thotë se ata janë thjesht të panumërt. Nëqoftëse një mjeshtër që kalon andej shikon që ti ke praktikuar shumë mirë me Syrin Qiellor të hapur dhe se ty të duhet një sy, ai apo ajo do të transformojnë një për ty, që mund të konsiderohet gjithashtu si rezultat i praktikës tënde. Kjo ndodh sepse kur i afrojnë njerëzve shpëtim, ata nuk vënë kushte apo mendojnë për çmim, shpërblim, apo famë. Kështu ata janë shumë më tepër fisnikë sesa heronjtë midis njerëzve. Ata e bëjnë këtë plotësisht nga zemërmirësia e tyre mëshiruese.

Pas hapjes së Syrit Qiellor, do të ndodhë kjo situatë: sytë do të verbohen keq nga drita dhe do të irritohen. Në fakt nuk janë sytë që irritohen. Por është gjendra pineale në trurin tuaj që është irrituar, megjithëse juve ju duket sikur janë irrituar sytë. Kjo ndodh për shkak se ju nuk jeni pajisur akoma me këtë sy. Pasi ju jepet ky sy, sytë fizikë nuk janë më të irrituar. Disa nga praktikuesit tanë do të jenë në gjendje ta ndiejnë apo shikojnë këtë sy. Meqenëse manifeston të njejtën natyrë si të universit, ai është shumë i pafajshëm dhe gjithashtu kurioz. Shikon brenda për të parë nëse kanali i Syrit Qiellor është hapur dhe në mund të shohë. Po ashtu shikon dhe brenda trupit tuaj. Në këtë moment Syri juaj Qiellor është hapur. Ndërsa të shikon ty, ti do të frikësohesh kur papritmas ta shohësh. Në fakt, ky është syri jot. Që këtë e tutje, kur të vështrosh gjërat, do t'i shikosh nëpërmjet këtij syri. Edhe sikur Syri Qiellor i jot të ishte hapur, ti nuk do të ishe në gjendje të shikoje pa këtë sy.

Faktori i tretë janë ndryshimet që manifestohen në dimensione të ndryshme pasi dikush bën ngjitje në nivele. Kjo është çështja që me të vërtetë përcakton nivelin e dikujt. Përveç kanalit kryesor për të parë gjërat, njerëzit gjithashtu kanë dhe shumë nënkanale. Shkolla Buddhës thotë se çdo pore djerse është sy, ndërsa Shkolla Tao beson se çdo hapje e trupit është sy. Domethënë, të gjitha qendrat e akupunkturës janë sy. Sigurisht, këto që thonë ato janë veçse një formë e transformimit të Ligjit në trup; njeriu mund të shikojë nga çdo pjesë e trupit.

Niveli të cilit i referohemi ne është i ndryshëm nga këto. Përveç kanalit kryesor, ka gjithashtu disa nënkanale të mëdha në disa vende, më saktë, sipër dy vetullave, sipër dhe poshtë qepallave dhe në pikën *shangen*¹. Ato përcaktojnë çështjen e ngjitjes në nivele. Sigurisht, për një praktikues mesatar, nëqoftëse ai mund të shikojë nga këto vende të ndryshme, ai ka arritur tashmë një nivel shumë të lartë. Disa njerëz mund të shikojnë gjithashtu dhe me sytë fizikë. Dhe ata kanë arritur të kultivojnë këta sy që janë gjithashtu të pajisur me forma të ndryshme aftësish supernormale. Nëqoftëse syri fizik nuk përdoret mirë, dikush do të shohë një objekt pa parë tjetrin. Dhe kjo nuk funksionon. Kështu, disa njerëz shpesh shikojnë njërin anë me njërin sy dhe anën tjetër me syrin tjetër. Megjithatë nuk ekziston nënkanal poshtë syrit të djathtë sepse ai lidhet drejtpërdrejt me Ligjin. Njerëzit kanë tendencë ta përdorin syrin e djathtë për të kryer vepra të këqija; kështu nuk ka nënkanal poshtë syrit të djathtë. Këto ishin nënkanale kryesore që zhvillohen në kultivimin e Ligjit-Në-Botën-Trefishe.

Pas arritjes së një niveli jashtëzakonisht të lartë dhe në kultivimin e Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe, një sy që i ngjan një syri të përbërë do të formohet. Më saktësisht, në pjesën e sipërme të fytyrës do të shfaqet një sy i madh me sy të vegjël të panumërt në të. Disa Qënie të Shumëlartësuara shpirtësisht të niveleve shumë të larta kanë kultivuar kaq shumë sy sa që i kanë në tërë fytyrën e tyre. Të gjithë sytë shikojnë nëpërmjet këtij syri të madh dhe ata mund të shikojnë çfarë të duan. Me një shikim, ata mund të shikojnë të gjitha nivelet. Sot, zoologët dhe entomologët kryejnë kërkime mbi mizat. Syri i një mize është shumë i madh; nëpërmjet mikroskopit është parë që ai përmban shumë sy të vegjël në të dhe ky quhet sy i përbërë. Pasi praktikuesit arrijnë një nivel jashtëzakonisht të lartë, kjo situatë mund të ndodhë. Personi duhet të jetë disa herë më lart se niveli i Tathagatës që kjo të bëhet e mundur. Megjithatë një person i zakonshëm nuk mund ta shikojë këtë sy. Edhe njerëzit në nivel të mesëm nuk mund ta shikojnë ekzistencën e tij për shkak se ai ekziston në një dimension tjetër dhe ata mund të shikojnë vetëm që personi është njeri normal. Kjo shpjegon kapërcimet në nivele. Me një fjalë, ka të bëjë me faktin nëse dikush mund të arrijë dimensione të ndryshme.

Kam përshkruar kështu strukturën e Syrit Qiellor për të gjithë. Ne e hapim Syrin tuaj Qiellor me një forcë të jashtme, kështu është relativisht më e shpejtë dhe më e lehtë. Kur po flisja për Syrin Qiellor, secili nga ju mund të ndjente ballin që i tkurrej; i ndjenit muskujt sikur po ju paloseshin mbi njeri tjetrin dhe shtynin drejt brendësisë. Ishte kështu apo jo? Kështu ishte. Për sa kohë që ju me të vërtetë i futeni studimit të Falun Dafës, të gjithë do ta ndjeni këtë; forca e jashtme vjen shumë e fortë kur depërton drejt brendësisë. Unë kam lëshuar energjinë e posaçme që hap Syrin Qiellor. Ndërkohë, kam lëshuar gjithashtu Falun që të riparojnë Syrin tuaj Qiellor. Ndërsa flisja për Syrin Qiellor, po ja u hapja atë të gjithëve, me kusht që ju të praktikoni kultivim në Falun Dafa. Megjithatë, nuk është e thënë që të gjithë mund të shikojnë qartë dhe jo të gjithë mund të shikojnë gjë me të. Kjo ka të bëjë direkt me vetë ju. Mos u shqetësoni sepse nuk ka rëndësi nëqoftëse ju nuk mund të shikoni me të. Kushtojini kohën ta kultivoni. Ndërsa ju vazhdimisht ngrini nivelin, ju do të bëheni të aftë gradualisht të shikoni gjëra dhe pamja e mjergullt do të bëhet gjithnjë dhe më e qartë. Për sa kohë që ju praktikoni kultivim dhe e vendosni në mëndje të praktikoni kultivim, ju do të rimerrni çdo gjë që keni humbur.

¹*shangen*—qendër akupunkturore që ndodhet në mes të vetullave.

Është relativisht e vështirë të hapësh Syrin Qiellor vetë. Më lejoni të flas për disa forma të hapjes së Syrit Qiellor vetë. Për shembull, kur shikoni ballin dhe Syrin Qiellor gjatë meditimit, disa nga ju ndiejnë që është errësirë brenda në ballë dhe se nuk ka asgjë atje. Me kalimin e kohës, do të shikoni që gradualisht zbardhet brenda ballit. Pas një kohe praktike kultivuese, do të zbuloni që gradualisht fillon dhe ndriçohet brenda ballit dhe pastaj kthehet në të kuqe. Në këtë kohë, do të çelët si lulet që shihen në televizor apo në një film ku lulet çelin në një sekondë. Skena të tilla do të shfaqen. Ngjyra e kuqe do fillojë e plotë dhe pastaj papritmas do të qëndrojë në mes dhe rrotullohet papushim. Po të doni ta rrotulloni vetë deri në fund, edhe tetë apo dhjetë vjet mund të mos jenë të mjaftueshëm meqenëse i gjithë Syri Qiellor është i bllokuar.

Syri Qiellor i disa njerëzve nuk është i bllokuar, por ata janë të pajisur me një kalim. Por në kalim nuk ka energji sepse ata nuk praktikojnë qigong. Kështu, kur ata praktikojnë qigong, një top i zi do të shfaqet papritmas para syve të tyre. Pasi ata të praktikojnë për disa kohë, ai do të shndërrohet ngadalë në të bardhë dhe pastaj do të bëhet i ndritshëm. Së fundi, do të ndriçojë gjithnjë e më shumë dhe sytë do të ndjehen pak si të verbuar. Prandaj, disa njerëz thonë, “Pashë diellin”, apo “Pashë hënën”. Në fakt, ata nuk panë as diellin dhe as hënën. Çfarë panë ata atëhere? Ishte kalimi i tyre. Disa njerëz arrijnë ngjitje të shpejta në nivelet e tyre. Me t’ju dhënë syri ata mund të shikojnë menjëherë. Për të tjerë është mjaft e vështirë. Kur ata praktikojnë qigong, ata do të ndiejnë sikur vrapojnë drejt daljes përgjatë këtij kalimi, që është si një tunel apo pus. Edhe në gjumë, ata ndiejnë sikur po vrapojnë drejt daljes. Disave mund t’i duket sikur po i japin një kali; disave mund t’i duket sikur fluturojnë; disave sikur vrapojnë; dhe disave u duket sikur ecin me makinë. Ngaqë është e vështirë të hapësh Syrin Qiellor vetë, atyre u duket gjithmonë sikur nuk arrijnë fundin. Shkolla Tao e konsideron trupin e njeriut një univers të vogël. Nëqoftëse është një univers i vogël, pa mendojeni, është më shumë se 108 mijë li^2 nga balli deri tek gjendra pineale e trurit. Kështu, ty të duket sikur gjithmonë po shtyn drejt daljes dhe nuk e arrin dot fundin.

Është plotësisht e arësyeshme që Shkolla Tao e konsideron trupin e njeriut një univers të vogël. Kjo nuk do të thotë që përbërja dhe struktura e saj janë të ngjashme me ato të universit dhe as i referohet kjo formës së ekzistencës së trupit në dimensionin tonë fizik. Ne pyesim, “Sipas të kuptuarit të shkencës moderne, në një nivel më mikroskopik, si shfaqet trupi fizik që përbëhet nga qelizat?” Ekzistojnë përbërje molekulare të ndryshme. Më të vogla se molekulat janë atomet, protonet, bërthamat, elektronet dhe kuarket. Grimcat më mikroskopike që studjohen sot janë neutrinet. Atëhere, cila është grimca më mikroskopike? Është me të vërtetë tepër e vështirë për t’u studjuar. Në vitet e tij të fundit, Sakyamuni bëri këtë deklaratë: “Është kaq e pamasë sa nuk ka konture të jashtme dhe kaq e vogël sa nuk ka konture të brendshme.” Çfarë do të thotë kjo? Në nivelin e Tathagatës, universi është kaq i pamasë saqë kufijtë e tij janë të paarritshëm, por po ashtu dhe kaq i vogël saqë as grimcat e tij më mikroskopike të përbërjes nuk janë të dukshme. Për pasojë, ai tha: “Është kaq e pamasë sa nuk ka konture të jashtme dhe kaq e vogël sa nuk ka konture të brendshme.”

Sakyamuni gjithashtu foli për teorinë e tre mijë botëve. Ai tha se, në universin tonë dhe në Kashtën tonë të Kumtrit, ka tre mijë planete me qenie të gjalla që kanë trupa fizikë si raca jonë njerëzore. Ai gjithashtu tha se ka tre mijë botë të tilla në një kokrrizë rëre. Një kokrrizë rëre është kështu një univers me vete, me njerëz që kanë inteligjencë si ne, planete, male dhe lumenj. Duket plotësisht e pakonceptueshme! Po qe kështu, pa mendojeni pak: A ka rërë në ato tre mijë botë? Dhe nuk do të ketë tre mijë botë të tjera në secilën nga ato kokrriza rëre? Atëhere, a ka rërë në vetë këto tre mijë botë të tjera? Atëhere a nuk do të ketë tre mijë botë edhe në secilën nga këto kokrriza rëre të rërës? Kështu, edhe në nivelin e Tathagatës, nuk mund t’i shohësh fundin.

E njejta gjë është e vërtetë me qelizat molekulare njerëzore. Njerëzit pyesin sa i madh është universi. Më lejoni t’ju them se ky univers ka kufijtë e tij. Por edhe në nivelin e Tathagatës, ai do të

² li —një njësi kineze gjatësie (=0.5 km). Në gjuhën kineze, “108 mijë li ” është një shprehje e zakonshme që përdoret për një distancë shumë të largët.

duket i pakufi dhe i pamasë në pafundësi. Megjithatë brendësia e trupit të njeriut është e madhe sa dhe ky univers, që nga molekulat tek pjesëzat mikroskopike. Kjo mund të duket shumë e pakonceptueshme. Kur një qenie njerëzore apo një jetë krijohet, elementet unike të jetës dhe cilësitë qenësore të saj janë tashmë të formuara që nga niveli tepër mikroskopik. Kështu, në studimin e kësaj sfere, shkencë jonë moderne është shumë mbrapa. Në krahasim me ato jetë të një inteligjence më të lartë në planetet e gjithë universit, niveli shkencor i racës sonë njerëzore është shumë i ulët. Ne nuk mund as të arrijmë dimensione të tjera që ekzistojnë njëkohësisht në të njejtin vend, ndërsa objekte fluturuese nga planete të tjera mund të udhëtojnë në dimensionin tonë. Koncepti i asaj kohë-hapësire është plotësisht i ndryshëm. Kështu, ata mund të shkojnë e vijnë sipas dëshirës dhe me një shpejtësi kaq të madhe sa që mëndja njerëzore nuk mund ta pranojë.

Kur fola për Syrin Qiellor, unë solla rastin kur ju ndjeni sikur po dilni jashtë përgjatë një tuneli e do t'ju duket sikur ai është i pakufi dhe i pafund. Disa njerëz mund të shohin një situatë tjetër, ku ata nuk ndjejnë sikur po vrapojnë përgjatë një tuneli, por sikur vrapojnë përgjatë një rruge të pakufi dhe të pafund. Ndërsa sulen për të dalë ka male, lumenj dhe qytete në të dy anët. Kjo mund të duket dhe më e pakonceptueshme. Më kujtohet që një mjeshtrë qigongu bëri një deklaratë të tillë: “Ka një qytet në çdo pore djerse të trupit të njeriut dhe trena dhe makina që ecin në të.” Me të dëgjuar këtë, të tjerët habiten dhe u duket e pakonceptueshme. Ju e dini që grimcat mikroskopike të materies përfshijnë molekulat, atomet dhe protonet. Kur kërkon më tutje, po të shikosh planin e secilit nivel në vend të një pike dhe të shikosh planin e molekulave, atomeve, protoneve dhe atë të bërthamave, do të shikosh format e ekzistencës në dimensione të ndryshme. Gjithë materia, duke përfshirë trupin e njeriut, ekziston njëkohësisht në lidhje me nivelet dimensionale të hapësirës kozmike. Kur fizika jonë moderne studjon grimcat mikroskopike të materies, ajo vetëm studjon një grimcë mikroskopike nëpërmjet ndarjes dhe shpërbërjes së saj. Ajo i studjon elementet e saj pas shpërbërjes bërthamore. Po të ekzistonte një instrument i tillë nëpërmjet të cilit ne mund të zgjerohim dhe shikojmë nivelin në të cilin të gjitha elementet atomike apo elementet molekulare mund të manifestoheshin në tërësinë e tyre, apo sikur kjo skenë të vëzhgohej, ju do të arrinit përtej këtij dimensionit dhe shikonit skenat e vërteta që ekzistojnë në dimensionet e tjera.

Ka dhe disa situata të tjera kur dikush hap Syrin Qiellor vetë. Ne kemi biseduar kryesisht rreth disa fenomeneve mjaft të zakonshme. Disa njerëzve gjithashtu u duket sikur Syri i tyre Qiellor rrotullohet. Ata që praktikojnë në Shkollën Tao shpesh shikojnë diçka që rrotullohet brenda Syrit të tyre Qiellor. Pasi pllaka Taiji kriset dhe hapet me një të kërcitur, ata do të shikojnë imazhe; megjithatë, nuk është se ka ndonjë Taiji në kokën tuaj. Ishte mjeshtri që kishte vendosur një komplet gjërash për ty që në fillim, një nga të cilat ishte Taiji. Ai e vulosi Syrin tuaj Qiellor. Në kokën kur Syri juaj Qiellor hapet çahet edhe pllaka. Mjeshtri me qëllim e kishte bërë atë në këtë mënyrë dhe nuk ishte diçka që gjendej në kokën tuaj.

Megjithatë disa njerëz kërkojnë të hapin Syrin e tyre Qiellor. Sa më shumë që ata e praktikojnë këtë, aq më e pamundur është që ai të hapet. Cila është arsyeja? As ata vetë nuk e kuptojnë. Kjo ndodh kryesisht ngaqë Syri Qiellor nuk mund të kërkohet; sa më shumë që dikush e dëshiron, aq më pak ai arrin. Kur një person e dëshiron atë jashtë mase, jo vetëm që nuk do të hapet por përkundrazi diçka as e zezë dhe as a bardhë do të dalë nga Syri i tij Qiellor. Kjo do ta mbulojë Syrin e tij Qiellor. Me kalimin e kohës, ajo do të formojë një fushë shumë të madhe. Sa më shumë që del jashtë, aq më shumë grumbullohet. Sa më shumë që ai ta dëshirojë atë, aq më e pamundur është që Syri Qiellor të hapet, e aq më shumë nga kjo substancë do të dalë jashtë. Si rezultat, ajo do të mbulojë gjithë trupin e tij deri sa të bëhet shumë e trashë dhe me një fushë shumë të madhe. Edhe sikur Syri Qiellor i këtij personi të hapet me të vërtetë, ai nuk do të mund të shikojë gjë sepse është bllokuar nga vetë dëshira e tij. Vetëm nëqoftëse ai nuk mendon më për të në të ardhmen dhe heq dorë plotësisht nga kjo përndjekje e tij, substanca do të zhduket gradualisht. Megjithatë do t'i duhet një periudhë tepër e dhimbshme dhe e gjatë praktike kultivuese për ta hequr atë. Kjo është tepër e

panevojshme. Disa njerëz nuk e dinë këtë. Megjithëse mjeshtri u thotë që të mos e kërkojnë apo përndjekin atë, ata nuk besojnë. Ata vazhdojnë ta kërkojnë dhe së fundi rezultojnë pikërisht e kundërta.

Aftësia Supernormale e Shikimit në Distançë

Një aftësi supernormale e lidhur drejtpërdrejt me Syrin Qiellor quhet shikim në distancë. Disa njerëz pretendojnë: “Ndërsa rri ulur këtu, unë mund të shikoj skena në Beijing dhe në Amerikë, si dhe në anën tjetër të tokës.” Disa njerëz nuk mund ta kuptojnë këtë dhe kjo as që mund të shpjegohet shkencërisht. Si është e mundur? Disa njerëz e shpjegojnë në këtë apo në atë mënyrë dhe nuk mund ta shpjegojnë në mënyrë të kuptueshme. Ata habiten si bëhen disa njerëz kaq të aftë. Nuk është kështu. Një praktikues në nivelin e kultivimit të Ligj-Në-Botën-Trefishe nuk e ka këtë aftësi. Ajo që sheh ai duke përfshirë shikimin në distancë dhe shumë aftësi të tjera supernormale, të gjitha funksionojnë brenda një dimensionit specifik. Të paktën, ato nuk janë jashtë këtij dimensionit fizik ku ekziston rracat jonë njerëzore. Në mënyrë tipike ato nuk janë as dhe përtej fushës dimensionale të vetë personit.

Brenda një dimensionit specifik, trupi njeriut ka një fushë e cila është e ndryshme nga fusha e virtytit. Ato nuk janë në të njëjtin dimension, por janë të një madhësie të njëjtë. Kjo fushë korrespondon me universin. Çfarëdo që ekziston në univers reflektohet aty. Çdo gjë mund të reflektohet. Është një lloj imazhi, por nuk është real. Për shembull, ekziston në këtë tokë Amerika dhe Washington D.C. Brenda fushës së një personi, Amerika dhe Uashington, D.C. janë të reflektuara, por ato janë imazhe të reflektuara. Imazhet e reflektuara janë megjithatë një formë e ekzistencës së materies dhe ato janë rezultat i një reflektimi korrespondues që ndryshon sipas ndryshimeve atje. Kështu, aftësia supernormale e shikimit në distancë që i referohen disa njerëz është të shikosh gjërat brenda fushës tënde dimensionale. Kur një person praktikon kultivim në Ligj-Përtej-Botës-Trefishe, ai nuk do t’i shikojë më gjërat në këtë mënyrë. Ai do t’i shikojë gjërat direct dhe kjo quhet fuqija hyjnore e Ligjit të Buddhës. Është diçka me fuqi të pamasë.

Pra si funksionon aftësia supernormale e shikimit në distancë në kultivimin e Ligjit-Në-Botën-Trefishe? Unë do ta shpjegoj këtë për çdo njeri. Brenda kësaj fushe, në ballin e secilit gjendet një pasqyrë. Pasqyra e një njeriu që nuk praktikon është e kthyer drejt vetes, por pasqyra e një praktikuesi kthehet në anën tjetër. Kur aftësia supernormale e shikimit në distancë të një personi është gati të shfaqet, pasqyra do të rrotullohet para dhe mbrapa. Dihet që një film shfaq njëzet e katër poza për sekondë në mënyrë që të krijojë figura në lëvizje. Nëqoftëse tregohen më pak se njëzet e katër poza për sekondë, pamjet do të mungojnë dhe nuk shfaqen në vazhdim. Shpejtësia e rrotullimit të pasqyrës është më e shpejtë se njëzet e katër poza për sekondë dhe reflekton çfarë sheh dhe e kthen atë që ta shikoni ju. Me t’u kthyer përsëri, figurat do të fshihen. Reflekton dhe kthehet dhe pastaj i fshin imazhet. Rrotullimi vazhdon pa ndërprerje. Kështu, ajo që shikoni është në lëvizje. Ajo të lejon të shikosh atë që reflektohet brenda fushës tënde dimensionale dhe i korrespondon asaj që gjendet në univers.

Atëhere si mund ta shikojë njeriu atë që është mbrapa trupit të vet? Me një pasqyrë kaq të vogël, si mund të reflektojë çdo gjë rreth trupit të njeriut? Ju e dini që kur Syri Qiellor i dikujt hapet përtej Shikimit Qiellor dhe është gati të arrijë Shikimin e Mençurisë, ai është gati të arrijë përtej dimensionit tonë. Në këtë pikë kur kalimi duket i afërt, Syri Qiellor do të pësojë një ndryshim. Kur shikon objektet fizike, ato do duken sikur zhduken. Njerëzit dhe muret do duken sikur zhduken—çdo gjë do zhduket. Domethënë, me një shikim më të përqëndruar, ti do të shohësh se në këtë dimension njerëzit nuk ekzistojnë më; ekziston vetëm një pasqyrë që qëndron brenda fushës tënde dimensionale. Megjithatë kjo pasqyrë në fushën tënde dimensionale është e madhe sa e gjithë fusha jote dimensionale. Kështu, kur rrotullohet para e mbrapa, reflekton çdo gjë kudo që ndodhet. Brenda

fushës tënde dimensionale, mund të të tregojë ty çdo gjë, me kusht që t'i korrespondojë asaj që gjendet në univers. Kjo është ajo që ne e quajmë aftësia supernormale e shikimit në distancë.

Kur ata që studjojnë shkencën e trupit të njeriut e vënë në prove këtë aftësi supernormale, ata mund ta përgënjeshtrojnë atë me lehtësi. Arsyeja për refuzimin është si vijon: Për shembull, kur një person e pyesin për kushërirën e dikujt në Beijing, “Çfarë po bën kushërira në shtëpi?” pasi i jepet emri i kushërirës dhe informacioni i përgjithshëm, personi mund ta shikojë atë. Ai do të përshkruajë ndërtesën, si të futesh në të dhe mobiljet e dhomës. Çfarë thotë ai është e gjitha e saktë. Çfarë po bën kushërira? Ai thotë se kushërira po shkruan. Për ta verifikuar këtë, ata do të pyesin kushërirën, “Çfarë po bën tani?” “Po ha.” A nuk do ta përgënjeshtronte kjo atë që pa ai? Në të kaluarën, kjo ishte arsyeja për të mos e pranuar këtë aftësi supernormale. Megjithatë, ambjenti që ai pa, nuk ishte aspak gabim. Meqenëse hapësira dhe koha janë, që ne i quajmë “kohë-hapësirë”, ka kohë të ndryshme nga kohë-hapësira e dimensionit ku ekziston aftësia supernormale, konceptet e kohës janë të ndryshme në të dy vendet. Ajo po shkruante diçka pak më parë dhe tani ajo po han; është ky ndryshim kohe. Si rezultat, nëqoftëse ata që studjojnë trupin e njeriut deduktojnë hipoteza dhe bëjnë studime bazuar në teoritë konvencionale dhe shkencën moderne, edhe pas dhjetë mijë vjetësh të tjera përpjekjet e tyre do të jenë të kota, sepse këto janë para së gjithash diçka përtej njerëzve të zakonshëm. Kështu, njerëzimi duhet të ndryshojë mentalitetin e vet dhe nuk duhet t'i kuptojë më këto gjëra në këtë mënyrë.

Aftësia Supernormale e Parashikimit të Fatit

Një aftësi tjetër supernormale drejtpërdrejt e lidhur me Syrin Qiellor quhet parashikim i fatit. Sot për sot, njihen gjashtë tipe aftësish supernormale publikisht në botë, ku përfshihen Syri Qiellor, shikimi në distancë dhe parashikimi i fatit. Çfarë është parashikimi i fatit? Kjo do të thotë që dikush mund të jetë i aftë të tregojë të kaluarën dhe të ardhmen e dikujt. Me një aftësi të fuqishme, dikush është i aftë të tregojë lulëzimin dhe rënien e një shoqërie. Me një aftësi akoma më të madhe, personi mund të shikojë ligjin e gjithë ndryshimeve kozmike. Kjo është aftësia supernormale e parashikimit të fatit. Për shkak se materia është në lëvizje dhe ndjek një ligj të caktuar, në një dimension të veçantë, e gjithë materia ka formën e vet të ekzistencës në shumë dimensione të tjera. Për shembull, kur trupi i një njeriu lëviz, qelizat në trup po ashtu do të lëvizin dhe në nivelin mikroskopik të gjitha elementet, si molekulat, protonet, elektronet dhe pjesëzat më mikroskopike gjithashtu do të lëvizin. Megjithatë ato kanë format e veta të pavarura të ekzistencës dhe format e trupit në dimensione të tjera do të pësojnë gjithashtu ndryshime.

A nuk e kemi trajtuar çështjen që materia nuk zhduket? Brenda një dimensionit të caktuar, atë që një person ka bërë apo bën me një të lëvizur të dorës është e gjitha ekzistencë materiale dhe çdo gjë që ai bën do të lërë një pamje dhe një mesazh. Në një dimension tjetër ato nuk zhduken dhe do të qëndrojnë atje përgjithmonë. Një person me aftësi supernormale do të dijë çfarë ka ndodhur duke parë pamjet ekzistuese të së kaluarës. Pasi ti të kesh aftësinë supernormale të parashikimit të fatit, forma e leksionit tim sot do të ekzistojë akoma atje kur ti t'i hedhësh një shikim. Ai ekziston atje njëkohësisht. Kur lind një njeri, brenda një dimensionit të caktuar që nuk ka konceptin e kohës, e tërë jeta e tij apo e saj ekziston atje njëkohësisht. Për disa njerëz edhe më shumë se një jetë ekziston atje.

Disa njerëz mund të pyesin, “Do të thotë kjo se përpjekjet tona individuale për ndryshimin e vetes janë të panevojshme?” Ata nuk mund ta pranojnë këtë. Në fakt, përpjekjet individuale mund të ndryshojnë gjëra të vogla në jetën e dikujt. Disa gjëra të vogla mund të ndryshohen pakëz nëpërmjet përpjekjeve individuale, por është pikërisht nga përpjekjet e tua për ndryshim që ti merr karmë. Përndryshe, çështja e shkaktimit të karmës nuk do të ekzistonte dhe as çështja e kryerjes së veprave të mira apo të këqija nuk do të ekzistonte. Kur dikush insiston në kryerjen e gjërave në këtë mënyrë, ai do të përfitojë nga të tjerët dhe do të kryejë vepra të këqija. Prandaj, kjo është arsyeja që praktika

kultivuese kërkon gjithmonë që njeriu të ndjekë rrjedhën e natyrshme të gjërave meqenëse përndryshe ti do të dëmtosh të tjerët me përpjekjet e tua. Nëqoftëse jeta jote nuk e përmban diçka që në fillim dhe ti e merr atë që duhej t'i përkiste dikujt tjetër në shoqëri, ti do i hysh atij personi në borxh.

Përsa i përket ngjarjeve të mëdha, një person i zakonshëm nuk mund t'i ndryshojë ato aspak. Ka vetëm një mënyrë për ta bërë këtë. Kjo ndodh kur ky person kryen vetëm vepra të këqija dhe asgjë veçse vepra të këqija, ai mund ta ndryshojë jetën e tij. Veçse çfarë e pret atë është shkatërrimi i plotë. Nga një nivel i lartë, ne kemi parë që kur një person vdes, Shpirti Primordial i tij nuk zhduket. Pse nuk zhduket Shpirti Primordial? Në fakt, ne kemi parë se pasi një person vdes, kufoma e tij në morg nuk është veçse një trup prej qelizash njerëzore në dimensionin tonë. Në këtë dimension, përbërjet e qelizave të ndryshme të organeve të brendshme dhe të gjitha qelizat në tërë trupin e njeriut bien, ndërsa në dimensione të tjera trupat e përbërë nga pjesëza më mikroskopike se molekulat, atomet, protonet, etj., nuk kanë vdekur aspak. Ato ekzistojnë në dimensione të tjera dhe akoma jetojnë në dimensionet mikroskopike. Ai që kryen gjithë llojet e veprave të këqija e pret shpërbërja totale e të gjitha qelizave të tij, që Buddhizmi e quan zhdukje e trupit dhe e shpirtit.

Ka dhe një mënyrë tjetër që një person mund ta ndryshojë jetën e tij dhe kjo është mënyra e vetme: Kjo ndodh kur personi merr rrugën e praktikës kultivuese që nga ky moment e tutje. Pse mund të ndryshohet jeta e dikujt kur ai merr rrugën e praktikës kultivuese? Kush mund ta ndryshojë atë? Sapo ky person mendon të marrë rrugën e praktikës kultivuese dhe kur ky mendim shfaqet, ai shkëlqen si ar dhe tund botën e dhjetë drejtimeve. Në pikëpamjen e vet mbi universin, Shkolla e Buddhës ka teorinë e botës me dhjetë drejtime. Në sytë e qënieve të larta, jeta e një njeriu nuk është krijuar për të qenë njeri. Ato mendojnë se jeta e një individi lind në hapësirën e universit dhe mishëron të njejtën cilësi si dhe universi; jeta është mëshirëplotë dhe e përbërë nga materia Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Megjithatë një jetë krijon gjithashtu marëdhënie shoqërore. Gjatë marëdhënieve shoqërore në komunitete, disa jetë korruptohen dhe kështu bien në një nivel më të ulët. Kur ato nuk mund të qëndrojnë më në atë nivel dhe përsëri bëhen më të këqinj, ata do të bien në një nivel akoma më të ulët. Ato vazhdojnë të bien derisa, në fund, arrijnë këtë nivel të njerëzve të zakonshëm.

Në këtë nivel, këta njerëz duhet të zhdukeshin dhe eliminoreshin. Megjithatë nga mirësia mëshiruese e tyre e madhe, Qëniet e Shumëlartësuarë posaçërisht krijuan një dimension pikërisht si kjo e shoqërisë njerëzore. Në këtë dimension të gjithësisë, njeriut i jepet një trup fizik njerëzor shtesë dhe këta palë sy që mund të shohin vetëm gjërat në këtë dimension fizik. Kështu, njeriu humbet në këtë mjergull dhe nuk i lejohet të shikojë të vërtetën e universit, diçka që mund të shikohet në të gjitha dimensionet e tjera. Në këtë mjergull dhe në këto kushte, njeriut i është dhënë kjo lloj mundësie. Për arsye se ai është në mjergull, ekzistenca e tij është dhe shumë e dhimbshme. Me këtë trup, ai bëhet që të vuajë. Nëqoftëse një person dëshiron të kthehet nga ky dimension në origjinën e tij, Shkolla Tao thotë se ai duhet të praktikojë kultivim që të kthehet në origjinë, në veten e vet të vërtetë. Po qe se ai ka dëshirën për praktikë kultivuese, thuhet se i është shfaqur natyra e Buddhës. Kjo zemër konsiderohet më e çmueshmja dhe qëniet e larta do ta ndihmojnë atë. Në kushte kaq të vështira, ky person megjithatë nuk ka humbur dhe dëshiron të kthehet. Si rezultat, qëniet e larta do ta ndihmojnë atë dhe do t'i japin një dorë pa kushte—ata do ta ndihmojnë atë me çdo gjë. Pse mund ta bëjmë ne këtë për një praktikues por jo për një njeri të zakonshëm? Kjo është arsyeja.

Përsa i përket një njeriu të zakonshëm që dëshiron të shërojë sëmundje, ne nuk mund ta ndihmojmë atë me asgjë. Një njeri i zakonshëm mbetet veçse një njeri i zakonshëm. Një njeri i zakonshëm duhet t'i përshtatet kushteve të shoqërisë së zakonshme njerëzore. Shumë njerëz thonë që Buddha i afron shpëtim gjithë qënieve dhe Shkolla Buddhës u mëson shpëtim gjithë qënieve. Më lejoni t'ju them se ju mund të kontrolloni të gjitha shkrimet e shenjta Buddhiste dhe asnjë prej tyre nuk thotë se të trajtosh sëmundje për njerëzit e zakonshëm do të thotë t'u afrosh shpëtim gjithë

qënieve. Janë ata, mjeshtërit e rremë qigong të viteve të fundit që e kanë ngatërruar këtë çështje. Ata mjeshtrit e vërtetë qigong, ata që hapën rrugën në fillim, nuk ju thanë aspak juve të kuroni sëmundjet e të tjerëve. Ata vetëm ju mësuani të praktikoni, shëroni sëmundjet dhe të mbaheni të shëndetshëm vetëm për veten tuaj. Ti je një njeri i zakonshëm. Si mund të shërosh sëmundje ti pas një studimi prej dy ditësh? A nuk është kjo të mashtrosh të tjerët? A nuk inkurajon kjo dëshirën tënde? Kjo do të thotë të shkosh pas famës, interesit personal dhe gjërave mbinatyrale që të mburresh para njerëzve të zakonshëm! Kjo është absolutisht e ndaluar. Prandaj, sa më shumë disa njerëz ndjekin diçka, aq më pak ata arrijnë. Juve nuk ju lejohet ta bëni këtë gjë dhe as nuk ju lejohet të shqetësoni gjendjen e shoqërisë së zakonshme njerëzore sipas dëshirës.

Ekziston një parim i tillë në këtë univers që kur ju dëshironi të ktheheni në origjinë, në veten tuaj të vërtetë, të tjerët do t'ju ndihmojnë. Ata mendojnë që një jetë njerëzore duhet të kthehet nga ku ka ardhur në vend që të qëndrojë me njerëzit e zakonshëm. Nëqoftëse një njeriu i lejohej që të mos kishte asnjë sëmundje dhe të jetonte rehatshëm, ai nuk do të kishte interes të bëhej i pavdekshëm edhe sikur t'a pyesje. Sa mirë do të ishte sikur njeriu të mos vuante nga asnjë sëmundje apo vështirësi dhe të kishte çfarë të donte! Do të ishte me të vërtetë një botë qënieve të pavdekshme. Por ti re tek ky nivel sepse u korruptove, prandaj ti nuk do të jesh kurrë rehat. Njeriu mund të kryejë gjëra të këqija me lehtësi kur është në mjergull dhe Buddhizmi e quan këtë shpagim karmik. Prandaj, kur njerëzit kanë vështirësi apo fatkeqësi, ata paguajnë karmën e tyre sipas shpagimit të karmës që kanë. Buddhizmi thotë se Buddhat gjenden kudo. Nëqoftëse një Buddha lëviz dorën një herë, të gjitha sëmundjet e njerëzimit mund të zhdukeshin; kjo është absolutisht e arritshme. Me kaq shumë Buddha përreth, pse nuk e ka bërë ndonjë këtë? Për shkak se një person ka bërë keq në të kaluarën, që ai vuan këto vështirësi. Po të shërosh sëmundjen e tij, do të ishte njësoj sikur të shkelje parimin e universit, sepse ai kështu mund të kryejë vepra të këqija dhe t'i ketë borxh të tjerëve pa ju dashur të paguajë për to. Kjo nuk lejohej. Kështu, të gjithë ruajnë gjendjen e shoqërisë njerëzore dhe askush nuk don ta shqetësojë atë. Praktika kultivuese është e vetmja mënyrë për të jetuar rehatshëm, pa sëmundje dhe të arrish qëllimin e të qenit me të vërtetë i çliruar! Vetëm duke bërë njerëzit të praktikojnë një mënyrë të vërtetë mund të ketë shpëtim për të gjitha qëniet.

Pse munden disa mjeshtër qigongu të shërojnë sëmundje? Pse flasin ata për shërim sëmundjesh? Disa njerëz mund t'i kenë menduar këto pyetje. Shumica e këtyre mjeshtërve qigong nuk janë nga praktika të vërteta. Lejohej që gjatë periudhës së kultivimit të tij, një mjeshtër qigongu i vërtetë i cili i konsideron të gjitha qëniet e gjalla qënie që vuajnë, ndihmon dikë nga zemërmirësia dhe keqardhja e tij. Megjithatë ai nuk mund të shërojë sëmundje dhe vetëm mund t'i kufizojë apo shtyjë ato përkohësisht. Ti nuk i ke ato tani, por do t'i kesh më vonë sepse ai e shtyn sëmundjen tënde për më vonë. Ai do t'i transferojë ato gjetkë apo në trupin e të afërmit të tu. Ai nuk është i aftë që me të vërtetë të eliminojë plotësisht karmën tënde. Atij nuk i lejohet që ta bëjë këtë për një njeri të zakonshëm por vetëm për një praktikues. Ky është parimi.

Në Shkollën e Buddhës, thënia “shpëtim i të gjitha qënieve” do të thotë që ta nxjerrësh individin nga gjendja më agonuese e njerëzve të zakonshëm dhe ta ngjitetësh atë drejt nivele të larta kështuqë ai nuk do të vuajë më dhe do të çlirohet—ky është kuptimi. A nuk foli Sakyamuni për anën tjetër të nirvanës³? Ky është kuptimi i vërtetë i shpëtimit të gjitha qënieve. Po sikur të jetoje rehat në mes të njerëzve të zakonshëm, të kishe shumë para madje dhe krevatin ta kishe plot me para dhe të mos kishe vuajtje, ti nuk do të ishe i interesuar edhe sikur të të pyesnin që të bëheshe qënie qiellore. Si praktikues, kursi i jetës tënde mund të ndryshohet. Vetëm nëpërmjet praktikës kultivuese mund të ndryshohet jeta jote.

³ nirvana—(nga Sanskrit) lënia e botës njerëzore pa trupin fizik; mënyra e përfundimit të kultivimit në Shkollën e Buddhës Sakyamuni.

Mënyra si funksionon aftësia supernormale e parashikimit të fatit është sikur ke një ekran të vogël televizori në ballë. Disa njerëz e kanë atë në ballë, disa të tjerë e kanë atë afër ballit. Disa e kanë brenda ballit. Disa njerëz mund të shikojnë gjëra me sy mbyllur. Nëqoftëse aftësia është e fortë, personi mund të shikojë me sy hapur. Ndërsa të tjerët nuk mund t'i shikojnë ato sepse ato janë diçka brenda hapësirës së fushës dimensionale të individit. Me fjalë të tjera, pasi zhvillohet kjo aftësi supernormale, duhet të jetë një tjetër që shërben si përçues për të reflektuar skenat nga dimensionet e tjera. Për rrjedhojë, ato mund të shihen nga Syri Qiellor. Dikush mund të shikojë me shumë saktësi të ardhmen dhe të kaluarën e një personi. Pamvarësisht sa mirë parashikojnë fatin fallxhoret, ato nuk mund të tregojnë ngjarjet e vogla dhe detaje të tjera. Ndërsa ky person është i aftë t'i shikojë gjërat shumë qartë duke përfshirë dhe kohën e vitin. Detajet e ndryshimeve janë të gjitha të dukshme meqenëse ajo që ai shikon është reflektim i vërtetë i njerëzve dhe gjërave nga dimensione të ndryshme.

Për aq kohë sa secili nga ju do të praktikojë Falun Dafën, unë do t'ju hap Syrin Qiellor. Por aftësitë supernormale që trajtuam më sipër nuk do të jepen. Me ngritjen e vazhdueshme të nivelit tuaj, aftësia e parashikimit të fatit do të shfaqet natyrshëm. Kjo gjë do të ndodhë në të ardhmen tuaj të praktikës kultivuese dhe ju do të dini çfarë po ndodh kur të zhvillohet kjo aftësi. Prandaj, po jua mësojmë këto parime të Ligjit.

Kalimi Përtej Pesë Elementeve dhe Tre Hapësirave

Çfarë do të thotë “të kalosh përtej Pesë Elementeve dhe Tre Hapësirave?” Kjo është një çështje shumë delikate për të ngritur. Më parë, shumë mjeshtër qigongu kanë folur për këtë çështje por atyre u mbyllej goja nga pyetjet e atyre që nuk besonin në qigong, “Cili nga ju që praktikon qigong i ka tejkaluar Pesë Elementet dhe nuk është brenda Tre Hapësirave?” Disa njerëz nuk janë mjeshtër qigongu dhe e quajnë veten mjeshtër qigongu. Nëqoftëse ata nuk janë të qartë mbi këtë çështje, ata duhet të mos flasin fare. Megjithatë, ata përsëri guxojnë dhe flasin dhe ata që i pyesin i zënë nga fjalët. Kjo i ka sjellë shumë dëm komunitetit të kultivuesve duke shkaktuar kaos të madh. Shumë njerëz e përdorin këtë si shkak për të sulmuar qigongun. “Të kalosh Pesë elementët dhe Tre Hapësirat” është një thënie në komunitetin e kultivuesve. Është e rrënjosur në fe dhe vjen nga feja. Prandaj, ne nuk mund ta shqyrtojmë këtë çështje pa marrë parasysh kushtet historike dhe rrethanat në atë kohë.

Çfarë do të thotë të kalosh Pesë Elementet? Si fizika e lashtë kineze ashtu dhe fizika moderne e quajnë teorinë e Pesë Elementeve të saktë. Është e vërtetë që Pesë Elementet—metali, druri, uji, zjarri dhe toka—përbëjnë çdo gjë në universin tonë. Kështu, ne flasim për teorinë e Pesë Elementeve. Kur themi se një njeri ka kaluar pesë elementet, në gjuhën moderne do të thotë që ai ka arritur përtej botës sonë fizike. Kjo tingëllon krejt e pabesueshme. Mendojeni këtë çështje të gjithë: Një mjeshtër qigongu ka gong. Unë kam marrë pjesë në një eksperiment dhe shumë mjeshtër të tjerë qigongu po ashtu i janë nënshtruar këtij eksperimenti për të matur energjinë e tyre. Elementet materialë në gong mund të kapen nga shumë aparatura të kohës së sotme. Kjo do të thotë se për aq kohë sa ekziston një aparaturë e tillë, elementet e rrezatuara nga një mjeshtër qigongu dhe ekzistenca e gongut të tij mund të kapen. Aparaturat moderne mund të zbulojnë rrezet infra të kuqe, rrezet ultravioletë, valët ultrasonike, valët infrasonike, elektricitetin, forcën magnetike, rrezet gama, atomet dhe neutronet. Një mjeshtër qigongu i ka të gjitha këto substanca dhe ekzistojnë edhe disa substanca të tjera të rrezatuara nga mjeshtërit e qigongut që janë të pakapshme sepse nuk ekziston ndonjë aparat i tillë. Por nëqoftëse ekziston aparatura e përshtatshme, çdo gjë është e kapshme. Substancat e lëshuara nga mjeshtërit e qigongut janë parë se janë të shumëllojshme.

Nën efektin e veçantë të fushës magnetike, një mjeshtër qigongu mund të rrezatojë një kurorë drite të fuqishme dhe shumë të bukur. Sa më e madhe fuqija e gongut të tij, aq më e madhe fusha e energjisë së lëshuar. Edhe një njeri i zakonshëm ka një kurorë drite, por ajo është shumë e vogël dhe e dobët. Në fushën e kërkimit të fizikës së energjisë së lartë, njerëzit besojnë se energjia është e përbërë nga pjesëza si neutronet dhe atomet. Shumë mjeshtër qigongu, duke përfshirë dhe ata të mirënjohurit, i janë nënshtruar testimi. Edhe unë jam testuar dhe radiacioni i kapur i lëshuar nga rrezet gama dhe neutronet termike ishte tetëdhjetë deri njëqind e shtatëdhjetë herë më shumë se materia normale. Në këtë pikë, treguesi i aparatit të testimi arriti limitin ndërsa gjilpëra e tij ndaloi në pikën maksimale. Në fund aparati nuk mund të tregonte sa energji unë kisha. Është thjesht e pabesueshme që një person të ketë neutrone kaq të fuqishme! Si mundet një njeri të çlirojë kaq neutrone të fuqishme? Kjo gjithashtu vërteton se ne, mjeshtër qigong, kemi gong dhe energji. Kjo është verifikuar nga komuniteti shkencor dhe teknologjik.

Që të kalosh Pesë Elementet, duhet një praktikë kultivuese e mendjes dhe e trupit. Nëqoftëse një praktikë nuk është e mendjes dhe e trupit dhe vetëm përmirëson gongun e nivelit të një personi pa kultivuar trupin, ajo nuk merret me këtë çështje dhe nuk kërkon kalim të Pesë Elementeve. Një praktikë kultivuese e mendjes dhe e trupit ruan energji në gjithë qelizat e trupit. Praktikuesi mesatar apo ata që sapo kanë filluar të zhvillojnë gong prodhojnë kokrriza shumë të ashpra energjie me boshllëqe dhe densitet të ulët. Kështu, ajo ka fuqi të vogël. Kur niveli i dikujt bëhet më i lartë, është plotësisht e mundur që densiteti i energjisë së tij të bëhet njëqind herë, njëmijë herë apo njëqind milion herë më i lartë se i molekulave të ujit të zakonshëm. Sa më i lartë niveli i personit, aq më e dendur, aq më e imët dhe aq më e fuqishme energjia e tij. Në këto kushte, energjia ruhet në çdo qelizë të trupit. Kjo energji nuk ruhet vetëm në çdo qelizë të trupit në këtë dimension fizik, por gjithashtu mbush molekulat, atomet, protonet dhe elektronet e të gjithë trupave në dimensione të tjera, derisa arrin qelizat jashtëzakonisht mikroskopike. Me kalimin e kohës, i gjithë trupi i individit do të mbushet me këtë materie energjie të lartë.

Kjo materie energjie të lartë ka inteligjencë dhe është shumë e aftë. Me t'u rritur dhe bërë më e dendur, ajo do të mbushë të gjitha qelizat në trupin e njeriut dhe do të kufizojë qelizat fizike njerëzore, që janë dhe qelizat më të paafta. Me kufizimin e qelizave, ato nuk do të kenë më metabolizëm. Në fund, qelizat fizike njerëzore do të zëvendësohen plotësisht. Sigurisht, është e thjesht për mua ta them këtë. Që të arrish në këtë pikë në kultivim është një proces gradual dhe i ngadaltë. Kur kultivimi juaj ka arritur këtë pikë, materia e energjisë së lartë do të zëvendësojë të gjitha qelizat në trupin tuaj. Mendojeni pak këtë: A është më trupi juaj i përbërë nga Pesë Elementet? Është kjo akoma materie nga ky dimension i jonë? Ajo është tashmë e përbërë nga materie energjie të lartë e mbledhur nga dimensione të tjera. Elementi virtytit është gjithashtu materie që ekziston në një dimension tjetër. Ai nuk është i kufizuar nga fusha e kohës në dimensionin tonë.

Shkenca moderne beson se koha ka fushë. Nëqoftëse diçka nuk është brenda rrezes së kësaj fushe kohe, ajo nuk kushtëzohet nga ajo kohë. Në dimensione të tjera, konceptet e kohë-hapësirës janë të ndryshme nga ato tonat këtu. Si mundet që koha këtu të komandojë materien nga dimensionet e tjera? Nuk është aspak e mundur. Mendojeni pak të gjithë: A nuk do t'i kishit kaluar ju Pesë Elementet atëherë? A do të ishte trupi juaj akoma ai i një njeriu të zakonshëm? Nuk do të ishte aspak por njerëzit e zakonshëm nuk mund ta dallojnë atë. Megjithatë trupi i dikujt do të ishte transformuar deri në atë shkallë, ky nuk është fundi i praktikës kultivuese. Ai duhet të vazhdojë të bëjë ngjitje drejt niveleve më të larta të kultivimit. Kështu, ai duhet të vazhdojë të praktikojë kultivim në mes të njerëzve; kjo nuk mund të bëhet në rast se njerëzit nuk mund ta shohin këtë person.

Çfarë do të ndodhë më vonë? Megjithatë gjatë kursit të kultivimit të gjitha qelizat e këtij personi në nivelin molekular janë zëvendësuar nga materie energjie të lartë, atomet kanë mënyrën e tyre të renditjes dhe kombinimet molekulare dhe konfiguracionet atomike nuk do të ndryshojnë. Kombinimet molekulare të qelizave janë në një gjendje të tillë që ato duken të buta kur i prek.

Kombinimet molekulare të kockave kanë densitet të lartë dhe kockat janë të forta. Densiteti i molekulave të gjakut është shumë i ulët, kështu ai është i lëngët. Një njeri i zakonshëm nuk mund të shohë ndryshim tek ty nga jashtë, sepse molekulat e qelizave të tua ruajnë akoma strukturën dhe kombinimin e tyre origjinal; struktura e tyre nuk ka ndryshuar. Megjithatë energjia brenda ka ndryshuar. Kështu, që nga ky moment ky person nuk do të plakët natyrshëm dhe qelizat e tij nuk do të vdesin. Për pasojë ai do të qëndrojë vazhdimisht i ri. Gjatë kursit të praktikës kultivuese, ai do të duket i ri dhe së fundi do të qëndrojë ashtu.

Sigurisht, kockat e tij përsëri mund të thyhen kur goditet nga një makinë. Ai përsëri do të gjakoset kur pritët me thikë, sepse kombinimet molekulare nuk kanë ndryshuar. Veçse qelizat e tij nuk do të vdesin apo plaken si më parë. Nuk do të ketë metabolizëm. Kjo është ajo që ne e quajmë “të kalosh Pesë Elementet”. Çfarë paragjykimi ka këtu? Kjo mund të shpjegohet edhe nga ana shkencore. Disa njerëz nuk janë në gjendje ta shpjegojnë atë, prandaj bëjnë komente shkarazi. Ndërsa të tjerë do thonin se ne përhapim paragjykime. Meqenëse kjo thënie vjen nga fetë, nuk është një term i krijuar nga qigongu ynë modern.

Çfarë do të thotë të “kalosh Tre Hapësirat”? Unë përmenda dje se çelësi për të rritur gongun qëndron tek kultivimi ynë i karakterit dhe asimilimi në karakteristikën e universit. Karakteristika e universit nuk do të kushtëzojë ty atëhere. Me të ngritur karakterin tuaj, elementi virtut do të transformohet në gong që vazhdimisht rritet lart drejt një niveli më të lartë, duke formuar kështu një kolonë gongu. Lartësia që arrin kolona gongut, tregon dhe lartësinë e nivelit tënd të energjisë. Thuhet kjo thënie: “Ligji i madh është i pakufishëm.” Kultivimi në të varet tërësisht nga zemra juaj. Përsa i përket lartësisë së nivelit që mund të arrijë kultivimi juaj, kjo varet nga durimi dhe aftësia juaj për të duruar vështirësi. Kur ta keni përdorur gjithë substancën tuaj të bardhë, substanca juaj e zezë mund të transformohet në të bardhë duke kaluar vuajtje. Po të mos jetë e mjaftueshme, ju mund të mbani mëkatet e miqve apo të afërmeve tuaj që nuk praktikojnë kultivim dhe ju mund ta rrisni kështu gongun tuaj. Kjo kërkon që dikush të ketë arritur një nivel jashtëzakonisht të lartë në praktikën kultivuese; një praktikues i zakonshëm nuk duhet as të mendojë të shlyejë mëkatet për të afërmit. Me atë sasi të madhe karme, një njeri mesatar nuk do të mundte të arrinte sukses në kultivim. Unë po shpjegoj këtu parimet e niveleve të ndryshme.

Tre Hapësirat që përmendin fetë i referohet nëntë niveleve të Qiellit apo thrindhjetë e tre niveleve të Qiellit—domethënë, Qielli, Toka dhe Ferri përfshijnë të gjitha qëniet brenda Tre Hapësirave. Fetë besojnë se të gjitha qëniet brenda tridhjetë e tre niveleve të Qiellit kalojnë në ciklin e ringjalljes së samsarës. “Samsara” do të thotë që dikush është njeri në këtë jetë dhe mund të jetë kafshë në jetën tjetër. Thuhet në Buddhizëm: “Njeriu duhet ta përdorë mirë kohën e kufizuar në këtë jetë. Po të mos praktikosh kultivim tani, kur do të mundesh ti?” Kjo ndodh sepse kafshët janë të ndaluara të praktikojnë kultivim dhe as nuk lejohen ta dëgjojnë Ligjin. Edhe sikur të praktikojnë kultivim, ato nuk do të arrinin Shkallën e Duhur⁴ në kultivim. Nëqoftëse niveli i gongut të tyre do të rritej, perënditë do t’i vrisnin ato. Ti mund të mos kesh një trup njeriu për qindra vjet; mbase do e kesh për njëmijë vjet. Kur ti merr një trup njeriu, ti nuk ja din vlerën. Po të ringjallesh në një copë shkëmb, ti nuk do të mund të çlirohesh për dhjetë mijë vjet. Nëqoftëse ajo copë shkëmbi nuk copëtohet apo thërmohet, ti nuk do të dalësh dot kurrë. Të marrësh një trup njeriu është kaq e vështirë! Nëqoftëse një person mundet që me të vërtetë të njohë Dafën, ky person është thjesht me shumë fat. Trupi njerëzor është i vështirë për t’u marrë—ky është kuptimi.

Në praktikën kultivuese ne flasim për çështjen e niveleve dhe kjo varet plotësisht nga praktika kultivuese e individit. Nëqoftëse ti dëshiron të kalosh Tre Hapësirat dhe nëqoftëse kolona e gongut tënd është kultivuar në një nivel shumë të lartë, a nuk je ti përtej Tre Hapësirave? Kur Shpirti Primordial i dikujt lë trupin gjatë meditimit ulur, ai mund të arrijë një nivel shumë të lartë menjëherë.

⁴ Shkallë e Duhur—realizimi i Shkallës së Arritjes në Shkollën e Buddhës.

Një praktikues shkruante në rrëfimin e eksperiencës së vet, “Mësues⁵, unë kam arritur shumë nivele të Qiellit dhe kam parë shumë skena.” Unë i thashë të ngjitej akoma. Ai tha, “Nuk e bëj dot. Nuk ma mban të ngjitem më lart dhe nuk mundem të ngjitem më lart.” Pse? Sepse kolona e gongut të tij ishte aq e lartë dhe ai kishte arritur atje duke u ulur në majë të kolonës së tij të gongut. Kjo është Shkalla e Arritjes që përmend Buddhizmi dhe kultivimi i tij kish arritur këtë nivel. Megjithatë për një praktikues nuk është akoma kulmi i Shkallës së Arritjes të tij. Ai vazhdon të ngjitet vazhdimisht lart dhe vazhdimisht rrit veten. Nëqoftëse gongu yt arrin përtej kufirit të Tre Hapësirave, a nuk je ti përtej Tre Hapësirave? Ne kemi zbuluar dhe parë se Tre Hapësirat e përmendura nga fetë janë vetëm brenda hapësirës së nëntë planeteve kryesore. Disa njerëz flasin për dhjetë planete kryesore. Unë do të thosha se nuk është aspak e vërtetë. Unë kam parë se disa nga ata mjeshtrit qigong në të kaluarën kishin kolona gongu shumë të larta që arrinin përtej Kashtës së Kumtrit; ata kishin kaluar përtej Tre Hapësirave. Deri tani kam folur për kalimin e Tre Hapësirave. Është në fakt çështje nivelesh.

Çështja e Dëshirës për të Përfitur

Shumë njerëz vijnë në vendet tona të kultivimit me dëshirën për të përfitur. Disa njerëz duan të arrijnë aftësi supernormale; disa duan të dëgjojnë disa teori, disa duan të shërojnë sëmundjet; disa duan të përfitojnë Falun. Ka nga të gjitha llojet e mentaliteteve. Disa të tjerë thonë: “Dikush nga familja ime nuk është këtu që të dëgjojë leksionin. Po paguaj unë paratë e klasës dhe ju lutem i jepni atij një Falun.” Na janë dashur neve shumë gjenerata, një periudhë kohe jashtëzakonisht e gjatë dhe një numër i jashtëzakonshëm vitesh për ta krijuar këtë Falun. Si mund të bleke ti një Falun me pak *yuan*⁶? Pse mund t’ja u japim ne të gjithë juve pa kushte? Sepse ju dëshironi të bëheni praktikues dhe ky mendim nuk mund të blihet me asnjë shumë parash. Vetëm kur natyra jote e Buddhës ka dalë në pah mund ta bëjmë ne këtë.

Ju jeni kapur fort pas dëshirës për të përfitur. A keni ardhur këtu veçse për këtë? *Fashen*⁷ im në një dimension tjetër din çdo gjë në mëndjen tuaj. Meqenëse konceptet në dy kohë-hapësirat ndryshojnë, në një dimension tjetër formimi i mendimeve të tua shihet si proces jashtëzakonisht i ngadaltë. Ai din çdo gjë madje para se ti ta mendosh atë. Prandaj, ju duhet të braktisni të gjitha mendimet tuaja jo të mira. Shkolla Buddhës beson në marrëdhënie të paracaktuara nga fati. Çdo njeri vjen këtu sepse e ka të paracaktuar nga fati. Nëqoftëse ti e merr këtë Falun, mbase ti supozohesh që ta marrësh atë. Prandaj ju duhet ta vlerësoni atë dhe jo të jepeni pas dëshirës së përfitimit.

Në praktikën kultivuese fetare të së kaluarës, Shkolla Buddhës mësonte Zbrazëtinë. Njeriu nuk duhet të mendojë për asgjë dhe duhet të hyjë në Portën e Zbrazëtisë. Shkolla Tao mësonte Asgjënë, sepse nuk ka asgjë. Njeriu nuk duhet të dëshirojë asgjë dhe as duhet të ndjekë asgjë. Një praktikues beson se ai vetëm duhet të përqendrohet tek praktika, pa i kushtuar vëmendje rritjes së gongut. Në kultivim dhe praktikë njeriu duhet të jetë në një gjendje të çliruar nga qëllimi. Për aq kohë sa përqendroheni në kultivimin e karakterit, ju do të arrini ngjitje në nivele dhe sigurisht do të merrni gjërat që meritoni. Nëqoftëse ju nuk mund të hiqni dorë nga diçka, a nuk është kjo një dëshirë? Ju kemi mësuar këtu një Ligj të një niveli kaq të lartë dhe kërkesa ndaj karakterit tuaj sigurisht është e një standarti të lartë. Prandaj, ju nuk duhet të vini të mësoni Ligjin me dëshirën për të përfitur.

Që të jemi të përgjegjshëm ndaj të gjithëve, ne ju udhëheqim drejt shtegut të drejtë dhe ne duhet t’ju shpjegojmë Ligjin me themel. Kur dikush kërkon Syrin Qiellor, ai do të bllokohet vetë dhe vuloset. Po ashtu, po ju them të gjithëve se të gjitha aftësitë supernormale që zhvillon njeriu në praktikën kultivuese në Ligjin-Në-Botën-Trefishe janë aftësi origjinale të lindura të këtij trupi fizik.

⁵ Mësuese—(quhet dhe Mjeshtër) mënyrë adresimi me respekt ndaj një mësuesi në Kinë.

⁶ *yuan* (ju-en)—njësi monetare kineze (afërsisht = USD\$0.12).

⁷ *Fashen*—“trup ligji”; trup i përbërë prej gongu dhe Ligj.

Sot ne i quajmë ato aftësi mbinatyrale. Ato vetëm kanë afekt në këtë dimensionin tonë dhe mund t'i imponohen vetëm njerëzve të zakonshëm. Pse shkoni pas këtyre lojrave të vogla? Ju kërkoni këtë apo atë, por pasi të arrini përtej Ligjit-Në-Botën-Trefishe ato nuk funksionojnë në dimensione të tjera. Në kohën e kultivimit të Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe, të gjitha këto aftësi supernormale duhet të hiqen dhe futen në një dimension shumë të thellë për t'u ruajtur. Në të ardhmen, ato do të shërbejnë si provë e praktikës tuaj kultivuese dhe ato mund të marrin vetëm këtë pak rol.

Pas arritjes së Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe, personi duhet të fillojë kultivim nga e para. Trupi i tij është trup që ka kaluar Pesë Elementet, siç e thashë pak më parë. Ai është trup Buddha. A nuk duhet të quhet një trup i tillë trup Buddha? Ky trup Buddha duhet të praktikojë kultivim nga e para dhe gjithashtu të zhvillojë nga fillimi aftësitë supernormale. Në vend që të quhen "aftësi supernormale", ato quhen tani "fuqi hyjnore të Ligjit të Buddhës". Ato janë pa masë të fuqishme dhe mund të veprojnë në dimensione të ndryshme, duke pasur shumë rezultat. A ja vlen të kërkosh aftësi supernormale? Përsa i përket atyre që ndjekin aftësitë supernormale, a nuk keni ju në plan t'i përdorni ato të mburreni para njerëzve? Përndryshe, përse i donit ju ato? Ato janë të padukshme dhe të pakapshme. Edhe sikur të ishin për dekorim, njeriu gjen diçka që duket bukur. Është e garantuar se thellë në ndërgjegje ju keni qëllimin që t'i përdorni ato. Ato nuk mund të kërkohen si aftësitë e zakonshme njerëzore. Ato janë diçka plotësisht mbinatyrore dhe ju e keni të ndaluar që t'i tregoni para njerëzve. Vetë mburrja është një dëshirë shumë e fortë dhe një dëshirë shumë e keqe që një praktikues duhet ta çrënjosë. Nëqoftëse ti don të bësh para dhe pasuri me to, apo të arrish qëllimet e tua personale mes njerëzve me anë të tyre, kjo është e ndaluar. Kjo do të thotë të përdorësh gjëra të një niveli të lartë për të shqetësuar dhe dëmtuar shoqërinë e zakonshme njerëzore. Ky mendim është akoma dhe më i keq. Prandaj ato ndalohen të përdoren spontanisht.

Normalisht, aftësitë supernormale janë më të mundura të zhvillohen për dy grupe njerëzish; fëmijët dhe të moshuarit. Veçanërisht, gratë e moshuara zakonisht paraqesin karakter të mirë pa ndonjë dëshirë në mes të njerëzve të zakonshëm. Pasi zhvillohen aftësitë e tyre supernormale, ato mund ta kontrollojnë veten me lehtësi dhe nuk kanë dëshirë të mburren me to. Pse është e vështirë për të rinjtë që të zhvillojnë aftësi supernormale? Veçanërisht, një mashkull i ri më shumë se të tjerët, akoma dëshiron të arrijë disa qëllime në shoqërinë njerëzore! Me të pasur aftësi supernormale, ai do t'i përdorë ato për të arritur qëllimet e tij. Përdorimi i tyre si mjet për të arritur qëllimet e tij është absolutisht i ndaluar, kështu ai nuk do të zhvillojë aftësi supernormale.

Çështja e praktikës kultivuese nuk është lojë fëmijësh dhe as teknikë e njerëzve të zakonshëm—ajo është një çështje shumë serioze. Nëse ju doni të praktikoni kultivim apo jeni i aftë të praktikoni kultivim varet plotësisht nga si e përmirësoni ju karakterin tuaj. Do të ishte e tmerrshme sikur dikush të mund të arrinte aftësitë supernormale duke i përndjekur ato me qëllim. Ju do të shihnit se atij nuk do i bëhej vonë për kultivim apo as që e mendon atë. Ngaqë karakteri i tij është në nivelin e njerëzve të zakonshëm dhe aftësitë supernormale të tij vijnë si pasojë e përndjekjes me qëllim, ai mund të kryente çdo lloj vepre të keqe. Ka plot para në bankë dhe ai do të merrte ca. Ka plot bileta llotarie për shitje në rrugë dhe ai do merrte çmimin e parë. Pse nuk kanë ndodhur këto gjëra? Disa mjeshtër qigongu thonë: "Kur nuk është i virtytshëm, njeriu mund të kryejë gjëra të këqija me lehtësi pasi zhvillon aftësitë supernormale." Unë them se kjo është një thënie e gabuar—nuk është aspak ashtu. Nëqoftëse ti nuk vlerëson virtytin apo nuk kultivon karakterin tënd, ti thjesht nuk do të zhvillosh ndonjë aftësi supernormale. Me karakter të mirë, disa njerëz zhvillojnë aftësi supernormale në nivelet e tyre. Më vonë, ata nuk e kontrollojnë veten dhe bëjnë gjëra që nuk duhet t'i bëjnë. Ekziston gjithashtu kjo situatë. Por me të bërë diçka të keqe, aftësitë e tij supernormale do të dobësohen apo zhduken. Me t'u zhdukur, ato janë humbur përgjithmonë. Për më tepër, e keqja është se ato e bëjnë individin të zhvillojë dëshira.

Një mjeshtër qigongu pretendon se nëqoftëse një person studjon praktikën e tij për tre apo katër ditë, ky person do të jetë i aftë të shërojë sëmundje. Kjo është si reklamë dhe ai duhet të quhet

tregëtar qigongu. Mendojeni pak të gjithë: Duke qenë njeri i zakonshëm, si mundesh ti të shërosh sëmundjen e një njeriu tjetër vetëm duke lëshuar pak nga qi-ja jote? Trupi i një njeriu të zakonshëm po ashtu ka qi brenda, siç ka dhe i joti. Ti sapo ke filluar praktikën dhe vetëm sa të është hapur pika e *laogong*⁸, kështu ti mund të thithësh dhe lëshosh qi. Kur ti shkon e shëron sëmundjet e të tjerëve, ata gjithashtu kanë qi në trupat e tyre. Mbase qi-ja e tyre do të shërojë sëmundjet e tua! Si mundka qi e dikujt të dominojë atë të një personi tjetër? Qi nuk mund të shërojë sëmundje aspak. Po ashtu, kur ti trajton një pacient, ti dhe pacienti formoni një fushë përmes së cilës qi-ja me bakterie e pacientit do të vijë e gjitha në trupin tënd. Ti ke aq sa dhe pacienti yt, megjithëse rrënja ndodhet tek pacienti. Shumë qi me bakterie mund të shkaktojë që edhe ti të sëmuresh. Me të menduar që ti mund të shërosh sëmundje, ti do të fillosh praktikën e marrjes së pacientëve. Ti nuk do të refuzosh kërkesat dhe do të zhvillosh dëshira. Sa kënaqësi është të jesh i aftë të shërosh sëmundjet e të tjerëve! Pse mund të shërohen ato? A e keni menduar ndonjëherë këtë? Mjeshtrit e rremë qigong të gjithë janë të zotëruar nga shpirtra apo kafshë. Në mënyrë që të të bëjnë ty t’i besosh atyre, ata të japin disa nga mesazhet e tyre të cilat do të mbarohen pasi ti të kesh shëruar tre, pesë, tetë apo dhjetë pacientë. Kjo konsumon energji dhe më pas kjo energji nuk do të ekzistojë më. Gongu nuk është yti, kështu ku mund ta marrësh ti atë? Si mjeshtër qigongu ne kemi praktikuar kultivim për dhjetëra vite. Ishte shumë e vështirë të praktikojë kultivim në të kaluarën. Të praktikosh kultivim është shumë e vështirë për dikë që merr një shteg të devijuar apo një rrugë të vogël në vend të një rruge të vërtetë.

Ti mund të shohësh se disa mjeshtër qigongu janë të mirënjohur, por ata kanë praktikuar kultivim për dekada për të zhvilluar atë pak gong. Ti nuk ke praktikuar kurrë qigong. Si mundesh ti të kesh gong pasi merr një klasë qigongu? Si është e mundur kjo? Ty do të të lindë dëshira më pas. Me të zhvilluar dëshirën, ti do të jesh në padurim po të mos shërosh ndonjë sëmundje. Për të shpëtuar emrin tënd, çfarë ke në mendje ndërsa trajton një sëmundje? “Të lutem le ta marr unë sëmundjen që të shërohet pacienti.” Kjo nuk ndodh nga dashamirësia, ngaqë dëshira për famë dhe interes personal nuk janë braktisur aspak. Ky person nuk është në gjendje aspak të zhvillojë këtë dashamirësi. Ai ka frikë se mos humb reputacionin e tij. Ai është gati të marrë sëmundjen vetë në mënyrë që të mos humbë reputacionin. Çfarë dëshirë e fortë për famë! Me t’u shprehur kjo dëshirë, ajo sëmundje do të transferohet në trupin e tij menjëherë—kjo do të ndodhë me të vërtetë. Ai do të shkojë në shtëpi me sëmundje ndërsa pacienti është shëruar. Pasi të ketë trajtuar pacientin, ai do të vuajë në shtëpi. Ai mendon se ka shëruar një sëmundje. Kur të tjerët e quajnë mjeshtër qigongu, ai do të kënaqet dhe gëzohet. A nuk është kjo një dëshirë? Kur ai nuk shëron dot një sëmundje, ai ul kokën dhe turfullon. A nuk shkaktohet kjo nga dëshira e tij për famë dhe përfitim personal? Po ashtu, gjithë qi-ja me bakterie e pacientit do t’i vijë atij në trup. Megjithëse ata mjeshtrit qigong të rremë e kanë mësuar si ta heqë atë nga trupi i tij, po ju them se ai nuk mund ta heqë atë aspak, as dhe një çikë, sepse ai nuk e ka vetë aftësinë të dallojë qi-në e keqe nga qi-ja e mirë. Me kalimin e kohës, trupi i tij do të nxihet i tëri nga brenda dhe ajo është karmë.

Kur ti do të duash të praktikosh kultivim me të vërtetë, do të dalë një problem i madh. Si do t’ja bësh ti? Sa duhet të vuash ti që të transformosh karmën në substancë të bardhë? Është shumë e vështirë. Veçanërisht, sa më e mirë cilësia e lindur e dikujt, aq më e lehtë është të takohet ky problem. Disa njerëz gjithmonë kërkojnë të trajtojnë sëmundje. Po përdoqe diçka me qëllim, një kafshë do ta shohë këtë dhe vjen e të zotëron. Ky është zotërim nga shpirtrat apo kafshët. A nuk do ti të shërosh sëmundje? Do të të ndihmojë ta bësh këtë. Por nuk të ndihmon të shërosh sëmundje pa arsye. Pa humbje nuk ka fitim. Kjo është shumë e rrezikshme dhe ti do përfundosh t’ja sjellësh këtë vetes. Si do e vazhdosh ti praktikën tënde kultivuese? Ajo do të marrë fund.

Disa njerëz me cilësi të lindura të mira i shkëmbejnë cilësitë e mira të lindura të tyre me karmën e të tjerëve. Një person i sëmurë ka plot karmë. Nëqoftëse ti shëron një pacient që ka një

⁸ *laogong*—pikë akupunkturë në qendër të pëllëmbës së dorës.

sëmundje të rëndë, pas trajtimit ti do të ndjehesh shumë keq në shtëpi. Në të kaluarën shumë njerëz ndjeheshin kështu pasi shikonin një pacient: Pacienti është duke u shëruar, kurse ti je shumë sëmurë në shtëpi. Me kalimin e kohës, akoma më shumë karmë kalon tek ty; ti i jep të tjerëve virtyt për karmë. Pa humbje, nuk ka fitim. Megjithëse ajo që merr ti është sëmundje, karma duhet të paguhet me virtyt. Ky univers ka këtë parim që askush nuk do të të ndalojë ty përderisa kjo është ajo që ti kërkon dhe as do të thotë njeri që ti je i mirë. Universi ka një rregull specifik, domethënë, kushdo që ka shumë karmë është njeri i keq. Ti po shpërdoron cilësinë tënde të lindur për karmë. Me shumë karmë, si mund të praktikosh ti kultivim? Cilësia jote e lindur do të shkatërrohet plotësisht nga ky personi tjetër. A nuk është kjo e frikëshme? Sëmundja e atij personi është zhdukur; ai ndjehet mirë tani, kurse ti vuan në shtëpi. Nëqoftëse ti shëron disa pacientë me kancer, ti do duhet të zësh vendin e tyre. A nuk është kjo e rrezikshme? Kështu qëndron e vërteta dhe shumë njerëz nuk e dinë këtë.

Mos u gënjeni nga sa emër kanë disa mjeshtër të rremë qigongu. Një njeri i mirënjohur nuk është e thënë që i din gjërat mirë. E çfarë dinë njerëzit e zakonshëm? Pak të fryhen gjërat dhe ata i besojnë atyre. Mbase ata mund të bëjnë gjëra të tilla tani, por ata nuk dëmtojnë vetëm të tjerët, por edhe veten. Për nja një apo dy vjet ju do shihni çfarë do u ndodhë. Praktika kultivuese nuk mund të sabotohet në këtë mënyrë. Praktika kultivuese mund të shërojë sëmundje, por nuk është që të përdoret për të shëruar sëmundje. Ajo është diçka supernormale dhe jo një teknikë njerëzish të zakonshëm. Që ti ta shkatërrosh atë sipas dëshirës është absolutisht e ndaluar. Në kohën e sotme disa mjeshtër të rremë qigongu kanë sjellë kaos dhe e përdorin qigongun si mënyrë për të siguruar famë dhe pasuri. Ato janë kulte që shtrijnë influencën e tyre të keqe dhe ja kalojnë në numër mjeshtërve të vërtetë të qigongut shumë herë. Disa njerëz të zakonshëm flasin dhe bëjnë gjërat në këtë mënyrë dhe ju i besoni atyre? Ju mund të mendoni se ky është qigongu, por nuk është kështu. Unë po ju them cili është parimi i vërtetë.

Gjatë zhvillimit të marëdhënieve të ndryshme shoqërore në mes të njerëzve, njeriu mund të bëjë keq për fitim personal dhe do i hyjë në borxh të tjerëve. Ai duhet të vuajë që të paguajë borxhet. Ta supozojmë se ti trajton një të sëmurë sipas dëshirës. Si mund të lejohesh ti të shërosh një sëmundje? Buddhat janë kudo. Me kaq shumë prej tyre, pse nuk e bëjnë ata këtë gjë? Sa bukur do të ishte sikur Buddhat ta bënin gjithë njerëzimin të jetonte në rehati të plotë! Pse nuk e bëjnë ata këtë? Njerëzit duhet të paguajnë karmën e tyre dhe askush nuk guxon ta shkelë këtë parim. Gjatë praktikës kultivuese, një praktikues mund të ndihmojë ngandonjëherë një person tjetër nga dashamirësia e vet; megjithatë kjo vetëm do e shtynte sëmundjen e tij. Po nuk vuajte tani, ti do të vuash më vonë. Gjithashtu, ai mund ta transformojë atë në mënyrë që ti të humbësh para apo të kesh një vështirësi në vend të sëmundjes. Eliminimi i vërtetë i gjithë karmës së një personi mund të bëhet vetëm për praktikuesit dhe jo për njerëzit e zakonshëm. Unë nuk po ju mësoj vetëm parimet e praktikës sime këtu. Unë po trajtoj parimet e gjithë universit dhe po diskutoj faktet aktuale në komunitetin e kultivuesve.

Këtu ne nuk ju mësojmë si të shëroni sëmundje. Ne po ju udhëheqim drejt Shtegut të Madh, rrugës së drejtë dhe ne po ju ngrejmë juve lart. Kështu, në leksionet e mia unë gjithmonë do të them se praktikuesit e Falun Dafës nuk lejohen të shërojnë sëmundje. Nëqoftëse ju trajtoni sëmundje, ju nuk jeni praktikues të Falun Dafës. Meqenëse ne po ju udhëheqim në rrugën e drejtë, gjatë praktikës kultivuese të Ligjit-Në-Botën-Trefishe trupi juaj do të pastrohet vazhdimisht derisa të transformohet plotësisht në materie me energji të lartë. Si mund të praktikosh kultivim nëqoftëse ti akoma mbledh ato gjëra të zeza në trupin tënd? Ato janë karma! Ti nuk do të jesh në gjendje të praktikosh kultivim aspak. Me kaq shumë karmë—ti nuk do jesh i zoti ta durosh atë. Po vuajte shumë, ti nuk do mundesh të praktikosh kultivim. Kjo është arsyeja. Unë e kam bërë publik këtë Ligj të Lartë dhe ju akoma mund të mos e dini çfarë ju kam mësuar. Përderisa ky Ligj i Lartë mund të bëhet publik, ka mënyra për ta mbrojtur atë. Nëqoftëse ti trajton sëmundjet e të tjerëve, Fashen im do t'ju marrë mbrapsht çdo gjë që ju është dhënë në trup për të kultivuar. Ne nuk mund t'ju lejojmë të shkatërrojmë diçka kaq të

vyer sipas dëshirës për famë e interes personal. Po nuk ndoqët kërkesat e Ligjit, ju nuk jeni praktikues i Falun Dafës. Me që ti don të jesh një njeri i zakonshëm, trupi yt do të kthehet në nivelin e një njeriu të zakonshëm dhe gjërat e këqija do t'ju kthehen.

Pas leksionit të djeshëm, shumë nga ju ndjenë se i gjithë trupi juaj ishte i lehtë. Megjithatë, ata pak njerëz me sëmundje të rënda u ndjenë keq dje. Pasi unë hoqa gjërat e këqija nga trupi juaj dje, shumica juaj ndjeu se i gjithë trupi ishte i lehtë dhe ndjeheshin shumë mirë. Megjithatë, universi ynë ka këtë parim “pa humbje nuk ka fitim”. Ne nuk mund ta heqim të gjithën për ju. Është absolutisht e ndaluar që ju të mos duroni pak vuajtje. Domethënë, ne kemi hequr shkaqet themelore të sëmundjeve tuaja dhe shëndetit tuaj të dobët. Por ju akoma keni një fushë sëmundjeje. Një person, Syri Qiellor i të cilit është hapur në nivel shumë të ulët, mund të shikojë në trupin tuaj grumbullime qi-je të zezë dhe qi bakteriale të errët e cila është gjithashtu një grumbull qi-je e zezë me densitet të lartë. Po të shpërndahet, ajo do të përhapet në gjithë trupin tuaj.

Që sot e tutje, disa njerëz do të ndjejnë të dridhura në tërë trupin sikur vuajnë nga një e ftohur e keqe dhe kockat gjithashtu mund t'i dhëmbin. Shumica juaj do të ndjehen keq diku. Këmbët mund t'ju dhëmbin apo mund t'ju merren mendtë. Pjesa e sëmurë e trupit që ju menduat se ishte shëruar nga ushtrimet e qigongut apo nga një mjeshtër qigongu, do të ndjehet përsëri sëmurë. Kjo ndodh për shkak se ai mjeshtër qigongu nuk ta shëroi sëmundjen—ai vetëm e shtyu atë. Ajo ishte akoma aty dhe do të kthehej më vonë në mos tani. Ne duhet ta çrrënjosim dhe ta eliminojmë plotësisht atë që nga rrënjët. Me këtë, ju mund të ndjeni se ju është kthyer sëmundja. Kjo ndodh me qëllim që të heqim karmën tuaj nga rrënjët. Kështu, ju do të keni reaksione. Disa njerëz mund të kenë reaksione fizike diku. Disa mund të ndjehen keq në një mënyrë apo tjetër sepse lloje të ndryshme shqetësimi do të shfaqen. Këto janë të gjitha normale. Po ju them të gjithëve se pamvaresisht sa keq që ndjeheni, ju duhet të vazhdoni të vini në klasë. Sapo të futeni në klasë, të gjitha simptomat tuaja do të zhduken dhe nuk do të ketë asnjë rrezik. Dua të theksoj një pikë për të gjithë: Pamvarësisht sa vuani nga “sëmundja”, unë shpresoj që të vazhdoni të vini sepse është e vështirë të marrësh Ligjin. Kur të ndjeheni shumë keq, kjo tregon se gjërat shpejt do të kthejnë pasi kanë arritur pikën kulminante. I gjithë trupi juaj do të pastrohet dhe duhet të pastrohet. Shkaku i sëmundjes suaj është hequr dhe ajo që mbetet është vetëm ajo pak qi e zezë që do të dalë vetë që t'ju bëjë juve të vuani pak dhe të keni pak dhimbje. Është e ndaluar që ju të mos vuani as dhe kaq pak.

Në shoqërinë njerëzore, ju konkuron me të tjerët për pak famë dhe fitim personal. Ju nuk fleni apo hani mirë dhe trupi juaj është në formë shumë të keqe. Kur trupi juaj shihet nga një dimension tjetër, kockat janë të gjitha të zeza. Me këtë trup, është e pamundur që ju të mos keni asnjë reaksion kur të pastroheni menjëherë. Kështu, ju do të keni reaksione. Disa njerëz do të kenë të vjella dhe diarre. Shumë praktikues nga vende të ndryshme i kanë përmendur këto shfaqje më parë në raportet e eksperiencave të tyre, “Mësues, pas klasës kërkoja banjo gjithë rrugës për në shtëpi.” Kjo ndodh për shkak se të gjitha organet e tua të brendshme duhet të pastrohen. Pak individë mund të bien në gjumë dhe zgjohen kur të mbarojë leksioni. Pse ndodh kjo? Për arsye se truri i tyre ka sëmundje që duhet të trajtohen. Personi nuk do të ishte në gjendje ta duronte kur i punohet në tru. Prandaj, ai duhet të futet në gjendje anestezie apo të bëhet i pandërgjegjshëm. Megjithatë disa njerëz nuk kanë problem të më dëgjojnë mua. Megjithëse janë në gjumë të thellë, ata dëgjojnë çdo gjë pa humbur asnjë fjalë. Ata do të bëhen energjikë më pas dhe nuk do të kenë nevojë për gjumë edhe sikur të shkojnë dy ditë pa gjumë. Ka sëmundje të ndryshme që duhen rregulluar. I tërë trupi juaj duhet të pastrohet.

Nëqoftëse ju jeni praktikues të vërtetë të Falun Dafës dhe kur ju hiqni dorë nga veset tuaja, të gjithë ju do të keni reaksione që sot e tutje. Ata që nuk mund të heqin dorë nga veset mund të pretendojnë se i kanë hequr ato, por në fakt ata nuk kanë hequr dorë prej tyre. Është në fakt shumë e vështirë për t'u arritur. Ka nga ata njerëz që e kuptojnë më vonë përmbajtjen e leksioneve të mia. Ata fillojnë të heqin dorë nga veset e tyre dhe trupat e tyre fillojnë të pastrohen. Ndërsa trupat e të tjerëve janë të lehtë, këta njerëz sapo fillojnë të shërojnë sëmundjet e tyre dhe ndjehen mirë. Në çdo klasë ka

nga ata njerëz që mbeten prapa, me cilësi të kuptuari shpirtëror të varfër. Prandaj, çdo gjë është normale pamvarësisht çfarë do të hasni. Kjo situatë ndodh gjithmonë sa herë që unë mbaj klasa në vende të ndryshme. Disa njerëz ishin aq keq sa nuk lëviznin dot nga vendet e tyre, duke pritur që unë të zbres poshtë nga podiumi t'i trajtoj ata. Unë nuk do e bëj atë. Nëqoftëse ju nuk kaloni as dhe këtë test, si mundet ju të praktikoni kultivim në të ardhmen kur ju do të takoni shumë probleme më të mëdha? A nuk mundet ju ta mposhtni këtë shqetësim kaq të vogël? Të gjithë mund ta arrijnë këtë. Prandaj, askush të mos vijë tek unë për të shëruar sëmundje dhe as që do shëroj unë sëmundje. Sapo ti e hedh fjalën aty, unë nuk dua të dëgjoj.

Njerëzit janë shumë të vështirë për t'u shpëtuar. Ka gjithmonë rreth pesë apo dhjetë përqind të njerëzve në çdo klasë që nuk mund të arrijnë të tjerët. Është e pamundur që të gjithë të arrijnë Taon. Edhe për ata që mund ta vazhdojnë praktikën e tyre kultivuese, mbetet të shikohet nëse ju do të keni sukses dhe nëqoftëse ju jeni të vendosur të praktikoni kultivim. Është e pamundur që të gjithë të bëhen Buddha. Praktikuesit e vërtetë të Dafës do të kenë të njejtat eksperiencë duke lexuar këtë libër dhe ata po ashtu do të jenë të aftë të marrin çfarëdo që ata të meritojnë.

LEKSIONI I TRETË

Unë i Trajtoj Gjithë Praktikuesit si Dishepujt e Mi

A e dini të gjithë çfarë po bëj unë? Unë i trajtoj të gjithë praktikuesit, duke përfshirë dhe ata që me të vërtetë mund të praktikojnë kultivim nëpërmjet studimit vetjak, si dishepujt e mi. Në mësimin e kultivimit në nivele të larta, nuk do të funksiononte po të mos ju trajtoja në këtë mënyrë. Përndryshe, do të ishte njësoj sikur të mos isha i përgjegjshëm e do të shkaktoja probleme. Ne ju kemi dhënë juve kaq shumë gjëra dhe ju kemi lejuar të dini kaq shumë parime që nuk duhet të dihen nga njerëzit e zakonshëm. Përveç këtyre, unë ju kam mësuar juve këtë Ligj të Lartë. Përveç disa çështjeve të tjera në lidhje me këtë, trupi juaj është pastruar. Kështu, është thjeshtë e papranueshme për mua që të mos ju tratoj si dishepuj. T'u zbulosh me papërgjegjësi kaq shumë sekrete qiellore njerëzve të zakonshëm nuk lejohet. Por duhet thënë diçka. Tani, kohët kanë ndryshuar. Ne nuk praktikojmë ritin e përkuljes me nderim. Ky lloj formaliteti nuk na shërben dhe duket si fe. Ne nuk e praktikojmë atë. Për çfarë vlen e përkulura dhe adhurimi jot ndaj Mësuesit nëqoftëse sapo ti del nga dera, ti përsëri vazhdon të sillesh si përherë dhe bën çfarë don, duke konkuruar dhe luftuar për famë e interesin tënd në mes të njerëzve të zakonshëm? Ti gjithashtu mund të dëmtosh edhe emrin e Falun Dafës nën flamurin tim!

Praktika kultivuese e vërtetë varet plotësisht nga zemra juaj. Për aq kohë sa ju praktikoni kultivim dhe jeni këmbëngulës dhe të vendosur në kultivimin e praktikës, ne do t'ju trajtojmë si dishepuj. Është e pamundur për mua që të mos ju trajtoj në këtë mënyrë. Mëgjithatë ka disa njerëz që nuk e konsiderojnë veten me të vërtetë si kultivues dhe nuk e vazhdojnë praktikën kultivuese. Për aq kohë sa do e vazhdoni atë, ne do t'ju trajtojmë si dishepuj.

A mund të konsiderohesh si dishepull i Falun Dafës nëqoftëse ti vetëm praktikon këto pak ushtrime çdo ditë? Nuk është ashtu. Kjo ndodh sepse praktika e vërtetë kultivuese duhet të ndjekë kërkesat e standarteve të karakterit që ne kemi vendosur dhe ju duhet që me të vërtetë të përmirësoni karakterin tuaj—vetëm atëherë është praktikë e vërtetë kultivuese. Nëqoftëse ti vetëm praktikon ushtrimet pa përmirësuar karakterin dhe pa energjinë e fuqishme që forcon çdo gjë, nuk mund të quhet praktikë kultivuese; dhe as mund t'ju trajtojmë ne juve si dishepuj të Falun Dafës. Nëqoftëse ju vazhdoni kështu pa ndjekur kërkesat e Falun Dafës sonë dhe silleni si zakonisht në mes të njerëzve të zakonshëm pa e përmirësuar karakterin tuaj, ju përsëri mund të keni probleme megjithëse praktikoni ushtrimet. Ju madje mund të pretendoni se është praktika e Falun Dafës që ju bën të devijoni. Edhe kjo mund të ndodhë. Prandaj, ju duhet që me të vërtetë të ndiqni kërkesat tona të karakterit—vetëm atëherë jeni ju një praktikues i vërtetë. Unë ja u kam bërë të qartë të gjithëve. Kështu, ju lutem mos vini tek unë nën formalitetin e adhurimit të mjeshtrit. Për aq kohë sa t'ju me te vërtetë praktikoni kultivim, unë do ju trajtoj në këtë mënyrë. Fashen e mia janë aq të shumtë sa ata janë të panumërueshëm. Përveç nxënësve që janë këtu, pamvarësisht nga sa shumë njerëz të tjerë të jenë, unë përsëri mund të kujdesem për ta.

Qigongu i Shkollës së Buddhës dhe Buddhizmi

Qigongu i Shkollës së Buddhës nuk është feja Buddhiste. Unë duhet t'ja u bëj të qartë këtë pikë të gjithëve. Në fakt, as qigongu i Shkollës Tao nuk është feja Taoiste. Disa prej jush i ngatërrojnë gjithmonë këto gjëra. Disa individë janë murgj nga tempuj dhe disa janë besimtarë Buddhistë. Ata mendojnë se dinë pak më shumë për fenë Buddhiste, kështu ata predikojnë me entuziazëm Buddhizmin tek praktikuesit tanë. Më lejoni t'ju them se ju nuk duhet ta bëni një gjë të tillë sepse ato janë diçka nga një shkollë tjetër kultivimi. Feja ka forma fetare. Këtu ne po mësojmë pjesën e

kultivimit të shkollës sonë. Përveç atyre murgjëve dhe murgeshave që janë dishepujt të Falun Dafës, asnjë tjetër nuk duhet të mbajë forma fetare. Prandaj, shkolla jonë nuk është Buddhismi në Periudhën e Fund-Dharmës.

Dharma në Buddhizëm është veçse një pjesë e vogël e Ligjit të Buddhës. Ekzistojnë shumë lloje të tjera Ligjesh të niveleve të larta. Nivele të ndryshme kanë gjithashtu Ligje të ndryshme. Sakyamuni pat thënë se janë tetëdhjetë e katër mijë mënyra kultivimi. Feja Budhiste përfshin vetëm pak mënyra kultivimi si Sektin Tiantai, Sektin Huayan, Sektin Zen, Tokën e Pashkelur, Tantrizmin, etj. Këto nuk përbëjnë veçse një numër të vogël! Prandaj, Buddhizmi nuk mund ta përfaqësojë të gjithë Ligjin e Buddhës dhe është vetëm një pjesë e vogël e këtij Ligji. Falun Dafa jonë është gjithashtu një nga tetëdhjetë e katër mijë mënyrat e kultivimit në Shkollën e Buddhës dhe nuk ka të bëjë aspak me Buddhizmin origjinal apo Buddhizmin në Periudhën e Fund-Dharmës dhe as që ka lidhje me fetë moderne.

Buddhizmi u themelua nga Sakyamuni në Indinë e lashtë 2500 vjet më parë. Kur Sakyamuni arriti momentin e Çbllokimit të Gongut dhe u lartësua shpirtërisht, ai rikujtoi atë çfarë kish kultivuar më parë dhe e bëri atë publike për të shpëtuar njerëzit. Pamvarësisht nga sa mijra volume shkrimesh të shenjta kanë dalë nga ajo shkollë, në fakt ajo konsiston në tre fjalë. Karakteristikat e kësaj shkolle janë: “kanun, samadhi¹, mençuri”. Kanunet janë për heqjen dorë nga të gjitha dëshirat e njeriut të zakonshëm dhe ato të detyrojnë të braktisësh ndjekjen e interesit personal duke të shkëputur nga çdo gjë e botës materiale e kështu me radhë. Në këtë mënyrë, mendja e dikujt do jetë bosh pa asnjë mendim dhe kështu mund të bëhet e qetë. Ato plotësojnë njera tjetrën. Duke qënë i aftë të arrijë qetësinë mendore, ai mund të qendrojë në meditim për të kultivuar dhe të mbështetet në meditimin në kllapi për të përparuar në kultivim. Kështu kjo është pjesa e vërtetë e praktikës kultivuese në këtë shkollë. Nuk ka ushtrime dhe as që ndryshon *benti*²-in e njeriut. Personi vetëm praktikon atë gong që përcakton lartësinë e nivelit të tij. Prandaj, ai vetëm kultivon karakterin e tij. Ai nuk kultivon trupin e vet, kështu ai nuk kërkon transformim të gongut. Ndërkaq nëpërmjet meditimit ai forcon aftësinë e vet për të qëndruar në gjendje meditimi në kllapi dhe qëndron në meditim për të vuajtur dhe eliminuar karmën. “Mençuri” i referohet asaj që njeriu lartësohet shpirtërisht me arrin mençuri të madhe. Ai mund të shikojë të vërtetën e universit si dhe të vërtetën e dimensioneve të ndryshme në univers. Të gjitha fuqitë e tij hyjnore do të shfaqen. Arritja e zgjimit të mençurisë dhe lartësimit shpirtëror quhet gjithashtu dhe Çbllokim i Gongut.

Kur Sakyamuni themeloi këtë mënyrë kultivimi, ekzistonin tetë fe mbizotëruese në Indi në atë kohë. Ekzistonte një fe me rrënjë të thella e quajtur Brahmanizëm. Gjatë gjithë jetës së tij, Sakyamuni luftoi në parim me fetë e tjera. Meqenëse ajo që Sakyamuni mësoi ishte një mënyrë e drejtë, Dharma Budhiste që mësoi ai u bë gjithnjë e më popullore gjatë mësimdhënies së tij ndërsa fetë e tjera u dobësuan gjithnjë e më shumë. Edhe Brahmanizmi i ngulitur thellë arriti në buzë të zhdukjes. Megjithatë, pas nirvanës së Sakyamunit, fetë e tjera, sidomos Brahmanizmi, rifituan popullaritet. Por çfarë situatë u krijua në Buddhizëm? Disa murgj arritën stadin e Çbllokimit të Gongut dhe arritën lartësimin shpirtëror në nivele të ndryshme, por nivelet e tyre të lartësimit shpirtëror ishin mjaft të ulta. Sakyamuni arriti nivelin e Tathagatës por shumë nga murgjit nuk arritën atë nivel.

Ligji i Buddhës ka manifestime të ndryshme në nivele të ndryshme. Megjithatë, sa më i lartë niveli aq më afër së vërtetës. Sa më i ulët niveli, aq më larg së vërtetës. Këta murgj arritën stadin e Çbllokimit të Gongut dhe u lartësuan shpirtërisht në nivele të ulta. Që të interpretonin atë çfarë kish thënë Sakyamuni, ata përdorën manifestimet e universit që ata shihnin në nivelet e tyre dhe situatat dhe parimet që ata kuptonin. Kështu disa murgj e interpretuan Dharmën e Sakyamunit në një mënyrë e disa në një tjetër. Në vend që të përdornin fjalët origjinale të Sakyamunit, disa murgj predikuan edhe ato që ata kuptonin si fjalë të Sakyamunit; kjo e shtrembëroi Dharmën Budhiste aq sa nuk

¹ samadhi—në Buddhizëm do të thotë meditim në pavetëdije, në kllapi.

² *benti*—trupi fizik i njeriut dhe trupat e tij në dimensionet e tjera.

njihej më dhe nuk ish më Dharma e mësuar nga Sakyamuni. Së fundi, kjo e çoi Dharmën Buddhiste drejt zhdukjes në Indi. Ky është një mësim serioz nga historia. Kështu më vonë, India nuk pati më Buddhizëm. Para zhdukjes së tij, Buddhizmi kaloi në shumë reforma. Për pasojë ai përfshiu diçka nga Brahmanizmi dhe u kthye në fenë e sotme indiane të quajtur Hinduizëm. Nuk i falet më ndonjë Buddha. I falet diçkaje tjetër dhe nuk beson më tek Sakyamuni. Kjo është situata tani.

Gjatë zhvillimit të vet, Buddhizmi kaloi disa reforma relativisht të mëdha. Njëra ndodhi pak pasi Sakyamuni ndërroi jetë. Disa njerëz themeluan Mahajanën³ me bazë parimet e nivelit të lartë që mësoi Sakyamuni. Ata besonin se Dharma që Sakyamuni mësoi publikisht kishte për synim vetshpëtimin e njerëzve të zakonshëm dhe arritjen e shkallës së Arhatit. Kjo Dharmë nuk i afronte shpëtim të gjitha qënieve dhe kështu u quajt Hinayana⁴. Murgjit në Azinë Juglindore vazhdojnë të ndjekin mënyrën origjinale të kultivimit të kohës së Sakyamunit. Në Kinë, ne e quajmë atë Buddhizmi i “Portës së Vogël”. Sigurisht, ata vetë nuk e konsiderojnë atë ashtu. Ata besojnë se kanë trashëguar traditën origjinale të Sakyamunit. Është me të vërtetë kështu sepse ata kanë trashëguar mënyrën e kultivimit të kohës së Sakyamunit.

Pasi kjo Mahayanë e reformuar u fut në Kinë, ajo hodhi rrënjë në vendin tonë dhe u bë Buddhizmi i kohës së sotme që mësohet në Kinë. Aktualisht, ajo ka marrë një formë plotësisht të ndryshme nga Buddhizmi i kohës së Sakyamunit. Çdo gjë ka ndryshuar, nga veshja deri tek arritja e lartësimit shpirtëror dhe gjithë kursi i praktikës kultivuese. Në Buddhizmin origjinal, njerëzit i faleshin vetëm Sakyamunit si themelues. Megjithatë tani Buddhizmi ka shumë Buddha dhe Bodhisattva. Gjithashtu, besimi i kushtohet shumë Buddhëve. Njerëzit i falen shumë Tathagatave dhe Buddhizmi është bërë një fe që i falet shumë Buddhëve, duke përfshirë Buddhën Amitabha, Bhaishajyaguru, Buddha Vairochana, etj. Ka gjithashtu dhe shumë Bodhisattva të mëdha. Në këtë mënyrë i gjithë Buddhizmi është bërë plotësisht i ndryshëm nga ajo që themeloi Sakyamuni në kohën e tij.

Gjatë kësaj periudhe kohe, ndodhi një reformë tjetër kur Bodhisattva Nagarjuna përhapi një praktikë kultivuese të fshehtë e cila erdhi nga India dhe u fut në Kinë nëpërmjet Afganistanit dhe më vonë nga provinca e Xinjiang. Kjo ndodhi në Dinastinë Tang⁵, prandaj u quajt Tantrizmi Tang. Për shkak të influencës së Konfucionizmit, vlerat morale të Kinës ishin në përgjithësi të ndryshme nga ato të nacionaliteteve të tjera. Kjo praktikë kultivuese përmbante kultivim të dyfishtë të burrit dhe gruas dhe shoqëria nuk mund ta pranonte atë në atë kohë. Kështu u zhduk kur Buddhizmi u shtyp gjatë kohës së Huichang në Dinastinë Tang dhe për rrjedhojë Tantrizmi Tang u zhduk nga Kina. Tani ekziston një Tantrizëm Lindor në Japoni që shkoi nga Kina në atë kohë; megjithatë, ai nuk ka *guanding*⁶. Sipas Tantrizmit, kur dikush studjon Tantrizëm pa *guanding*, ai konsiderohet njësoj sikur ta ketë vjedhur Dharmën dhe nuk konsiderohet se e ka mësuar atë. Një mënyrë tjetër kultivimi e futur në Tibet nga India dhe Nepali, u quajt “Tantrizëm Tibetan” dhe është përcjellë deri në kohën tonë. Në përgjithësi kjo është situata në Buddhizëm. Unë sapo përmbloodha kështu shumë shkurtimisht situatën e tij të zhvillimit dhe të evoluimit. Gjatë gjithë kursit të zhvillimit të Buddhizmit, u shfaqën disa praktika si ajo e sektit Zen e themeluar nga Boddhidharma, sekti i Tokës së Pashkelur dhe sekti Huayan. Ato u themeluan të gjitha mbi të kuptuarit e asaj që tha Sakyamuni në atë kohë. Të gjitha këto i përkasin Buddhizmit të reformuar. Ekzistojnë mbi dhjetë mënyra të tilla kultivimi në Buddhizëm dhe të gjitha kanë marrë formën e fesë. Prandaj, ato të gjitha i përkasin Buddhizmit.

Përsa i përket feve të themeluara në këtë shekull dhe jo vetëm në këtë shekull por edhe shumë fe të reja të themeluara në vende të ndryshme të botës në shekujt e fundit, shumica e tyre janë të rreme. Qëniet e Shumëlartësuara kanë të gjithë parajsat e tyre ku ata i shpëtojnë njerëzit. Buddhat Tathagata si Sakyamuni, Buddha Amitabha dhe Buddha Vairochana, secili ka parajsën e vet për të

³ Mahajana—“Buddhizmi i Portës Madhe.”

⁴ Hinajana—“Buddhizmi i Portës së Vogël.”

⁵ Dinastia Tang—një nga periudhat më të zhvilluara në historinë kineze (618 e.r. - 907 e.r.).

⁶ *guanding*—hedhje energjie mbi majën e kokës së personit; rit i fillimit të praktikës; tip bapizimi në Buddhizëm.

shpëtuar njerëzit. Në Kashtën tonë të Kumtrit ekzistojnë mbi njëqind parajsa të tilla. Falun Dafa jonë ka gjithashtu Parajsën Falun.

Përsa i përket shpëtimit, ku mund t'i çojnë këto praktika të rreme pasuesit e tyre? Ata nuk mund të shpëtojnë njerëz, sepse ajo që ata predikojnë nuk është Ligj. Sigurisht, disa njerëz, kur ata themeluan fetë në fillim, nuk kishin për qëllim të bëheshin djajt që sabotojnë fetë tradicionale. Ata arritën shkallën e Çbllokimit të Gongut dhe arritën lartësimin shpirtëror në nivele të ndryshme. Ata panë disa parime, por ata ishin larg nga Qëniet e Shumëlartësuar të cilët mund të shpëtojnë njerëz. Ata ishin në nivele shumë të ulta dhe zbuluan disa parime. Ata kuptuan se disa gjëra tek njerëzit ishin të gabuara dhe ata gjithashtu i tregonin njerëzve si të kryenin vepra të mira. Në fillim, ata nuk ishin kundra feve të tjera. Por njerëzit sigurisht do të fillonin të besonin tek ata, duke menduar se ajo që ata thonin ishte e mençur. Kështu njerëzit i besuan këtyre individëve gjithnjë e më shumë. Për pasojë, njerëzit ju dedikuan atyre në vend të feve. Me të zhvilluar dëshirën për famë dhe interes personal, ata do t'i kërkonin njerëzve që t'i nderonin ata me tituj. Pas kësaj ata themeluan fetë e reja. Po ju them se të gjitha këto janë fe të këqija. Edhe sikur të mos dëmtonin njerëz, ato prap se prap janë praktika të këqija sepse ndërhyjnë me besimin e njerëzve në fetë tradicionale. Fetë tradicionale mund të shpëtojnë njerëz, kurse ato nuk mundën ta bëjnë këtë. Me kalimin e kohës, ata kryen vepra të këqija si pa të keq. Kohët e fundit, shumë nga këto fe janë futur edhe në Kinë. I ashtuquajtur i sekti Guanyin⁷ është njeri prej tyre, prandaj ruajuni. Thuhet se ekzistojnë mbi dy mijë praktika në një vend të Azisë Lindore. Të gjitha llojet e besimeve ekzistojnë në vendet e Azisë Juglindore dhe në vende të tjera perëndimore. Një vend haptazi beson në një praktikë që i falet djallit. Të gjithë këta janë djajt që kanë dalë në Periudhën e Fund-Dharmës. Periudha e Fund-Dharmës nuk i përket vetëm Buddhizmit, por gjithashtu korrumpimit të shumë dimensioneve nën një dimension shumë të lartë. “Fund-Dharmë” nuk i referohet vetëm Buddhizmit, por do të thotë gjithashtu se në shoqërinë njerëzore nuk ekziston më ndonjë detyrim shpirtëror që ruan moralin.

Praktikim i një Mënyre të Vetme Kultivimi

Ne ju mësojmë se një person duhet të praktikojë vetëm një mënyrë kultivimi. Pamvarësisht si praktikoni kultivim, ju duhet të mos e ngatërroni kultivimin tuaj duke shtuar gjëra të tjera. Disa besimtarë Buddhistë praktikojnë Buddhizmin dhe Falun Dafën tonë. Po ju them se në fund ju nuk do të fitoni asgjë sepse askush nuk do t'ju japë gjë. Meqenëse jemi të gjithë të Shkollës së Buddhës, ekziston çështja e karakterit dhe në të njejtën kohë çështja e specializimit vetëm në një praktikë. Ju keni vetëm një trup. Gongun e cilës shkolle do të zhvillojë trupi i juaj? Si mund të transformohet ai? Ku doni të shkoni ju? Ju do të shkoni kudo ku t'ju çojë mënyra juaj e kultivimit. Nëqoftëse ndiqni kultivimin në Buddhizmin e Tokës së Pashkelur, ju do të shkoni tek Parajsa e Lumturisë Absolute të Buddhës Amitabha. Po ndoqët Buddhën Bhaishajyaguru në kultivim, ju do të shkoni në Parajsën e Xhamtë. Kjo thuhet në fetë dhe quhet gjithashtu “jo kultivimim i dytë”.

Praktika që po diskutojmë këtu i referohet në të vërtetë tërë procesit të transformimit të energjisë dhe kjo ndjek shkollën tuaj të praktikës kultivuese. Atëhere ku do të thojë ti se don të shkosh? Po vutë këmbën në dy varka në të njejtën kohë, ju nuk do të merrni asgjë. Jo vetëm praktikat qigong nuk duhet të përzihen me praktikat Buddhiste në tempuj, por nuk duhet të ketë fare përzjerje ndërmjet praktikave të ndryshme kultivuese, praktikave të ndryshme qigong, apo fetë e ndryshme. Në kultivim, edhe brenda për brenda së njejtës fe, nëndarjet e ndryshme nuk mund të përzjehen. Ju duhet të zgjidhni vetëm një mënyrë kultivimi. Nëqoftëse kultivoni Buddhizmin e Tokës së Pashkelur, ju duhet të kultivoni vetëm Buddhizmin e Tokës së Pashkelur. Nëqoftëse ju kultivoni Tantrizëm, ju

⁷ Sekti Guanyin—një kult i quajtur sipas Bodhisattva Avalokitesvarës, “Perëndeshës së Mëshirës”.

duhet të kultivoni vetëm Tantrizëm. Nëqoftëse ju kultivoni sektin Zen, ju duhet të kultivoni vetëm sektin Zen. Nëqoftëse fusni këmbën në dy barka në të njëjtën kohë dhe kultivoni si këtë dhe atë mënyrë, ju nuk mund të arrini asgjë. Kjo do të thotë që edhe në Buddhizëm mësohet të mos praktikosh një sistem tjetër dhe juve nuk ju lejohet të përzjeni praktikat kultivuese. Buddhizmi, gjithashtu, përfshin praktikim të gongut dhe kultivim. Proçesi i transformimit të gongut ndjek proçesin e një praktike të caktuar kultivuese dhe transformimin në atë mënyrë kultivuese. Ekziston gjithashtu një proçes i evoluimit të gongut në dimensione të tjera dhe ky është një proçes jashtëzakonisht kompleks dhe i komplikuar që nuk mund të përzjehet ashtu kot me gjëra të tjera në kultivim.

Me të mësuar se ne praktikojmë gong nga Shkolla Buddhës, disa Buddhistë i marrin praktikuesit tanë në tempuj për t'i konvertuar. Po ju them të gjithë juve që jeni këtu që asnjëri të mos e bëjë këtë. Ju po dëmtoni si Dafën ashtu dhe rregullat e Buddhizmit. Në të njëjtën kohë ju i ndërhyni praktikuesve duke i bërë ata të mos arrijnë asgjë. Kjo nuk lejohet. Praktika kultivuese është një gjë serioze. Ti duhet të jesh i përqëndruar vetëm në një praktikë. Megjithëse kjo pjesë që po i mësojmë njerëzve sot nuk është fe, qëllimi i saj në praktikën kultivuese është i njëjtë. Të dyja përpiqen të arrijnë shkallën e Çbllokimit të Gongut, lartësimin shpirtëror dhe arritjen e kultivimit.

Sakyamuni pat thënë se në kohën e Fund-Dharmës edhe murgjit në tempuj do të kenë vështirësi të shpëtojnë veten, le pastaj ata besimtarë Buddhistë që nuk kanë asnjë që kujdeset për ta. Megjithëse ju keni një “mjeshtër”, ai i ashtuquajtur mjeshtër është gjithashtu praktikues. Nëqoftëse mjeshtri nuk praktikon kultivim të vërtetë, është pa vlerë. Pa kultivuar zemrën, asnjë nuk ja arrin dot. Konvertimi është një formalitet i njerëzve të zakonshëm. A je ti pjesëtar i Shkollës së Buddhës pas konvertimit? A do të kujdeset Buddha për ty atëhere? Kjo nuk është gjë që bëhet. Edhe sikur të përkuleshe me nderim çdo ditë derisa të të gjakosej koka, apo edhe sikur të digjje tufa me erë të mirë, përsëri është e kotë. Ti duhet me të vërtetë të kultivosh zemrën që të arrish diçka. Në kohën e Fund-Dharmës, universi ka kaluar përmes ndryshimesh të mëdha. Edhe vendet fetare të lutjeve nuk janë më të pastra. Ata me aftësi supernormale (duke përfshirë murgjit) e kanë vënë re këtë situatë gjithashtu. Në kohën tonë, unë jam i vetmi person në botë që po u mësoj njerëzve një mënyrë të vërtetë. Unë kam bërë diçka të pa bërë më parë. Për më tepër e kam hapur këtë derë aq gjërë në kohën e Fund-Dharmës. Në fakt, kjo mundësi nuk vjen në një mijë vjet apo në dhjetë mijë vjet. Por nëse dikush mund të shpëtohet—me fjalë të tjera, nëse dikush mund të praktikojë kultivim—përsëri varet nga vetë personi. Ajo që po ju them është parim i universit të pakufishëm.

Unë nuk po them që ju duhet të mësoni Falun Dafën time. Ajo që thashë është parimi. Nëqoftëse doni të praktikoni kultivim, ju duhet të praktikoni vetëm një mënyrë kultivimi. Përndryshe, ju nuk do të mund të praktikoni kultivim aspak. Sigurisht, nëqoftëse ju nuk doni të praktikoni kultivim, ne do ju lëmë të qetë. Ky Ligj i mësohet vetëm praktikuesve të vërtetë. Prandaj, individit duhet të jetë i përqëndruar vetëm në një praktikë madje as mendime nga praktika të tjera nuk duhet të ketë. Unë nuk ju mësoj si të drejtoni mendimet këtu; nuk ka drejtim mendimesh në Falun Dafën tonë. Kështu, asnjëri të mos i shtojë asaj ndonjë mendim. Bëni kujdes ta mbani këtë në mendje: Nuk ka asnjë aktivitet mendor. Shkolla Buddhës kërkon Zbrazëti dhe Shkolla Tao mëson Asgjënë.

Në një rast unë lidha mëndjen time me katër a pesë Qënie të Shumëlartësuarra dhe Tao të mëdhenj nga nivele jashtëzakonisht të larta. Kur flasim për nivele të larta, nivelet e tyre ishin aq të larta sa njerëzit e zakonshëm do ta konsideronin thjesht të paimagjinueshme. Ata donin të dinin çfarë kisha unë në mendje. Unë kam praktikuar për kaq shumë vite. Është plotësisht e pamundur për njerëzit e tjerë të lexojnë mëndjen time dhe aftësitë supernormale të njerëzve të tjerë nuk mund të më arrijnë mua aspak. Asnjëri nuk mund të më kuptojë apo të dijë çfarë kam në mendje. Ata donin të dinin çfarë mendoja unë. Kështu me lejen time ata e lidhën mëndjen time me të tyren për një periudhë kohe. Pas lidhjes, ishte pak e mundimshme për mua sepse pamvarësisht nga sa i lartë apo i ulët është niveli im, unë jam në mes të njerëzve dhe akoma jam duke bërë diçka të qëllimshme—domethënë

duke shpëtuar njerëzit—dhe zemra ime i është dedikuar shpëtimit të njerëzve. Por sa të qeta ishin mëndjet e tyre? Mëndjet e tyre ishin të qeta deri në një pikë të frikshme. Është e mundur për një njeri të arrijë një qetësi të tillë. Por me katër apo pesë vetë aty me qetësi të tillë—i ngjan një pellgu me ujë të qetë me asgjë tjetër brenda. Unë u përpoqa më kot t'i ndjej ata. Për ato disa ditë, unë me të vërtetë u ndjeva mendërisht shumë pa rehat dhe pata një ndjenjë të veçantë. Njerëzit e zakonshëm nuk mundën në asnjë mënyrë ta imagjinojnë apo ndjejnë këtë; ishte plotësisht e paqëllimshme dhe bosh.

Nuk ka asnjë aktivitet mendor në kultivimin në nivele shumë të larta. Kjo ndodh sepse ndërsa ti ishe në stadin e hedhjes së themeleve, ai sistem themeli u krijua dhe kur kultivimi yt arrin një nivel të lartë, praktika kultivuese është plotësisht automatike dhe kjo është veçanërisht e vërtetë për sistemin tonë të kultivimit. Për sa kohë që ju vazhdoni të përmirësoni karakterin tuaj, gongu juaj do të rritet. Ju madje nuk do të keni nevojë as për ushtrime. Ushtrimet tona janë për të përforcuar mekanizmin automatik. Pse rrin njeriu pa lëvizur në meditim? Ai është plotësisht në një gjendje mosveprimi. Ju mund ta dini që Shkolla Tao mëson këtë apo atë ushtrim, të ashtuquajturat aktivitete mendore, apo udhëheqjen e mëndjes. Po ju them se sapo Shkolla Tao arrin përtej nivelit të qi-së, nuk ka asgjë dhe nuk përdor as këtë apo atë aktivitet mendor. Prandaj, disa njerëz të cilët kanë praktikuar një qigong tjetër nuk heqin dot dorë nga metodat e frymëmarrjes, aktivitetet mendore e të tjera si këto. Unë po u mësoj atyre diçka nga universiteti dhe ata gjithmonë më pyesin për gjërat e një nxënësi të shkollës filllore, si për shembull si të udhëheqin e përdorin aktivitetet mendore. Ata janë mësuar tashmë me atë mënyrë. Ata mendojnë se qigongu është i tillë, në fakt nuk është ashtu.

Aftësitë Supernormale dhe Fuqija Gongut

Shumë prej jush nuk janë të qartë rreth terminologjisë në qigong dhe disa njerëz shpesh ngatërrohen prej saj. Ata i marrin aftësitë supernormale si fuqi të gongut dhe anasjelltas. Gongu që ne arrijmë duke kultivuar karakterin dhe duke u asimiluar në karakteristikën e universit zhvillohet nga virtyti jonë. Ai përcakton lartësinë e nivelit të individit, lartësinë e fuqisë së gongut dhe Shkallën e Arritjes të kultivimit të dikujt. Ky është gongu më i rëndësishëm. Gjatë periudhës së kultivimit, çfarë situatash do të shfaqen tek një person? Ai mund të zhvillojë disa aftësi të pazakonshme dhe mbinatyrale që, shkurt, po i quajmë aftësi supernormale. Gongu që përmirëson nivelin e dikujt quhet, siç e thashë më parë, fuqi gongu. Sa më i lartë niveli i dikujt, aq më e madhe fuqia e gongut dhe aq më të fuqishme aftësitë supernormale të tij.

Aftësitë supernormale janë vetëm produkte dytësore të procesit të kultivimit të personit; ato nuk përfaqësojnë as nivelin apo lartësinë e tij dhe as forcën e fuqisë së gongut të tij. Disa njerëz zhvillojnë më shumë aftësi supernormale ndërsa të tjerë zhvillojnë më pak. Për më tepër, aftësitë supernormale nuk janë diçka që mund të ndiqen si qëllimi kryesor i kultivimit. Vetëm kur njeriu është i vendosur që të praktikojë kultivim me të vërtetë mundet ai t'i zhvillojë ato; megjithatë, ato nuk duhet të trajtohen si qëllimi kryesor i kultivimit. Për çfarë i kultivon ti ato? A don t'i përdorësh para njerëzve? Ty të ndalohet në mënyrë absolute që t'i përdorësh ato sipas dëshirës para njerëzve. Kështu, sa më shumë i ndjek ti ato, aq më pak arrin. Kjo ndodh sepse po kërkon diçka me qëllim. Ndjekja me qëllim është dëshirë. Në praktikën kultivuese dëshirat janë ato që duhet të braktisen.

Shumë njerëz kanë arritur një nivel shumë të lartë në kultivim pa aftësi supernormale. Mjeshtri i ka mbyllur ato nga merakun se mos ata nuk e kontrollojnë veten dhe bëjnë gabime. Prandaj, ata nuk lejohen t'i përdorin aftësitë e tyre mbinatyrale. Ka plot njerëz të tillë. Aftësitë supernormale drejtohen prej mëndjes së njeriut. Dikush mund të jetë i paaftë ta kontrollojë veten në gjumë. Me një ëndërr të vetme ai mund ta kthejë qiellin e tokën përmbys në mëngjes dhe kjo nuk lejohet. Meqenëse praktika kultivuese kryhet në mes të njerëzve, ata me aftësi supernormale të mëdha zakonisht nuk lejohen t'i përdorin ato. Shumica e tyre janë të kyçura por kjo nuk është absolute. Ka plot njerëz që praktikojnë shumë mirë kultivim dhe mund ta përmbajnë veten mirë. Atyre ju lejohet të kenë disa

aftësi supernormale. Përsa i përket këtyre njerëzve edhe sikur t'u kërkosh të demonstrojnë aftësitë e tyre supernormale, ata nuk do ta bënin atë në asnjë mënyrë; ata mund ta kontrollojnë veten.

Kultivimi i Anasjelltë dhe Marrja Hua e Gongut

Disa njerëz nuk kanë praktikuar asnjëherë qigong apo kanë mësuar pak gjëra në një klasë qigongu. Por ato janë për të shëruar sëmundje e mbajtur trupin në formë dhe nuk janë praktika kultivuese. Me fjalë të tjera, këta njerëz nuk kanë marrë kurrë mësim të vërtetë, megjithatë ata papritmas kanë gong brenda natës. Do flasim nga vjen ky lloj gongu. Ka disa lloje.

Njëri i përket kultivimit të anasjelltë. Çfarë është kultivimi i anasjelltë? Disa njerëz janë relativisht të shkuar në moshë dhe duan të praktikojnë kultivim. Është tepër vonë për ta të praktikojnë kultivim nga fillimi. Kur qigongu ishte në kulmin e popullaritetit të tij, ata gjithashtu dëshironin të praktikonin kultivim. Ata e dinin se me qigong ata mund të bënin të mira për njerëzit e tjerë dhe në të njëjtën kohë do të mund të ngrinin nivelin e tyre. Ata kishin këtë dëshirë dhe donin të përmirësoheshin dhe praktikonin kultivim. Megjithatë, kur qigongu ishte popullor disa vite më parë, mjeshtërit e qigongut thjesht e përhapnin atë por askush në fakt nuk u mësonte njerëzve gjëra të niveleve të larta. Deri më sot, kur është fjala për mësim në publik të një qigongu të vërtetë të niveleve të larta, unë jam i vetmi person që po e bën këtë. Nuk ka njeri tjetër që po e bën këtë. Të gjithë njerëzit e kultivimit të anasjelltë ishin mbi pesëdhjetë vjeç, në një moshë relativisht të shkuar. Ata kishin cilësi të lindur shumë të mirë dhe kishin në trupat e tyre gjëra shumë të mira. Pothuajse të gjithë ishin të denjë për të qenë dishepuj apo pasardhës të këtyre mjeshtërvë. Megjithatë këta persona ishin goxha të moshuar. Nëqoftëse dëshironin të praktikonin kultivim, nuk ishte një fjalë goje. Ku do ta gjenin ata një mjeshtër? Por sapo ata shprehnin dëshirën për të praktikuar kultivim dhe me këtë mendim në zemër, ky mendim do të shkëlqente si flori dhe tundte botën e dhjetë drejtimeve. Njerëzit shpesh flasin për natyrën e Buddhës dhe kjo do ishte natyra e tyre e Buddhës që kish dalë në pah.

E parë nga një perspektivë e nivelit të lartë, kuptimi i jetës së njeriut nuk është për të qenë njeri. Meqënëse jeta e një individi është krijuar në hapësirën e universit, ajo është e asimiluar në Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), karakteristikën e universit. Natyra e saj është e mirë dhe bamirëse. Megjithatë, pasi numri i jetëve rritet, formohen lidhjet shoqërore. Si pasojë, disa njerëz bëhen egoistë dhe të këqinj dhe nuk mund të qëndrojnë në nivele shumë të larta. Ata duhet të bien në nivele më të ulta ku ata përsëri bëhen të këqinj dhe duhet të bien akoma më poshtë në nivele të tjera. Kjo vazhdon derisa në fund ata bien në këtë nivel të njerëzimit. Me të rënë në këtë nivel, ata duhet të shkatërroheshin plotësisht. Megjithatë, nga zemërmirësia dhe mëshira e tyre Qëniet e Shumëlartësuar vendosën t'i japin njerëzimit një mundësi tjetër në këtë mjedis tepër të dhimbshëm; kështu ata krijuan këtë dimension.

Në dimensionet e tjera, njerëzit nuk kanë trupa të tillë. Ata mund të qëndrojnë pezull në ajër dhe mund të zmadhohen apo zvogëlohen. Por në këtë dimension njerëzit pajisen me këtë lloj trupi, me trupat tanë fizikë. Me këtë trup, njeriu nuk mund të durojë kur trupi ka ftohtë, vapë, është i lodhur apo i uritur. Me një fjalë ai vuan. Kur ju jeni sëmurë, ju vuani. Njeriut i duhet të kalojë lindje, plakje, sëmundje dhe vdekje në mënyrë që ai të mund të ripaguajë borxhet karmike nëpërmjet vuajtjeve. Juve ju është dhënë një mundësi tjetër për të parë në mund të ktheheni në origjinë. Prandaj, qëniet njerëzore kanë rënë në këtë nivel mjergulle. Pasi ti ke rënë këtu poshtë, këta palë sy janë krijuar për ty me qëllim që ti të mos mund të shohësh dimensionet e tjera dhe të vërtetën e materies. Nëqoftëse ti mund të kthehesh në origjinë, do të shohësh se vuajtjet më të hidhura janë gjithashtu dhe më të çmuarat. Në mënyrë që të kthehesh në origjinën tënde duke praktikuar kultivim në mjergull dhe nëpërmjet zgjimit ndaj kuptimit të brendshëm të gjërave, do të ketë vështirësi të shumta; kështu njeriu mund të arrijë shpejt. Nëqoftëse ti bëhesh i keq, jeta jote do të eliminohet. Prandaj, për jetët e larta,

qëllimi i jetës së njeriut nuk është për të qenë njeri por për t'u kthyer në origjinë, në veten e tyre të vërtetë. Një njeri i zakonshëm nuk mund ta kuptojë këtë. Një njeri i zakonshëm është veçse një njeri i zakonshëm në shoqërinë njerëzore, një njeri që mendon si të eci përpara e jetojë mirë. Sa më mirë të jetojë, aq më tepër egoist bëhet ai; sa më tepër që don të ketë, aq më shumë i largohet karakteristikës së universit. Atëhere ai shkon drejt shkatërrimit.

E parë nga një nivel i lartë, ndërsa ju mund të mendoni se po avanconi përpara, ju në fakt po ecni mbrapsht. Njerëzimi mendon se po zhvillon shkencë dhe po bën përparime; në fakt po ndjek vetëm ligjin e universit. Mjeshtri Zhang Guo, një nga Tetë Shenjtorët⁸ Taoistë, i jepte gomarit mbrapsht. Pak njerëz e dinin pse ai i jepte gomarit mbrapsht. Ai zbuloi se të ecësh përpara do të thotë të ecësh mbrapsht, kështu ai i jepte gomarit në anën e kundërt. Prandaj, sapo njerëzit duan të praktikojnë kultivim, Qëniet e Shumëlartësuaras do e vlerësonin këtë zemër së tepërmi dhe do t'i afronin ndihmë pa kursim. Është pikërisht e njejta gjë për praktikuesit që janë këtu sot. Nëqoftëse ju dëshironi të praktikoni kultivim, unë mund t'ju ndihmoj juve pa kushte. Megjithatë kjo nuk mund të bëhet nëqoftëse ju doni të shëroni sëmundjet e të largoheni si njerëz të zakonshëm dhe unë nuk do të mund t'ju ndihmoj dot. Pse ndodh kështu? Për shkak se ju doni të mbeteni një njeri i zakonshëm dhe njerëzit e zakonshëm duhet të kalojnë përmes lindjes, plakjes, sëmundjeve dhe vdekjes—kjo duhet të mbetet kështu. Çdo gjë ka shkaqet e veta karmike tek të cilat nuk mund të ndërhyhet. Jeta juaj në fillim nuk përmbante praktikë kultivuese, por tani ju dëshironi të praktikoni kultivim. Për pasojë, jeta juaj e ardhshme duhet të riorganizohet dhe kështu lejohet që ta pastrojmë trupin tuaj.

Sapo një person dëshiron të praktikojë kultivim dhe kjo dëshirë shfaqet, Qëniet e Shumëlartësuaras e shikojnë atë dhe do e konsiderojnë si shumë të çmuar. Por si mund ta ndihmojnë ato këtë person? Ku mund të gjejë ai një mjeshtrë? Aq më tepër, ai është mbi pesëdhjetë vjeç. Qëniet e Shumëlartësuaras nuk mund ta mësojnë këtë person. Kjo ndodh sepse po të shfaqeshin ato dhe t'i mësonin këtij personi Ligjin dhe ushtrimet, ato do të nxirrnin sekretet qiellore; atyre do t'u duhej të zbrisnin vetë këtu. Njerëzit bien në mjergull sepse kanë kryer vepra të këqija dhe kështu duhet të praktikojnë kultivim dhe vazhdimisht të lartësohen shpirtërisht në mjergull. Për pasojë, Qëniet e Shumëlartësuaras nuk mund t'a mësojnë atë. Nëqoftëse një Buddha shfaqet këtu para syve të njerëzve dhe u mëson njerëzve Ligj dhe ushtrime, edhe ata me mëkatë të pafalshme do të vinin për të mësuar. Të gjithë do të besonin. Atëhere çfarë mbetet për njerëzit që të ndriçohen shpirtërisht duke i kuptuar gjërat në mjergull? Çështja e ndriçimit shpirtëror nuk do ekzistonte më. Meqenëse njerëzit kanë rënë vetë në mjergull, ata duhet të eliminohen. Juve ju është dhënë një mundësi tjetër për t'u kthyer nga mjergulla në origjinë. Nëqoftëse mundet të kthehesh në origjinë, ti ke arritur qëllimin. Po nuk arrite të kthehesh, ti do të vazhdosh në ciklin e ringjalljes ose do të eliminohesh.

Njeriu e zgjedh vetë rrugën e tij. Çfarë ndodh kur dikush dëshiron të praktikojë kultivim? Ata gjetën një mënyrë. Qigongu ishte shumë popullor në atë kohë dhe kjo ishte gjithashtu si rezultat i një ndryshimi në klimën kozmike. Në mënyrë që të kooprohej me këtë klimë kozmike, Qëniet e Shumëlartësuaras i dhanë këtij personi gong në masë proporcionale me nivelin e tij të karakterit nëpërmjet një tubi. Si një rrubinet uji, energjia vinte kur ai hapesh. Nëqoftëse personi donte të lëshonte gong, gongu dilte. Ai vetë nuk mund të lëshonte gong, sepse ai nuk e kish gongun e vet. Ndodhte kështu. Ky quhet “kultivim i anasjelltë” dhe personi e përfundon kultivimin nga më e larta tek më e ulta.

Ne normalisht praktikojmë kultivim nga më e ulta tek më e larta deri në Çbllokimin e Gongut apo mbarimin e kultivimit. Kultivimi i anasjelltë ishte për ata të moshuar të cilët nuk kishin kohë të mjaftueshme të praktikonin kultivim nga më e ulta në më të lartën. Kështu do të ishte më e shpejtë nëqoftëse ata praktikonin nga më e larta tek më e ulta. Ky ishte një fenomen që u krijua në atë kohë. Ky person duhet të kishte nivel shumë të lartë karakteri dhe atij i ishte dhënë energjia në bazë të

⁸ Tetë Shenjtorët—Tao të mirënjohur në historinë kineze.

meritës së nivelit të tij të karakterit. Pse bëhej kështu? Sepse duhet të kooprohej me klimën kozmike të asaj kohe. Kur ky person kryente një vepër të mirë, në të njejtën kohë ai mund të vuante. Kjo ndodhte ngaqë në mes të njerëzve të zakonshëm, dëshirat njerëzore do të ndërhyjnë. Kur ai shëronte sëmundjen e një pacienti, pacienti mund të mos ja dinte për nder. Kur ai trajtonte pacientin, ai mund t'i kish hequr shumë gjëra të këqija trupit të tij. Megjithëse ai e kishte shëruar këtë pacient deri në atë shkallë, mund të mos kishte ndryshime të dukshme në atë kohë. Kështu pacienti nuk do të ishte i kënaqur. Në vend që t'i shprehte mirënjohje, ai mund ta akuzonte atë për mashtrim. Me këto probleme, ai do të kalonte vështirësi psikologjike në këtë mjedis. Qëllimi i dhënies së energjisë atij ishte që ta aftësonte atë të praktikonte kultivim dhe të ngrinte nivelin e tij. Ndërsa kryente vepra bamirëse, ai do të zhvillonte aftësitë e tij supernormale dhe do të krijonte gongun e vet. Megjithatë, disa njerëz nuk e kuptonin këtë parim. A nuk thashë unë më lart se askush nuk mund t'i mësonte këtij personi Ligjin? Nëqoftëse personi do mund ta kuptonte, ai do e merrte vesh. Është çështje ndriçimi shpirtëror. Nëqoftëse personi nuk do mund ta kuptonte, nuk mund të bëhesh asgjë.

Kur disa njerëz merrnin energji, një natë ata do të ndjenin papritmas shumë të nxehtë gjatë gjumit dhe nuk do duronin dot as mbulesat. Pasi të zgjoheshin në mëngjes, ata do të kishin shok elektrik nga prekja e çfarëdo lloj gjëje. Ata e dinin se kishin marrë energji. Kur dikush kishte dhimbje diku në trup, ata mund ta lehtësonin atë me duar dhe kjo jepte rezultat të mirë. Që nga ai moment ata e dinin se kishin energji. Kështu ata u bënë mjeshtër qigongu dhe vendosën tabela. Ata e quajtën veten mjeshtër qigongu dhe filluan të ushtrojnë zanatin. Në fillim ky person ishte shumë i mirë. Kur ai shëronte sëmundjet për njerëzit, ata i jepnin atij para apo dhurata të tjera—të gjitha këto ai i kthente mbrapsht apo refuzonte t'i merrte. Megjithatë ky person nuk mund t'i shpëtonte korrupsionit të madh të njerëzve të zakonshëm. Meqenëse këta persona të kultivimit të anasjelltë nuk kishin kaluar nëpërmjet kultivimit të vërtetë të karakterit, ishte shumë e vështirë për ta që të silleshin mirë. Gradualisht, ky person do të pranonte dhurata të vogla. Më pas, ai do të pranonte dhe dhurata të mëdha. Në fund ai do të ofendohej kur dhuratat ishin të vogla. Së fundi, ai do thosh, “Pse më jepni kaq shumë gjëra? Më jepni para!” Ai nuk do kënaqej kur t'i jepnin pak para. Duke dëgjuar lavdërimet e njerëzve se sa i zoti ishte, ai do fillonte të mos respektonte mjeshtërit e qigongut nga shkollat e vërteta. Kur dikush fliste keq për të, ai do zemërohej. Dëshira e këtij personi për famë dhe interes personal do të fillonte të zhvillohej. Ai do e konsideronte veten më të aftë se të tjerët dhe të jashtëzakonshëm. Ai gabimisht mendonte se i ishte dhënë energjia që të bëhesh mjeshtër qigongu dhe të bënte pasuri, ndërsa në fakt iu dha që të praktikonte kultivim. Me zhvillimin e dëshirave për famë e fitim, karakteri i këtij personi aktualisht do të zbriste.

Unë kam thënë se niveli i gongut të një personi është sa dhe niveli i tij i karakterit. Kur niveli i karakterit të tij bie, atëherë ai nuk do pajiset më me aq shumë gong sepse ai duhet të jepet në përshtatje me nivelin e karakterit. Niveli i gongut është aq i lartë sa dhe niveli i karakterit. Sa më shumë që dikush të jetë i dhënë pas famës e interesit personal, aq në nivel më të ulët bie ky person në mes të njerëzve. Për pasojë dhe gongu i tij do të zbrisë. Së fundi, kur personi të ketë rënë plotësisht në fund, atij nuk do i jepet më gong. Ky person nuk do ketë më gong. Disa vite më parë kishte disa nga këta njerëz dhe më shumë ishin gra mbi pesëdhjetë vjet në moshë. Megjithëse ju mund të kishit parë një grua të moshuar duke praktikuar qigong, ajo nuk kishte marrë kurrë mësim të vërtetë. Ajo mund të kishte mësuar në një klasë qigongu disa lëvizje për shërim e mirëmbajtje trupit. Një ditë, ajo papritmas ka gong. Sapo karakteri i saj bie apo nëqoftëse dëshirat e saj për famë dhe interes personal zhvillohen, niveli i saj do të bjerë. Kështu ajo do të përfundojë pa emër dhe gongu i saj do të zhduket. Sot ka plot nga këta njerëz të kultivimit të anasjelltë niveli i të cilëve ka rënë. Vetëm pak prej tyre kanë mbetur. Përse? Ajo grua nuk e dinte që gongu i ishte dhënë që të praktikonte kultivim dhe ajo gabimisht mendoi se i ishte dhënë për të bërë pasuri e fituar famë dhe për t'u bërë mjeshtër qigongu. Në fakt, ishte që ajo të praktikonte kultivim.

Çfarë është “marrja hua e gongut”? Nuk ka kufi moshe për këtë, por ka një kërkesë: Personi duhet të ketë karakter të mirë. Ky person e din se qigongu mund të aftësojë dikë të praktikojë kultivim dhe ai gjithashtu dëshiron të praktikojë kultivim. Ai e ka praktikën kultivuese në zemër por ku mund të gjejë ai një mjeshtër? Disa vjet më parë kishte me të vërtetë mjeshtër qigongu të vërtetë. Megjithatë, ajo që mësonin ata ishte diçka vetëm për shërim dhe mbajtje të trupit në formë. Askush nuk përhapte qigong të nivelit të lartë dhe as që mund ta bënin ata këtë.

Me që po flasim për marrje hua të gongut, unë do diskutoj dhe një çështje tjetër. Përveç Shpirtit Kryesor⁹ (*zhu yuanshen*), njeriu ka dhe Shpirtin Ndihmës¹⁰ (*fu yuanshen*). Disa njerëz kanë një, dy, tre, katër apo pesë Shpirtra Ndihmës. Gjinia e Shpirtit Ndihmës mund të mos jetë e njejtë me atë të personit. Disa janë meshkuj dhe disa janë femra, ata janë të ndryshëm. Në fakt, gjinia e Shpirtit Kryesor gjithashtu mund të mos jetë e njejtë me atë të trupit fizik të njeriut, sepse ne kemi parë që tani shumë meshkuj kanë Shpirtra Primordialë femërorë, ndërsa shumë femra kanë Shpirtra Primordialë mashkullorë. Kjo përputhet plotësisht me klimën kozmike që siç e përshkruan Shkolla Tao, *yin* dhe *yang*¹¹ janë me pole të kundërta me *yin* në ngjitje dhe *yang* në rënie.

Shpirti Ndihmës i personit normalisht vjen nga një nivel më i lartë sesa Shpirti Kryesor. Veçanërisht për disa njerëz, Shpirti i tyre Ndihmës vjen nga një nivel shumë i lartë. Shpirti Ndihmës nuk është shpirt i keq, sepse ai lind me ty në të njejtën kohë nga nëna jote, ka të njejtin emër me ty dhe është pjesë e trupit tënd. Normalisht, kur njerëzit mendojnë për diçka apo bëjnë diçka, është Shpirti Kryesor ai që e ka në dorë të marrë vendimet. Shpirti Ndihmës kryesisht përqipet me të gjitha mënyrat për të parandaluar Shpirtin Kryesor që ai të mos kryejë veprime të këqija. Megjithatë, kur Shpirti Kryesor është shumë kokëfortë, Shpirti Ndihmës nuk mund të ndihmojë. Shpirti Ndihmës nuk gënjehet nga shoqëria njerëzore ndërsa Shpirti Kryesor gënjehet lehtas.

Disa Shpirtra Ndihmës vijnë nga nivele shumë të larta dhe ka mundësi të jenë afër arritjes së Shkallës së Duhur në kultivim. Shpirti Ndihmës dëshiron të praktikojë kultivim, por nuk mund të bëjë gjë nëqoftëse Shpirti Kryesor nuk dëshiron ta bëjë këtë. Kur qigongu ishte shumë popullor, një ditë Shpirtri Kryesor gjithashtu shpreh dëshirën për të praktikuar qigong. Mendimi i kultivimit drejt niveleve të larta ishte sigurisht shumë i pastër dhe i thjeshtë; personi nuk kish dëshirë për gjëra të tilla si famë dhe përfitim personal. Kjo do ta ngazëllente Shpirtin Ndihmës, “Unë dua të praktikoj kultivim, por unë nuk vendos dot. Tani ti dëshiron të kultivosh dhe kjo është pikërisht ajo që dua dhe unë.” Megjithatë ku mund të gjente personi një mjeshtër? Shpirti Ndihmës ishte shumë i aftë dhe mund të linte trupin për të gjetur Qënien e Shumëlartësuar që njihte nga një jetë e mëparshme. Meqenëse disa Shpirtra Ndihmës vinin nga nivele shumë të larta, ata mund të linin trupin. Pasi arrinte atje lart, ai shprehte dëshirën e tij për kultivim dhe për të marrë gong hua. Qëniet e Shumëlartësuar do e pëlqenin idenë dhe sigurisht do t’i afronin ndihmë për kultivim. Kështu Shpirti Ndihmës do të marrte hua ca gong. Normalisht, ky gong është energji rrezatuese e sjellë nëpërmjet një tubi. Disa lloje energjish të marra hua vijnë gjithashtu në forma dhe normalisht përmbajnë aftësi supernormale.

Në këtë mënyrë, ky person mund të kishte në të njejtën kohë edhe aftësi supernormale. Personi, siç e përshkruajta, do të ndjente shumë nxehtësi një natë në gjumë. Kur të zgjohej në mengjes ai do të kishte energji. Ai pësonte shok elektrik kudo ku vendoste dorën. Nga vinte energjia? Ai nuk ishte i sigurtë. Ai kishte vetëm një ide të përafërt se i erdhi nga hapësira e universit. Por ai nuk e dinte me saktësi si i erdhi. Shpirti Ndihmës nuk do t’i tregonte atij, sepse ishte Shpirti Ndihmës i cili praktikonte kultivim. Ai vetëm din që kish marrë energji.

Zakonisht nuk kishte kufi moshe për njerëzit që merrnin energji hua dhe kishte relativisht më shumë të rinj. Prandaj, disa vjet më parë kishte gjithashtu disa persona në moshën njëzet dhe tridhjetë

⁹ Shpirti Kryesor—ndërgjegjja kryesore e njeriut.

¹⁰ Shpirti Ndihmës—shpirti/shpirtrat dytësor(ë); ndërgjegjja ndihmëse e njeriut.

¹¹ *yin* dhe *yang* (*jin*; *jang*)—Shkolla Tao beson se çdo gjë përmban forca të kundërta të *yin* dhe *yang* të cilat përjashtojnë njëra tjetrën por dhe varen nga njëra tjetra, psh. femërore (*yin*) kundrejt mashkullore (*yang*).

vjeç të cilët dolën në publik. Kishte edhe disa të moshuar. Ishte më e vështirë për një të ri të sillet mirë. Mbase ty do të ishte dukur ky person shumë i mirë, pa interes për famë dhe interes personal, në kohën kur nuk kishte shumë aftësi të shoqërisë njerëzore. Me t'u bërë i mirënjohur, fama dhe përfitimi do t'i ndërhyjnë me lehtësi. Ai mund të mendonte se akoma kishte një rrugë të gjatë në jetë dhe akoma donte të bënte përpjekje për të arritur disa qëllime njerëzore. Kështu, me të zhvilluar aftësi supernormale dhe disa aftësi të tjera, ai do t'i përdorte ato si mjete për të realizuar qëllimet e tij personale në shoqërinë njerëzore. Por ato nuk do të vepronin sepse nuk lejohet që të përdoren në këtë mënyrë. Sa më shumë që i përdorte ai ato, aq më pak energji ai kishte. Së fundi, ai do të përfundonte me asgjë. Ka akoma shumë individë nivelet e të cilëve kanë rënë në këtë mënyrë. Unë kam konstatuar që tani nuk ka mbetur më asnjë.

Dy rastet që sapo diskutova lidhen me energjinë që merrej nga njerëz me karakter relativisht të mirë. Kjo energji nuk ishte zhvilluar nëpërmjet praktikës së tyre kultivuese. Ajo vinte nga Qëniet e Shumëlartësuar dhe kështu energjia në thelb ishte e mirë.

Zotërimi nga Shpirtrat apo Kafshët

Shumë nga ju mund të kenë dëgjuar në komunitetin e kultivuesve historira se si kafshë si dhelprat, nuselalet, fantazmat apo gjarpërinjt kanë zotëruar trupa njerëzish. Çfarë janë këto? Disa njerëz flasin për zhvillimin e aftësive supernormale nëpërmjet praktikës së qigongut. Në fakt, aftësitë supernormale nuk zhvillohen; përkundrazi ato janë aftësi njerëzore të lindura. Vetëm se me përparimin e shoqërisë njerëzore, njerëzit përqendrohen më shumë në gjërat e prekshme të botës fizike, duke u bërë kështu akoma më të varur nga mjetet moderne. Për rrjedhojë, aftësitë tona të lindura njerëzore po bëhen gjithnjë e më të atrofizuara e së fundi kanë arritur pikën e zhdukjes së plotë.

Në mënyrë që të ketë aftësi supernormale, njeriu duhet t'i zhvillojë ato nëpërmjet praktikës kultivuese dhe të kthehet në origjinë, në veten e tij të vërtetë. Por një kafshë nuk ka këtë mendje të sofistikuar, kështu ajo lidhet me karakteristikën e universit nëpërmjet instinktit të vet primordial. Disa njerëz pretendojnë se kafshët mund të praktikojnë kultivim, që dhelprat dinë si të kultivojnë dan, apo që gjarpërinjtë dinë si të praktikojnë kultivim etj. Këto kafshë nuk dinë si të praktikojnë kultivim. Në fillim, edhe ato nuk dinë aspak çfarë është kultivimi. Ato vetëm kanë instinktin primordial. Më pas, në kushte dhe situata të veçanta, aftësitë e tyre të lindura mund të marrin efekt pas një periudhe kohe të gjatë. Ato mund të marrin energji dhe zhvillojnë aftësi supernormale.

Në këtë mënyrë, kjo kafshë do të ketë disa aftësi. Në të kaluarën, thuhej se një kafshë ishte bërë shumë dinake dhe me disa aftësi. Në sytë e njerëzve, kafshët janë kaq të frikshme sa ato mund të manipulojnë njerëzit me lehtësi. Në fakt, unë them që ato nuk janë të frikshme dhe nuk janë asgjë para një praktikuesi të vërtetë. Megjithatë ti mund të gjesh ndonjë që ka praktikuar kultivim për se një mijë vjet, edhe gishti i vogël mjafton ta zhdukë atë. Ne kemi thënë se kafshët kanë këtë instinkt primordial dhe ato mund të kenë disa aftësi. Megjithatë, ka një parim në universin tonë: Kafshët nuk lejohen të përfundojnë kultivim. Prandaj, të gjithë juve mund të lexoni në libra të vjetër që një herë në disa qindra vjet, kafshët vriten në një katastrofë të madhe apo në ndonjë fatkeqësi. Pas një periudhe kohe, kafshët do të zhvillojnë energji dhe duhet të vriten apo goditen nga rrufetë, etj. Atyre u ndalohet të praktikojnë kultivim sepse ato nuk kanë natyrë njerëzore të lindur; ato nuk mund të praktikojnë kultivim si qëniet njerëzore sepse ato nuk kanë cilësi njerëzore. Nëqoftëse ato arrijnë të kultivojnë, ato përfundojnë në djaj. Kështu ato nuk lejohen t'ja arrijnë në kultivim. Përndryshe, ato do të vriten nga Qielli. Edhe ato e dinë këtë mirë. Por siç e kam thënë, shoqëria njerëzore është tani në degjenerim të madh dhe disa njerëz kryejnë të gjitha llojet e mëkateve. Në këtë fazë a nuk është shoqëria njerëzore në rrezik?

Gjërat kanë për të kthyer për mirë pasi kanë arritur kulmin! Ne kemi konstatuar se sa herë që shoqëritë njerëzore shkatërroheshin në periudha të ndryshme parahistorike, kjo ndodhte gjithmonë kur njerëzimi ishte korrumpuar moralisht në kulm. Në kohën tonë, dimensiononi i banuar nga qëniet njerëzore si dhe shumë dimensione të tjera janë të gjitha në një situatë të rrezikshme. E njejtja gjë është e vërtetë me dimensione të tjera në këtë nivel; shpirtrat apo kafshët zotëruese gjithashtu vrapojnë të shpëtojnë dhe duan të ngjiten në nivele më të larta. Ato mendojnë se duke u ngjitur në nivele më të larta ato mund të shpëtojnë. Megjithatë si mund të jetë kaq e lehtë? Në mënyrë që të praktikojë kultivim, dikush duhet të ketë trup njeriu. Prandaj, kjo është njëra nga arësyet pse disa praktikues qigongu janë zotëruar nga shpirtra dhe kafshë.

Disa njerëz mund të mendojnë, “Përderisa ka kaq shumë Qënie të Shumëlartësuar dhe mjeshtër të niveleve të larta, pse nuk e zgjidhin ata këtë çështje?” Ekziston një parim tjetër në universin tonë: Nëqoftëse ti ndjek apo dëshiron diçka, të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë. Këtu, ne po ju mësojmë të gjithëve të ndjekin rrugën e virtytshme dhe në të njejtën kohë ne po ju shpjegojmë Ligjin me themel që t’ju lejojmë të lartësoheni shpirtërisht vetë. Është puna juaj në dëshironi ta mësoni atë. Mjeshtri ju çon deri tek porta dhe e keni në dorë ju vetë të praktikoni kultivim. Askush nuk do t’ju detyrojë të praktikoni kultivim. Është puna juaj në praktikoni kultivim. Me fjalë të tjera, askush nuk do të ndërhyjë në cilën rrugë ti vetë merr, apo në atë që ti përpiqesh të arrish. Ne vetëm mund t’i këshillojmë njerëzit të bëhen të mirë.

Megjithëse ju njihni disa njerëz që praktikojnë qigong, energjia e tyre në fakt vjen nga shpirtrat zotërues dhe kafshët. Si e merr dikush shpirtin apo kafshën zotëruese? Sa praktikues qigongu në gjithë vendin kanë shpirt apo kafshë zotëruese në trupat e tyre? Po të tregoja numrin, shumë njerëz do të tmerroheshin aq shumë sa nuk do të praktikonin qigong. Numri është tmerrësisht i madh! Pra pse ndodh kjo situatë? Këto gjëra po shkaktojnë shqetësime dhe në shoqërinë njerëzore. Pse po bëhet ky kaq fenomen serioz? Kjo shkaktohet dhe nga vetë njerëzit përderisa njerëzimi është në degjenerim dhe djajtë janë kudo. Veçanërisht, të gjithë ata mjeshtër qigongu që janë të rremë kanë shpirtra dhe kafshë zotëruese në trupat e tyre dhe po i transmetojnë ato me mësimet e tyre. Gjatë gjithë historisë njerëzore, kafshëve ju është ndaluar të zotërojnë njerëzit. Kur e bënin këtë, ato vriteshin; kushdo që e shihte këtë nuk do e lejonte. Megjithatë, në shoqërinë tonë sot, disa njerëz u luten atyre për ndihmë, i duan ato dhe u falen atyre. Disa njerëz mund të mendojnë. “Unë nuk po kërkoja këtë!” Ti nuk kërkoje atë, por ti kërkoje aftësi supernormale. A do të t’i jepte ty ato një Qënie e Shumëlartësuar nga një praktike e virtytshme kultivuese? Përndjekja e qëllimshme është një dëshirë e njerëzve të zakonshëm dhe kjo dëshirë duhet të hiqet. Pra kush ti jep ty ato? Vetëm djajtë nga dimensione të tjera dhe kafshët e ndryshme mund të t’i japin ty ato. A nuk është kjo njësoj sikur ti të kërkosh zotërim nga shpirtrat apo kafshët? Pastaj, ato do të vinë.

Sa njerëz praktikojnë qigong me mendime të mira? Praktika qigongut kërkon që personi të vlerësojë virtytin, të kryejë vepra të mira dhe të jetë dashamirës. Ai duhet të sillet në këtë mënyrë në çdo gjë dhe në të gjitha llojet e rrethanave. Pamvarësisht në praktikojnë qigong në park apo shtëpi, sa njerëz mendojnë në këtë mënyrë? Askush nuk e di çfarë lloj qigongu praktikojnë disa njerëz. Ndërsa është duke praktikuar dhe duke përkulur trupin, personi mëmërit, “Oh, nusja ime nuk më respekton.” “Vjehrra ime është kaq e keqe!” Disa njerëz madje komentojnë çdo gjë—nga vendi punës deri tek punët e qeverisë. Nuk ka gjë që ata nuk do e përflasin dhe zemërohen keqas kur diçka nuk u shkon me mënyrën e tyre të mendimit. A do e quanit ju këtë praktikë qigongu? Akoma më keq, një person i tillë praktikon një ushtrim aty me këmbët që i dridhen nga lodhja. Megjithatë mëndja e tij nuk është e qetë: “Sot gjërat janë kaq të shtrenjta dhe çmimet po rriten. Ndërmarrja nuk më paguan dot më. Pse nuk po zhvilloj dot disa aftësi supernormale nga praktika qigongut? Po zhvillova aftësi supernormale, edhe unë do të bëhem mjeshtër qigongu dhe do të bëhem i pasur. Unë mund të shihja pacientë dhe të bëja para.” Sapo të shikojë që të tjerët kanë zhvilluar aftësi supernormale, ai bëhet akoma më me padurim. Ai do shkojë pas aftësive supernormale duke ndjekur Syrin Qiellor dhe aftësinë për të

shëruar sëmundje. Pa mendojeni të gjithë: Sa larg është kjo nga Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), karakteristika e universit tonë! Kjo shkon plotësisht në drejtim të kundërt me të. Që ta themi seriozisht, ky person praktikon kultivim të lig! Megjithatë ai e bën këtë pa e ditur. Sa më shumë që mendon ai në këtë mënyrë, aq më e keqe bëhet mendja e tij. Ky person nuk e njeh Ligjin dhe nuk e njeh vlerën e virtytit. Pastaj ai mendon se mund të zhvillojë energji vetëm duke bërë ushtrimet dhe se ai mund të arrijë çfarë të dojë nëpërmjet përndjekjes së qëllimshme. Kështu mendon ky person.

Është pikërisht për shkak të qëllimeve të këqija të personit që ai i sjell vetes gjëra të këqija. Por një kafshë e sheh këtë: “Ky person dëshiron të bëjë pasuri nëpërmjet praktikës së qigongut. Ai tjetri don të bëhet i famshëm dhe të ketë aftësi supernormale. Për be, trupi i tij nuk ka të sharë dhe gjithashtu përmban shumë gjëra të mira. Por mendjen e ka me të vërtetë të keqe dhe ndjek aftësitë supernormale! Ai mund të ketë një mjeshtër, por edhe sikur të ketë mjeshtër, unë nuk kam frikë.” Kafsha e din që një mjeshtër nga një praktikë kultivuese e vërtetë nuk do t’i japë atij individit aftësi supernormale kur të shohë që ai i ndjek ato në atë mënyrë. Sa më shumë që ai i ndjek ato, aq më pak do t’i japë atij mjeshtri i tij, sepse është pikërisht kjo dëshirë që duhet të hiqet. Sa më shumë që ai mendon në këtë mënyrë, aq më pak aftësi supernormale ai merr dhe aq më e pamundur bëhet që ai ta kuptojë këtë. Sa më shumë që ai i ndjek ato, aq më e keqe bëhet mendja e tij. Së fundi, pasi të shohë që ky person nuk ka më shpresë, mjeshtri i tij do e lërë atë duke psherëtirë dhe nuk do kujdeset më për të. Disa njerëz nuk kanë mjeshtër dhe me siguri që kanë ndonjë mjeshtër kalimtar që kujdeset për ta, sepse ka plot Qënie të Shumëlartësuara në dimensione të ndryshme. Një Qënie e Shumëlartësuar mund të tregojë interes për një person dhe ta ndjekë atë për një ditë. Më pas qenia e lartë mund ta lërë atë pasi të shohë që ai nuk është i mirë. Ditën tjetër një qënie tjetër e lartë mund të kalojë aty pranë dhe ai do të largohet pasi të zbulojë që ky individ nuk është i mirë.

Kafsha e din që si të jetë ndonjë mjeshtër apo si të jetë ndonjë mjeshtër kalimtar, mjeshtri nuk do t’i japë atij ato që ai ndjek. Meqenëse kafshët nuk janë në gjendje të shohin dimensionet ku rrinë Qënie të Shumëlartësuara, ato nuk kanë frikë dhe ato përfitojnë nga një hallkë e dobët: ekziston një parim në universin tonë që normalisht njerëzit e tjerë nuk mund të ndërhyjnë në çfarëdo që personi ndjek dhe në atë që ai dëshiron për veten. Kafsha përfiton nga kjo hallkë e dobët —“Nëqoftëse ai dëshiron diçka, unë do t’ja jap. Nuk është gabim për mua t’a ndihmoj atë, apo jo?” Kafsha do t’ja japë atij. Në fillim, kafsha nuk guxon ta zotërojë atë dhe do t’i japë në fillim energji që ta provojë. Një ditë papritmas personi do të ndjejë energjinë që ka kërkuar dhe po ashtu mund të shërojë sëmundje. Me të parë që kjo po funksionon, kafsha do e përdorë këtë si prelud muzikor para se të fillojë shfaqja e vërtetë, “Përderisa ai e don këtë, unë do t’i ngjitem në trup. Në këtë mënyrë unë mund t’i jap atij më shumë gjëra dhe ta bëj këtë më me lehtësi. A nuk dëshiron ai Syrin Qiellor? Tani unë do t’i jap atij çdo gjë.” Kështu do e zotërojë atë.

Ndërsa mendja e këtij person mendon për të marrë gjëra, Syri i tij Qiellor hapet dhe ai gjithashtu mund të lëshojë energji me disa aftësi të vogla supernormale. Ai gëzohet shumë dhe mendon se më në fund ai ka arritur atë që kërkonte nëpërmjet praktikës. Në fakt, ai nuk ka arritur asgjë nëpërmjet praktikës së tij. Ai mendon se mund të shikojë përmes trupit të njeriut dhe të zbulojë ku qëndron sëmundja në trupin e dikujt. Në fakt, Syri i tij Qiellor nuk është hapur aspak; është ajo kafsha që kontrollon mendjen e tij. Kafsha reflekton çfarë sheh me sytë e vet në trurin e tij, kështu ai mendon se është hapur Syri i tij Qiellor. “Don të lëshosh gong? Jëpi.” Kur ai nxjerr dorën për të lëshuar energjinë, kafsha gjithashtu zgjat putrën e vet nga mbrapa. Sapo ai lëshon energjinë, gjuha e mprehtë do dalë nga koka e gjarprit për të lëpirë pjesën e sëmurë apo pjesën e enjtur të pacientit. Ka plot raste të tilla dhe këta persona të gjithë kanë marrë zotërim shpirti apo kafshe nga përndjekjet e tyre.

Kështu ky person i përndjek gjërat, shkon pas pasurisë dhe famës dhe arriti aftësi supernormale. Ai mund të trajtojë sëmundje dhe Syri i tij Qiellor mund të shikojë gjëra. Kjo e bën atë

shumë të lumtur. Kafsha e shikon këtë, “a nuk don ti të bësh pasuri? Shkëlqyeshëm, do të të lejoj të bësh para.” Është shumë e lehtë të manipulosh mendjen e një personi të zakonshëm. Kafsha mund të bëjë shumë njerëz, plot prej tyre, të vijnë tek ai për trajtim. Për be, ndërsa ai trajton një sëmundje këtu, kafsha i bën reporterët e gazetave të vënë reklama në gazeta atje. I manipulon njerëzit e zakonshëm të bëjnë këto gjëra. Nëqoftëse një pacient nuk i paguan atij para sa duhet, nuk lejohet; kafsha do e bëjë pacientin me dhimbje koke. Pra njerëzit duhet t’i paguajnë atij shumë para. Ai ka arritur si famë ashtu dhe pasuri me paratë e bëra dhe famën e rritur. Ai gjithashtu është bërë tashmë mjeshtër qigongu. Normalisht, një person i tillë nuk vlerëson karakterin dhe guxon të thotë çdo gjë. Ai do e konsiderojë veten më të mirë se çdo person në Qiell, duke guxuar të pretendojë se ai është Nëna Mbretëreshë¹² apo Perandori Gurçmuar¹³ i ringjallur. Ai madje do të guxojë ta quajë veten Buddhë. Ngaqë ai nuk ka kaluar në kultivim karakteri, ai ndjek aftësitë supernormale në praktikë. Për pasojë, ai i sjell vetes zotërim nga shpirtrat apo kafshët.

Disa njerëz mund të mendojnë, “E ç’ të keqe ka këtu? Ja vlen për aq kohë sa mund të bëhen para dhe pasuri dhe të rrisë famën.” Shumë njerëz mendojnë në këtë mënyrë. Më lejoni t’ju them të gjithëve se kafsha ka në fakt qëllimin e vet dhe nuk do t’ju japë gjë pa ndonjë qëllim. Ky univers ka një parim: “pa humbje nuk ka fitim”. Çfarë merr ajo? A nuk e diskutova unë këtë çështje? Don të marrë esencën në trupin tuaj kështu që mund të kultivojë një formë njerëzore dhe mbledh esencën njerëzore nga trupi personit. Trupi i njeriut ka vetëm këtë masë esence. Nëqoftëse dikush dëshiron të praktikojë kultivim, ekziston vetëm kjo masë. Po e lejove kafshën që ta marrë atë, harroje praktikën kultivuese. Si do mund të praktikosh kultivim ti? Ty nuk të ka mbetur gjë dhe nuk mund të praktikosh kultivim aspak. Disa njerëz mund të pretendojnë: “Unë nuk dua të praktikoj kultivim dhe vetëm dua të bëj para. Për sa kohë të kem para, jam në rregull. Kush don t’ja dijë!” Po ju them se ju mund të doni të bëni pasuri, por nuk do të mendoni kështu kur t’ju them arsyen. Pse? Nëqoftëse e lë trupin tuaj herët, do t’i ndjeni gjymtyrët tuaj shumë të dobët. Më pas, do mbeteni kështu për gjithë jetën sepse ka marrë shumë nga esenca juaj. Nëqoftëse e lë trupin tuaj vonë, ti do mbetesh i paralizuar dhe mbetesh në shtrat për gjithë jetën vetëm me një fije frymë. Megjithëse ti ke para, a je në gjendje t’i përdorësh ato? Megjithëse ke famë, a e gëzon dot? A nuk është kjo e frikëshme?

Këto raste janë veçanërisht të dukshme tek praktikuesit sot dhe ato janë të shumta. Një kafshë jo vetëm mund të magjepsë një person, por gjithashtu mund të vrasë Shpirtin Primordial të personit dhe të futet në majën *niwan*¹⁴ dhe qëndrojë aty. Megjithëse personi duket si qenie njerëzore, ai nuk është i tillë. Edhe gjëra të tilla mund të ndodhin në kohën e sotme. Kjo ndodh sepse vlerat morale të njeriut kanë ndryshuar. Kur dikush bën diçka të keqe, ky person nuk do e besonte po t’i thojë se po bën diçka të keqe. Ai mendon se është e drejtë dhe e ndershme të bësh para, ndjekësh paranë, apo të bësh pasuri dhe se kjo është sjellje korrekte. Kështu ai do lëndojë dhe dëmtojë të tjerët. Që të bëjë para ai do të kryejë çdo lloj mëkati dhe do guxojë të bëjë çdo gjë. Pa humbur diçka, kafsha nuk do të marrë gjë. Si mund të të japë ty diçka për asgjë? Don të marrë gjëra nga trupi jot. Sigurisht, ne e kemi thënë se dikush ka këto probleme sepse vlerat dhe mendja e tij nuk janë të drejta apo të virtytshme.

Ne po ju mësojmë Falun Dafën. Në praktikën kultivuese të shkollës sonë, ju nuk do të keni ndonjë problem për sa kohë që ju silleni mirë sepse një mendje e virtytshme mund të mundë njëqind të liga. Nëqoftëse ju nuk mund të silleni mirë dhe shkoni pas kësaj apo asaj, ju me siguri keni për të pasur probleme. Disa njerëz nuk mund të heqin dorë nga ajo që praktikonin më parë. Ne kërkojmë që njerëzit të praktikojnë vetëm një mënyrë kultivimi sepse në praktikën e vërtetë kultivuese kjo është e domosdoshme. Megjithëse disa mjeshtër qigongu kanë shkruar libra, po ju them se ato libra përmbajnë të gjitha llojet e gjërave dhe janë të njejtat gjëra që ata praktikojnë: ato janë gjarpërinj, dhelpra dhe nuselale. Kur ti lexon ato libra, këto gjëra do dalin nga fjalët. Unë e kam thënë që

¹² Nëna Mbretëreshë—në mitologjinë kineze, perëndi femër me nivelin më të lartë brenda Tre Hapësirave.

¹³ Perandori Gurçmuar—në mitologjinë kineze, perëndia që kujdeset për Tre Hapësirat.

¹⁴ *niwan* (ni-uan)—term Taoist për gjendrën pineale.

mjeshtrit e rremë qigong i kalojnë në numër ata të vërtetët shumë herë dhe ju nuk jeni të aftë t'i dalloni ata. Prandaj, ju duhet të dini çfarë po bëni. Unë nuk them që ju duhet të praktikoni Falun Dafën; ju mund të praktikoni në çdo shkollë që dëshironi. Por ka qënë një thënie në të kaluarën: “Dikush më mirë do të donte të mos praktikonte një mënyrë të vërtetë për një mijë vjet sesa të kultivonte një praktikë dhelpre vetëm për një ditë.” Kështu, personi duhet të sillet mirë dhe me të të vërtetë të praktikojë kultivim në një mënyrë të virtytshme. Mos e përzjeni atë me ndonjë gjë tjetër në kultivim, as dhe me ndonjë mendim. Falunët e disa individëve janë shtrembëruar. Pse janë shtrembëruar ato? Ata pretendojnë se nuk kanë praktikuar qigong tjetër. Megjithatë kurdo kur ata praktikojnë në mëndjen e tyre ata shtojnë gjëra nga praktikat e tyre të mëparshme. A nuk po ia shtoni ju ato praktikës? Kaq do të themi për çështjen e shpirtave apo kafshëve zotëruese.

Gjuha Kozmike

Çfarë është “gjuha kozmike”? Kjo është kur papritmas një person mund të flasë një gjuhë të panjohur. Ai mëmërit diçka që as ai vetë nuk e kupton. Dikush me aftësi telepatike mund të kapë idenë e përgjithshme por nuk mundet të thotë në mënyrë specifike çfarë po flet ky person. Gjithashtu, disa njerëz mund të flasin disa gjuhë të ndryshme. Disa madje e quajnë këtë si një gjë të jashtëzakonshme dhe e konsiderojnë atë si zotësi apo aftësi supernormale. Kjo nuk është as aftësi supernormale dhe as aftësi e zotësie një praktikuesi; dhe as nuk mund të përfaqësojë nivelin e personit. Atëhere, çfarë është kjo? Kjo ndodh ngaqë mëndja juaj po kontrollohet nga një shpirt i huaj. Megjithatë juve mund t'ju duket përsëri gjë e mirë dhe mund ta dëshironi atë, sepse jeni i gëzuar që e keni. Sa më shumë që jeni i kënaqur, aq më mirë ju kontrollon ai juve. Si praktikues i vërtetë, si mund ta lejoni ju atë t'ju kontrollojë? Aq më tepër, ai vjen nga një nivel shumë i ulët. Si praktikues të vërtetë, ne nuk duhet t'i ftojmë këto probleme.

Meqenëse janë shpirti i të gjithë materies, qëniet njerëzore janë tepër të çmuara. Si mund të kontrolloheni ju nga këto gjëra? Sa keq që ju u jepni atyre trupin tuaj! Disa nga këto gjëra i ngjiten trupave të njerëzve. Disa nuk e bëjnë këtë por qëndrojnë në një distancë nga njerëzit, por ato përsëri ju manipulojnë dhe kontrollojnë juve. Kur ti don ta flasësh atë, ata do të lejojnë ta flasësh dhe mëmëritësh. Gjuha mund t'i kalohet dhe një personi tjetër nëse personi don ta mësojë atë. Kur ky person ka guximin ta provojë, ai apo ajo gjithashtu do e flasë atë. Në fakt, këto gjëra vijnë në grupe. Kur ti dëshiron ta flasësh atë, një do të vijë dhe do të të lejojë ta flasësh atë.

Pse ndodh kjo? Siç e kam thënë, ata duan të ngrenë nivelin e tyre. Por atje tek ata nuk ka vështirësi, kështu ata nuk mund të praktikojnë kultivim dhe përmirësojnë veten. Ata kanë dalë me një ide—t'i ndihmojnë njerëzit të bëjnë vepra të mira për të tjerët. Por ata nuk dinë si ta bëjnë këtë. Megjithatë ata e dinë se energjia që lëshojnë mund të kufizojë sëmundjen e një pacienti dhe mund ta lehtësojë vuajtjen e pacientit për momentin megjithëse nuk mund ta kurojë sëmundjen. Në bazë të kësaj, ata e dinë që kjo mund të arrihet duke përdorur gojën e një personi për të lëshuar energji. Kështu pra shfaqet ky fenomen. Disa njerëz e quajnë këtë gjuhë qiellore dhe ka të tjerë të cilët e quajnë atë gjuha Buddhës. Unë e quaj këtë çmenduri të plotë!

Dihet se një Buddha nuk e hap gojën rastësisht për të folur. Po ta hapte ai gojën dhe të fliste në dimensionin tonë, ai mund t'i shkaktonte një tërmet njerëzimit. Me zë kaq të lartë, si mund të lejohej kjo? Disa njerëz thonë, “Syri im Qiellor ka parë një Buddha që fliste me mua.” Ai nuk fliste me ty. Gjithashtu disa njerëz panë fashën tim duke folur. As ai nuk po fliste me ju. Mesazhi që ai jep është në tingull stereo. Kur ti e dëgjon atë, të duket sikur ai të flet. Ai zakonisht flet në dimensionin e vet. Megjithatë, pasi transmetohet këtu, ti nuk mund të dëgjosh qartë çfarë ai thotë sepse konceptet e

kohës dhe hapësirës janë të ndryshme në dy dimensionet. Një *shichen*¹⁵ në dimensionin tonë është dy orë. Në atë dimension të madh, një shichen i jonë është një vit dhe koha jonë është më e ngadaltë sesa koha atje.

Ekzistonte një thënie në të kaluarën: “Vetëm një ditë në qiell, por kanë kaluar një mijë vjet në tokë.” Kjo i referohet parajsave të veçanta të cilat nuk kanë konceptin e kohës dhe hapësirës. Më saktë ato janë parajsa ku rrinë Qëniët e Shumëlartësuarat, si Parajsa e Lumturisë Absolute, Parajsa e Xhamtë, Parajsa e Falunit dhe Parajsa e Lotusit. I referohet këtyre vendeve. Megjithatë, në atë dimension të madh, koha është më e shpejtë se koha jonë. Nëqoftëse je i aftë të marrësh mesazhin, ti mund të dëgjosh dikë duke folur. Disa njerëz kanë aftësinë e dëgjimit nga dimensione të tjera dhe ju janë hapur Veshët Qiellorë. Ata janë të aftë të dëgjojnë dikë duke folur por jo qartë. Çfarëdo që ti dëgjon do të të ngjajë me cicërimën e zogut apo me mbledhjen e një shiriti manjetofoni me shpejtësi; nuk mund ta dallosh çfarë thuhet. Sigurisht, disa njerëz mund të dëgjojnë muzikë dhe të folur. Por ndryshimi i kohës duhet eliminuar nëpërmjet një aftësie supernormale e cila shërben si përçues. Atëhere zëri mund të arrijë ty në vesh dhe ti mund ta dëgjosh atë qartë. Ndodh pikërisht kështu. Disa njerëz e quajnë gjuha e Buddhës, Por nuk është aspak kështu.

Kur dy Qënie të Shumëlartësuarat takohen me njëri tjetrin, ata mund të kuptojnë çdo gjë me një buzëqeshje. Kjo ndodh për shkak të telepatisë mendore dhe ajo që merret është në tingull stereo. Kur ata buzëqeshin, idetë e tyre janë komunikuar tashmë. Kjo nuk është metoda e vetme që ata përdorin, sepse ngandonjëherë ata përdorin një mënyrë tjetër. Ju e dini që në Tantrizëm, lamat tibetanë i kushtojnë shumë vëmendje përdorimit të shenjave me duar. Por po e pyete një lama çfarë janë shenjat e duarve, ai do të përgjigjet se ato janë joga më e lartë. Për çfarë janë ato më saktësisht? As ai nuk e di. Në fakt, ato janë gjuha e Qënieve të Shumëlartësuarat. Kur ka shumë njerëz, ata përdorin shenjat e mëdha të duarve; ato janë shumë të bukura dhe përbëhen nga disa shenja të mëdha duarsh. Kur ka vetëm pak njerëz, ata përdorin shenjat e vogla të duarve; dhe ato janë shumë të bukura dhe përbëhen nga disa shenja të vogla duarsh. Ato janë shumë të sofistikuarat dhe të pasura sepse përbëjnë një gjuhë. Në të kaluarën, ky ka qënë një sekret qiellor dhe tani unë e zbulova para jush. Ato që përdoren në Tibet janë vetëm pak lëvizje për praktikë dhe njerëzit i kanë klasifikuar e i kanë kthyer ato në një sistem. Ato vetëm shërbejnë si gjuhë në praktikë dhe janë vetëm pak forma për praktikë. Lëvizjet e vërteta të duarve janë tepër të sofistikuarat.

Çfarë i Jep Mësuesi Praktikuesve?

Pasi më takojnë mua, disa njerëz ma mbajnë dorën fort e nuk e lëshojnë. Kur të tjerët i shohin këta persona duke më dhënë dorën edhe ata më japin dorën. Unë e di çfarë kanë ata në mendje. Disa persona janë mjaft të gëzuar t'i shtrëngojnë dorën Mësuesit. Disa persona duan të marrin mesazhe e nuk e lëshojnë dorën time. Ne ju kemi thënë se praktika e vërtetë kultivuese është puna juaj. Ne nuk jemi këtu për shërim sëmundjesh e mbajtje trupi në formë apo për t'ju dhënë juve ca mesazhe dhe për t'ju shëruar sëmundjet tuaja; dhe as që jemi ne të preokupuar me këto gjëra. Sëmundjet tuaja do të shërohen direkt nga unë. Ata që praktikojnë në vendet tona të ushtrimeve do t'i shërohen sëmundjet nga Fashen e mi. Ata që studjojnë Dafën individualisht duke lexuar librin gjithashtu do të kenë Fashen e mi për t'i shëruar sëmundjet. A mendoni se do të rrisni gongun duke prekur dorën time? A nuk është kjo për të qeshur?

Gong varet nga kultivimi i karakterit tuaj. Nëqoftëse ju nuk praktikoni kultivim me të vërtetë, gong nuk rritet; kjo ndodh për shkak se ekziston një standart për karakterin. Ndërsa gongu juaj rritet, një qënie e nivelit të lartë do të shikonte se kur vesi juaj, një substancë, hiqet, një shkop matës rritet

¹⁵ *shichen* (shichen)—një njësi kineze kohe prej dy orësh.

mbi kokë. Po ashtu ky shkop ekziston në formën e kolonës gongut. Shkopi është aq i lartë sa dhe kolona juaj e gongut. Ai përfaqëson gongun që ti ke kultivuar. Po ashtu ai përfaqëson lartësinë e nivelit tuaj të karakterit. Nuk do të funksiononte pamvarësisht sa mund ta shtonin njerëzit e tjerë. Nuk mund të shtohet as edhe pak, sepse nuk do të qëndronte dot atje dhe do të binte i gjithi. Unë mund t'ju bëj që të arrini menjëherë stadin e “Tre Luleve mbi Kokë (*sanhua juding*)”. Megjithatë, me të dalë jashtë kësaj dere gongu do të binte sepse nuk është juaji dhe nuk është nga kultivimi juaj. Ngaqë standarti i karakterit tuaj nuk është akoma atje, ai nuk mund të qëndrojë atje. Kushdo që do të donte t'ja u shtonte nuk do të arrinte ta bënte sepse ai vjen plotësisht nga kultivimi juaj dhe nga kultivimi i mëndjes suaj. Ju mund të ngjiteni lart vetëm duke zhvilluar gongun me këmbëngulje, duke përmirësuar veten vazhdimisht dhe duke ju asimiluar karakteristikës së universit. Disa njerëz më kërkojnë autograf, por unë nuk dua t'ja u jap. Disa persona mburren se kanë autografin e Mësuesit. Ata duan ta tregojnë për mburrje apo duan mesazhin e Mësuesit që t'i mbrojnë. A nuk është kjo një dëshirë tjetër? Ju duhet të praktikoni kultivim vetë. Për çfarë mesazhesh e keni fjalën? A duhet t'i kërkonte ju këto në kultivimin e nivelit të lartë? Për çfarë vlejné ato? Ato janë diçka vetëm për shërim dhe mbajtje të trupit në formë.

Në një nivel shumë mikroskopik, gongu që ju zhvillon, apo çdo pjesëz mikroskopike nga ai gong, ka plotësisht pamjen tuaj. Pas arritjes në stadin e Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe, ju do të praktikoni kultivim të një trupi Buddhe. Ai gong do të marrë pamjen e një Buddhe. Ky është shumë i bukur, i ulur mbi një lule lotusi. Çdo pjesëz mikroskopike ka atë pamje. Ndërsa gongu i një kafshe është diçka si dhelprë apo gjarpërinj të vegjël. Në një nivel shumë mikroskopik, pjesëzat e tyre të imta kanë pamjen e tyre. Ekzistojnë dhe ato që quhen mesazhe. Disa njerëz përzejnë çaj dhe ju kërkojnë ta pini sepse gjoja është gong. Një njeri i zakonshëm vetëm dëshiron të çlirohet nga dhimbjet përkohësisht duke e shtyrë apo kufizuar sëmundjen e tij. Mbi të gjitha një njeri i zakonshëm është një njeri i zakonshëm. Ne nuk jemi të preokupuar se si e ngatërron ai trupin e tij. Ju jeni praktikues. Prandaj jau them këto gjëra. Që sot e tutje ju nuk duhet t'i bëni këto gjëra. Kurrë mos kërkonte gjëra të tilla si “mesazhe”, këtë gjë apo atë gjë. Një mjeshtër qigongu pretendon, “Unë ju jap mesazhe dhe ju i merrni ato nga çdo pjesë e vendit.” Çfarë merrni ju? Ju them se këto gjëra nuk kanë ndonjë përdorim. Ta zëmë se janë të mira, ato përsëri janë vetëm për shërim dhe mbajtje të trupit në formë. Si praktikues, gongu jonë vjen nga kultivimi ynë. Mesazhet nga njerëzit e tjerë nuk mund të rrisin nivelin e dikujt, por vetëm të trajtojnë sëmundje për njerëzit e zakonshëm. Personi duhet të mbajë mëndje të virtytshme; askush nuk mund të praktikojë kultivim për një tjetër. Vetëm duke praktikuar kultivim vetë me të vërtetë, mundet që ju të ngrini nivelin tuaj.

Çfarë ju kam dhënë unë juve atëhere? Të gjithë e dinë se shumë nga kultivuesit tanë nuk kanë praktikuar qigong kurrë dhe trupat e tyre kanë sëmundje. Megjithëse plot njerëz kanë praktikuar qigong për shumë vjet, ata akoma mbeten në nivelin e qi-së pa marrë ndonjë gong. Sigurisht, disa njerëz kanë trajtuar pacientë pa ditur si e bënë atë. Kur fola për çështjen e zotërimit nga shpirtrat apo kafshët, unë i hoqa shpirtrat apo kafshët zotëruese—pamvarësisht se çfarë të ishin ato—nga trupat e praktikuesve të vërtetë të Dafës dhe unë i kam hequr të gjitha këto gjëra brenda apo jashtë trupave të tyre. Kur ata që praktikojnë kultivim vetë me të vërtetë lexojnë këtë Ligj të Lartë, unë do t'i pastroj edhe trupat e tyre. Po ashtu ambjenti i shtëpisë tuaj gjithashtu duhet të pastrohet. Menjëherë ju duhet të hidhni tabelat përkujtimore¹⁶ për dhelprën apo nuselalën që i keni shenjtëzuar më parë. Ato janë hequr të gjitha dhe nuk ekzistojnë më. Meqenëse ju dëshironi të praktikoni kultivim, ne mund të hapim për ju portën më të përshtatshme dhe këto gjëra për rrjedhojë mund të bëhen për ju. Megjithatë ato mund të bëhen vetëm për praktikuesit e vërtetë. Sigurisht, disa njerëz nuk duan të praktikojnë kultivim dhe deri në këtë çast as nuk e kuptojnë atë. Kështu ne nuk mund të kujdesemi për ta. Ne vetëm kujdesemi për praktikuesit e vërtetë.

¹⁶ tabelë përkujtimore—tabelë e shenjtëruar druri në shtëpi për t'ju lutur të parëve apo shpirtrave të tjerë në shtëpi.

Ekziston dhe një tip tjetër personi. Dikujt i ishte thënë në të kaluarën se ai kishte shpirt apo kafshë zotëruese. Ai ndjente të njejtën gjë. Megjithatë pas heqjes së tyre, atij përsëri i rrinte mendja aty. Ai gjithmonë mendonte se gjendja ishte akoma e njejtë. Ai akoma mendon se i ka ato dhe ky ves quhet dyshim. Me kalimin e kohës, ky person mund t'ja sjellë përsëri vetes. Personi duhet të heqë dorë nga ky ves, sepse ai shpirt apo kafshë zotëuese nuk ekziston më. Disa njerëz ishin pastruar nga këto gjëra në klasat e mëparëshme. Unë i kisha bërë tashmë këto gjëra për ta dhe i kisha hequr të gjithë shpirtrat apo kafshët zotëruese.

Shkolla Tao kërkon hedhjen e një themeli në praktikën në nivel të ulët. Kështu Qarku Qiellor, *dantian*¹⁷ dhe disa gjëra të tjera duhet të zhvillohen. Këtu ne do t'ju pajisim juve me Falun, *qiji*¹⁸, të gjithë mekanizmat për praktikë kultivuese e plot gjëra të tjera—më shumë se dhjetë mijë prej tyre. Ato do t'ju jepen të gjitha juve si fara që mbillen në trupin tuaj. Pasi të heqim sëmundjet tuaja, unë do të bëj çfarëdo që duhet bërë dhe do t'ju jap juve çfarëdo që duhet t'ju jepet. Pastaj, ju do të jeni në gjendje që me të vërtetë të vazhdoni praktikën tuaj kultivuese në shkollën tonë deri në fund. Përndryshe, pa ju dhënë juve gjë, kjo do të ishte vetëm për shërim dhe mbajtje të trupit në formë. Singërisht, disa njerëz nuk e vlerësojnë karakterin dhe ata do të ishin më mirë të bënë ushtrime fizike.

Nëqoftëse ju me të vërtetë praktikoni kultivim, ne duhet të jemi të përgjegjshëm ndaj jush. Ata praktikues që mësojnë vetë gjithashtu do të marrin të njejtat gjëra, por ata duhet të jenë praktikues të vërtetë. Ne ja u japim të gjitha këto gjëra praktikuesve të vërtetë. Unë kam thënë që duhet me të vërtetë t'ju trajtoj si dishepujt e mi. Po ashtu, ju duhet të studjoni Ligjin e nivelit të lartë me thellësi dhe të dini si të praktikoni kultivim. Pesë ushtrimet do t'ju mësohen të gjitha në të njejtën kohë dhe ju do t'i zotëroni ato të gjitha. Me kohë, ju do të jeni të aftë të arrini një nivel shumë të lartë—një nivel aq i lartë sa është përtej imagjinatës suaj. Për aq kohë që praktikoni kultivim, nuk do jetë problem për ju të arrini Shkallën e Duhur në kultivim. Në mësimin e këtij Ligji, unë kam përfshirë nivele të ndryshme. Në praktikën tuaj kultivuese të ardhshme në nivele të ndryshme, ju do të shihni se ajo do t'ju udhëheqë juve gjithmonë.

Si praktikues, rruga juaj e jetës do të ndryshohet që nga ky moment e tutje. Fashen im do ta riorganizojë atë për ju. Si riorganizohet ajo? Sa vjet ka akoma një person për të jetuar? Personi nuk e din këtë vetë. Disa persona mund të marrin një sëmundje serioze pas një viti apo gjysmë viti, apo mund të kenë një sëmundje për disa vjet. Disa njerëz mund të pësojnë trompozë cerebrale apo sëmundje të tjera dhe nuk mund të lëvizin fare. Si mund të praktikosh ti kultivim më tutje në jetë? Ne duhet t'i rregullojmë të gjitha këto për ju dhe t'i parandalojmë këto gjëra që të mos ndodhin. Megjithatë, ne duhet ta bëjmë të qartë që më përpara që ne mund t'i bëjmë këto gjëra vetëm për praktikuesit e vërtetë. Këto nuk lejohen të bëhen shkarazi për njerëzit e zakonshëm. Përndryshe, është njëllë sikur të bësh një gjë të keqe. Për njerëzit e zakonshëm, fenomene si lindja, plakja, sëmundjet dhe vdekja kanë të gjitha lidhje shkakore karmike dhe nuk mund të prishen sipas dëshirës.

Ne i konsiderojmë praktikuesit si njerëzit më të çmuar. Kështu, ne mund të bëjmë gjëra vetëm për praktikuesit. Si i bëjmë ne ato? Nëqoftëse një mjeshtër ka virtyt të madh—domethënë, nëqoftëse një mjeshtër ka fuqi të madhe gongu—ky mjeshtër mund të eliminojë karmën tuaj. Nëqoftëse niveli i energjisë së një mjeshtri është i lartë, ai mund të eliminojë më shumë nga karma jote. Nëqoftëse niveli i energjisë së një mjeshtri është i ulët, ai mund të eliminojë më pak nga karma jote. Le të marrim një shembull. Ne do të mbledhim gjithë karmën e ndryshme të jetës suaj të ardhshme dhe eliminojmë një pjesë të saj apo gjysmën e saj. Gjysma që mbetet është akoma më e madhe se një mal dhe ju nuk mund ta përballoni atë. Çfarë duhet bërë? Kur ju të arrini Taon, shumë njerëz do të përfitojnë në të ardhmen. Kështu, shumë njerëz mund të durojnë një pjesë për ty. Sigurisht, nuk është asgjë për ta. Nëpërmjet praktikës ju gjithashtu do të zhvillonit shumë qenie në trupin tuaj. Përveç

¹⁷ *dantian*—“fushë dan-i”; pjesa poshtme e barkut.

¹⁸ *qiji* (çi-xhi)—“mekanizma energjie”.

Shpirtit tuaj Kryesor dhe Shpirtit tuaj Ndhmës, janë dhe shumë ju që do të përballojnë një pjesë për ty. Nuk do të mbetet pothuajse asgjë për ty gjatë kohës që kalon vështirësi. Megjithëse nuk ka mbetur pothuajse asgjë, është akoma plot dhe ti je akoma i paaftë ta kapërcesh. Atëhere çfarë ndodh? Ajo do të ndahet në pjesë të shumta për faza të ndryshme të praktikës tënde kultivuese. Ato do të përdoren që të rrisësh karakterin tënd, të transformosh karmën tënde dhe rrisësh gongun.

Pra nuk është gjë e lehtë nëqoftëse dikush dëshiron të praktikojë kultivim. E kam thënë që kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Është diçka përtej njerëzve të zakonshëm dhe më e vështirë se çdo gjë njerëzore. A nuk është kjo mbinatyrale? Prandaj, kërkesa për ty është më e lartë se çdo gjë njerëzore. Si qenie njerëzore, ne kemi Shpirt Primordial dhe Shpirti Primordial nuk zhduket. Nëqoftëse Shpirti Primordial nuk zhduket, mendojeni pak të gjithë: A nuk ka kryer Shpirti juaj Primordial vepra të këqija gjatë marëdhënieve shoqërore në një jetë të mëparshme? Ka shumë mundësi. Ju mund të keni kryer gjëra si vrasje, i keni borxh dikujt, keni keqtrajtuar dikë, apo dëmtuar dikë. Nëqoftëse kjo është e vërtetë, kur ju praktikoni kultivim këtu, ata mund t'ju shikojnë qartë nga atje. Atyre nuk u bëhet vonë nëqoftëse ju po shëroni sëmundje apo mbani trupin në formë. Sepse ata e dinë që ju vetëm po e shtyni borxhin. Nëqoftëse nuk e paguani tani, ju do e paguani atë më vonë dhe ju do paguani më shumë për të në të ardhmen. Kështu ata nuk merakosen nëqoftëse ju nuk e paguani në moment.

Kur ti thua se do të praktikosh kultivim, ata nuk do të të lejojnë ta bësh, “Ti don të praktikosh kultivim dhe të ikësh. Kur ti të kesh zhvilluar gong, ne nuk do të mundim të të arrijmë apo prekim dot ty.” Ata nuk do e lejojnë këtë të ndodhë dhe do provojnë çdo gjë të të ndalojnë ty të praktikosh kultivim. Për pasojë, të gjitha mënyrat do të përdoren për të ndërhyrë ty. Ata madje do të vijnë edhe të të vrasin. Sigurisht, koka jote nuk do të këputet këtu ndërsa ti je ulur në meditim. Kjo është e pamundur sepse gjërat duhet të përputhen me mënyrën e shoqërisë njerëzore. Mbase ti do të goditesh nga një makinë sapo të dalësh nga dera, apo mund të biesh nga ndonjë ndërtesë apo ndeshesh me rreziqe të tjera. Gjëra të tilla mund të ndodhin dhe do të jenë mjaft të rrezikshme. Praktika kultivuese e vërtetë nuk është aq e lehtë sa e imagjinoni. A mendoni se nëqoftëse ju dëshironi të praktikoni kultivim ju do arrini ta bëni? Me të dëshiruar që të praktikoni kultivim të vërtetë, jeta juaj do të jenë në rrezik menjëherë dhe kjo do të ndodhë shpejt. Shumë mjeshtër qigongu nuk guxojnë t'i mësojnë nxënësit e tyre drej nivelesh të larta. Pse? Ata nuk mund ta zgjidhin këtë çështje dhe ata nuk mund të të mbrojnë ty.

Në të kaluarën ka pasur shumë persona që i mësonin njerëzve Taon. Ata mund të mësonin vetëm një dishepull dhe mund të kujdeseshin vetëm për një dishepull. Përsa i përket përhapjes së saj në një shkallë të gjërë, një person mesatar nuk do guxonte ta bënte atë. Por ne po ju themi juve këtu se unë mund ta bëj këtë, sepse unë kam Fashen të shumtë të cilët kanë fuqinë time hyjnore të plotfuqishme. Ata mund të tregojnë fuqi të mëdha mbinatyrale—fuqi të plotfuqishme të Ligjit. Po ashtu, kjo që ne po bëjmë sot nuk është dhe aq e thjeshtë sa ajo që shihet në sipërfaqe. Unë nuk isha kokënxehtë kur dola në publik. Unë mund t'ju them se shumë Qënie të Shumëlartësuar janë duke e vëzhguar këtë ngjarje. Kjo është hera e fundit që ne po përhapim një mësim të vërtetë në Periudhën e Fund-Dharmës. Kur e bëjmë këtë, ne gjithashtu nuk lejojmë të devijojë. Nëqoftëse ju ndiqni me të vërtetë rrugën e virtytshme në praktikën kultivuese, askush nuk do të guxojë t'ju bëjë gjë juve sipas dëshirës. Përveç kësaj, ju keni mbrojtjen e Fashen të mi dhe juve nuk do t'ju kanoset ndonjë rrezik.

Çfarë është borxh duhet paguar. Prandaj disa rreziqe mund të ndodhin gjatë periudhës së kultivimit. Megjithatë, kur këto gjëra ndodhin, ju nuk do të frikësoheni dhe as do të lejohet që t'ju kanoset ndonjë rrezik i vërtetë. Po ju jap disa shembuj. Kur jepja një klasë në Beijing, një praktikues kalonte rrugën me biçikletë. Në një kthesë, një veturë luksoze vjen dhe e hedh përtokë këtë praktikues, një grua kjo mbi pesëdhjetë vjeçe. Përplasat me të dhe e godet me shumë forcë. Më një zhurmë “bam”, i godet kokën dhe koka e saj shkon e godet drejt e tek pjesa e sipërme e makinës. Në atë kohë këmbët e kësaj praktikuese ishin akoma tek pedalet. Megjithëse koka e saj u godit, ajo nuk

ndjeu ndonje dhimbje. Jo vetëm që nuk ndjeu ndonjë dhimbje, por koka e saj as nuk u gjakos dhe as nuk u enjt. Shoferi u frikësua për vdekje dhe kërcëu jashtë nga makina. Ai e pyeti me nxitim atë nëse ishte vrarë dhe i sugjeroi të shkonin në spital. Ajo iu përgjigj se ishte në rregull. Sigurisht, kjo praktikuese kishte nivel karakteri shumë të lartë dhe nuk do e fuste shoferin në telashe. Ajo tha se çdo gjë ishte në rregull por përplasja la një të shtrembëruar të madhe në makinë.

Të gjitha këto gjëra vijnë të marrin jetën e personit. Por personi nuk do të rrezikohet. Herën e fundit që mbajtëm një klasë në Universitetin Jilin, një praktikues shtynte biçikletën ndërsa po kalonte në hyrjen kryesore të Universitetit. Sapo doli në mes të rrugës, papritmas dy vetura e futën në mes. Veturat për pak e goditën atë, por ai nuk u frikësua aspak. Normalisht, ne nuk frikësohemi fare kur na ndodhin gjëra të tilla. Pikërisht në atë moment, veturat ndaluan dhe asgjë nuk ndodhi.

Pati një rast të tillë në Beijing. Errësohet mjaft herët në dimër dhe njerëzit bien të flenë shpejt. Rrugët janë shumë të qeta pa këmbë njeriu. Një praktikues po shpejtonte për në shtëpi me biçikletë dhe vetëm një xhip ishte duke shkuar para tij. Papritmas, xhipi frenoi. Ai nuk e vuri re këtë dhe vazhdoi t'i japë biçikletës përpara me kokën ulur. Kur papritmas xhipi filloi të shkonte mbrapsht dhe ecte me një shpejtësi shumë të madhe. Po të puqeshin dy forcat, do t'i kishte kushtuar jetën atij. Pikërisht përpara se të përplaseshin, një forcë papritmas e tërhoqi biçikletën e tij më shumë se një gjysmë metri dhe xhipi menjëherë ndaloi tek rrota e biçikletës. Mbase shoferi i xhipit vuri re se dikush ishte prapa tij. Ky praktikues nuk u frikësua në atë moment. Të gjithë ata që kanë hasur në këto situata nuk frikësohen, megjithëse mund të frikësoheshin më mbrapa. Gjëja e parë në mendjen e tij ishte, "U! Kush më tërhoqi mbrapsht? Duhet ta falenderoj." Kur ktheu kokën dhe u bë gati të falenderonte, ai pa që rruga ishte shumë e heshtur pa asnjëri rreth e rrotull. Ai e kuptoi menjëherë, "Ishte Mësuesi që më mbroi!"

Një rast tjetër ndodhi në Changchun. Një ndërtesë pranë shtëpisë së një praktikuesi ishte në ndërtim. Në kohën tonë ndërtesat janë shumë të larta dhe panelet janë prej shufrash hekuri me diametër pesë centimetra dhe katër metra të gjata. Pasi ky praktikues kishte ecur një distancë të shkurtër nga shtëpia, një shufër hekuri ra vertikalisht nga ndërtesa e lartë drejt e në kokë të tij. Njerëzit në rrugë u shtangën të gjithë. Ai tha, "Kush më preku?" Ai mendoi se dikush e preku në kokë. Në atë moment, ai ktheu kokën dhe pa një Falun të madh që rrotullohesh mbi kokën e tij. Shufra e hekurit rrëshqiti përgjatë kokës dhe u ngul në tokë me majë. Po t'i ishte ngulur trupit të personit—mendojeni pak të gjithë—do e shponte trupin tejpertej si të shponte shalqi sepse ishte shumë e rëndë. Ishte kaq e rrezikshme!

Ka qaq shumë raste të tilla sa nuk mund të numërohen. Megjithatë asnjë rrezik nuk ju kanoset. Jo të gjithë do të ndeshen me gjëra të tilla, por disa individë do të ndeshen me to. Nëse ju do të ndesheni me to apo jo, unë mund t'ju siguroj se ju nuk do të jeni në ndonjë rrezik të vërtetë—unë ja u garantoj këtë. Disa praktikues nuk ndjekin kërkesat e karakterit e ata vetëm bëjnë ushtrimet pa kultivuar karakterin e tyre. Ata nuk mund të konsiderohen si praktikues.

Për sa i përket asaj çfarë ju ka dhënë Mësuesi juve, këto janë ato që ju kam dhënë. Fashen i im do t'ju mbrojnë derisa ju të jeni në gjëndje të mbroni veten. Në atë kohë, ju do të praktikoni kultivim në Ligj-Përtej-Botës-Trefishe dhe ju do të keni arritur të kultivoni Taon. Por ju duhet ta trajtoni veten si praktikues të vërtetë dhe atëherë mund t'ja arrini qëllimit. Njëri ecte në rrugë me librin tim në dorë dhe bërtiste, "Unë kam mbrojtjen e Mësuesit Li, kështu unë nuk kam frikë se me shtyp makina." Kjo është njësoj si të sabotosh Dafën. Ky lloj personi nuk do të mbrohet. Në fakt, një praktikues i vërtetë nuk do e bënte një gjë të tillë.

Fusha Energjisë

Kur ne praktikojmë, ka një fushë rreth nesh. Çfarë fushe është ajo? Disa njerëz e quajnë fushë qi-je, fushë magnetike, apo fushë elektrike. Në fakt, është gabim çfarëdo lloj që ta quajmë atë përderisa materia që gjendet në këtë fushë është jashtëzakonisht e pasur. Pothuajse të gjitha llojet e materies që përbëjnë çdo dimension të universit tonë mund të gjenden në këtë gong. Është më e përshtatshme që ne ta quajmë atë fushë energjie dhe kështu ne e quajmë atë fushë energjie.

Pra çfarë efekti ka kjo fushë? Siç e dini të gjithë, praktikuesit tanë të kësaj mënyre të vërtetë kanë ketë ndjenjë: Meqenëse vjen nga kultivimi i një mënyre të vërtetë, është mëshirëplotë dhe e asimiluar në Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), karakteristikën e universit. Prandaj, të gjithë praktikuesit tanë mund ta ndjejnë këtë ndërsa janë në këtë fushë dhe nuk kanë mendime të këqija në mendje. Po ashtu, ndërsa rrinë ulur këtu shumë vetëve as dhe u shkon mendja të pinë duhan. Ata ndjejnë një atmosferë të qetë dhe paqësore, e cila është shumë e rehatshme. Kjo është energjia që ka një praktikues i një mënyre të vërtetë dhe këtë efekt ka ajo brenda kufijve të kësaj fushe. Më vonë, pas kësaj klase, shumica e praktikuesve tanë do të kenë gong—energjinë e zhvilluar dhe të vërtetë. Meqenëse ajo që po ju mësoj unë është diçka nga një kultivim i një mënyre të vërtetë, edhe ju duhet të zbatoni këtë standart karakteri ndaj vetes. Ndërsa ju vazhdimisht praktikoni dhe ndiqni kërkesat tona të karakterit në praktikën kultivuese, energjia juaj do të bëhet gradualisht më e fuqishme.

Ne mësojmë shpëtim të vetes dhe të të tjerëve, pra dhe të gjitha qënieve. Kështu, Falun i afron shpëtim personin kur rrotullohet nga brenda dhe i afron të tjerëve shpëtim kur rrotullohet nga jashtë. Kur rrotullohet nga jashtë, lëshon energji dhe mund të përfitojnë të tjerët. Në këtë mënyrë brenda fushës që arrin energjia juaj, të tjerët do të përfitojnë dhe ata mund të ndjehen shumë mirë. Qoftë kur ju jeni duke ecur në rrugë, në punë, apo në shtëpi, ju keni këtë efekt tek të tjerët. Njerëzve brenda fushës suaj mund t’i shërohen sëmundjet pa dashje sepse kjo fushë mund të ndreqë të gjitha gjendjet anormale. Një trup njeriu nuk duhet të sëmurë dhe të qenit sëmurë është një gjendje anormale. Kjo gjendje anormale mund të korigjohet. Kur një person me mendje të ligë mendon diçka të keqe, mendja e këtij personi mund të ndryshojë nga efekti i fuqishëm i fushës suaj; ai mund të mos mendojë më të kryejë gjëra të këqija. Mbase një person dëshiron të flasë keq për dikë. Papritmas, ai mund të ndryshojë mendjen e tij dhe nuk do të shajë më. Vetëm një fushë energjie nga një praktikë kultivuese e vërtetë mund të ketë këtë efekt. Prandaj, në të kaluarën ekzistonte kjo thënie në Buddhizëm: “Drita Buddhës shkëlqen kudo dhe korigjon të gjitha anomalitë.” Ky është kuptimi.

Si Duhet ta Përhapin Praktikën Praktikuesit e Falun Dafës

Pas kësaj klase, shumë nga nxënësit tanë mendojnë që kjo praktikë është shumë e mirë dhe ata duan t’ja mësojnë të afërmeve apo miqve të tyre. Po, të gjithë mund ta përhapni dhe mund t’ja mësoni kujtdo. Por ka një gjë që ne duhet t’ja bëjmë të ditur të gjithëve. Ne i kemi dhënë secilit kaq shumë gjëra që nuk mund të maten apo vlerësohen me para. Pse ia jap unë këto të gjithëve? Ato janë për praktikën tuaj kultivuese. Vetëm po praktikuat kultivim, mundet t’ju jepen këto gjëra. Me fjalë të tjera, kur ju shpërndani praktikën në të ardhmen, ju nuk mund t’i përdorni këto gjëra për të kërkuar famë apo për interesin tuaj. Kështu, ju nuk mund të hapni ndonjë klasë dhe të merrni para siç bëj unë. Meqenëse neve na duhet të shtypim libra dhe materiale dhe të udhëtojmë për të mësuar praktikën, ne na duhet të mbulojmë shpenzimet. Çmimet tona janë tashmë më të ultat në vend, megjithatë gjërat që jepen janë më të shumtat në numër. Ne me të vërtetë po i sjellim njerëzit drejt niveleve të larta; secili e din këtë gjë vetë. Si praktikues i Falun Dafës, kur ju shpërndani praktikën në të ardhmen, ne kemi dy kërkesa për ju.

E para është që ju nuk mund të merrni para. Ne ju kemi dhënë kaq shumë gjëra, por ato nuk janë që ju të bëni pasuri apo të bëni emër. Përkundrazi, ato janë për shpëtimin tuaj dhe për t'ju bërë juve të aftë për të praktikuar kultivim. Po të merrni para, Fashen i im do t'ju marrë të gjitha ato që ju janë dhënë dhe ju nuk do të jeni më praktikues i Falun Dafës sonë. Ajo që keni përhapur nuk është Falun Dafa jonë. Kur ju e shpërndani atë, ju nuk duhet të keni pikësynime për famë apo përfitim personal, por duhet t'i shërbeni të tjerëve vullnetarisht. Të gjithë praktikuesit po e bëjnë atë kështu në të gjithë vendin dhe ndihmësit në të gjitha zonat kanë dhënë këtë shembull. Nëqoftëse dëshironi të mësoni praktikën tonë, ju mund të vini kur të doni ta mësoni atë. Ne do jemi të përgjegjshëm ndaj jush dhe nuk do t'ju marrim as edhe një qindarkë.

Kërkesa e dytë është që ju nuk duhet t'i shtoni gjëra personale Dafës. Me fjalë të tjera, gjatë mësimin të ushtrimeve, pamvarësisht nëse ju është hapur Syri Qiellor, ju keni parë diçka, apo ju keni zhvilluar ndonjë aftësi supernormale, ju nuk mund të përdorni çfarë keni parë për të shpjeguar Falun Dafën tonë. Ajo pak gjë që keni parë në nivelin tuaj nuk është asgjë dhe larg kuptimit të vërtetë të Ligjit që ju mësojmë ne. Kështu kur ju shpërndani praktikën në të ardhmen, duhet të jeni shumë të kujdesshëm me këtë çështje. Vetëm duke bërë këtë mund të sigurohemi që gjërat origjinale në Falun Dafa mbeten të pandryshuara.

Po ashtu, askush nuk lejohet t'u mësojë praktikën njerëzve në mënyrën si e bëj unë dhe askush nuk lejohet të mësojë Ligjin në këtë format leksioni të zgjeruar që përdor unë. Ju nuk mund ta mësoni Ligjin. Kjo për arsye se ajo që ju mësoj unë ka shumë kuptime të thella dhe unë kam inkorporuar gjëra të niveleve të larta aty. Ju praktikoni kultivim në nivele të ndryshme. Në të ardhmen pasi ju të përparoni, ju do të vazhdoni të përmirësoheni kur të dëgjoni përsëri rregjistrimin e këtij leksioni. Ndërsa ju do e dëgjoni vazhdimisht atë, ju gjithmonë do të keni kuptime të reja dhe përfitime të reja. Aq më shumë kur lexoni këtë libër. Ky mësimi im ju mësohet duke inkorporuar diçka thelbësore të niveleve shumë të larta. Prandaj, ju nuk mund ta mësoni këtë Ligj. Juve nuk ju lejohet ta thoni atë me fjalët e mia origjinale sikur ato të ishin tuajat, përndryshe do të ishte vjedhje e Ligjit. Ju mund të përdorni fjalët e mia origjinale ta shprehni atë vetëm kur shtoni se kështu e thotë Mësuesi këtë apo kështu është e shkruar në libër. Ju mund ta thoni vetëm kështu. Pse? Sepse kur e thoni kështu do të ketë fuqinë e Dafës. Ju nuk mund të shpërndani gjërat që ju dini si Falun Dafa. Përndryshe, ajo çfarë përhapni nuk është Falun Dafa dhe ajo që bëni është njëllë si të sabotoni Falun Dafën. Nëqoftëse thoni diçka sipas ideve dhe mendjes suaj, ai nuk është Ligji dhe nuk mund të shpëtojë njerëz dhe as do ketë ndonjë efekt. Prandaj, askush tjetër nuk mund ta japë mësim këtë Ligj.

Mënyra si duhet ta transmetosh ti këtë praktikë është duke vënë kasetat apo video-kasetat për nxënësit në vendet e ushtrimeve dhe ndihmësit mund t'u mësojnë atyre ushtrimet pastaj. Ju mund të përdorni formën e seminarit që të gjithë të komunikojnë me njeri tjetrin dhe ju mund të diskutoni dhe shkëmbeni mendime me njeri tjetrin. Ne kërkojmë që ju ta bëni në këtë mënyrë. Po ashtu ju nuk mund ta quani një praktikues (dishepull) që transmeton Falun Dafën "Mësues" apo "Mjeshtër", sepse ka vetëm një mjeshtër në Ligjin e Lartë. Të gjithë praktikuesit janë dishepuj, pamvarësisht kur filluan praktikën.

Kur ju përhapni praktikën, disa njerëz mund të mendojnë, "Mësuesi mund të vendosë Falun dhe përshtasë trupat e njerëzve, kurse ne nuk e bëjmë dot këtë." Nuk ka gjë. Unë ju kam thënë që prapa çdo praktikuesi është Fashen im dhe jo vetëm një. Kështu Fashen im do të kujdeset për këto gjëra. Kur ju i mësoni dikujt praktikën, ai do të marrë në vend Falun nëqoftëse ai ka lidhje të paracaktuara nga fati. Nëqoftëse nuk ka ndonjë lidhje të mirë të paracaktuar nga fati, ai mund ta marrë atë gradualisht pas një periudhe praktike dhe pasi t'i jetë përshtatur trupi. Fashen im do ta ndihmojë atë të përshtasë trupin e tij. Përveç këtyre gjërave, unë po ju them se nëqoftëse një person e mëson Ligjin dhe praktikën duke lexuar librin tim, duke shikuar videot e mia, apo duke dëgjuar kasetat e mia dhe nëqoftëse ai e trajton veten si praktikues të vërtetë, ai gjithashtu mund të marrë gjërat që meriton.

Ne nuk lejojmë që praktikuesit të shikojnë pacientë, sepse praktikuesit e Falun Dafës janë absolutisht të ndaluar për të trajtuar sëmundjet e njerëzve të tjerë. Ne po ju mësojmë juve të ngjiteni në kultivim dhe nuk ju lejojmë që të zhvilloni ndonjë dëshirë apo të shkatërroni trupin tuaj. Vendet tona të ushtrimeve janë më të mira se ato të çdo lloj ushtrimi tjetër qigongu. Për aq kohë sa ju shkoni në vendet e ushtrimeve tona për të praktikuar, kjo është shumë më mirë sesa trajtimi i sëmundjeve tuaja. Fashen e mij janë të ulur në një rreth dhe mbi vendin e ushtrimeve gjendet një mburojë mbi të cilën ndodhet një Falun i madh. Një Fashen i madh ruan vendin mbi mburojën. Ky vend ushtrimesh nuk është i zakonshëm dhe as nuk është ai një vend ushtrimesh praktike qigongu të zakonshëm: Ai është vend për praktikë kultivuese. Shumë nga praktikuesit tanë me aftësi supernormale kanë parë që vendi ushtrimeve të Falun Dafës është i rrethuar me dritë të kuqe dhe është i gjithi i kuq.

Fashen im mund të vendosë Falun për një praktikues, por ne nuk ja u inkurajojmë dëshirën. Kur ti i mëson dikujt ushtrimet, ai mund të thotë, “Oh, unë kam Falun tani.” Ti gabimisht mendon se ja vendose ti, kur kjo nuk është e vërtetë. Po ja u them këtë kështu që ju të mos zhvilloni këtë dëshirë. Të gjitha bëhen nga Fashen im. Kështu duhet ta përhapin praktikën praktikuesit tanë të Falun Dafës.

Kushdo që do të provonte të ndryshonte ushtrimet e Falun Dafës do e dëmtonte Dafën dhe këtë shkollë praktike. Disa njerëz i kanë kthyer instruksionet e ushtrimeve në rimë dhe kjo nuk lejohet aspak. Një mënyrë kultivimi e vërtetë kalohet gjithmonë që nga kohërat parahistorike. Ajo është ruajtur nga një kohë tepër e largët dhe ka kultivuar me sukses shumë Qenie të Shumëlartësuar. Askush nuk guxon ta ndryshojë atë as edhe pak. Kjo mund të ndodhë vetëm në Periudhën e Fund-Dharmës. Këto gjëra nuk kanë ndodhur kurrë në histori. Secili duhet të jetë shumë i kujdesshëm me këtë çështje.

LEKSIONI I KATËRT

Humbja dhe Fitimi

Në komunitetin e kultivuesve, lidhja ndërmjet humbjes dhe fitimit përmendet shpesh. Gjithashtu, ajo diskutohet edhe midis njerëzve të tjerë. Si duhet t'i trajtojnë praktikuesit tanë humbjet dhe fitimet? Ndryshe nga njerëzit e zakonshëm. Ajo që njerëzit duan është fitimi dhe si të jetojnë mirë dhe në rehati. Praktikuesit tanë nuk janë kështu por krejtësisht e kundërta. Ne nuk kërkojmë atë që duan njerëzit e zakonshëm. Përkundrazi, ajo që arrijmë ne është diçka që njerëzit e zakonshëm nuk e marrin dot—edhe sikur ata të donin—veçse po e arritën me praktikë kultivuese.

Humbja në kuptimin tonë nuk është humbje në kuptim të ngushtë. Kur një njeri flet për humbje, ai mendon për të dhuruar ca para, të ndihmojë ata që kanë nevojë, apo t'i japë diçka një lypësi në rrugë. Edhe këto janë një formë dhënie dhe një formë humbjeje. Sidoqoftë kjo i referohet vetëm të qenurit më pak të interesuar për para apo pasuri. Të heqesh dorë nga pasuria është natyrisht, një aspekt humbjeje dhe relativisht një aspekt gjithashtu i rëndësishëm. Por humbja së cilës i referohemi ne nuk kufizohet tek ky kuptim i ngushtë. Si praktikues, gjatë kultivimit ne kemi kaq shumë vese për të braktisur, si psh. mentalitetin për tu dukur, xhelozinë, mentalitetin e konkurrencës dhe zellin e tepruar. Shumë vese të ndryshme duhet të braktisen, pasi humbja për të cilën flasim ne është humbje në kuptim më të gjërë. Gjatë gjithë kohës së kultivimit, ne duhet të heqim dorë nga të gjitha veset dhe dëshirat e ndryshme të njerëzve të zakonshëm.

Dikush mund të pyesë: “Ne praktikojmë kultivim midis njerëzve. Nëse ne humbim gjithshka, a nuk jemi ne njëllor si murgjit apo murgeshat? Është e pamundur të humbësh gjithshka.” Në shkollën tonë të praktikës, ata që praktikojnë kultivim midis njerëzve të zakonshëm kërkohet të praktikojnë kultivim pikërisht në shoqërinë e zakonshme njerëzore dhe të përshtaten mes njerëzve të zakonshëm sa më shumë që të jetë e mundur. Juve në të vërtetë nuk ju kërkohet të humbni ndonjë gjë materialisht. Nuk ka rëndësi se sa e lartë është pozita juaj apo sa shumë pasuri ju keni. Thelbi është nese ju mund ta braktisni atë dëshirë.

Shkolla jonë e praktikës synon drejtpërdrejt mendjen e individit. Çështja thelbësore është nëse ju mund ta merrni lehtëshëm dhe të mos merakoseni për çështjet që lidhen me fitimin personal dhe konfliktet me të tjerët. Praktikant kultivues në tempuj apo në male dhe pyje të largëta ju veçojnë plotësisht nga shoqëria njerëzore, duke ju detyruar kështu të humbni dëshirat e njerëzve të zakonshëm dhe duke ju mohuar çfarëdo fitimi material kështu që ju t'i humbni ato. Një praktikues në mes të njerëzve të zakonshëm nuk ndjek këtë rrugë. Këtij personi i kërkohet t'i marrë gjërat lehtëshëm në ambjentin e përditshëm njerëzor. Sigurisht, kjo është shumë e vështirë. Gjithashtu ky është aspekti më thelbësor i shkollës sonë të praktikës. Prandaj, humbja së cilës i referohemi ne është humbje në kuptimin e gjërë të fjalës e jo në atë të ngushtë. Le të flasim pak për kryerjen e veprave të mira dhe dhurim parash apo gjërash të tjera. Sot, disa nga lypësat që shikoni në rrugë janë profesionistë dhe madje mund të kenë më shumë para se ju. Ne duhet të përqëndrohemi në gjërat e mëdha e jo në ato të vogla. Praktika kultivuese duhet të përqëndrohet në perspektivën e gjërë të gjërave dhe ta bëjë këtë në mënyrë të hapur dhe me dinjitet. Kur ne humbim gjëra, ato që humbim janë në të vërtetë gjëra të këqija.

Njerëzit shpesh besojnë që çdo gjë që ata kërkojnë me insistim është e mirë. Në fakt, nga një perspektivë e një niveli të lartë, ato janë për të kënaqur ato pak interesa personale midis njerëzve të zakonshëm. Fetë e ndryshme kanë thënë që pavarësisht nga sa shumë para që ju keni apo sa e lartë është pozita juaj, ato vlejné vetëm për pak dhjetë-vjeçarë. Njeriu nuk mund t'i sjellë me vete ato kur lind apo t'i marrë ato me vete pas vdekjes. Pse është gongu kaq i çmuar? Pikërisht sepse ai rritet drejt e mbi trupin e Shpirtit tuaj Primordial dhe sillet në lindje dhe merret me vete pas vdekjes. Për më

teper, ai percakton drejteperdrejt Shkallen e Arritjes se kultivimit tuaj dhe prandaj eshte shume i veshtire per t'u kultivuar. Me fjalë të tjera, ajo që ju humbni është diçka e keqe. Kështu, ju mund të ktheheni në origjinë, në veten tuaj të vërtetë. Pra çfarë fitoni ju? Përmirësimin e nivelit tuaj; së fundi ju arrini Shkallën e Duhur dhe përfundoni kultivimin, duke zgjidhur kështu problemin themelor. Natyrisht, nuk do të jetë e lehtë për ju që menjëherë të hiqni dorë nga të gjitha llojet e dëshirave të njerëzve të zakonshëm dhe të arrini standartin e një praktikuesi të vërtetë, sepse kjo kërkon kohë të arrihet. Kur ju më dëgjoni mua që them don kohë, ju mund të thoni që Mësuesi na ka thënë që kjo don kohë dhe kështu ju do ta merrni me ngadalë. Kjo nuk lejohet! Ju duhet të jini strikt me veten megjithëse ne ju lejojmë që të përmisoheni gradualisht. Sikur të gjithë ju të mund ta arrinit atë sot, ju do të ishit Buddhë sot. Prandaj, kjo nuk është e mundur. Ju do të mund ta arrini atë gradualisht.

Ajo që ne humbim është në fakt diçka e keqe. Çfarë është ajo? Është karmë dhe shkon hap pas hapi me veset e ndryshme të njerëzve. Për shembull, njerëzit e zakonshëm kanë mendime nga më të këqijat. Për interesa personale, ata kryejnë një sërë veprash të këqija dhe nga kjo ata mbledhin këtë substancë të zezë, karmën. Kjo ka të bëjë drejtëpërdrejtë me mëndjet tona. Me qëllim që të eliminoni këtë gjë negative, ju fillimisht duhet të ndryshoni mëndjen tuaj.

Transformimi i Karmës

Ekziston një proces transformimi ndërmjet substancës së bardhë dhe substancës së zezë. Kur ndodh një konflikt ndërmjet dy personave, ndodh dhe ky proces transformimi. Kur një individ kryen një vepër të mirë, ai merr substancë të bardhë, virtyt. Kur një individ kryen një vepër të keqe, ai merr substancë të zezë, karmë. Ekziston gjithashtu dhe një proces trashëgimie. Dikush mund të pyesë, “A ndodh kjo për shkak se individi ka bërë gjëra të këqija në jetën e tij të mëparshme?” Mund të mos jetë pikërisht kështu sepse karma nuk akumulohet vetëm gjatë një jetë. Komuniteti i kultivuesve beson që Shpirti Primordial nuk zhduket. Nëse një Shpirt Primordial nuk zhduket, atëherë personi me siguri ka pasur lidhje shoqësore përpara kësaj jete. Kështu, personi mund t'i ketë borxh dikujt tjetër, të ketë keqtrajtuar dikë, apo të ketë bërë gjëra të tjera të këqija, si vrasje, e cila do të shkaktonte këtë karmë. Këto gjëra mblidhen në një dimension tjetër dhe njerëzit i mbartin ato gjithmonë me vete. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për substancën e bardhë. Ky nuk është burimi i vetëm pasi ekziston gjithashtu dhe një situatë tjetër. Gjatë gjithë brezave të një familjeje, paraardhësit gjithashtu mund të akumulojnë karmë për brezat e mëvonshëm. Në të kaluarën, të moshuarit thonin: “Njeriu duhet të bledhë virtyt dhe të parët e dikujt kanë mbledhur virtyt. Ky person po fal virtyt dhe ky po shpërdoron virtyt.” Këto ishin thënie shumë të sakta. Në ditët e sotme, njerëzit nuk ia venë më veshin këtyre thënieve. Nëse ju i flisni të rinjve për humbje virtyti apo mungesë virtyti, ata nuk do të preken fare. Në fakt, kuptimi i saj është me të vërtetë shumë i thellë. Virtyti nuk është thjesht një koncept apo standart shpirtëror i njerëzve modernë por është në fakt një material që ekziston me të vërtetë. Trupat tanë fizikë i kanë të dyja këto lloj substancash.

Dikush pyet, “Është e vërtetë që nëse një njeri ka shumë substance të zezë është e pamundur për të që të praktikojë në nivele të larta?” Mund të jetë ashtu sepse me tepër substancë të zezë, cilësia e ndriçimit shpirtëror të personit do të ndikohej. Meqenëse ajo formon një fushë rreth trupit të njeriut dhe e mbështjell njeriun drejt e në mes, ai është kështu i shkëputur nga Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), karakteristika e universit. Pra, ndriçimi shpirtëror i këtij njeriu mund të jetë i ulët. Kur njerëzit flasin për praktikë kultivuese dhe qigong, ky individ do t'i konsiderojë të gjitha këto si paragjykime dhe nuk do t'i besojë ato aspak. Ai do t'i shohë ato si qesharake. Zakonisht ndodh kështu por kjo nuk është absolute. A do të ishte tepër e veshtirë për këtë person që të praktikonte kultivim dhe se ai nuk do të ishte në gjëndje të arrinte gong të nivelit të lartë? Jo, nuk është ashtu. Ne kemi thënë se Ligji i Lartë është i pakufishëm dhe se varet plotësisht nga zemra juaj për të praktikuar

kultivim. Mjeshtri ju çon deri tek porta dhe varet nga vetë ju për të praktikuar kultivim. Gjithçka varet nga ju vetë sesi praktikoni kultivim. Nëse ju mund të praktikoni kultivim varet e gjitha nga sa ju mund të duroni, sakrifikoni dhe vuani. Nëse ju e vendosni në mëndje, asnjë vështirësi nuk mund t'ju ndalojë. Unë do të thoja që nuk do kishte asnjë problem.

Një personi me shumë substance të zezë normalisht do t'i duhet të sakrifikojë me shumë se sa një personi me shumë substance të bardhë. Pasi substanca e bardhë është drejtëpërdrejtë e asimilueshme në karakteristikën e universit, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), për aq kohë që një person përmirëson karakterin e tij gjatë konflikteve, gongu i tij do të rritet. Është kaq e thjeshtë. Një person me shumë virtyt ka cilësi të mirë ndriçimi shpirtëror. Ai mund të vuajë dhe durojë si vështirësi fizike ashtu dhe mendore. Edhe sikur ky njeri të vuajë më shumë fizikisht sesa mendërisht, gongu përsëri do t'i rritet. Kjo nuk ndodh për një person me shumë substance të zezë sepse ai së pari duhet të kalojë gjatë këtij procesi: Ai duhet të transformojë substancën e zezë në substancë të bardhë. Ky proces është gjithashtu shumë i dhimbshëm. Prandaj, një person me cilësi të ulët ndriçimi shpirtëror zakonisht duhet të vuajë më shumë vështirësi. Me shumë karmë dhe cilësi të ulët ndriçimi shpirtëror është më e vështirë për këtë person të praktikojë kultivim.

Marrim një rast të veçantë si shembull. Le të shohim se si praktikon kultivim ky person. Meditimi ulur kërkon vendosjen e të dyja këmbëve mbi njëra tjetrën për një periudhë kohe të gjatë. Këmbët do të dhëmbin dhe mpihen pasi të marrin këtë pozicion. Me kalimin e kohës, personi do të fillojë të mos ndjehet rehat dhe më pas dhimbja bëhet e padurueshme. Vuajtja fizike dhe mendore mund të bëjnë që si mëndja ashtu dhe trupi, të vihen në gjendje mjaft të parehatshme. Disa njerëz nuk mund ta durojnë dhimbjen kur ulen me këmbët kryq dhe ata do të duan të heqin dorë duke ulur këmbët. Disa të tjerë nuk durojnë dot pasi rrinë ulur për një kohë pak më të gjatë. Po u ulën këmbët, praktika është e kotë. Kur këmbët fillojnë të dhëmbin, personi do të bëjë disa shtriqje të këmbëve para së të rimarrë pozicionin e meditimit. Për mendimin tim kjo nuk ka asnjë vlerë. Kjo për arsyen se ne kemi parë që kur këmbët dhëmbin, substanca e zezë ka lëvizur tek këmbët. Substanca e zezë është karmë që mund të eliminohet nëpërmjet vuajtjes e më pas ajo mund të transformohet në virtyt. Sapo fillon dhimbja, karma fillon të eliminohet. Sa më shumë karmë vjen aq më shumë dhëmbin këmbët. Prandaj dhimbja në këmbë nuk fillon pa shkak. Zakonisht, gjatë meditimit këmbët tuaja do ta ndjejnë dhimbjen me intervale. Pas një momenti dhimbjeje të padurueshme, ajo mbaron dhe ka pak lehtësim. Menjëherë dhimbja fillon përsëri. Zakonisht ndodh kështu.

Ndërkohë që karma eliminohet pjesë-pjesë, këmbët do të ndjehen pak më mirë sa herë që eliminohet një pjesë. Sapo një pjesë tjetër karme arrin, këmbët do të dhëmbin përsëri. Kur substanca e zezë eliminohet, ajo nuk zhduket pasi kjo substancë nuk shduket. Sapo eliminohet ajo kthehet direkt e në substancë të bardhë, që është virtyt. Pse mund të transformohet në këtë mënyrë? Kjo ndodh për arsye se ky person ka vuajtur, sakrifikuar dhe duruar vështirësi. Ne e kemi thënë që virtyti merret nëpërmjet durimit dhe kalimit të vështirësive ose nga kryerja e veprave të mira. Prandaj, kjo situatë do të ndodhë gjatë meditimit ulur. Disa njerëz i ulin shpejt këmbët sapo ato fillojnë tu dhëmbin dhe bëjnë disa shtriqje përpara se të rimarrin pozicionin ulur. Kjo nuk do të arrijë as dhe një gjë. Gjatë kryerjes së ushtrimeve në këmbë, krahët e dikujt mund të lodhen nga pozicioni i mbajtjes së rrotës. Kur ai nuk e duron dot më dhe ul krahët poshtë, ai nuk arrin asgjë. E ç'është kjo pak dhimbje? Unë do të thoja që do ishte fare e lehtë që një njeri t'ja arrinte në kultivim vetëm duket mbajtur krahët lart. Kjo pra do të ndodhë kur njerëzit praktikojnë meditimin ulur.

Shkolla jonë e praktikës nuk procedon kryesisht në këtë mënyrë, megjithëse një pjesë e saj luan një rol në këtë aspekt. Në shumicën e rasteve, transformimi i karmës ndodh në konfliktet me njëri-tjetrit dhe kjo është mënyra sesi ajo manifestohet me shumë. Kur je në një konflikt me dikë, përplasjet me njëri-tjetrin ia kalojnë edhe dhimbjeve fizike. Unë do të thoja se dhimbjet fizike janë gjërat më të lehta për t'u duruar, pasi ato mund të mposhten duke shtrënguar fort dhëmbët. Kur një konflikt ndodh ndërmjet njëri-tjetrit, mëndja është gjëja më e vështirë për tu kontrolluar.

Për shembull, me të arritur në vendin e punës, një person do të nxehet kur dëgjon dy individë tek flasin shumë keq për të. Sidoqoftë, ne kemi thënë që si praktikues ju nuk duhet të kundërviheni kur ju godasin apo ju vënë në lojë por duhet të silleni me një standart të lartë. Kështu, ai mendon se Mësuesi ka thënë që si praktikues ne nuk duhet të jemi njëloj si të tjerët dhe se duhet të sillemi më mirë. Ai nuk do të grindet me këta dy persona. Por zakonisht kur del ndonjë problem, nëse problemi nuk e irriton personin psikologjikisht, ai nuk llogaritet apo është i kotë dhe nuk mund të bëjë që ai të përmirësohet. Për pasojë, atij nuk i hiqet mendja nga kjo dhe ajo vazhdon ta shqetësojë. Mundet që mendja ti rrijë po aty. Ai gjithmonë don të kthejë sytë të shikojë fytyrat e atyre të dyve. Me të kthyer kokën, ai sheh dy fytyrat e liga në një bisedë të zjarrtë. Ai nuk mund të durojë më dhe fillon të nxehet. Ai mandje mund të fillojë të zihet me ata në atë çast. Kur një konflikt ndodh midis njëri-tjerit është shumë e vështirë të kontrollosh mendjen. Unë them se do të ishte e lehtë sikur për çdo gjë të rregullohej gjatë meditimit; sidoqoftë jo gjithmonë do të ndodhë kështu.

Për pasojë, në të ardhmen gjatë praktikës suaj kultivuese, ju do të ndesheni me vështirësi nga më të ndryshmet. Si mund të praktikoni ju kultivim pa këto vështirësi? Nëqoftëse të gjithë jemi të mirë me njëri tjetrin pa konflikt interesash apo ndërhyrje që vijnë nga mendja juaj, si mundet të përparojë karakteri juaj vetëm duke qëndruar ulur aty dhe duke medituat? Kjo është e pamundur. Secili duhet me të vërtetë të kalisë dhe përmirësojë veten nëpërmjet praktikës. Dikush pyet: “Pse kemi ne gjithmonë probleme gjatë praktikës kultivuese? Ato probleme nuk duken shumë të ndryshme nga ato të njerëzve të zakonshëm.” Kjo ndodh sepse ju po praktikoni kultivim midis njerëzve të zakonshëm. Juve nuk do t’ju kapin për këmbësh e varin papritmas me kokën poshtë e t’ju lënë ashtu varur që të vuani—nuk ndodh ashtu. Çdo gjë do të marrë formën e situatave të përditshme, si për shembull, dikush mund t’ju ketë inatosur juve sot, dikush ju ka mërzhitur, dikush ju ka trajtuar keq, apo dikush ju flet pa pikë respekti. Kjo është për të parë se si do të reagoni ndaj këtyre problemeve.

Pse do të ndesheni ju me këto probleme? Ato shkaktohen të gjitha nga karma juaj. Ne tashmë kemi eliminuar shumë pjesë të panumërta të saj për ju, duke lënë vetëm atë pjesë të vogël të cilën e kemi shpërndarë si probleme në nivele të ndryshme për të përmirësuar karakterin tuaj, për të kalitur mendjen tuaj dhe për të hequr veset tuaja të ndryshme. Këto janë të gjitha problemet tuaja që ne i përdorim për të përmirësuar karakterin tuaj dhe ju do të jeni të aftë t’i kapërceni ato. Nëqoftëse ju përmirësoni karakterin tuaj, ju do t’i kapërceni ato. Tjetër punë nëse ju vetë nuk doni ta bëni këtë, po deshët ta bëni, ju do t’ja arrini qëllimit. Prandaj, duke filluar që sot kur ju ndesheni me një konflikt ju nuk duhet ta konsideroni atë si rastësi. Kjo për arsye se kur ndodh një konflikt, ai do të dalë papritur. Por ai nuk është rastësi—është për ju që të përmirësoni karakterin tuaj. Për aq kohë sa ju e konsideroni veten si praktikues, ju mund ta përballoni atë siç duhet.

Natyrisht, ju nuk do të informoheni për një hall apo konflikt më përpara. Si mund të praktikoni ju kultivim nëse çdo gjë ju thuhet para kohe? Nuk do të kishte asnjë vlerë. Ato zakonisht ndodhin papritur në mënyrë që ato mund të testojnë karakterin tuaj dhe bëjnë që ju me të vërtetë ta përmirësoni atë. Vetëm atëherë mund të shikohet nëse një njeri mund t’i përmbahet kërkesave të karakterit. Prandaj, kur lind një konflikt, ai nuk ndodh rastësisht. Kjo çështje do të jetë e pranishme gjatë tërë procesit të praktikës kultivuese dhe në atë të transformimit të karmës. Ndryshe nga ç’e mendojnë njerëzit e zakonshëm, kjo është shumë më e vështirë sesa vuajtja fizike. Si mundet ju të rrisni gongun thjesht duke shtuar kohën e praktikës së ushtrimeve me krahët që ju dhëmbin duke i mbajtur lart dhe këmbët e lodhura nga të qëndruarit më këmbë. Si mund të rrisni gongun me pak orë më shumë ushtrimesh? Kjo shërben vetëm për të transformuar bentin por ai prapëprap ka nevojë të rforcohet me energji. Kjo nuk ndihmon në ngritjen e nivelit. Kapërcimi i problemeve në mendje është çelësi për përmirësimin e vërtetë të nivelit. Nëse një njeri mund të përparonte vetëm duke vuajtur fizikisht, unë do të thoja që fshtarët në Kinë vuajnë më shumë. A nuk do të bëheshin ata mjeshtër qigongu atëherë? Pavarësisht sa vuani ju fizikisht, ju nuk vuani aq sa ata, të cilët punojnë shumë dhe papushuar në fushë nën diellin përvëlues. Kjo nuk është çështje e thjeshtë. Prandaj, ne

kemi thënë që të përmirësoni me të vërtetë veten, ju duhet të përmirësoni me ndershmëri mendjen. Vetëm atëherë personi mund të përmirësojë veteveten me të vërtetë.

Gjatë procesit të transformimit të karmës, në mënyrë që ta keni veten nën kontroll, ndryshe nga njerëzit e zakonshëm që i bëjnë gjërat lëshues, ju duhet të mbani gjithmonë dashamirësi në zemër dhe mirësi në mendje. Nëse ju papritur ndesheni me ndonjë problem, ju do të jeni të aftë ta përballoni atë ashtu siç duhet. Kur ju gjithmonë mbani dashamirësinë dhe mëshirën në zemër, ju do të keni kohë dhe vend për të përballuar konfliktet dhe të mendoni, nëqoftëse një problem ju del papritur. Nëse ju gjithmonë mendoni të konkuroni me të tjerët dhe të luftoni për çdo gjë, unë do të thoja se ju do të fillonit sherr me të tjerët sa herë që lind ndonjë problem—kjo është e sigurt. Pra, kur ju ndesheni me një konflikt, unë do të thoja se ai del për të transformuar substancën tuaj të zezë në substancë të bardhë, virtyt.

Kur njerëzimi ynë zhvillohet deri në shkallën e sotme, pothuajse çdonjeri lind me karmë përmbi karmë dhe trupi i të gjithëve ka grumbulluar mjaft karmë. Prandaj, në procesin e transformimit të karmës, zakonisht ndodh një situatë e tillë: Ndërsa gongu juaj rritet dhe karakteri juaj përmirësohet, karma juaj eliminohet dhe transformohet. Kur një person ndeshet me një konflikt, ai mund të shfaqet si një konflikt karakteri me një tjetër. Nëqoftëse ju mund ta duroni atë karma e juaj do të eliminohet, karakteri juaj do të përmirësohet dhe gongu juaj gjithashtu do të rritet. Të gjitha këto janë të lidhura me njëra tjetrën. Njerëzit në të kaluarën kishin shumë virtyt dhe karakter të mirë që në fillim. Dhe kur ata vuanin pak, ata do të mund të rrisnin gongun e tyre. Njerëzit sot nuk janë si atëhere. Sapo kanë vuajtje, ata nuk duan të praktikojnë kultivim. Për më tepër, ata janë bërë me më pak ndriçim shpirtëror e si rrjedhim e kanë më të vështirë për të praktikuar kultivim.

Në praktikën kultivuese, mund të jepen dy shpjegime përsa i përket konflikteve specifike apo kur të tjerët ju trajtojnë keq. Njëra është që ju mund ta keni trajtuar keq atë person në jetën tuaj të mëparshme. Ju ndjeni në zemër se kjo është e padrejtë, “Si mund të më trajtojë ky person kështu?” Atëhere, pse e trajtove ti këtë person në të njëjtën mënyrë në të kaluarën? Ju mund të pretendoni se nuk dini gjë për atëhere dhe se kjo jetë nuk ka të bëjë me jetën tjetër. Kjo nuk bëhet. Ka dhe një çështje tjetër. Konfliktet lidhen me çështjen e transformimit të karmës. Prandaj, në trajtimin e konflikteve specifike ne duhet të falim në vend që të veprojmë si njerëzit e zakonshëm. Kjo duhet të aplikohet jo vetëm në vendin e punës po edhe në mjedise të tjera. E njëjta gjë është e vërtetë edhe me njerëzit e vetëpunësuar sepse edhe ata kanë lidhje shoqërore. Është e pamundur të mos kesh të bësh me shoqërinë, sepse të paktën janë kontaktet midis fqinjëve.

Në marrëdhëniet shoqërore një person do të ndeshet me të gjitha llojet e konflikteve. Për ata që praktikojnë kultivim midis njerëzve të zakonshëm, çfarëdo lloj biznesi në të cilin ju jeni, nuk ka rëndësi. Pavarësisht nga sa para që keni, në çfarë pozite të lartë shoqërore jeni, apo çfarëdo lloj sipërmarrje private apo kompani ju drejtoni nuk ka asnjë dallim, pasi ju duhet të bëni tregti të ndershme dhe të mbani një mendje të virtytshme. Të gjitha profesionet në shoqërinë njerëzore duhet të ekzistojnë. Është zemra e njeriut që korruptohet dhe jo zanati apo profesioni. Ekzistonte një fjalë popullore në kohët e shkuara: “Nëntë nga dhjetë tregëtarë janë mashtrues.” Kjo është thënie e bërë nga njerëzit e zakonshëm. Unë do të thoja që është çështje që ka të bëjë me zemrën e njeriut. Përderisa zemra e juaj është e pastër dhe ju tregtoni me ndershmëri, ju e meritoni të fitoni para nëse ju bëni më shumë përpjekje. Kjo për arsye se ju jeni shpërblyer për përpjekjet e bëra midis njerëzve të zakonshëm. Pa humbje, s’ka fitim. Ju punuat për të. Pavarësisht nga statusi shoqëror, çdo njeri mund të jetë njeri i mirë. Ka konflikte të ndryshme për njerëzit e klasave të ndryshme shoqërore. Shtresa e pasur e shoqërisë ka konflikte të shtresës së pasur dhe të gjitha ato mund të trajtohen siç duhet. Në çdo klasë shoqërore, personi mund të jetë një njeri i mirë dhe të tregojë pak interes ndaj dëshirave apo veseve. Çdo njeri mund të jetë njeri i mirë në shtresa të ndryshme shoqërore dhe të praktikojë kultivim në nivelin e vet shoqëror.

Në ditët e sotme në Kinë, si në një ndërmarje shtetërore apo në sipërmarrje të tjera, konfliktet ndërpersonale janë bërë shumë të veçanta. Në vende të tjera dhe gjatë gjithë historisë, ky fenomen nuk ka ndodhur ndonjëherë. Për rrjedhojë, konfliktet mbi interesin vetjak veçarërisht duken se janë shumë të ashpra. Njerëzit thurin intriga në mëndje dhe konkurojnë për interesin më të vogël personal; mendimet që kanë dhe manovrat që përdorin janë shumë të ulta. Që të jesh njeri i mirë është e vështirë. Për shembull, ti arrin në vendin e punës dhe gjen një atmosferë jo të mirë. Më vonë, dikush të thotë se filani ka folur keq për ty dhe se të kanë raportuar tek përgjegjësi, duke të vënë ty në një situatë shumë të keqe. Të tjerët të vështrojnë me një shikim jo të zakonshëm. Si mundet ta tolerojë një njeri i zakonshëm këtë? Si mund ta durojë dikush këtë? “Nëse dikush do të më nxjerrë telashe, unë do t’i bëj të njëjtën gjë. Nëqoftëse ai ka përkrahës edhe unë kam gjithashtu. Fillojmë luftën.” Kur ti e bën këtë gjë midis njerëzve të zakonshëm, ata do të thonin se ti je i fortë. Por si praktikues, kjo do të ishte krejt e papranueshme. Nëse ti konkuron dhe lufton si njeri i zakonshëm, ti je njeri i zakonshëm. Nëse ti e mund atë, ti je akoma më i keq se ai njeriu i zakonshëm.

Si duhet ta trajtojmë në këtë çështje? Kur ndeshemi me një konflikt të tillë, ne duhet së pari të ruajmë gjakftotësinë dhe nuk duhet të sillemi njësoj si ai tjetri. Natyrisht, ne mund t’ja shpjegojmë çështjen me njerëzillëk dhe nuk ka asnjë problem nëse ne sqarojmë çështjen. Por nuk duhet të na mbesë mëndja aty. Nëse ne ndeshemi me këto probleme, ne nuk duhet të konkurojmë dhe të luftojmë si të tjerët. Nëqoftëse ju bëni të njëjtën gjë që bën ai tjetri, a nuk jeni ju një njeri i zakonshëm? Jo vetëm që ju nuk duhet të konkuronit dhe të luftoni si ai por ju nuk duhet t’i mbani mëri atij në zemër. Me të vërtetë, ju nuk duhet ta urreni atë person. Nëse ti e urren atë person a nuk je nxehur ti? Ti nuk ke ndjekur parimin e Tolerancës (Ren). Në praktikojmë Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë) dhe ti do të kesh edhe më pak Mirësi do të thoshim. Kështu, ju nuk duhet të jeni si ai apo të mërzhiteni me të vërtetë me të, pavarësisht se ai ju vuri në një situatë të keqe ku ju nuk mund as edhe të ngrinit kokën. Në vend që të jeni të zemëruar më të ju duhet ta falenderoni atë nga zemra dhe ta falenderoni me sinqeritet. Një njeri i zakonshëm mund të mendojë kështu: “A nuk është kjo sikur je Ah Q¹?” Unë po ju them që nuk është ashtu.

Pa mendojeni pak: Ju jeni praktikues. A nuk ju kërkohet juve që të arrini një standart të lartë? Parimet e njerëzve të zakonshëm nuk duhet të aplikohen tek ju, apo jo? Si praktikues, a nuk është ajo që merrni ju diçka e niveleve të larta? Për rrjedhojë, ju duhet të ndiqni parimet e nivelit të lartë. Nëse ju bëni të njëjtën gjë që bëri ai person, a nuk jeni ju njësoj si ai? Pse duhet ta falenderoni ju atë, atëherë? Pa mendoni pak: Çfarë do të merrni ju? Në këtë univers, ka një parim që thotë: “pa humbje, s’ka fitim.” Që të fitosh duhet të humbesh. Ai person ju vuri në një situatë të keqe mes njerëzve dhe ai është pala që ka fituar në kurrizin tuaj. Sa më e keqe situata që ai të vë, sa më të mëdha pasojat dhe sa më shumë duron ti, aq më shumë virtyt do të humbë ai. Ky virtyt do t’ju jepet i gjithi juve. Ndërsa ju jeni duke duruar gjithë këtë, ju nuk doni t’ja dini dhe nuk e merrni me shumë seriozitet në mëndje.

Në këtë univers, ekziston dhe një parim tjetër: Nëse ju vuani shumë, karma në trupin tuaj do të transformohet. Ngaqë ju keni vuajtur, aq sa shumë keni vuajtur aq do të transformohet në virtyt. A nuk është ky virtyt ajo që dëshiron një praktikues? Ju do të fitoni dyfish, sepse dhe karma juaj do të eliminohet. Nëqoftëse ky person nuk do e kishte krijuar këtë situatë për ju, si mundet që ju të përmirësoni karakterin tuaj? Nëqoftëse ju dhe unë jemi të mirë me njëri-tjetrin dhe në harmoni, si mund të jetë e mundur të rrisim gongun? Është pikërisht sepse ai person ka krijuar këtë konflikt për ju që krijohet kjo mundësi përmirësimi karakteri dhe ju mund ta përdorni atë për të përmirësuar karakterin tuaj. A nuk ngrihet karakteri juaj në këtë mënyrë? Ju keni fituar trefish. Ju jeni praktikues. Me ngritjen e karakterit, a nuk do të rritet edhe gongu juaj? Ju keni fituar katërfish me një të shtënë. Pse të mos e falenderoni atë person? Ju sinqerisht duhet ta falenderoni atë nga thellësia e zemrës—në fakt është kështu.

¹ Ah Q—një personazh budalla në një novelë Kineze.

Natyrisht, qëllimi i atij personi nuk ishte i ndershëm, përdryshe ai nuk do të të jepte ty virtyt. Por ai me të vërtetë krijoi një mundësi për të përmirësuar karakterin tuaj. Me fjalë të tjera, ne duhet ti kushtojmë vëmendje kultivimit të karakterit. Në të njëjtën kohë që karakteri kultivohet, karma eliminohet dhe transformohet në virtyt kështu që ju mund të ngjiteni në nivel më të lartë; këto shkojnë njëra me tjetrën. Nga pikëpamja e një niveli të lartë, këto parime janë të gjitha të ndryshme. Një njeri i zakonshëm nuk do t'i kuptojë ato. Kur i shikoni këto parime nga nivele të larta, çdo gjë do të jetë ndryshe. Për njerëzit e zakonshëm këto parime mund të jenë të drejta, por në fakt ato nuk janë të drejta. Vetëm ajo që shikohet nga nivele më të larta është me të vërtetë e drejtë. Normalisht është kështu.

Unë ja u kam shpjeguar parimet me hollësi të gjithëve dhe shpresoj që në praktikën kultivuese në të ardhmen secili do ta trajtojë veten si praktikues dhe me të vërtetë do të praktikojë kultivim përderisa parimet janë prezantuar tashmë këtu. Ndoshta disa njerëz, për arsye se ata jetojnë midis njerëzve të zakonshëm dhe para interesave aktuale materiale, akoma mendojnë që të jesh njeri i zakonshëm është gjë praktike. Në mes të rrymës së njerëzve të zakonshëm ata akoma nuk mund të sillen me standart të lartë. Në fakt, për të qënë njeri i mirë në mes të njerëzve, janë herojtë që shërbejnë si model i njerëzve të mirë por ato janë modele midis njerëzve të zakonshëm. Nëse ju doni të bëheni praktikues, varet plotësisht nga kultivimi i zemrës suaj dhe nga vetë ju sa do të kuptoni meqenëse nuk ka shembuj për të ndjekur. Për fat të mirë, sot e kemi bërë publik këtë Ligj të Lartë. Në të kaluarën, nëse dëshironit të praktikoni kultivim, askush nuk do t'ju mësonte. Kështu, ju mund të ndiqni Ligjin e Lartë dhe mbase do të ecni mirë. Nëse mund të praktikoni kultivim apo t'ja arrini atij dhe çfarë niveli mund të arrini varet e tëra nga vetë ju.

Natyrisht, mënyra se si karma transformohet nuk ndodh gjithmonë siç e kam përshkruar, ajo mund të shfaqet dhe në aspekte të tjera. Kjo mund të ndodhë në shoqëri ose në shtëpi. Ndërsa ecni në rrugë ose në një mjedis tjetër shoqëror, ju mund të hasni në ndonjë problem. Juve do t'ju kërkohet që të braktisni të gjitha ato vese që nuk mund të braktisen nga njerëzit e zakonshëm. Të gjitha ato vese që keni duhet të hiqen në mjedise të ndryshme. Ju mund edhe të rrëzoheni dhe në këtë proces do të arrini të lartësoheni shpirtërisht dhe të kuptoni Taon. Kjo është mënyra se si personi ecën në praktikën kultivuese.

Ka dhe një situatë tjetër tipike. Gjatë kursit të praktikës kultivuese shumë nga ju do të vënë re se kur praktikoni qigong, bashkëshorti apo bashkëshortja juaj do të zemërohen shpesh. Sapo të filloni ushtrimet, bashkëshorti do të fillojë t'ju ngacmojë. Nëse ju bëni diçka tjetër, atij apo asaj nuk do t'i bënte përshtypje. Pamvarësisht nga sa kohë harxhoni duke luajtur Mah Jong,² bashkëshortja juaj mund të mërzhitej por jo aq shumë se sa kur filloni të bëni ushtrimet. Praktika juaj e qigongut nuk i prish punë bashkëshortes tuaj dhe sa gjë e mirë është ajo përderisa ju bëni ushtrimet për të mbajtur trupin në formë dhe nuk jeni duke e shqetësuar bashkëshorten. Megjithatë sapo ju filloni të praktikoni qigong bashkëshortja do të fillojë të hedhë ca fjalë dhe më pas të fillojë të grindet. Disa çifte pothuajse ndahen për shkak të grindjeve mbi praktikën e qigongut. Shumë njerëz nuk e kanë menduar pse ndodh një gjë e tillë. Nëse ju pyesni bashkëshortin më pas "Pse mërzhitesh kaq shumë kur unë praktikoj qigong?" ai apo ajo nuk mund ta shpjegojnë këtë dhe nuk gjejnë dot arsyen. "Vërtetë, pse u zemërova dhe u acarova kaq shumë në atë kohë?" Në fakt, ku qëndron shkak? Ndërsa një person po praktikon qigong, karma e tij duhet të transformohet. Ju nuk do të fitoni po nuk humbët dhe ato që ju humbni janë gjëra të këqija. Ju duhet të sakrifikoni.

Ndoshta sapo të hynit në prag të derës, bashkëshorti juaj do të fillonte t'ju sulmojë me fjalë drejt e në fytyrë. Po e duruat, përpjekjet tuaja për të praktikuar qigong sot nuk shkuan kot. Disa njerëz gjithashtu e dinë se në praktikën e qigongut personi duhet të vlerësojë virtytin. Prandaj, ai zakonisht shkon shumë mirë me bashkëshorten e tij. Ai mendon: "Normalisht, nëse unë them një fjalë, ajo nuk

² Mah Jong—lojë tradicionale kineze që luhet me katër veta.

do të thotë dy. Sot ajo po më mund mua.” Ai nuk mund ta kontrollojë veten më dhe do të fillojë të ngrindet. Me këtë, praktika e sotme shkoi dëm. Për arsye se karma ishte aty, ajo po e ndihmonte atë që ta hiqte. Por ai nuk e pranoi dhe filloi të grindet me të. Pra, karma nuk mundi të eliminohej. Ka shumë raste të tilla dhe shumë nga praktikuesit tanë i kanë përjetuar ato, por ata nuk e patën menduar pse ato ndodhin kështu. Bashkëshortit tuaj nuk do t’i interesonte sikur ju të ishit duke bërë diçka tjetër. Praktika e qigongut duhet të jetë faktikisht një gjë e mirë, por ai apo ajo gjithmonë do t’ja u vë fajin juve. Në fakt, gruaja juaj po ju ndihmon që të eliminoni karmë edhe pse ajo vetë nuk e di. Ajo nuk po grindet me ju vetëm për sy e faqe dhe thellë në zemër ajo është e mirë me ju—nuk është ashtu. Është zemërim i vërtetë që i vjen thellë nga zemra, sepse kushdo që ka mbledhur karmë ndjehet në siklet. Është e sigurtë që është kështu.

Përmirësimi i Karakterit

Për arsye se shumë njerëz më parë nuk mund të mbanin karakter të mirë, ndodhnin dhe shumë probleme. Pasi praktika e tyre arrinte në një farë niveli, ata nuk mundnin të përparonin më tej. Disa njerëz kishin nivel të lartë karakteri që para praktikës. Syri i tyre Qiellor hapej menjëherë sapo praktikonin dhe mund t’i arrinte një nivel të caktuar. Për arsye se ky person kishte cilësi shpirtërore të lindur relativisht të mirë dhe nivel karakteri të lartë, gongu i tij rritej me shpejtësi. Në kohën që gongu i tij arrinte në të njëjtin nivel me karakterin e tij, ai ishte rritur deri në atë nivel. Nëse ai donte që të rriste gongun e tij, konfliktet do të bëheshin shumë seriozë, pasi atij i kërkohesh që të vazhdonte të përmirësonte karakterin. Kjo është veçanërisht e vërtetë për një njeri me cilësi shpirtërore të lindur të mirë. Ai mund të mendojë që gongu i tij po rritet mirë dhe gjithashtu praktika po i shkon shumë mirë. Pse atëhere shumë probleme fillojnë të lindin papritur? Çdo gjë shkon keq. Njerëzit e keqtrajtojnë dhe përgjegjësi gjithashtu nuk e pëlqen atë. Mandje edhe gjendja në shtëpi bëhet shumë e tensionuar. Pse dalin kaq shumë probleme kaq papritur? Vetë ky person mund të mos e kuptojë shkakun. Për shkak të cilësisë shpirtërore të lindur të mirë, ai ka arritur një nivel të tillë që shkakton këtë situatë. Megjithatë si mund të jetë ky kriteri i fundit për një praktikues për të mbaruar kultivimin? Është larg nga përfundimi i praktikës kultivuese! Ju duhet të vazhdoni të përmirësoni veten tuaj. Për shkak të asaj pak sasive cilësie shpirtërore të lindur ju arritët këtë stad. Me qëllim që të ngjitesh me tej edhe standarti duhet të rritet.

Dikush mund të thotë, “Unë do të fitoj edhe ca para që të rregulloj mirë familjen kështu që të mos shqetësohem për asgjë. Pastaj do të praktikoj kultivim”. Unë do të thoja që këto janë ëndrra në diell. Ju nuk jeni i zoti të ndërhyni në jetët e të tjerëve dhe as nuk mund të kontrolloni fatet e të tjerëve duke përfshirë ato të gruas, djemve, vajzave, prindërve apo vëllezërve tuaj. A i vendos ti këto gjëra? Për më tepër si do të praktikosh ti kultivim nëse ti nuk do të kesh shqetësime apo probleme? Si mund t’i bësh ushtrimet me rehati dhe lehtësi? Ku është dëgjuar kjo? Kështu mendon ti nga pikëpamja e një njeriu të zakonshëm.

Praktika kultivuese duhet të kalojë përmes vështirësive në mënyrë që të testojë nëse ju mund të ndaheni nga llojet e ndryshme të emocioneve dhe dëshirave njerëzore dhe të tregoni më pak interes për to. Nëse ju jeni i dhënë shumë pas këtyre gjërave, ju nuk do t’ja arrini kultivimit. Çdo gjë ka lidhje karmike. Pse qëniet njerëzore janë qënie njerëzore? Sepse qëniet njerëzore kanë emocione. Ato jetojnë për këto emocione—dashuria ndërmjet pjesëtarëve të familjes, dashuria ndërmjet burrit e gruas, dashuria për prindërit, ndjenjat, shoqëria, të bësh për shoqërinë dhe çdo gjë tjetër e lidhur me këtë sentimentalitet. Nëse një personi i pëlqen të bëjë diçka apo jo, është i lumtur apo i dëshpëruar, dashuron apo urren diçka dhe çdo gjë në shoqërinë njerëzore vjen nga ky sentimentalizëm. Nëse ky sentimentalizëm nuk braktiset, ju do të jeni të paafët të praktikoni kultivim. Nëqoftëse ju liroheni nga ky sentimentalizëm, askush nuk mund t’ju lëkundë. Mëndja e një njeriu të zakonshëm do të jetë e

paaftë t'ju lëkundë. Ajo që e zëvendëson atë është mirësia, e cila është diçka më fisnike. Natyrisht, nuk është e lehtë të braktisësh këtë sentimentalizëm menjëherë. Praktika kultivuese është një proces i gjatë dhe një proces i heqjes dorë gradualisht nga veset. Sidoqoftë, ju duhet të jeni i rreptë me veten tuaj.

Si praktikues, ju do të ndesheni me konflikte të papritura. Çfarë duhet të bëni ju? Ju gjithmonë duhet të jeni zemërmadh dhe dashamirës. Pastaj, kur ju del një problem, ju do të jeni të aftë të silleni mirë sepse ajo ju krijon hapësirë për të përballuar konfliktin. Ju duhet të jeni gjithmonë dashamirës dhe të sjellshëm me të tjerët dhe të keni parasysh të tjerët në gjithçka që bëni. Kurdo që ndesheni me ndonjë problem, ju më parë duhet të mendoni nëse të tjerët mund ta durojnë këtë apo nëse ajo dëmton njëri. Duke vepruar kështu, nuk do të dalë ndonjë problem. Prandaj, në praktikën kultivuese ju duhet të ndiqni një standart akoma më të lartë për veten tuaj.

Disa njerëz shpesh nuk i kuptojnë këto çështje. Kur dikujt i hapet Syri Qiellor dhe shikon një Buddha, ai do të shkojë në shtëpi dhe do t'i falet Buddhës, duke iu lutur në mëndjen e tij, “Pse nuk më ndihmon? Të lutem ma zgjidh këtë problem.” Buddha natyrisht, nuk do të bëjë asgjë për këtë person sepse ai problem u krijua nga Buddha me qëllim që të përmirësojë karakterin dhe të rrisë nivelin e tij nëpërmjet vështirësive. Si mund ta zgjidhë Buddha problemin tënd? Ai nuk do ta zgjidhë atë problem për ty aspak. Si mund të rritësh ti gongun tënd dhe të përmirësh karakterin dhe nivelin tënd nëse ai zgjidh problemin për ty? Kryesorja është që ti të rrisësh gongun tënd. Për Qëniet e Shumëlartësuarra, qëllimi nuk është të jesh njeri dhe jeta e njeriut nuk u krijua për të qenë njeri. Qëllimi i saj është që ju të ktheheni në origjinë. Qëniet njerëzore vuajnë kaq shumë. Qëniet e Shumëlartësuarra mendojnë se sa më shumë një njeri vuan aq më mirë, sepse ai duhet të shpejtojë shlyerjen e borxheve të tij. Kështu mendojnë ata. Disa njerëz nuk e kuptojnë këtë dhe fillojnë t'i ankohen Buddhës kur lutjet e tyre nuk realizohen, “Pse nuk më ndihmon? Unë djeg erë të mirë për ty dhe të përkulem me nderim çdo ditë.” Për shkak të kësaj ai mund ta hedhë statujën e Buddhës në tokë dhe të fillojë ta shajë Buddhën që këtej e tutje. Si rezultat i këtyre sharjeve, karakteri i tij do të bjerë dhe gongu tij zhduket. Personi e kupton që i iku gjithshka dhe ai zemërohet me Buddhën akoma më shumë, duke besuar se Buddha po e shkatërron. Ky individ e mat karakterin e Buddhës me kriterin e një njeriu të zakonshëm. Si mund të bëhet një krahasim i tillë? Si mundet që gjërat të funksionojnë kur një njeri i shikon gjërat e një niveli të lartë nga standarti i njerëzve të zakonshëm? Prandaj, shumë nga këto raste ndodhin shpesh kur njerëzit e konsiderojnë vuajtjen e tyre në jetë si të padrejtë. Ka shumë njerëz që bien poshtë në këtë mënyrë.

Disa vjet më parë, shumë mjeshtër të mëdhenj qigongu, duke përfshirë dhe ata më të mirënjohurit, kanë rënë në nivele duke u bërë askushi. Natyrisht, mjeshtrit e vërtetë qigong kanë ikur tashmë pasi kryen misionin e tyre në histori. Vetëm disa kanë mbetur mbrapa dhe kanë humbur midis njerëzve të zakonshëm, duke qenë akoma aktivë me një nivel të ulët karakteri. Këta persona e kanë humbur tashmë gongun e tyre. Pak mjeshtër qigongu që ishin të mirënjohur në të kaluarën janë akoma aktivë në shoqëri. Kur mjeshtërit e tyre panë që ata kishin humbur midis njerëzve të zakonshëm dhe nuk mund ta çlironin veten nga të shkuarit pas famës dhe përfitimeve personale, pasi ata ishin bënë të pashpresë, mjeshtrit e tyre ua hoqën Shpirtin Ndihmës. I gjithë gongu ishte zhvilluar mbi trupin e Shpirtit Ndihmës. Ka shumë shembuj të tillë.

Në shkollën tonë të praktikës, këto raste janë tepër të pakta. Edhe sikur të jenë disa, ato nuk janë kaq të dukshme. Ka plot shembuj të jashtëzakonshëm përsa i përket përmirësimit të karakterit. Një praktikues punonte në një fabrikë tekstili në një qytet të provincës Shandong. Pasi studjoi Falun Dafën, ai ia mësoi dhe punëtorëve e tjerë. Si rezultat, fabrika është shndërruar. Ai e kishte zakon të merrte në shtëpi copa peshqiri nga fabrika e tekstileve dhe kështu bënin edhe punëtorët e tjerë. Pas praktikimit të Dafës, në vend që të merrte gjëra në shtëpi, ai ktheu në fabrikë ato që kishte marrë më parë. Kur të tjerët panë veprimin e tij, asnjëri nuk merr më gjëra në shtëpi. Edhe disa nga punëtorët kthyen në fabrikë ato që kishin marrë më parë. Kjo situatë ndodhi në tërë fabrikën.

Një drejtues vullnetar i qëndrës së mësimin të Dafës për qytetin shkoi në një fabrikë për të parë se si po ja kalonin praktikuesit me praktikën. Përgjegjësi i fabrikës doli jashtë për ta takuar atë personalisht: “Që kur filluan të studjojnë Falun Dafën, këta punëtorë vijnë në punë herët dhe shkojnë në shtëpi vonë. Ata punojnë me shumë zell dhe kryejnë çdo detyrë që i ngarkon përgjegjësi. Ata gjithashtu nuk konkurojnë më për përfitime personale. Duke vepruar kështu, ata kanë bërë që e gjithë fabrika të marrë një pamje tjetër dhe gjithashtu të ardhurat ekonomike të fabrikës janë përmirësuar. Praktika e juaj është kaq e fuqishme. Kur do të vijë mjeshtri juaj? Do të më pëlqente të merrja pjesë në leksionet e tij.” Qëllimi kryesor i kultivimit të Falun Dafës është që t’i çojë njerëzit drejt niveleve të larta. Megjithatë nuk ka për qëllim ta bëjë një gjë të tillë, ajo mund të luajë një rol të madh konstruktiv duke përhapur zhvillimin shpirtëror në shoqëri. Nëqoftëse çdo njeri kërkon brenda vetes dhe mendon se si të sillet mirë, unë do të thoja që shoqëria do të stabilizohej dhe standarti moral njerëzor do të përmirësohej përsëri.

Kur unë mësoja Ligjin dhe praktikën në qytetin Taiyan, ishte atje një praktikuese mbi të pesëdhjetat. Ajo dhe i shoqi kishin ardhur të dëgjonin leksionet e mia. Kur ata po kalonin rrugën, një makinë i kaloi pranë me shumë shpejtësi dhe pasqyra anësore kapi rrobat e gruas së moshuar. Me rrobat e ngecura në makinë, makina e zvarriti atë për një distancë mbi dhjetë metra dhe e përplasi për tokë. Makina ndaloi pasi bëri rreth njëzet metra. Shoferi ishte shumë i zemëruar kur doli nga makina: “Hey, ku i kishe sytë kur kaloje?” Në ditët e sotme, njerëzit sillen në këtë mënyrë dhe pikësëpari mundohen të shmangin përgjegjësitë kur ndeshen me ndonjë problem, pavarësisht nëse është faji i tyre apo jo. Pasagjerët në makinë thanë: “Shko merr vesh nëse është vrarë zonja. Le ta çojmë në spital.” Shoferi erdhi në vehte dhe nxitoi t’i thotë: “Si ndjehesh zonjë? A jeni vrarë? Hajde të shkojmë në spital të kontrollohesh.” Kjo praktikuese u ngrit me ngadalë dhe tha: “S’kam asgjë. Ju mund të shkoni.” Ajo pastroi pluhurin nga rrobat dhe u largua me të shoqin.

Ajo erdhi në klasë dhe më tregoi këtë ngjarje dhe mua mu bë qejfi. Karakteri i praktikuesve tanë është përmirësuar me të vërtetë. Ajo më tha: “Mësues, unë studjova Falun Dafën sot. Po të mos kisha studjuar Falun Dafën, unë nuk do ta kisha trajtuar aksidentin sot në këtë mënyrë.” Pa mendojeni pak, të gjithë: Për një pensionist, çmimet e tregut janë kaq të larta këto ditë dhe nuk ka ndihmë sociale. Një njeri mbi të pesëdhjetat u tërhoq zvarrë aq shumë nga një makinë dhe më pas u përplas në tokë. Ku mund të ishte vrarë trupi i saj? Kudo. Ajo mund të kishte qëndruar në tokë pa lëvizur. Të shkojë në spital? Patjetër. Ajo mund të kishte qëndruar në spital dhe të mos dilte që andej. Një njeri i zakonshëm mund të sillet në këtë mënyrë, por ajo ishte praktikuese dhe nuk e bëri një gjë të tillë. Ne kemi thënë që e mira apo e keqja vijnë nga një mendim spontan i personit dhe mendimi në atë çast mund të sjellë pasoja të ndryshme. Në atë moshë, sikur ajo të ishte një njeri i zakonshëm, është e pamundur që ajo të mos vritej. Megjithatë lëkura e saj as qe gërvishtur. E mira dhe e keqja vijnë nga ai mendim i çastit. Nëse ajo do të ishte shtrirë përtokë dhe ankohej, “Uh, ndjehem shumë keq. Më dhëmb këtu e më dhëmb atje.” Atëhere kockat e saj me të vërtetë mund të ishin thyer dhe ajo mund të ishte paralizuar. Pamvarësisht nga sa para e paguajtën, si mund të ishte ajo rehat duke qëndruar në spital për gjithë jetën? Atyre që ishin të pranishëm iu duk e çuditshme që gruaja e moshuar nuk e shrytëzoi atë dhe t’i kërkonte para. Në ditët e sotme vlerat morale njerëzore janë shtrembëruar. Shoferi me të vërtetë i jepte makinës me shumë shpejtësi, por si mund të godiste ai dikë me qëllim? A nuk e bëri ai atë nga pakujdesia? Por njerëzit janë kështu sot dhe në rast se ai nuk shfrytëzohej, edhe kalimtarëve do t’ju dukej e padrejtë. Unë e kam thënë që sot njerëzit nuk dallojnë dot të mirën nga e keqja. Nëse një njeri i thotë një tjetri që ai po bën diçka të keqe, ai nuk do ta bësojë atë. Ngaqë vlerat morale të njeriut kanë ndryshuar, disa njerëz nuk kërkojnë asgjë përveç interesit vetjak dhe do të bënin gjithçka për para. “Nëse një njeri nuk jepet pas interesit vetjak, qielli dhe toka do ta vrasin atë”—kjo është bërë tashmë moto!

Një praktikues në Beijing nxorri djalin e tij për shëtitje në Qianmen³ një mbasdite dhe pa një automjet tregtar që shiste bileta llotarie. Djali u bë kurioz dhe i kërkoi që të luante llotarinë. Ai i dha djalit një yuan që të luajë dhe djali fitoi çmimin e dytë, një biçikletë luksoze për fëmijë. Djali u gëzua shumë. Në atë çast një mendim i lindi në mendje të jati: “Unë jam praktikues. Si mund ta pranoj një gjë të tillë? Sa virtyt duhet të jap për një gjë për të cilën nuk kam paguar?” Ai i tha djalit të tij: “Leje, të mos e marrim. Ne mund të blejmë një vetë nëqoftëse e don.” Djali u mërzit: “Unë të kam lutur të më blesh një dhe ti nuk ma ke blerë. Tani që unë e fitova vetë, ti nuk më lejon ta mbaj.” Djali qante dhe ulërinte me të madhe. Ai nuk mund të bënte asgjë, veçse ta merrte biçikletën në shtëpi. Në shtëpi, sa më shumë ai e mendonte atë, aq më në siklet ai ndjehej. Ai mendoi që t’ja dërgonte paratë atyre personave. Pastaj ai mendoi: “Tashmë llotaria ka mbaruar dhe a nuk do t’i ndanin paratë ata mes tyre nëse unë ja dërgoj? Unë duhet t’ja dhuroj paratë vendit të punës.”

Fatmirësisht, kishte disa praktikues të Falun Dafës në vendin e punës dhe përgjegjësi i tij mund ta kuptonte. Nëse kjo do të ndodhte në një mjedis apo vend pune tipike, ku ti thua se je praktikues që nuk don një biçikletë e fituar në llotari dhe që don t’ia dhurosh paratë vendit të punës, edhe përgjegjësi do të mendonte se ke ndonjë problem mendor. Të tjerët gjithashtu mund të komentonin: “A ka rrëshqit ky person duke praktikuar apo po e kap ndonjë marrosje nga kultivimi?” Unë e kam thenë që vlerat morale janë shtrembëruar. Në vitet 1950 dhe 1960, kjo nuk do të ishte ndonjë gjë e madhe por shumë e zakonshme—asnjënjeri nuk do të çuditej.

Ne kemi thënë që pavarësisht nga sa ndryshojnë vlerat morale të njeriut, kjo karakteristikë e universit, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë) mbetet përgjithmonë e pandryshueshme. Nëse dikush thotë që ju jeni i mirë, ju në të vërtetë mund të mos jeni i mirë. Nëse dikush thotë që jeni i keq, ju mund të mos jeni me të vërtetë i keq. Kjo për arsye se kriteri që vlerëson të mirën dhe të keqen është shtrembëruar. Vetëm një njeri që vepron konform kësaj karakteristike të universit është njeri i mirë. Ky është i vetmi kriter që dallon një njeri të mirë apo të keq dhe që njihet nga universi. Megjithë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në shoqërinë njerëzore, vlerat morale të njeriut kanë rënë tmerrësisht poshtë. Morali njeriut është duke u keqësuar nga dita në ditë dhe përfitimet janë bërë motivimi i vetëm. Megjithatë ndryshimet në univers nuk ndodhin në përputhje me ndryshimet e njerëzimit. Si praktikues, dikush nuk duhet të sillet sipas standartit të njerëzve të zakonshëm. Është e papranueshme që ju të bëni gjëra thjesht sepse konsiderohen të drejta nga njerëzit e zakonshëm. Kur njerëzit e zakonshëm thonë që është e drejtë, mund të mos jetë ashtu. Kur ata thonë që është gabim, mund të mos jetë as ashtu. Në kohën e sotme, kur vlerat morale janë shtrembëruar, nëse ju i thoni dikujt se ai po bën një gjë të keqe, ai nuk do ta besojë një gjë të tillë! Si praktikues, një njeri duhet ti vlerësojë gjërat me karakteristikën e universit. Vetëm atëhere mundet ai të dallojë çfarë është me të vërtetë e mirë dhe çfarë është me të vërtetë e keqe.

Guanding

Në komunitetin e kultivuesve ekziston ky fenomen i quajtur guanding. Guanding është një rit fetar i praktikës kultivuese të Tantrizmit në Shkollën e Buddhës. Qëllimi i tij është që nëpërmjet procedurës së guandingut një njeri të mos ndjekë më shkollën e tjera kultivuese dhe të pranohet në shkollën në fjalë si një dishepull i vërtetë. Atëhere, çfarë ka për tu çuditur me këtë? Ky formalitet fetar po aplikohet gjithashtu dhe nga praktikantët e qigongut. Nuk po praktikohet vetëm nga Tantrizmi, por edhe nga lloji Taoist i qigongut. Unë e kam thënë që të gjithë ata që mësojnë në shoqëri praktikën e Tantrizmit nën flamurin e Tantrizmit janë të rremë. Pse është kështu? Kjo për arsye se Tantrizmi Tang është zhdukur nga vendi ynë për më se një mijë vjet dhe nuk ekziston më. Për shkak të pengesës

³ Qianmen—një nga qendrat tregtare në zonën e Beijingut.

së gjuhës, Tantrizmi Tibetan nuk arriti kurrë të bëhet i njohur në rajonet e Hanit⁴. Veçanërisht, për shkak se është fe vetëm për pak persona të zgjedhur, ajo duhet të praktikohet në fshehtësi në manastire. Ajo gjithashtu duhet të mësohet në mënyrë sekrete nga mjeshtri dhe mjeshtri e merr personin për të praktikuar në vend të fshehtë. Nëqoftëse nuk mund të bëhet kështu, ajo nuk mund të mësohet në asnjë mënyrë.

Shumë njerëz që shkojnë në Tibet për të mësuar qigong kanë këtë qëllim: Ata duan të gjejnë një mjeshtër dhe të mësojnë Tantrizmin Tibetan me qëllim që të bëhen mjeshtër qigongu në të ardhmen dhe të bëhen të pasur dhe të famshëm. Pa mendoni pak, të gjithë: Një lama Buddhist⁵ i vërtetë i cili ka marrë mësim të vërteta ka aftësi supernormale shumë të fuqishme dhe mund të lexojë mendjen e një personi të tillë. Pse ka ardhur ky person këtu? Ai do ta dijë menjëherë duke lexuar mendjen e këtij personi: “Ti vjen këtu sepse don të studjosh praktikën që të bëhesh mjeshtër qigongu për famë dhe para duke sabotuar kështu këtë shkollë të kultivimit të Buddhës.” Një praktikë kaq serioze e kultivimit të Buddhës, si mund që të shkatërrohet ajo sipas dëshirës nga qëllimi yt për t’u bërë mjeshtër qigongu për famë dhe para? Cili është motivi yt? Prandaj, ai nuk do t’i mësojë këtij personi asgjë dhe as do të marrë ky individ mësim të vërteta. Natyrisht me kaq shumë manastire rreth e rrotull, një njeri mund të mësojë disa gjëra sipërfaqësore. Nëse mendja e tij nuk është e mirë, ai do të zotërohet nga shpirtëra apo kafshë ndërsa përpiqet që të bëhet mjeshtër qigongu dhe bën gjëra të këqija. Edhe kafshët zotëruese kanë energji, por ajo nuk vjen nga Tantrizmi Tibetan. Ata që shkojnë në Tibet për të kërkuar Dharmën me sinqeritet do të vendosen atje sapo të arrijnë—ata janë praktikues të vërtetë.

Është për t’u habitur që tani shumë praktika Taoiste gjithashtu kryejnë guanding. Shkolla Tao përdor kanalet e energjisë. Pse duhet ajo të praktikojë të ashtuquajturin guanding? Unë kam qënë në jug për të dhënë mësim. Me sa di unë, ekzistojnë mbi dhjetë praktika jo tradicionale që kryejnë guanding, veçanërisht në rajonin Guandong. Çfarë përpiqen të bëjnë ata? Nëqoftëse mjeshtri të bën guanding, ti bëhesh dishepulli i tij dhe nuk mund të mësosh ndonjë praktikë tjetër. Nëse ti e bën këtë, ai do të të dënojë sepse këtë bën ai. A nuk do të thotë kjo të ndjekësh një praktikë të keqe? Ajo që ai mëson është diçka vetëm për shërim dhe mbajtje trupit në formë. Njerëzit e mësojnë atë thjesht sepse ata duan të kenë një trup të shëndetshëm. Pse i bën ai këto gjëra? Dikush pohon që nëqoftëse njerëzit praktikojnë qigongun e tij, ata nuk mund të ndjekin praktikë tjetër qigongu. A mundet ai t’i shpëtojë njerëzit dhe ti japë atyre mundësinë për të përfunduar kultivimin? Kjo do të thotë t’i mashtrosh dishepujt. Shumë njerëz i bëjnë këto gjëra.

Shkolla Tao nuk ka mësuar kurrë guanding, por tani edhe ajo ka të ashtuquajturin guanding. Unë kam konstatuar që mjeshtri qigong që bën më shumë zhurmë rreth praktikimit të guandingut ka një kolonë gongu të lartë vetëm sa një ndërtesë dy apo tre katëshe. Unë mendoj që për një mjeshtër qigongu të mirënjohur, gongu i tij ka rënë për të ardhur keq. Me qindra njerëz presin në rradhë për të bërë guanding. Gongu i tij është i kushtëzuar në atë lartësi dhe së shpejti nuk do të ketë më asgjë. Atëherë, çfarë do të përdorë ai për të bërë guanding? A nuk po i mashtron ai njerëzit? I parë nga një dimension tjetër, guandingu i vërtetë i bën kockat e personit të duken si jade⁶ i bardhë nga koka tek këmbët. Është gongu apo materia me energji të lartë që arrin pastrimin e trupit të individit nga koka tek këmbët. A mundet ky mjeshtër qigongu ta bëjë këtë? Ai nuk mund ta bëjë. Çfarë bën ai? Natyrisht, ai nuk do të përpiqet të krijojë një fe. Qëllimi i tij është që me të filluar praktikën e tij, ju i përkisni atij. Ju duhet të ndiqni klasat e tij që të mësoni gjërat e tij. Qëllimi i tij është t’ju marrë para. Ai nuk do të bëjë para nëse asnjëri nuk studjon praktikën e tij.

Ashtu si dishepujt në praktikat e tjera kultivuese të Shkollës Buddhës, dishepujt e Falun Dafës do të marrin guanding shumë herë nga mjeshtri në dimensione të tjera; por juve nuk do t’ju tregohet

⁴ Han—shumica etnike e popullit kinez.

⁵ lama—titull për një mjeshtër në traditën e Buddhizmit Tibetan.

⁶ jade—gur disi i çmuar që përdoret për të bërë vazo apo ornamente bizhuterie.

për të. Ata me aftësi supernormale apo ata që janë të ndjeshëm mund ta ndjejnë gjatë gjumit apo në një kohë tjetër ndërsa një rrymë e ngrohtë zbret papritur nga maja e kokës në të gjithë trupin. Qëllimi i guandingut nuk është që të rrisë lartësinë e gongut tuaj, pasi ai duhet të zhvillohet nëpërmjet praktikës suaj kultivuese. Guanding është një metodë përforcimi për të pastruar më tej trupin tuaj. Një person do të kalojë nëpër guanding shumë herë—trupin tuaj duhet të pastrohet në çdo nivel. Meqenëse kultivimi varet nga përpjekjet e secilit ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri, ne nuk praktikojmë ritin e guandingut.

Ka disa njerëz që gjithashtu praktikojnë të ashtuquajturin “adhurim të mjeshtrit”. Me që ra fjala, do të doja të thoja diçka. Shumë njerëz duan të më falen mua si mjeshtër. Kjo periudha jonë është e ndryshme nga periudha historike e shoqërisë feudale Kineze. A mund ta quajmë gjynjëzimin dhe të përkulurim me nderim si shenjë e pranimit të mjeshtrit? Ne nuk e praktikojmë këtë rit. Shumë njerëz mendojnë: “Nëqoftëse unë përkulem me nderim, djeg erë të mire dhe i falem Buddhës me zemër të pastër, gongu im do të rritet.” Kjo mua më duket mjaft qesharake. Praktika kultivuese e vërtetë varet tërësisht nga vetë individi, kështu që është e kotë që të lutesh për diçka. Juve nuk ju duhet t’i faleni Buddhës apo të digjni erë të mirë. Për aq kohë sa ju praktikoni kultivim me të vërtetë në përputhje me standartin e një praktikuesi, Buddha do të jetë shumë i kënaqur t’ju shohë. Nëse ju gjithmonë kryeni vepra të këqija në vende të tjera, ju do t’i pështiroseni atij edhe sikur të digjni erë të mirë apo t’i përkuleni me nderim. A nuk është kjo e vërtetë? Praktika kultivuese e vërtetë varet nga vetë personi. Çfarë kuptimi ka të përkulurit dhe adhurimi juaj ndaj mjeshtrit kur ju bëni atë që doni sapa dilni nga pragu i derës? Ne nuk na intereson fare ky lloj formaliteti. Ju mandje mund të dëmtoni edhe emrin tim!

Ne i kemi dhënë secilit prej jush kaq shumë gjëra. Të gjithë ju, për aq kohë sa ju më të vërtetë praktikoni kultivim dhe silleni në mënyrë rigorozë në përputhje me Dafën, unë do t’ju trajtoj si dishepujt e mi. Për aq kohë sa ju praktikoni Falun Dafën, ne do t’ju trajtojmë si dishepuj. Nëse ju nuk doni të praktikoni, ne nuk mund të bëjmë asgjë për ju. Nëqoftëse ju nuk praktikoni, ç’kuptim ka të mbani atë emër? Nuk ka rëndësi nëse ju jeni nga klasat e sezonit të parë apo të sezonit të dytë. Si mund të jeni praktikuesit tanë vetëm duke bërë ushtrimet? Që të arrini të keni një trup të shëndetshëm dhe me të vërtetë të përparoni drejt niveleve të larta, ju duhet të praktikoni kultivim duke ndjekur me të vërtetë kërkesat tona të karakterit. Prandaj, ne nuk na interesojnë ato formalitete. Për aq kohë sa ju praktikoni kultivim, ju jeni praktikues në shkollën tonë të praktikës. Fashen e mia dijnë gjithçka—ato dijnë çdo gjë në mëndjen tuaj dhe ato mund të bëjnë gjithçka. Ato nuk do të kujdesen për ju nëse ju nuk praktikoni kultivim. Nëqoftëse ju praktikoni kultivim, ato do t’ju ndihmojnë deri në fund.

Në disa praktika qigongu, praktikuesit që nuk e kanë parë kurrë mjeshttrin thonë se nëse ata paguajnë disa qindra yuan dhe përkulen me nderim në një drejtim të caktuar, kjo është e mjaftueshme. A nuk do të thotë kjo të mashtrosh vehten dhe të tjerët? Përveç kësaj, këta njerëz janë shumë të devotshëm dhe fillojnë të mbrojnë praktikën dhe mjeshtrit e tyre. Ata gjithashtu u thonë të tjerëve të mos studiojnë praktika të tjera. Mua më duket kjo mjaft qesharake. Gjithashtu, disa bëjnë diçka që quhet *mo ding*⁷. Askush nuk e di se çfarë efekti ka pas prekjës së tij.

Jo vetëm ata që mësojnë praktikën e tyre nën parrullën e Tantrizmit janë të rremë; të gjithë ata që mësojnë qigong në emër të Buddhizmit janë njësoj. Pa mendoni pak të gjithë: Për disa mijëra vjet, metodat kultivuese në Buddhizëm kanë qënë në këtë formë. Si mundet ajo të jetë akoma Buddhizëm nëse dikush e ndryshon atë? Metodatat kultivuese janë për kultivim serioz të Buddhës dhe ato janë jashtëzakonisht komplekse. Një ndryshim i vogël do të shkaktojë rrëmujë. Për arsye se transformimi i gongut është shumë kompleks, ajo që ndjen personi nuk vlen për asgjë. Një njeri nuk mund të praktikojë kultivim duke u bazuar në atë që ndjen. Forma fetare për murgjit është metodë kultivimi; me t’u ndryshuar, nuk i përket më asaj shkolle. Ka një Qenie të Shumëlartësuar në ngarkim të çdo

⁷ *mo ding*—siç pretendojnë disa mjeshtër qigongu, prekje e majës së kokës së dikujt për t’i dhënë energji.

shkolle dhe çdo shkollë ka nxjerrë shumë Qënie të Shumëlartësuar. Asnjënjëri nuk guxon të ndryshojë metodën kultivuesë të asaj shkolle. Çfarë virtyti të plotfuqishëm ka një mjeshtër i vogël qigongu që të guxojë të ofendojë mjeshterin dhe të ndryshojë një praktikë të kultivimit të Buddhës? Dhe nëse ajo ndryshohet a do të ishte më e njëjta shkollë praktike? Qigongu i rremë mund të dallohet.

Vendosja e Kalimit të Fshehtë

“Vendosja e Kalimit të Fshehtë” (*xuanguan shewei*) quhet gjithashtu “Një Hapje e Fshehtë” (*xuanguan yiqiao*). Këto terma mund të gjenden në librat *Libri i Elikzirit, Kanuni Taoist dhe Udhëzues për të Gjetur Naturën dhe Jetëgjatësinë*⁸. Pra, për çfarë bëhet fjalë? Shumë mjeshtër qigongu s’mund ta shpjegojnë këtë qartë. Kjo ndodh për arsye se në nivelin e një mjeshtri të zakonshëm qigongu, ai jo vëtem që nuk mund ta shohë atë, por atij as nuk i lejohet ta shohë. Nëse një praktikues don ta shohë atë, ky person duhet të arrijë nivelin e lartë të Shikimit të Mençurisë apo më lart. Një mjeshtër qigongu i zakonshëm nuk mund të arrijë këtë nivel; prandaj ai nuk mund ta shohë. Gjatë gjithë historisë, komuniteti i kultivuesve ka diskutuar se çfarë është Kalimi i Fshehtë, ku është Hapja dhe si të vendosësh Kalimin e Fshehtë në pozicion. Në librat e *Libri i Elikzirit, Kanuni Taoist dhe Udhëzues për të Gjetur Naturën dhe Jetëgjatësinë*, ju mund të gjeni diskutime të të gjitha teorive pa ju treguar thelbin. Nga një diskutim në tjetrin, ata ju ngatërrojnë juve. Ata nuk i shpjegojnë gjërat qartë sepse thelbi nuk mund të dihet nga njerëzit e zakonshëm.

Po ashtu, po ju them disa fjalë, vetëm sepse jeni dishepuj të Falun Dafës: “Kurrë mos i lexoni ato libra të korruptuar qigongu.” Unë nuk i referohem teksteve klasike të mëparshëm, por atyre librave të rremë qigongu të shkruara nga njerëzit e sotëm. Ju nuk duhet as edhe ti hapni ato. Nëse një ide ju shkrepi në mendje “epo kjo fjali duket e arsyeshme”, me këtë ide, shpirtërat apo kafshët zotëruese në libër do të të ngjiten në trup. Shumë libra janë shkruar nën kontrollin e kafshëve apo shpirtërave të këqinj që manipulojnë dëshirat njerëzore për famë dhe pasuri. Ka plot, ka me të vërtetë shumë libra të rremë qigongu. Shumë njerëz po tregohen të papërgjegjshëm dhe po shkruajnë libra me kafshë apo shpirtëra zotërues dhe gjëra të tjera të këqija të përziera në to. Normalisht, është mirë të mos lexoni as edhe librat klasike të përmendura më lart apo shkrime të tjera klasike të ngjashme, sepse kjo ka të bëjë me çështjen e të ndjekurit të një praktike.

Një zyrtar nga Shoqata e Kërkimeve të Qigongut të Kinës më tregoi një histori që më bëri me të vërtetë për të qeshur. Ai më tha se ishte një person në Beijing që shkonte shpesh në seminare qigongu. Pasi dëgjoi shumë ligjërata, ai kujtoi se qigongu nuk ishte asgjë më shumë nga ç’thuhej atje. Meqënëse të gjithë ishin në të njëjtin nivel, ata të gjithë flisnin për të njëjtat gjëra. Ashtu si dhe mjeshtrit e tjerë të rremë qigong, ai mendoi se kjo ishte e gjithë përmbajtja e qigongut! Më vonë edhe ai donte të shkruante një libër mbi qigongun. Pa mendoni pak të gjithë: Një person që nuk është praktikues do të shkruante një libër qigongu. Në ditët e sotme, librat e qigongut kopjohen nga njëri tjetri. Ndërsa shkrimi i tij përparonte, ai ngeci në çështjen e Kalimit të Fshehtë. Kush e kuptonte se çfarë është Kalimi i Fshehtë? Edhe midis mjeshtërve të vërtetë qigong, pak vetë e kuptojnë atë. Ai shkoi dhe pyeti një mjeshtër të rremë qigongu. Ai nuk e dinte që personi ishte i rremë, pasi ai vetë gjithësesi nuk kuptonte nga qigongu. Por nëse ky mjeshtër i rremë qigongu nuk mund t’i përgjigjej pyetjes, a nuk do ta kuptonin të tjerët që ai ishte i rremë? Prandaj ai guxoi ta sajonte dhe tha se Një Hapje e Kalimit të Fshehtë gjendet në majën e organit privat mashkullor. Tingëllon mjaft qesharake. Mos qeshni, pasi ky libër tashmë është botuar. Kjo tregon se librat e sotëm të qigongut janë bërë kaq qesharakë. Çfarë vlere ka që t’i lexoni këto libra? Nuk kanë asnjë vlerë dhe vetëm janë të dëmshëm.

⁸ *Udhëzues për të Gjetur Naturën dhe Jetëgjatësinë*—tekst klasik kinez për praktikë kultivuese.

Çfarë është “Vendosja e Kalimit të Fshehtë”? Në praktikën e Ligjit-Në-Botën-Trefishe të një individi, kur kultivimi i personit ka arritur përtej niveleve mesatare apo ndryshe në nivelin e lartë të Ligjit-Në-Botën-Trefishe, Foshnja e Pavdekshme fillon të zhvillohet. Foshnja e Pavdekshme është e ndryshme nga ata që ne quajmë Foshnjet e Kultivuara⁹ (*yinghai*). Foshnjet e Kultivuara janë të vegjël, plot gjallëri dhe sillen përçark me gëzim. Foshnja e Pavdekshme nuk lëviz. Nëse Shpirti Primordial i personit nuk e merr nën kontrollon, Foshnja e Pavdekshme do të rrijë ulur pa lëvizur mbi një lule lotusi¹⁰ me dy këmbët e kryqëzuara mbi njëra tjetrën dhe me dy duart e bashkuara. Foshnja e Pavdekshme rritet prej dantian dhe mund të shikohet në nivelin mikroskopik edhe kur është më e vogël se maja e gjilpërës.

Po ashtu një tjetër çështje duhet sqaruar. Ekziston vetëm një fushë dantian e vërtetë dhe kjo gjendet në pjesën e poshtme të barkut. Ajo ndodhet mbi pikën *huiyin*¹¹ dhe poshtë barkut brenda në trup. Shumë forma gongu, shumë aftësi supernormale, shumë aftësi, Fashen, Foshnja e Pavdekshme, Foshnjet e Kultivuara dhe shumë qenie të tjera lindin nga kjo fushë.

Në të kaluarën, ka patur disa praktikues që flisnin për dantian të sipërm, të mesëm dhe të poshtëm. Unë do të thoja që ata e kishin gabim. Disa njerëz gjithashtu pohojnë që mjeshtrit e tyre i kanë mësuar ata kështu për breza me radhë dhe se librat thonë të njëjtën gjë. Më lejoni t’ju them të gjithëve se ka patur gjeputura edhe në kohët e lashta. Edhe pse disa gjëra janë trashëguar për vite me radhë, kjo nuk do të thotë se ato janë të sakta. Disa mënyra të vogla kultivimi në botë janë transmetuar gjithmonë midis njerëzve, por ato nuk janë për kultivim dhe nuk janë për asgjë. Kur ata e quajnë atë dantian i sipërm, dantian i mesëm dhe dantian i poshtëm, ata duan të thonë se ekziston dantian kudo ku mund të rritet dan. A nuk është kjo qesharake? Kur mendja e një njeriu përqëndrohet diku në një pjesë trupi për një kohë të gjatë, një grumbull energjie do të zhvillohet dhe do të formojë dan. Nëse nuk e besoni, mbajeni mendjen të përqëndruar në krah dhe mbajeni aty për një kohë të gjatë dhe aty do të formohet dan. Prandaj, disa njerëz e kanë konstatuar një situatë të tillë dhe deklarojnë që dantian gjendet kudo. Kjo tingëllon akoma me qesharake. Ata mendojnë se dantian është kudo ku formohet dan. Në fakt, ky është dan por jo fushë dan-i. Ju mund të thoni se dan-i është kudo, ose që ekziston dan i sipërm, dan i mesëm dhe dan i poshtëm. Sidoqoftë, ekziston vetëm një fushë dan-i që mund të zhvillojë Ligje të panumërta dhe ajo është në pjesën e poshtme të barkut. Prandaj, thëniet për dantian të sipërm, dantian të mesëm dhe dantian të poshtëm janë të gabuara. Kudo që mendja përqëndrohet për një kohë të gjatë, atje do të formohet dan.

Foshnja e Pavdekshme rritet ngadalë nga dantian në pjesën e poshtme të barkut duke u bërë gjithnjë e më e madhe. Kur bëhet e madhe sa një top ping-pongu, forma e trupit të saj do të jetë shumë e dukshme me hundën dhe sytë të formuara. Në të njëjtën kohë kur Foshnja e Pavdekshme është e madhe sa një top ping-pongu, një flluckë e vogël rrumbullake do të lindë pranë saj. Pas lindjes, fllucka do të rritet bashkë me Foshnjen e Pavdekshme. Kur Foshnja e Pavdekshme bëhet dhjetë centimetra e gjatë, një petale lule lotusi do të shfaqet. Kur Foshnja e Pavdekshme bëhet trembëdhjetë apo pesëmbëdhjetë centimetra e gjatë, petalet e lotusit do të jenë formuar dhe do të shfaqet një shtresë petalesh lotusi. Një Foshnjë e Pavdekshme e artë dhe e shndritshme do të qëndrojë ulur mbi një pjatë lotusi të artë—duket shumë e bukur. Ky është trupi i Vajrës që nuk priset kurrë, i cili quhet “Trup Buddha” në Shkollën e Buddhës, apo “Foshnja e Pavdekshme “ në Shkollën Tao.

⁹ Foshnjet e Kultivuara—ndryshe çerub apo engjëll (nga Bibla) zakonisht të paraqitura në piktura si fëmijë të shëndetshëm me krahë.

¹⁰ lule lotusi—1.zambak uji zakonisht i bardhë apo rozë; 2. në Shkollën e Buddhës simbolizon shumë gjëra ndërmjet të cilave arrijten e pastërtisë, ashtu si lotusi del nga balta e liqenit dhe shkëlqen me bukuri, ashtu dhe ndërgjegja e një kultivuesi ngrihet mbi ambientin njerëzor dhe arrin lartësimin shpirtëror. Statujat e lashta të Buddhës dhe Bodhisattvave qëndrojnë mbi lule lotusi.

¹¹ *huiyin*—pikë akupunkturë në qendër të perineut (pjesa ndërmjet organit të jashtëqitjes dhe organeve gjinitale).

Praktika e shkollës sonë kultivon dhe kërkon të dyja format e trupit; benti duhet gjithashtu të transformohet. Dihet nga të gjithë që një trup Buddhe nuk lejohet të shfaqet midis njerëzve të zakonshëm. Me shumë përpjekje, ai mund të tregojë formën dhe shkëlqimi i tij mund të shihet me sytë e një njeriu të zakonshëm. Sidoqoftë pas transformimit, trupi fizik duket njësoj me atë të një njeriu të zakonshëm. Një njeri i zakonshëm nuk mund të shikojë ndryshimin, megjithëse ky trup mund të udhëtojë nëpër dimensione. Kur Foshnja e Pavdekshe bëhet dhjetë deri dymbëdhjetë centimetra e gjatë, fllucka e ajrit do të rritet gjithashtu në po atë lartësi dhe është e tejudkshme si një tullumbac me ajër. Foshnja e Pavdekshme qëndron aty pa lëvizur e ulur në pozicion meditimi. Në këtë kohë fllucka e ajrit do të shkëputet nga dantian. Meqenëse është rritur dhe ka arritur pjekurinë, ajo do të ngjitet lart. Proçesi i lëvizjes lart është shumë i ngadalshëm, por lëvizja e saj mund të vëzhgohet çdo ditë. Ajo gradualisht lëviz lart e më lart. Me vëmendje të kujdesshme, ne jemi të aftë ta ndjejmë ekzistencën e saj.

Kur fllucka e ajrit arrin në pikën *tanzhong*,¹² ajo do të qëndrojë atje për ca kohë. Meqenëse atje gjëndet shumë esencë e trupit të njeriut (zemra është atje gjithashtu), një sistem gjërash do të formohen në flluckën e ajrit. Fllucka e ajrit do të pajiset me këtë esencë. Pas ca kohe, ajo do të lëvizë përsëri lart. Kur të kalojë nëpër fyt, personi do ndjejë sikur po mbytet, sikur venat e gjakut i janë bllokuar dhe personi do të ndjejë një fryrje të sikletshme. Kjo do të zgjasë vetëm disa ditë. Pastaj fllucka e ajrit do të lëvizë lart në majën e kokës dhe ne e quajmë këtë “mbrirje në niwan”. Thuhet se ka arritur në niwan ndërsa në fakt ajo është e madhe sa dhe gjithë koka juaj. Ju do e ndjeni kokën të fryrë. Për arsye se niwan është një vend shumë i rëndësishëm për njeriun, esenca e saj duhet gjithashtu të formohet në flluckën e ajrit. Pastaj fllucka e ajrit do të përpiqet të dalë jashtë nga tuneli i Syrit Qiellor dhe kjo do të jetë tepër e sikletshme. Syri Qiellor do të ketë një shtrëngim deri në dhimbje dhe personi do t’i ndjejë tëmthata të fryra ndërsa sytë sikur po shpojnë për nga Brenda. Kjo ndjenjë do të zgjasë derisa fllucka e ajrit të dalë nga tuneli i Syrit Qiellor dhe të varet përpara ballit. Kjo quhet Vendosja e Kalimit të Fshehtë—ajo qëndron atje varur.

Në këtë kohë, ata që kanë Syrin Qiellor të hapur nuk mund të shohin gjë. Kjo për arsye se në praktikën kultivuese në Shkollën e Buddhës apo në Shkollën Tao, dera e saj mbyllet që të përshpejtojë formimin e gjërave brenda Kalimit të Fshehtë. Janë dy dyer në fillim dhe dy në fund dhe ato janë të gjitha të mbyllura. Si dyert e sheshit Tiananmen në Beijing, gjënden dy dyer të mëdha në të dyja anët. Me qëllim që Kalimi i Fshehtë të formohet dhe pasurohet shpejt, dyert nuk mbahen të hapura me përjashtim në rrethana shumë të veçanta. Një njeri që mund të shohë me Syrin Qiellor, në këtë fazë nuk mund të shohë asgjë pasi nuk i lejohet. Cili është qëllimi i të qëndruarit varur atje? Ngaqë qindra kanale energjie në trupin tonë takohen atje, në këtë kohë ato duhet të qarkullojnë të gjitha përmes Kalimit të Fshehtë dhe pastaj të dalin jashtë tij. Ato duhet të kalojnë nëpër Kalimin e Fshehtë dhe qëllimi është që të vendosen disa baza suplementare dhe të formohet një sistem gjërash brenda Kalimit të Fshehtë. Meqenëse trupi i njeriut është një univers i vogël, ai formon një botë të vogël me të gjitha gjërat bazë të trupit të njeriut. Sidoqoftë ai është akoma vetëm një vend që nuk funksionon akoma.

Në praktikën kultivuese të Shkollës Qimen, Kalimi i Fshehtë mbahet hapur. Kur Kalimi i Fshehtë del përjashta, ai është si cilindër dhe gradualisht do të bëhet i rrumbullakët. Dyert e tij në të dyja anët janë kështu të hapura. Për arsye se Shkolla Qimen nuk kultivon Buddhë apo Tao, secili duhet të mbrojë vetveten. Ka shumë mjeshtër në Shkollën e Buddhës dhe të Taos dhe ata të gjithë mund t’ju ruajnë. Ju nuk keni nevojë të shikoni dhe as nuk do të keni ndonjë problem. Por nuk është kështu në shkollën Qimen, pasi secili duhet të mbrojë veten. Prandaj, personi duhet ta ruajë aftësinë për të parë. Në këtë kohë, Syri Qiellor i personit i shikon gjërat si me teleskop. Pasi të formohet ky

¹² *tanzhong*—pikë akupunture që gjëndet afërsisht në qendër të gjoksit.

sistem, për nja një muaj, ai fillon të futet brenda. Me t'u futur brenda në kokë, kjo quhet ndryshimi i pozicionit të Kalimit të Fshehtë.

Kur Kalimi i Fshehtë kthehet brenda, personi do ta ndjejë kokën të enjtur dhe të parehatshme. Më pas ai do të dalë me forcë jashtë nga pika *yuzhen*¹³. Edhe kjo dalje e bën personin që të ndjehet në siklet, sikur po i hapet koka. Kalimi i Fshehtë do të dalë jashtë menjëherë dhe ju do të ndjeheni të çliruar. Pasi del jashtë, Kalimi i Fshehtë do të qëndrojë varur në një dimension shumë të thellë dhe ekziston në formë trupi të një dimensionit shumë të thellë. Prandaj, ju nuk do ta shtypni kur fleni. Por është një gjë: Kur Vendosja e Kalimit të Fshehtë ndodh për herë të parë, ju do të ndjeni diçka përpara syve. Megjithëse ndodhet në një dimension tjetër, ju gjithmonë ndjeni sikur sytë ju janë turbulluar, sikur i mbulon diçka, duke ju bërë të ndjeheni shumë në siklet. Për arsye se pika *yuzhen* është një kalim shumë i rëndësishëm, Kalimi i Fshehtë duhet gjithashtu të formojë një sistem gjërash atje. Pastaj ai kthehet përsëri brenda në trup. Një Hapje e Fshehtë në fakt nuk i referohet pozicionit të Kalimit të Fshehtë sepse ai duhet të ndryshojë pozicion shumë herë. Kur ai kthehet në niwan, ai fillon të zbresë në trup deri sa arrin pikën *mingmen*¹⁴. Në pikën *mingmen* ai do të dalë përsëri jashtë.

Pika *Mingmen* në trupin e njeriut është një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe kryesore. Ajo quhet “hapje” në Shkollën Tao dhe “Kalim” (*guan*) nga ne. Është një kalim kryesor i cili me të vërtetë ngjan me një portë hekuri dhe ka shtresa të shumta dyersh hekuri. Dihet që trupi i njeriut ka shumë shtresa. Qelizat e trupit tonë fizik përbëjnë një shtresë dhe molekulat brenda tij janë një tjetër shtresë. Gjendet një portë në secilën shtresë të atomeve, protoneve, elektroneve dhe pjesësive shumë mikroskopike, pjesësive pafundësisht mikroskopike. Prandaj, gjenden shumë aftësi supernormale dhe shumë dhunti të veçanta të kyçyra brenda portave të shtresave të ndryshme. Praktikantët e tjera kultivojnë dan. Kur dan është gati për të shpërthyer, pika *mingmen* është e para që do të shpërthehet. Nëqoftëse ajo nuk hapet me të shpërthyer, aftësitë supernormale nuk mund të çlirohen. Pasi Kalimi i Fshehtë formon një sistem në pikën *mingmen*, ai do të kthehet përsëri brenda në trup. Pastaj ai kthehet në pjesën e fundit të barkut. Kjo quhet “Kalimi i Fshehtë kthehet në pozicion”.

Në kthim, Kalimi i Fshehtë nuk shkon në vendin e vet të origjinës. Tashmë, Foshnja e Pavdekshme është rritur goxha. Fllucka e ajrit do ta mbulojë Foshnjen e Pavdekshme dhe do e mbështjellë atë. Kur rritet Foshnja e Pavdekshme, po ashtu rritet dhe Kalimi i Fshehtë. Në Shkollën Tao, zakonisht kur Foshnja e Pavdekshme rritet sa një fëmijë rreth gjashtë apo shtatë vjeç, ajo do të lejohet të lërë trupin e njeriut; kjo quhet “Foshnja e Pavdekshme vjen në jetë.” Nën kontrollin e Shpirtit Kryesor të personit, ajo mund të lëvizë rrotull jashtë trupit të njeriut. Trupi fizik nuk lëviz por Shpirti Kryesor do të dalë jashtë. Normalisht në Shkollën e Buddhës, Foshnja e Pavdekshme do të jetë jashtë çdo rreziku kur është kultivuar e rritur sa vetë personi. Në këtë kohë, zakonisht lejohet që ajo ta lërë trupin dhe të dalë jashtë tij. Tashmë Foshnja e Pavdekshme është rritur aq sa dhe vetë personi dhe mbulesa e saj është gjithashtu e madhe. Mbulesa tashmë është zgjeruar nga jashtë trupit të njeriut—ky është kalimi i Fshehtë. Për shkak se Foshnja e Pavdekshme është rritur kaq shumë, Kalimi i Fshehtë sigurisht do të zgjerohet nga jashtë trupit.

Ndoshta ju keni parë statuja të Buddhës në tempuj dhe keni vënë re që Buddhat janë gjithmonë brenda një rrethi. Veçanërisht, një portret Buddha gjithmonë ka një rreth në të cilin Buddha qëndron ulur. Shumë portrete të Buddhës janë kështu veçanërisht ato në tempujt e vjetër. Pse ulet Buddha brenda një rrethi? Askush nuk mund ta shpjegojë këtë qartë. Më lejoni t'ju them që është pikërisht ky Kalim i Fshehtë, por në këtë kohë ai nuk quhet më Kalim i Fshehtë. Quhet “parajsë”, megjithëse në fakt nuk është akoma parajsë sepse ka vetëm aftësinë për të qënë. Është si një fabrikë me ndërtesa, por pa aftësinë për të prodhuar. Duhet të ketë burime energjie dhe lëndë të para që ajo të prodhojë. Pak vite më parë, shumë praktikues thonin: “Niveli i gongut tim është më i lartë se i një Bodhisattva,” apo “Niveli i gongut tim është më i lartë se ai i një Buddha.” Me të dëgjuar këtë, të

¹³ *yuzhen*—pikë akupunkturë që ndodhet në rrëzë të kokës prapa.

¹⁴ *mingmen*—“Porta e jetës”; një pikë akupunkturë që ndodhet në mes të pjesës së poshtme të kurrizit.

tjerët do ta konsideronin si të pakonceptueshme. Në fakt, kjo që thonin ata nuk ishte aspak e pakonceptueshme, sepse gongu personit duhet me të vërtetë të kultivohet në një nivel shumë të lartë në botën njerëzore.

Si mund të jetë e mundur një gjë e tillë: Ata kanë arritur një nivel më të lartë se ai i një Buddha? Nuk duhet kuptuar në mënyrë kaq sipërfaqësore. Gongu i këtij personi është me të vërtetë në një nivel shumë të lartë. Kjo për arsye se kur kultivimi i tij arrin një nivel shumë të lartë dhe momentin e lartësimit të plotë shpirtëror, niveli i gongut të tij do të jetë me të vërtetë shumë i lartë. Vetëm pak çaste para arritjes së lartësimit të plotë shpirtëror, tetë të dhjetat e gongut të tij do t'i zbriten bashkë me standartin e karakterit dhe kjo energji do të përdoret për të pasuruar parajsën—një parajsë të tijën. Të gjithë e dinë që përveç standartit të karakterit, gongu i një praktikuesi kultivohet përmes vuajtjeve të shumta gjatë gjithë jetës dhe duke kaluar përmes ambjentesh të vështira. Prandaj ai është jashtëzakonisht i çmuar. Tetë të dhjetat e kësaj materie të çmueshme përdoret për të pasuruar parajsën e tij. Prandaj, kur ai ia arrin kultivimit në të ardhmen, ai do të ketë gjithçka që don vetëm me një të zgjatur të dorës dhe do të ketë çdo gjë që dëshiron. Ai mund të bëjë çfarëdo gjë që don dhe çdo gjë gjëndet në parajsën e tij. Ky është virtyti i tij i plotëfuqishëm që ai ka kultivuar nëpërmjet vuajtjeve të tij.

Kjo energji e personit mund të transformohet në gjithshka sipas dëshirës. Prandaj, nëqoftëse një Buddha dëshiron të ketë diçka, të hajë diçka, apo të luajë me diçka, ai mund ta bëjë këtë. Këto janë rrjedhojë e arritjes së tij në kultivimin, që është Statusi i tij prej Buddha (*fowei*). Pa të, një person nuk mund t'ja arrijë në kultivim. Në këtë kohë ajo mund të quhet parajsë. Ky person do të ketë vetëm dy të dhjetat e gongut të mbetur për të përfunduar kultivimin dhe të arrijë Taon. Megjithëse vetëm dy të dhjetat e gongut të tij ka mbetur, trupi i tij nuk është i kyçur. Ai ose mund ta lërë ose mund ta mbajë këtë trup, sidoqoftë ky trup do të jetë transformuar tashmë në materie të energjisë së lartë. Në këtë kohë, ai mund të ushtrojë fuqitë e tij hyjnore të cilat kanë pushtet të pakrahasueshëm. Por kur një person praktikon kultivim midis njerëzve të zakonshëm, ai zakonisht është i kyçur, pa ndonjë aftësi të madhe. Pamvarësisht sa i lartë është niveli i gongut të tij, ai është akoma i kufizuar. Tani është ndryshe.

LEKSIONI I PESTË

Emblema e Falunit

Simboli i Falun Dafës është Falun. Ata me aftësi supernormale mund të shikojnë që ky Falun rrotullohet. E njëjta gjë ndodh me stemat tona të vogla me Falun, të cilat gjithashtu rrotullohen. Praktika jonë kultivuese udhëhiqet nga Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), karakteristika e universit dhe nga parimet e evolucionit të kozmosit. Prandaj ajo që kultivojmë ne është e pamasë. Në një farë kuptimi, kjo emblemë Faluni është një miniatyrë e universit. Shkolla Buddhës e koncepton universin si një botë me dhjetë drejtime, me katër faqe dhe tetë anë. Mbase disa njerëz mund të shikojnë një kolonë vertikale energjie mbi dhe nën Falun. Me pjesën e lartme dhe të poshtme të tij, Falun përbën me saktësi botën e dhjetë drejtimeve dhe përfaqëson këtë univers. Ai përfaqëson përmbledhjen e universit të Shkollës së Buddhës.

Ky univers, natyrisht përbëhet nga galaksi të shumta që përfshin dhe Kashtën e Kumtrit. I tërë universi është në lëvizje dhe po ashtu dhe galaksitë brenda tij. Prandaj, simbolet Taiji si dhe *svastikat*¹ (卐) e vogla që ndodhen në emblemë gjithashtu rrotullohen. I tërë Faluni rrotullohet dhe simboli i madh i svastikës (卐) që ndodhet në qendër të emblemës gjithashtu rrotullohet. Në një mënyrë, ajo simbolizon Kashtën tonë të Kumtrit. Për arsye se ne jemi nga Shkolla e Buddhës, qendra e emblemës mban simbolin e Shkollës së Buddhës. Kështu duket ajo në sipërfaqe. Të gjitha substancat kanë format e tyre të ekzistencës në dimensione të tjera ku ato kanë një proces zhvillimi shumë të zgjeruar dhe kompleks si dhe format e veta të ekzistencës. Kjo emblemë e Falunit është miniatyrë e universit. Ajo ka gjithashtu formën e vet të ekzistencës dhe procesin e zhvillimit në gjithë dimensionet e tjera, prandaj unë e quaj atë një botë.

Kur Falun rrotullohet në drejtim të akrepave të orës, ai automatikisht thith energji nga universi. Kur rrotullohet në drejtim të kundërt ai çliron energji. Rrotullimi i drejtuar nga brenda (në drejtim të akrepave) ofron vetëshpëtim ndërsa rrotullimi i drejtuar nga jashtë (në drejtim të kundërt të akrepave) ofron shpëtim për të tjerët—ky është një tipar i praktikës sonë. Disa njerëz më kanë pyetur: “Përderisa ne jemi nga Shkolla e Buddhës, pse ndodhet simboli Taiji në Falun? A nuk i përket Taiji Shkollës Tao?” Kjo ndodh për arsye se ajo që ne kultivojmë është shumë e pamasë, e cila është njësoj sikur të kultivosh të tërë universin. Pra mendojeni pak, të gjithë: Ky univers konsiston në dy shkolla kryesore, Shkolla Buddhës dhe Shkolla Tao. Përrjashtimi i secilës prej tyre, nuk do të përbënte një univers të plotë dhe as që mund të quhesh një univers i plotë. Për rrjedhim, ne kemi përfshirë gjëra nga Shkolla Tao. Gjithashtu, disa njerëz thonë që përveç Shkollës Tao është edhe Kristianizmi, Konfucionizmi, fe të tjera etj. Më lejoni t’ju them që pasi kultivimi i tij arrin një nivel shumë të lartë, Konfucionizmi i përket Shkollës Tao; kur shumë praktika kultivuese fetare perëndimore arrijnë nivele të larta, ato klasifikohen në të njëjtin sistem me tonin, në Shkollën e Buddhës. Ekzistojnë vetëm dy sisteme shkollash kryesore.

Atëhere pse dy nga simbolet Taiji kanë ngjyrë të kuqe lart dhe blu poshtë dhe dy të tjerët kanë të kuqe lart dhe të zezë poshtë? Ajo që njihet në përgjithësi është se Taiji përbëhet nga dy substanca, një e zezë dhe një e bardhë, qi-ja e yin dhe yang. Ky concept vjen nga një nivel shumë i ulët sepse Taiji ka manifestime të ndryshme në dimesione të ndryshme. Në nivelin më të lartë ngjyrat e tij manifestohen në këtë mënyrë. Tao që ne në përgjithësi kuptojmë ka të kuqe lart dhe të zezë poshtë. Për shembull, disa nga praktikuesit tanë me Syrin Qiellor të hapur kanë zbuluar që e kuqja që ata

¹ *svastika*—“Rrotë drite” nga Sanskrit, simboli e ka origjinën mbi 2500 vjet më parë dhe është zbuluar në gërmimet tokësore të relikeve kulturore në Greqi, Peru, Indi, Kinë etj.. Për shekuj ka pasur kuptimin e fatit të mirë, ka simbolizuar djellin dhe mbahej si shenjë positive.

shohin me sy është e gjelbërt në dimensionin tjetër më të afërt. Ngjyra e artë shikohet si ngjyrë manushaqe në një dimension tjetër pasi ajo ka këtë transformim. Me fjalë të tjera, ngjyrat ndryshojnë nga dimensionin në dimension. Taiji me të kuqen lart dhe blunë poshtë i përket Shkollës së Madhe Primordiale të Taos e cila përfshin praktikën kultivuese të Shkollës Qimen. Katër simbolet e vogla ☯ janë nga Shkolla e Buddhës. Ato janë të njëjta me atë në qendër, e cila është gjithashtu nga Shkolla e Buddhës. Falun me këto ngjyra është relativisht i shndritshëm dhe ne e përdorim atë si simbol të Falun Dafës.

Faluni që ne shikojmë nëpërmjet Syrit Qiellor nuk është e thënë të ketë këto ngjyra, sepse ngjyra e sfondit të tij mund të ndryshojë megjithëse renditja nuk ndryshon. Kur Faluni që unë kam vendosur në pjesën e poshtme të barkut tuaj rrotullohet, Syri juaj Qiellor mund ta shohë atë si të kuqe, manushaqe, të gjelbërt apo ndoshta pa ngjyrë. Ngjyra e sfondit ndryshon vazhdimisht me këtë radhë, e kuqe, portokalli, e verdhë, e gjelbërt, e kaltërt, blu dhe manushaqe. Si rezultat, ajo që ju shikoni mund të jetë në ngjyra të ndryshme, por simbolet svastika apo ngjyrat dhe renditja e Taiji-ve do të mbeten të pandryshuara. Ne mendojmë se kjo ngjyrë e sfondit duket relativisht mirë, kështu që ne e kemi adoptuar atë. Ata më aftësi supernormale mund të shohin shumë gjëra përtëj këtij dimensionin.

Disa njerëz thonë: “Ky simbol ☯ duket si ai i Hitlerit”. Më lejoni t’ju them që ky simbol në vetvete nuk përmban asnjë koncept shoqëror. Disa njerëz thonë: “Nëqoftëse cepat i ka të kthyera nga kjo anë, është shenja e Hitlerit”. Nuk është aspak kështu për arsye se ajo rrotullohet në të dyja anët. Shoqëria jonë njerëzore filloi ta njohë këtë simbol gjërësisht 2500 vjet me parë në kohën e Sakyamunit. Kanë kaluar vetëm disa dekada që nga koha e Hitlerit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai e përvetësoi atë, por ngjyra që ai përdori ishin ndryshe nga e jona. Ajo ishte e zezë me cepat drejtuar nga lart dhe në pozicion vertikal. Kaq kam për të thënë përsa i përket Falunit, megjithëse kam përmendur vetëm formën e saj sipërfaqësore.

Atëhere çfarë simbolizon kjo svastika ☯ në Shkollën tonë të Buddhës? Disa njerëz thonë që ajo simbolizon fat të mirë, që është interpretim i njerëzve të zakonshëm. Më lejoni t’ju them që ☯ përfaqëson nivelin e një Buddhë. Vetëm ata që arrijnë nivelin e Buddhës e kanë atë. Një Bodhisattva apo një Arhat nuk e ka. Por Bodhisattvat e një rangu më të lartë, si Katër Bodhisattvat e Mëdha e kanë atë. Ne kemi parë se këto Bodhisattva të Mëdha e kanë tejkaluar nivelin e Buddhëve të zakonshëm dhe janë më lart edhe se një Tathagata. Përtej nivelit të Tathagatës gjenden shumë Buddha. Një Tathagata ka vetëm një simbol ☯. Ata që kanë arritur përtej nivelit të Tathagatës do të kenë më shumë simbole ☯. Buddha niveli i të cilit është dy herë më i lartë se i një Tathagate ka dy simbole ☯. Për ata që janë akoma më lart, ata kanë tre, katër pesë svastika e kështu me radhë. Disa kanë kaq shumë svastika sa ato janë në të gjithë trupin, duke përfshirë kokën, shpatullat dhe gjunjët. Kur ka shumë prej tyre, ato do të shfaqen dhe në pëllëmbët e duarve, gishtërinj, këmbë, gishtat e këmbëve etj. Sa më shumë ngrihet niveli, aq më shumë simbole ☯ do të ketë. Prandaj simboli ☯ përfaqëson nivelin e një Buddhë. Sa më i lartë niveli i Buddhës, aq më shumë simbole ☯ ka ai.

Shkolla Qimen

Përveç Shkollës e Buddhës dhe Shkollës Tao, ekziston dhe Shkolla Qimen, e cila e quan veten praktikën kultivuese Qimen. Përsa i përket praktikave kultivuese, njerëzit e zakonshëm kanë këtë perceptim: Që nga Kina e lashtë deri më sot njerëzit e kanë konsideruar Shkollën e Buddhës dhe të Taos si mënyra kultivimi ortodokse dhe i quajnë ato shkollat të vërteta të praktikës kultivuese. Kjo Shkolla Qimen nuk është bërë kurrë e njohur publikisht dhe shumë pak njerëz kanë dëgjuar për ekzistencën e saj, me përjashtim të veprave letrare.

A ekziston pra kjo Shkollë Qimen? Po, ekziston. Gjatë kohës së praktikës sime kultivuese veçanërisht në vitet e fundit, unë jam takuar me tre mjeshtrë shumë të arrirë nga Shkolla Qimen. Ata më kaluan mua thelbin e praktikave të tyre, gjëra shumë të veçanta dhe të mira. Thjesht për arsye se ajo është shumë e veçantë, ajo që ajo kultivon është shumë e pazakontë dhe nuk mund të kuptohet nga shumica e njerëzve. Përveç kësaj, ata pohojnë që nuk janë as nga Shkolla Buddhës dhe as nga Shkolla Tao. Ata nuk kultivojnë Buddha apo Tao. Me të dëgjuar se ata nuk kultivojnë Buddha apo Tao, njerëzit e quajnë atë “Derë Anësore dhe Rrugë e Ngathët” (*pangmen zuodao*). Ata e quajnë veten Shkolla Qimen. Derë Anësore dhe Rrugë e Ngathët ka një nënkuptim ofendues, por këtu nuk ka kuptim negativ, sepse ajo nuk e akuzon shkollën si një praktikë të keqe—kjo është e sigurt. Edhe përkufizimi letrar i këtij termi nuk nënkupton një praktikë të keqe. Historikisht Shkolla Buddhës dhe Shkolla Tao kanë qenë quajtur “shkolla ortodokse” të praktikës kultivuese. Kur kjo praktikë nuk kuptohet nga publiku, njerëzit e quajnë atë “Derë Anësore” ose rrugë anësore dhe një shkollë joortodokse. Çfarë është atëhere “Rruga e Ngathët”? “E ngathët” nënkupton përtacëri apo mënyrë të ngadaltë. Një term i ardhur nga Kina e lashtë, “i ngathët” shpesh i referohej të qenit të ngadaltë. Derë Anësore dhe Rrugë e Ngathët mbart këtë kuptim.

Pse nuk është ajo një praktikë e keqe? Kjo për arsye sepse ajo ka gjithashtu kërkesa të rrepta mbi karakterin. Praktika e saj kultivuese ndjek gjithashtu karakteristikën e universit. Ajo nuk shkel karakteristikën apo ligjin e universit dhe as nuk kryen vepra të këqija. Prandaj, ajo nuk mund të quhet një praktikë e ligë. Shkolla Buddhës dhe Shkolla Tao janë shkolla ortodokse, jo sepse karakteristika e universit i përshtatet praktikës së tyre, por sepse praktikat e të dy shkollave i përmbahen karakteristikës së universit. Nëqoftëse praktika kultivuese e Shkollës Qimen gjithashtu i përmbahet karakteristikës së universit, ajo nuk është një praktikë e ligë por një shkollë e drejtë. Kjo për arsye se kriteri për të dalluar të mirën nga e keqja dhe mirësinë nga ligësia është karakteristika e universit. Kultivimi i saj i përmbahet karakteristikës së universit, kështu që ajo është një rrugë e drejtë, pavarësisht nëse kërkesat e saj ndryshojnë nga ato të Shkollës Buddhës dhe të Taos. Ajo nuk mëson shumë dishepuj por i mësohet vetëm një grupi shumë të vogël njerëzish. Shkolla Tao mëson shumë dishepuj, por vetëm një dishepull merr mësimin e vërtetë. Shkolla Buddhës beson në shpëtimin e të gjitha qenieve, kështu që kushdo që mund të praktikojë mund ta arrijë atë.

Shkolla Qimen nuk mund të trashëgohet nga dy persona, sepse ajo i transmetohet vetëm një personi të zgjedhur gjatë një periudhë të gjatë historike. Prandaj, gjatë gjithë historisë gjërat e saj nuk mund të njiheshin nga njerëzit e zakonshëm. Natyrisht kur qigong ishte popullor, unë konstatova që pak njerëz nga kjo shkollë dolën për të mësuar. Megjithatë, pas disa mësimëve në publik, ata kuptuan që kjo nuk ishte e arritshme sepse mjeshtri nuk lejonte që disa gjëra t’i trasmetoheshin publikut. Nëqoftëse doni të mësoni publikun, ju nuk mund të zgjidhni nxënësit. Ato që vijnë për të mësuar do të sjellin nivele të ndryshme karakteri dhe mentalitete të ndryshme sepse ato janë njerëz nga të gjitha llojet. Do të jetë e pamundur për ju që të zgjidhni dishepujt për t’i mësuar. Prandaj, Shkolla Qimen nuk mund të mësohet gjërësisht në publik. Duke vepruar kështu mund të jetë me rrezik sepse praktika e saj është shumë e veçantë.

Disa njerëz mundohen të kuptojnë: ndërsa Shkolla Buddhës kultivon Buddha dhe Shkolla Tao kultivon Tao, çfarë do të bëhet një praktikues në Shkollën Qimen pasi të përfundojë kultivimin? Ky person do të jetë një Zot shëtitës pa ndonjë kufi të caktuar në univers. Dihet nga të gjithë se Tathagata Sakyamuni ka Parajsën Saha, Buddha Amitabha ka Parajsën e Lumturisë Absolute dhe Buddha Bhaishajyaguru ka Parajsën e Xhamtë. Çdo Tathagata apo Buddha i madh ka parajsën e tij. Çdo Qenie e Shumëlartësuar ndërton mbretërinë qiellore të tij dhe shumë nga dishepujt e tij jetojnë atje. Ndërsa një nga Shkolla Qimen nuk ka ndonjë kufi të caktuar në univers dhe ky person do të jetë si një Zot shëtitës apo i Pavdekshëm i vetmuar.

Të Praktikosh një Praktikë të Ligë

Çfarë do të thotë “të praktikosh një praktikë të ligë”? Kjo ka disa forma. Ka njerëz që specializohen në praktikën e kultivimit të lig, sepse gjatë gjithë historisë ka pasur njerëz që i kanë trasmetuar këto gjëra. Pse janë trasmetuar ato? Kjo për arsye se ata kërkojnë famë, përfitime personale dhe para midis njerëzve të zakonshëm; këto gjëra duan ata. Natyrisht, një person i tillë nuk ka një nivel të lartë karakteri dhe nuk mund të marrë gong. Çfarë mund të marrë ai? Karmë. Kur dikush ka shumë karmë, ajo gjithashtu mund të kthehet në një formë energjie. Por ky njeri nuk ka ndonjë nivel dhe as që mund të krahasohet me një praktikues. Sidoqoftë në krahasim me njerëzit e zakonshëm, ai mund t’i kontrollojë ata sepse karma është gjithashtu një formë energjie. Kur densiteti i saj bëhet shumë i lartë, ajo mund gjithashtu të forcojë aftësitë supernormale që ka trupi i personit dhe të prodhojë një efekt të tillë. Prandaj, në gjithë historinë disa njerëz i kanë mësuar këto gjëra. Një person i tillë pretendon: “Duke kryer vepra të këqija dhe duke mallëkuar, unë mund të rrisë gongun tim”. Ai nuk po rrit gongun. Faktikisht, ai po rrit densitetin e kësaj substance të zezë, përderisa kryerja e veprave të këqija sjell si pasojë substancën e zezë, karmën. Për rrjedhojë, aftësitë e vogla supernormale të këtij personi mund të përforcohen nga karma. Ata mund të zhvillojnë disa aftësi të vogla supernormale, megjithatë ata janë të paaftë të bëjnë ndonjë gjë të madhe. Këta njerëz besojnë se duke kryer vepra të këqija, ata mund të rrisin gongun. Kështu thonë ata.

Disa njerëz thonë: “Nëse një Tao është një metër i lartë, një demon është një mijë”. Kjo është një thënie jo e vërtetë e bërë nga njerëzit e zakonshëm. Një demon nuk do të jetë kurrë më i lartë se një Tao. Ekziston ky fakt që universi që ne njohim si qenie njerëzore është një nga më të vegjëlit midis universeve të panumërta dhe ne e quajmë atë shkurt univers. Sa herë universi ynë kalon një periudhë kohe prej shumë vitesh, ai gjithmonë do të pësojë një katastrofë e cila shkatërron çdo gjë në univers, duke përfshirë planetet dhe të gjitha qëniet e gjalla. Lëvizja e universit ndjek një ligj. Në universin tonë kësaj here, raca njerëzore nuk është lloji i vetëm që është korruptuar. Shumë qenie kanë konstatuar tashmë që përse i përket kohës së tanishme, një shpërthim i madh ka ndodhur kohë më parë në hapësirën e këtij universi. Sot, astronomët nuk mund ta vrojtojnë atë sepse ato që ne shohim tani nëpërmjet teleskopëve më të fuqishëm janë gjëra që kanë ndodhur 150 mijë vjet-drite më parë. Me qëllim që të shohim ndryshimet e tanishme të trupave qiellorë, ne duhet të presim për 150 mijë vjet-drite. Kjo është një kohë shumë e largët.

Ne kohën tonë, i tërë universi ka pësuar një ndryshim të madh. Sa herë që ndodh një ndryshim i tillë, të gjitha qëniet e gjalla në tërë universin do të shkatërrohen plotësisht dhe do të zhduken. Sa herë që ndodh kjo situatë, e gjithë materia dhe karakteristikat e saj brenda universit të mëparshëm do të hidhen në erë. Zakonisht, të gjitha jetët do të vriten nga shpërthimi. Megjithatë jo të gjithë janë zhdukur nga shpërthimi çdo herë. Pasi universi i ri të rindërtohet nga Qëniet e Shumëlartësuara të një niveli jashtëzakonisht të lartë, akoma gjenden disa nga ata që kanë mbijetuar nga shpërthimi. Qëniet e Shumëlartësuara e ndërtojnë universin në përputhje me karakteristikat dhe standartet e tyre. Prandaj, ai ka karakteristikë të ndryshme nga ajo e universit të mëparshëm.

Ata që i kanë shpëtuar shpërthimit do të vazhdojnë t’i përmbahen karakteristikës dhe parimeve të mëparshme kur ata bëjnë gjëra në këtë univers. Universi i rindërtuar do t’i përmbahet karakteristikave dhe parimeve të universit të ri mbi të cilat u ndërtua. Kështu, ata që i shpëtuan shpërthimit kthehen në demonë që ndërhyjnë me parimet e universit. Sidoqoftë, ata nuk janë aq të këqinj përderisa ata i përmbahen vetëm karakteristikës së universit të periudhës së mëparshme. Ata quhen nga njerëzit djaj të qiellit. Sidoqoftë, ata nuk kërcënojnë njerëzit e zakonshëm dhe as nuk i shkaktojnë dëm atyre. Ata vetëm i përmbahen parimeve të veta për të vepruar. Më parë, kjo nuk lejohej që të dihej nga njerëzit e zakonshëm. Unë e kam thënë se ka shumë Buddha përtej nivelit të Tathagatës. Këta demonë nuk janë asgjë! Ata janë shumë të parëndësishëm në krahasim me Buddhat.

Plakja, sëmundjet dhe vdekja janë gjithashtu formë demonësh, por ato janë krijuar për të ruajtur karakteristikën e universit.

Buddhizmi beson në samsara (ringjallje), e cila përmend dhe çështjen *asura*². Kjo i referohet qënieve të gjalla në dimensione të ndryshme, por që nuk kanë cilësitë e lindura njerëzore. Për një Qënie të Shumëlartësuar, ato janë të një niveli shumë të ulët dhe të paaftë. Sidoqoftë ata janë të frikshëm për njerëzit e zakonshëm sepse ata kanë një farë sasive energjie. Ata i konsiderojnë njerëzit e zakonshëm si kafshë, kështu që ata i përdorin njerëzit si ushqim. Kohët e fundit ata gjithashtu kanë dalë në public për të mësuar qigong. Çfarë janë këta? Si ka mundësi që ata të duken si qënie njerëzore? Ata duken shumë të frikshëm. Sapo ju mësoni gjërat e tyre, juve do t'ju duhet të shkoni me ta dhe të bëheni lloji i tyre. Në praktikën e qigongut, nëqoftëse disa njerëz kanë mendime të këqija që përputhet me mentalitetin e tyre, ata do të vijnë të mësojnë pikërisht këta njerëz. Një mendim i drejtë mund të mundë njëqind të ligj. Nëse ju nuk shkoni pas diçkaje, asnjëri nuk do të guxojë t'ju shqetësojë. Nëqoftëse keni një mendim të lig apo shkoni pas diçkaje të keqe, ata do të vijnë t'ju ndihmojnë dhe ju do të ndiqni një mënyre demonike kultivimi. Një gjë e tillë mund të ndodhë.

Një situatë tjetër quhet “të praktikosh një praktikë të ligë pa e ditur”. Çfarë do të thotë “të praktikosh një praktikë të ligë pa e ditur”. Kjo ndodh kur dikush praktikon një mënyrë të ligë pa e kuptuar këtë gjë. Ky problem është shumë i zakonshëm dhe mjaft i përhapur. Ashtu siç e thashë më parë, shumë njerëz praktikojnë qigong me mendime të gabuara në mendje. Megjithëse ata janë duke bërë ushtrimet atje me duart dhe këmbët që ju dridhen nga lodhja, mëndjet e tyre nuk janë të qeta. Dikush mendon: “Çmimet po rriten. Duhet të shkoj në pazar pasi të mbaroj ushtrimet. Po nuk nxitova, gjërat do të shtrenjtohen.” Një person tjetër mendon: “Ndërmarrja tani po ndan apartamente. A do të marr unë një? Personi i ngarkuar me ndarjen e tyre ka gjithmonë mosmarrëveshje me mua.” Sa më shumë ky person mendon për këtë, aq më i zemëruar bëhet ai: “Ai me siguri nuk do të më japë një hyrje. Si mund t'i kundërvihem atij...” Mendime nga më të ndryshmet shfaqen. Siç e thashë më parë, ata komentojnë nga çështjet familjare në ato shtetërore. Kur ata flasin për tema të pakëndshme, ata inatosen akoma më shumë.

Praktika e qigongut kërkon që të vlerësosh virtytin. Gjatë bërjes së ushtrimeve, nëse ju nuk mendoni dot për gjëra të mira, të paktën ju nuk duhet të mendoni për gjëra të këqija. E mira është të mos mendoni për asgjë. Kjo për arsye se gjatë praktikës së qigongut të një niveli të ulët, duhet të hidhet një themel. Ky themel do të luajë një rol kritik, sepse veprimtaria mendore e njeriut ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në praktikë. Pa mendoni pak të gjithë: Çfarë po i shtoni ju qigongut tuaj? Si mundet që ajo që praktikoni të jetë e mirë? Si mos të jetë ajo e zezë? Sa njerëz që praktikojnë qigong nuk i kanë këto lloj mendimesh? Megjithëse ju praktikoni qigong gjithmonë, pse atëhere nuk ju kanë ikur sëmundjet tuaja? Megjithëse disa njerëz nuk kanë mendime të këqija kur bëjnë ushtrimet, ata gjithmonë praktikojnë qigong me qëllim për të fituar aftësi supernormale, dëshirën për të pasur këtë apo atë, mentalitete të ndryshme dhe dëshira nga më të ndryshmet. Aktualisht, ata kanë praktikuar tashmë pa e kuptuar një kultivim të lig. Po të thuash se ky person po praktikon një mënyrë kultivimi të lig, ai apo ajo do të zemërohen: “Mua më ka mësuar një mjeshtër qigongu i njohur.” Por ai mjeshtër qigongu i njohur të kërkon të vlerësosh virtytin. A e ke bërë ti këtë? Gjatë praktikës së qigongut, ti gjithmone fut mendime të këqija. Si mund të thuash ti se do të dalësh nga praktika me gjëra të mira? Ky është problemi dhe do të thotë të praktikosh kultivim të lig pa e ditur—diçka shumë e përhapur.

² *asura*—shpirtra të këqinj (nga gjuha Sanskrit).

Kultivimi i Dyfishtë Mashkull–Femër

Në komunitetin e kultivuesve ekziston një praktikë kultivuese që quhet kultivim i dyfishtë mashkull–femër. Ndoshta ju keni parë praktikën kultivuese të Tantrizmit Tibetan ku në një skulpturë apo portret të Buddhës, një figurë mashkulli mban një trup femre duke praktikuar. Figura mashkullore ndonjëherë ka pamjen e një Buddhë që mban një femër lakuriq. Disa mund të jenë transformime të Buddhës me pamjen e një Vajra me kokë–lope dhe fytyrë–kali, që mbajnë një femër të zhveshur. Pse janë ato kështu? Së pari, le t'ja u shpjegojmë këtë çështje të gjithëve. Në planetin tonë nuk është vetëm Kina që është influencuar nga Konfucionizmi. Disa shekuj më parë e tërë rraca jonë njerëzore ka pasur vlera të njëjta morale. Prandaj kjo praktikë kultivuese nuk e ka prejardhjen nga planeti jonë. Ajo erdhi nga një planet tjetër, por kjo metodë me të vërtetë bën të mundur që dikush të praktikojë kultivim. Kur kjo praktikë kultivuese u prezantua në Kinë në atë kohë, ajo ishte e papranueshme për kinezët pikërisht sepse kishte kultivimin e dyfishtë mashkull–femër dhe praktika sekrete. Prandaj, gjatë periudhës së Huichang në Dinastinë Tang ajo u ndalua në krahinat e Hanit nga perandori. Kështu u ndalua që të mësohej në krahinat e Hanit dhe në atë kohë quhej Tantrizmi Tang. Megjithatë, ajo u transmetua në ambjentin e veçantë të Tibetit, një krahinë e veçantë. Pse praktikojnë ata kultivim në këtë mënyrë? Kultivimi i dyfishtë mashkull–femër është për të mbledhur yin që të kompensohet yang dhe anasjelltas, me plotësim reciprok për kultivim të përbashkët duke i dhënë kështu mundësi arritjes së qëllimit të balancimit të yin dhe yang.

Dihet që sipas Shkollës Buddhë apo Shkollës Tao, veçanërisht sipas teorisë Taoiste të yin dhe yang, trupi i njeriut trashëgon yin dhe yang. Për arsye se trupi i njeriut ka yin dhe yang, ai mund të zhvillojë nëpërmjet praktikës kultivuese një sërë aftësish mbinatyrale dhe qenie të gjalla si Foshnjën e Pavdekshme, Foshnjët e Kultivuara, Fashen etj. Për shkak të ekzistencës së yin dhe yang, njeriu mund të zhvillojë nëpërmjet kultivimit shumë qenie të gjalla, të cilat mund të rriten në dantian pamvarësisht nëse trupi është femëror apo mashkullor—është njësoj. Kjo teori me të vërtetë ka kuptim. Shkolla Tao zakonisht e konsideron pjesën e sipërme të trupit si yang dhe të poshtmen si yin. Disa njerëz gjithashtu e konsiderojnë pjesën e mbrapme të trupit si yang dhe të përparmen si yin. Të tjerë e konsiderojnë pjesën e majtë të trupit si yang dhe të djathtën si yin. Në Kinë, ne kemi një thënie që ana e majtë e trupit është mashkullore dhe ana e djathtë është femërore dhe ka shkaqe të arsyeshme për prejardhjen e kësaj thënie. Meqënëse trupi i njeriut trashëgon yin dhe yang, me bashkëveprimin e yin dhe yang, ai e arrin vetë balancimin e yin dhe yang dhe kështu mund të sjellë në jetë shumë qenie të gjalla.

Atëherë kjo sqaron një çështje: Edhe pa aplikuar metodën e kultivimit të dyfishtë mashkull–femër, ne prapsërapë mund të arrijmë një nivel shumë të lartë në kultivim. Përdorimi i pamoralshëm i kësaj metode do të sjellë ndërhyrje demonike dhe për rrjedhojë bëhet një praktikë e ligë. Në Tantrizëm, nëqoftëse do të përdoret kultivimi i dyfishtë mashkull–femër në nivele shumë të larta, murgu apo lama duhet të ketë arritur një nivel shumë të lartë kultivimi. Në atë kohë mjeshtri mund të udhëhiqte një person në këtë lloj praktike kultivuese. Për arsye se niveli i karakterit të këtij personi është shumë i lartë, ai është në gjëndje të përmbajë veten dhe pa e kthyer në diçka të ligë. Por dikush me nivel të ulët karakteri nuk duhet të praktikojë këtë metodë në mënyrë absolute. Përndryshe, ky person me siguri do të ndjekë një praktikë të ligë. Për arsye të nivelit të kufizuar të karakterit dhe për arsye se ai nuk ka hequr dorë nga dëshirat dhe epshi i njerëzve të zakonshëm, aty është niveli i tij i karakterit dhe po u përdor do të kthehej në një praktikë të ligë. Prandaj, ne kemi thënë që kur ajo përhapet pa kujdes në nivele të ulta, kjo do të thotë të mësosh një praktikë të ligë.

Në vitet e fundit, disa mjeshtër qigongu po mësojnë praktikën e kultivimit të dyfishtë mashkull–femër. Çfarë është për t'u çuditur këtu? Kultivimi i dyfishtë mashkull–femër është shfaqur gjithashtu dhe në Shkollën Tao. Për më tepër, ajo nuk filloi sot por që në kohën e Dinastisë Tang. Si mundet që Shkolla Tao të ketë kultivim të dyfishtë mashkull–femër? Sipas teorisë së Taijisë së

Shkollës Tao, trupi i njeriut është një univers i vogël dhe trashëgon yin dhe yang. Të gjitha mësimet e vërteta dhe të drejta janë transmetuar nga një kohë shumë e largët. Çdo ndryshim apo shtesë e rastit do ta prishë atë shkollë praktike të veçantë dhe e bën atë të paaftë për të arritur qëllimin e përfundimit të praktikës kultivuese. Kështu, përderisa praktika juaj nuk ka kultivim të dyfishtë mashkull–femër, ju nuk duhet kurrë ta ushtroni atë në kultivimin tuaj. Përdryshe, ju do të shkoni në rrugë të gabuar dhe do të keni telashe. Veçanërisht në Shkollën tonë të Falun Dafës, nuk ka kultivim të dyfishtë mashkull–femër dhe as që kemi ne nevojë për të. Ky është mendimi jonë në lidhje me këtë çështje.

Kultivimi i Mëndjes dhe i Trupit

Çështja e kultivimit të mëndjes dhe të trupit ju është shpjeguar tashmë të gjithëve. Të kultivosh mëndjen dhe trupin do të thotë të kultivosh karakterin në të njëjtën kohë që kultivon dhe trupin. Me fjalë të tjera, benti transformohet. Në procesin e transformimit, qelizat e njeriut do të zëvendësohen gradualisht me materie energjie të lartë dhe plakja do të ndadalësohet. Trupi gradualisht do të rinohet dhe do të pësojë transformim gradual derisa më në fund i tërë trupi të jetë zëvendësuar me materie energjie të lartë. Në këtë kohë, ky trup do të jetë shndërruar tashmë në një trup prej një materie të një lloji tjetër. Ai trup, siç e thashë me parë, do të ketë tejkalar Pesë Elementet. Përderisa ai nuk kufizohet më nga Pesë Elementet, ky trup nuk do të priset më kurrë.

Praktika kultivuese në tempuj merret vetëm me kultivimin e mëndjes, pra nuk mëson ushtrime apo kultivon trupin. Ajo kërkon nirvana, sepse metoda e mësuar nga Sakyamuni kërkon nirvana. Në fakt, vetë Sakyamuni kishte një nivel shumë të lartë Dharme dhe ai ishte në gjendje të transformonte plotësisht bentin e tij në materie të energjisë së lartë dhe ta merrte atë me vete. Me qëllim që të linte këtë metodë kultivimi, ai mori vetë rrugën e nirvanës. Pse ndoqi ai këtë rrugë? Ai veproi kështu që t'i bënte njerëzit të hiqnin dorë nga dëshirat dhe çdo gjë tjetër në maksimum duke përfshirë së fundi edhe trupin fizik; të gjitha veset duhet të braktisen. Me qëllim që njerëzit të arrijnë këtë sa më shumë që të jetë e mundur, ai mori rrugën e nirvanës. Prandaj, të gjithë murgjit Buddhistë historikisht kanë marrë rrugën e nirvanës. Nirvana do të thotë që kur një murg vdes ai braktis trupin e tij fizik dhe Shpirti i tij Primordial do të ngjitet bashkë me gongun.

Shkolla Tao thekson kultivimin e trupit. Ngaqë ajo i zgjedh dishepujt dhe nuk i ofron shpëtim të gjitha qënieve, ajo ka nxënëse shumë të shquar. Prandaj, ajo mëson teknikat dhe mënyrat se si të kultivosh jetë. Megjithatë në praktikën kultivuese të Shkollës Buddhës dhe në veçanti në Buddhizëm, këto nuk janë mësuar. Jo të gjitha praktikat e Shkollës Buddhës nuk e mësojnë atë. Shumë praktika të niveleve të larta të Shkollës Buddhës e mësojnë atë. Shkolla jonë e praktikës e mëson atë. Falun Dafa jonë kërkon si bentin ashtu dhe Foshnjën e Pavdekshme; këto nuk janë e njejtja gjë. Foshnja e Pavdekshme është gjithashtu një trup i përbërë prej materie energjie të lartë, por që nuk mund të shfaqet shkarazi në dimensionin tonë. Me qëllim që të ruajmë pamjen e një njeriu të zakonshëm në këtë dimension për një periudhë të gjatë kohe, ne duhet të kemi bentin. Prandaj, me transformimin e këtij benti, kombinimet molekulare e tij nuk ndryshojnë edhe pse qelizat janë shndërruar në materie energjie të lartë. Kështu ky trup nuk do të duket shumë ndryshe nga ai i njerëzve të zakonshëm. Sidoqoftë ka akoma një ndryshim: Domethënë, ky trup mund të hyjë në dimensione të tjera.

Ato praktika që kultivojnë si mëndjen ashtu dhe trupin bëjnë që njeriu të duket shumë i ri në pamje dhe shumë ndryshe nga moshja që ka. Një ditë një person me pyeti: “Mësues, sa vjeç mendon se jam unë? Në fakt ajo po i afrohej të shtatëdhjetave por ajo dukej vetëm rreth dyzet vjeç. Fytyra e saj ishte pa rrudha, me shkëlqim dhe me lëkurë të lëmuar e rozë. Ajo nuk dukej fare që po i afrohej të shtatëdhjetave. Kjo do të ndodhë me praktikuesit tanë të Falun Dafës. Po themi një shaka: Të rejave u pëlqen të bëjnë tualet dhe duan ta bëjnë lëkurën e fytyrës të lëmuar e më të mirë. Unë do të thoja se nëse ju me të vërtetë ndiqni një praktikë kultivuese të mëndjes dhe të trupit, ju do t'ia arrinit

këtij qëllimi natyrshëm. Është e garantuar që ju nuk do të keni nevojë të përdorni gjëra kosmetike. Nuk do të japim më shembuj të këtij lloji. Në të kaluarën, për arsye se në profesione të ndryshme pjesa më e madhe e kolegëve të punës ishin në moshë të madhe, unë trajtohesha si i ri. Gjendja është përmirësuar tani dhe ka relativisht më shumë të rinj në çdo profesion. Në fakt, unë nuk jam më i ri. Unë po shkoj drejt të pesëdhjetave, pasi tashmë i kam mbushur dyzet e tre vjeç.

Fashen

Pse ka një fushë rreth statujës së Buddhës? Shumë njerëz nuk e shpjegojnë dot këtë. Disa njerëz thonë: “Një statujë Buddha ka fushë për arsye se murgjit i këndojnë shkrimet e shenjta asaj.” Me fjalë të tjera, fusha vjen ngaqë murgjit praktikojnë kultivim para saj. Nëse është nga praktika kultivuese e murgjëve apo të tjerëve, kjo energji duhet të jetë e shpërndarë dhe jo e drejtuar. Dyshemeja, tavanet dhe muret e tërë tempullit duhet të kenë të njejtën fushë. Atëherë pse është fusha e statujës së një Buddhe kaq e fuqishme? Veçanërisht një statujë Buddha në male të largëta, në shpella, apo mbi shkëmbinj zakonisht ka fushë. Pse gjendet kjo fushë atje? Disa njerëz kanë dhënë shpjegime nga më të ndryshmet por megjithatë asnjë nuk mund ta shpjegojë atë në mënyrë të qartë. Në fakt, një statujë Buddha ka fushë sepse ajo ka Fashen e një Qënieje të Shumëlartësuar. Për shkak se Fashen e një Qënie të Shumëlartësuar është atje, ajo ka energji.

Nëse ishte Sakyamuni apo Bodhisattva Avalokitesvara³, nëse ata kanë ekzistuar me të vërtetë në histori, pa mendohen pak të gjithë, a nuk ishin edhe ata praktikues gjatë kohës së praktikës së tyre kultivuese? Kur një person praktikon kultivim në nivel shumë të lartë të Ligj-Përtej-Botës-Trefishe, ai ose ajo do të zhvillojë Fashen. Fashen lind në dantian të personit dhe përbëhet prej Fa dhe gong. Ai shfaqet në dimensione të tjera. Fashen ka të njëjtën fuqi me atë të personit, por mendja dhe mendimet e tij kontrollohen nga personi. Megjithatë, vetë Fashen është gjithashtu një jetë e plotë, e pavarur dhe reale. Prandaj, ai mund të bëjë çdo gjë vetë në mënyrë krejt të pavarur. Fashen bën pikërisht atë që i kërkon të bëjë Shpirti Kryesor i personit. Nëse një person bën diçka në një mënyrë të caktuar, Fashen i saj apo i tij do ta bëjë atë njësoj; kjo është Fashen të cilës i referohemi ne. Kur unë dua të bëj diçka, ajo mund të bëhet nga Fashen i im, si për shembull të përshtas trupat e praktikuesve të vërtetë. Për shkak se Fashen nuk ka trup njeriu, ai shfaqet në dimensione të tjera. Trupi i tij nuk është i palëvizshëm dhe i pandryshueshëm; përkundrazi ai mund të zmadhohet ose svogëlohet. Ngadonjëherë, ai bëhet shumë i madh, kaq i madh sa nuk mund t'i shikosh dot kokën. E ngadonjëherë ai bëhet shumë i vogël, më i vogël sesa një qelizë.

Ceremonia e Bekimit

Një statujë Buddha e bërë në një fabrikë është vetëm një objekt arti. “Ceremonia e bekimit” ka për qëllim të ftojë Fashën e një Buddhe në statujë që do të adhurohet pastaj si objekt konkret nga njerëzit. Në praktikën kultivuese, kur një praktikues ka në zemër respekt, Fashen në statujën e Buddhës do të ruajë Ligjin për këtë person duke u kujdesur dhe mbrojtur atë. Ky është qëllimi i vërtetë i ceremonisë së bekimit. Kjo mund të kryhet vetëm me mendime të singërta të shprehura në ceremoninë formale të bekimit, ose nga Qënie të Shumëlartësuar të niveleve të larta, ose nga kultivues të një niveli shumë të lartë që kanë këtë fuqi.

³ Bodhisattva Avalokitesvara—e njohur për dashamirësinë e saj, ajo është një nga dy Bodhisattvat e Mëdha në Parajsën e Lumturisë Absolute.

Një tempull kërkon që statuja e Buddhës të kalojë një ceremoni bekimi dhe njerëzit thonë se pa bekim një statujë Buddha nuk vlen për asgjë. Sot në tempuj nuk ka më nga ata mjeshtrit e vërtetë të mëdhej midis murgjëve, ata kanë vdekur të gjithë. Që nga Revolucioni i Madh Kulturor, disa nga ata murgjit e rinj të cilët nuk kanë marrë ndonjë mësim të vërtetë janë bërë kryemurgj. Shumë gjëra nuk janë transmetuar. Nëse ju pyesni ndonjë prej tyre: “Cili është qëllimi i ceremonisë së bekimit?” Ai do të thotë: “Statuja e Buddhës do të veprojë pas bekimit.” Ai nuk mund të shpjegojë pse është ajo veçanërisht e domosdoshme, kështu që ai vetëm mban ceremoninë. Ai do të vendosë një shkrim të shënjtë Buddhist brenda statujës së Buddhës. Pastaj ai do ta mbyllë statujën me letër dhe i këndon asaj shkrimin e shënjtë. Ai e quan këtë bekim, por a u arrit qëllimi i bekimit? Kjo varet nga si e këndon ai shkrimin e shënjtë. Sakyamuni pat thënë që personi duhet ta këndojë shkrimin e shënjtë me një mendje të virtytshme dhe me vëmendje të palëkundur me qëllim që të tundë parajsën e praktikës së tij kultivuese. Vetëm atëherë mund të ftohet një Qënie e Shumëlartësuar. Dhe vetëm kur Fashen e një Qënieje të Shumëlartësuar arrin në statujën e Buddhës, mund të arrihet qëllimi i bekimit.

Ndërsa këndojnë shkrimet e shënjtë aty, disa murgj mendojnë: “Pas bekimit, sa para do të më paguajnë?” Apo ndërsa këndon shkrimet e shënjtë, dikush mendon: “Filani më trajton kaq keq.” Ata kanë gjithashtu konflikte personale. Tani është Periudha e Fund-Dharmës. Nuk mund të mohohet që ky fenomen ekziston. Ne nuk po kritikojmë Buddhizmin këtu. Disa nga tempujt nuk janë fare të qetë në Periudhën e Fund-Darmës. Nëse mendja e personit është e mbushur me këto gjëra dhe shpreh mendime të tilla të këqija, si mundet që një Qënie e Shumëlartësuar të vijë? Qëllimi i bekimit atëherë nuk mund të arrihet kurrësi. Por kjo nuk është absolute, sepse ka disa tempuj dhe manastire Taoiste të mira.

Në një qytet, pashë një murg që i kishte duart shumë të zeza. Ai e futi shkrimin e shënjtë brenda statujës së Buddhës dhe e vulosi atë pa kujdes. Pasi mëmëriti disa fjalë, procesi i bekimit përfundoi. Pastaj ai mori një statujë tjetër Buddha dhe përsëri mëmëriti disa fjalë. Ai merrte dyzet yuan për çdo bekim. Në ditët e sotme, murgjit e kanë kthyer në tregti bekimin dhe nxjerrin para prej tij. Pasi i hodha një sy, unë konstatova që bekimi nuk ishte arritur sepse ai nuk mund ta bënte atë aspak. Në ditët e sotme murgjit bëjnë edhe gjëra të tilla. Çfarë kam parë tjetër unë? Një person që dukej se ishte Buddhist i thjeshtë, jo murg, po kryente bekimin e një statuje Buddha në një tempull. Ai mbante një pasqyrë nga dielli që të reflektonte rrezet e diellit mbi statujën e Buddhës. Pastaj ai pretendoi se bekimi u krye. Është kthyer në kaq qesharake! Sot, Buddhizmi ka arritur në këtë pikë dhe këto fenomene janë shumë të zakonshme.

Një statujë Buddha e madhe prej bronxi u bë në Nanjing dhe u vendos në ishullin Lantau në Hong Kong. Është një statujë Buddha gjigande. Shumë murgj nga e gjithë bota erdhën për të kyer bekimin e saj. Njëri nga murgjit mbajti një pasqyrë nga dielli për të reflektuar rrezet e diellit mbi fytyrën e statujës së Buddhës dhe e quajti këtë bekim. Në një ceremoni kaq madhështore si kjo, mund të ndodhë dhe një veprim i tillë. Mua më duket shumë për të ardhur keq! Nuk është për t’u habitur që Sakyamuni pat thënë: “Në Periudhën e Fund-Dharmës, murgjit do e kenë të vështirësi të shpëtojnë veten, jo më pastaj të shpëtojnë të tjerët.” Për më tepër, shumë murgj i interpretojnë shkrimet e shënjtë në bazë të të kuptuarit të tyre. Edhe shkrimi i shënjtë i Zonjës së Madhe Mbretëreshë është futur në tempuj. Shumë gjëra që nuk janë materiale klasike Buddhiste kanë hyrë gjithashtu në tempuj, duke i bërë këto vende mjaft konfuze dhe lëmsh e li. Natyrisht, ka murgj që akoma praktikojnë kultivim me sinqeritet dhe janë mjaft të mirë. Bekimi është në fakt të ftosh Fashen e një Qënie të Shumëlartësuar që të qëndrojë në statujën e Buddhës. Ky është bekimi.

Kështu nëqoftëse kjo statujë Buddha nuk ka kaluar nëpër ceremoninë e bekimit me sukses, asaj nuk duhet t’i falet njeri. Nëqoftëse falen tek ajo, do të ketë pasoja serioze. Cilat janë këto pasoja serioze? Sot ata që studjojnë trupin e njeriut kanë zbuluar që veprimtaria jonë mendore apo mendimet e njeriut mund të prodhojnë një substancë. Nga nivele shumë të larta ne kemi zbuluar që është me të vërtetë një substancë, por kjo substancë nuk është në formën e valëve të trurit siç është zbuluar nga

kërkimet e sotme. Por ka formën e një truri të plotë njeriu. Në mënyrë tipike, kur një njeri i zakonshëm mendon për diçka, ajo që ai prodhon është diçka në formën e trurit. Për shkak se nuk ka energji, ajo do të shpërndahet menjëherë më pas. Nga ana tjetër energjia e një praktikuesi mund të ruhet shumë më gjatë. Kjo nuk do të thotë që kjo statujë Buddha ka një mendje pasi të prodhohet në fabrikë. Jo, nuk ka. Disa statuja Buddha nuk kanë kaluar nëpër ceremoninë e bekimit dhe as që u arrit qëllimi i bekimit pasi ato u dërguan në tempuj. Nëse bekimi u krye nga një mjeshtër qigongu i rremë ose nga një person prej një praktike të ligë, do të jetë akoma më e rrezikshme, pasi një dhelpër apo nuselale do të futet fshehurazi në statujën e Buddhës.

Kështu një statujë Buddha që nuk ka kaluar nëpër ceremoninë e bekimit, nëse ju i faleni asaj, do të jetë shumë e rrezikshme. Sa e rrezikshme do të jetë? Unë e kam thënë që njerëzimi ka arritur në një pikë ku çdo gjë po prishet. E tërë shoqëria dhe gjithçka në gjithë universin po korruptohen vazhdimisht. Çdo gjë që i ndodh njerëzve është shkaktuar nga ata vetë. Është shumë e vështirë të gjesh një rrugë të vërtetë ose të ndjekësh një rrugë të virtytshme, për shkak të ndërhyrjes nga burime të ndryshme. Dikush don ti lutet Buddhës por kush është Buddha? Është shumë e vështirë të gjesh një që t'i lutesh. Nëse ju nuk e besoni, me lejoni që ta them hapur. Do të jetë e tmerrshme kur personi i parë t'i falet një statuje Buddha që nuk ka kaluar nëpër ceremoninë e bekimit. Sa njerëz i falen sot Buddhës që të arrijnë Shkallën e Duhur në kultivim? Ka tepër pak njerëz të tillë. Cilat janë motivet e shumicës së njerëzve për t'ju falur Buddhës? Ata kërkojnë që të zhdukin hallet, të zgjidhin problemet dhe të vejnë pasuri. A janë këto gjëra nga shkrimet e shenjta Buddhiste? Ato nuk përmbajnë aspak gjëra të tilla.

Supozojmë që një adhurues i Buddhës që është i dhënë pas parave përkulet me nderim para një statuje të Buddhës apo asaj të Bodhisattva Avalokitesvarës apo një Tathagate dhe thotë: "Të lutem më ndihmo të bëj ca para." Një mendje e plotë do të formohet. Përderisa kjo kërkesë iu bë një statuje të Buddhës, ajo në çast do të projektohet mbi statujën e Buddhës. Në një dimension tjetër, një gjë mund të bëhet e madhe apo e vogël. Kur ky mendim arrin tek ajo, statuja e Buddhës do të ketë një tru dhe mendje por jo një trup. Njerëz të tjerë gjithashtu vijnë për t'ju falur statujës së Buddhës. Me këtë falje, ata gradualisht do t'i japin asaj një sasi energjie. Do të jetë akoma më e rrezikshme nëse një praktikues i falet asaj, pasi falja do t'i japë asaj gradualisht energji dhe do të bëjë të mundur që ajo të formojë një trup të prekshëm. Megjithatë ky trup i prekshëm është formuar në një dimension tjetër. Pasi të jetë formuar, ai ekziston në një dimension tjetër dhe gjithashtu mund të mësojë disa të vërteta të universit. Prandaj, ai mund të bëjë disa gjëra për njerëzit. Në këtë mënyrë, ai gjithashtu mund të zhvillojë pak gong. Por ai i ndihmon njerëzit me kusht dhe me një çmim. Ai lëviz lirisht në një dimension tjetër dhe mund t'i kontrollojë njerëzit e zakonshëm me shumë lehtësi. Ky trup duket krejtësisht i njëjtë me statujën e Buddhës. Pra është adhurimi i njerëzve që krijon një Bodhisattva Avalokitesvara apo një Tathagata të rremë, që ngjan plotësisht me statujën e Buddhës dhe ka pamje Buddha. Por mendja e Buddhës apo Bodhisattvës së rreme është jashtëzakonisht e keqe dhe është e dhënë pas parave. Meqenëse është krijuar në një dimension tjetër dhe ka mendje, ai njeh pak të vërteta dhe nuk guxon të bëjë të këqija të mëdha, por ai guxon që të bëjë disa të këqija të vogla. Ndonjëherë ai gjithashtu ndihmon njerëzit; përndryshe do të ishte krejtësisht i lig dhe do të vritej. Si i ndihmon ai njerëzit? Kur dikush lutet: "Buddha, të lutem me ndihmo sepse dikush në shtëpi është sëmurë," atëherë ai do t'ju ndihmojë. Do t'ju bëjë të dhuroni para në kutinë e dhurimit pasi mendja e tij është e dhënë pas parave. Sa më shumë para fusni ju në kutinë e dhurimit, aq më shpejt do të shërohet sëmundja. Përderisa ka energji, ai mundet që nga një dimension tjetër, të manipulojë një njeri të zakonshëm. Do të ishte veçanërisht e rrezikshme nëse një praktikues do i falej statujës. Për çfarë lutet një praktikues? Para. Pa mendojeni pak, të gjithë: Pse duhet një praktikues të jepet pas parave? Të luturit për të eliminuar fatkeqësitë dhe sëmundjet për anëtarët e familjes është një dëshirë sentimentale ndaj familjes. A doni ju të ndryshoni fatin e njerëzve të tjerë? Secili ka fatin e vet! Nëse ju i faleni asaj dhe mërmëritni: "Të lutem më ndihmo të bëj ca para," epo, do t'ju ndihmojë. Ai don

që ju të shkoni më shumë pas parave sepse sa më shumë i doni ju ato, aq më shumë gjëra ai do të marrë prej jush. Ky është këmbim i barabartë. Adhuresit e tjerë kanë futur plot para në kutinë e dhurimit dhe ai do t'ju lejojë juve të merrni ca. E si bëhet kjo? Ju mund të gjeni një kuletë pasi të dilni nga dera, apo puna mund t'ju japë ndonjë shpërblim. Sidoqoftë, do ta rregullojë që ju të merrni para. Si mund t'ju ndihmojë juve pa kushte? Po nuk humbe, nuk fiton. Ai do të marrë pak nga gongu juaj nëse i duhet apo do t'ju marrë danin që keni kultivuar. Ai don këto gjëra.

Këto Buddha të rremë janë shpesh shumë të rrezikshëm. Shumë nga praktikuesit tanë që kanë Syrin Qiellor të hapur mendojnë se kanë pare një Buddhë. Dikush mund të thotë që një grup Buddhesh erdhi në këtë tempull sot, me një Buddhë që quhej kështu apo ashtu që udhëhiqte grupin. Ky person do të përshkruajë si ishte grupi dje, si ishte grupi sot dhe sapo që ikën një grup, vjen një tjetër. Kush janë këta? Ata thjesht i përkasin kësaj kategorie—ata nuk janë Buddha të vërtetë, por të rremë. Rastet e tilla janë të shumta.

Është akoma më e rrezikshme nëse një gjë e tillë ndodh në tempuj. Nëse murgjit i falen atij, ai do t'i marrë nën kontroll: “A nuk po më faleni ju mua? Dhe po e bëni këtë me mendje të kthjellët! Epo, a nuk doni ju që të praktikoni kultivim? Unë do të kujdesem për ju dhe do t'ju tregoj si të praktikoni kultivim.” Ai do të bëjë plane për ta. Ku do të shkoni ju nëse përfundoni kultivimin? Përderisa praktika kultivuese u organizua prej tij, asnjë shkollë praktike e nivelit të lartë nuk do t'ju pranojë. Përderisa ai ka organizuar gjithshka për ju, juve do t'ju duhet të ndiqni atë në të ardhmen. A nuk do të shkonte dëm kultivimi juaj? Unë e kam thënë se tani është shumë e vështirë për njerëzimin të arrijë Shkallën e Duhur në kultivim. Ky fenomen është tepër i shpeshtë. Shumë prej jush kanë parë dritë Buddhesh në malet e famshme përgjatë lumejve të mëdhej. Shumica e tyre i përket kësaj kategorie. Ai ka energji dhe mund ta manifestojë veten. Një Qënie e Shumëlartësuar e vërtetë nuk e shfaq veten sipas dëshirës.

Në të kaluarën, ka pasur relativisht më pak të ashtuquajtur Buddha dhe Tao tokësorë. Ndërsa tani ka shumë. Kur ata bëjnë të këqija, jetët e larta do t'i vrasin ato. Kur kjo është gati të ndodhë, ata do të vrapojnë dhe do të futen në statujat e Buddhës. Zakonisht, një Qënie e Shumëlartësuar nuk ndërhyr shkarazi në parimet e njerëzve të zakonshëm. Sa më i lartë të jetë niveli i një Qënie të Shumëlartësuar, aq më pak ai apo ajo do të ndërhyjë në parimet e njerëzve të zakonshëm, as edhe pak. Në fund të fundit, kjo qënie e lartë nuk do të rrënojë papritur një statujë Buddhesh me rrufe, sepse ai apo ajo nuk do e bënin një gjë të tillë. Qënie e larta do t'i lënë kështu ato nëse ato futen në statuja Buddhesh. Ata e dinë kur janë për tu eliminuar, prandaj ata do të përpiqen që të shpëtojnë. Për pasojë, është ajo që ju shihni Bodhisattva Avalokitesvara e vërtetë? A është ai që ju shihni një Buddha i vërtetë? Është e vështirë ta dallosh.

Shumë prej jush mund të keni menduar për këtë çështje: “Çfarë duhet të bëjmë ne me statujat e Buddhës që kemi në shtëpi?” Ndoshta shumë prej jush u ka shkuar mendja për mua. Me qëllim që të ndihmojmë praktikuesit në praktikën kultivuese, unë po ju them se ju mund të veproni kështu: Duke mbajtur statujën e Buddhës në dorë, ju mund të merrni librin tim (sepse libri ka fotografinë time) ose një fotografi timen. Pastaj ju bëni Shenjën e Madhe të Lotusit me duar dhe i bëni mësuesit një kërkesë për bekim, njësoj sikur të ma kërkonit mua. Do të bëhet menjëherë. Më lejoni t'ju them të gjithëve, se kjo mund të bëhet vetëm për praktikuesit tanë. Ky bekim nuk vepron për të afërmit apo miqtë tuaj sepse ne kujdesemi vetëm për praktikuesit. Disa njerëz thonë se ata marrin foton time në shtëpinë e të afërmëve apo miqve të tyre për të larguar shpirtërat e këqinj. Unë nuk jam këtu për të larguar shpirtërat e këqinj për njerëzit e zakonshëm—ky është mosrespekti më i madh kundrejt Mësuesit.

Meqë po flasim për Buddhath dhe Taot tokësorë, ekziston dhe një çështje tjetër. Në Kinën e lashtë, ka patur shumë njerëz që praktikonin kultivim në malet e largëta dhe pyjet e thella. Pse nuk ka ndonjë sot? Në fakt, ata nuk janë zhdukur. Ata vetëm nuk lejojnë që njerëzit e zakonshëm ta dinë dhe asnjë prej tyre nuk mungon. Këta persona kanë të gjithë aftësi supernormale. Nuk është se ata nuk

janë rrotull gjatë kohëve të fundit, ata janë akoma të pranishëm. Ekzistojnë akoma disa mijëra prej tyre në botë sot. Relativisht ka më shumë prej tyre në vendin tonë, sidomos në ato malet e lartë e të famshëm dhe përgjatë lumenjve të mëdhej. Ata janë gjithashtu të pranishëm në disa male të lartë, por ata i mbyllin shpellat e tyre dhe fuqi supernormale kështu që ju nuk mund t'i shihni. Përparimi i kultivimit të tyre është relativisht i ngadaltë dhe metodat e tyre janë relativisht të ngadalta sepse ata nuk kanë arritur të kuptojnë thelbin e kultivimit. Ne, nga ana tjetër, synojmë drejtëpërdrejt mëndjen e secilit dhe praktikojmë kultivim në përputhje me karakteristikën më të lartë të universit dhe formën e tij. Natyrisht, gongu rritet shumë shpejt. Kjo për arsye se rrugët e praktikës kultivuese janë si një piramidë; vetëm shtegu i mesit është rruga kryesore. Në shtegjet anësore dhe të vogla, niveli i karakterit në praktikën kultivuese mund të mos jetë i lartë. Dikush mund të arrijë lartësimin shpirtëror pa arritur një nivel të lartë kultivimi. Këto, megjithatë, janë shumë më inferiore në krahasim me rrugën kryesore të një praktike të vërtetë kultivuese.

Dikush nga një shkollë e tillë praktike merr gjithashtu dishepuj. Meqenëse kjo praktikë mund të arrijë vetëm një nivel kaq të lartë kultivimi dhe niveli i karakterit të individit mund të rritet në po atë nivel, të gjithë dishepujt praktikojnë kultivim vetëm drejt këtij niveli. Sa më afër një praktikë e rrugëve anësore është me skajet e jashtme të kultivimit, aq më shumë kërkesa do të ketë dhe aq më shumë e ndërlikuar do të jetë praktika kultivuese e saj, përderisa ajo nuk mund të kuptojë thelbin e kultivimit. Në kultivim, çdo njeri duhet kryesisht të kultivojë karakterin e vet. Ata akoma nuk e kuptojnë këtë dhe besojnë se ata mund të praktikojnë kryesisht duke vuajtur vështirësi. Prandaj, pas një periudhe të gjatë kohe dhe pasi kanë praktikuar kultivim për disa qindra vjet ose për më shumë se një mijë vjet, ata kanë arritur veçse pak gong. Në fakt, nuk është se e kanë arritur gongun nëpërmjet vuajtjeve. Si e kanë marrë atë? Kjo ngjan me shembullin e një njeriu të zakonshëm: Një person ka shumë dëshira në rini, por me kalimin e kohës njeriu plakët dhe e ardhmja i duket e pashpresë. Këto dëshira braktisen dhe hiqen natyrshëm. Këto praktika të rrugëve anësore përdorin gjithashtu këtë metodë. Ata kanë zbuluar se mund të rrisin gongun kur meditojnë ulur dhe në kllapi dhe kur vuajnë vështirësi gjatë përparimit në kultivim. Megjithatë ata nuk e dinë që dëshirat e tyre prej njerëzish të zakonshëm konsumohen gradualisht gjatë një periudhe të gjatë dhe të egër kohe dhe është nëpërmjet heqjes dorë dalëngadalë prej këtyre dëshirave që gongu rritet.

Praktika jonë ka një fokus dhe me të vërtetë nxjerr në pah veset. Duke i braktisur ato, personi do të përparojë shumë shpejt në kultivim. Unë kam qenë në disa vende, ku shpesh u ndesha me ata njerëz që kanë praktikuar kultivim për shumë vite. Ata më thanë: “Askush nuk e din që ne jemi këtu. Përsa i përket, asaj që po bën ti, ne nuk do të ndërhyjmë apo shkaktojmë ndonjë shqetësim.” Këta njerëz i përkasin rangut të atyre që janë relativisht të mirë.

Ka patur gjithashtu edhe disa të këqinj me të cilët na është dashur të merreni. Për shembull, kur unë dhashë një klasë në Guizhou për herë të parë, dikush erdhi të më takojë gjatë mësimit dhe më tha që mjeshtri i tij i madh donte të më takonte. Ai më tregoi për mjeshtrin e tij dhe se si ai kishte praktikuar kultivim për shumë vite. Unë pashë që ky person mbarte qi negative dhe dukej shumë i keq me një fytyrë të zbehtë. Unë i thashë që nuk kisha kohë ta takoja dhe e refuzova atë. Për rrjedhojë, mjeshtri i tij u zemërua dhe filloi të më hapë telashe, duke insistuar të më shqetësonte çdo ditë. Unë jam një njeri që nuk më pëlqen të luftoj me të tjerët dhe as që ia vlente të luftoja me të. Sa here që ai sillte probleme për mua, unë thjesht i mënjanoja ato. Më pas unë vazhdoja leksionin tim.

Ishte një Taoist në Dinastinë Ming⁴ i cili ishte zotëruar nga një gjarpër në kohën e kultivimit të tij Taoist. Më pas, ky Taoist vdiq pa e përfunduar kultivimin. Gjarpri e uzurpoi trupin e tij dhe kultivoi një formë njeriu. Mjeshtri i madh i atij personit ishte ky gjarpër me formë njeriu. Ngaqë natyra e tij nuk kishte ndryshuar, ai e transformonte veten në një gjarpër të madh që të me sillte mua telashe. Unë mendova që ai po e tejkalonte cakun, kështu që e kapa në duart dhe përdora një gong

⁴ Dinastia Ming—periudhë ndërmjet 1368 dhe 1644 p.e.r. në historinë e Kinës.

shumë të fuqishëm të quajtur “gongu shpërbërës” për t’ja shkrirë pjesën e poshtme të trupit dhe për ta kthyer në ujë. Pjesa e sipërme e trupit të tij u kthye me vrap në shtëpi.

Një ditë, drejtuesi vullnetar i qëndrës së mësimimit në Guizhou u kontaktua prej dishepullit të këtij personi, I cili i tha se mjeshtri i tij i madh donte ta takonte atë. Drejtuesi shkoi atje dhe hyri në një shpellë të errët ku ajo nuk mund të shihte asgjë përveç një hijeje të ulur atje me sytë që ndriçonin dritë jeshile. Kur ai hapte sytë, shpella ndriçohet. Shpella do të errësohet përsëri nëse ai mbyllte sytë. Ai tha me një dialekt lokal: “Li Hongzhi do të vijë përsëri dhe asnjë nga ne nuk do të shkaktojë më ato trazira. Unë e kisha gabim. Li Hongzhi vjen për t’u afruar njerëzve shpëtim.” Dishepulli i tij e pyeti: “Mjeshtër i Madh, të lutem ngrihu në këmbë. Çfarë të ka ndodhur me këmbët?” Ai u përgjigj: “Unë nuk mund të ngrihem më sepse këmbët më janë dëmtuar.” Kur u pyet se si i ishin dëmtuar, ai filloi të përshkruante telashet që më kish sjellë. Më 1993, në Expozitën Shëndetësore Orientale në Beijing, ai përsëri më ndërhyri. Për arsye se ai gjithmonë kryente vepra të këqija dhe ndërhynte me mësimin tim të Dafës, unë atëhere e eliminova atë plotësisht. Pas eliminimit të tij, motrat dhe vëllezërit e tij të gjithë deshën të hakmerreshin. Atëhere unë u thashë nja dy fjalë. Ata u shtangën dhe u frikësuan kaq shumë sa asnjë prej tyre nuk guxonte të bënte gjë. Ata më në fund e kuptuan çfarë po ndodhte. Disa prej tyre ishin komplet njerëz të zakonshëm megjithëse kishin kultivuar për një kohë të gjatë. Këto janë disa shembuj që ju dhashë përta i përket çështjes së bekimit.

Disiplina e Magjisë

Çfarë është disiplina e magjisë? Në komunitetin e kultivuesve, gjatë mësimimit të qigongut shumë njerëz e mësojnë atë si një kategori kultivimi. Në fakt, nuk është diçka që i përket kategorisë së praktikës kultivuese. Ajo është mësuar në formën e aftësive, e lutjeve dhe teknikave. Ajo përdor forma vizatimi të simboleve, djegje ere të mirë, djegje letrash, këndim lutjesh etj. Ajo mund të shërojë sëmundje dhe metodat e kurimit të saj janë shumë të veçanta. Për shembull, nëse dikush ka një lungë të fryrë në fytyrë, praktikuesi do të vizatojë një rreth në tokë me një pendë të lyer me bojë dhe vizaton një kryq në mes të rrethit. Ai do t’i kërkojë personit që të qëndrojë në qëndër të rrethit. Pastaj ai do të fillojë të këndojë lutjet. Ai vazhdon të vizatojë derisa bën një pikë mbi lungë me pendë dhe këndimi i lutjeve mbaron aty. Ai do t’i thotë asaj se tani e ka mirë. Kur ajo e prek lungën, kjo do të jetë me të vërtetë më e vogël dhe nuk i dhëmb më, sepse kjo mënyrë mund të ketë efekt. Ai mund të shërojë sëmundje të vogla por jo të mëdha. Çfarë do të bëjë ai nëse ju dhemb krahu? Ai do të fillojë të këndojë lutje, ndërkohë ju kërkon që të ngrini krahun. Ai do të fryjë në pikën *hegu*⁵ të kësaj dore dhe do e nxjerrë atë nga pika *hegu* e dorës tjetër. Ju do të ndjeni një rrymë ajri dhe kur ju të prekni krahun tuaj, nuk do të ndjeni më dhimbje si më parë. Përveç kësaj, disa njerëz përdorin metodat e djegjes së letrave, vizatimit të simboleve, vendosjes së simboleve, etj. Ata bëjnë gjëra të tilla.

Praktikat e njohura të rrugëve anësore të Shkollës Tao nuk kultivojnë jetë. Ato i dedikohen kryesisht kallëzimit të fatit, *fengshui*⁶, largimit të shpirtrave të këqinj dhe shërimit të sëmundjeve. Shumica e këtyre përdoren nga praktikantët tokësorë të rrugëve anësore. Ato mund të shërojnë sëmundje por metodat e përdorura nuk janë të mira. Ne nuk do të tregojmë se çfarë përdorin ata për të shëruar sëmundjet por praktikuesit e Dafës sonë nuk duhet t’i përdorin ato përderisa ato mbartin mesazhe shumë të ulëta dhe të këqija. Në Kinën e lashtë, metodat e shërimit ishin ndarë në disiplina si metoda e rregullimit të frakturave, akupunktura, masazhi, kiropraktika⁷, shtypja me duar, shërimi qigong,

⁵ *hegu*—pikë akupunkte në kurriz të dorës, ndërmjet gishtit të madh dhe gishtit tregues.

⁶ *fengshui* (feng-shuei)— praktikë e lashtë kineze e të jetuarit në harmoni me energjinë e ambientit rrethues; një lloj arti i interpretimit të truallit dhe natyrës.

⁷ kiropraktika—metodë trajtimi sëmundjesh duke manipuluar nujet e kockave sidomos atyre të shtyllës kurrizore.

kurimi me bimë mjekësore, e kështu me radhë. Ato klasifikoheshin në shumë ndarje. Çdo metodë shërimi quhej një disiplinë. Kjo disiplina e magjisë është klasifikuar si disiplina e trembëdhjetë. Prandaj, emri i saj i plotë është “Disiplina e Trembëdhjetë e Magjisë.” Disiplina e Magjisë nuk është diçka brenda kategorisë sonë të kultivimit, për arsye se nuk është gong i arritur nëpërmjet praktikës kultivuese. Përkundrazi është një lloj teknike.

LEKSIONI I GJASHTË

Marrosja nga Kultivimi

Në komunitetin e kultivuesve ekziston ky term i quajtur “marrosje nga kultivimi”. Ai ka lënë një përshtypje shumë të madhe tek njerëzit. Në veçanti, disa individë e kanë përhapur atë kaq shumë sa që disa njerëz kanë frikë që të praktikojnë qigong. Kur njerëzit dëgjojnë që praktika qigongut mund të çojë në marrosje nga kultivimi, ata do të kenë frikë për ta provuar. Në fakt, me lejon t’ju them që marrosja nga kultivimi nuk ekziston aspak.

Plot persona janë zotëruar nga shpirtra apo kafshë sepse mendjet e tyre nuk janë të pastra. Shpirtrat Kryesorë të tyre janë të paaftë të kontrollojnë veten dhe megjithatë i duket sikur kanë gong. Trupat e tyre kontrollohen nga shpirtrat apo kafshët zotëruese duke i bërë ata mendërisht të paqëndrueshëm apo duke i bërë ata të bërtasin apo ulërasin. Kur njerëzit shohin që praktika qigongut qenka e tillë, ata i zë frika për të praktikuar. Shumë prej jush mendojnë se ky është qigongu, por si mund të jetë kjo praktika e qigongut? Kjo është vetëm shkalla më e ulët për të mbajtur trupin të shëndetshëm dhe në formë megjithatë ajo është edhe shumë e rrezikshme. Nëqoftëse jeni mësuar me këtë mënyrë, Shpirti juaj Kryesor do të jetë gjithmonë i paaftë të kontrollojë veten. Atëhere trupi juaj mund të kontrollohet nga Shpirti juaj Ndihmës, mesazhe të huaja, shpirtrat apo kafshët zotëruese, etj. Ju mund të kryeni vepra të rrezikshme dhe t’i shkaktoni dëm të madh komunitetit të kultivuesve. Kjo shkaktohet nga mendja imorale dhe dëshira për t’u dukur e personit—kjo nuk është marrosje nga kultivimi. Askush nuk e di se si disa njerëz janë bërë të ashtuquajtur mjeshtrë qigongu, pasi ata gjithashtu besojnë në marrosjen nga kultivimi. Faktikisht, praktika e qigongut nuk mund të çojë në marrosje nga kultivimi. Shumica e njerëzve mësojnë këtë terminologji nga veprat letrare, novelat e arteve marciale e të tjera si këto. Po nuk besuat, ju mund të kontrolloni librat e vjetër apo librat e kultivimit, ku nuk ka gjëra të tilla. Si është e mundur të ekzistojë marrosja nga kultivimi? Është e pamundur që të ndodhë një gjë e tillë.

Besohet se marrosja nga kultivimi ka disa forma. Ajo që sapo përmenda është gjithashtu një nga këto forma. Për shkak se mendja e dikujt nuk është e pastër, ai pushtohet nga shpirtrat apo kafshët zotëruese dhe ka mentalitete të ndryshme si insistimin për të arritur ndonjë gjëndje qigongu me qëllim për t’u dukur. Disa njerëz jepen pas aftësive supernormale ose praktikojnë qigong të rremë. Kur ata praktikojnë qigong, ata e kanë zakon ta braktisin Shpirtin e tyre Kryesor. Ata humbin vetëdijen dhe ua lënë trupin e tyre të tjerëve. Ata bëhen mendërisht të çorientuar dhe i lënë trupat e tyre të komandohen nga Shpirti Ndihmës apo mesazhe të huaja. Ata shfaqin disa sjellje të çuditshme. Një person i tillë do të hidhej nga një ndërtesë apo do të zhytej në ujë nëse i thonë të bëjë këtë. Ai vetë nuk don as të jetojë dhe do t’ja japë trupin e tij të tjerëve. Kjo nuk është marrosje nga kultivimi, por devijim në një rrugë të gabuar në praktikën e qigongut dhe ajo shkaktohet nga të verpruarit me këtë qëllim që në fillim. Shumë njerëz mendojnë se të lëkundurit e trupit në mënyrë të pavetëdijshme është praktikë qigongu. Në fakt, nëse një person praktikon vërtet qigong në këtë gjëndje, ajo mund të çojë në pasoja serioze. Ajo nuk është praktikë qigongu, por rezultat i veseve dhe përdjekjeve të qëllimshme të njerëzve të zakonshëm.

Një rast tjetër është kur në praktikën e qigongut dikush do të frikësohej kur qi bllokohet diku në trup apo kur qi nuk zbret dot poshtë nga maja e kokës. Trupi i njeriut është një univers i vogël. Veçanërisht në një praktikë Taoiste kur qi kalon në një pasazh, një individ do të ndeshet me këto probleme. Nëqoftëse qi nuk kalon dot në pasazh, ajo do të qëndrojë atje. Mund të ndodhë jo vetëm në kokë por edhe në pjesët e tjera të trupit, sidoqoftë, pjesa më e ndjeshme e njeriut është koka. Qi do të ngjitet në majën e kokës dhe me pas do të zbrisë poshtë. Nëqoftëse qi nuk kalon dot nëpër një

pasazh, individi do të ketë një ndjenjë sikur koka i është rënduar dhe enjtur sikur ka vënë një kapele të trashë prej qi-je, etj. Por qi nuk mund të kontrollojë asgjë dhe as mund të sjellë ndonjë shqetësim apo ndonjë sëmundje kurrsesi. Disa njerëz nuk e dinë të vërtetën rreth qigongut dhe bëjnë disa komente misterioze dhe kjo ka çuar në një situatë kaotike. Për pasojë, njerëzit mendojnë se nëqoftëse qi ngjitet në majë të kokës dhe nuk mund të zbresë poshtë, personi do të ketë marrosje nga kultivimi, mund të ketë marrë rrugë të shtrembur e kështu me radhë duke çuar në atë që shumë njerëz kanë frikë.

Nëqoftëse qi ngjitet në majë të kokës dhe nuk zbrer poshtë, kjo është vetëm një gjëndje e përkohshme. Për disa njerëz kjo mund të zgjasë për një kohë shumë të gjatë apo gjysëm viti dhe përsëri nuk zbrer poshtë. Nëse ndodheni para një rasti të tillë, personi mund të gjejë një mjeshtër të vërtetë qigongu për ta drejtuar qi-në poshtë dhe ajo mund të zbresë. Në praktikën e qigongut, ju qi-ja e të cilëve nuk kalon nëpër një pasajh apo nuk zbrer poshtë, duhet të shikoni për shkakun në karakterin tuaj, për të parë nëse ju keni ngecur në atë nivel për një kohë të gjatë dhe nëse ju duhet të përmirësoni karakterin tuaj! Sapo ju të përmirësoni me të vërtetë karakterin tuaj, do të shikoni që qi do të zbresë poshtë. Ju nuk mund të kërkonte vetëm transformimin e gongut në trupin tuaj fizik pa theksuar përmirësimin e karakterit tuaj. Ai po pret që ju të përmirësoni karakterin tuaj—vetëm atëherë do të bëni ju një ndryshim tërësor. Nëqoftëse qi është bllokuar me të vërtetë, prapëseprapë ajo nuk do të shkaktojë ndonjë shqetësim. Zakonisht janë faktorët tanë psikologjikë që luajnë një rol. Përveç kësaj, një person do të frikësohet sapo të mësonte nga një mjeshtër i rremë qigongu që kur qi shkon në majë të kokës, personi do të shkojë dëm. Me këtë frikë në mendje, ajo me të vërtetë mund t'i sjellë këtij personi shqetësime. Me t'u frikësuar ju do të keni ndjenjën e frikës. A nuk është dhe ky një ves? Sapo vesi juaj del në pah, a nuk duhet të hiqet ai? Sa më shumë frikë të keni, aq më i sëmurë ju do të dukeni. Ky vesi juaj duhet të hiqet. Pra, kjo ndodh që ju të nxirrni një mësim prej gjithë kësaj, kështu që frika juaj të mund të hiqet dhe ju të mund të përparoni.

Praktikuesit nuk do të ndjehen rehat fizikisht gjatë kultivimit në të ardhmen, pasi trupat e tyre do të zhvillojnë lloje të ndryshme gongu. Të gjitha këto janë gjëra shumë të fuqishme që lëvizin gjithandej nëpër trup; ato do t'ju bëjnë juve të mos ndjeheni rehat në një mënyrë apo një tjetër. Arsyeja për parehatinë tuaj është kryesisht se ju gjithmonë keni frikë se mos sëmurëni. Në fakt, gjërat që zhvillohen në trupin tuaj janë kaq të fuqishme dhe ato janë të gjitha gong, aftësi supernormale dhe shumë qënie të gjalla. Kur ato lëvizin, ju do të ndjeni në trup kruajtje, dhimbje, siklete, etj. Ekstremitet e sistemit nervor janë veçanërisht të ndjeshme dhe do të ketë nga të gjitha llojet e simptomave. Për aq kohë sa trupi juaj nuk është transformuar plotësisht në materie të energjisë së lartë, ju do të ndjeheni kështu. Gjithsesi duhet parë si një gjë e mirë. Si praktikues, nëqoftëse ju gjithmonë e trajtoni veten si një njeri të zakonshëm dhe gjithmonë mendoni se ju keni ndonjë sëmundje, si mund të praktikoni ju kultivim? Kur gjatë praktikës kultivuese ndesheni me vështirësi, nëse ju akoma e trajtoni veten si njeri të zakonshëm, unë do të thoja që karakteri juaj në atë moment do të binte në nivelin e njerëzve të zakonshëm. Të paktën përse i përket këtij rasti të veçantë, ju keni rënë në nivelin e njerëzve të zakonshëm.

Si praktikues të vërtetë, ne duhet t'i shikojnë çështjet nga një nivel shumë i lartë, ndryshe nga prespektiva e njerëzve të zakonshëm. Nëse ju do të besoni se jeni i sëmurë, kjo mund të shkaktojë që të sëmurëni me të vërtetë. Kjo ndodh për arsye se me të menduar se jeni sëmurë, karakteri juaj do të jetë aq i lartë sa ai i njerëzve të zakonshëm. Praktika e qigongut dhe praktika kultivuese e vërtetë nuk do të çojnë në sëmundje, veçanërisht nën këto kushte. Dihet që ajo që i bën njerëzit të sëmurë në fakt është shtatëdhjetë përqind psikologjike dhe tridhjetë përqind fiziologjike. Në mënyrë tipike, personi përjeton një krizë mendore, mendja nuk mund ta përballojë më atë dhe ai pëson një peshë të madhe mendore para se gjendja e sëmundjes të keqësohet seriozisht. Zakonisht ndodh kështu. Më lejoni t'ju jap një shembull. Njëherë një person e kishin lidhur në një krevat. Ata i morren njërin krah dhe i thanë se do t'ja prisnin që t'i dilte gjak. Pastaj ata ia mbyllën sytë dhe e gërvishën njëherë tek

kyçi i dorës. (Ai nuk ishte prerë aspak dhe as nuk po i rridhte gjak.) Një rubinet çezmeje u hap në mënyrë që ai të dëgjonte ujin që rridhte dhe të mendonte kështu se ishte gjaku i tij që po pikonte. Ky njeri vdiq menjëherë pas kësaj. Në fakt, ai as nuk ishte prerë dhe as që i rridhte gjak—ishte uji i rubinetit që rridhte. Ishin faktorët e tij psikologjikë që i shkaktuan vdekjen. Nëqoftëse ju gjithmonë besoni se jeni i sëmurë, ka shumë mundësi që ju ta sëmurni veten për rrjedhojë. Për shkak se karakteri juaj ka rënë në nivelin e njerëzve të zakonshëm, ju do të sëmureni, pasi një njeri i zakonshëm natyrisht do të ketë sëmundje.

Si praktikues, nëse ju gjithmonë mendoni se është sëmundje, ju në fakt po e kërkonti atë vetë. Po e kërkuat sëmundjen, ajo do t'ju vijë në trup. Si praktikues, niveli i karakterit tuaj duhet të jetë i lartë. Ju nuk duhet të shqetësoheni që diçka është sëmundje, sepse frika e sëmundjes është një mendim për t'u braktisur dhe ai mund t'ju sjellë shqetësime. Në praktikën kultivuese, personi duhet të eliminojë karmën dhe kjo është e dhimbshme. Si mundet që të rritësh gongun ti duke qenë rehat? Si mundet ndryshe që secili të heqë veset e tij? Më lejoni t'ju tregoj një histori nga Buddhizmi. Ishte njëherë një person që ishte duke u bërë Arhat pas shumë përpjekjesh në kultivim. Ndërkohë që ai ishte në prag të arritjes së Shkallës së Duhur në kultivim dhe do të bëhesh Arhat, si të mos ishte ai i lumtur? Ai do të kalonte përtej Tre Hapësirave! Gjithësesi, ky emocion është një ves, vesi i kënaqësisë. Një Arhat nuk duhet të ketë vese, me një zemër që nuk mund të preket. Por ai dështoi dhe kultivimi i tij shkoi kot. Përderisa ai dështoi, ai duhet ta fillonte përsëri nga e para. Ai e rifilloi kultivimin dhe pas shumë përpjekjeve të mundimshme përsëri arriti në fund të kultivimit të tij. Këtë herë ai u frikësua dhe me mendje i tha vetes: “Unë nuk duhet të gëzohem. Përndryshe, do të dështoj përsëri.” Me këtë frikë ai përsëri dështoi. Frika është gjithashtu një lloj vesi.

Ka dhe një situatë tjetër: Kur një person bëhet psikopat, këtij personi i vihet damka sikur ka marrosje nga kultivimi. Ka disa njerëz që mandje presin që unë të trajtoj psikoza e tyre! Unë do të thoja që psikoza nuk është sëmundje dhe as që kam unë kohë të merrem me gjëra të tilla. Pse? Kjo është për arsye së një pacient me psikozë nuk ka ndonjë virus dhe trupi i tij nuk ka ndryshime patologjike dhe as infeksione; nuk është problem shëndeti për mendimin tim. Psikoza ndodhin kur dobësohet ndërgjegja kryesore e personit. Sa e dobët mund të bëhet ajo? Është njësoj si një njeri që nuk e ka veten kurrë nën kontroll. Shpirti Kryesor i një të sëmuri mendor është pikërisht kështu. Nuk don të ketë më kontroll mbi trupin. Ai është gjithmonë i turbullt dhe nuk mund të bëhet i vetëdijshëm. Në këtë kohë, Shpirti Ndhimës apo mesazhe të huaja do të ndërhyjnë me personin. Ka kaç shumë nivele në secilin dimension. Gjitha llojet e mesazheve do ta shqetësojnë atë. Përveç kësaj, Shpirti i tij Kryesor mund të ketë bërë gjëra të këqija në jetët e mëparshme dhe kreditorët mund të duan ti bëjnë atij keq. Gjitha llojet e gjërave mund të shfaqen. Ne do të thonim që kjo është e gjitha përta i përket psikozës. Si mund ta kuroj unë atë për ju? Unë do të thoja se ndodh pikërisht kështu që një njeri në fakt arrin në psikozë. Çfarë mund të bëhet me të? Të edukohet personi dhe të ndihmohet ai që të bëhet i vetëdijshëm—por është shumë e vështirë për ta bërë këtë. Ju do të shikoni që kur një mjek në një spital psikiatrik merr në dorë elektroshotin menjëherë pacienti do të frikësohet tej mase e nuk do të shqiptonte ndonjë marrëzi. Pse ndodh kjo? Në atë çast Shpirti Kryesor i këtij personi vjen në vete dhe ka frikë nga shoku elektrik.

Zakonisht, sapo një person fillon të praktikojë kultivim, ai do të dojë të vazhdojë. Çdo njeri ka natyrë Buddhe dhe dëshirën për kultivim. Prandaj, sapo e mësojnë atë, shumë praktikues do të praktikojnë kultivim gjatë gjithë jetës së tyre. Nuk ka rëndësi nëse ai e përfundon kultivimin apo mund të marrë Ligjin. Ky person megjithatë ka zemër për të ndjekur Taon dhe gjithmonë don ta praktikojë atë. Të gjithë e dinë që ky person praktikon qigong. Njerëzit në vendin e tij të punës e dinë, lagja, si dhe fqinjët. Pa mendojeni pak të gjithë: Përta i përket praktikës së vërtetë kultivuese, kush e ka bërë një gjë të tillë vite më parë? Askush nuk e ka bërë. Vetëm nëse një person praktikon me të vërtetë kultivim mund të ndryshohet rrjedha e jetës së tij. Por ai është një njeri i zakonshëm dhe ai po praktikon qigong vetëm për të mbajtur trupin të shëndetshëm dhe në formë. Kush do ta

ndryshonte rrjedhën e jetës së tij? Si njeri i zakonshëm, ai do të sëmurej një ditë ose do të ndeshej me ndonjë problem një ditë tjetër. Ai mund të bëhet psikopat ndonjë ditë apo dhe të vdiste në vend. Jeta e një njeriu të zakonshëm e tillë është. Megjithëse ju mund të shikoni një person që praktikon qigong në park, nuk do të thotë se ai praktikon me të vërtetë kultivim. Megjithëse ai dëshiron të praktikojë kultivim drejt niveleve të larta, ai nuk mund ta arrijë atë pa marrë mësim të vërteta. Ai ka vetëm dëshirën për të kultivuar kultivim drejt niveleve të larta. Ky njeri është akoma një praktikues qigongu i nivelit të ulët të mbajtjes së trupit të shëndetshëm dhe në formë. Askush nuk do ta ndryshojë rrjedhën e jetës së tij, kështu që ai do të ketë sëmundje. Nëqoftëse një person nuk vlerëson virtytin, as sëmundjet e tij nuk do të shërohen. Nuk është e vërtetë që sapo një njeri praktikon qigong, ai nuk do të ketë më sëmundje.

Një individ duhet të praktikojë kultivim me të vërtetë dhe t'i kushtojë vëmendje karakterit të vet. Vetëm duke praktikuar kultivim me të vërtetë, mund të zhduken sëmundjet e tij. Për shkak se qigongu nuk është një ushtrim fizik por diçka përtej njerëzve të zakonshëm, duhet të ketë një parim dhe standart më të lartë për praktikuesit. Një individ duhet të ndjekë ato në mënyrë që t'ja arrijë qëllimit. Por megjithatë shumë njerëz nuk veprojnë ashtu dhe vazhdojnë të mbeten njerëz të zakonshëm. Prandaj, ata përsëri do të sëmuren kur t'i vijë koha. Ky person mundet që një ditë papritur të pësojë trombozë cerebrale, papritur ta zërë kjo apo ajo sëmundje, apo të bëhet me psikozë. Të gjithë e dinë se ai praktikon qigong. Me t'u bërë psikopat, njerëzit do të thonë, "ai ka marrosje nga kultivimi," dhe do ti vihet ky epitete. Pa mendoni pak, të gjithë: A është e llogjikshme të veprohet kështu? Njerëzit që nuk praktikojnë nuk e dinë të vërtetën. Është e vështirë edhe për profesionistët apo për shumë praktikues që të dinë të vërtetën. Nëqoftëse ky person bëhet psikopat në shtëpi, mund të ishte më pak problematike, megjithëse të tjerët përsëri do të thoshin se ai e pati nga praktika e qigongut. Nëse personi bëhet psikopat në vendin e ushtrimeve, kjo do të ishte shkatërruese. Një damkë e madhe do t'i vihej praktikës dhe do të ishte e pamundur për ta hequr atë, pavarësisht nga përpjekjet. Gazetat do të shkruanin se praktika e qigongut çoi në marrosje nga kultivimi. Disa njerëz i kundërvihen qigongut edhe pa e njohur atë: "Shiko, ai ishte mirë pak më parë duke bërë ushtrime qigongu dhe tani ai u bë i tillë." Duke qenë një njeri i zakonshëm, çdo gjë që duhet t'i ndodhë atij, do të ndodhë. Ai mund të marrë sëmundje të tjera apo të ndeshet me probleme të tjera. A është llogjike të fajësosh qigongun për gjithshka? Është si puna e doktorit në një spital. Fakti që ai është doktor nuk do të thotë se ai nuk do të sëmuret kurrë gjatë jetës së vet—si mund të kuptohet kjo në këtë mënyrë?

Prandaj, mund të thuhet se shumë njerëz bëjnë komente pa vend pa njohur të vërtetën rreth qigongut apo parimeve prapa tij. Sapo del ndonjë problem, të gjitha llojet e epiteteve i ngjiten qigongut. Qigongu është bërë i njohur në shoqëri për një periudhë shumë të shkurtër kohe. Shumë njerëz janë kokëfortë dhe gjithmonë e mohojnë, shajnë dhe e kundërshtojnë atë. Asnjëri nuk e din çfarë lloj paragjykimi kanë këta njerëz. Ata e kanë kaq inat qigongun, sikur ai të kishte të bënte me ta. Sapo përmendet fjala qigong, ata do ta quajnë atë idealiste. Qigongu është shkencë, mandje një shkencë më e lartë. Kjo ndodh ngaqë mentaliteti i këtyre njerëzve është tepër kokëfortë dhe njohuritë e tyre janë tepër të cekëta.

Ekziston dhe një situatë tjetër e quajtur "gjëndje qigongu" në komunitetin e kultivuesve. Një person i tillë ka iluzione mendore dhe jo marrosje nga kultivimi. Një person në këtë gjëndje është jashtëzakonisht racional. Me lejoni më parë të shpjegoj se çfarë është "gjëndja qigongu". Dihet që cilësia e lindur e personit luan një rol të rëndësishëm në praktikën e qigongut. Ka njerëz nga të gjitha vendet e botës që besojnë në fe. Për disa mijëra vjet ka pasur në Kinë njerëz që besonin në Buddhizëm dhe Taoizm. Ata besojnë që e mira shpërblehet me të mirë dhe e keqja shpërblehet me të keqe. Por disa njerëz nuk e besojnë këtë. Veçanërisht në kohën e Revolucionit të Madh Kulturor, kjo u kritikua dhe u quajt paragjykim. Disa njerëz konsiderojnë si paragjykim gjithshka që ata nuk kuptojnë, atë që nuk e kanë mësuar nga librat, atë që shkenca moderne nuk e ka arritur akoma dhe atë që ende nuk është arritur të kuptohet. Kishte plot njerëz të tillë pak vite me parë, por tani ka më pak.

Megjithëse ju nuk mund t'i pranoni disa fenomene, ato faktikisht janë shfaqur tashmë në dimensionin tonë. Ju nuk guxonin t'i njihni ato, por tani njerëzit kanë kurajon të flasin hapur rreth tyre. Ata gjithashtu kanë mësuar disa fakte përsa i përket praktikës së qigongut duke dëgjuar rreth tyre apo duke i parë vetë ato.

Disa njerëz janë kaq kokëfortë saqë sapo t'ju përmendësh qigongun, ata do të qeshin me ju me të madhe. Ata mendojnë se ju po tregoheni supersticioz dhe shumë qesharak. Sapo t'ju flasësh për dukuritë në praktikën e qigongut, ata do t'ju konsiderojnë tepër të prapambetur. Megjithëse një njeri i tillë ka paragjykime, cilësia e tij e lindur mund të mos jetë e keqe. Nëse ai ka cilësi të mirë të lindur dhe dëshiron të praktikojë qigong, Syri i tij Qiellor mund t'i hapet në një nivel shumë të lartë dhe ai gjithashtu mund të ketë aftësi supernormale. Ai nuk beson në qigong por ai nuk mund të garantojë se nuk do të sëmuret. Kur ai të sëmuret, ai do të shkojë në spital. Kur doktorët e mjekësisë perëndimore nuk mund ta kurojnë dot, ai do të shkojë tek një doktor i mjekësisë kinese. Kur edhe doktori i mjekësisë kineze nuk mund t'ja kurojë dot sëmundjen dhe kur asnjë lloj kure nuk i bën efekt, ai atëherë do të mendojë për qigongun dhe do thotë me vete: “Do të provoj fatin e të shoh mos e shëroj sëmundjen nëpërmjet qigongut.” Ai do të vijë me shumë hezitim. Për shkak të cilësisë së vet të mirë të lindur, sapo ai praktikon qigong, ai do të përparojë shumë mirë. Mbase ndonjë mjeshtrë do të interesohet për të apo ndonjë qenie e lartë në dimensione të tjera do ta ndihmojë. Papritur Syri i tij Qiellor hapet ose ai është në një gjëndje të një lartësimi shpirtëror gjysëm të plotë. Me syrin e tij qiellor të hapur në një nivel shumë të lartë, ai papritur mund të shohë disa të vërteta të universit. Për më tepër ai do të ketë aftësi supernormale. A mendoni që kur një njeri i tillë shikon këtë lloj situatë e beson atë? Në çfarë gjëndje mendore mendoni ju se do të jetë ai? Ajo që më parë ishte konsideruar nga të tjerët si supersticion, absolutisht e pamundur dhe qesharake, gjëndet në fakt pikërisht para syve të tij dhe ai është me të vërtetë në kontakt me të. Mëndja e këtij personi nuk do të mund ta përballojë këtë pasi presioni mendor është tepër i madh. Ato që ai thotë nuk do të kuptohen nga të tjerët megjithëse mendja e tij është e kthjellët. Por thjesht ai nuk mund të balancojë lidhjen midis dy anëve. Ai ka zbuluar se ajo që bëjnë njerëzit është gabim, ndërsa ajo që bëhet në anën tjetër është zakonisht e drejtë. Nëqoftëse ai i bën gjërat në përputhje me mënyrën si bëhen atje, njerëzit do të thonë se ai e ka gabim. Ata nuk e kuptojnë atë, kështu që ata do të thonë që ai ka marrosje nga kultivimi.

Në fakt ky person nuk ka marrosje nga kultivimi. Shumë prej jush që praktikoni qigong nuk do të bëheni aspak kështu. Vetëm ata persona me shumë paragjykime do të pësojnë “gjëndjen qigong”. Shumë njerëz që janë të pranishëm këtu e kanë Syrin Qiellor të hapur—një numër i konsiderueshëm njerëzish. Ata me të vërtetë kanë parë gjëra në dimensione të tjera. Ata nuk janë të çuditur, ndjehen shumë mirë, mëndjet e tyre nuk janë të tronditura dhe as nuk janë ata në gjëndje qigongu. Pasi një person kalon në gjëndje qigongu, ai është shumë racional dhe flet me shumë arsye dhe logjikë. Është vetëm se njerëzit e zakonshëm nuk do ta besojnë atë që ai thotë. Ndonjëherë ai mund t'ju thotë se ka parë dikë që ka vdekur dhe se ky person i tha atij të bënte diçka. Si mund ta besojnë njerëzit e zakonshëm këtë? Me vonë, ky person e kupton se ai duhet t'i mbajë këto gjëra për vete në vend që të flasë për to. Pasi ai mund të dijë të kontrollojë marrëdhënien ndërmjet dy anëve çdo gjë do të jetë në rregull. Në mënyrë tipike, këta individë mbartin gjithashtu aftësi supernormale por edhe kjo nuk është aspak marrosje nga kultivimi.

Ka dhe një situatë tjetër e quajtur “marrosje e vërtetë” dhe kjo shihet rrallë. “Marrosja e vërtetë” të cilës i referohemi ne nuk ka të bëjë me një njeri që është me të vërtetë i marrë. Nuk është ky kuptimi por ajo do të thotë “kultivim i së vërtetës”. Çfarë është marrosja e vërtetë? Unë do të thoja që midis praktikuesve, një njeri i tillë shihet shumë rrallë, ndoshta një në njëqindmijë vetë. Si rezultat nuk është e zakonshme dhe as nuk ka ndonjë pasojë në shoqëri.

Zakonisht, ka një kusht për “marrosjen e vërtetë”. Duhet që ky person të ketë cilësi të lindur jashtëzakonisht të mirë dhe duhet të jetë goxha i shkuar në moshë. Duke qenë në moshë të madhe, do të jetë tepër vonë për këtë person të praktikojë kultivim. Ata me cilësi të lindur jashtëzakonisht të

mirë janë zakonisht me mision këtu dhe kanë ardhur nga nivele të larta; të gjithë kanë frikë të vizitojnë shoqërinë njerëzore, pasi personi do të jetë i paaftë të njohë cilindo pasi t'i jetë hequr kujtesa. Pasi një person vjen në këtë ambjent shoqëror të njerëzve të zakonshëm, ndikimi i njerëzve do ta bëjnë atë të jepet pas famës apo pasurisë dhe ai gradualisht do të bjerë në nivelin e njerëzve të zakonshëm. Nuk do të arrihte kurrë ajo ditë që ai të shpëtonte prej këtu. Prandaj, asnjëri nuk guxon të vijë këtu sepse të gjithë kanë frikë. Megjithatë ka pasur persona të cilët kanë ardhur këtu. Pasi vijnë, ata me të vërtetë nuk mund të sillen mirë midis njerëzve të zakonshëm. Ata me të vërtetë do të bien në nivele të ulëta dhe do të kryejnë shumë vepra të këqija gjatë jetëve të tyre. Kur një njeri jeton vetëm për të konkuruar për përfitim personal, ai kryen shumë vepra të këqija dhe i detyrohet shumë të tjerëve. Mjeshtri i tij shikon se ai është duke rënë poshtë. Megjithatë ai është dikush me Shkallë Arritjeje, kështu që mjeshtri nuk do ta lërë të bjerë poshtë kaq lehtë! Çfarë mund të bëhet në këtë rast? Mjeshtri i tij do të jetë shumë i shqetësuar dhe nuk ka mënyrë tjetër për ta lejuar atë të praktikojë kultivim. Ku mund të gjejë në këtë kohë ai një mjeshtër? Atij do t'i duhet të kthehet në origjinë duke filluar kultivimin nga fillimi. Por si mund të bëhet kjo kaq lehtë? Duke qenë i moshuar do të jetë tepër vonë për të që të praktikojë kultivim. Ku mund të gjejë ai një praktikë kultivuese të mëndjes dhe të trupit.

Vetëm nëse ai ka cilësi të lindur jashtëzakonisht të mirë dhe vetën nën një rrethanë të tillë të pazakontë mundet të aplikohet metoda e marrosjes së vërtetë për të. Me fjalë të tjera, kur nuk ka absolutisht asnjë shpresë që ky person të kthehet në origjinë me përpjekjet e veta, kjo metodë që e bën atë të marrë mund të përdoret. Disa funksione të trurit të tij do të kyçen. Për shembull, si qenie njerëzore ne kemi frikë nga të ftohtit dhe pislleku, kështu ato pjesë të trurit që lidhen me frikën nga të ftohtit dhe pislleku do të kyçen. Pasi disa funksione të trurit nuk punojnë, ai do të duket sikur ka probleme mendore dhe do të veprojë si një njeri me të vërtetë i marrë. Por ai zakonisht nuk bën ndonjë gjë të keqe dhe as nuk përbuz apo godet njeri. Përkundrazi, ai shpesh kryen vepra të mira por është shumë mizor me veten. Për shkak se ai është i pandjeshëm ndaj të ftohtit, në dimër ai do të vrapojë nëpër borë zbatshur dhe veshur hollë. Këmbët e tij do të ngrijnë nga të ftohtit aq sa të gjakosen keq. Për shkak se ai është i pandjeshëm ndaj pisllekut, ai do të guxojë të hajë jashtëqitje dhe të pijë urinë njeriu. Unë njëherë kam njohur një person të tillë që hante jashtëqitjen e kuajve sikur të ishte e shijshme, megjithëse ishte gur e ngrirë. Ai mund të vuante vështirësi që një njeri i zakonshëm nuk do të mund të vuante me një mëndje të kthjellët. Imagjinoni sa shumë e bënte të vuante marrëzia atë. Natyrisht, njerëz të tillë kanë aftësi supernormale; shumica e tyre janë gra të moshuara. Grave të moshuara ia lidhnin këmbët në të kaluarën, por ishte njëra që mund të kërcente pa mundim mbi një mur rreth dy apo më shumë metra. Kur familja e saj pa që ajo ishte marrosur dhe gjithmonë ikte nga shtëpia, ata e mbyllnin atë në shtëpi. Sapo anëtarët e familjes largoheshin, ajo do e hapte derën vetëm duke drejtuar gishtërinjtë nga çelësi i derës. Pastaj ajo ja mbathte. Më pas, ata do e mbërthenin atë me zinxhira hekuri. Kur të gjithë iknin nga shtëpia, ajo i shkunte zinxhirët pa mundim. Ishte e pamundur ta mbaje atë nën kontroll. Me këtë, ajo do të vuante shumë vështirësi. Për shkak se ajo vuante shumë dhe tepër mizorisht, ajo do të paguante shpejt detyrimet që kishte nga kur kish bërë keq. Do të duheshin maksimumi tre vjet dhe zakonisht vetëm një apo dy vjet sepse ajo lloj vuajtjeje ishte shumë e tmerrshme. Pas kësaj, ajo do të kuptonte menjëherë se çfarë kish ndodhur. Për shkak se ajo përfundoi kultivimin, asaj do t'i çlirohej gongu menjëherë i shoqëruar me një shumëllojshmëri fuqish hyjnore. Këto raste ndeshen shumë rrallë por kanë ekzistuar disa në histori. Njerëzit me cilësi të lindur mesatare nuk do të lejohen ta bëjnë kështu. Dihet që në histori janë dokumentuar me të vërtetë murgj apo Taoistë të marrë, si murgu i marrë që nxorri Qin Hui-n¹ nga tempulli me fshesë si dhe histori të tjera rreth Taoistësh të marrë. Ka shumë histori të tilla klasike.

¹ Qin Hui—një zyrtar i keq i oborrit mbretëror në Dinastisë Song të Jugut (1127 e.r.—1279 e.r.).

Përsa i përket marrosjes nga kultivimi, ne mund të themi që ai përfundimisht nuk ekziston. Nëse dikush mund “të prodhojë zjarr”² dhe nëse është me të vërtetë i tillë, unë do të thoja që ky njeri është mjaft i zoti. Nëqoftëse një person mund të ndezë zjarr duke hapur gojën apo duke shtrirë dorën, apo të ndezë një cigare me një gisht, unë do ta quaja atë aftësi supernormale!

Ndërhyrja Demonike në Kultivim

Çfarë është ndërhyrja demonike në kultivim? Ajo është ndërhyrje me te cilën ne ndeshemi shpesh në praktikën e qigongut. Si ndodh që praktika e qigongut tërheq ndërhyrje demonike? Në fakt dalin shumë vështirësi kur një njeri don të praktikojë kultivim. Një person nuk do të mund t’ja arrinte kultivimit të vërtetë pa mbrojtjen e Fashenit im. Sapo ju dilni nga pragu i derës, jeta juaj mund të ishte në rrezik. Shpirti Primordial i personit nuk vdes. Atëhere, në aktivitetin tuaj shoqëror në jetët e shkuara, ju mund t’i keni hyrë në borxh të tjerëve, keqtrajtuar të tjerët apo të keni kryer vepra të tjera të këqija. Këta kreditorë do t’ju kërkojnë. Thuhet në Buddhizëm që një njeri jeton për shkak të shpagimit karmik. Nëse ju i detyroni dikujt, ai do t’ju kërkojë për të marrë shpagimin. Nëse ai merr më shumë shpagim, atij do t’i duhet t’ju kthejë tepërcën herën tjetër. Nëse një bir nuk respekton prindërit e tij, ata do të shkëmbejnë vendet në jetën tjetër. Kështu shkojnë gjërat rrotull. Por ne kemi vërejtur me të vërtetë ndërhyrje demonike e cila ju pengon juve të praktikoni qigong. Të gjitha ato kanë marrëdhënie karmike dhe nuk ekzistojnë pa shkak. Nuk do të lejoheshin të ekzistonin pa shkak.

Forma më e zakonshme e ndërhyrjes demonike ndodh si vijon. Para se të praktikoni qigong, ambjenti juaj është relativisht i qetë; tani që ju i keni mësuar ushtrimet, ju gjithmonë doni t’i praktikoni ato. Por sapo ju uleni për të filluar meditimin, papritmas fillon zhurma jashtë dhomës. Dëgjohen buri makinash, të ecura në koridore, biseda, përplasje dyersh dhe një radio nga jashtë. Nuk është më qetësi. Nëse ju nuk po praktikoni, ambjenti është mjaft i qetë, por sapo ju filloni të praktikoni ushtrimet, ndodh kështu. Shumë prej jush nuk e kanë menduar gjatë. Çfarë po ndodh me të vërtetë? Juve ju duket e çuditshme dhe ndjeheni mjaft të zhgënjyer që nuk mund të praktikoni qigong. Kjo “çuditje” do t’ju ndalojë të praktikoni. Është një demon që ju ndërhyr, pasi ai manipulon njerëzit që të shqetësojnë ty. Kjo është forma më e thjeshtë e ndërhyrjes dhe mund t’ja arrijë qëllimit që të ndalojë praktikën tuaj të qigongut. Nëqoftëse ju praktikoni qigong dhe arrini Taon atëhere si i bëhet për ato detyrimet e papaguara që ju i detyroni të tjerëve? Ata nuk do ta lejojnë këtë, kështu që ata nuk do t’ju lënë të praktikoni qigong. Për më tepër, kjo është gjithashtu një tregues i një niveli të caktuar. Pas një periudhë kohe ky fenomen nuk do të lejohet të ekzistojë. Me fjalë të tjera, pasi këto borxhe të konsumohen, ato nuk do të lejohen të vijnë e ndërhyjnë përsëri. Kjo për arsye se ata që praktikojnë kultivim në Falun Dafën tonë bëjnë përparim të shpejtë dhe ata gjithashtu ngjiten shpejt në nivele.

Ka dhe një formë tjetër ndërhyrje demonike. Ju e dini që nëpërmjet praktikës së qigongut Syri ynë Qiellor mund të hapet. Me Syrin Qiellor të hapur disa njerëz mund të shohin skena ose fytyra të frikshme kur praktikojnë qigong në shtëpi. Disa kanë flokë të ngatërruar e të gjatë dhe disa duan të ndeshen me ju apo bëjnë lëvizje të ndryshme frikësuese. Ngandonjëherë dikush mund t’i shohë ato të zvarriten jashtë dritares me pamje shumë të frikshme. Si mund të ndodhë një situatë e tillë? Kjo është një formë ndërhyrjeje demonike. Sidoqoftë, në shkollën tonë të Falun Dafës ky rast ndeshet shumë rrallë. Mbase ndodh një në njëqind vetë. Shumica e njerëzve nuk do të ndeshen me këtë situatë. Ngaqë nuk ka asnjë përfitim për praktikën tuaj, nuk lejohet t’ju ndërhyjë kështu. Në praktikën e tjera konvencionale, kjo lloj ndërhyrjeje është fenomeni më i zakonshëm dhe ai zgjat për një periudhë

² “të prodhosh zjarr”—një term kinez që do të thotë gjithashtu “marrojtje nga kultivimi”; është një lojë fjalësh, mund të ketë këtu si kuptim figurativ ashtu dhe letrar.

mjaft të gjatë. Disa njerëz nuk mund të praktikojnë qigong sepse frikësohen pikërisht për këtë arsye. Dikush zakonisht zgjedh për të praktikuar qigong ambientin e qetë të natës. Nëse ai do të shikonte dikë që qëndron përpara syve të tij me pamje gjysmë-fantazmë dhe gjysmë-njeri, ai do të ishte tepër i frikësuar për të praktikuar qigong. Zakonisht nuk ekziston një fenomen i tillë në Falun Dafën tonë. Por ka disa përjashtime tepër të rralla pasi disa njerëz kanë kushte shumë të veçanta.

Një lloj praktike tjetër është kultivimi i brendshëm dhe i jashtëm. Ajo kërkon praktikën e arteve marciale dhe kultivim të brendshëm. Kjo lloj praktike shihet zakonisht në Shkollën Tao. Sapo një person studjon këtë praktikë, ai do të ndeshet shpesh me një lloj ndërhyrje demonike që nuk ndeshet në praktikën e zakonshme, por ndodh vetëm në praktikën e kultivimit të brendshëm dhe të jashtëm, apo në ato të arteve marciale. Domethënë do të ketë njerëz që e kërkojnë atë për t'u ndeshur. Ka shumë praktikues Taoistë në botë; shumë prej tyre janë studentë të arteve marciale apo bëjnë kultivim të brendshëm dhe të jashtëm. Një student i arteve marciale mund të zhvillojë gjithashtu gong. Pse ndodh kjo? Nëqoftëse një person heq dëshirat e tjera si famën dhe përfitimin vetjak, ai gjithashtu mund të rrisë gong. Por dëshira e tij e konkurrencës don kohë për t'u hequr dhe do të braktiset shumë ngadalë. Prandaj, ai do ta bëjë një gjë të tillë me lehtësi, gjë që mund të ndodhë edhe në nivele të caktuara. Ndërsa është ulur në meditim, ai e din se kush po praktikon arte marciale. Shpirti i tij Primordial do ta lërë trupin për të ftuar në ndeshje një person tjetër dhe për të parë se kush e ka artin marcial më të mirë dhe kështu shpërthen një dyluftim. Këto gjëra ndodhin në dimensione të tjera, ku dikush mund të vijë për të luftuar. Nëse ai refuzon, personi tjetër do ta vrasë atë me të vërtetë. Pra një luftim midis të dyve shpërthen. Sapo ky person bjen të flerë, dikush do ta kërkojë atë që të ndeshet dhe kjo e bën natën e tij pa prehje. Në fakt kjo është koha për të hequr dëshirën e tij të konkurrencës. Nëqoftëse ky mentalitet konkurues nuk braktiset, ai nuk do të ndryshojë. Ndërsa koha kalon, ai akoma nuk mund të lëvisë përtej këtij niveli edhe pas disa vitesh. Ai do të bëhet i paaftë për të vazhduar praktikën e qigongut. Me kaq energji të konsumuar, trupi i tij fizik gjithashtu nuk mund të durojë më dhe mund të bëhet shpejt i paaftë. Kështu, në praktikën e kultivimit të brendshëm dhe të jashtëm, një njeri mund të ndeshet me një situatë të tillë dhe kjo është tepër e zakonshme. Në praktikën tonë të kultivimit të brendshëm nuk ka ndonjë situatë të tillë dhe as që lejohet ajo që të ndodhë. Këto forma të ndryshme që sapo diskutova ndodhin mjaft shpesh.

Ka edhe një formë tjetër ndërhyrjeje demonike që të gjithë, duke përfshirë dhe secilin në shkollën tonë të praktikës, do ta ndeshin: Ky është demoni i epshit. Kjo është diçka shumë serioze. Në shoqërinë njerëzore nëpërmjet martesës, njerëzimi mund të krijojë pasardhësit. Raca njerëzore zhvillohet në këtë mënyrë dhe sentimentalizmi është gjithashtu pjesë e shoqërisë njerëzore. Kështu, një gjë e tillë është plotësisht e justifikuar për njerëzit e zakonshëm. Përderisa njerëzit kanë emocione, të mërzitësh është emocion, po kështu janë lumturia, dashuria, urrejtja, të kënaqurit nga kryerja e një gjëje, marazi nga kryerja e një gjëje tjetër, të pëlqyerit e dikujt më shumë se një tjetër, qefet dhe pakënaqësitë—çdo gjë është emocion dhe njerëzit e zakonshëm jetojnë veç për të. Prandaj, si praktikues dhe si një njeri që ngrihet mbi çdo gjë, ju nuk duhet të përdorni këtë logjikë për t'i gjykuar gjërat dhe ju duhet të çliroheshi prej tyre. Prandaj, përse i përket gjithë dëshirave që vijnë nga emocionet, ne duhet t'i marrim ato lehtësisht dhe gradualisht t'i braktisim ato. Dëshirat, epshi dhe gjëra të kësaj natyre janë të gjitha vese njerëzore dhe të gjitha ato duhet të braktisen.

Shkolla jonë e praktikës, ose të paktën ajo pjesë që praktikon kultivim midis njerëzve të zakonshëm, nuk kërkon nga ju që të bëheni murgj apo murgesha. Praktikuesit e rinj duhet të kenë familje. Pra, si duhet të trajtohet kjo çështje? Unë kam thënë që shkolla jonë e praktikës synon direkt mëndjen e njeriut. Nuk ju bën juve që në fakt të humbni ndonjë gjë përse i përket të mirave materiale. Përkundrazi, ju duhet të kalisni karakterin tuaj midis të mirave materiale të njerëzve të zakonshëm. Ai që përmirësohet në të vërtetë është karakteri juaj. Nëse ju mund të hiqni veset, ju jeni i aftë të braktisni çdo gjë; po t'ju kërkohet të heqni dorë nga të mirat materiale, ju me siguri do të jeni i aftë për ta bërë këtë. Nëse nuk i hiqni veset, ju nuk do të jeni në gjëndje të braktisni asgjë. Prandaj,

qëllimi i vërtetë i kultivimit është që të kultivoni zemrën tuaj. Praktika kultivuese në tempuj ju detyron juve të humbni këto gjëra në mënyrë që të zhdukni veset tuaja. Duke mos ju lënë që të mendoni për to, ata ju detyrojnë që t'i refuzoni ato plotësisht; kështu ata kanë adoptuar një metodë të tillë. Por ne nuk kërkojmë nga ju që të veproni kështu. Ne kërkojmë që ju të tregoni më pak interes për të mirat materiale që gjenden para jush. Prandaj, ata që kultivojnë në shkollën tonë të praktikës janë shumë të qëndrueshëm. Ne nuk kërkojmë që ju të bëheni murgj apo murgesha. Pasi praktika jonë të përhapet më shumë në të ardhmen, praktikuesit tanë që praktikojnë kultivim midis njerëzve të zakonshëm nuk do të kthehen në gjysmë murgj. Nuk lejohet që çdo praktikues i Falun Dafës të bëhet i tillë. Gjatë praktikës, ne kërkojmë nga secili sa vijon: Nëqoftëse ju praktikoni dhe bashkeshorti (-ja) juaj nuk praktikojnë, nuk lejohet që ju të divorcoheni për shkak të praktikës. Me fjalë të tjera, ne duhet ta marrin atë lehtëshëm dhe të mos i vëmë aq rëndësi sa i japin njerëzit e zakonshëm. Në veçanti, e ashtuquajtura liri seksuale dhe pornografia në shoqërisë e sotme u ndërhyjnë njerëzve. Disa njerëz janë shumë të interesuar në këto gjëra. Si praktikues, ne nuk duhet t'i kushtojmë rëndësi atyre.

Nga pikëpamja e një niveli të lartë, njerëzit po luajnë me baltë në shoqëri pa e kuptuar se ajo është e pisët. Ata po luajnë me baltë në tokë. Ne kemi thënë se ju nuk duhet të shkaktoni prishjen e harmonisë në familjen tuaj për shkak të kësaj çështje. Prandaj, në këtë fazë, ju duhet ta merrni atë lehtë. Është mirë të ruani një jetë martesore normale dhe të harmonishme. Në të ardhmen, kur ju arrini një farë niveli, do të keni gjendjen kultivuese të atij niveli. Tani për tani duhet të jetë kështu dhe jeni në rregull nëse i përmbaheni kësaj kërkesë. Natyrisht, ju nuk duhet të shkoni pas gjërave që ndodhin sot në shoqëri. Si mund të lejohet kjo?

Një faktor tjetër ka lidhje me këtë çështje. Ju e dini që trupat e praktikuesve tanë kanë energji. Tashmë, tetëdhjetë deri në nëntëdhjetë përqind e njerëzve nga kjo klasë jo vetëm që do t'i shërohen sëmundjet por do të zhvillojnë gjithashtu gongun e tyre. Kështu, trupi juaj mbart energji shumë të fuqishme. Gongu dhe niveli i karakterit tuaj në këtë kohë nuk janë në proporcion të barabartë. Gongu juaj është përkohësisht më i lartë, pasi unë e rris menjëherë dhe tani ai pret që ju të përmirësoni karakterin juaj. Karakteri juaj do ta arrijë atë gradualisht. Është e garantuar që brenda kësaj periudhe kohe do ta arrijë. Kështu që ne e kemi bërë këtë para kohe. Me fjalë të tjera, ju keni një sasi energjie. Meqenëse energjia e kultivuar nga një rrugë e drejtë është plotësisht e pastër dhe dashamirëse, të gjithë ju që jeni ulur këtu ndjeni një atmosferë qetësuese dhe dashamirëse. Unë e kam kultivuar veten në këtë mënyrë dhe i mbart këto gjëra me vete. Të gjithë ju që jeni ulur këtu jeni në harmoni pa mendime të këqija dhe asnjëri nuk i shkon mendja për të pirë cigare. Në të ardhmen, ju duhet të ndiqni kërkesat e Dafës sonë dhe gongu që ju do të zhvillon nëpërmjet praktikës kultivuese do të jetë i njejtë. Me fuqinë e gongut në rritje, energjia që shpërndahet nga gongu në trupin tuaj do të jetë gjithashtu e fuqishme. Edhe sikur të mos jetë aq e fuqishme, një njeri i zakonshëm brenda fushës tuaj të energjisë do të kufizohet. Ose nëse ju jeni në shtëpi, ju do të frenoni anëtarët e familjes suaj. Pse ndodh kështu? Juve nuk ju duhet të përdorni as mendjen për ta bërë këtë. Kjo fushë është plot harmoni, dashamirësi dhe plot besim. Prandaj, njerëzit zor se do të mendojnë për gjëra të këqija apo kryejnë vepra të këqija. Ka këtë efekt.

Dje unë thashë që drita e Buddhës ndriçon kudo dhe korigjon të gjitha anomalitë. Me fjalë të tjera, energjia e shpërndarë nga trupi ynë mund të korigjojë të gjitha gjendjet anormale. Prandaj nën efektin e kësaj fushe, nëse ju nuk mendoni për këto gjëra, ju do të frenoni pa dashur edhe bashkeshortin (-ten) tuaj. Nëqoftëse ju nuk do të mendoni për to as bashkeshorti (-ja) juaj nuk do të mendojë për to. Por kjo nuk është absolute, pasi në ambjentin e sotëm ka nga të gjitha llojet e gjërave në televizor që po ta ndezësh, mund të nxisin dëshirat e njerëzve me lehtësi. Por në kushtet normale ju keni këtë efekt frenues. Në të ardhmen kur ju te arrini nivele të larta në praktikën kultivuese, pa ju thënë unë, ju do të dini se çfarë të bëni. Në atë kohë do të ekzistojë një gjëndje tjetër për të siguruar një jetë me harmoni. Prandaj, ju nuk duhet të shqetësoheni shumë për këtë, pasi të jesh tëper i shqetësuar është gjithashtu një ves. Nuk ka problem epshi ndërmjet burrit dhe gruas, por ekziston

problemi dëshirës. Për aq kohë sa ju mund ta merrni lehtëshëm dhe e konsideroni të drejtë një gjë në mëndje, çdo gjë do të shkojë mirë.

Pra, me çfarë lloj demonësh të epshit do të ndesheni ju? Nëse aftësia juaj e përqëndrimit në meditim nuk është e mjaftueshme, ai do t'ju shfaqet në ëndërr kur flini. Kur ju jeni duke fjetur apo medituar, ai do të shfaqet papritur. Nëse jeni mashkull një bukuroshe do të shfaqet. Nëse jeni femër, burri i ëndrrave tuaja do të shfaqet. Dhe ata do të jenë lakuriq. Me t'u eksituar, ju do të vini dhe do e bëni realitet. Pa mendojeni pak të gjithë: Në praktikën tonë kultivuese, esenca e trupit përdoret për të kultivuar jetën; ju nuk mund të vini gjithmonë kështu. Ndërkohë, ju nuk e keni kaluar testin e epshit. Si mund të lejohet një gjë e tillë? Prandaj, unë po ju them se të gjithë do të ndesheni me këtë çështje—është e garantuar. Ndërkohë që po ju mësoj Ligjin, unë ju transmetoj një energji shumë të fuqishme në mëndjen tuaj. Ju mund të mos kujtoni me hollësi së çfarë kam thënë unë pasi të dilni nga kjo derë, por kur ju të ndesheni në fakt me këtë çështje, ju do të kujtoheni se çfarë kam thënë. Për aq kohë sa ju e konsideroni veten si praktikues, ju do ta kujtoni menjëherë dhe do të jeni të aftë ta përmbani veten dhe pastaj do të mund ta kaloni këtë test. Nëse ju e humbni testin herën e parë, do të jetë e vështirë për ta kaluar për herë të dytë. Por ka edhe raste kur një njeri që dështon herën e parë do të ndjejë keqardhje shumë të madhe kur të zgjohet nga gjumi. Ndoshta ky mendim dhe kjo gjëndje mendore do të përforcojë kujtesën tuaj në lidhje me të. Kur kjo gjë ndodh përsëri, ju do të jeni në gjëndje ta kontrolloni veten dhe ta kaloni testin. Nëse një njeri që e ka humbur testin nuk i bën përshtypje, do të jetë tepër e vështirë për ta kaluar atë më vonë. Është pa diskutim kështu.

Kjo formë ndërhyrjeje mund të vijë ose nga demonët ose nga mjeshtri, i cili transformon një objekt në një tjetër për t'ju testuar. Të dyja format ekzistojnë pasi të gjithë duhet ta kalojnë këtë test. Ne e fillojmë praktikën kultivuese si njerëz të zakonshëm. Hapi i parë është ky test dhe çdo njeri do të ndeshet me të. Më lejoni t'ju jap një shembull. Kur po mësoja një klasë në Wuhan, atje ishte një djalë tridhjetë-vjeçar. Menjëherë sapo dhashë këtë leksion, ai shkoi në shtëpi dhe u ul të bënte ushtrimin e meditimit. Ai arriti të përqëndroheshte në meditim menjëherë. Pas kësaj, ai papritur pa Buddha Amitabhën të shfaqej në njërën anë dhe Lao Zi në anën tjetër. Këto ai i shkruajti në raportin e experiences së vet. Pasi u shfaqen, të dy e vështruan pa thënë asnjë fjalë dhe më pas u zhdukën. Më pas, Bodhisattva Avalokitesvara u shfaq me një vazo në duar nga e cila dilte një tym i bardhë. Ndërsa rrinte ulur aty dhe shihte çdo gjë sikur të ishte e gjallë, ai pati një kënaqësi të madhe. Papritur tymi u transformua në disa bukuroshe; bukuroshet janë ato vajzat fluturuese qiellore të cilat janë shumë magjepëse. Ato kërcyen për të me lëvizje shumë elegante. Ai tha me vete: “Ngaqë unë po praktikoj, Bodhisattva Avalokitesvara po me shpërblen duke transformuar disa bukuroshe që t'i shikoj unë dhe po dërgon vajzat fluturuese qiellore që të kërcëjnë për mua.” Ndërsa ai po kënaqej nga ky mendim, këto bukuroshe papritur u zhveshën lakuriq dhe lëvizën drejt tij, duke iu afruar për ta përqafuar dhe përkëdhelur. Karakteri i këtij praktikuesi ishte përmirësuar shumë shpejt. Në atë çast, ai u alarmua menjëherë. Mendimi i parë që i erdhi në mëndje ishte: “Unë nuk jam një njeri i zakonshëm. Unë jam praktikues. Ju nuk duhet të më trajtoni në këtë mënyrë sepse unë jam një praktikues i Falun Dafës.” Sapo ky mendim u shfaq, çdo gjë u zhduk menjëherë përderisa ato ishin transformime gjithsesi. Pastaj Buddha Amitabha dhe Lao Zi u shfaqën përsëri. Lao Zi tregoi me gisht nga ky praktikues dhe i tha Buddha Amitabhës me një buzëqeshje: “Ky djalosh mund të mësohet.” Ai e kish fjalën se ky djalë është i mirë dhe se mund të mësojë.

Gjate gjithë historisë apo nga perspektiva e dimensioneve të larta, çështja e dëshirës dhe epshit kanë qenë shumë kritike në përcaktimin nëse një individ mund të praktikojë kultivim. Kështu që ne duhet me të vërtetë ti konsiderojmë këto gjëra me indiferencë. Sidoqoftë, ne praktikojmë kultivim midis njerëzve të zakonshëm, kështu që ne nuk ju kërkujmë të hiqni dorë plotësisht. Të paktën në stadin e tanishëm, ju duhet ta merrni lehtëshëm dhe të mos i ngjani atij që ishit në të kaluarën. Si praktikues, ju duhet të jeni i tillë. Kurdo që ka ndërhyrje të çfarëdo lloji në praktikën

kultivuese, ju duhet të shikoni për shkakun brenda vetes dhe të vendosni se çfarë ju nuk keni braktisur akoma.

Ndërhyrja Demonike nga Vetë Mëndja e Njeriut

Çfarë është “ndërhyrja demonike nga vetë mëndja e njeriut”? Trupi i njeriut ka një fushë materiale në çdo nivel dimensionali. Brënda një fushe të veçantë, çdo gjë në univers mund të reflektohet në fushën tuaj dimensionale si hije. Megjithëse janë hije ato kanë ekzistencë materiale. Çdo gjë brënda fushës suaj dimensionale diktohet nga mendimet në trurin tuaj. Pra, nëse ju me qetësi i shikoni gjërat me Syrin Qiellor dhe pa përdorur mëndjen, ajo që ju shikoni është e vërtetë. Nëse ju filloni sadopak të mendoni, ajo që shikoni do të jetë e rreme. Kjo quhet ndërhyrje demonike nga vetë mëndja juaj apo “transformim që ndjek mendimin.” Kjo ndodh sepse disa praktikues nuk e trajtojnë veten si praktikues dhe janë të paafte ta trajtojnë veten ashtu siç duhet. Ata shkojnë pas aftësive supernatyrle dhe janë të dhënë pas gjërave të parëndësishme apo të dëgjojnë diçka nga dimensione të tjera. Ata jepen pas këtyrë gjërave. Është e lehtë që këta njerëz të zhvillojnë ndërhyrje demonike nga vetë mëndja e tyre dhe të bien në nivele të ulta. Pamvarësisht sesa i lartë është niveli kultivues i tij, sapo ndodh ky problem ai do të bjerë drejt e në fund dhe në këtë mënyrë të shkatërrohet—kjo është një çështje jashtëzakonisht serioze. Nuk është si rastet e tjera ku nëse një person dështon në një test të karakterit herën e parë, ai mund të ngrihet e të vazhdojë përsëri të kultivojë. Kjo nuk ndodh në rastin e ndërhyrjes demonike nga vetë mëndja e njeriut, pasi jeta e këtij personi do të shkatërrohet. Veçanërisht për ata praktikues me Syrin Qiellor të hapur në një farë niveli, ky problem mund të ndodhë lehtë. Gjithashtu, disa njerëz gjithmonë kanë ndërhyrje nga mesazhe të huaja në ndërgjegjen e tyre dhe ata besojnë çfarëdo që u thuhet nga këto mesazhe të huaja; ky problem mund t’u ndodhë dhe atyre gjithashtu. Prandaj, disa prej jush me Syrin Qiellor të hapur do të kenë ndërhyrje nga mesazhe të llojeve të ndryshme.

Më lejoni t’ju jap një shembull. Është shumë e vështirë për një njeri që të mbajë mëndjen pa ndërhyrje në një nivel të ulët kultivimi. Ju mund të mos jeni në gjëndje të shikoni qartë pamjen e mësuesit tuaj. Një ditë ju mund të shikoni papritmas një Qënie Qiellore të madhe dhe të lartë. Ai ju bën disa komplimente dhe ju mëson diçka. Nëse ju e pranoni atë, gongu juaj do të prishet. Sapo të ndjeheni i kënaqur dhe ta pranoni atë si mjeshttrin tuaj, ju do të shkoni me të. Por ai nuk ka arritur Shkallën e Duhur për vete. Në atë dimension trupi i tij mund të bëhet i madh apo i vogël. Me diçka të tillë para syve dhe duke parë këtë Qënie Qiellore, ju do të jeni me të vërtetë i emocionuar. Me këtë emocion, a nuk do të shkoni ju të mësoni prej tij? Është shumë e vështirë të shpëtossh një praktikues nëqoftëse ai nuk sillet ashtu siç duhet. Ai mund ta shkatërrojë veten me shumë lehtësi. Qënie Qiellore janë të gjitha të pavdekshme, por edhe ato nuk kanë arritur Shkallën e Duhur dhe do të vazhdojnë t’i nënshtrohen ringjalljes njësoj si të tjerët. Nëqoftëse ju shkarazi e merrni një qënie të tillë për mjeshttrin tuaj dhe i shkoni atij nga pas, ku do t’ju çojë ai? Ai nuk mund të arrijë Shkallën e Duhur për vete. A nuk do të shkonte kot kultivimi juaj? Faktikisht, gongu juaj do të prishej. Është shumë e vështirë që një njeri ta mbajë mëndjen pa ndërhyrje. Unë po ju them të gjithëve që kjo është një çështje shumë serioze dhe shumë prej jush do ta kenë këtë problem më vonë. Unë ju kam mësuar juve Ligjin; varet nga ju nëse ju mund të silleni ashtu siç duhet. Kjo që diskutova është një nga situatat. Mos e lejoni mëndjen tuaj të shqetësohet kur ju shikoni një Qënie të Shumëlartësuar nga një shkollë praktike tjetër. Qëndro vetëm me një shkollë. Nëse është një Buddhë, një Tao, një Qënie Qiellore apo një demon, ata nuk duhet të të prekin në zemër. Duke u sjellë në këtë mënyrë, sukcesi është i sigurt.

Ndërhyrja demonike nga vetë mëndja e juaj manifestohet edhe në forma të tjera. Ju mund të keni ndërhyrje nga një i afërm i juaj që ka vdekur i cili qan dhe ju lutet që të bëni këtë apo atë gjë.

Gjëra nga më të ndryshmet mund të ndodhin. A do të qëndrojë mëndja juaj pa u lëkundur? Supozojmë që ju jeni shumë i dhënë pas një fëmije apo prindërve tuaj dhe ata kanë vdekur. Ata ju thonë që të bëni disa gjëra..., gjëra këto që ju nuk duhet t'i bëni. Nëqoftëse ju i bëni, do të jetë keq. Është tepër e vështirë të jesh praktikues. Është thënë që Buddhizmi është në kaos. Ka marrë gjëra madje dhe nga Konfucionizmi si respektin për prindërit dhe dashurinë për fëmijët. Buddhizmi nuk ka pasur përmbajtje të tillë. Çfarë do të thotë kjo? Përderisa jeta juaj e vërtetë është Shpirti Kryesor, ajo që i dha jetë Shpirtit Kryesor është nëna juaj e vërtetë. Gjatë ringjalljes ju keni patur nëna që kanë qenë njerëzorë dhe jonjerëzorë dhe aq shumë saqë nuk numërohen. Gjithashtu nuk numërohen edhe djemtë apo vajzat që ju keni patur gjatë jetëve të tjera. Kush është nëna juaj? Kush është djali apo vajza juaj? Asnjëri nuk e di pasi personi vdes. Ju përsëri duhet të paguani për atë që i detyroheni të tjerëve. Njerëzit jetojnë në mjergull dhe nuk mund të heqin dorë nga këto gjëra. Fëmijët e dikujt kanë vdekur dhe ata nuk i heqin nga mëndja djemtë apo vajzat e tyre dhe pretendojnë se ata ishin kaq të mire. Tjetri thotë se sa njeri i mirë është nëna e tij por më vonë edhe ajo vdes. Ky person dëshpërohet kaq shumë saqë don ti shkojë nga mbrapa. Pse nuk mendoni pak? A nuk janë ata këtu për t'ju munduar ? Ata përdorin këtë formë për ta bërë të pamundur që të jetoni rehat.

Mbase njerëzit e zakonshëm nuk e kuptojnë këtë: nëse ju jeni i dhënë pas këtyre gjërave, ju nuk mund të praktikoni kultivim aspak. Prandaj Buddhizmi nuk ka përmbajtje të tillë. Nëqoftëse ju doni të praktikoni kultivim, ju duhet të braktisni sentimentalizmin njerëzor. Natyrisht duke qënë se praktikojmë kultivim në shoqërinë njerëzore, ne duhet të respektojmë prindërit dhe të edukojmë fëmijët. Në të gjitha rrethanat, ne duhet të jemi të mirë dhe të sjellshëm me të tjerët, jo më pastaj me anëtarët e familjes. Ne duhet t'i trajtojmë të gjithë njësoj. Ne duhet të jemi të mirë me prindërit dhe fëmijët dhe ti trajtojmë të tjerët me respekt. Një zemër e tillë nuk është egoiste por është një zemër dashamirëse dhe mëshiruese. Sentimentalizmi është diçka e njerëzve të zakonshëm dhe ata jetojnë veç për të.

Shumë njerëz nuk sillen mirë dhe kjo u sjell vështirësi në praktikën kultivuese. Një person mund të pretendojë se një Buddha i ka thënë atij diçka. Veç nëqoftëse ju kanoset ndonjë rrezik për jetën dhe ju thuhet se si ta eliminoni, të gjithë ata që ju thonë se do të keni një problem sot apo që diçka do t'ju ndodhë së shpejti dhe se si t'i evitoni ato, ata që ju tregojnë çmimin e parë të llotarisë dhe ju thonë ta provoni dhe ata që duan të merrni gjëra të mira nga shoqëria, janë djaj. Nëqoftëse ju gjithmonë doni t'ja hidhni të tjerëve dhe nuk e kaloni këtë test, ju nuk do të përmirësoheni. Nëqoftëse ju jetoni shumë mirë midis njerëzve si mund të praktikoni ju kultivim? Si mund të transformohet karma juaj? Si do të keni ju një mjedis për të përmirësuar karakterin dhe transformuar karmën? Secili duhet ta ngulisë këtë në mëndje. Një djall mund t'ju lavdërojë dhe t'ju thotë se niveli juaj është kaq i lartë, apo se çfarë Buddha apo Tao i madh ti je dhe se mendon që ti je i mrekullueshëm—ata janë të gjithë të rremë. Si një njeri që praktikon vërtet kultivim drejt niveleve të larta ju duhet të hiqni dorë nga veset e ndryshme. Kur të ndesheni me këto probleme, ju duhet të jeni vigjilent!

Gjatë praktikës kultivuese, Syri juaj Qiellor do të hapet. Me Syrin Qiellor të hapur një njeri do të ketë vështirësitë e veta në kultivim. Me Syrin Qiellor të mbyllur një njeri përsëri do të ketë vështirësi në kultivim. Në të dyja rastet nuk do të jetë e lehtë të praktikosh kultivim. Pasi t'ju hapet Syri Qiellor, mesazhe të ndryshme do t'ju ndërhyjnë dhe do të jetë vërtetë e vështirë për ju që të silleni mirë. Në dimensionet e tjera çdo gjë është vezulluese për sytë, shumë e bukur dhe e mrekullueshme, të gjitha këto mund t'ju ndjellin në zemrën. Me t'ju prekur në zemër, ju mund të keni ndërhyrje dhe gongu juaj do të prishet—kështu ndodh zakonisht. Prandaj, kur një person që ka ndërhyrje demonike nga mëndja e vet nuk sillet ashtu siç duhet, një situatë e tillë do të ndodhë. Për shembull, sapo një njeri të krijojë një mendim të keq, do të jetë shumë e rrezikshme. Një ditë Syri i tij Qiellor hapet dhe ai i sheh gjërat shumë qartë. Ai mendon: “Në këtë grup praktikuesish vetëm Syri im Qiellor është hapur shumë mirë. Mbase unë jam një njeri i veçantë? Unë mund të mësoj Falun Dafën e Mësuesit Li dhe e kam mësuar atë kaq mirë, më mirë se të gjithë të tjerët. Ndoshta unë nuk jam një

njeri i zakonshëm.” Ky mendim nuk është i drejtë. Ai do të pyesë veten: “Ndoshta unë jam një Buddha. Pa t’i hedh një sy vetes.” Kur ai shikon veten, atij do t’i duket vetja me të vërtetë Buddhë. Pse ndodh kjo? Arsyeja është se gjithçka brënda fushës së tij dimensionale rreth trupit të tij do të transformohet në përputhje me mendimet e tij, e cila quhet “transformim që ndjek mendimin”.

Çdo gjë që reflektohet nga universi do të transformohet në përputhje me mendimet e personit sepse çdo gjë brënda fushës së tij dimensionale është nën urdhërat e tij. Po kështu janë dhe imazhet e reflektuara të cilat janë gjithashtu diçka materiale. Ky njeri mendon: “Ndoshta unë jam një Buddha dhe mbase dhe rrobat që kam veshur janë si të Buddhës.” Pastaj ai do t’i hedhë një sy vetes dhe do të shohë që ajo që ka veshur është me të vërtetë një veshje Buddhë. “Uau, unë me të vërtetë qënkam një Buddha”. Ai do të gëzohet shumë. “Ndoshta nuk jam një Buddha i vogël.” Me një shikim tjetër vetes dhe atij do t’i duket vetja një Buddha i madh. “Ndoshta unë jam më i madh se Li Hongzhi!” Ai do ti hedhë përsëri një sy vetes: “Uau, unë jam me të vërtetë më i madh se Li Hongzhi.” Disa njerëz e dëgjojnë këtë dhe me veshë. Një djall do t’i ndërhyjë dhe thotë: “Ti je më i madh se Li Hongzhi. Shumë më i madh se Li Hongzhi.” Ai do ta besojë këtë. A keni menduar se si do të praktikoni kultivim në të ardhmen? A keni praktikuar ju ndonjëherë kultivim? Kush ju mësoi juve të kultivoni? Edhe kur një Buddha i vërtetë vjen këtu me mission, edhe atij i duhet të praktikojë kultivim nga fillimi. Atij nuk do t’i jepet gongu i tij original dhe vetëm se ai do të përparojë më shpejt në praktikën kultivuese. Kështu, me të ndodhur një gjë e tillë, do të jetë e vështirë për personin që të ndihmojë veten të dalë nga kjo; ai do të krijojë këtë dëshirë menjëherë. Pasi të krijohet një dëshirë e tillë ai do të guxojë të thotë gjithçka: “Unë jam një Buddha. Ju nuk keni pse të mësoni nga të tjerët. Unë jam Buddha kështu unë do t’ju them se çfarë duhet të bëni.” Ai do të fillojë të bëjë gjëra të tilla.

A nuk kemi një të tillë në Changchun? Në fillim ai ishte shumë i mirë. Më pas, ai filloi të bënte gjëra të tilla. Ai mendoi se ishte një Buddha. Në fund ai e konsideroi veten më të madh se çdo njeri tjetër. Kjo ndodhi sepse ai nuk u soll ashtu siç duhet dhe prej dëshirës që krijoi. Pse ndodh një fenomen i tillë? Buddhizmi mëson se pavarësisht nga çfarë shikoni ju duhet të mos i vini rëndësi, sepse është e gjitha një vegim demonik dhe se ju duhet vetëm të vazhdoni të përparoni në kultivim duke medituar. Pse nuk ju lejon që t’i shihni ato dhe të jepen pas tyre? Të paralajmëron ndaj këtij problemi. Në praktikën kultivuese në Buddhizëm nuk ka ndonjë metodë kultivuese përforcuese dhe as udhëzime në shkrimet e saj se si të mënjanojë këto gjëra. Sakyamuni nuk mësoi një Darmë të tillë në atë kohë. Me qëllim që të mënjanojë problemin e ndërhyrjes demonike nga vetë mendja e njeriut apo transformin që ndjek mendimin, ai i quajti të gjitha skenat që shihen gjatë praktikës kultivuese si vegime demonike. Kështu që sapo krijohet një ves, ai të çon në vegime demonike dhe është shumë e vështirë për dikë që të çlirohet prej tyre. Nëqoftëse nuk trajtohet siç duhet, personi do të rrënohet dhe ndjekë rrugën e djallit. Për shkak se ai e quajti veten Buddhë, ai e ka demonizuar tashmë veten. Në fund, ai mund të zotërohet nga shpirtat e këqinj apo të kalojë gjëra të tjera dhe të rrënohet përfundimisht. Zemra e tij do të kthehet gjithashtu në të pamoralshme dhe ai do të rrënohet plotësisht. Ka plot njerëz të tillë. Edhe në këtë klasë, ka njerëz që kanë mendim të lartë për veten dhe flasin me mëndjemadhësi. Është tabu edhe në Buddhizëm për të ditur se kush je ti në të vërtetë. Ajo të cilën sapo e diskutova, është një formë tjetër e ndërhyrjes demonike e cila quhet “ndërhyrje demonike nga vetë mendja e njeriut” apo “transformim që ndjek mendimin”. Ka disa praktikues të tillë në Beijing si dhe në disa krahina të tjera. Për më tepër, ata kanë shkaktuar ndërhyrje shumë serioze tek praktikuesit e tjerë.

Dikush më pyeti: “Mësues, pse nuk e eliminoni ju këtë problem?” Pa mendoni të gjithë: Nëse ne heqim të gjitha pengesat në rrugën tuaj të praktikës kultivuese, si do të praktikoni ju kultivim? Duke qenë nën këto rrethana të ndërhyrjes demonike mundet ju të tregoni nëse mund të vazhdoni kultivimin tuaj, të arrini lartësimin shpirtëror në Tao, të mos ndikoheni nga ndërhyrjet dhe të jeni të vendosur në këtë shkollë praktike. Valët e mëdha e sitin rërën, e tillë është dhe praktika kultivuese. Ajo që mbetet në fund do të jetë ar i pastër. Pa ndërhyrjeje të formave të tilla, unë do të thoja se do të

ishite shumë e lehtë për të praktikuar kultivim. Për mendimin tim, kultivimi juaj është shumë i lehtë. Qëniet e Shumëlartësuar të niveleve të larta mund të mendojnë se kjo nuk është e drejte: “Çfarë po bën? Kështu do t’i shpëtosh njerëzit? Nuk ka pengesa në rrugën e kultivimit të tyre dhe të gjithë mund t’ia dalin mbanë në kultivim. A është ky kultivim? Ndërsa dikush përparon në kultivim, ai e ka me të lehtë dhe nuk ka ndërhyrje. Si mund të lejohet kjo?” Kështu është puna dhe unë e kam menduar këtë gjithashtu. Në fillim, u mora unë me shumë nga këta djaj. Nëqoftëse unë e bëj këtë vazhdimisht, edhe mua nuk më duket e drejtë kjo. Mua gjithashtu më thanë: “Ju ja keni bërë kultivimin atyre shumë të lehtë. Njerëzit kanë shumë pak vështirësi për të kaluar vetë. Ata kanë vetëm shumë pak probleme midis tyre. Ata kanë shumë vese që akoma nuk i kanë braktisur! Çështja është nëse ata do të arrijnë të kuptojnë vetë Dafën tënde kur janë në mes të vështirësive dhe problemeve.” Kjo ka të bëjë me këtë çështje kështu që do të ketë ndërhyrje dhe teste. Sapo thashë që kjo është një formë e ndërhyrjes demonike. Është shumë e vështirë që me të vërtetë të shpëtosh një njeri, e megjithatë kaq e lehtë për ta rrënuar. Sapo mëndja juaj nuk është e drejtë, ju do të rrënoheni menjëherë.

Ndërgjegjia Kryesore Duhet të Mbizotërojë

Për shkak se njerëzit kanë bërë të këqija në jetë të ndryshme, kjo ka rezultuar në fatkeqësi për njerëzit dhe në pengesa karmike për praktikuesit. Prandaj, do të ketë lindje, plakje, sëmundje dhe vdekje. Këto janë karmë e zakonshme. Ekziston edhe një karmë tjetër e fuqishme që ndikon shumë tek praktikuesit—kjo quhet karmë mendimesh. Njerëzve u duhet të mendojnë gjatë jetës së tyre. Ngaqë njerëzit janë në mjergull në mes të njerëzve të zakonshëm, ata do të zhvillojnë mendime për famë, përfitime, dëshira, zëmërim etj. Gradualisht këto mendime kthehen në karmë të fuqishme mendimesh. Përderisa çdo gjë në dimensionet e tjera ka jetë edhe karma ka jetë. Kur dikush fillon të praktikojë kultivim në një rrugë të drejtë, ai duhet të eliminojë karmën e vet. Të eliminosh karmën do të thotë ta zhdukësh dhe ta transformosh atë. Natyrisht, karma do të rezistojë prandaj ju do të keni vështirësi dhe pengesa. Por karma e mendimeve mund t’i ndërhyjë drejtëpërdrejt mëndjes suaj. Kështu, mëndja e personit mbart mallkime për Mësuesin dhe Dafën dhe ai mund të ketë mendime të liga apo fjalë fyese. Si pasojë disa praktikues nuk dinë se çfarë po ndodh dhe mendojnë se këto mendime u vijnë nga mëndja e tyre. Disa njerëz gjithashtu mendojnë se ato ju vijnë nga kafshë apo shpirtra zotërues, por nuk është ashtu. Në fakt, ato vijnë nga reflektimi i karmës së mendimeve në mëndjen e njeriut. Disa njerëz nuk kanë Ndërgjegje Kryesore të fortë dhe pajtohen me karmën e mendimeve për të kryer gjëra të këqija. Njerëz të tillë do të rrënohen dhe do të bien poshtë nga niveli. Sidoqoftë, shumica e njerëzve mund t’i heqin ato dhe t’i rezistojnë atyre me mendime shumë të vendosura nga vetja (Ndërgjegje Kryesore të fortë). Kjo tregon se ky person mund të shpëtohet dhe mund të dallojë të mirën nga e keqja. Me fjalë të tjera, ky person ka cilësi ndriçimi shpirtëror të mirë. Fasheni im do t’ju ndihmojë të eliminoni shumicën e karmës së mendimeve. Kjo situatë ndodh shpesh. Me t’u shfaqur, një person do të vihet në provë për të parë nëse ai do të mund t’i mundë mendime të tilla të këqija vetë. Nëqoftëse një njeri është i vendosur, karma mund të eliminohet.

Mëndja Juaj Duhet të Jetë e Pastër

Çfarë do të thotë të mos kesh mëndje të pastër? Kjo i referohet paaftësisë së një personi për ta trajtuar veten gjithmonë si praktikues. Një praktikues do të ndeshet me vështirësi në praktikën kultivuese. Kur një vështirësi shfaqet, ajo mund të manifestohet si një konflikt ndërpersonal. Do të ketë inskenime dhe gjëra të tjera si këto, të cilat do të ndikojnë drejtëpërdrejt në karakterin tuaj. Do të ketë shumë raste të tilla. Çfarë gjërash të tjera do të ndeshni ju? Trupat tuaj papritur mund të mos ndjehen

mirë. Kjo ndodh për shkak se shpagimi i karmës manifestohet në mënyra të ndryshme. Në një periudhë kohe të caktuar, do t'ju bëjmë të mos jeni në gjëndje të dalloni qartë nëse diçka është e vërtetë, nëse gongu juaj ekziston, nëse ju mund të praktikoni dhe t'ja dilni mbanë apo nëse Buddhat ekzistojnë me të vërtetë. Në të ardhmen, këto situata do të shfaqen përsëri që t'ju krijojnë juve përshtypje të rreme dhe t'ju bëjnë të mendoni se ato nuk ekzistojnë dhe se janë të gjitha të rreme—kjo është për të parë nëse ju jeni të vendosur. Ju thoni se jeni të vendosur dhe të sigurtë. Me këtë vendosmëri, nëse me të vërtetë qëndroni të palëkundur, natyrisht ju do të veproni siç duhet sepse edhe karakteri juaj do të jetë përmirësuar. Por ju akoma nuk jeni aq të vendosur në këtë kohë. Nëqoftëse ja u japim këtë problem menjëherë, ju nuk do ta kuptoni atë aspak dhe as që do të jeni të aftë për të praktikuar kultivim. Vështirësitë mund të jenë nga më të ndryshmet.

Gjatë praktikës kultivuese një individ duhet të praktikojë në këtë mënyrë që të ngjitet në nivele të larta. Kështu sapo disa prej jush nuk ndjehen mirë fizikisht, ata do të mendojnë se janë të sëmurë. Ju nuk arritët ta trajtonit veten si praktikues në të gjitha rastet, sepse kur diçka e tillë ju ndodh, ju e konsideroni atë si sëmundje. Pse dalin kaq shumë probleme? Më lejoni t'ju them se një pjesë shumë e madhe e vështirësive është eliminuar për ju dhe ato që kanë mbetur tashmë janë tepër të vogla. Po të mos ishin eliminuar ju mund të kishit vdekur në vend po t'ju kishte dalë ky problem. Ndoshta ju nuk do të ishit në gjëndje të çoheshit më kurrë nga shtrati. Kur t'ju dalë një vështirësi sado e vogël, ju nuk do të ndjeheni rehat. E si mund të jetë e rehatshme? Për shembull, kur unë dhashë mësim në Changchun ishte një person me cilësi të lindur shumë të mirë i cili me të vërtetë kishte prespektivë të mirë. Ai mu duk shumë i mirë dhe unë ia shtova pak vështirësitë kështu që ai ta hiqte karmën shpejt dhe të lartësohej shpirtërisht—unë po e përgatisja në këtë mënyrë. Papritur një ditë u duk sikur ai pësoi trombozë celebrale dhe ra në tokë. Atij ju duk sikur nuk mund të lëvizte dhe sikur gjymtyrët i ishin paralizuar. Atë e dërguan urgjentisht në spital për ta shpëtuar. Më vonë ai mundi të ecë përsëri. Pa mendojeni të gjithë: Me trombozë celebrale, si ka mundësi që një njeri të ecë dhe të lëvizë të katër gjymtyrët kaq shpejt? Në vend që ta falënderonte, ai fajësoi Falun Dafën për atë që ndodhi. Ai nuk mendoi se si mundi ta merrte veten kaq shpejt pasi pësoi trombozë celebrale. Po të mos kishte praktikuar Falun Dafën në atë kohë, ai mund të kishte vdekur në vend. Ndoshta mund të mbetej i paralizuar për gjithë jetën dhe me të vërtetë të kishte pësuar trombozë celebrale.

Kjo tregon se sa e vështirë është të shpëtosh një njeri. Kaq shumë u bë për të dhe përsëri ai nuk e kuptoi; përkundrazi ai tha gjëra të tilla. Disa praktikues veteranë thonë: “Mësues, pse kam kaq siklet në të gjithë trupin? Unë shkoj gjithmonë në spital dhe bëj gjilpëra por nuk më bëjnë efekt. Marrja e mjekimeve gjithashtu nuk ndihmon.” Si nuk u erdhi zor të ma thoshin këtë mua! Sigurisht që nuk do të bëjnë gjë. Ato nuk janë sëmundje. Si mund të bëjnë efekt? Ju mund të shkoni dhe të bëni analiza mjekësore. Ju nuk keni asgjë, vetëm se nuk ndjeheni rehat. Ne kemi një praktikues i cili theu disa gjilpëra në spital. Më në fund ilaçi u derdh dhe gjilpëra prapëprapë nuk hynte. Ai e kuptoi: “Oh, unë jam praktikues dhe nuk duhet të bëj gjilpëra.” Ai e kuptoi se nuk duhet të bënte inxheksione. Prandaj, sa herë që ju ndesheni me vështirësi, kini kujdes që t'i kushtoni rëndësi kësaj çështjeje. Disa njerëz mendojnë se unë nuk i lejoj ata që të shkojnë në spital, kështu që ata thonë: “Nëse nuk më lejon të shkoj në spital, atëherë unë do të shkoj tek një mjeshtër qigongu.” Ata akoma e konsiderojnë atë si sëmundje dhe duan të shkojnë tek një mjeshtër qigongu. Ku mund të gjejnë ata një mjeshtër qigongu të vërtetë? Nëse gjejnë një të rremë, ata do të rrënohen menjëherë.

Ne kemi thënë: “Si mund të dalloni një mjeshtër qigongu të vërtetë nga një i rremë?” Shumë mjeshtër qigongu janë të vetëshpallur. Unë i jam nënshtruar eksperimenteve dhe kam vlerësimet nga institutet shkencore që i bëjnë ato. Shumë mjeshtër qigongu janë të rremë dhe të vetëshpallur. Ka shumë prej tyre që gënjejnë dhe mashtrojnë njerëzit. Një mjeshtër qigongu i tillë mund të shërojë sëmundje. Pse mund ta bëjë ai atë? Ai është i zotëruar nga shpirtrat apo kafshët pa të cilët ai nuk do të ishte i zoti të mashtronte njerëzit! Një shpirt i keq apo një kafshë zotëruese gjithashtu mund të çlirojë energji dhe të arrijë të kurojë sëmundjet. Duke qenë një formë energjie, ajo mund të frenojë njerëzit

shumë kollaj. Por unë e kam thënë “Çfarë do t’ju japë ai shpirt i keq apo ajo kafshë zotëruese kur kuron sëmundjen tuaj?” Në nivelin më mikroskopik, ajo që ju jepet ka imazhin e shpirtit apo kafshës zotëruese. Çfarë do të bëni ju po t’ju transmetohet juve? Ekziston një thënie: “Është më e lehtë ta ftosh një shenjtor sesa ta largosh atë”³ Ne nuk kemi pse shqetësohemi me njerëzit e zakonshëm, pasi ata veç duan të jenë njerëz të zakonshëm dhe kërkojnë lehtësim të përkohshëm. Ndërsa ju jeni praktikues. A nuk doni ju të pastroni vazhdimisht trupin tuaj? Nëse ajo ju ngjitet në trup, kur do të mund ta hiqni qafe ju atë? Për më tepër ajo ka një farë sasive energjie. Disa njerëz do të pyesin: “Pse e lejon Falun një gjë të tillë të vijë? A nuk kemi ne Fashen e Mësuesit që na mbron?” Ekziston një parim në universin tonë: Asnjënjëri nuk do të ndërhyjë nëse ju e kërkonit diçka vetë. Për aq kohë sa ju e kërkonit atë, askush nuk do të ndërhyjë. Fashen im do t’ju ndalojë dhe do ju japë shenja. Nëqoftëse sheh se ju nuk ndryshoni, ai nuk do të kujdeset më për ju. A mund të detyrosh një njeri të praktikojë kultivim? Ju nuk jeni të detyruar të praktikoni kultivim. Varet nga ju nëse doni me të vërtetë të përparoni. Askush nuk mund të bëjë gjë për ju nëqoftëse ju nuk doni të përmirësoni veten. Ne ju kemi mësuar parimet dhe Ligjin. Kujt do t’ja hidhni fajin nëqoftëse ju akoma nuk doni të përmirësoni veten? Përsa i përket asaj që ju doni, si Falun ashtu dhe Fasheni im nuk do të ndërhyjë—kjo është e sigurt. Disa njerëz mandje kanë shkuar edhe në klasa të tjera qigongu dhe pasi u kthyen në shtëpi nuk u ndjenë mirë. Natyrisht që kështu do të ndodhë. Pse Fasheni im nuk ju mbrojt? Për çfarë shkua ju atje? Duke shkuar për të dëgjuar, a nuk do të thotë se kërkonit diçka? A mund të futej në trupin tuaj nëqoftëse ju nuk e morët atë me veshë? Disa njerëz e kanë deformuar Falunin e tyre. Më lejoni t’ju them se ky Falun është më i çmuar se jeta juaj. Është një jetë më e lartë që nuk mund ta shkatërrosh sipas dëshirës. Tani ka shumë mjeshtër qigongu të rremë dhe disa prej tyre janë mjaft të mirënjohur. Unë u kam thënë administratorëve të Shoqatës së Kërkimeve Shkencore të Qigongut në Kinë që, në kohët e lashta oborri mbretëror ishte infektuar njëherë nga Da Ji⁴. Ajo dhelpër bëri shumë gjëra të liga por jo aq sa po bëjnë mjeshtrit e rremë qigong sot që po i sjellin dëm gjithë vendit. Sa njerëz kanë rënë viktimë të tyre? Nga ana e jashtme duket si një gjë e mirë, por sa njerëz mbartin në trupat e tyre gjëra të tilla? Nëqoftëse ata jua japin juve, ju do e merrnit atë—ata janë tepër të përhapur. Prandaj, është e vështirë për një njeri të dallojë gjërat nga paraqitja.

Disa njerëz mund të mendojnë: “Pasi ndoqa këtë seminar qigongu dhe dëgjova atë që tha Li Hongzhi sot, kam kuptuar sa i madh dhe i thellë është qigongu! Nëqoftëse ka seminare të tjera qigongu do të shkoj të marr pjesë.” Unë do të thoja që ju absolutisht nuk duhet të shkoni atje. Nëqoftëse ju dëgjoni çfarë thuhet atje, gjëra të këqija do t’ju hyjnë në veshë. Është shumë e vështirë të shpëtosh një njeri dhe të ndryshosh mënyrën e tij të menduarit. Të pastrosh trupin e një njeriu është gjithashtu e vështirë. Ka kaq shumë mjeshtër të rremë qigongu. Përsa i përket madje dhe një mjeshtri të vërtetë qigongu nga një praktikë e vërtetë, a është ai vetë me të vërtetë i pastër? Disa kafshë janë shumë të këqija dhe megjithëse ato nuk mund t’i ngjiten atij në trup, prapsepapë ai nuk mundet t’i përzërë ato. Ky person dhe veçanërisht nxënësit e tij, nuk e kanë aftësinë për të përballuar këto gjëra në një shkallë të madhe. Kur ai jep energji, bashkë me të çlirohen dhe gjëra të tjera të papastra. Megjithëse ai vetë mund të jetë shumë i ndershëm, nxënësit e tij nuk janë të virtytshëm dhe janë të zotëruar nga shpirta apo kafshë të ndryshme—ka nga të gjitha llojet e tyre.

Nëqoftëse ju me të vërtetë doni të praktikoni kultivim në Falun Dafa, ju nuk duhet të shkoni dhe të dëgjoni ata. Natyrisht, nëqoftëse ju nuk doni të praktikoni kultivim në Falun Dafa dhe doni të praktikoni çdo gjë tjetër, shkoni dhe bëni ashtu; Unë nuk do t’ju ndaloj pasi ju nuk jeni dishepull i Falun Dafës. Po t’ju dalin probleme, mos u ankoni se ju erdhën nga praktika e Falun Dafës. Vetëm nëqoftëse ju ndiqni standartin e karakterit dhe praktikoni kultivim në përputhje me Ligjin e Lartë, jeni

³ “Është më e lehtë ta ftosh një shenjtor sesa ta largosh atë”—një shprehje kineze që përdoret për të përshkruar një situatë në të cilën është shumë e lehtë të biesh brenda por e vështirë për të dalë.

⁴ Da Ji—një konkubinë e ligë e perandorit të fundit në Dinastinë Shang (1765 p.e.r.-1122 p.e.r.). Ajo mendohet se ka qenë zotëruar nga një shpirt dhelpre dhe se shkaktoi rënien e Dinastisë Shang.

ju një praktikues i vërtetë i Falun Dafës. Dikush më pyeti: “A mund të shoqërohem me praktikues të praktikave të tjera qigong?” Më lejoni t’ju them se ata praktikojnë vetëm qigong ndërsa ju po praktikoni kultivim në Ligjin e Lartë. Pas mbarimit të kësaj klase, ju do t’i lini ata shumë prapa përse i përket niveleve. Ky Falun është krijuar nëpërmjet praktikës kultivuese të shumë brezave dhe ka fuqi madhore. Sigurisht, kur ju jeni në kontakt me ta, nuk prish punë nëqoftëse nuk jepni apo merrni gjë prej tyre dhe thjesht jeni shokë. Nëqoftëse ata individë mbartin diçka në trupin e tyre, do të jetë shumë keq dhe është më mirë të mos keni kontakt fare me ta. Përse i përket një çifti, unë mendoj se nuk prish shumë punë nëse bashkëshorti juaj ndjek një praktikë tjetër qigongu. Por ka një gjë: Përderisa ju praktikoni një rrugë të drejtë, praktika juaj do t’i sjellë përfitime të tjerëve. Nëqoftëse bashkëshorti juaj ndjek një praktikë të keqe, ai ose ajo mund të mbartë gjëra të këqija në trup. Me qëllim që t’ju sigurojmë juve, ai ose ajo gjithashtu do të pastrohet. Çdo gjë do të pastrohet për ju në dimensionet e tjera. Edhe ambjenti i shtëpisë suaj do të pastrohet. Nëqoftëse ambjenti juaj nuk do të pastrohej dhe ju keni gjëra nga më të ndryshmet që ju ndërhyjnë, si mund të praktikoni ju kultivim?

Megjithatë ekziston një situatë në të cilën Fasheni im nuk do t’ju ndihmojë në pastrimin e gjërave. Unë kam një nxënës i cili një ditë pa Fashen tim t’i vinte në shtëpi. Ai ishte shumë i emocionuar: “Fashen i Mësuesit është këtu. Mësues, hyr brënda të lutem.” Fasheni im tha: “Dhoma jote është tepër rrëmujë dhe ka shumë gjëra”. Pastaj u largua. Zakonisht, kur ka shumë shpirtra të këqinj në dimensione të tjera, Fasheni im do t’i pastrojë ato për ju. Ndërsa dhoma e tij ishte plot me libra të ndryshëm të këqinj qigongu. Ai më në fund e kuptoi dhe e pastroi atë duke i djegur apo shitur librat. Fasheni im u kthye pastaj. Këtë ma tha ai praktikuesi.

Ka gjithashtu nga ata që shkojnë të shohin fallxhorë. Dikush më pyeti: “Mësues, unë po praktikoj Falun Dafën tani por jam gjithashtu shumë i interesuar në *Librin e Ndryshimeve* apo në parashikimin e fatit. A mund t’i përdor ato akoma?” Po ja u shpjegoj kështu: Nëqoftëse ju mbartni një sasi të konsiderueshme energjie, çfarëdo gjë që thoni, do të ketë efekt. Nëse diçka nuk është ashtu por ju i keni thënë dikujt se është ashtu, ju mund të keni bërë një gjë të keqe. Një njeri i zakonshëm është shumë i dobët. Gjërat në jetën e tij janë të paqëndrueshme dhe mund të ndryshojnë. Nëqoftëse ju pa gajle i thoni atij diçka, ajo fatkeqësi mund të ndodhë me të vërtetë. Nëse ky person ka shumë karmë për të shlyer dhe ju vazhdoni t’i thoni se ai do të ketë mbarësi, si mund të lejohet një gjë e tillë kur ai nuk do të shlyejë karmën? A nuk po i bëni dëm ju atij? Disa njerëz nuk mund të heqin dorë nga këto gjëra dhe janë kaq të dhënë pas tyre sikur e kanë talent. A nuk është ky një ves? Përveç kësaj, edhe sikur ju ta dini të vërtetën, si praktikues ju duhet të ruani karakterin tuaj dhe jo t’i zbuloni shkarazi një sekret qiellor një njeriu të zakonshëm. Ky është parimi. Pavarësisht sesi një njeri e përdor *Librin e Ndryshimeve* për të parashikuar, disa nga gjërat e tij nuk janë më të vërteta. Parashikimi i një gjëje apo një tjetre me disa që janë të vërteta dhe disa që janë të rreme—kjo lejohet të ekzistojë në shoqërinë njerëzore. Përderisa ju jeni një njeri me gong të vërtetë, unë do të thoja që ju si praktikues duhet të ndiqni një standart me të lartë. Prapëseprapë disa praktikues do të kërkojnë njerëz të tjerë për t’i treguar atyre fatin dhe i pyesin ata: “A do të ma shohësh pak fatin për të parë si më shkojnë punët? Si po shkon praktika ime kultivuese? A do të kem ndonjë vështirësi?” Ata do të gjejnë të tjerë për t’ju parashikuar këto gjëra. Nëqoftëse një vështirësi ju tregohet, si do ta përmirësoni ju veten? E tërë jeta e një praktikuesi është ndryshuar. Leximi i dorës, leximi i fytyrës, të dhënat nga lindja dhe të gjitha mesazhet në trupin e tij apo të saj janë tashmë të ndryshme dhe janë ndryshuar. Nëqoftëse ju shkoni tek një fallxhore, ju do ta besoni atë. Ndryshe pse do të shkoni? Ato që mund të thotë ajo janë disa gjëra të përcipta nga e kaluara juaj. Sidoqoftë thelbi i tyre tashmë ka ndryshuar. Pra, pa mendojeni të gjithë: Nëqoftëse ju shkoni tek një fallxhore, a nuk do ta dëgjoni dhe besoni ju atë? Atëhere, a nuk krijon kjo një peshë psikologjike për ju? A nuk është ky një ves nëqoftëse ju i sillni vetes pengesa duke menduar për të? Pra si mund të hiqet ky ves? A nuk ia imponuat ju vetes një vështirësi tjetër? A nuk do t’ju duhet të vuani më shumë që të hiqni këtë ves? Çdo sprovë apo çdo vështirësi është e lidhur me progresin apo me regresin në kultivim. Është e vështirë kështu siç është, e ju shkoni e i

shtoni vetes një vështirësi tjetër. Si do ta kapërceni ju atë? Ju mund të ndesheni me vështirësi apo probleme për pasojë të saj. Rruga juaj e ndryshuar e jetës nuk lejohet të shikohet nga të tjerët. Nëqoftëse shikohet nga të tjerët ose nëse ju thuhet se kur do të keni një sprovë, atëherë si do të praktikoni ju kultivim? Prandaj, nuk lejohet që të shikohet aspak. Askush nga shkolla të tjera praktike gjithashtu nuk lejohet ta shohë. As edhe dishepujt nga e njëjta shkollë praktike nuk lejohen ta shohin. Askush nuk mund t'i parashikojë gjërat me saktësi sepse një jetë e tillë është ndryshuar dhe është një jetë për praktikë kultivuese.

Dikush më pyeti nëse mund të lexonte libra të tjerë fetarë dhe libra qigongu. Ne kemi thënë se librat fetarë, veçanërisht ato Buddhiste, u mësojnë njerëzve si të kultivojnë karakterin e tyre. Ne jemi gjithashtu të Shkollës së Buddhës, pra nuk duhet të ketë ndonjë problem. Por duhet bërë e qartë një gjë: Shumë gjëra në shkrimet e shenjta janë përkthyer keq gjatë procesit të përkthimit. Për më tepër shumë interpretime të shkrimeve të shenjta janë bërë nga prespektiva të niveleve të ndryshme dhe përkufizimet janë bërë sipas rastit. Kjo do të thotë të dëmtosh Dharmën. Ata njerëz që interpretuan shkrimet sipas rastit ishin tepër larg nga niveli i Buddhëve; ata nuk e kuptonin përmbajtjen e vërtetë të shkrimeve të shenjta. Kështu, ata gjithashtu mund të kishin të kuptuar të ndryshëm të çështjeve. Nuk do të jetë e lehtë për ju t'i kuptoni ato thellë dhe ju nuk do të jeni të aftë për t'i kuptuar ato vetë. Por nëse ju thoni: "Unë thjesht jam i interesuar në shkrimet e shenjta," dhe ju gjithmonë i lexoni ato, ju do të praktikoni në atë shkollë praktike sepse shkrimet kanë ndërthurur gongun dhe Ligjin e asaj shkolle praktike. Kur ju i studjoni ato është njësoj sikur të praktikoni praktikën e asaj shkolle. Kjo ka të bëjë me këtë çështje. Nëqoftëse e studjoni thellë dhe ndiqni atë shkollë praktike, ju mund të keni pranuar atë shkollë në vend të shkollës sonë. Gjatë gjithë historisë, në praktikën kultivuese, secili i është kërkuar të mos ndërmarrë dy shkolla në të njëjtën kohë. Nëqoftëse ju doni me të vërtetë të praktikoni këtë shkollë, ju duhet të lexoni vetëm tekstet e kësaj shkolle.

Përsa i përket librave të qigongut, ju nuk duhet t'i lexoni ato nesë doni të praktikoni kultivim. Sidomos librat e qigongut që janë botuar kohët e fundit, ju nuk duhet t'i lexoni ato. E njëjta gjë duhet thënë për libra të tillë si *Kryevepra e Perandorit të Verdhtë të Alkimiisë së Brëndshme*, *Udhëzues për të Gjetur Naturën dhe Jetëgjatësinë*, apo *Kanuni Taoist*. Megjithëse ato nuk mbartin mesazhe të këqija, ato përmbajnë mesazhe nga nivele të ndryshme. Ato janë vetë mënyra praktike kultivuese. Sapo ju t'i lexoni ato, ato do t'ju japin diçka dhe do t'ju ndërhyjnë. Nëqoftëse ju gjeni një fjali që ju pëlqen, diçka do të vijë dhe do t'i shtohet gongut tuaj. Megjithëse nuk është diçka e keqe, si mund të praktikoni ju kultivim kur papritur ju jepet diçka tjetër? A nuk do të sjellë ajo probleme? Nëqoftëse ju shtoni një pjesë tjetër elektronike brënda një televizori, çfarë mendoni ju se do të ndodhë me të? Do të dalë jashtë përdorimit në çast. Ky është parimi. Për më tepër, shumë libra qigongu sot janë të rremë dhe mbartin një sërë mesazhesh. Ndërsa një praktikuesi ynë po kthente faqet e një libri qigongu, një gjarpër i madh doli nga libri. Natyrisht, unë nuk do të jaq hollësisë për këtë. Këto që sapo kam diskutuar janë disa probleme që dalin nga paaftësia e praktikuesve për t'u sjellë ashtu siç duhet, pra këto probleme shkaktohen nga një mëndje jo e mirë. Është me vlerë që t'i vemë këto në dukje në mënyrë që të tjerët të përfitojnë dhe të dinë çfarë të bëjnë dhe si t'i dallojnë ato, kështu që këto probleme të mos ndodhin në të ardhmen. Megjithëse nuk e theksova sa duhet këtë që sapo thashë, secili duhet t'i kushtojë vëmendje, sepse zakonisht dalin probleme mbi këtë çështje. Praktika kultivuese është jashtëzakonisht e vështirë dhe shumë serioze. Nëqoftëse ju tregoheni i pakujdesshëm për një çast, ju mund të pengoheni dhe rrënoheni menjëherë. Prandaj, mëndja juaj duhet të jetë e pastër.

Qigongu i Arteve Marziale

Përveç praktikës së kultivimit të brëndshëm, është edhe qigongu i arteve marziale. Ndërsa flas për qigongun e arteve marziale duhet të theksoj faktin që tashmë ka pretendime të shumë formave qigong në komunitetin e kultivuesve.

Tani kanë dalë disa lloje si të ashtuquajturit “qigong pikturë”, “qigong muzike”, “qigong kaligrafie” dhe “qigong vallëzimi”—ka nga të gjitha llojet. A janë ato të gjitha qigong? Mua më duken shumë të habitshme. Unë do të thoja që është njësoj sikur ta poshtërosh qigongun. Jo vetëm ta poshtërosh por thjesht ta shkatërrosh atë. Cila është baza e tyre teorike? Thuhet që kur një njeri është duke pikturuar, kënduar, vallëzuar apo shkruar, ai duhet të jetë të kllapi apo siç quhet gjëndje qigongu. A është ky qigong? Nuk duhet të kuptohet kështu. A nuk do të thotë kjo ta shkatërrosh qigongun? Qigong është studimi i gjërë dhe i thellë i kultivimit të trupit të njeriut. Si mund të quhet të qenurit në kllapi qigong? Atëhere çfarë do të quhet nëqoftëse ne shkojmë në banjo në gjëndje kllapie? A nuk do të thotë kjo ta shkatërrosh qigongun? Unë do ta quaja ta sabotosh qigongun. Dy vjet më parë në Ekspozitën Shëndetësore Orientale ishte e pranishme dhe i ashtuquajturit qigong kaligrafie. Çfarë është qigongu kaligrafisë? Unë shkova atje për t’i hedhur një sy dhe pashë një njeri që po shkruante. Kur shkruante ai i jepte çdo fjale qi me duar dhe qi-ja e çliruar ishte e tëra e zezë. Mëndja e tij ishte e preokupuar për para dhe famë. E si mund të kishte ai gong? As qi-ja e tij nuk mund të ishte e mirë. Shkrimet e tij ishin të varura atje me çmime të larta. Por ato u shiteshin vetëm të huajve. Unë do të thoja se kushdo që i blen ato do të ishte fatkeq. Si mund të jetë e mirë qi-ja e zezë? Fytyra e atij njeriu ishte e tëra e zezë. Ai ishte i fiksuar pas parave dhe mendonte vetëm për para—si mund të kishte ai gong? Megjithatë kartëvizita e këtij personi kishte një tufë titujsh, si psh. e ashtuquajtura Qigongu Ndërkombëtar i Kaligrafisë. Unë pyes se si mund të quhet një gjë e tillë qigong?

Pa mendojeni pak të gjithë: Nga tetëdhjetë në nëntëdhjetë përqind e njerëzve nga kjo klasë jo vetëm që do të shërohen nga sëmundjet por gjithashtu do të zhvillojnë gong—gong të vërtetë. Ajo që trupi juaj mbart tashmë është mbinatyrale. Nëqoftëse ju do të praktikoni kultivim vetëm, as edhe një jetë e tërë nuk do të mjaftonte për t’i zhvilluar ato nëpërmjet kultivimit. Edhe sikur një i ri të fillonte praktikën në këtë moment, në këtë jetë të tij, ai nuk do të mundte të zhvillonte atë që unë ju kam dhënë dhe për më tepër ai do të kishte përsëri nevojë të udhëhiqej nga një mjeshtër i vërtetë dhe i mirë. Na janë dashur neve shumë breza për të formuar këtë Falun dhe këto mekanizma. Këto gjëra instalohen në trupin tuaj të gjitha në të njëjtën kohë. Prandaj, unë po ju them që meqënëse i fituat lehtëshëm të mos i humbisni lehtëshëm. Ato janë jashtëzakonisht të çmueshme dhe nuk kanë çmim. Mbas kësaj klase, ajo që ju mbartni është gong i vërtetë, materie me energji të lartë. Kur të shkoni në shtëpi dhe të shkruani, pavarësisht se si është shkrimi juaj, ai mbart gong! Atëhere, a do t’i takonte secilit nga kjo klasë titulli “mjeshtër” dhe të bëheshit të gjithë mjeshtër qigongu në kaligrafi? Unë do të thoja se nuk duhet të kuptohet në këtë mënyrë. Si një person që mbart gong të vërtetë dhe energji, juve nuk ju duhet ta jepni atë me qëllim; ju do të leni energji në çdo gjë që prekni dhe ajo do të ndriçojë me shkëlqim.

Unë gjithashtu gjeta njëherë në një revistë një lajmërim mbi mbajtjen e një klase qigongu kaligrafie. E lexova shpejt që të shikoja se si do të mësohej. Aty thuhej se një njeri së pari duhet të rregullonte frymëmarrjen dhe të kontrollonte marrjen dhe nxjerrjen e frymës. Pastaj, ai duhet të ulesh nga pesëmbjëdhjetë deri në tridhjetë minuta duke përqëndruar mëndjen tek qi në dantian dhe të imagjinonte sikur ngrinte qi-në nga dantian tek parakrahu. Pastaj, ai duhet të merrte penelin dhe ta lyente me bojë të zezë. Pas kësaj, personi duhet të çonte qi-në në majën e penelit. Kur përqëndrimi i mëndjes arrinte atje ai mund të fillonte të shkruante. A nuk do të thotë kjo të mashtrosh njerëzit? Pra nëse një njeri mund të lëvizë qi-në diku, kjo konsiderohet qigong? Nëse është ashtu, përpara se ne të ulemi për të ngrënë, ne duhet të ulemi në meditim për ca kohë. Pastaj do të marrim shkopat e ngrënies dhe lëvizim qi-në në majën e shkopave që të hamë. Kjo do të quhej qigong ngrënie apo jo? Ajo që do

të hanim do të ishte gjithashtu energji. Thjesht po ilustroj këtë pikë. Unë e quaj këtë të sabotosh qigongun pasi ata e marrin qigongun diçka kaq të cekët. Prandaj njerëzit nuk duhet ta kuptojnë kështu këtë çështje.

Ndërsa përta i përket qigongut të arteve marziale, ai mund të konsiderohet një praktikë e veçantë qigongu. Pse? Sepse ai ka një trashëgimi prej disa mijëra vjetësh, një sistem të plotë teorish kultivimi dhe një sistem të plotë metodash kultivimi—ai mund të konsiderohet si një sistem i plotë. Pamvarësisht nga kjo, qigongu i arteve marziale mbetet diçka e nivelit më të ulët në praktikën e kultivimit të brendshëm. Qigongu i Rëndë është një formë grumbulli energjie që shërben vetëm për gotitje dhe gjuajtje. Po ju jap një shembull. Pas mësimit të një klase të Falun Dafës, një praktikues në Beijing nuk mund të prekte dot asgjë me duar. Kur ai shkoi për të blerë një karrocë për fëmijë, ai u çudit që karroca u thye kur ai e provoi me duar për fortësi. Kur u kthye në shtëpi dhe u ul në karrige, ai nuk mund ta prekte se po ta prekte karrigja do të thyhej. Ai më pyeti se çfarë po ndodhte. Unë nuk i thashë gjë sepse nuk doja që ai të krijonte një dëshirë. Unë vetëm i thashë që ishte e natyrshme dhe mos t'i kushtonte rëndësi përderisa ishte diçka e mirë. Nëqoftëse ajo aftësi supernormale përdorej mirë, një copë guri mund të thërmohej vetëm me një shtrëngim të dorës. A nuk është ky Qigongu i Rëndë? Sidoqoftë ai kurrë nuk kishte praktikuar Qigongun e Rëndë. Në praktikën e kultivimit të brendshëm, këto aftësi supernormale zakonisht mund të zhvillohen. Por, për shkak se është e vështirë të kontrollohet karakteri, një njeri zakonisht nuk lejohet t'i përdorë ato edhe sikur ato të jenë zhvilluar. Në veçanti, në nivelin e ulët të praktikës kultivuese, karakteri i personit nuk është përmirësuar. Prandaj, aftësitë supernormale që zhvillohen në nivelin e ulët nuk do të lejohen aspak. Me kalimin e kohës dhe rritjen e nivelit tuaj, këto gjëra nuk do të kenë ndonjë përdorim dhe nuk është nevoja që t'ju jepen.

Më konkretisht, si praktikohet qigongu i arteve marziale? Në praktikën e arteve marziale një njeri duhet të kontrollojë qi-në, por nuk është e lehtë që të kontrollosh qi-në në fillim. Megjithatë dikush do të donte të kontrollonte qi-në, ai mund të mos ishte i aftë për ta bërë këtë. Çfarë duhet të bëjë ai atëherë? Ai duhet të ushtrojë duart, kraharorin, shputat e këmbëve, këmbët, krahët dhe kokën. Si duhen ushtruar ato? Disa njerëz godasin pemë me duar apo pëllëmbët e duarve dhe disa godasin një gur me duart. Sa e dhimbshme duhet të jetë për kockat kur vijnë në kontakt me to sepse ato do të gjakosen edhe sikur të ushtrohet një sasi e vogël force! Përsëri qi nuk mund të kontrollohet. Çfarë duhet bërë? Personi do të fillojë të rrotullojë krahët që ta bëjë gjakun që të lëvizë mbrapsht, kështu krahët dhe duart e personit do të enjten. Ato do të enjten me të vërtetë. Pas kësaj, kur personi godet një gur, kockat do të mbrohen dhe nuk do të jenë direkt në kontakt me gurin. Kështu, ata nuk do të ndjejnë dhe aq shumë dhimbje. Ndërsa personi vazhdon të praktikojë, mjeshtri do ta mësojë atë. Me kalimin e kohës ai do të mësojë të kontrollojë qi-në. Megjithatë, aftësia për të kontrolluar qi-në nuk mjafton sepse në një ndeshje të vërtetë kundërshtari nuk do të presë për ju. Natyrisht kur një njeri mund të kontrollojë qi-në, ai është i aftë t'i rezistojë sulmeve dhe mund të mos ndjejë dhimbje kur goditet edhe me një shkop të trashë. Pasi e drejton qi-në tek krahët, ato do të enjten. Por fillimisht qi është gjëja më primitive dhe mund të transformohet në energji të lartë kur personi vazhdon të praktikojë. Kur transformohet në materie me energji të lartë, ajo gradualisht do të formojë një masë energjie me densitet të lartë dhe kjo masë energjie ka inteligjencë. Prandaj, ajo është edhe një masë aftësish supernormale apo siç quhet një lloj aftësie supernormale. Megjithatë, kjo aftësi supernormale është vetëm për goditje dhe mbrojtje nga goditjet. Nuk do të funksionojë për të shëruar sëmundje. Ngaqë kjo materie energjie të lartë ekziston në një dimension tjetër dhe nuk udhëton në dimensionin tonë, koha e saj është më e shpejtë sesa e jona. Kur ju goditni dikë, ju nuk keni nevojë të drejtoni qi-në apo të mendoni për të, sepse gongu do të ketë arritur përpara. Kur ju përpiqeni të mbroheni nga sulmi i dikujt, gongu përsëri do të ketë arritur atje. Pamvarësisht sa i shpejtë jeni kur godisni, ai do të shkojë më shpejt se ju sepse koncepti kohës është ndryshe në të dyja anët. Nëpërmjet praktikës së qigongut të arteve marziale një njeri mund të zhvillojë të ashtuquajturit Pëllëmbë të Hekurt, Pëllëmbë

Mërkuri, Këmbë Diamanti dhe Këmbë Arhati⁵. Këto janë aftësi njerëzish të zakonshëm. Nëpërmjet praktikës një njeri i zakonshëm mund të arrijë këtë nivel.

Ndryshimi më i madh ndërmjet qigongut të arteve marziale dhe praktikës së kultivimit të brëndshëm është se qigongu i arteve marziale kërkon praktikë në lëvizje; qi-ja kështu lëviz nën lëkurë. Për shkak se kërkon praktikë në lëvizje, një njeri nuk mund të arrijë një gjëndje qetësie dhe qi nuk mund të hyjë në dantian. Qi-ja e personit do të lëvizë nën lëkurë dhe përmes muskujve. Prandaj, ai nuk mund të kultivojë as trupin dhe as aftësi të nivelit të lartë. Praktika jonë e kultivimit të brëndshëm kërkon të praktikosh në një gjëndje qetësie. Praktikata tradicionale kërkojnë që qi të hyjë në dantian në pjesën e poshtme të barkut. Ato kërkojnë praktikë në një gjëndje qetësie dhe transformimin e bentit. Ato mund të kultivojnë trupin dhe të udhëheqin në praktikën kultivuese të niveleve më të larta.

Ju mund të keni dëgjuar nga novelat për teknikat e arteve marziale si për shembull, të ashtuquajturit Mburoja Këmbanës së Artë, Këmisha e Hekurt dhe goditja e një peme plepi nga njëqind hapa larg. Me artet marziale të lehta një njeri mund të kërcejë lart e zbrësë poshtë nga lartësi. Disa mund të hyjnë edhe në dimensione të tjera. A ekzistojnë arte marziale të tilla? Sigurisht që po. Por ato nuk ekzistojnë midis njerëzve të zakonshëm. Ata që me të vërtetë kanë kultivuar arte marziale kaq të shquara nuk mund t'i shfaqin ato në publik. Ngaqë një person i tillë nuk praktikon thjesht artet marziale por është përtej nivelit të njerëzve të zakonshëm, ai duhet të praktikojë kultivim duke ndjekur një praktikë të kultivimit të brëndshëm. Ky person duhet të vlerësojë dhe të përmirësojë karakterin. Ai nuk duhet të tregojë interes për gjëra si interesat materiale. Megjithëse ai mund të kultivojë arte marziale të tilla, ai nuk mund t'i përdorë ato më pas shkarazi para njerëzve të zakonshëm. Lejohet që ai t'i përdorë ato kur nuk e shikon asnjëri. Kur lexoni ato novela, ju do të shikoni që një personash do të luftojë dhe vrasë për një manual arti shpate secrete, thesar apo për gra. Të gjithë përshkruhen sikur kanë aftësi të mëdha dhe lëvizin poshtë e lart në mënyrë misterioze. Pa mendoheni të gjithë: A nuk duhet të kultivojnë veten nëpërmjet praktikës së kultivimit të brëndshëm të gjithë ata individë që me të vërtetë kanë këto aftësi artesh marziale? Ata i fitojnë ato vetëm nëpërmjet kultivimit të karakterit dhe ata duhet që të kenë hequr dorë me kohë nga fama, përfitimi dhe dëshirat e ndryshme. Si mund të vrasin ata njerëz të tjerë? Si ka mundësi që ata të jenë të interesuar për para dhe pasuri? Është absolutisht e pamundur. Ato janë thjesht ekzagjirime artistike. Njerëzit shkojnë pas stimulimit emocional dhe do të bëjnë gjithçka për ta kënaqur atë. Autorët spekullojnë me këtë pikë dhe përpiqen me sa mundin që të shkruajnë çfarëdo që ju kërkoni dhe gjeni kënaqësi. Sa më të pabesueshme që janë shkrimet, aq më shumë ju doni t'i lexoni ato. Ato janë vetëm akzagjirime artistike. Ata që me të vërtetë i kanë këto aftësi artesh marziale nuk do të veprojnë ashtu. Veçanërisht, ata nuk do t'i demostrojnë ato në publik.

Mentaliteti për t'u Dukur

Për shkak se praktikojnë kultivim në mes të njerëzve të zakonshëm, mjaft nga praktikuesit tanë nuk mund të braktisin shumë prej veseve të tyre. Shumë vese tashmë janë bërë natyrë e dytë dhe vetë personi nuk mund t'i dallojë ato. Mentaliteti për t'u dukur mund të shfaqet në çdo situatë; mund të shfaqet edhe kur je duke kryer një vepër të mirë. Me qëllim që të fitojnë famë, fitim personal dhe pak përfitim, disa njerëz shpesh lavdërohen dhe mburren: “Unë jam shumë i aftë dhe i zoti.” Ne kemi gjithashtu raste të tilla ku ata që praktikojnë pak më mirë se të tjerët, shohin më mirë me Syrin Qiellor apo lëvizjet e ushtrimeve të cilëve duken më mire u pëlqen që të mburren.

⁵ Pëllëmbë e Hekurt, Pëllëmbë Mërkuri, Këmbë Diamanti dhe Këmbë Arhati—Iloje teknikash të artit marcial kinez.

Dikush mund të pretendojë: “Unë kam dëgjuar diçka nga Mësues Li.” Njerëzit do ta rrethojnë atë dhe dëgjojnë se çfarë thotë ai. Ai do të transmetojë thashethemin duke e zbukuar me të kuptuarit e vet. Cili është qëllimi? Është thjesht për t’u dukur. Ka gjithashtu disa njerëz që përhapin thashetheme midis njeri-tjetrit me interes të madh sikur ata janë të mirë informuar apo sikur shumë nga praktikuesit tanë nuk kuptojnë apo nuk dinë aq shumë sa ata. Është bërë e natyrshme për këta dhe ndodhta ata vetë nuk e kuptojnë. Në ndërgjegje ata thjesht kanë mentalitetin për t’u dukur. Përndryshe, cila do të ishte arsyeja e qarkullimit të thashethemeve? Disa njerëz nxjerrin thashetheme sikur unë do të kthehem në male. Unë nuk jam nga malet. Pse duhet të kthehem në male? Të tjerë nxjerrin thashetheme sikur unë i kam thënë dikujt diçka në një ditë të caktuar dhe se unë e trajtoj atë njeri në mënyrë të veçantë. Çfarë të mire ka në përhapjen e gjërave të tilla? Ato nuk shërbejnë për asgjë. Sidoqoftë, ne kemi parë që ky është vesi i tyre—mentaliteti për t’u dukur.

Disa njerëz më kërkojnë autograf. Cili është qëllimi? Është zakon i njerëzve të zakonshëm që të mbajnë autografin e dikujt si kujtim. Nëqoftëse ju nuk praktikoni kultivim, autografi im nuk ju vlen për asgjë. Çdo fjalë në librin tim mbart imazhin tim dhe Falun dhe çdo fjali është thënë nga unë. Për çfarë e doni autografin tim? Disa njerëz pandehin: “Mesazhet e Mësuesit nëpërmjet autografit do të më mbrojnë.” Ata akoma besojnë në gjëra të tilla si mesazhet. Ne nuk na interesojnë mesazhet. Ky libër është i çmuar pa masë. Çfarë gjëje tjetër kërkoni? Të gjitha këto janë pasqyrime të veseve tuaja. Gjithashtu, disa njerëz pasi shohin sjelljen e dishepujve që udhëtojnë me mua mundohen që t’i imitojnë ata pa e kuptuar nëse ato janë gjëra të mira apo të këqija. Në fakt, nuk ka rëndësi kush je, ekziston vetëm një Ligj. Vetëm duke vepruar në përputhje me Ligjin e Lartë, mundet një person të arrijë standartin e vërtetë. Njerëzit që udhëtojnë me mua nuk janë trajtuar në mënyrë të veçantë dhe janë njësoj si të tjerët; ata janë thjesht personel të Shoqatës Kërkimore. Mos krijoni vese të tilla. Shpesh, me të krijuar këto dëshira, ju padashje mund të luani një rol negativ ndaj Dafës. Thashethemi sensacional që ju shpikët mund të çojë madje dhe në konflikte apo të nxisë dëshirën e një praktikuesi për t’ju afruar Mësuesit me qëllim që të dëgjojë më shumë gjëra e kështu me radhë. A nuk janë këto e njejtat gjë?

Ku mund t’ju çojë tjetër ky mentaliteti i mburrjes? Unë kam dhënë mësim të praktikës për dy vjet. Disa nga praktikuesit tanë veteranë të Falun Dafës mund të arrijnë shpejt gjëndjen e Çbllokimit të Gongut. Disa do të hyjnë në fazën e lartësimit shpirtëror gradual dhe papritur do ta arrijnë atë. Pse nuk i kishin ata aftësitë supernormale më parë? Kjo ndodh për arsye se, megjithëse unë ju kam shtyrë në nivele kaq të larta menjëherë, kjo nuk do të lejohej sepse vese tuaja prej njeriu të zakonshëm nuk janë eliminuar plotësisht. Natyrisht karakteri juaj është përmirësuar jashtë mase por megjithatë shumë vese akoma nuk janë hequr. Prandaj, ato aftësi supernormale nuk ju janë dhënë. Kur kjo fazë të kalojë dhe ju të jeni të qëndrueshëm, ju do të vihëni menjëherë në një gjëndje lartësimi shpirtëror gradual. Në këtë gjëndje të lartësimit shpirtëror gradual, Syri juaj Qiellor do të hapet në një nivel shumë të lartë dhe ju do të zhvilloni shumë aftësi supernormale. Në fakt, më lejoni t’ju them se kur ju praktikoni kultivim me të vërtetë, ju keni zhvilluar shumë aftësi supernormale që në fillim. Ju tashmë keni arritur këtë nivel të lartë, kështu që keni shumë aftësi supernormale. Kjo situatë mund t’i ketë ndodhur shumë prej jush kohët e fundit. Gjithashtu ka njerëz që nuk mund të arrijnë një nivel të lartë në kultivim. Ajo që ata kanë fizikisht së bashku me durimin e tyre është e paracaktuar nga fati. Rrjedhimisht, disa persona do të përjetojnë Çbllokimin e Gongut apo do të lartësohen shpirtërisht plotësisht në një nivel shumë të ulët. Do të ketë njerëz të tillë.

Unë po ja u vë në dukje këtë çështje që secili ta dijë nëse ka një person të tillë ju nuk duhet ta konsideroni atë si një njeri të lartësuar shpirtërisht dhe të jashtëzakonshëm. Kjo është një çështje shumë serioze në praktikën kultivuese. Vetëm duke ndjekur Ligjin e Lartë mund t’i bëni ju gjërat siç duhet. Ju nuk duhet ta ndiqni apo ta dëgjoni atë për shkak se ai ka aftësi supernormale, fuqi mbinatyrale apo sepse ai mund të shohë ca gjëra. Ju do ta dëmtoni atë sepse ai do të zhvillojë vesin e zellit të tepruar dhe do të humbë gjithçka dhe aftësitë do t’i mbyllën. Së fundi, ai do të bjerë poshtë.

Edhe një njeri që ka arritur gjëndjen e Çbllokimit të Gongut mund të bjerë poshtë. Nëqoftëse një njeri nuk sillet ashtu siç duhet, ai do të bjerë poshtë edhe sikur të jetë lartësuar shpirtërisht. Edhe një Buddha kur nuk sillet siç duhet mund të bjerë poshtë jo më pastaj një praktikues si ju midis njerëzve të zakonshëm! Prandaj, pamvarësisht nga sa aftësi supernormale ju keni zhvilluar, sa të mëdha janë ato apo sa të fuqishme janë fuqitë tuaja hyjnore, ju duhet të silleni ashtu siç duhet. Kohët e fundit, ne kishim këtu një njeri që mund të zhdukesh një çast dhe të shfaqesh përsëri më pas. Është pikërisht ashtu. Edhe aftësi supernormale akoma më të mëdha do të zhvillohen. Çfarë do të bëni ju? Si praktikuesit apo dishepujt tanë nëse këto gjëra ju ndodhin juve apo të tjerëve, në të ardhmen, ju nuk duhet t'i adhuronit ato apo të ndiqni këto gjëra. Sapo ju mendoni keq, do të jetë fundi dhe ju do të bini poshtë. Ndoshta ju jeni në një nivel më të lartë se ata, vetëm se fuqitë tuaja mbinatyrale nuk janë shfaqur ende. Të paktën ju keni rënë poshtë në këtë çështje. Për këtë arsye, secili duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë kësaj çështjeje. Ne e kemi konsideruar këtë një çështje me rëndësi shumë të madhe sepse një gjë e tillë do të ndodhë shpejt. Kur ajo të ndodhë është e papranueshme nëse ju nuk silleni siç duhet.

Një praktikues që ka zhvilluar gong dhe ka arritur shkallën e Çbllokimit të Gongut apo është lartësuar shpirtërisht nuk duhet ta konsiderojë veten si të veçantë. Ato që ai shikon janë gjëra të kufizuara nga niveli i tij. Kultivimi i tij ka arritur këtë nivel sepse aftësia e lartësimit të tij shpirtëror, standarti i karakterit dhe mençuria e tij kanë arritur këtë nivel. Përsa i përket gjërave të një niveli më të lartë, ai mund të ketë dyshime. Pikërisht për shkak se ai nuk i beson ato, ai mendon se ajo që ai shikon është absolute dhe se ekzistojnë vetëm këto gjëra. Nuk është aspak ashtu sepse niveli i këtij personi ka arritur deri aty.

Disa njerëzve do t'u çbllokohet gongu në këtë nivel përderisa ata nuk mund të shkojnë me tej në praktikën kultivuese. Si rezultat, ata mund të kenë Çbllokimin e Gongut dhe të lartësohen shpirtërisht vetëm në atë nivel. Midis jush që do të përfundoni kultivimin në të ardhmen, disa do të lartësohen shpirtërisht në rrugë të vogla tokësore, disa do të lartësohen shpirtërisht në nivele të ndryshme dhe disa do të lartësohen shpirtërisht me Shkallë të Duhur. Vetëm personat e lartësuar shpirtërisht me Shkallën e Duhur do të arrijnë nivelet e tyre më të larta duke qenë të aftë të shohin gjëra dhe duke u shfaqur në nivele të ndryshme. Edhe ata që janë lartësuar shpirtërisht në rrugë të vogla tokësore të një niveli të ulët, do të jenë të aftë të shohin disa dimensione dhe disa Qënie të Shumëlartësuar dhe do të kenë gjithashtu mundësi të komunikojnë me to. Në atë kohë, ju nuk duhet të vetëkënaqeni sepse lartësimi shpirtëror në rrugët e vogla tokësore e nivelet e ulta nuk mund të arrijë Shkallën e Duhur—kjo është e sigurt. Çfarë mund të bëhet për këtë atëhere? Personi mund të qëndrojë vetëm tek ky nivel. Për të praktikuar kultivim drejt një niveli më të lartë, do të jetë një çështje e së ardhmes. Përderisa kultivimi i tij mund të shkojë deri këtu, ç'kuptim ka që t'ja mbash gongun të mbyllur? Megjithëse ju do të vazhdoni të kultivoni, kultivimi juaj nuk mund të përparojë më tej, kështu që juve do t'ju çbllokohet gongu, sepse ju keni arritur fundin e kultivimit tuaj; do të ketë shumë njerëz të tillë. Çfarëdo që të ndodhë, ju duhet të mbani një karakter të mirë. Vetëm duke vepruar në përputhje me Ligjin e Lartë mund të jetë një person me të vërtetë i mirë. Qoftë aftësitë supernormale, qoftë Çbllokimi i Gongut tuaj, ju i arritët ato vetëm duke praktikuar kultivim në Dafa. Nëse ju e vendosni Dafën në plan të dytë dhe vendosni fuqitë tuaja mbinatyrale në plan të parë, apo si një njëri i lartësuar shpirtërisht, ju besoni se në një mënyrë apo tjetrën, ajo që ju kuptoni është e saktë apo nëqoftëse ju e konsideroni veten si të madh dhe përtej Dafës, unë do të thoja se ju keni filluar të bini poshtë. Kjo do të ishte me rrezik dhe ju do të bëheshit akoma më i keq. Në atë kohë ju me të vërtetë do të keni probleme dhe kultivimi i juaj do të shkojë kot. Nëqoftëse gjërat nuk i bëni mirë, ju do të bini poshtë dhe do të dështoni në kultivim.

Më lejoni gjithashtu t'ju them se përmbajtja e këtij libri është kombinim i Ligjit që unë kam mësuar gjatë disa klasave. Çdo gjë është mësuar prej meje dhe çdo fjali ë shtë thënë prej meje. Çdo fjalë është marrë nga kaseta e rregjistruar dhe shkruar fjalë për fjalë. Dishepujt dhe praktikuesit e mi

më ndihmuan që të shkruaja në tekst çdo gjë nga kasetat. Më pas, unë e kam rishikuar disa herë. Është i gjithi Ligji im dhe ajo që unë ju kam mësuar është vetëm ky Ligj.

LEKSIONI I SHTATË

Çështja e Vrasjes

Çështja e vrasjes është shumë sensitive. Për praktikuesit, ne kemi vënë kërkesën e rreptë që ata nuk duhet të vrasin jetë. Qoftë Shkolla e Buddhës, Shkolla Tao, apo Shkolla Qimen, pamvarësisht se cila shkollë apo praktikë është, nëqoftëse janë praktika kultivuese të vërteta, do e konsiderojë këtë çështje shumë absolute dhe e ndalojë vrasjen—kjo është e sigurtë. Meqë pasojat e vrasjes së një jete janë kaq serioze, ne duhet ta sqarojmë atë në detaj. Në Buddhizmin origjinal, vrasja kryesisht i referohej marrjes së një jete njeriu, e cila konsiderohej vepra më serioze. Më pas, vrasja e kafshëve të mëdha, kafshëve të mëdha shtëpiake, apo kafshëve relativisht të mëdha konsideroheshin të gjitha si tepër serioze. Pse është konsideruar kaq serioze çështja e vrasjes në komunitetin e kultivuesve? Në të kaluarën, Buddhizmi thoshte se jetët që nuk duhet të vdisnin po të vriteshin do të ktheheshin në shpirtra të vetmuar dhe fantazma pa shtëpi. Më parë, kryheshin rite për të çliruar shpirtrat e këtyre njerëzve nga vuajtjet. Pa këto shërbesa, këta shpirtra do të vuanin nga uria dhe etja, duke jetuar në një gjendje tepër të ashpër. Këtë thoshte Buddhizmi në të kaluarën.

Ne besojmë se kur dikush i bën keq dikujt tjetër, ai duhet të japë plot virtyt si kompensim. Këtu ne i referohemi zakonisht asaj kur dikush ka marrë gjërat që i takojnë njerëzve të tjerë etj. Ndërsa nëqoftëse një jetë merret papritur, qoftë kafshë apo krijesë tjetër, kjo do të krijojë plot karmë. Në të kaluarën, vrasja i referohej kryesisht marrjes së një jete njeriu që do të shkaktonte një sasi karme të madhe. Megjithatë vrasja e jetëve të tjera nuk është mëkat më i vogël, sepse ajo gjithashtu shkakton plot karmë. Veçanërisht për një praktikues, gjatë praktikës kultivuese juve ju jepen disa vështirësi në çdo nivel të ndryshëm. Ato shkaktohen të gjitha nga karma juaj dhe janë vështirësitë tuaja, të cilat vendosen në nivele të ndryshme në mënyrë që ju të përmirësoni veten. Po e përmirësuar karakterin tuaj, ju do të mundni t'i mposhtni ato. Por nëqoftëse ju papritmas merrni kaq shumë karma nga vrasja, si mundet t'i mposhtni ju ato? Me nivelin tuaj të karakterit ju nuk do mundni t'ja arrini aspak. Kjo mund ta bëjë të pamundur që ju të praktikoni kultivim.

Ne kemi parë që kur një njeri lind, lindin shumë prej tij njëkohësisht brenda një pjese të caktuar të hapësirës kozmike. Ata ngjajnë me njeri tjetrin, kanë të njejtin emër dhe bëjnë gjëra të ngjashme. Prandaj, edhe ata mund të quhen pjesë të qënies së tij të plotë. Kjo ka lidhje me çështjen që vijon: në rast se njeri prej tyre (kjo është e njejtë dhe për rastin e jetës së kafshëve të mëdha) vdes papritur ndërsa të tjerët në dimensione të ndryshme kanë akoma kohë për të përfunduar udhëtimin e tyre të jetës të paracaktuar nga fati dhe akoma kanë shumë vite për të jetuar, personi i vdekur do të jetë i pashtëpi dhe do të sorrollatet në hapësirën e universit. Thuhej në të kaluarën se shpirtrat e vetmuar dhe fantazmat pa strehë vuajnë nga uria, etja dhe vuajtje të tjera. Kjo mbase është e vërtetë. Por ne me të vërtetë kemi konstatuar gjendjen e tmerrshme në të cilën vuan një person ngaqë ai duhet të presë për fatin e tij përfundimtar ku çdonjeri prej tij në çdo dimension përfundon jetën e vet. Sa më gjatë të shkojë, aq më shumë vuan ai. Sa më shumë vuan ai, aq më shumë karmë e krijuar nga vuajtjet e tij do t'i shtohet trupit të vrasësit. Mendoheji pak: Sa shumë karmë mund të grumbulloni? Këtë kemi konstatuar nëpërmjet aftësive supernormale.

Ne gjithashtu kemi vënë re këtë situatë: Kur një person lind, një profil i tërë jetës së tij do të ekzistojë në një dimension të caktuar. Me fjalë të tjera, ku ai ndodhet në jetë dhe çfarë duhet të bëjë janë të tëra të përfshira në të. Kush e ka paracaktuar jetën e tij? Është bërë me sa duket nga një jetë më e lartë. Për shembull, në shoqërinë tonë njerëzore, pas lindjes dikush i përket një familjeje të caktuar, një shkollë të caktuar dhe pasi rritet një vendi pune të caktuar; kontakte të ndryshme në shoqëri vendosen nëpërmjet punës së personit. Domethënë, tërë përbërja e shoqërisë është rregulluar në këtë mënyrë. Megjithatë nëqoftëse një jetë vdes papritmas dhe jo sipas renditjes origjinale dhe

specifike, apo nëqoftëse ndryshohen gjërat, jeta më e lartë nuk do t'ja falë prishësit. Pa mendojeni njëherë të gjithë: Si praktikues, ne duam të praktikojmë kultivim drejt niveleve të larta. Ajo jetë e nivelit të lartë nuk do t'ja falë vrasësit. A mendoni se ky person mund të praktikojë më kultivim? Nivelet e disa mjeshtrëve nuk janë aq të lartë sa ajo jetë e lartë që ka bërë planifikimin. Prandaj, edhe mjeshtri i personit do të ndëshkohet dhe do të ulet në nivel të ulët. Veç mendojeni pak: A është kjo një çështje e rëndomtë? Kështu sapo një person të ketë bërë një gjë të tillë, do jetë shumë e vështirë për të që të praktikojë kultivim.

Në mes të praktikuesve të Falun Dafës mund të ketë disa që kanë luftuar në kohë luftërash. Ato luftëra ishin rrethana që u shkaktuan nga ndryshime kozmike më të mëdha në tërësinë e fenomeneve qiellore dhe ju ishin vetëm një element në ato rrethana. Pa pjesëmarrjen e njerëzve nën efektin e ndryshimeve kozmike, këto situata nuk do të ndodhnin në shoqërinë njerëzore dhe as do të quheshin ato ndryshime kozmike. Këto ngjarje u shkaktuan si pasojë e ndryshimeve më të mëdha dhe nuk ishin për fajin tuaj. Ajo që po diskutojmë këtu është karma që rezulton nga këmbëngulja e njeriut për të bërë gjëra të këqija kur kërkon fitim personal, të kënaqë interesin personal, apo kur preket interesi i tij. Për aq kohë sa kjo lidhet me ndryshimet e gjithë universit të pamasë dhe ndryshimet themelore në shoqëri, nuk është faji juaj.

Vrasja mund të sjellë karmë kolosale. Dikush mund të mendojë: “Ne nuk mund të vrasim jetë, por unë jam kuzhinieri në familje. Çfarë do të hajë familja ime nëqoftëse unë nuk vras dot? Kjo çështje specifike nuk më përket mua sepse unë po u mësoj Ligjin praktikuesve e nuk jam këtu duke ju treguar njerëzve të zakonshëm si të jetojnë. Në lidhje me çështjen si duhet të trajtoni ju çështje të veçanta, ju duhet të gjykoni sipas Ligjit të Lartë. Ju duhet të veproni si ta shihni të arsyeshme. Njerëzit e zakonshëm do të bëjnë çfarëdo që duan dhe kjo është puna e tyre; nuk është e mundur për çdo njeri të praktikojë kultivim me të vërtetë. Megjithatë, si praktikues, ju duhet të ndiqni një standart më të lartë, kështu unë këtu po parashtroj kërkesat për praktikuesit.

Përveç njerëzve dhe kafshëve, bimët kanë jetë gjithashtu. Jeta e çdo lloj materieje mund të manifestohet në dimensione të tjera. Kur Syri yt Qiellor arrin nivelin e Shikimit të Ligjit, ju do të zbuloni se gurët, muret, apo çdo gjë tjetër mund t'ju flasë dhe t'ju përshëndesë. Mbase dikush mund të mendojë: “Drithërat dhe zarzavatet që hamë janë gjithashtu jetë. Po ashtu ka miza dhe mushkonja në shtëpi. Çfarë të bëjmë? Nuk do ishte aspak e këndshme që të pickohesh nga një mushkonjë në verë dhe një person do rrinte e vështronte si po pickohesh pa bërë gjë. Nëqoftëse dikush do shihte një mizë duke ndotur mbi ushqimin e tij, ai nuk do të mund ta vriste atë. Më lejoni t'ju them se ne nuk duhet të marrim jetë sipas dëshirës pa ndonjë arsye. Por as dhe nuk duhet të bëhemi njerëz me kujdes të tepruar, duke u përqëndruar gjithmonë tek vogëlsirat, apo duke kërcyer këtu e aty kur ecim nga frika se mos po shtypim mbi milingona. Do thoja se do jetonit kështu një jetë të lodhshme. A nuk do ishte ky dhe një ves? Edhe sikur duke kërcyer nuk do vrisje asnjë milingonë, ju prapëprapë mund të keni vrarë shumë mikroorganizma. Ka shumë jetë edhe më të vogla në nivel mikroskopik, duke përfshirë mikrobet dhe bakteriet; mbase ju keni shkelur dhe vrarë shumë prej tyre. Kështu, ne po ndalojmë më mirë së jetuari. Ne nuk duam të bëhemi njerëz të tillë, sepse kjo e bën praktikën kultivuese të pamundur. Njeriu duhet të ketë këndvështrim më të gjërë dhe të praktikojë kultivim në mënyrë të hapur dhe dinjitoze.

Si qenie njerëzore, ne kemi të drejtë të bëjmë jetë njerëzish. Prandaj, ambjenti ynë jetësor duhet të plotësojë nevojat e jetësës njerëzore. Ne nuk mund të dëmtojmë apo marrim jetë me qëllim, por ne as nuk duhet të shqetësohemi me tepri me këto gjëra të vogla. Për shembull, zarzavatet dhe drithërat që rrisim janë të gjitha jetë. Ne nuk mund të ndalojmë së ngrëni apo së piri për shkak se ato kanë jetë, sepse si mund të praktikojmë ne kultivim pastaj? Njeriu duhet të shikojë përtej këtyre gjërave. Për shembull, ndërsa ti je duke ecur, disa milingona apo insekte mund të bien nën këmbët e tua dhe të vriten. Mbase ato ishin për të ngordhur përderisa ti nuk i vrave ato me qëllim. Në botën e organizmave dhe mikroorganizmave, ekziston edhe çështja e ekuilibrit ekologjik—çdo lloj specie me

tepricë do të ishte problematike. Ne duhet kështu të praktikojmë kultivim në mënyrë dinjitoze dhe të hapur. Kur mizat dhe mushkonjat janë në shtëpi, mund t'i nxjerrim ato përjashta apo të vendosim një rrjetë në dritare që të mos hyjnë brenda. Shpesh, ato nuk duan të dalin dhe në rast se shtypen, ashtu qoftë. Nëqoftëse do të pickonin apo dëmtonin njerëzit në vendin ku ata jetojnë, ne sigurisht duhet t'i nxjerrim ato përjashta. Nëqoftëse ato nuk nxirren dot jashtë, ti nuk mund të rridh e t'i shikosh ato kur pickojnë njerëzit. Si praktikues, ju nuk i kushtoni vëmendje atyre dhe nuk ju gjen gjë prej tyre, por pjesëtarët e familjes nuk praktikojnë kultivim dhe janë njerëz të zakonshëm që kanë problemin e sëmundjeve ngjitëse. Ne nuk mund të vëzhgojmë dhe të mos bëjmë asgjë kur një mushkonjë pickon një fëmijë në fytyrë.

Më lejoni t'ju jap një shembull. Ekziston një histori për Sakyamunin në vitet e tij të hershme. Një ditë Sakyamuni do të bënte banjë në një pyll dhe i kërkoi një dishepulli të pastronte vaskën. Dishepulli i tij shkoi tek vaska dhe e gjeti plot me insekte që ecnin gjithandej. Insektet do të vriteshin nëqoftëse ai pastronte vaskë. Dishepulli u kthye tek Sakyamuni dhe i tha: "Vaska është plot me insekte." Sakyamuni ju përgjigj pa e parë: "Ti duhet të shkosh e të pastrosh vaskën." Dishepulli u kthye tek vaska dhe nuk dinte si ta pastronte atë, sepse po të bënte ashtu do të vriste insektet. Ai u kthye përsëri tek Sakyamuni dhe i tha: "Mjeshtër, vaska është plot me insekte. Po ta pastroj, insektet do të vriten." Sakyamuni e pa dhe i tha: "Ajo që të kërkova të bësh është të lash vaskën." Dishepulli e kuptoi këtë herë dhe shkoi dhe e pastroi vaskën menjëherë. Kjo histori tregon një parim: Ne nuk duhet të ndalojmë së bëri banjo sepse ka insekte dhe as duhet që të gjejmë një vend tjetër të jetojmë sepse ka mushkonja. Ne po ashtu nuk duhet të qepim gojën e të mos hamë e pijmë sepse si drithërat dhe zarzavatet janë jetë. Nuk duhet të jetë kështu. Ne duhet ta zgjidhim këtë çështje siç duhet dhe praktikojmë kultivim në mënyrë dinjitoze. Nuk ka problem për aq kohë sa ne nuk dëmtojmë ndonjë jetë me qëllim. Ndërkohë, njerëzit gjithashtu duhet të kenë hapësirën dhe kushtet e jetesës dhe këto duhet gjithashtu të ruhen. Qëniet njerëzore kanë nevojë të vazhdojnë jetën dhe të jetojnë normalisht.

Në të kaluarën, disa mjeshtër të rremë qigongu thonin: "Mund të vrasësh jetë në ditën e parë dhe të pesëmbëdhjetë të çdo muaji të kalendarit hënor." Disa prej tyre madje pretendonin se nuk ishte gjë e keqe të vrisje kafshë me dy këmbë sikur ato të mos ishin jetë. A nuk konsiderohen si marrje jete vrasjet që bëhen në ditën e parë apo të pesëmbëdhjetë? Pra kjo na qënka si të grish sallatë ë? Disa mjeshtër qigongu të rremë mund t'i tregosh nga fjalët dhe veprat, apo nga ajo që thonë dhe çfarë qëllimi kanë. Të gjithë ata mjeshtër qigongu që bëjnë deklarata të tilla zakonisht janë zotëruar nga shpirtra apo kafshë. Veç të shikoni se si një mjeshtër qigongu i zotëruar nga dhelpra ha mish pule. Kur ky person e kullufit atë, ai nuk i nxjerr jashtë as kockat.

Vrasja nuk shkakton vetëm shumë karmë, por ajo gjithashtu lidhet me çështjen e mëshirës. A nuk duhet të jemi ne mëshirues si praktikues? Kur mëshira jonë shfaqet, ne me siguri do të na duken të gjitha qëniet e gjalla dhe të gjithë njerëzit të vuajnë. Kjo do të ndodhë.

Çështja e Ngrënies së Mishit

Ngrënia e mishit është gjithashtu një çështje shumë sensitive, por të hash mish nuk do të thotë të vrasësh jetë. Megjithëse të gjithë ju keni studjuar Ligjin për caq kohë, ne nuk ju kemi kërkuar të ndaloni ngrënien e mishit. Shumë mjeshtër qigongu ju thonë të ndaloni ngrënien e mishit sapo ju hyni në klasat e tyre. Ju mund të mendoni: "Unë nuk jam akoma i përgatitur mendërisht të ndaloj ngrënien e mishit menjëherë." Ushqimi i servirur sot në shtëpi mund të jetë pulë e pjekur apo peshk i fërguar. Megjithëse ato kanë aromë shumë të mirë, juve nuk ju lejohet t'i hani ato. Kjo është e vërtetë dhe me praktikën kultivuese fetare që i detyrojnë njerëzit të mos hanë mish. Praktikën konvencionale në Shkollën e Buddhës dhe disa praktika në Shkollën Tao gjithashtu thonë të njejtën gjë dhe i ndalojnë njerëzit të hanë mish. Ne nuk ju kërkojmë juve këtu të bëni të njejtën gjë, por edhe neve na intereson

kjo çështje. Atëhere, çfarë kërkojmë ne? Meqenëse në praktikën tonë është Ligji që kultivon praktikuesit, kjo do të thotë që disa gjendje do të lindin nga gongu dhe Ligji. Në periudhën e praktikës, nivele të ndryshme prodhojnë situata të ndryshme. Një ditë apo pas leksionit tim sot, disa njerëz mund të hyjnë në këtë gjendje: Ata nuk mund të hanë mish dhe nuk ja durojnë dot erën. Po të hanë mish, atyre do t'ju vijë për të vjellë. Kjo nuk vjen sepse ju detyron njeri dhe as sepse e detyroni ju veten të mos hani mish. Përkundrazi, kjo vjen nga mëndja juaj. Pas arritjes së këtij niveli, ju nuk do të jeni të aftë të hani mish, sepse është gongu juaj që e sjell këtë gjendje. Nëqoftëse e përcillni mishin, ju me të vërtetë do të villni.

Praktikuesit tanë veteranë të gjithë e dinë që kjo situatë do të ndodhë në praktikën kultivuese të Falun Dafës, sepse nivele të ndryshme sjellin gjendje kultivimi të ndryshme. Disa praktikues kanë një dëshirë të madhe dhe një ves të fortë ndaj ngrënies së mishit—ata zakonisht hanë shumë mish. Kur të tjerëve ju duket mishi shumë i pështirshëm, atyre nuk ju duket kështu dhe akoma mund ta hanë atë. Në mënyrë që t'ja heqim këtë ves, çfarë mund të bëhet? Ky person do të ketë dhimbje stomaku sapo të hajë mish. Kur nuk ha mish, ai apo ajo nuk do të ketë dhimbje. Kjo situatë do të ndodhë dhe do të thotë që personi nuk duhet të hajë mish. A do të thotë kjo se pas kësaj shkolla jonë e praktikës nuk do ketë të bëjë fare me mishin? Nuk është kështu. Si ta trajtojmë ne këtë çështje? Kur nuk je në gjendje të hash mish, kjo vjen nga brenda teje. Cili është qëllimi? Praktikant kultivuese në tempuj e detyrojnë personin të mos hajë mish. Si kjo ashtu dhe gjendja e të mos ngrënit mish që shfaqet në praktikën tonë, të dyja kanë për qëllim të heqin këtë dëshirë njerëzore apo vesit e të ngrënit mish.

Nëqoftëse nuk kanë mish në pjatë, disa persona thjesht nuk e hanë ushqimin e tyre. Kjo është një dëshirë prej njeriu të zakonshëm. Një mëngjes kur unë po kaloja në hyrjen e pasme të Parkut të Triumfit në Changchun, tre persona dolën nga hyrja e pasme duke folur me zë të lartë. Njëri prej tyre tha: “Çfarë lloj qigongu qenka ky që nuk të lejon të hash mish? Unë më mirë jap dhjetë vjet nga jeta ime se sa të lë mishin!” Çfarë dëshirë e fortë kjo! Mendojeni pak të gjithë: A nuk duhet të hiqet kjo dëshirë? Patjetër që duhet. Gjatë kursit të praktikës kultivuese, personi duhet të heqë dorë nga dëshirat dhe veset e ndryshme. Që ta themi hapur, nëqoftëse dëshira për të ngrënë mish nuk është hequr, a nuk do të thotë kjo që vesi nuk është braktisur? Si mundet personi ta përfundojë kultivimin? Prandaj për aq kohë sa një gjë është ves, ai duhet të hiqet. Por kjo nuk do të thotë se personi nuk do të ha më kurrë mish. Heqja dorë nga të ngrënit e mishit nuk është qëllimi. Qëllimi është të mos ju lejojmë juve të keni këtë ves. Nëqoftëse ju mund të hiqni dorë nga vesi gjatë kohës kur nuk mund ta hani mishin, ju mund të jeni në gjendje ta hani atë përsëri. Mishi atëhere nuk do t'ju mbajë erë të keqe apo të ketë shije të pështirshme.

Kur ju mund të hani mish përsëri, si vesi dhe dëshira juaj për mish do të jenë zhdukur. Megjithatë, do të ketë një ndryshim të madh: mishi nuk do t'ju shijojë më. Nëse është gatuar në shtëpi, ju do e hani me familjen tuaj. Nëse nuk është gatuar në shtëpi, ju nuk do e ndjeni mungesën. Po ta hani atë, nuk do t'ju shijojë. Kjo gjë do të ndodhë. Por të praktikosh kultivim në mes të njerëzve është tepër e komplikuar. Nëqoftëse familja juaj gatuan gjithmonë mish, pas një periudhe kohe, juve do të fillojë t'ju shijojë përsëri. Të tilla kthime mbrapa do të ndodhin në të ardhmen dhe ato do të përsëriten disa herë gjatë gjithë periudhës së praktikës kultivuese. Ju mund të jeni në gjendje të hani mish përsëri papritmas. Ju nuk duhet ta hani kur nuk mundni ta hani dot. Ju me të vërtetë nuk do jeni në gjendje ta hani dhe me ta ngrënë ju do të villni. Pritni derisa të mund të hani mish përsëri dhe ndiqni rrjedhën e natyrshme të gjërave. Qëllimi nuk është të hash apo të mos hash mish—thelbi është të heqësh dorë nga vesi.

Shkolla jonë e Falun Dafës e aftëson personin të bëjë përparim të shpejtë. Për aq kohë sa ju përmirësoni karakterin tuaj, ju do të bëni kapërcime të shpejta në çdo nivel. Disa njerëz nuk janë të dhënë pas mishit dhe nuk duan t'ja dinë nëse ka mish në pjatat e tyre apo jo. Do i duhet atyre disa javë ta heqin këtë ves. Disa njerëzve mund t'ju duhet një, dy, apo tre muaj apo mbase gjysmë viti për ta arritur këtë. Përveçse në raste shumë të veçanta, një personi nuk do i duhet më shumë se një vit që

të jetë në gjendje të hajë mish përsëri. Kjo ndodh ngaqë mishit është bërë tashmë ushqim i rëndësishëm për njerëzit. Pamvarësisht nga kjo, praktikuesit profesionistë në tempuj nuk duhet të hanë mish.

Le të flasim për atë se si e konsideron të ngrënët e mishit Buddhizmi. Buddhizmi origjinal më i hershëm nuk e ndalonte ngrënien e mishit. Kur Sakyamuni i mori dishepujt e tij në pyje të praktikonin kultivim përmes vështirësive, nuk kishte një rregull të tillë që ndalonte ngrënien e mishit. Pse nuk kishte? Kjo ndodhte ngaqë kur Sakyamuni u mësoi njerëzve Dharmën e tij 2500 vjet më parë, shoqëria njerëzore ishte shumë e pazhvilluar. Disa zona kishin bujqësi ndërsa të tjerat akoma nuk kishin gjë. Tokat e kultivuara ishin shumë të pakta dhe pyjet ishin kudo. Drithërat ishin të pakta dhe shumë të radha. Njerëzit sapo kishin dalë nga shoqëria primitive dhe jetonin kryesisht me gjueti; shumë zona ushqeheshin kryesisht me mish. Me qëllim që të braktisnin veset njerëzore sa më shumë që të ishte e mundur, Sakyamuni ia ndaloi dishepujtë të tij të pasurit e pasurisë, gjërave materiale etj. Ai i mori dishepujt me vete për të lypur për ushqim. Ata hanin çfarëdo gjë që u jepej, sepse si praktikues ata nuk mund ta zgjidhnin ushqimin që i jepej që mund të kishte dhe mish.

Disa ushqime u quajtën tabu në Buddhizmin origjinal. Ky ndalim i disa ushqimeve erdhi nga Buddhizmi origjinal por tani thuhet se edhe të ngrënët e mishit është tabu. Në fakt, në atë kohë ndalimi i ushqimeve nuk i referohej mishit por gjërave si qepë, xhinxher¹ dhe hudhër. Pse konsideroheshin ato tabu? Në ditët e sotme, shumë murgjër gjithashtu nuk mund ta shpjegojnë këtë qartë. Ngaqë shumë prej tyre nuk praktikojnë kultivim me të vërtetë, ata nuk janë të qartë për shumë gjëra. Ajo që Sakyamuni u mësoi njerëzve përmbledhet në “kanun, samadhi, mençuri”. Kanuni i referohet braktisjes së të gjitha veseve të njeriut. Samadhi do të thotë që një praktikues praktikon kultivim duke qënë plotësisht në meditim në kllapi—personi duhet të jetë plotësisht i pandërgjegjshëm. Çfarëdo që do të ndikonte në meditimin në kllapi dhe kultivimin do të konsiderohej si ndërhyrje serioze. Kushdo që hante qepë, xhinxher apo hudhër do të kundërmonte erë të fortë. Në atë kohë, murgjit zakonisht qëndronin në pyje apo shpella. Shtatë apo tetë vetë rrinin ulur në rreth dhe formonin disa rrethe për të medituar. Nëqoftëse dikush i hante këto gjëra, ata do të lëshonin një erë shumë irrituese që do të ndikonte tek të tjerët që meditonin, duke ndërhyrë kështu seriozisht me praktikën e tyre. Kështu u vendos ky rregull; ushqime të tilla u konsideruan tabu dhe u ndaluan. Shumë prej qënieve të kultivuara nga trupi i personit u vjen ndot nga erëra të tilla të forta. Qepët, xhinxher dhe hudhërat gjithashtu mund të stimulojnë oreksin e personit. Nëse dikush i han ato me tepri, ai gjithashtu mund të obsesohet me to dhe kështu ato u konsideruan tabu.

Në të kaluarën, pasi arrinin nivele shumë të larta në kultivim dhe hynin në stadin e Çbllokimit të Gongut apo gjysmë Çbllokimi të Gongut, shumë murgj gjithashtu e kuptonin se këto rregulla nuk kishin shumë rëndësi gjatë kursit të praktikës kultivuese. Nëqoftëse hiqej dorë nga një ves, vetë materiali nuk kishte ndonjë efekt. Ajo që me të vërtetë ndërhynte tek personi është dëshira apo vesi. Prandaj, gjatë gjithë historisë murgjit që arritën të konsumohen gjithashtu kishin kuptuar se çështja nëse dikush han apo nuk han mish nuk është çështje kritike. Çështja kryesore është nëse vesi mund të braktiset. Nëqoftëse dikush nuk ka ndonjë dëshirë të tepruar për diçka, është normale të hajë çfarëdo që të jetë për të mbushur stomakun. Meqenëse praktikantët kultivues në tempuj e kishin vënë këtë rregull, shumë njerëz janë mësuar me të. Po ashtu, nuk është më thjesht një rregull, por një rregullore e institucionalizuar në tempuj sipas së cilës askush nuk mund të hajë mish fare. Kështu njerëzit janë mësuar me këtë mënyrë kultivimi. Le të flasim pak për Murgun Jigong² i cili u bë i famshëm nga veprat letrare. Murgjit nuk duhet të hanë mish, por ai hante mish dhe u bë kështu shumë i njohur. Në fakt, që kur ai u dëbua nga Tempulli Linguin, natyrisht ushqimi u bë problem i madh për të sepse mbijetesa ishte në rrezik. Për të mbushur stomakun, ai hante çfarëdo që ai gjente; kjo nuk kishte rëndësi sepse ai veç donte të mbushte stomakun dhe nuk kishte dëshirë për ndonjë ushqim të caktuar.

¹ xhinxher—një lloj rrënjë bimore që përdoret në gjellë të ndryshme si erëzë; ka pak shije djegëse.

² Jigong—murg i njohur Buddhist në Dinastinë Song të Jugut (1127 e.r.-1279 e.r.).

Në atë nivel kultivimi, ai e kish kuptuar këtë parim. Në fakt, Jigong hëngri mish vetëm në një a dy raste. Me të dëgjuar për një murg që hante mish shkrimtarët u entuziazmuan. Sa më sensacional subjekti, as më shumë të interesuar do të ishin lexuesit. Veprat letrare bazohen në fakte nga jeta dhe pastaj shkojnë përtej tyre; kështu ai u publikua. Në fakt, nëse personi braktis dëshirën me të vërtetë, nuk ka rëndësi çfarë ai ha për të mbushur stomakun.

Në Azinë juglindore apo në krahinat jugore të Kinës si Guangdong dhe Guangxi, disa Buddhistë që nuk janë murgj nuk e quajnë veten Buddhistë në bisedë, sikur kjo të tingullonte jashtë mode. Ata thonë se hanë ushqim Buddhist apo se janë vegjetarianë, që sugjeron se ata janë Buddhistë vegjetarianë. Ata e marrin kultivimin e Buddhës si diçka kaq të thjeshtë. Si mund të qënit vegjetarian ta bëjë një person të kultivohet në Buddhë? Të gjithë e dinë se të ngrënit e mishit është veçse një ves dhe një dëshirë—ai është veçse një ves. Të qënit vegjetarianë heq vetëm këtë ves. Personit akoma i duhet të heqë dorë nga zilia, mentaliteti i konkurrencës, zelli i tepruar, mentaliteti për t'u dukur dhe shumë vese të tjera; ekzistojnë vese të shumta njerëzore. Vetem duke i hequr të gjitha veset dhe dëshirat mundet një njeri të përfundojë praktikën kultivuese. Si mund të kultivohet në një Buddhë një person duke hequr dorë vetëm nga dëshira për të ngrënë mish? Kjo nuk mund të bëhet.

Përsa i përket ushqimit, përveç të ngrënit e mishit personi nuk duhet të jepet pas asnjë ushqimi tjetër. Kjo është e vërtetë dhe për çdo gjë tjetër. Disa njerëz thonë se atyre u pëlqen të hanë një ushqim të caktuar—edhe kjo është një dëshirë. Pasi arrin një nivel të caktuar në kultivim, një praktikues nuk do ta ketë këtë dëshirë. Sigurisht, Ligji ynë u mësohet njerëzve në nivel shumë të lartë dhe u mësohet duke integruar nivele të ndryshme. Është e pamundur që dikush ta arrijë këtë shkallë menjëherë. Ti pretendon se vetëm dëshiron të hash atë lloj ushqimi, por kur kultivimi juaj të arrijë kohën për të hequr dorë me të vërtetë nga ky ves, ju nuk do të jeni në gjendje ta hani atë. Nëqoftëse ju e hani atë, ai nuk do të ketë shije të mirë dhe mund t'ju duket si shija e çfarëdo gjëje tjetër. Kur unë shkoja në punë, menca e punës gjithmonë humbte para dhe më vonë u mbyll fare. Pasi u mbyll, të gjithë e sillnin drekën me vete. Ishte bela e madhe dhe goxha punë për të përgatitur ushqim në mëngjes. Ngandonjëherë, unë bleja dy kuleçë të gatuar në avull dhe një copë tofu³ në salcë soje. Në teori, ky duhej të ishte ushqim shumë i lehtë, por të hash atë gjithmonë përsëri nuk ishte mirë sepse dëshira duhet të braktiset. Kështu sapo shihja tofu me sy, më vinte pështirë. Nuk e haja dot kur e provoja gjë që nuk më lejonte të zhvilloja vesin. Sigurisht, kjo do të ndodhë vetëm kur personi të ketë arritur një nivel të caktuar në praktikën kultivuese. Nuk do të jetë kështu që në fillim.

Shkolla Buddhës nuk e lejon pirjen e alkolit. A keni parë ndonjëherë një Buddha duke mbajtur një shishe me verë? Kurrë. Unë kam thënë se një person mund të mos jetë në gjendje të hajë mish, por pasi ai heq dorë nga vesi gjatë praktikës kultivuese në mes të njerëzve, nuk ka problem që ai ta hajë atë përsëri. Por pasi heq dorë nga pirja alkolit, një individ nuk duhet të pijë përsëri. A nuk ka një praktikues gong në trup? Forma të ndryshme gongu dhe disa aftësi supernormale shfaqen në sipërfaqe të trupit tuaj dhe ato janë të tëra të pastra. Sapo të pish alkol, ato do të largohen të gjitha nga trupi menjëherë. Për një sekondë dhe trupit tuaj nuk do t'i mbetet asgjë, sepse ato nuk e durojnë dot erën. Është shumë e pështirshme po të jepesh pas këtij zakoni, sepse pirja e alkolit mund ta bëjë personin të humbë arsyen. Pse disa praktika kultivuese Taoiste të Mëdha kërkojnë të pish alkol? Kjo ndodh sepse ato nuk kultivojnë Shpirtin Kryesor të personit dhe të pirët mund ta bëjnë Shpirtin Kryesor të humbë vetëdijen.

Disa njerëz e duan alkolin sa dhe jetën a tyre. Disa njerëzve u pëlqen të pinë alkol. Disa njerëz janë tashmë të helmuar nga pirja alkolit dhe nuk hanë asnjë ushqim pa pirë—ata nuk jetojnë dot pa pirë. Si praktikues, ne nuk duhet të jemi kështu. Pirja alkolit është pa dyshim një ves. Është dëshirë dhe stimulon nervat e vesit të personit. Sa më shumë një personi pin, aq më shumë jepet ai pas tij. Le të mendojmë pak: Si praktikues, a nuk duhet të heqim dorë ne nga ky ves? Ky është ves që duhet

³ tofu—ushqim tradicional kinez që përgatitet nga qumështi i sojës. Duket si djathë por nuk ka të njëjtën shije.

hequr. Dikush mund të mendojë: “Kjo është e pamundur sepse unë jam përgjegjës për të kënaqur klientët,” apo “Unë kam përgjegjësinë për të kryer kontaktet e biznesit. Nuk është e lehtë të bësh pazar pa pirë alkol.” Unë do të thoja se mund të mos jetë me të vërtetë ashtu. Zakonisht, në kryerjen e një marëveshjeje biznesi, veçanërisht në biznes me të huajt, ti mund të kërkosh një pije freskuese, ai apo ajo mund të kërkojë një ujë mineral dhe një person tjetër mund të kërkojë një birra. Askush nuk do t’ju detyrojë të pini alkol. Ti e zgjedh vetë dhe pin aq sa don. Veçanërisht midis intelektualësh, një gjë e tillë ndodh rallë. Zakonisht është kështu.

Pirja e duhanit është gjithashtu një ves. Disa njerëz thonë se pirja e duhanit i shploh, por unë e quaj këtë të gënjesh veten dhe të gënjesh të tjerët. Kur ndjehet i lodhur nga puna apo nga të shkruajturit e diçkaje, një personi mund të dojë të bëjë pushim duke pirë një cigare. Pasi pin cigaren, ai ndjehet i shplohur. Në fakt, nuk është e vërtetë. Kjo ndodh ngaqë ai bëri pushim. Mëndja njerëzore mund të krijojë një ndjesi të rreme dhe iluzion që më pas mund të bëhet me të vërtetë koncept apo ndjesi e rreme se të pirit e duhanit të freskon. Ajo nuk e bën aspak këtë dhe as që mund të ketë këtë efekt. Pirja e duhanit nuk i bën ndonjë të mirë trupit të njeriut. Nëqoftëse një person pin për një kohë të gjatë, në kohën e autopsisë një mjek do të gjejë që trakea dhe mushkëritë janë të komplet të zeza.

A nuk duam ne praktikuesit të pastrojmë trupat tanë? Ne duhet që vazhdimisht të pastrojmë trupat tanë dhe vazhdimisht të përparojmë drejt niveleve të larta. E megjithatë ti akoma i fut trupin tënd atë, a nuk po shkon ti kështu në drejtim të kundërt nga ne? Për më tepër, kjo është dhe një dëshirë e fortë. Disa njerëz e dinë që nuk është i mirë, por nuk e lënë dot. Në fakt, më lejoni t’ju them se ata nuk kanë mendime të drejta që të udhëheqin veten dhe nuk do jetë e lehtë për ta që të heqin dorë. Si praktikues, pse nuk e konsideron ti atë si ves që duhet të hiqet dhe të shikosh nëse mund ta heqësh? Ju këshilloj të gjithëve që nëse me të vërtetë doni të praktikoni kultivim ju duhet të leni duhanin që nga ky çast dhe është e garantuar se mund ta leni. Në fushën e kësaj klase, askujt nuk i shkon mendja të pijë cigare. Nëse doni ta leni, është e garantuar se mund ta bëni këtë. Kur të pini përsëri cigare, ajo do të ketë shije të keqe. Po të lexoni këtë leksion në libër, do të ketë të njejtin efekt. Sigurisht, nëqoftëse nuk doni të praktikoni kultivim, ne nuk do të kujdesemi për ju. Unë mendoj se si praktikues, ju duhet të hiqni dorë. Unë kam përdorur këtë shembull më parë: A keni parë ndonjëherë një Buddha apo Tao me cigare në gojë? Si mund të jetë kjo e mundur? Si praktikues, cili është qëllimi juaj? A nuk duhet ta leni ju atë? Prandaj, unë kam thënë se nëse doni të praktikoni kultivim, ju duhet ta leni duhanin. Ai ju dëmton trupin dhe është gjithashtu një ves. Ajo është plotësisht e kundërta e asaj që duhet të bëjë një praktikues.

Zilia

Kur unë u mësoj njerëzve Ligjin, unë shpesh përmend çështjen e zilisë. Pse e bëj unë këtë? Sepse zilia është shumë e fortë në Kinë. Është kaq e fortë saqë është bërë e natyrshme dhe njerëzit as që e kuptojnë këtë. Pse kanë kinezët kaq zili të madhe? Kjo ka rrënjët e veta. Kinezët në të kaluarën janë ndikuar shumë nga Konfucionizmi dhe ata zhvilluan një temperament të mbyllur. Kur janë të zemëruar apo të gëzuar, ata nuk e shprehin këtë. Ata besojnë në vetkontroll dhe tolerancë. Ngaqë janë mësuar në këtë mënyrë, kombësia kineze në tërësi ka zhvilluar një temperament shumë të mbyllur. Sigurisht, kjo ka avantazhet e veta, sepse një person i tillë nuk mburret për fuqitë e brendshme. Por ka gjithashtu dhe disavantazhe dhe mund të sjellë efekte negative anësore. Veçanërisht në këtë Periudhë të Fundit-Dharmës, aspektet e saj negative kanë dalë më në pah dhe mund të inkurajojnë thellimin e zilisë së personit. Nëqoftëse dikush ka lajmet e mira dhe ja bën të ditur të tjerëve, të tjerët menjëherë do bëhen xhelozë. Disa njerëz kanë frikë të përmendin çmimet apo fitimet e tyre nga puna apo gjetkë, se mos të tjerët ndjehen keq pasi dëgjojnë lajmin. Perëndimorët e quajnë këtë “zili orientale” apo “zili

aziatike”. I gjithë rajoni i Azisë është pak a shumë kështu, prej influencës së Konfucionizmit kinez. Veçanërisht në Kinë ajo shfaqet akoma më e fortë.

Kjo zili lidhet në një farë mënyre me barazinë absolute që ne praktikojmë dikur: Nëqoftëse toka përmbysset, në fund të fundit, të gjithë do të vdesin; të gjithë duhet të marrin një pjesë të barabartë nëqoftëse ka ndonjë gjë të mirë; të gjithë duhet të marrin rritje të barabartë rroge, pamvarësisht nga përqindja e rritjes. Ky mentalitet duket sikur është i drejtë kur secili trajtohet i barabartë. Në fakt, si qenkan njerëzit të njejtë? Puna që bëjnë është e ndryshme, po ashtu dhe mënyra si i kryejnë ata përgjegjësitë e tyre. Ekziston një parim në këtë univers që quhet, “po nuk humbe nuk fiton”. Që të fitojë, njeriu duhet të humbë. Njerëzit besojnë se njeriu nuk fiton po nuk punoi për diçka. Sa më shumë punë, aq më shumë fitim, më pak punë do të thotë më pak fitim. Sa më shumë të përpiqet njeriu, aq më shumë fitim meriton. Barazia absolute e praktikuar në të kaluarën pretendonte se njerëzit kanë lindur të barabartë dhe është jeta pas lindjes që e ndryshon atë. Mua më duket kjo shprehje tepër absolute. Kur çfarëdolloj gjëje bëhet absolute, ajo bëhet e gabuar. Pse atëhere disa njerëz lindin meshkuj e disa femra? Pse nuk ngjajnë njësoj ata? Njerëzit nuk lindin të njejtë, sepse disa lindin të sëmurë e disa të shtrembëruar. Nga nivele të larta, ne shikojmë se e tërë jeta e një personi ekziston atje në një dimension tjetër. Si mund të jenë njerëzit të njejtë atëhere? Të gjithë njerëzit kanë dëshirë të jenë të barabartë. Nëqoftëse diçka nuk është pjesë e jetës së dikujt, si mund të bëhen ata të barabartë atëhere? Njerëzit nuk janë njëlloj.

Personalitetet e njerëzve nga vendet perëndimore janë relativisht më të hapur. Mund ta kuptosh kur ata janë të gëzuar apo kur janë të zemëruar. Kjo ka avantazhet e veta, por ka gjithashtu dhe disavantazhe dhe mund të rezultojë në mungesë vetpërmbajtjeje. Meqenëse dy temperamentet janë të ndryshme në mënyrën e të menduarit, ato sjellin dhe rezultate të ndryshme në kryerjen e gjërave. Nëqoftëse një kinez lavdërohet nga përgjegjësi apo i jepet ndonjë gjë e mirë, mëndjet e të tjerëve do humbin qetësinë. Kur ai merr një bonus më të madh, ai më mirë e fut në xhep fshehurazi pa ja treguar njeriu. Sot, është e vështirë të jesh punëtor i dalluar. “Ti je punëtor model. Ti je më i miri në punë. Ti duhet të vish herët në mëngjes dhe të ikësh natën vonë. Ti duhet ta bësh të gjithë punën meqenëse je i zoti. Ne nuk jemi kaq të mirë sa ty.” Njerëzit do bëhen sarkastikë dhe cinikë dhe kështu nuk është e lehtë as të jesh njeri i mirë.

Nëqoftëse kjo ndodh në vende të tjera, do ishte krejtësisht e kundërta. Nëqoftëse përgjegjësi do të shohë se ky punëtor bën punë të mirë, ai mund t’i japë atij një bonus më të madh. Ky i fundit me gëzim numëron paratë para të tjerëve: “Ej, kapo më dha gjithë këto para sot.” Ai gjithë gëzim i tregon të tjerëve për to pa ndonjë pasojë. Nëqoftëse kjo do ndodhte në Kinë që dikush të fitonte një bonus ekstra, përgjegjësi madje do t’i thonte personit që ta fshihte dhe të mos lejonte të tjerët që t’ja shihnin. Në vende të tjera, nëqoftëse një fëmijë merr njëqind pikë në një provim, ai do vrapojë për në shtëpi me gëzim duke thirrur: “Mora njëqind pikë sot! Mora njëqind!” Fëmija do vrapojë për në shtëpi gjithë rrugës nga shkolla. Një komshi do hapë derën dhe thotë: Hej, Tom, djalë i mbarë.” Një komshi tjetër mund të hapë dritaren: “Hej, Jack, të lumtë. Djalë i mbarë.” Po të ndodhte kjo në Kinë, do të ishte katastrofike. “Kam marrë njëqind, kam marrë njëqind.” Fëmija vrapon për në shtëpi nga shkolla. Që para se të hapte derën, një komshi do kish filluar të mallkonte nëpër shtëpi: “E ç’ka këtu për t’u mburrur që ke marrë njëqind? Mburravec! E kush nuk ka marrë njëqind!” Dy mentalitetet do sjellin rezultate të ndryshme. Kështu kjo mund të nxisë xhelozinë e të tjerëve, sepse kur dikujt po i ecën mbarë, në vend që të ndjehen të gëzuar për të, mëndja e njerëzve do fillojë të humbë qetësinë. Mund të sjellë pra këtë problem.

Pak vite më parë, praktikohesh barazia absolute dhe kjo i ka prishur mëndjet dhe vlerat e njerëzve. Më lejoni t’ju jap një shembull konkret. Në vendin e punës, një personi mund t’i duket se të tjerët nuk janë aq të zotë sa ai. Çfarëdo që ai bën, ai e bën mirë. Atij me të vërtetë i duket vetja i jashtëzakonshëm. Ai mendon me vete: “Jam i kualifikuar për t’u bërë drejtor fabrike apo përgjegjës, apo dhe një pozitë më të lartë. Mendoj se mund të bëhem edhe kryeministër.” Edhe përgjegjësi mund

të thotë se ky person është me të vërtetë i aftë dhe mund të bëjë çdo gjë. Kolegët po ashtu mund të shprehin se ai është me të vërtetë i aftë dhe i talentuar. Por mund të jetë një person tjetër në të njëjtin grup pune apo në të njëjtën zyrë me atë i cili është i pazoti për të bërë gjë apo nuk ja thotë fare. Megjithatë një ditë ky person i paaftë ngrihet në përgjegjësi në vend të tjetrit madje bëhet dhe përgjegjësi i tij. Ai do preket në zemër dhe do i duket e padrejtë dhe ankohet tek shefi dhe kolegët me një ndjenjë zemërimi të madh dhe me mjaft xhelozë.

Unë po ju them këtë parim që njerëzit e zakonshëm nuk janë në gjendje ta kuptojnë. Ju mund të mendoni se jeni i mirë në çdo gjë, por nuk është fati juaj. Ai personi tjetër nuk është për asgjë, por është fati i tij dhe ai bëhet përgjegjës. Pamvarësisht se çfarë mendojnë njerëzit, kjo është vetëm pikëpamja e njerëzve të zakonshëm. Nga perspektiva e një jete më të lartë, zhvillimi i shoqërisë njerëzore ecën sipas një ligji specifik të zhvillimit. Prandaj, ajo që personi bën në jetë nuk përcaktohet në bazë të aftësive të personit. Buddhizmi beson në parimin e shpagimit karmik. Jeta e një personi përcaktohet sipas karmës së tij. Pamvarësisht sa i zoti je, po nuk pate virtyt, mbase ti nuk do të kesh asgjë në këtë jetë. Ti mendon se një person tjetër nuk është për asgjë, por ai ka plot virtyt. Ai mund të bëhet një ushtarak i lartë apo të bëjë pasuri të madhe. Një njeri i zakonshëm nuk e sheh këtë pikë dhe gjithmonë beson se ai duhet të bëjë atë që është i aftë të bëjë. Prandaj, ai konkuron dhe lufton tërë jetën e vet me zemër të lënduar keq. Ai mund të ndjehet shumë i zemëruar dhe lodhur, duke ju dukur gjërat gjithmonë të padrejta. Duke mos qënë në gjendje të hajë e flejë mirë, ai ndjehet i trishtuar dhe i zhgënjyer. Kur plaket, ai përfundon me shëndet të keq dhe të gjitha llojet e sëmundjeve do i shfaqen.

Kështu, praktikuesit tanë nuk duhet të jenë të tillë, sepse një praktikues duhet të ndjekë rrjedhën e natyrshme të gjërave. Nëqoftëse diçka është e juaja, ju nuk do ta humbni atë. Nëqoftëse diçka nuk është e juaja, ju nuk do ta merrni edhe sikur të luftoni për të. Sigurisht, kjo nuk është absolute. Po të ishte aq absolute, nuk do ekzistonte çështja e bërjes keq. Me fjalë të tjera, ekzistojnë disa faktorë të pastabilizuar. Por si praktikues, ju jeni në parim të mbrojtur nga Fashen i Mësuesit. Të tjerët nuk mund të marrin atë që është juaja edhe sikur të donin. Prandaj ne besojmë në ndjekjen e rrjedhës së natyrshme të gjërave. Shpesh, ju mendoni se diçka duhet të jetë e juaja dhe të tjerët gjithashtu ju thonë se ju takon. Në fakt, nuk është kështu. Ju mund të besoni se është e juaja, por në fund të fundit nuk është e juaja. Me anë të kësaj, do shihet nëse ju mund të hiqni dorë. Nëqoftëse nuk e lëshoni dot, kjo është dëshirë. Kjo metodë duhet përdorur për t'ju hequr dëshirën për interes personal. Kështu është çështja. Ngaqë njerëzit nuk e kuptojnë këtë parim, ata do të konkurojnë dhe luftojnë për fitim.

Në mes të njerëzve, zilia shfaqet haptas. Është shumë e dukshme edhe në komunitetin e kultivuesve. Nuk ka respekt në mes të praktikave të ndryshme të qigongut, si për shembull “praktika jote është e mirë” apo “praktika e tij nuk është e mirë”—bëhen si komente pozitive ashtu edhe negative. Sipas mendimit tim, ato të gjitha i takojnë nivelit të shërimit dhe mbajtjes së trupit në formë. Nga ato praktika që shajnë njëra tjetrën, shumica janë praktika kaotike, shpirttrash zotërues apo të krijuara në bazë të lëvizjeve të kafshëve dhe ato nuk duan t'ja dinë për karakterin. Një person mund të ketë praktikuar qigong për më shumë se njëzet vjet pa zhvilluar asnjë aftësi supernormale, ndërsa një person tjetër i merr ato sapo fillon praktikën. Ky person do ta shikojë këtë si të padrejtë: “Unë kam praktikuar për mbi njëzet vjet pa zhvilluar asnjë aftësi supernormale ndërsa ai i zhvillon ato menjëherë. Çfarë lloj aftësish supernormale ka marrë ai?” Ky person do të tërbohët: “Atë e ka zënë ndonjë shpirt apo kafshë zotëruese dhe po kalon në marrosje nga kultivimi!” Kur një mjeshtër qigongu mëson një klasë, dikush mund të ulet atje me mosrespekt: “Oh, e ç'mjeshtër qigongu është ky? As nuk jam i interesuar të dëgjoj çfarë thotë.” Mjeshtri qigongut me të vërtetë mund të mos jetë i aftë të flasë më mirë se ky person. Por ato që thotë mjeshtri i qigongut janë diçka nga shkolla e tij e praktikës. Ky person studjon çdo gjë dhe ka ndjekur klasat e çdo mjeshtri qigong me një tufë certifikatash mbarimi kursesh. Me të vërtetë, ky person din plot gjëra më shumë sesa ky mjeshtër

qigongu. Por për çfarë vlejné ato? Ato janë të gjitha për shërim dhe mbajtje trupit në formë. Sa më shumë mbushet personi me to, aq më rrëmujë dhe komplekse bëhen mesazhet dhe aq më e vështirë do jetë që ai të praktikojë kultivim—është bërë lëmsh e li. Praktika kultivuese e vërtetë mëson se duhet të ndjekësh vetëm një mënyrë kultivimi dhe të mos shkosh në rrugë të gabuar. Ky fenomen gjithashtu ndodh edhe në mes të praktikuesve të vërtetë, sepse mosrespekti për njeri-tjetrin dhe mos eliminimi i dëshirës për të konkuruar mund të çojnë me lehtësi në zili.

Po ju tregoj një histori. Në librin *Inaugurimi i Zotëve*⁴, Shen Gongbao⁵-s i dukej se Jiang Ziya⁶ ishte si plak ashtu dhe i paaftë. Por Zoti Primordial i Qiellit i tha Jiang Ziya-së t'i vërë titujt Zotëve. Shen Gongbao-s ju duk kjo e padrejtë: “Pse iu kërkua atij t'i japë titujt Zotëve? E shikoni sa i zoti jam unë. Unë mund ta vendos kokën përsëri pasi të më jetë prerë. Pse nuk mu kërkua mua t'u jepja titujt Zotëve?” Ai u bë kaq shumë xheloz sa gjithmonë i krijonte trazira Jiang Ziya-së.

Buddhizmi origjinal i kohës së Sakyamunit i përmendte aftësitë supernormale. Në Buddhizmin e ditëve tona, askush nuk guxon të përmendë më aftësitë supernormale. Po të përmendësh aftësitë mbinatyrale, ata do të thonë se ke marrosje nga kultivimi. “Çfarë aftësish supernormale?” Ata nuk i pranojnë ato aspak. Pse ndodh kjo? Në kohën tonë, as murgjit nuk dinë më çfarë janë ato. Sakyamuni kishte dhjetë dishepuj kryesorë meshkuj, nga të cilët Mujianlian mbahej prej tij si numër një në aftësi mbinatyrale. Sakyamuni gjithashtu kishte dhe dishepuj femra, mes të cilave Lianhuase ishte numër një në aftësi mbinatyrale. E njëjta gjë ishte e vërtetë kur Buddhizmi u prezantua në Kinë. Në histori ka pasur shumë murgj të arrirë. Kur Boddhidarma erdhi në Kinë, ai e kaloi lumin i hipur mbi një tufë kallamash. Megjithatë me kalimin e kohës, aftësitë mbinatyrale kundërshtohen gjithnjë e më shumë. Arësyeja kryesore është se persona si murgjit e vjetër, mbikqyrësit apo abotët në tempuj nuk kanë ndonjë cilësi të madhe të lindur. Megjithëse ata janë abotë apo murgj të vjetër, këto janë vetëm pozita njerëzish. Ata janë gjithashtu praktikues, veçse ata janë profesionistë. Ju praktikoni kultivim në shtëpi si amatorë. Nëse dikush arrin sukses në kultivim kjo varet plotësisht nga kultivimi i mendjes. Kjo është e vërtetë për të gjithë dhe askush nuk mund të bie poshtë standartit sikur edhe pak. Por një murg i ri që gatuan ushqimet mund të ketë cilësi të lindur të mirë. Sa më shumë që murgu i ri vuan, aq më e lehtë është për të që ai të arrijë Çbllokimin e Gongut. Sa më rehat që jetojnë murgjit e vjetër, aq më e vështirë është për ta të arrijnë stadin e Çbllokimit të Gongut sepse ekziston çështja e transformimit të karmës. Murgu i ri punon gjithmonë shumë dhe pa u lodhur. Ai e ripagon karmën më shpejt dhe arrin lartësimin shpirtëror. Mbase një ditë ai arrin Çbllokimin e Gongut krejt papritur. Me këtë Çbllokim të Gongut, lartësim shpirtëror apo gjysmë-lartësim, aftësitë e tij mbinatyrale do të shfaqen të gjitha. Murgjit në tempull do vinë të gjithë t'i bëjnë pyetje dhe të gjithë do e respektojnë. Por aboti nuk do e duronte dot këtë: “Si mund të jem unë akoma abot? Çfarë lartësimi shpirtëror? Ai ka kaluar në marrosje nga kultivimi. Përzejeni prej këtu.” Kështu tempulli e përzen murgun e ri. Me kalimin e kohës, askush në Buddhizmin kinez nuk guxon më të përmendë aftësitë supernormale. Ju e dini sa i aftë ishte Jigong. Ai mund të lëvizte trungjet e pemës nga Mali Emei dhe mund t'i flakte ato trungje nga pusi⁷ një nga një. Megjithatë në fund ai prapsepap u përzu nga Tempulli Lingyin.

Çështja e zilisë është shumë serioze sepse lidhet direkt me çështjen nëse ju do të mund ta përfundoni praktikën kultivuese. Nëse zilia nuk liqet, çdo gjë që keni kultivuar do bëhet e paqëndrueshme. Ekziston ky rregull: Nëqoftëse gjatë kursit të praktikës kultivuese nuk hiqet dorë nga zilia, personi nuk do të arrijë dot Shkallën e Duhur—absolutisht jo. Mbase keni dëgjuar më parë se Buddha Amitabha pat folur që mund të shkohet në parajsë me karmë. Por kjo nuk do të ndodhë pa hequr dorë nga zilia. Mund të jetë e mundur që dikush të ketë mangësira në disa anë të tjera dhe

⁴ *Inaugurimi i Zotëve*—një vepër klasike artistike kineze.

⁵ Shen Gongbao—një personazh xheloz në *Inaugurimi i Zotëve*.

⁶ Jiang Ziya—një personazh në *Inaugurimi i Zotëve*.

⁷ Mali Emei—është rreth një mijë milje nga Tempulli Lingyin ku ndodhej pusi.

shkon në parajsë me karma për kultivim të mëtejshëm. Por është absolutisht e pamundur nëqoftëse nuk braktiset zilia. Sot unë u them praktikuesve se ju nuk duhet ta leni veten në errësirë pa e kuptuar këtë problem. Qëllimi që doni të arrini është të praktikoni kultivim drejt nivelesh të larta. Vesi i zilisë duhet hequr, kështu e kam veçuar këtë çështje në këtë leksion.

Çështja e Trajtimit të Sëmundjeve

Përsa i përket trajtimit të sëmundjeve, unë nuk ju mësoj të trajtoni sëmundje. Asnjë dishepull i vërtetë i Falun Dafës nuk duhet të trajtojë sëmundjet e të tjerëve. Sapo të trajtosh një sëmundje, të gjitha gjërat në trupin tuaj nga Falun Dafa do t'ju merren mbrapsht nga Fashen e mi. Pse kjo çështje konsiderohet kaq serioze? Sepse është një fenomen që dëmton Dafën. Ju do të dëmtoni më shumë se shëndetin tuaj. Sapo disa persona do të shëronin një sëmundje, ata nuk do duronin e do e bënin përsëri. Ata do marrin këdo që do gjenin për t'i trajtuar sëmundjet dhe të mburreshin me aftësitë e tyre. A nuk është kjo një dëshirë? Kjo do e pengonte seriozisht praktikën kultivuese të personit.

Shumë mjeshtër qigongu të rremë kanë përfutuar nga dëshira e njerëzve për të shëruar pacientë pasi mësojnë qigong. Ata do t'ju mësojnë juve këto gjëra dhe pretendojnë se duke lëshuar qi një person do të mund të shërojë sëmundje. A nuk është kjo për të qeshur? Ti ke qi dhe ai tjetri ka qi. Si mund ta trajtosh ti atë me qi-në tënde? Mbase qi-ja e tij do e mundë tëndin! Nuk ka kufizim ndërmjet një qi-je dhe një tjetër. Kur një person zhvillon gong në kultivim të nivelit të lartë, ajo që zhvillon ai është materie me energji të lartë që mund të shërojë, përmbajë dhe kontrollojë një sëmundje me të vërtetë, por nuk mund të heqë shkakun e sëmundjes. Prandaj, që të shërosh një sëmundje me të vërtetë dhe plotësisht duhen aftësi supernormale. Ekziston një aftësi supernormale e veçantë për të kurrar çdo sëmundje. Në lidhje me aftësitë supernormale për shërimin e sëmundjeve, unë do të thoja se janë mbi një mijë lloje dhe se ka aq aftësi supernormale sa dhe sëmundje. Pa këto aftësi supernormale është e kotë pamvarësisht sa i aftë të jetë trajtimi juaj.

Në vitet e fundit, disa njerëz e kanë futur në kaos komunitetin e kultivuesve. Nga ata mjeshtër të vërtetë qigongu të cilët dolën në publik për të shëruar njerëzit dhe për t'i mbajtur trupin atyre në formë apo nga ata që hapën rrugën në fillim, cili prej tyre u mësoi njerëzve të trajtonin pacientë? Ose ishin ata që e shëronin sëmundjen tuaj, ose ju tregonin juve si të praktikoni kultivim dhe si të mbaheni vetë në formë. Ata ju mësuuan një sistem ushtrimesh dhe pastaj ju mund të shëronit sëmundjet nëpërmjet praktikës suaj. Më pas, mjeshtër qigongu të gënjeshtërt dolën në publik dhe krijuan këtë rrëmujë. Kushdo që dëshiron të trajtojë pacientë me qigong do të tërheqë shpirta apo kafshë zotëruese—është plotësisht kështu. Në kushtet e asaj kohe, disa mjeshtër qigongu trajtuan disa pacientë. Kjo ndodhi që të bashkëpunohej me klimën kozmike të asaj kohe. Megjithatë qigongu nuk është një aftësi e njerëzve të zakonshëm dhe ai fenomen nuk mund të vazhdonte përgjithmonë. Ai ishte rezultat i ndryshimeve të klimës kozmike të asaj kohe; ishte vetëm një prodhim i asaj periudhe kohe. Më pas, disa njerëz e specializuan veten që t'i mësojnë të tjerëve të trajtojnë sëmundje, duke krijuar kështu një kaos. Si mundet një person i zakonshëm të mësojë të trajtojë një sëmundje për tre apo pesë ditë? Dikush pretendon: “Unë mund të shëroj këtë sëmundje apo atë sëmundje.” Më lejoni t'ju them se këta njerëz të gjithë kanë shpirta dhe kafshë zotëruese. A e dinë ata se çfarë i është ngjitur në kurriz? Ata kanë shpirt apo kafshë zotëruese, por ata as e ndjejnë dhe as e dinë këtë. E megjithatë ata mund të ndjehen shumë mirë dhe mendojnë se janë shumë të aftë.

Mjeshtrit qigong të vërtetë duhet të kalojnë shumë vite të vështira kultivimi në mënyrë që të arrijnë këtë qëllim. Kur ju trajtoni një pacient, a e keni menduar ndonjëherë nëse ju i keni apo jo ato aftësi supernormale të fuqishme për të eliminuar karmën e këtij personi? A keni marrë ndonjëherë mësim të vërtetë? Si mund të mësoni ju si shërohen sëmundjet në tre apo pesë ditë? Si mund të shëroni ju një sëmundje me duart e një personi të zakonshëm? Një mjeshtër i tillë i rremë qigongu ka

përfitur nga debulesa juaj dhe nga dëshirat njerëzore. A nuk kërkon ju të shëroni sëmundje? E po mirë, ky person do të organizojë një klasë trajtimi që pikërisht ju mëson juve disa teknika shërimi, si për shembull gjilpërën prej qi-je, metodën e terapisë së dritës, zhkarkimin e qi-së, kompensimin e qi-së, të ashtuquajturin akupresion dhe të ashtuquajturën metodë të mbërthimit me dorë. Ka një variete metodash që synojnë të marrin paratë tuaja.

Le të flasim për metodën e mbërthimit me dorë. Ajo që kemi vënë re është situata e mëposhtme. Pse sëmuren njerëzit? Shkaku themelor i të qënies sëmurë dhe të gjithë fatkeqësive të tjera të personit është karma dhe fusha karmike e kësaj substance të zezë. Është diçka negative dhe e keqe. Edhe qëniet e këqija që rrinë aty janë gjithashtu negative dhe të zeza. Kështu, ato vijnë në trupin tuaj ngaqë ky ambient i përshtatet atyre. Kjo është arsyeja themelore e të qënies sëmurë të njeriut; ky është burimi më kryesor i sëmundjeve. Sigurisht, ka dhe dy forma të tjera. Njëra është një qenie shumë mikroskopike me densitet shumë të lartë që është si një grumbull karme. Forma tjetër është sikur karma vjen me tub, por kjo shihet rrallë; kjo e fundit është e gjitha e grumbulluar nga paraardhësit e personit. Ka gjithashtu dhe nga këto raste.

Le të flasim për sëmundjet më të zakonshme. Dikush mund të ketë në trup një tumor, një infeksion, një kockë të ngritur etj. Kjo ndodh ngaqë në një dimension tjetër gjendet një qenie në atë vend. Ajo qenie ndodhet në një dimension shumë të thellë. Një mjeshtër qigongu i zakonshëm apo një aftësi e zakonshme supernormale nuk është në gjendje ta diktojë atë; ata vetëm mund të shikojnë qi të zezë në trupin e personit. Është e drejtë të themi se kudo ku ka qi të zezë, ka sëmundje. Megjithatë qi-ja e zezë nuk është shkaku kryesor i një sëmundjeje. Kjo ndodh ngaqë gjendet një qenie në një dimension të thellë e cila lëshon këtë fushë. Kështu disa njerëz flasin për zhdukje dhe heqje të qi-së së zezë—shko dhe hiqe po të duash! Menjëherë pas kësaj, ajo do të rikrijohet përsëri sepse disa qenie janë shumë të fuqishme dhe mund të ritërheqin qi-në sapo ajo hiqet; ato mund ta rimarrin vetë. Trajtimet nuk bëjnë gjë pamvarësisht si aplikohen.

Sipas një personi që shikon me aftësi mbinatyrale, kudo ku ka qi të zezë, ai vend konsiderohet të ketë qi sëmundjeje. Një mjek i mjekësisë kineze do të shohë se kanalet e energjisë janë të bllokuara në atë vend, sepse qi dhe gjaku nuk qarkullojnë dhe kanalet e energjisë bllokohen. Për një mjek të mjekësisë perëndimore, ai vend jep simptomën e një ulçere, tumorri, dalje kocke apo infeksioni etj. Kur shfaqet në këtë dimension, ka këtë formë. Pasi të hiqni qënien që është aty, ju do të shihni se nuk ka asgjë që nuk shkon me trupin në këtë dimension. Qoftë dalja e disqeve ndërvertebrare apo kocka e ngritur, pasi të jetë hequr ajo qenia dhe të jetë pastruar fusha, ju do të gjeni se është shëruar menjëherë. Mund të bëni një grafi tjetër dhe të shihni se kocka e ngritur është zhdukur. Arsyeja themelore është se kjo qenie e shkaktonte atë.

Disa njerëz pretendojnë se duke ju mësuar juve metodën e mbërthimit me dorë për tre apo pesë ditë, ju mund të kuroni sëmundje. Pa na e tregoni metodën tuaj të mbërthimit me dorë! Qëniet njerëzore janë më të dobta ndërsa ajo qenia është tepër e frikshme. Mund të kontrollojë mendjen tuaj dhe të të manipulojë me lehtësi sipas dëshirës. Madje mund t'i japë fund jetës suaj me lehtësi. Ti pretendon se mund ta kapësh atë. Si e kap? Ti nuk mund ta arrish me duart e tu prej njeriu të zakonshëm. Ti mund të kapësh më kot atje dhe ajo nuk do të të përfillë dhe do të qeshë me ty pas shpinës tënde—të kapësh ashtu me kot është për të qeshur. Nëqoftëse me të vërtetë mund ta prekësh atë, do të të dëmtojë duart menjëherë. Kjo do të jetë një plagë e vërtetë! Kam parë dikur njerëz dy duart e të cilëve dukeshin normalë në të examinar. Si trupi ashtu dhe dy duart nuk ishin sëmurë, por ata nuk mund t'i ngrinin dot duart që u rrinin ashtu të varura. Kam hasur në pacientë të tillë: Ishte dëmtuar trupi i tyre në një dimension tjetër—në këtë rast një person do të ishte me të vërtetë i paralizuar. Nëqoftëse trupi juaj është dëmtuar, a nuk jeni paralizuar ju? Disa njerëz më pyesin: “Mësues, a do mund të praktikoj unë qigong? Kam pasur një operacion sterilizimi,” apo “Kam hequr diçka nga trupi.” Unë u them, “Nuk ka rëndësi përderisa trupi juaj në një dimension tjetër nuk ka patur ndonjë operacion dhe në praktikën e qigongut ai është trupi mbi të cilin veprohet.” Kështu, sapo

thashë që kur ju mundoheni ta kapni atë qënien, ajo nuk do t'ja dijë nëse nuk e arrini dot. Nëse e prekni, mund t'ju dëmtojë duart.

Për të mbështetur një aktivitet të madh të organizuar nga shteti, unë mora me vete disa dishepuj për të marrë pjesë në Ekspozitat Orientale të Shëndetit në Beijing. Në të dyja Ekspozitat, ne ishim praktika më e dalluar. Në Ekspozitën e parë, Falun Dafa u nderua si “Shkolla Qigong me Yll”. Në Ekspozitën e dytë, vendi ku ishim ne ishte kaq plot sa ne nuk mund ta përballonim dot. Nuk kishte shumë njerëz në tavolinat e tjera, të dy tavolinat tona ishin plot me njerëz. Ishin tre radhë që pritnin: rreshti i parë ishte me ata që ishin rregjistruar herët në mëngjes për trajtimin e mëgjesit, rreshti i dytë priste të rregjistrohej për trajtimin e mbasditës dhe rreshti i tretë priste për autografin tim. Ne nuk trajtojmë sëmundje. Pse e bëmë ne këtë atëhere? Sepse kjo ishte për të mbështetur një aktivitet të rëndësishëm qigongu të organizuar nga shteti dhe për të kontribuar në këtë ngjarje, ne morëm pjesë në të.

Unë i shpërndava gongun tim dishepujve që kishin ardhur me mua. Secili mori një pjesë që ishte në formën e një grumbulli energjie e përbërë prej më shumë se njëqind aftësish supernormale. I vulosa duar e tyre me gong, por edhe kështu, duart e disave u kafshuan deri sa patën flluska apo gjak; kjo madje ndodhi shpesh. Qëniet ishin shumë të egra. A kujton ti se do guxosh t'i prekësh ato me duart e një njeriu të zakonshëm? Përveç kësaj, ti nuk i arrin dot ato. Metoda nuk do të funksionojë pa një lloj aftësie supernormale. Kjo ndodh sepse në një dimension tjetër ajo do të dijë çfarëdo që ti don të bësh sapo ti ta kesh menduar atë. Kur ti përpiqesh ta kapësh atë, ajo do t'ja mbathë. Sapo pacienti të dalë nga dera, ajo do të kthehet përsëri atje menjëherë dhe sëmundja do të përsëritet. Ta kapësh atë nevojitet një aftësi supernormale e tillë me të cilën personi zgjat dorën dhe “Fap!” e gozhdon atje. Me ta mbërthyer atje, ne kemi një aftësi tjetër supernormale që quhej njëkohë “Metoda e Madhe e Kapjes së Shpirtit” dhe kjo aftësi supernormale është akoma dhe më e fuqishme. Mund të nxjerrë jashtë Shpirtin Primordial të dikujt dhe në çast personi nuk do mund të lëvizë. Kjo aftësi supernormale e ka qëllimin në gjëra të caktuara dhe kur ne kapim me dorë atë qënien, piketojmë pikërisht ato gjëra. Të gjithë e dinë se megjithëse Mbreti Majmun⁸ ishte shumë i madh, Tathagata mund të përdorte tasin që kish në dorë për ta kthyer atë në një gjë tepër të vogël duke e mbuluar me tas. Kjo aftësi supernormale mund të sjellë këtë rezultat. Pamvarësisht sa e madhe apo sa e vogël që të jetë kjo qenie, ajo do të kapet në dorë menjëherë dhe bëhet shumë e vogël.

Po ashtu, nuk lejohet që dora e dikujt të germojë në trupin fizik të një pacienti dhe të nxjerrë diçka jashtë. Kjo do sillte konfuzion në mendjen e njerëzve në shoqërinë njerëzore dhe kjo është absolutisht e ndaluar. Edhe sikur të ishte e mundur, nuk duhet të bëhet në këtë mënyrë. Dora me të cilën germohet është dora në një dimension tjetër. Supozojmë që dikush ka një sëmundje zemre. Kur kjo dorë lëviz drejt zemrës për të kapur qënien, dora në një dimension tjetër lëviz brenda trupit dhe do e kapë atë menjëherë. Ndërsa dora jashtë mbyllet, të dyja duart mbyllen dhe e kapin atë. Ajo është shumë e egër, shpesh lëviz në duart e tu dhe përpiqet t'i hapë ato duke kafshuar shpesh dhe ulëritur. Megjithëse duket shumë e vogël në duart e tu, ajo do të bëhej shumë e madhe nëse e lëshon nga duart. Ajo nuk është diçka që çdo njeri e prek. Pa aftësinë supernormale, personi nuk mund ta prekë atë. Është plotësisht ndryshe nga sa të thjeshtë mund ta mendojnë këtë njerëzit.

Sigurisht, kjo formë trajtimi qigongu mund të lejohet të ekzistojë në të ardhmen, sepse gjithmonë kishte ekzistuar në të kaluarën. Por duhet vënë një kusht: Ky person duhet të jetë praktikues. Gjatë kursit të praktikës kultivuese, nga dashamirësia e vet këtij personi i lejohet të bëjë këtë gjë për pak njerëz të mirë. Por ai nuk mund të eliminojë plotësisht karmën e tyre përderisa ai nuk ka virtyt të madh të mjaftueshëm. Prandaj, fatkeqësitë do të vazhdojnë të ekzistojnë për personin, ndërsa sëmundja në fjalë do të shërohet. Një mjeshtër i zakonshëm qigongu nuk është person që ka arritur Taon në praktikën kultivuese. Ai vetëm mund t'i shtyjë sëmundjet apo mbase t'i transformojë

⁸ Mbreti Majmun—një personazh në veprën klasike artistike kineze *Udhëtim për në Perëndim*.

ato. Ai mund t'i transformojë ato në fatkeqësi të tjera, megjithatë ai, vetë, mund të mos e dijë këtë proces shtyrjeje. Nëqoftëse praktika e tij kultivon Shpirtin Ndihmës, kjo bëhet nga Shpirti i tij Ndihmës. Praktikuesit në disa praktika duken sikur janë shumë të famshëm. Shumë mjeshtër të mirënjohur qigongu nuk kanë gong sepse gongu i tyre rritet në trupat e Shpirtit Ndihmës. Domethënë, disa njerëz lejohen të bëjnë gjëra të tilla gjatë kursit të tyre të praktikës kultivuese sepse ata vazhdojnë të qëndrojnë në të njejtin nivel. Ata kanë vazhduar të praktikojnë mbi një dekadë apo disa dekada dhe akoma nuk mund të shkojnë përtej këtij niveli. Kështu gjatë gjithë jetës së tyre ata gjithmonë shohin pacientë. Ngaqë ata vazhdojnë të mbeten në atë nivel, atyre u lejohet ta bëjnë këtë gjë. Praktikuesve të Falun Dafës u ndalohet rreptësisht të trajtojnë pacientë. Ju mund t'i lexoni këtë libër një pacienti. Nëqoftëse pacienti e pranon atë, sëmundja mund t'i shërohet. Por rezultati do të ndryshojë në varësi nga sasia e karmës së çdo personi.

Trajtimi në Spital dhe Trajtimi i Qigongut

Le të flasim për lidhjen ndërmjet trajtimit në spital dhe shërimit nëpërmjet qigongut. Disa mjekë të mjekësisë perëndimore nuk e kuptojnë qigongun dhe mund të themi se shumica e tyre janë si këta. Mendimi i tyre është se nëqoftëse qigongu mund të shërojë sëmundje, atëherë pse i duam ne spitalet? “Zëvendësoni spitalet tona atëherë! Përderisa qigongu juaj mund të shërojë sëmundje me një dorë dhe pa përdorur inxheksione, ilaçe apo spital, a nuk do të ishte mirë sikur ju t'i zëvendësonit spitalet tona?” Kjo thënie nuk është as racionale dhe as e arësyeshme; disa njerëz nuk e njohin qigongun. Në fakt, shërimi nëpërmjet qigongut nuk mund t'i ngjajë trajtimit të njerëzve të zakonshëm, sepse nuk është një aftësi e njerëzve të zakonshëm—është diçka mbinatyrale. Kështu si mund të lejohet diçka kaq mbinatyrale sa kjo t'i ndërhyjë shoqërisë njerëzore në shkallë kaq të gjërë? Një Buddha është i plotfuqishëm dhe ai mund t'i zhdukë të gjitha sëmundjet e njerëzimit me një të lëvizur të dorës. Pse nuk e bën ai këtë? Përveç kësaj, ka kaq shumë Buddha. Pse nuk e tregojnë ata mëshirën e tyre duke ju shëruar sëmundjet tuaja? Sepse shoqëria njerëzore supozohet të jetë në këtë mënyrë. Lindja, plakja, sëmundja dhe vdekja janë thjesht pjesë të jetës. Ato kanë të gjitha arsye karmike dhe ndodhin për shkak të shpagimit karmik. Ju duhet të paguani borxhet që keni.

Nëqoftëse ju shëroni sëmundjen e dikujt, do të jetë njësoj sikur të kishit shkelur këtë parim, sepse personi do të jetë në gjendje të kryejë vepra të këqija pa paguar për to. Si mund të jetë kjo gjë e mirë? Si individ që praktikon kultivim, kur ju nuk e keni atë aftësi të madhe për të zgjidhur problemin e karmës përfundimisht, juve ju lejohet të trajtoni një pacient në shenjë mëshire. Meqenëse mëshira juaj ka dalë në pah nëpërmjet kultivimit, juve ju lejohet ta bëni këtë. Por nëqoftëse ju mund ta zgjidhni këtë problem me të vërtetë, ajo nuk do të lejohej të bëhej në shkallë të gjërë. Në atë rast, ju do të dëmtonit në mënyrë serioze gjendjen e shoqërisë njerëzore—kjo nuk lejohet. Prandaj, zëvendësimi i spitaleve me qigong nuk do të funksiononte, sepse qigongu është Ligj mbinatyrar.

Nëqoftëse spitale qigongu do të lejoheshin të hapeshin në Kinë dhe shumë mjeshtër të mëdhenj qigongu do dilnin të bënin shërimë, si mendoni ju se do ishte kjo? Kjo nuk do të lejohej sepse ata të gjithë ruajnë kushtet e shoqërisë njerëzore. Nëqoftëse do të krijoheshin spitale qigongu, klinika qigongu, qendra mjekësore qigongu dhe qendra trajtimi, efikasiteti i shërimit i mjeshtërve qigong do të binte në mënyrë të konsiderueshme dhe rezultatet e trajtimeve nuk do të ishin më të mira. Pse ndodh kjo? Përderisa ata e bëjnë këtë gjë tek njerëzit e zakonshëm, Ligji i tyre duhet të jetë i lartë sa dhe ai i njerëzve të zakonshëm. Ata duhet të qëndrojnë në nivel të njejtë me njerëzit. Efikasiteti i shërimit të tyre duhet të jetë i njejtë me atë të spitalit. Kështu trajtimet e tyre nuk do të funksionojnë mirë dhe atyre do ju duhen disa të ashtuquajtura “sesione terapie” për të shëruar një sëmundje. Ndodh zakonisht kështu.

Me apo pa spitale qigongu, askush nuk mund ta mohojë se qigongu mund të shërojë sëmundje. Qigongu ka qënë popullor prej kaq kohësh. Shumë njerëz me të vërtetë kanë arritur qëllimin e shërimit të sëmundjeve dhe mbajtjes së trupit në formë nëpërmjet praktikës. Nëqoftëse sëmundja ishte shtyrë nga një mjeshtër qigongu apo sidoqë të ishte trajtuar, tashmë sëmundja është zhdukur. Me fjalë të tjera, askush nuk mund ta mohojë se qigongu mund të shërojë sëmundje. Shumica e njerëzve të cilët janë parë nga mjeshtër të qigongut janë ata me sëmundje të vështira e të komplikuar që nuk mund të trajtohen në spitale. Ata shkojnë tek mjeshtër qigong për të provuar fatin dhe sëmundjet së fundi i janë shëruar. Ata që i shërojnë sëmundjet në spital nuk shkojnë të shohin mjeshtër qigong. Veçanërisht në fillim, njerëzit të gjithë mendonin kështu. Qigongu pra mund të shërojë sëmundje veçse nuk mund të zbatohet si gjërat e tjera që bëhen në shoqërinë njerëzore. Ndërsa ndërhyrje në shkallë të gjërë nuk lejohen, ndërhyrje në një shkallë të vogël apo mbajtja e saj si një praktikë e kufizuar dhe e qetë është e lejueshme. Por kjo nuk do e shëronte sëmundjen plotësisht—kjo është gjithashtu e sigurtë. Mënyra më e mirë për të shëruar sëmundjet është të praktikosh vetë qigong.

Ka gjithashtu disa mjeshtër qigongu që pretendojnë se spitalet nuk mund të shërojnë sëmundje dhe se efikasiteti i trajtimeve në spitale është i tillë apo i atillë. Çfarë duhet të themi ne në lidhje me këtë çështje? Sigurisht, kjo ka lidhje me arsye nga shumë fusha. Sipas mendimit tim, arsyeja kryesore është se vlerat morale njerëzore kanë arritur një pikë të ulët duke çuar në një shumëllojshmëri sëmundjes të rralla që spitalet nuk i shërojnë dot. As marrja e ilaçeve nuk jep më rezultate. Ka dhe plot ilaçe të rreme. Kjo ndodh nga shkalla e korruptimit të shoqërisë njerëzore. Askush të mos fajësojë të tjerët për këtë sepse të gjithë i kanë shtuar benzinë zjarrit. Për pasojë, të gjithë do të kalojnë shqetësime në praktikën kultivuese.

Disa sëmundje nuk mund të zbulohen në spital, megjithëse njerëzit janë në fakt të sëmurë. Disa njerëz janë diagnostikuar me sëmundje që nuk kanë emra, sepse ato nuk janë parë kurrë më parë. Spitalet i quajnë ato “sëmundje moderne”. A mund të shërojnë spitalet sëmundje? Sigurisht që po. Nëqoftëse spitalet nuk do të mundnin të shëronin sëmundje, pse do të besonin njerëzit në to dhe shkonin për shërim? Spitalet janë akoma të afta për të shëruar sëmundje, por mënyrat e tyre të trajtimit i përkasin nivelit të njerëzve të zakonshëm ndërsa sëmundjet janë mbinaturale. Disa sëmundje janë tepër serioze dhe kështu spitalet kërkojnë trajtim të hershëm nëse dikush e ka këtë sëmundje. Nëqoftëse sëmundja bëhet tepër serioze, spitalet nuk do të kenë shpresa sepse dozat e tepërta të ilaçeve mund ta helmojnë personin. Trajtimet e mjekësisë së sotme janë në të njëjtin nivel me shkencën dhe teknologjinë tonë—ato janë të gjitha në nivelin e njerëzve të zakonshëm. Kështu, ato kanë vetëm efikasitet shërimi të tillë. Një çështje që duhet sqaruar është se trajtimet tipike të qigongut dhe trajtimet spitalore vetëm i shtyjnë problemet që janë shkaku themelor i sëmundjeve në gjysmën tjetër të jetës apo për më vonë. Karma nuk zhduket aspak.

Le të flasim për mjekësinë kineze. Mjekësia kineze është shumë e ngjashme me shërimin nëpërmjet qigongut. Në Kinën e lashtë, aftësitë mbinatyrare ishin të zakonshme për pothuajse të gjithë mjekët kinezë, si për shembull ata shkencëtarët e mëdhenj në mjekësi: Sun Simiao, Huatuo, Li Shizhen dhe Bian Que⁹. Ata të gjithë kishin aftësi mbinatyrare që janë dokumentuar në tekste mjekësore. Megjithatë tani këto pjesë të shkëlqyera shpesh kritikohen. Ato që mjekësia kineze trashëgoi prej tyre janë vetëm receta apo eksperiencat nga kërkimet. Mjekësia e lashtë kineze ishte shumë e përparuar dhe shkalla e zhvillimit të saj ishte jashtë shkencës së sotme mjekësore. Disa njerëz mund të mendojnë se mjekësia moderne është kaq e avancuar me CT skaner për të ekzaminuar brenda trupit të njeriut dhe me ultratinguj, fotografi e grafi. Megjithëse pajisjet moderne mund të jenë shumë të përparuara, sipas mendimit tim ato përsëri mbeten inferiore ndaj mjekësisë së lashtë kineze.

⁹ Sun Simiao, Huatuo, Li Shizhen, Bian Que—mjekë të mirënjohur të mjekësisë kineze në histori.

Huatuo pa një tumorr në trurin e Caocao-s¹⁰ dhe donte t'ja operonte atij. Caocao mendoi se Huotuo donte ta vriste dhe kështu e burgosi Huatuo-n. Si rezultat, Huatuo vdiq në burg. Kur sëmundja e Caocao-s u rishfaq, ai e mbajti mend Huatuo-n dhe e kërkoi atë, por Huatuo kishte vdekur tashmë. Me vonë, Caocao vdiq me të vëtetë nga kjo sëmundje. Nga e dinte Huatuo tumorin? Ai e kish parë atë. Kjo është aftësi mbinatyrë e jona të cilën e kishin të gjithë mjekët e mëdhenj në të kaluarën. Pasi Syri Qiellor hapet, personi mund të shikojë nga një anë, katër anët e trupit të njeriut njëherësh. Personi mund të shikojë prapa, anën e majtë dhe të djathtë nga përpara. Ai mund të shikojë një shtresë pas tjetrës apo shikojë përtej këtij dimension shkakun themelor të një sëmundjeje. A mundet mjetet moderne mjekësore ta bëjnë këtë? Aspak. Do të duhen dhe një mijë vjet të tjera! CT skaner, ultratingujt dhe grafitë mund të ekzaminojnë brendësinë e trupit të njeriut, por pajisja është tepër e kabashme dhe këto gjëra të mëdha nuk janë të lëvishme; dhe as mund të punojnë ato pa elektricitet. Megjithatë Syri Qiellor mund të shikojë kudo ku shkon njeriu dhe nuk ka nevojë për elektricitet. Si mund të krahasohen këto?

Disa njerëz thonë se sa e jashtëzakonshme është mjekësia moderne. Unë do të thoja se mund të mos jetë ashtu sepse barërat e lashta kineze mund të shëronin sëmundje me të vërtetë me t'u përdorur. Ka plot gjëra që nuk janë trashëguar por shumë nuk kanë humbur dhe përdoren akoma nga njerëzit. Kur jepja një klasë në Qiqihar, pashë një person që kishte një banak ambulatori në rrugë dhe shkulte dhëmbë për njerëzit. Mund të tregoje me lehtësi se ky person vinte nga Jugu sepse nuk ishte veshur si verilindor. Ai nuk kthente mbrapsht asnjë që i vinte. Ai do i shkulte dhëmbin kujtdo që vinte dhe kishte atje një tufë me dhëmbë të shkulura. Qëllimi i tij nuk ishte të shkulte dhëmbë, por të shiste ilaçin e lëngshëm që kish sjellë. Lëngu ilaçit lëshonte një avull shumë të trashë të verdhë. Ndërsa shkulte një dhëmb, ai hapte shishen e ilaçit dhe e vendoste tek faqja e pacientit drejt vendit ku ishte dhëmbi i keq. Pacientit i kërkohet të thithte tymin e lëngut të verdhë i cili pothuajse nuk harxhohej fare. Shishja e ilaçit do të mbyllej dhe vendosesh mënjanë. Personi pastaj nxirrte një shkop shkrepseje nga xhepi. Ndërsa fliste për ilaçin e tij, ai e shtynte dhëmbin e prishur me shkrepësen dhe ai dilte. Nuk ishte e dhimbshme. Dhëmbi do kishte vetëm disa njolla gjaku por nuk kishte rrjedhje gjaku. Mendojeni pak të gjithë: Një shkop shkrepseje mund të thuhet nëqoftëse përdoret me forcë, por ai e përdorte të shkulte një dhëmb me fare pak kontakt.

Unë kam thënë se në Kinë ka akoma disa gjëra që i janë kaluar njerëzve të cilat nuk mund të krahasohen me instrumentet e sofistikuar të mjekësisë perëndimore. Le të shohim cili trajtim është më i mirë. Shkopi shkrepseje së tij mund të shkulë një dhëmb. Nëqoftëse një mjek i mjekësisë perëndimore don të shkulë një dhëmb, mjeku së pari do t'i bëjë pacientit një gjilpërë mpirjeje. Inxheksionet janë mjaft të dhimbshme dhe personi duhet të presë derisa të fillojë të veprojë. Pastaj mjeku do të shkulë dhëmbin me një palë pinca. Pas goxha kohe dhe përpjekjesh, nëqoftëse mjeku nuk është i kujdesshëm, rrënja mund të thyhet brenda në nofull. Kështu mjeku do të përdorë çekiç dhe daltë që të gërmojë për ta nxjerrë, gjë që mund ta bëjë pacientin të dridhet nga frika dhe ankthi. Më pas ai do të përdorë një instrument të sofistikuar për të gërryer. Disa njerëz kanë kaq shumë dhimbje nga gërryerja sa ata për pak kërcejnë përpjetë. Dhëmbi do nxjerrë plot gjak dhe pacienti do pështyjë gjak për ca kohë. Trajtimi i kujt thoni ju është më i mirë? I kujt është më i përparuar? Ne nuk duhet të shikojmë vetëm pamjen e veglave, por edhe efektivitetin e tyre. Mjekësia e lashtë kineze ishte shumë e përparuar dhe mjekësia e sotme perëndimore nuk do e arrijë dot dhe për shumë vjet të tjera.

Shkenca e lashtë kineze është e ndryshme nga shkenca e sotme që kemi mësuar nga Perëndimi, sepse mori një drejtim tjetër që solli një situatë të ndryshme. Prandaj, ne nuk mund ta kuptojmë shkencën dhe teknologjinë e lashtë kineze me mënyrën tonë të tanishme të të kuptuarit. Megjithatë shkenca e lashtë kineze përqëndrohej direkt tek trupi i njeriut, jeta dhe universi dhe i studjonte këto subjekte drejtpërdrejt, ajo mori një mënyrë trajtimi të ndryshëm. Në atë kohë, kur

¹⁰ Caocao—perandor i një prej Tre Mbretërive (220 e.r.-265 e.r.).

nxënësit shkonin në shkollë, ata praktikonin meditimin dhe theksonin mbajtjen e pozicionit të trupit drejt. Kur e kapnin pendën, ata do të rregullonin frymëmarrjen dhe qi-në. Të gjitha profesionet besonin në zbrasjen e mëndjes dhe rregullimin e frymëmarrjes sepse kjo ishte situata në gjithë shoqërinë.

Dikush thotë: “A do kishim makina dhe trena po të kishim ndjekur shkencën e lashtë kineze? A do kishim modernizimin e sotëm?” Unë do të thoja se ju nuk mund të kuptoni kushte të tjera nga perspektiva e këtij ambienti. Duhet të ndodhë një revolucion në të menduarit tuaj. Pa televizorë, njerëzit do t’i kishin ato në ballë dhe do të mund të shikonin çdo gjë që dëshironin. Ata gjithashtu do të kishin aftësi supernormale. Pa trena dhe avionë, njerëzit do të mund të ngriheshin në ajër pa përdorur ashensorë. Kjo do të sillte një situatë të ndryshme zhvillimi shoqëror dhe nuk do të thotë të ishte e kufizuar në këto kufij. Disqet fluturuese të alienëve mund të fluturojnë me një shpejtësi të pa imagjinueshme dhe mund të zmadhohen e zvogëlohen. Ata kanë marrë një metodë alternative tjetër zhvillimi e cila është një mënyrë tjetër shkencore.

LEKSIONI I TETË

Agjërimi Bigu¹

Disa njerëz kanë ngritur çështjen e agjërimit bigu. Ekziston ky fenomen i quajtur agjërimit bigu. Jo vetëm që ekziston në komunitetin e kultivuesve, por e kanë provuar edhe shumë njerëz në shoqëri. Disa njerëz nuk hanë apo pijnë për disa vjet apo për më shumë se një dhjetëvjeçar, megjithatë ata jetojnë shumë mirë. Ka njerëz që flasin për bigun sikur të ishte tregues i një niveli të caktuar, ndërsa të tjerë e marrin si shenjë të pastrimit të trupit. E akoma të tjerë pretendojnë se është pjesë e procesit të kultivimit të niveleve të larta.

Në fakt, nuk është asnjë nga këto. Çfarë është atëhere? Bigu në fakt i referohet një metode kultivimi të veçantë në një ambjent special. Në cilat kushte përdoret ai? Në Kinën e lashtë para se të themeloheshin fetë, shumë praktikues përdornin formën e praktikës sekrete apo kultivimin e vetmuar në male të largëta apo shpella shumë larg nga vendbanimet e njerëzve. Me të zgjedhur këtë mënyrë, dilte problemi i furnizimit me ushqim. Nëqoftëse personi nuk do të përdorte metodën e bigut, ai nuk do të mund të praktikonte aspak kultivim dhe do të vdiste atje nga uria e etja. Unë shkova nga qyteti Chongqing deri në qytetin Wuhan për t'u mësuar njerëzve Ligjin dhe mora një anije që shkonte në lindje mbi lumin Jance. Pashë disa shpella në të dy anët e Tre Grykave në mes të maleve; edhe shumë male të tjera të mirënjohura i kanë ato. Në të kaluarën, pasi ngjitej në shpellë me ndihmën e një litari, një praktikues do e priste litarin për të praktikuar në shpellë. Nëqoftëse ky person nuk do kishte sukses në kultivim, ai do të vdiste brenda. Pa ushqim apo ujë, vetëm në këto kushte shumë të veçanta, ai do të zgjidhte këtë metodë kultivimi të veçantë.

Shumë praktika kanë kaluar një proces trashëgimie të tillë dhe kështu ato përfshijnë bigun. Plot praktika nuk kanë bigu. Sot, shumica e praktikave që janë bërë publike nuk përfshijnë bigu. Kemi thënë se personi duhet të praktikojë vetëm një praktikë dhe se ju nuk duhet të bëni çfarëdo gjëje që dëshironi. Ju mund të mendoni se bigu është i mirë dhe mund ta bëni atë. Për çfarë e doni ju atë? Disa njerëz mendojnë se është gjë e mirë dhe bëhen kureshtarë dhe mbase ata mendojnë që aftësitë e tyre janë goxha të mira aq sa të mburren me to. Ka njerëz me të gjitha llojet e mentaliteteve. Kur përdoret kjo metodë kultivuese, personi duhet të konsumojë energjinë e vet për të mbajtur trupin fizik. Prandaj, nuk ja vlen. Ju e dini se veçanërisht pas themelimit të feve, personi është furnizuar me ushqim dhe çaj gjatë periudhës së meditimit në kllapi apo kultivimit të vetmuar në një tempull. Pra kjo çështje nuk ekziston. Veçanërisht në praktikojmë kultivim në mes të shoqërisë njerëzore dhe ju nuk duhet të përdorni aspak këtë metodë. Për më tepër nëqoftëse shkolla juaj e praktikës nuk e përfshin atë, ju nuk duhet ta bëni atë sipas dëshirës. Nëqoftëse me të vërtetë ju dëshironi të praktikoni bigu, shko e bëjeni atëhere. Me sa di unë, zakonisht kur një mjeshtër mëson një praktikë niveli të lartë dhe udhëheq një dishepull me vërtetësi dhe nëqoftëse ajo shkollë praktike e përmban bigun, ky fenomen mund të ndodhë. Megjithatë një person nuk mund ta përhapë atë në publik; ai në mënyrë tipike do ta merrte dishepullin me vete ta praktikonin atë fshehurazi apo vetëm.

Tani kanë dalë gjithashtu mjeshtër qigongu që mësojnë bigu. A ka pasur bigu sukses? Në fund të fundit, aspak. Kush ka pasur sukses me të? Kam parë shumë njerëz të shtruar në spitale dhe jeta e shumë njerëzve është vënë në rrezik. Atëhere pse ndodh kjo? A nuk ekzistoka ky fenomeni bigu? Po ekziston. Megjithatë, duhet vënë në dukje një pikë: Askujt nuk i lejohet të prishë sipas dëshirës gjendjen e shoqërisë sonë njerëzore—nuk lejohet t'i ndërhyhet asaj në këtë mënyrë. Le të mos përmendim pastaj sa njerëz në gjithë vendin nuk do kishin nevojë të hanin dhe pinin. Unë do të thoja se do ishte shumë kollaj sikur njerëzit në zonat e Changchun të mos kishin nevojë të hanin e pinin!

¹ bigu—një term i lashtë që do të thotë të heqësh dorë nga ushqimi dhe uji.

Nuk do të kishim nevojë të merakoseshim për të gatuar. Bujqit lodhen kaq shumë në fushë dhe tani askush nuk do të kishte nevojë të hante. Kjo me të vërtetë do t'i lehtësonte kaq shumë gjërat sepse njerëzit vetëm do të punonin pa ju dashur të hanin. Si mund të lejohej kjo gjë? A do të ishte kjo shoqëri njerëzore? Është plotësisht e ndaluar sepse një ndërhyrje e një shkalle kaq të gjërë në shoqërinë e zakonshme njerëzore nuk lejohet.

Kur disa mjeshtër qigongu u mësojnë njerëzve bigu, jeta e shumë njerëzve vihet në rrezik. Disa njerëz janë thjesht të dhënë pas bigut, megjithatë dëshirat e tyre njerëzore nuk janë braktisur—ka plot dëshira të tilla njerëzore pa u hequr. Goja e një personi të tillë do të lëngëzohej kur ai të shikonte ndonjë ushqim të shijshëm. Sapo i lind kjo dëshirë, ai nuk e kontrollon dot atë dhe nuk do i durohet sa të hajë ushqim. Sapo i hapet oreksi, ai do dojë të hajë; përndryshe ai do të ndjehet i uritur. Megjithatë, ai do të vjellë po të hajë. Ngaqë nuk han dot, ai do të bëhet nervoz dhe frikësohet shumë. Shumë njerëz shtrohen në spital dhe në fakt jeta e shumë vetëve vihet në rrezik. Ka njerëz që më kërkojnë mua dhe më kërkojnë të ndreq këto raste të vështira por unë nuk dua t'i marr ato përsipër. Disa mjeshtër qigongu thjesht bëjnë gjëra pa përgjegjësi. Askush nuk dëshiron të merret me këto probleme për ta.

Për më tepër, nëqoftëse ju keni probleme kur praktikoni bigu, a nuk vjen kjo nga përndjekja juaj e qëllimshme? Ne kemi thënë se ai ekziston, por ai nuk është e ashtuquajtura “gjendje e nivelit të lartë” apo të ashtuquajturit “reaksione speciale”. Është vetëm një metodë praktike e përdorur në kushte të veçanta kështu nuk mund të përhapet gjërisht. Një numër njerëzish shkojnë pas bigut dhe e klasifikojnë atë si të ashtuquajturin bigu apo gjysmë-bigu dhe madje e radhisin atë në nivele të ndryshme. Disa njerëz pretendojnë se ata vetëm kanë nevojë të pinë ujë, ndërsa të tjerë pretendojnë se vetëm kanë nevojë të hanë fruta. Të gjitha këto janë bigu të rreme dhe me kalimin e kohës, të gjitha janë të destinuara të dështojnë. Një praktikues i vërtetë do të qëndrojë në shpellë pa pirë e ngrënë—ky është bigu i vërtetë.

Vjedhja e Qi-së

Kur flasim për vjedhjen e qi-së, disa njerëz do të zbehen nga tmerrri dhe ata do të ishin shumë të frikësuar për ta provuar qigongun. Për shkak të thashethemeve mbi fenomenin e marrosjes nga kultivimi, vjelljes së qi-së e të tjera, në komunitetin e kultivuesve shumë njerëz janë tepër të frikësuar që të praktikojnë qigong apo t'i afrohen atij. Po të mos ishin këto thashetheme, mbase më shumë njerëz do të praktikonin qigong. Megjithatë ka mjeshtër qigongu me karakter të ulët të cilët i mësojnë këto gjëra me qëllim. Kjo sjell shumë rrëmujë në komunitetin e kultivuesve. Në fakt nuk është aq e tmerrshme sa thuhet. Ne kemi thënë se qi është vetëm qi, megjithëse ju mund ta quani “përzjerje qi-je fillestare” e kjo qi apo ajo qi. Për aq kohë sa trupi i një personi ka qi, ai është në nivelin e mbajtjes së trupit të shëndetshëm e në formë dhe nuk është akoma praktikues. Për aq kohë sa ai ka qi, do të thotë se trupi i tij nuk është pastruar thellësisht dhe prandaj ka akoma qi me bakterie—kjo është e sigurt. Personi që vjedh qi është gjithashtu në nivelin e qi-së. Nga praktikuesit tanë, kush do ta donte atë qi të papastër? Qi-ja në trupin e njeriut që nuk praktikon është mjaf e papastër, megjithëse mund të bëhet më e ndritshme nëpërmjet praktikës së qigongut. Kështu vendi i një sëmundjeje do të ketë një grumbull shumë të madh substance të zezë me densitet të lartë. Duke vazhduar praktikën, nëqoftëse personi me të vërtetë e ka shëruar sëmundjen dhe është bërë i shëndoshë, qi-ja e tij do të kthehet gradualisht në të verdhë. Po të vazhdojë të praktikojë më tutje, sëmundja do të shërohet me të vërtetë dhe po ashtu dhe qi-ja e tij do të zhduket. Ai do të hyjë në fazën e Trupit Qumësht të Bardhë².

² Trup Qumësht i Bardhë—një trup i pastruar pa qi.

Kjo do të thotë se nëqoftëse dikush ka qi, ai ka akoma sëmundje. Ne jemi praktikues—për çfarë e duam ne qi-në në praktikë? Trupat tanë duhet të pastrohen. Pse do e donim ne atë qi të papastër? Në asnjë mënyrë jo. Një person që dëshiron qi është akoma në nivelin e qi-së. Duke qënë në nivelin e qi-së, ai nuk mund të dallojë qi-në e mirë nga qi-ja e keqe, sepse ai nuk e ka akoma këtë aftësi. Qi-ja e vërtetë në dantian të trupit tuaj nuk mund të merret prej tij sepse ajo qi primordiale mund të hiqet vetëm nga dikush me aftësi niveli të lartë. Përsa i përket qi-së së papastër në trupin tuaj, lëreni ta vjedhë—nuk është ndonjë gjë e madhe. Gjatë praktikës, nëqoftëse unë dua ta mbush veten me qi, vetëm me një mendim dhe barku im do të mbushet me qi menjëherë.

Shkolla Tao mëson ushtrimin në këmbë të *tianzi zhuang*³ ndërsa Shkolla Buddhës mëson hedhjen e qi-së mbi majën e kokës. Ka plot qi në univers që ju ta mbushni veten çdo ditë. Me pikën laogong dhe pikën *baihui*⁴ të hapur, ju mund ta mbushni veten me qi me anë të duarve ndërsa fokusoheni në dantian. Ju do të mbusheni plot me qi brënda pak kohe. Pamvarësisht sa plot jeni mbushur me qi, ç'vlerë ka ajo? Kur disa njerëz kanë praktikuar shumë qi, ata i ndjejnë gishtërinjtë dhe trupat si të enjtur. Kur të tjerët i afrohen një personi si ky, ata do të ndjejnë një fushë rreth tij. “Uau, ti ke praktikuar kaq mirë.” Unë do të thoja se nuk është asgjë. Ku e ke ti gongun? Është akoma praktikë në qi, e cila nuk mund të zëvendësojë gongun pamvarësisht sa qi të ketë ai. Qëllimi i praktikës në qi është të zëvendësojë qi-në brënda trupit të personit me qi të mirë nga jashtë dhe të pastrojë trupin. Pse grumbullon personi qi? Kur ti je në atë nivel dhe nuk ke kaluar përmes ndryshimesh themelore, qi nuk është akoma gong. Pamvarësisht sa qi ke vjedhur, ti nuk je gjë tjetër veçse një thes me qi. Për çfarë vlen ai? Ai nuk është transformuar akoma në materie të energjisë së lartë. Pra nga çfarë ke ti frikë? Lëre të vjedhë qi nëqoftëse ai don ta bëjë këtë.

Mendojeni pak të gjithë: Nëqoftëse trupi juaj ka qi, ai ka sëmundje. Atëhere, kur personi vjedh qi-në tënde, a nuk vjedh ai dhe qi-në me bakterie? Ai nuk mund të dallojë njërin nga tjetra, sepse një që don qi është gjithashtu në nivelin e qi-së dhe nuk ka ndonjë aftësi. Një person që ka gong nuk dëshiron qi—kjo është e sigurtë. Po nuk e besuat, mund të kryejmë një eksperiment. Nëqoftëse një person me të vërtetë dëshiron të vjedhë qi-në tënde, ju mund të qëndroni aty dhe ta lejoni atë ta vjedhë qi-në. Ju mund të përqëndroni mendjen tuaj në mbushjen e trupit me qi nga universi këtu, ndërsa ai vjedh qi-në prapa jush. Ju do e shikoni sa pazar i mirë që është sepse do t'ju ndihmojë të përshpejtoni pastrimin e trupit tuaj dhe juve nuk do t'ju duhet të mbushni e zbrazni qi nga trupi juaj. Ngaqë ai ka një qëllim të keq dhe vjedh diçka nga të tjerët, megjithëse ka vjedhur diçka jo të mirë, ai prapëprap ka kryer një veprim që e bën të humbë virtyt. Prandaj, ai do t'ju japë juve virtyt. Kjo formon një sistem qarkullimi ku ndërsa ai merr qi-në tënde këtu, ai të jep ty virtyt atje. Personi që vjedh qi nuk e din këtë—po ta dinte, ai nuk do të guxonte ta bënte atë!

Të gjithë ata persona që vjedhin qi kanë fytyra verdhacake si të sëmurë dhe janë të gjithë ashtu. Shumë njerëz që shkojnë në parqe për të praktikuar qigong shpresojnë të shërojnë sëmundjet e tyre dhe ata kanë nga të gjitha llojet e sëmundjeve. Kur dikush po shëron një sëmundje, ai duhet të përpiqet të shkarkojë qi-në me bakterie. Ndërsa personi që vjedh qi nuk do të zbrazë qi por do të mbledhë të gjitha llojet e qi-ve me bakterie në gjithë trupin e tij. Edhe brenda trupit ai do bëhet i gjithi i zi. Ndërsa ai gjithmonë humb virtyt, pamja e tij bëhet e tëra e zezë. Me një fushë të madhe karme dhe humbje të madhe virtyti, ai do të nxihet brenda e jashtë. Sikur ta dinte personi që vjedh qi se po pësonte këtë ndryshim dhe të kuptonte se ai po i jepte të tjerëve virtyt duke bërë këtë budallallëk, ai nuk do ta bënte kurrsesi këtë.

Disa njerëz e kanë fryrë qi-në tej mase: “Kur unë lëshoj qi, ti mund ta marrësh atë dhe në Amerikë.” “Ti mund të presësh në anën tjetër të murit dhe mund të marrësh qi-në që lëshoj unë.” Disa njerëz janë shumë të ndjeshëm dhe mund ta ndjejnë qi-në kur lëshohet. Por qi nuk udhëton në këtë dimension. Ajo lëviz në një dimension tjetër ku nuk ka ndonjë mur. Pse nuk ndjeni gjë ju kur një

³ *tianzi zhuang*—një formë ushtrimi qigongu në këmbë në Shkollën Tao.

⁴ *baihui*—pikë akupunkte në majë të kokës.

mjeshtë qigongu lëshon qi në një vend të hapur? Ndodhet një ndarës atje në dimensionin tjetër. Kështu, qi-ja nuk ka fuqi penetruese sa e kanë përshkruar njerëzit.

Ai që me të vërtetë ka efekt është gongu. Kur një praktikues mund të lëshojë gong, ai apo ajo nuk ka më qi dhe mund të rrezatojë lëndë të një energjie të lartë e cila shihet si dritë nga Syri Qiellor. Kur arrin tek një person tjetër, e bën atë person të ndjejë ngrohtësi; mund të kontrollojë një njeri të zakonshëm. Megjithatë akoma nuk mund të arrijë plotësisht qëllimin e shërimit të sëmundjeve, sepse ka vetëm efekt kufizues. Në mënyrë që me të vërtetë të shërosh sëmundje, ti duhet të kesh aftësi supernormale. Ekziston një aftësi supernormale e veçantë për secilën sëmundje. Në një nivel shumë mikroskopik, secila pjesëzë mikroskopike e gongut merr pamjen tënde. Ai mund të njohë njerëzit dhe ka inteligjencë sepse është materie energjie të lartë. Nëqoftëse dikush e vjedh atë, si mund të qëndrojë atje? Nuk do të qëndrojë atje e nuk mund të vendoset atje, sepse nuk është pronë e atij person. Përsa i përket gjithë atyre praktikuesve të vërtetë, pasi ata zhvillojnë gong ata mbrohen nga mjeshtrit e tyre. Mjeshtri jot sheh çfarë bën ti. Kur ti përpiqesh të marrësh gjëra nga një person tjetër, as mjeshtri i atij personit nuk do ta lejojë këtë gjë.

Mbledhja e Qi-së

Në mësimin e praktikës kultivuese të niveleve të larta, vjedhja dhe mbledhja e qi-së nuk janë çështje që ne do të ndihmojmë të zgjidhim për secilin. Po flas për to sepse unë akoma kam për qëllim të vë në vend emrin e praktikës kultivuese dhe të kryej vepra të mira. Unë do t'i nxjerr në shesh këto fenomene kaq të këqija, të cilat askush nuk i ka diskutuar në të kaluarën. Unë dua që ju të gjithë t'i dini këto, kështu që disa njerëz mos të kryejnë vepra të këqija dhe kjo do të ndihmojë disa njerëz që nuk e dinë të vërtetën e qigongut e kanë gjithmonë frikë kur flasin për të.

Ka plot qi në univers. Disa njerëz flasin për qi qiellore yang dhe qi tokësore yin. Meqenëse edhe ti je një element i universit, ti mund të mbledhësh qi. Por disa njerëz nuk e mbledhin qi-në nga universi. Ata specializohen dhe i mësojnë njerëzit të mbledhin qi nga bimët. Ata madje dhe e kanë përmbledhur eksperiencën e tyre: Si dhe kur të mbledhësh këtë lloj qi-je, qi-ja e plepit është e bardhë, apo qi-ja e pishës është e verdhë. Disa gjithashtu pretendojnë: “Ishte një pemë para shtëpisë sonë. U tha sepse unë i mbledha qi-në.” Çfarë lloj aftësie është kjo? A nuk është ky një veprim i keq? Dihet nga të gjithë se kur ne praktikojmë me të vërtetë kultivim, ne duam mesazhe pozitive dhe t'i asimilohemi karakteristikës së universit. A nuk duhet të praktikoni ju Shan (Mirësi)? Në mënyrë që t'i asimilohet karakteristikës së universit, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), një individ duhet të praktikojë Shan. Nëqoftëse ti gjithmonë kryen vepra të këqija, si mund ta shtosh ti gongun? Si mund të shërohen sëmundjet e tua? A nuk është kjo e kundërta e asaj që duhet të bëjnë praktikuesit tanë? Kjo do të thotë gjithashtu të vrasësh jetë dhe të kryesh vepra të këqija! Dikush mund të thotë: “Sa më shumë që thua aq më të ekzagjeruara duken—ti e quajte vrasjen e kafshëve të vrasësh jetë dhe tani e quan dhe vrasjen e bimëve gjithashtu të vrasësh jetë.” Në fakt kështu është. Buddhizmi flet për samsarën. Ju mund të kenë qënë ringjallur në bimë gjatë samsarës. Kështu thuhet në Buddhizëm. Këtu ne nuk e themi ashtu por ne ju themi se pemët janë gjithashtu gjallë. Jo vetëm që ato kanë jetë, por ato kanë dhe aktivitet mendor të një niveli të lartë.

Për shembull, është njeri në Amerikë i cili është specializuar në studime elektronike dhe jep mësim mbi përdorimin e poligrafit.⁵ Një ditë atij i lindi papritmas një ide. Ai ia vuri të dy elektrodën e poligrafit një luleje në vazo dhe i hodhi ujë rrënjëve të saj. Ai pa se gjilpëra e poligrafit vizatoi një hark. Ky hark ishte identik me atë të vizatuar kur truri njeriut prodhon një ngacim të shkurtër apo gëzim. Në atë moment, ai u shtang. Si mundet që një bimë të ketë ndjenja? Ai për pak donte të

⁵ poligraf—aparati që përdoret për të zbuluar vërtetësinë e thënieve të personit që i nënshtrohet testit.

ulërinte në rrugë: “Bimët kanë ndjenja!” I frymëzuar nga kjo ngjarje, ai e vazhdoi kërkimin në këtë fushë dhe kreu shumë eksperimente.

Një herë ai vendosi dy bimë bashkë dhe i kërkoi një prej studentëve të tij ta shtypte me këmbë njëherë prej bimëve para tjetrës. Pastaj ai mori bimën tjetër në një dhomë dhe e lidhi tek poligrafi. Ai i kërkoi pesë studentëve të tij të hynin në dhomë me radhë nga jashtë. Bima nuk pati asnjë reagim kur katër studentët e parë hynë në dhomë. Kur studenti i pestë i cili kishte shkatërruar bimën tjetër hyri në dhomë, edhe para se t’i afrohej bimës, gjilpëra elektronike menjëherë vizatoi një hark që prodhohet vetëm kur një person është i frikësuar. Ai u shokua me të vërtetë! Kjo ngjarje nxjerr në pah një çështje të rëndësishme: Ne kemi besuar gjithmonë se njeriu është një jetë e nivelit të lartë me funksione ndjesie që mund të dallojnë gjërat dhe me një tru që mund të analizojë. Si mundkan bimët të dallojnë gjërat? A nuk tregon kjo se dhe ato kanë organe ndjesie? Në të kaluarën, nëqoftëse dikush do të thoshte se bimët kanë organe ndjesie, mëndje që mendojnë, ndjenja dhe mund të njohin njerëzit, ky person do të quhej supersticioz. Përveç këtyre, bimët duket se ja kanë kaluar njerëzve sot në disa aspekte.

Një ditë ai lidhi poligrafën tek një bimë dhe mendoi: “Çfarë eksperimenti të bëj? Po sikur t’i djeg gjethet me zjarr e të shikoj si do të reagojë.” Me këtë mendim, edhe përpara se të digjte gjethet, gjilpëra elektronike menjëherë vizatoi një hark të njejtë me atë që krijohet vetëm kur dikush thërret për ndihmë. Ky funksion super ndjesie që është quajtur telepati, është një funksion njerëzor i pazhvilluar dhe një aftësi e lindur. Por njerëzimi sot është në degjenerim. Që t’i rimerrni këto aftësi, ju duhet të praktikoni kultivim nga fillimi dhe të ktheheni në origjinë, në veten tuaj të vërtetë, në natyrën tuaj origjinale. E megjithatë bima i ka ato dhe din çfarë ke ti në mëndje. Duket tepër e pakonceptueshme, por ky ka qënë një eksperiment shkencor që ka ndodhur. Ai ka kryer eksperimente të ndryshme përfshirë testimin e aftësisë së kontrollit në distancë. Kur u publikuan, shkrimet e tij shkaktuan interes në gjithë botën.

Botanistët në vende të ndryshme përfshirë dhe ata në vendin tonë kanë filluar kërkimet e tyre në këtë fushë dhe kjo nuk konsiderohet më si diçka supersticioze. Dje unë thashë se ato që njerëzimi ynë ka dëshmuar, shpikur dhe zbuluar janë të mjaftueshme të ndryshojnë tekstet tona sot. Megjithatë për shkak të influencës së mentaliteteve konvencionale, njerëzit nuk duan t’i pranojnë ato. Dhe askush nuk po i organizon këto gjëra në mënyrë sistematike.

Në një park në verilindje, vura re se një grup pishash ishin tharë. Askush nuk e din çfarë lloj qigongu praktikonin disa njerëz aty: Ata rrokulliseshin mbi tokë dhe pastaj mbledhnin qi-në nga pemët me këmbë nga njëra anë dhe me duar nga ana tjetër. Menjëherë pas kësaj të gjitha pishat atje u zverdhën dhe u thanë. Ishe kjo që bënë ata një veprim i mirë apo i keq? Nga pikpamja e praktikuesve tanë, kjo është njësoj si të vrasësh jetë. Ti je praktikues. Kështu, në mënyrë që t’i asimilohesh gradualisht karakteristikës së universit dhe të heqësh ato gjërat e këqija që ke, ti duhet të bëhesh njeri i mirë. Edhe nga pikpamja e një njeriu të zakonshëm, ky ishte një veprim i dënueshëm. Është abuzim i pronës publike dhe prishje e gjelbërimit dhe ekuilibrit të sistemit ekologjik. Nuk është veprim i mirë ngado që ta marrësh. Ka plot qi në univers dhe ti mund të mbledhësh sa të duash. Disa njerëz kanë plot energji. Sapo praktikojnë në një nivel të caktuar, ata me të vërtetë mund të mbledhin qi-në e bimëve në një zonë të gjërë me një lëvizje të krahut. Megjithatë, ajo nuk është gjë tjetër veçse qi. Pamvarësisht sa një person mbledh nga ajo, ajo nuk vlen për asgjë. Kur disa njerëz shkojnë në park, ata nuk bëjnë gjë tjetër. Dikush pretendon: “Unë nuk kam nevojë të praktikoj qigong. Mjafton të mbledh qi kur eci rreth e rrotull dhe praktika time mbaron me kaq. Mjafton thjesht të marrësh qi.” Ata mendojnë se qi është gong. Kur njerëzit i afrohen këtij personi, ata do të ndjejnë se trupi i tij është i ftohtë. A nuk është qi-ja e bimëve prej natyre yin? Një praktikues duhet të ruajë ekuilibrin ndërmjet yin dhe yang. Megjithëse trupi i këtij personi vjen erë vaj pishe, ai mund të mendojë se po ecën mirë në praktikë.

Kush Praktikon Kultivim do të Marrë Gong

Çështja se kush praktikon gong dhe kush e merr gongun është shumë e rëndësishme. Kur më pyesin për avantazhet e Falun Dafës, unë u them se Falun Dafa mund të bëjë që gongu të kultivojë praktikuesit dhe kështu të shkurtojë kohën e praktikës. Kjo zgjidh problemin e mos pasjes kohë për praktikë dhe bën të mundur që të kultivosh në mënyrë të vazhdueshme. Po ashtu praktika jonë është kultivim i vërtetë i mendjes dhe i trupit. Trupat tanë fizikë do të pësojnë ndryshime të mëdha. Falun Dafa ka dhe një avantazh tjetër, më të madhin prej tyre, të cilin nuk e kam përmendur më parë. Vetëm sot do ta zbulojmë sepse ai ka lidhje me çështje madhore me rëndësi historike dhe ka goxha ndikim në komunitetin e kultivuesve. Askush në histori nuk ka guxuar ta zbulojë atë dhe as që i lejohej kujt ta bënte këtë. Megjithatë unë nuk kam rrugë tjetër veçse ta bëj atë të njohur.

Disa dishepuj thonë: “Çdo fjali që thotë Mjeshtri Li Hongzhi është sekret qiellor dhe zbulim i sekreteve të qiellit.” Ne po i ngrejmë njerëzit me të vërtetë në nivele të larta që do të thotë t’i shpëtosh ata. Ne jemi përgjegjës ndaj secilit dhe ky është një detyrim që ne jemi të aftë ta mbajmë. Kështu, nuk është zbulim i sekreteve qiellore. Nëqoftëse dikush flet për të pa përgjegjësi, atëherë do të thotë të nxjerrësh sekrete qiellore. Sot do e bëjmë të njohur çështjen se kush praktikon gong dhe kush merr gong. Sipas mendimit tim, të gjitha praktikat sot, duke përfshirë gjatë gjithë historisë praktikat në Shkollën e Buddhës, Shkollën Tao dhe Shkollën Qimen, kanë kultivuar Shpirtin Ndihmës të personit dhe ishte Shpirti Ndihmës ai që e merrte gongun. Shpirti Kryesor që po përmendim këtu është mendja e personit. Një person duhet të jetë i vetëdijshëm për çfarë po mendon apo bën—kjo është vetja juaj reale. Por ju nuk e dini aspak çfarë bën Shpirti juaj Ndihmës. Megjithëse ti dhe ai keni lindur në të njejtën kohë, me të njejtin emër, njejtën pamje dhe kontrolloni të njejtin trup, ai nuk është ti në kuptimin e ngushtë të fjalës.

Ekziston një parim në univers: Kushdo që humb fiton. Kushdo që praktikon kultivim merr gong. Gjatë gjithë historisë, të gjitha praktikat i kanë mësuar njerëzit të bien në kllapi gjatë praktikës dhe që të mos mendojnë për asgjë. Atëherë personi do të bjerë në një kllapi të thellë dhe së fundi do të humbë vetëdijen plotësisht. Disa njerëz rrinë ulur në meditim për tre orë sikur të kishte kaluar vetëm një sekondë. Të tjerët mund ta admirojnë aftësinë e këtij personi për të ndenjur në kllapi. A praktikoi ai në fakt? Ai vetë nuk e din këtë aspak. Në veçanti Shkolla Tao mëson se *shishen*⁶ vdes dhe Shpirti Primordial lind. Çfarë ata quajnë “shishen” ne e quajmë “Shpirti Kryesor” dhe “Shpirti Primordial” i referohet asaj që ne quajmë “Shpirti Ndihmës”. Nëqoftëse Shpirti juaj Kryesor vdes, ti do të vdesësh me të vërtetë dhe ti nuk do të kesh Shpirt Kryesor. Dikush nga një praktikë tjetër më tha: “Mësues, kur unë praktikoj, unë nuk jam në gjendje të njoh njeri në shtëpi.” Ndërsa një person tjetër më tha: “Unë nuk do të praktikoj si të tjerët të cilët e bëjnë atë herët në mëngjes dhe vonë në darkë. Pasi shkoj në shtëpi, unë shtrihem në një divan dhe dal jashtë vetes për të praktikuar. Ndërsa jam i shtrirë atje shoh veten duke praktikuar.” Mua mu duk kjo shumë e trishtueshme, por në të njejtën kohë nuk ishte e trishtueshme.

Pse ata shpëtojnë Shpirtin Ndihmës? Lu Dongbin⁷ bëri njëherë këtë deklaratë: “Më mirë të shpëtoj një kafshë sesa një njeri.” Me të vërtetë, është jashtëzakonisht e vështirë për njerëzit të arrijnë ndriçim shpirtëror ngaqë njerëzit janë të humbur në padijen e shoqërisë njerëzore. Me fitimet praktike përpara tyre, ata nuk mund të heqin dorë nga dëshirat. Po nuk e besuat, me të mbaruar kjo klasë, disa njerëz do të dalin nga ky auditor si njerëz të zakonshëm përsëri. Nëqoftëse dikush i ofendon apo përplasat me ta, ata nuk do e durojnë dot. Pas një periudhe kohe, ata nuk do të sillen aspak si kultivues. Shumë Taoistë në histori patën kuptuar këtë pikë: “Njerëzit janë shumë të vështirë për tu

⁶ *shishen*—një term Taoist për Shpirtin Kryesor të personit.

⁷ Lu Dongbin—një nga Tetë Shenjtorët në Shkollën Tao.

shpëtuar sepse Shpirti i tyre Kryesor është jashtëzakonisht i humbur. Disa njerëz kanë cilësi të kuptuari të mirë dhe do ta kuptojnë diçka menjëherë me një sugjerim. Disa njerëz nuk do t'ju besojnë pamvarësisht çfarë ju thoni. Ata mendojnë se po tregoni përralla me bisht. Ne po flasim kaq shumë për kultivimin e karakterit, e megjithatë ky person akoma sillet si më parë sapo është në mes të njerëzve. Ai mendon se përfitimet aktuale dhe të prekshme para tij janë praktike dhe ai do t'i shkojë atyre nga prapa; Ligji nga Mësuesi gjithashtu tingëllon i arsyeshëm, por nuk mund të ndiqet. Shpirti Kryesor njerëzor është më i vështiri për t'u shpëtuar, ndërsa Shpirti Ndhmës mund të shikojë skena në dimensione të tjera. Ata mendojnë për pasojë: “Pse duhet të shpëtoj Shpirtin tënd Kryesor? Shpirti jot Ndhmës është gjithashtu ti. A nuk është njësoj sikur të të shpëtoja ty? Është i njëjtë me ty, prandaj kushdo që ta marrë do të jetë njësoj sikur ta kesh marrë ti.”

Më lejoni t'i përshkruaj në mënyrë më të detajuar metodat e praktikës së tyre. Nëqoftëse dikush ka aftësinë supernormale të shikimit në distancë, ai me siguri do të shihte këtë skenë: Kur ti ulesh në meditim, sapo futesh në kllapi, dikush me të njëjtën pamje si tënden do të lërë menjëherë trupin tënd. Nëqoftëse ti përpiqesh t'i dallosh nga njëri tjetri, kush është vetja jote? Ti je ulur pikërisht këtu. Pasi ti shikon atë person të lërë trupin tënd, mjeshtri do ta marrë këtë person për të praktikuar kultivim në një dimension të transformuar nga mjeshtri. Ky mund të jetë në formën e një shoqërie të kaluar, shoqërie të sotme apo një shoqëri në një dimension tjetër. Personit do t'i mësohet praktika dhe do të kalojë përmes vështirësive të shumta për një apo dy orë çdo ditë. Kur personi kthehet nga praktika, ti zgjohesh nga kllapia. Kështu do të ndodhë për ata që mund të shikojnë.

Është akoma më për të ardhur keq nëqoftëse personi nuk mund të shikojë. Ky person zgjohet pas dy orësh ulur në kllapi duke mos ditur asgjë dhe me mendje të turbullt. Si formë praktike, disa njerëz bien në gjumë për dy a tre orë dhe ja japin veten krejtësisht të tjerëve. Kjo bëhet me intervale me uljen në meditim për një periudhë të caktuar kohe çdo ditë. Një lloj tjetër përfundohet njëherazi. Ju të gjithë mund të keni dëgjuar për Bodhidarmën, i cili u ul para një muri për nëntë vjet. Në të kaluarën, ka pasur shumë murgj të cilët rrinin ulur për dekada të tëra. Në histori, rekordi për kohën më të gjatë të qëndrimit ulur është mbi nëntëdhjetë vjet. Disa madje kanë qëndruar më gjatë se kaq. Edhe me pluhur të trashë mbi qepalla dhe bar të mbirë mbi trupat e tyre, ata vazhdonin të qëndronin ulur. Edhe disa në Shkollën Tao e mësojnë këtë metodë. Veçanërisht disa praktika në Shkollën Qimen mësojnë gjumin si formë praktike. Një individ mund të flejë për dekada pa dalë nga gjendja e kllapisë dhe pa u zgjuar. Por kush ka praktikuar? Shpirti Ndhmës i personit ka dalë jashtë të praktikojë. Nëqoftëse është nga ata që shohin, ai do të shohë se mjeshtri e merr Shpirtin e tij Ndhmës për të bërë praktikë. Edhe Shpirti Ndhmës mund të ketë shumë karmë borxh dhe mjeshtri nuk ka aftësinë t'ja eliminojë të gjithë karmën. Prandaj, mjeshtri do t'i thotë atij: “Ti duhet të praktikosh mirë këtu. Unë do largohem dhe do kthehem pas pak. Ti më prit mua.”

Mjeshtri e din me saktësi çfarë do të ndodhë, por përsëri duhet ta bëjë në këtë mënyrë. Pastaj një djall do të vijë ta frikësojë personin apo do të transformohet në një bukuroshe që ta joshë atë—do të ndodhin lloj lloj gjërash. Djalli do e shohë se ai nuk preket fare nga këto. Kjo ndodh sepse është relativisht e lehtë për Shpirtin Ndhmës të praktikojë kultivim, sepse ai mund të dijë të vërtetën e gjërave. I dëshpëruar djalli do të bëjë një përpjekje për t'i marrë jetën për hakmarrje dhe me të vërtetë do ta vrasë atë. Me këtë borxhi i tij u ripagua menjëherë. Pas vdekjes, Shpirti Ndhmës do të dalë si shtëllungë tymi e sillet rrotull derisa të ringjallet në një familje shumë të varfër. Fëmija do të fillojë të vuajë që në moshë të hershme. Kur të rritet e maturohet, mjeshtri do të kthehet. Sigurisht, fëmija nuk mund ta njohë atë. Me anë të aftësive supernormale mjeshtri do të çbllokojë kujtesën e tij të ruajtur. Ai do të kujtohet menjëherë për çdo gjë. “A nuk është ky mjeshtri im?” Mjeshtri do t'i thotë: “Tani është koha për të filluar praktikën.” Kështu, pas shumë vitesh mjeshtri do t'i kalojë atij mësimet.

Pas mësimet, mjeshtri përsëri do t'i thotë: “Ti ke akoma shumë dëshira që duhen hequr. Dil e sillu rrotull për ca kohë.” Të sillesh rrotull në shoqëri është mjaft e vështirë. Duhet të lypë për ushqim dhe do të takojë tipa të ndryshëm njerëzish të cilët do ta qortojnë, tallin, apo përfitojnë prej tij. Mund

të hasë nga të gjithë llojet e problemeve. Ai do ta trajtojë veten si kultivues dhe do të balancojë mirë marëdhëniet me të tjerët, gjithmonë duke mbajtur dhe përmirësuar karakterin. Nuk do të preket nga tundimet e përfitimeve të ndryshme në mes të njerëzve. Pas shumë vitesh, ai do të kthehet nga sjellja rrotull nëpër botë. Mjeshtri do t'i thotë: “Ti ke arritur tashmë Taon dhe ke përfunduar kultivimin. Po nuk pate gjë për të bërë, mund të bëhesh gati të largohesh. Nëqoftëse ke akoma ndonjë gjë për të bërë, shko e mbaroje atë punë prej njerëzish.” Pas shumë vitesh, Shpirti Ndhimës kthehet. Me t'u kthyer Shpirti Ndhimës, edhe Shpirti Kryesor del nga gjendja e kllapisë dhe personi zgjohet.

Megjithatë ky person në fakt nuk ka praktikuar kultivim. Shpirti Ndhimës i tij ka praktikuar, kështu Shpirti Ndhimës do të marrë gongun. Por edhe Shpirti Kryesor ka vuajtur. Në fund të fundit, personi ja dedikoi gjithë rininë e tij të qëndruarit ulur dhe kjo jetë si njeri i zakonshëm mori fund. Kështu çfarë do të ndodhë? Pasi zgjohet nga kllapia, ky person do ta ndjejë se ai ka zhvilluar gong nëpërmjet praktikës dhe ka marrë aftësi supernormale. Nëqoftëse ai dëshiron të shërojë një pacient apo të bëjë diçka tjetër, ai mund ta bëjë këtë sepse Shpirti Ndhimës do të përpiket ta kënaqë atë. Sepse ky person është Shpirti Kryesor në fund të fundit dhe Shpirti Kryesor kontrollon trupin dhe merr vendimet. Po ashtu ai ka harxhuar kaq shumë vjet ulur aty sa kjo jetë i iku tashmë. Kur ky person vdes, Shpirti Ndhimës do të largohet. Secili do të shkojë në punë të vet. Sipas Buddhizmit, ky person përsëri do të kalojë nëpër samsara. Meqenëse një Qënie e Shumëlartësuar u kultivua me sukses në trupin e tij, ky person gjithashtu ka grumbulluar shumë virtyt. Kështu çfarë do të bëhet me të? Ai mund të bëhet një zyrtar i lartë apo mund të bëjë shumë pasuri në jetën tjetër. Mund të zgjidhet vetëm kështu. A nuk i shkoi kultivimi kot atij?

Na është dashur neve shumë mundim për të marrë leje dhe shprehur këtë çështje. Unë kam zbuluar misterin shekullor—ai ka qënë sekreti i sekreteve që absolutisht nuk duhej nxjerrë. Kam zbuluar thelbin e të gjitha praktikave të ndryshme të kultivimit në histori. A nuk ju thashë se ka lidhje të thella me historinë. Këto janë arsytet. Mendojeni pak: Cila praktikë apo shkollë nuk praktikon kultivim në këtë mënyrë? Ti praktikon e praktikon por pa marrë gong. A nuk është për të ardhur keq? Kush e ka fajin? Qëniet njerëzore janë kaq të humbura sa ato nuk arrijnë të ndriçohen shpirtërisht pamvarësisht nga sa shenja i jepen. Nëqoftëse diçka shpjegohet nga një pikëvështrim i lartë, atyre do t'u duket e pakonceptueshme. Nëqoftëse diçka shpjegohet nga një pikëvështrim i ulët, ata nuk mund të ndriçohen shpirtërisht për ç'ka është më lart. Edhe pasi e kam shpjeguar kaq qartë, disa njerëz akoma duan që unë t'u shëroj sëmundjet. Unë me të vërtetë nuk di si t'ja u them ndryshe. Ne ju mësojmë praktikë kultivuese dhe ne vetëm mund të kujdesemi për ata që praktikojnë kultivim drejt niveleve të larta.

Në shkollën tonë të praktikës, është Shpirti Kryesor ai që merr gongun. Atëhere a do marrë Shpirti Kryesor gong kur ti thua se e don? Kush e jep lejen? Nuk është ashtu, sepse duhet të plotësohet një kusht. Të gjithë e dinë se shkolla jonë e praktikës nuk i shmanget shoqërisë njerëzore gjatë praktikës kultivuese dhe as i shmanget apo largohet konflikteve. Në këtë mjedis kompleks të njerëzve të zakonshëm, ju duhet të keni mendje të kthjellët dhe të humbni në interesa me vetëdije. Kur të tjerët ju dëmtojnë interesin personal, ju nuk duhet të shkoni e konkuroni apo luftoni për të si të tjerët. Me ndërhyrje të ndryshme që prekin karakterin, ju do të pësoni humbje. Në këtë ambient të vështirë, ju do të kalisni vullnetin dhe do të përmirësoni karakterin tuaj. Nën ndikimin e mendimeve të ndryshme të këqija nga njerëzit e zakonshëm, ju do të jeni të aftë të dilni prej saj i paprekur.

Mendojeni pak të gjithë: A nuk jeni ju që vuani me vetëdije? A nuk është Shpirti juaj Kryesor që sakrifikon? Përsa i përket atyre që ti ke humbur në mes të njerëzve, a nuk i ke humbur ti ato me vetëdije? Atëhere ky gong duhet të të takojë ty sepse ai që humb, fiton. Prandaj, kjo është arsyeja që shkolla jonë nuk shmanget praktikën kultivuese në këtë ambient kompleks të njerëzve të zakonshëm. Pse zgjedhim ne të praktikojmë kultivim në një ambient plot me konflikte njerëzish? Sepse vetë ne do të marrim gong. Praktikuesve profesionistë në tempuj në të ardhmen do t'u duhet të sillen rrotull në mes të njerëzve të zakonshëm.

Disa njerëz pyesin: “A nuk praktikojnë dhe praktikat e tjera në mes të njerëzve tani? Por ato praktika janë për shërim dhe mbajtje të trupit në formë. Askush nuk ka mësuar praktika të vërteta drejt niveleve të larta në publik përveç atyre që marrin privatisht një dishepull të vetëm. Ata që i mësojnë dishepujt me të vërtetë i kanë marrë ata tashmë mënjane për t’u dhënë mësim privatisht. Gjatë viteve, kush ka folur për këto gjëra në publik? Askush nuk e ka bërë një gjë të tillë. Shkolla jonë e praktikës mëson në këtë mënyrë, sepse kjo është pikërisht mënyra si ne praktikojmë kultivim dhe pikërisht kjo është mënyra si ne marrim gong. Ndërkohë, shkolla jonë e praktikës i jep qindra e mijra gjëra Shpirtit tënd Kryesor që me të vërtetë të të aftësojë ty të marrësh gong vetë. Unë e kam thënë se kam bërë diçka të paparë dhe kam hapur derën më të gjërë. Disa njerëz i kanë kuptuar këto fjalë të miat, sepse ajo që them nuk është aspak e pakonceptueshme. Kam një zakon personal: Nëqoftëse kam një metër dhe ju tregoj vetëm një centimetër, ju prapsepapë mund të thoni se po mburrem, por ajo që kam thënë është në fakt vetëm një pjesëz e vogël. Për shkak të diferencës së madhe në nivele, nuk mund t’ju zbuloj as dhe një pjesë tjetër më të lartë nga Dafa.

Shkolla jonë praktikon kultivim në këtë mënyrë duke ju aftësuar juve vetë të merrni gong me të vërtetë. Kjo është e paparë që nga fillimi i qiellit e tokës—shkoni e kontrolloni historinë. Është e mirë sepse ju do të merrni gong vetë, por është gjithashtu shumë e vështirë. Në mes të ambjentit kompleks të njerëzve të zakonshëm dhe mosmarrëvedhjeve ndërmjet njerëzve, ti do të arrish të ngrihesh mbi të gjitha këto—kjo është gjëja më e vështirë. Është e vështirë sepse ti humb interesat e tua personale me vetëdije në mes të njerëzve të zakonshëm. A prekesh ti kur interesat e tua vetjake më të rëndësishme çënohen? A prekesh ti në mes të prapaskenave të njerëzve? A prekesh ti kur miqtë e familjarët e tu vuajnë? Si i shikon ti këto çështje? Është e vështirë të jesh kultivues! Dikush më tha: “Mësues, mjafton të jesh njeri i mirë në mes të njerëzve të zakonshëm. Kush mund të ketë sukses në kultivim?” Pasi dëgjova këtë, unë u ndjeva me të vërtetë i zhgënjyer! Unë nuk i thashë asnjë fjalë. Ka lloj lloj nivelesh karakteri. Secili kupton aq sa mundet; kushdo që arrin të kuptojë fiton.

Lao Zi pat thënë: “Tao është një shteg që mund të ndiqet, por nuk është një shteg i çfarëdoshëm.” Tao nuk do ishte i çmuar sikur kushdo ta merrte kudo dhe të arrinte të kultivonte me sukses. Shkolla jonë e praktikës të mëson ty si të arrish gong në mes të konflikteve. Prandaj, ne duhet të jemi konform mënyrës së njerëzve të zakonshëm sa më shumë të jetë e mundur. Nga ana materiale, ju nuk do të humbni gjë. Por në këtë ambjent material ju duhet të përmirësoni karakterin tuaj. Prandaj ky ambjent është i përshtatshëm. Shkolla jonë e praktikës është më e përshtatshme, sepse personi mund të praktikojë në mes të njerëzve në vend që të bëhet murg apo murgeshë. Për shkak të kësaj është dhe më e vështira sepse personi do të praktikojë kultivim në këtë ambjent tepër kompleks të njerëzve të zakonshëm. Por në të njejtën kohë, për shkak të kësaj është dhe mënyra më e mirë sepse e aftëson personin ta mbajë gongun për vete. Kjo është pika më themelore e shkollës sonë të praktikës dhe sot unë e kam zbuluar atë për të gjithë. Sigurisht, kur Shpirti Kryesor merr gong, po ashtu merr dhe Shpirti Ndihmës. Pse ndodh kjo? Kur të gjitha mesazhet, qëniet e gjalla dhe qelizat në trupin tuaj po zhvillojnë gong, sigurisht edhe Shpirti Ndihmës do e merrë atë; megjithatë niveli i tij i gongut nuk do të jetë asnjëherë më i lartë se i juaji. Ti je ai që merr vendimet ndërsa ai është ruajtësi i Ligjit.

Me që ra fjala për këtë, do të doja të shtoja se ka plot njerëz në komunitetin e kultivuesve të cilët gjithmonë janë përkjekur të praktikojnë drejt niveleve të larta. Ata kanë shkuar gjithandej dhe kanë harxhuar gjithë ato para. Megjithatë nuk e kanë gjetur mjeshtrin e njohur që kërkonin edhe pasi kërkuan në të gjithë vendin. Të jesh i njohur nuk do të thotë se me të vërtetë i din gjërat mirë. Në fund të fundit, këta njerëz udhëtuan kudo, duke harxhuan shumë para dhe fuqi për asgjë. Sot po ju njohim me këtë praktikë të jashtëzakonshme. Ja u kam prurë në prag të derës. Varet nga ju nëse mund të praktikoni kultivim dhe në ja arrini atij. Nëqoftëse ju mund ta bëni këtë, atëhere vazhdoni kultivimin. Nëqoftëse nuk mund ta bëni apo nuk mund të praktikoni kultivim, që sot e tutje harrojeni praktikën kultivuese. Përveç djajve që do t’ju mashtrojnë, askush tjetër nuk do t’ju mësojë dhe në të ardhmen nuk do të mund të praktikoni kultivim. Nëqoftëse nuk mund t’ju shpëtoj dot unë, askush

tjetër nuk do të mundte. Në fakt, të gjesh një mjeshtër të një praktike të vërtetë që të të mësojë është më e zorshme se sa të ngjitesh në parajsë. Askush nuk kujdeset më për këto gjëra. Në Periudhën e Fund-Dharmës, edhe nivelet shumë të larta janë në periudhën e tyre të fundit. Askush nuk po kujdeset për njerëzit. Kjo është shkolla më e përshtatshme për praktikë. Për më tepër, praktikohet drejtpërdrejt sipas karakteristikës së universit. Është shtegu më i shpejtë dhe më i drejtpërdrejtë dhe e vë theksin pikërisht tek mëndja e njeriut.

Qarku Qiellor

Në Shkollën Tao, mësohen Qarku Qiellor i Madh dhe i Vogël. Le të shpjegojmë çfarë është “qarku qiellor”. Qarku qiellor të cilit i referohemi zakonisht është lidhja e dy kanaleve të energjisë⁸ të *ren* dhe *du*. Ky qark qiellor është i cekët dhe nuk është për më shumë se shërim dhe mbajtje të trupit në formë. Ky quhet Qarku Qiellor i Vogël. Një tjetër qark qiellor që nuk quhet as “qark qiellor i vogël” dhe as “qark qiellor i madh” është një formë qarku qiellor për të praktikuar kultivim në meditim. Duke filluar brenda trupit, ai shkon rreth niwan dhe ulet poshtë deri në dantian ku kthehet përsëri dhe shkon lart. Ky është një qarkullim i brendshëm. Ky është Qarku i vërtetë Qiellor për të praktikuar kultivim në meditim. Pasi formohet ky qark qiellor, ai do të kthehet në një rrymë energjie shumë të fuqishme e cila pastaj do të vërë në lëvizje qindra kanale energjie nëpërmjet një kanali të vetëm energjie në mënyrë që të hapë të gjitha kanalet e tjera të energjisë. Shkolla Tao mëson Qarkun Qiellor ndërsa Buddhizmi nuk e mëson atë. Çfarë mëson Buddhizmi? Kur Sakyamuni përhapi Dharmën e tij, ai nuk shpjegoi praktikën e ushtrimeve dhe as i mësoi ai ato. Megjithatë praktika e tij ka gjithashtu formën e vet të transformimit në praktikën kultivuese. Si lëviz kanali energjisë në Buddhizëm? Ai fillon nga dhe shkon përmes pikës baihui. Pastaj shkon nga maja e kokës për në pjesën e poshtme të trupit në formë spirale dhe në fund nëpërmjet kësaj metode vë në lëvizje qindra kanale energjie duke i hapur ato.

Kanali qendror i energjisë në fenë Tantrike i shërben gjithashtu këtij qëllimi. Disa thonë se nuk ka kanal qendror energjie. Atëhere si mundën njerëzit të zhvillojnë një kanal qendror energjie në fenë Tantrike? Në fakt kur të gjitha kanalet e energjisë në trupin e njeriut mblidhen së bashku, ato numërojnë në mbi dhjetë mijë në numër. Ato ndërthuren vertikalisht dhe horizontalisht tamam si enët e gjakut dhe madje numërojnë më shumë se enët e gjakut; nuk ka enë gjaku ndërmjet organeve të brendshme, por ka kanale energjie. Ato do të lidhen vertikalisht dhe horizontalisht nga maja e kokës deri në pjesët e ndryshme të trupit. Mbase ato nuk janë të drejta në fillim dhe do të hapen me qëllim që të lidhen me të tjerat. Ato pastaj do të zgjerohen gradualisht dhe dalëngadalë formojnë një kanal të drejtë energjie. Ai kanal energjie shërben si bosht dhe duke u rrotulluar vë në lëvizje shumë rrathë konceptuale në rrotullim horizontal. Qëllimi është të hapë të gjitha kanalet e energjisë në trup.

Praktika kultivuese në Falun Dafën tonë shmang përdorimin e kësaj metode të një kanali energjie që vë në lëvizje qindra kanale energjie. Që në fillim, ne kërkojmë që qindra kanale energjie të hapen dhe të bëjnë rrotullime të njëkohshme. Menjëherë ne praktikojmë në një nivel shumë të lartë dhe evitojmë gjërat e një niveli të ulët. Për disa njerëz, që ata të hapin qindra kanale energjie me një kanal të vetëm, edhe një jetë e tërë mund të mos ishte e mjaftueshme. Disa njerëz duhet të praktikojnë kultivim për dekada të tëra dhe kjo është shumë e vështirë. Shumë praktika thonë se një jetë nuk mjafton për t’ja arritur në kultivim, ndërsa ka shumë praktikues në praktika niveli të lartë të cilët mund ta zgjasin jetën e tyre—a nuk flasin ata për kultivimin e jetës? Ata mund ta zgjasin jetën e tyre në mënyrë që të praktikojnë kultivim që do të zgjasë një kohë shumë të gjatë.

⁸ kanale energjie—në mjekësinë kineze thuhet se ato janë përçues të qi-së dhe formojnë një rrjet kompleks për qarkullimin e energjisë.

Qarku i Vogël Qiellor është në fakt për shërim e mbajtje trupi në formë, ndërsa Qarku i Madh Qiellor është për të praktikuar gong—domethënë kur personi praktikon kultivim me të vërtetë. Qarku i Madh Qiellor që përmendet në Shkollën Tao nuk vjen aq i fuqishëm sa i joni që hap qindra kanale energjie menjëherë. Rrotullimi i Qarkut të Madh Qiellor në Shkollën Tao i referohet asaj kur shumë kanale energjie udhëtojnë nga kanalet Tre Yin dhe Tre Yang⁹ të duarve të personit për në tabanin e këmbëve, në të dy këmbët, tek flokët dhe në të gjithë trupin. Ky është Qarku i Madh Qiellor në lëvizje. Sapo Qarku i Madh Qiellor vihet në lëvizje, kjo do të thotë se po praktikon gong. Prandaj, disa mjeshtër qigongu nuk e mësojnë Qarkun e Madh Qiellor sepse ajo që mësojnë ata është vetëm për shërim dhe mbajtje të trupit në formë. Disa njerëz flasin për Qarkun e Madh Qiellor, por ata nuk kanë vendosur ndonjë gjë në trupin tuaj dhe ju nuk mund t'i hapni ato vetë. Pa një sistem të instaluar, si mund të hapen kanalet kollaj duke u mbështetur vetëm në një mendim të qëllimshëm. Është një lloj si të bësh akrobacira—si mund të hapen ato? Kultivimi varet nga përpjekjet e individit ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri. Vetëm pasi të është dhënë “mekanizmi” i plotë i brendshëm, mundet të arrihet ky rezultat.

Historikisht Shkolla Tao e ka konsideruar trupin e njeriut një univers të vogël: Ajo beson se pjesa e jashtme e universit është aq e madhe sa dhe pjesa e brendshme dhe se pjesa e jashtme duket e njejtë me atë të brendshme. Kjo pikëpamje duket e pakonceptueshme dhe jo aq e lehtë për t'u kuptuar. Ky univers është kaq i madh, si mund të krahasohet ai me një trup njeriu? Po sjellim këtë argument: Fizika e sotme studjon elementet e materies nga molekula, atomi, elektroni, protoni deri tek quarket e neutrino. Por çfarë grimce është më tutje? Mikroskopi nuk mund ta zbulojë më. Kështu cila do të ishte pjesëza mikroskopike e radhës? Nuk dihet. Në fakt, ajo që kupton fizika jonë sot është kaq larg nga pjesëza më e vogël mikroskopike e universit. Kur dikush nuk ka këtë trup mishi, sytë e tij do të jetë të aftë të shikojnë gjërat me shikim të zmadhuar dhe do të shikojnë nivelin mikroskopik. Sa më i lartë niveli i tij, aq më i madh niveli mikroskopik që ai mund të shikojë.

Në nivelin e tij, Sakyamuni solli teorinë e tre mijë botëve që do të thotë se në Kashtën tonë të Kumtrit gjënden gjithashtu dhe njerëz me trupa prej mishi si ato të racës sonë njerëzore. Ai gjithashtu pat thënë se një grimcë rëre përmban tre mijë botë dhe kjo përputhet me të kuptuarit në fizikën tonë moderne. Cili është ndryshimi ndërmjet rrotullimit të elektronëve që rrotullohen rreth bërthamës dhe asaj të Tokës që rrotullohet rreth diellit? Prandaj, Sakyamuni pat thënë që në nivel mikroskopik, një kokrrizë rëre përmban tre mijë botë. Është pikërisht si një univers me jetë dhe materie brenda. Nëqoftëse kjo është e vërtetë, pa mendoni pak: A ka rërë në botët e kësaj kokrrizë rëre? Atëhere a nuk do të ndodhen tre mijë botë në secilën kokrrizë rëre të asaj rëre? Atëhere a nuk do të ketë rërë edhe në këto tremijë botë brenda secilës kokrrizë rëre të rërës? Është e pafund po të vazhdojmë kështu. Prandaj, edhe kur arriti nivelin e Tathagatës, Sakyamuni pat thënë: “Është kaq i pafund sa nuk ka kufi të jashtëm dhe kaq i vockël sa nuk ka kufi të brendshëm.” Është kaq i pamasë sa ai nuk mund të shihte perimetrin e universit, megjithatë kaq i vockël sa ai nuk mund të dallonte pjesëzën më mikroskopike të origjinës së materies.

Një mjeshtër qigongu pat thënë: “Gjendet një qytet i tërë në një pore trupi me trena dhe makina që lëvizin.” Kjo tingëllon krejt e pakonceptueshme, por ne na duket se ajo nuk është e pakonceptueshme po ta kuptojmë e studjojmë nga perspektiva shkencore. Kur fola për hapjen e Syrit Qiellor, shumë persona gjatë hapjes së Syrit Qiellor patën këtë eksperiencë: Ata panë sikur po vraponin përgjatë një tuneli në ballin e tyre dhe nuk arrinin dot fundin. Çdo ditë gjatë praktikës ata ndjenin sikur po vraponin gjatë një rruge me male dhe lumenj në të dy anët. Ndërsa vraponin ata kalonin përmes qytetesh dhe shikonin plot njerëz dhe mund të kujtonin se ishte vegim. Çfarë po ndodh? Ajo që shikohet është shumë e qartë dhe jo vegim. Unë e kam thënë se nëqoftëse trupi i njeriut është me të vërtetë aq i pafund në nivelin mikroskopik, atëhere nuk është vegim. Shkolla Tao

⁹ Tre Yin dhe Tre Yang—një emër për meridianët tre yin dhe tre yang të duarve dhe të këmbëve.

e ka konsideruar gjithmonë trupin e njeriut një univers. Nëqoftëse është me të vërtetë një univers, distanca nga balli deri tek gjendra pineale do të ishte mijra kilometra. Ti mund të turresh drejt daljes por është distancë shumë e largët.

Nëqoftëse Qarku i Madh Qiellor është plotësisht i hapur gjatë periudhës së praktikës kultivuese, do t'i sjellë praktikuesit një aftësi supernormale. Cilën aftësi supernormale? Ju e dini që Qarku i Madh Qiellor quhet gjithashtu “qarku qiellor i meridianit”, “rrotullimi *qiankun*,¹⁰” apo “rrotullimi *heche*.¹¹” Në nivel të ulët, rrotullimi i Qarkut të Madh Qiellor do të formojë një rrymë energjie e cila gradualisht do të bëhet më e dendur duke u transformuar drejt nivelesh më të larta dhe duke u bërë një brez i gjërë energjie me dendësi të lartë. Ky brez energjie do të bëjë lëvizje rrotulluese. Gjatë rrotullimit, ne mund të shohim me një Sy Qiellor niveli shumë të ulët se ai mund të bëjë që qi-ja të lëvizë nga një vend në tjetrin brenda trupit të personit. Qi-ja e zemrës mund të lëvizë në zorrë apo qi-ja e mëlçisë mund të shkojë në stomak ... Në nivel mikroskopik ne mund të shikojmë që ajo që transportohet është diçka shumë e madhe. Nëqoftëse ky brez energjie çlirohet jashtë trupit të personit, atëhere kemi aftësinë e telekinesis: dikush me gong shumë të fuqishëm mund të lëvizë diçka shumë të madhe dhe kjo quhet Telekinesis i Madh; dikush me gong shumë të dobët mund të lëvizë diçka shumë të vogël dhe kjo quhet Telekinesis i Vogël. Këto janë dy tipet e telekinesis dhe si formohen ato.

Qarku i Madh Qiellor lidhet drejtpërdrejt me praktikimin për gong. Kështu, ai sjell gjendje dhe forma të ndryshme gongu. Gjithashtu do të na sjellë dhe një gjendje shumë të veçantë. Çfarë gjendje? Të gjithë mund ta kenë lexuar këtë shprehje të quajtur “ngritje në ajër në mes të ditës” (*bairi feisheng*) në libra të lashtë si *Biografia e të Pavdekshmëve*, *Libri i Elikzirit*, *Kanuni Taoist*, apo *Udhëzues për të Gjetur Naturën dhe Jetëgjatësinë*. Ajo do të thotë që personi mund të ngrihet në ajër në mes të ditës. Në fakt, po ju them se një person mund të ngrihet në ajër me t’ju hapur Qarku i Madh Qiellor—është kaq e thjeshtë. Disa njerëz mendojnë se ka disa njerëz Qarku i Madh Qiellor i të cilëve është hapur pas kaq vitesh praktike. Unë do të thoja se nuk është për t’u habitur që dhjetëra mijra vetë të kenë arritur këtë nivel sepse Qarku i Madh Qiellor është në fund të fundit vetëm hapi fillestar i praktikës kultivuese.

Atëhere, pse nuk i ka parë njeri ata duke u ngritur në ajër apo duke fluturuar? Gjendja e shoqërisë njerëzore nuk mund të prishet dhe as mund të ndërhyhet apo ndryshohet forma e saj sipas dëshirës. Si mund të lejohet që njerëzit të fluturojnë në ajër? A do të ishte kjo një shoqëri njerëzore? Ky është aspekti kryesor i çështjes. Nga një perspektivë tjetër, qëniet njerëzore nuk jetojnë në mes të njerëzve të zakonshëm për të qenë njerëz, por për t’u kthyer në origjinë, në veten e tyre të vërtetë. Kështu ekziston çështja e ndriçimit shpirtëror për ta kuptuar këtë. Nëqoftëse dikush sheh se me të vërtetë shumë njerëz mund të ngrihen në ajër, edhe ai do të dojë të praktikojë kultivim dhe nuk do të ekzistonte më çështja e zgjimit ndaj kuptimit të saj. Prandaj, nëqoftëse ju mund t’ja arrini të ngriheni në ajër nëpërmjet kultivimit, ju nuk mund t’ja tregoni të tjerëve ashtu shkarazi apo ta demonstroni këtë para të tjerëve sepse dhe ata duhet të praktikojnë kultivim. Për pasojë, pasi Qarku juaj i Madh Qiellor hapet, ju nuk do të mund të jeni në gjendje të ngriheni në ajër nëqoftëse maja juaj e gishtit apo gishti këmbës apo ndonjë pjesë tjetër e trupit është kyçur.

Kur Qarku ynë i Madh Qiellor është gati të hapet, një situatë do të ndodhë ku disa njerëz do të përkulen përpara gjatë meditimit ulur. Meqenëse qarkullimi në kurriz është hapur më mirë, kurrizi do të ndjehet shumë më i lehtë ndërsa pjesa e përparme e trupit do të ndjehet e rëndë. Disa njerëz përkulen nga prapa dhe ndjejnë kurrizin të rëndë ndërsa pjesën e përparme të trupit më të lehtë. Nëqoftëse i tërë trupi juaj është hapur mirë, ju do të ndjeni sikur ju ngrejnë lart, sikur ngrihesh në ajër. Kur të ngriheni në ajër me të vërtetë, ju nuk do të lejoheni të ngriheni në ajër. Por kjo nuk është absolute. Ata që zhvillojnë aftësi supernormale janë zakonisht në dy ekstremet: Fëmijët nuk kanë

¹⁰ *qiankun*—“qiell dhe tokë.”

¹¹ *heche*—“mjet lumi.”

dëshira dhe po ashtu dhe të moshuarit—veçanërisht gratë e moshuara. Ata mund ta zhvillojnë me lehtësi dhe mund ta ruajnë këtë aftësi. Për meshkujt, veçanërisht të rinjtë, me të zhvilluar këtë aftësi ata nuk do të mund ta heqin mëndjen nga të mburrurit. Në të njejtën kohë, ata mund ta përdorin atë si mënyrë për të konkuruar me njerëzit. Kështu ajo nuk lejohet të ekzistojë dhe do të kyçet sapo të zhvillohet gjatë praktikës. Nëqoftëse një pjesë e trupit është kyçur, ky person nuk do të mund të ngrihet në ajër. Kjo nuk do të thotë se ju jeni krejtësisht të ndaluar ta keni këtë aftësi. Ju mund të lejoheni ta provoni atë dhe disa njerëz janë të aftë ta mbajnë.

Këto situata ndodhin sa herë që jap leksione. Kur dhashë një klasë në Shangdon, aty ndodheshin praktikues nga qytetet e Beijing dhe Jinan. Dikush pyeti: “Mësues, çfarë po ndodh me mua? Ndërsa eci, ndjehem sikur po ngihem nga toka. Po ashtu dhe kur fle ndjej sikur po ngrihem në ajër. Edhe mbulesat e krevatit ngrihen lart si balonë”. Kur dhashë një klasë në Guiyang, ishte një praktikuese veterane nga Guizhou e cila ishte grua e moshuar. Ajo kishte dy krevate në dhomën e saj, njëri në një anë të murit dhe tjetri në anën tjetër të murit. Kur ajo ishte ulur në meditim mbi krevat, ajo ndjeu që u ngrit në ajër dhe kur hapi sytë e gjeti veten se kishte kaluar në krevatin tjetër. Ajo mendoi me vete, “Duhet të kthehem tek krevati im,” dhe kështu fluturoi mbrapsht tek krevati tjetër.

Ishte një praktikues në qytetin Qingdao i cili meditonte mbi një krevat gjatë pushimit të drekës kur asnjëri nuk ishte në zyrën e rojes. Sapo ulej aty ai ngrihej dhe lëvizte nja një metër lartësi lart e poshtë me forcë. Ai mund të ulej poshtë pasi ngrihej dhe kjo përsëritej. Mbulesat e krevatit i ranë poshtë. Ai ishte pak i gëzuar dhe paksa i frikësuar. Kjo lëvizje lart e poshtë zgjati gjithë kohën e drekës. Së fundi, zilja ra dhe ai mendoi me vete: “Nuk duhet ta shohin të tjerët këtë. Ata do mendojnë çfarë po ndodh. Duhet të ndaloj menjëherë.” Ai ndaloi. Kjo është arsyeja që ata me moshë të shkuar mund të sillen siç duhet. Nëqoftëse kjo do t’i kishte ndodhur një të riu, kur zilja e zyrës do binte ai do të mendonte: “Hajdeni të gjithë të më shikoni si ngrihem unë në ajër.” Kështu dikush do e kishte të vështirë të kontrollonte mentalitetin e të mburrurit: “Shikoni sa mirë kam praktikuar. Unë mund të ngrihem në ajër.” Sapo ai ta demonstronte, aftësia do t’i ikte sepse nuk lejohet të ekzistojë në këtë mënyrë. Ka plot raste të tilla mes praktikuesve kudo.

Ne duam që qindra kanale energjie të hapen që në fillim. Deri më sot, tetëdhjetë deri nëntëdhjetë përqind e praktikuesve tanë kanë arritur gjendjen ku trupat e tyre janë shumë të lehtë dhe pa sëmundje. Në të njejtën kohë, ne kemi thënë se në këtë klasë ne jo vetëm që ju ngrejmë në gjendjen ku trupi juaj është plotësisht i pastruar, por gjithashtu shumë gjëra ju vendosen në trup në mënyrë që ju të zhvilloni gong në këtë klasë. Është njësoj sikur unë t’ju kem ngritur juve lart dhe pastaj t’ju kem shtyrë përpara. Unë ja kam mësuar Ligjin secilit në këtë klasë dhe gjithashtu karakteri i secilit ka pësuar ndryshim të vazhdueshëm. Kur të dilni jashtë këtij auditori, shumë prej jush do të ndjehen njerëz të ndryshuar dhe pikëpamja juaj për botën është e garantuar që do të ndryshojë. Ju do të dini si të silleni në të ardhmen dhe ju nuk do të jeni si në mjergull si më parë. Është e garantuar që do të jetë kështu. Kështu, edhe karakteri juaj do të arrijë nivelin e trupit.

Meqë po flasim për Qarkun e Madh Qiellor, megjithëse juve nuk ju lejohet të ngriheni në ajër, ju do të ndjeni që trupi juaj është i lehtë sikur qëndron në ajër. Më përpara, ju lodheshit kur ecnit disa hapa, ndërsa tani e keni shumë të lehtë pamvarësisht sa larg ecni. Ju ndjeheni sikur ju shtyn njeri kur jeni me biçikletë dhe nuk jeni i lodhur kur hypni shkallët pamvarësisht sa kate të jenë. Është e sigurtë që do të jetë kështu. Ata që lexojnë këtë libër dhe praktikojnë kultivim vetë gjithashtu do të arrijnë atë nivel që u takon. Unë si person nuk them atë që nuk dua të them, por ajo që them duhet të jetë e vërtetë. Veçanërisht në këto kushte, nëqoftëse unë nuk them të vërtetën kur ju mësoj Ligjin, nëqoftëse bëj deklaratatë të pakonceptueshme apo nëqoftëse flas kot dhe pa kujdes, unë do t’ju mësoja një Ligj të shtrembër. Nuk është e lehtë që unë ta bëj këtë sepse i gjithë universi po vëzhgon. Nuk lejohet që të ketë devijim.

Një njeri i zakonshëm do të njohë vetëm këtë Qark të Madh Qiellor dhe kjo do të ishte e gjitha. Në fakt, kjo nuk është e mjaftueshme. Në mënyrë që trupi të zëvendësohet dhe transformohet

plotësisht nga materia me energji të lartë sa më shpejt, duhet të jetë dhe një qark tjetër qiellor që vë në lëvizje të gjithë kanalet e energjisë në trupin tuaj. Ky quhet Qarku Qiellor *Maoyuo*¹² dhe ai me siguri që njihet nga shumë pak njerëz. Ky term përmendet në libra me raste, por askush nuk ja u ka shpjeguar apo treguar juve. Diskutohet vetëm si teori sepse është sekret i sekreteve. Ne do të zbulojmë çdo gjë mbi të këtun. Ai mund të fillojë nga pika baihui (apo dhe nga pika huiyin) dhe del jashtë duke lëvizur përgjatë kufirit të yin dhe yang. Pastaj lëviz nga veshi poshtë në shpatull, duke shkuar rreth e qark secilit gisht, anës së trupit dhe pastaj zbret poshtë në taban të këmbës. Pastaj ngjitet lart anës së brendshme të njërës kofshë dhe poshtë anës së brendshme të kofshës tjetër duke kaluar përmes tabanit të këmbës tjetër dhe duke u ngjitur lart anës tjetër të trupit. Përsëri lëviz rreth e rrotull secilit gisht dhe arrin majën e kokës duke përfunduar kështu një rreth të plotë. Ky është Qarku Qiellor Maoyou. Të tjerët mund të shkruajnë një libër për të, e unë e përmbloodha në pak fjalë. Unë mendoj se nuk duhet të konsiderohet sekret qiellor, megjithatë të tjerët i konsiderojnë këto gjëra shumë të çmuara dhe nuk i diskutojnë ato veçse kur mësojnë dishepujt e tyre. Megjithëse unë e zbulova atë për ju, askush nuk duhet të përdorë mendimin me qëllim që ta udhëheqë apo kontrollojë atë gjatë praktikës. Nëqoftëse e bëni këtë, ju nuk po praktikoni Falun Dafën tonë. Praktika e vërtetë drejt niveleve të larta kryhet në gjendje wuwei dhe e çliruar nga çdo aktivitet mendor. Çdo gjë është e instaluar në trupin tuaj e gatshme. Ato formohen automatikisht dhe këto mekanizma të brendshëm ju kultivojnë; ato do të bëjnë rrotullime automatike kur t'ju vijë koha. Një ditë gjatë praktikës, koka juaj mund të shkojë nga një anë në tjetrën. Nëqoftëse koka juaj shkon në këtë anë, po rrotullohet në atë anë. Nëqoftëse koka lëkundet në anën tjetër, po rrotullohet në atë anë. Rrotullohet në të dyja anët.

Kur hapen Qarku i Madh apo i Vogël Qiellor, koka e personit do të ulet përpara gjatë meditimit ulur dhe kjo është shenjë që po kalon energji. E njejtja gjë është e vërtetë me Qarkun Qiellor Falun që praktikojmë ne; ne thjesht praktikojmë në këtë mënyrë. Në fakt, kur ju nuk po praktikoni, ai rrotullohet vetë. Do të rrotullohet vazhdimisht përgjithmonë; kur ju praktikoni, ju përforconi mekanizmat. A nuk kemi thënë ne që Ligji kultivon praktikuesit? Normalisht, ju do të zbuloni se Qarku juaj Qiellor është gjithmonë në rrotullim. Megjithëse ju nuk jeni duke praktikuar, një radhë mekanizmash energjie të instaluara jashtë trupit tuaj, domethënë një radhë kanalesh të gjërë të jashtëm po e vënë trupin tuaj në praktikë—është e tëra automatike. Gjithashtu mund të rrotullohet në anë të kundërt sepse rrotullohet nga të dyja anët dhe është vazhdimisht duke hapur kanalet e tua të energjisë.

Kështu cili është qëllimi i hapjes së Qarqeve Qiellorë? Hapja e Qarqeve Qiellorë nuk është qëllimi i praktikës. Edhe pasi hapet Qarku juaj Qiellor, unë do të thoja se përsëri nuk është asgjë. Nëse praktika e personit vazhdon më tutje, nëpërmjet metodës së hapjes së Qarkut Qiellor synohet që të hapen qindra kanale energjie nëpërmjet një kanali energjie dhe kështu personi mund të hapë të gjitha kanalet e energjisë së trupit. Ne kemi filluar tashmë ta bëjmë këtë. Me praktikë të mëtejshme personi do të zbulojë se me rrotullimin e Qarkut të Madh Qiellor kanalet e energjisë do të bëhen të gjëra sa një gisht dhe mjaft të gjërë brenda. Meqenëse edhe energjia është bërë shumë e fuqishme, pasi të formohet rryma e energjisë, ato do të bëhen shumë të gjërë dhe të ndritshëm. Kjo akoma nuk është ndonjë gjë e madhe. Kur do të jetë praktika optimale? Kur qindra kanale energjie të personit gradualisht bëhen më të gjëra, me energji që bëhet gjithmonë e më e fortë dhe më e ndritshme. Së fundi, mijra kanale energjie do të bashkohen me njeri tjetrin dhe do e kthejnë trupin e personit në një që nuk ka më kanale energjie apo pika akupunture; ato do të bashkohen së bashku për të formuar një trup të plotë. Ky është qëllimi final në hapjen e kanaleve të energjisë. Qëllimi është të transformohet trupi njeriut plotësisht nga materia me energji të lartë.

Në këtë pikë, trupi i personit do të transformohet nga materie prej energjie të lartë. Me fjalë të tjera, personi ka arritur nivelin më të lartë në kultivimin e Ligjit-Në-Botën-Trefishe. Trupi njerëzor

¹² *maoyou*—kufiri ndarës ndërmjet anëve të yin dhe yang të trupit.

prej mishi do të jetë kultivuar në pikën përfundimtare. Në këtë kohë, personi do të kalojë në një gjendje tjetër. Çfarë gjendjeje? Ky person do të ketë zhvilluar gong shumë të pasur. Në kultivimin e trupit apo gjatë kultivimit në Ligjin-Në-Botën-Trefishe, të gjitha aftësitë supernormale e çdo gjë tjetër do të zhvillohen. Megjithatë, në praktikën në mes të njerëzve, shumica e tyre janë të kyçura. Po ashtu, kolona e gongut të personit do të jetë rritur shumë lart. Të gjitha format e gongut do të përforcohen nga gongu i plotfuqishëm duke u bërë akoma më të fuqishme. Megjithatë ato mund të funksionojnë në këtë dimensionin tonë dhe nuk mund të veprojnë mbi asgjë në dimensione të tjera ngaqë janë aftësi supernormale të kultivuara nga trupat tanë njerëzorë. Pamvarësisht nga kjo ato do të jenë shumë të pasura. Në dimensione të ndryshme dhe përsa i përket formave të trupit në dimensione të ndryshme, do të ketë plot ndryshime. Gjërat që mbart ky trup në çdo nivel të dimensioneve do të jenë tepër reale dhe duken shumë të frikshme. Disa njerëz kanë sy në gjithë trupin dhe të gjitha poret e djersës në trup do të kthehen në sy. Do të ketë sy brenda gjithë fushës dimensionale të personit. Meqenëse është gong nga Shkolla e Buddhës, disa njerëz do të kenë pamjen e Bodhisattvës apo Buddhës mbi gjithë trupin. Të gjitha format e gongut do të kenë arritur shkallë të konsiderueshme. Po ashtu, shumë qenie të gjalla do të shfaqen.

Në këtë kohë, do të shfaqet një gjendje e quajtur “tre lule mbi kokë”. Është një gjendje shumë e dukshme dhe gjithashtu është diçka që nuk mund t’i shpëtojë syrit. Mund të shihet dhe me Sy Qiellor të nivelit të ulët. Personi do të ketë tre lule mbi kokë. Njëra është lule lotusi por nuk është lotusi në dimensionin tonë fizik. Dy lulet e tjera gjithashtu janë nga një dimension tjetër dhe janë jashtëzakonisht të bukura. Këto tre lule rrotullohen me radhë mbi kokë. Ato do të rrotullohen në drejtim të akrepave të orës dhe në drejtim të kundërt të akrepave dhe po ashtu secila lule rrotullohet rreth vetes. Secila lule do të ketë një bosht të madh të gjërë sa dhe diametri i lules. Këto tre boshte arrijnë deri lart në qiell, por ato nuk janë kolona gongu. Ato janë thjesht në këtë formë dhe janë jashtëzakonisht të mrekullueshme. Sikur ti shihnit, ju do të mbeteshin gjithashtu të mahnitur. Kur kultivimi i dikuajt arrin këtë shkallë, trupi i personit do të jetë i bardhë dhe i pastërt dhe lëkura do t’i bëhet e lëmuar dhe delikate. Në këtë kohë, personi do të ketë arritur formën më të lartë të kultivimit në Ligjin-Në-Botën-Trefishe, megjithatë kjo nuk është shkalla përfundimtare. Personi duhet të vazhdojë akoma të praktikojë kultivim dhe të përparojë.

Ndërsa ai përparon, ai do të hyjë në nivelin e ndërmjetëm midis Ligjit-Në-Botën-Trefishe dhe Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe të quajtur Trup i Tej Pastërt¹³ (gjithashtu i njohur si “trup si kristal”). Kur kultivimi i trupit fizik ka arritur formën më të lartë të Ligjit-Në-Botën-Trefishe, kjo do të thotë se vetëm trupi mishtor njerëzor është transformuar në formën më të lartë. Kur i gjithë trupi është me të vërtetë në këtë formë, ai është plotësisht i përbërë prej lënde energjie të lartë. Pse quhet ai Trup i Tej Pastërt? Sepse ky trup ka arritur tashmë pastërtinë absolute të shkallës më të lartë. Kur shihet me Syrin Qiellor, i gjithë trupi është transparent—tamam si qelq transparent. Kur e shikon nuk ka asgjë dhe ekziston në këtë mënyrë. Ta themi thjesht, ky trup është tashmë një trup Buddha. Kjo ndodh ngaqë trupi i përbërë nga lëndë energjie të lartë është i ndryshëm nga trupat tanë fizikë. Në këtë kohë të gjitha aftësitë supernormale dhe cilësitë mbinatyrale do të braktisen menjëherë. Ato do të vendosen në një dimension shumë të thellë, sepse janë të pavlefshme dhe nuk shërbejnë më për ndonjë funksion. Një ditë, në të ardhmen, kur ju të keni arritur sukses në kultivim, ju mund t’i hidhni një sy të kaluarës dhe rishikoni udhën tuaj të praktikës kultivuese duke i nxjerrë ato jashtë për t’i parë. Në këtë kohë vetëm dy gjëra do të mbeten: Kolona gongut është akoma aty dhe Foshnja e Pavdekshme e kultivuar do të jetë rritur dhe bërë shumë e madhe. Megjithatë të dyja këto ekzistojnë në një dimension të thellë që nuk mund të shikohet nga njeri me Sy Qiellor të nivelit mesatar. E vetmja gjë që dikush mund të shohë është se trupi i këtij personi është transparent.

¹³ Trup i Tej Pastërt—trup transparent në nivelin më të lartë të kultivimit në Ligj-Në-Botën-Trefishe.

Meqenëse shkalla e Trupit të Tej Pastërt është vetëm një nivel i përkohshëm, me praktikë kultivuese të mëtejshme personi do të fillojë me të vërtetë kultivimin në Ligjin-Përtej-Botës-Trefishe i njohur gjithashtu si kultivim i një Trup-Buddhe. I tërë trupi do të jetë i përbërë prej gongu. Tashmë karakteri i personit do të jetë bërë i qëndrueshëm. Ai do të fillojë të praktikojë kultivim nga fillimi dhe do të zhvillojë nga e para aftësitë supernormale që nuk duhet të quhen më “aftësi supernormale.” Ato duhet të quhen “fuqi hyjnore të Ligjit të Buddhës”, sepse ato mund të veprojnë në të gjitha dimensionet me fuqinë e tyre të pakufishme. Ndërsa ju vazhdoni të praktikoni kultivim në të ardhmen, ju vetë do të dini gjëra të niveleve të larta, si të praktikoni kultivim dhe format e ekzistencës së praktikës kultivuese.

Vesi i Zellit të Tepruar

Unë do të trajtoj një çështje, atë të vesit të zellit të tepruar. Shumë njerëz kanë praktikuar qigong për një kohë shumë të gjatë. Ka gjithashtu njerëz që nuk kanë praktikuar kurrë, por që kanë kërkuar dhe janë munduar të kuptojnë të vërtetën dhe kuptimin e jetës njerëzore. Sapo ata mësojnë Falun Dafën tonë, ata do të kuptojnë menjëherë shumë pyetje në jetë që kishin dashur t'i kuptonin por që nuk mund t'i përgjigjeshin. Mbase me përmirësimin e mendjes ata do të entuziazmohen së tepërmi—kjo me siguri që do të ndodhë. Unë e di që një praktikues i vërtetë do t'ja dijë rëndësinë dhe do ta vlerësojë atë. Megjithatë shpesh një problem ndodh: Për shkak të gëzimit njerëzor, personi do të zhvillojë zell të tepruar të panevojshëm. Kjo bën që ai të sillet anormal në veprimet e tij, në lidhje me të tjerët në shoqëri, apo në ambjentin e shoqërisë njerëzore. Unë them se kjo është e papranueshme.

Shumica e njerëzve në shkollën tonë do të praktikojnë kultivim në shoqërinë normale njerëzore, kështu ju nuk duhet ta distanconi veten nga shoqëria njerëzore dhe ju duhet të praktikoni kultivim me mendje të kthjellët. Marëdhëniet me njeri tjetrin duhet të mbeten normale. Sigurisht, ju keni një nivel karakteri shumë të lartë dhe një mendje të ndershme. Ju do të përmirësoni karakterin dhe nivelin tuaj; ju nuk kryeni vepra të këqija dhe vetëm kryeni vepra të mira— ju duhet të jeni kështu. Disa njerëz sillen sikur ose janë mendërisht anormale apo sikur i kanë parë të gjitha në këtë botë. Ata thonë gjëra që të tjerët nuk i kuptojnë. Të tjerët do thonë: “Si ka mundësi që një njeri që mëson Falun Dafën bëhet kështu? Duket se ka ndonjë problem mendor.” Në fakt nuk është kështu. Ai është thjesht tepër i entuziazmuar dhe kështu duket irracional dhe nuk vepron si normal. Mendojeni pak të gjithë: Të vepruarit kështu është gjithashtu i gabuar dhe ju keni shkuar në ekstremin tjetër— është prapëprap një ves. Ju duhet të hiqni dorë dhe të praktikoni kultivim ndërsa jetoni normalisht si gjithë të tjerët në mes të njerëzve. Nëqoftëse njerëzit e tjerët ju konsiderojnë të marrosur, ata nuk do të merren me ju dhe do t'ju qëndrojnë larg. Askush nuk do t'ju japë mundësi për të përmirësuar karakterin dhe as do t'ju trajtojnë si njeri normal. Unë do të thojë se kjo nuk është e pranueshme! Prandaj, secili duhet të sigurohet dhe të ketë mendjen ndaj kësaj çështjeje dhe të sillet mirë.

Praktika jonë nuk është si praktikatat e zakonshme që e bëjnë personin të humbë mendjen, të bie në kllapi, apo të obsesohet. Praktika jonë kërkon që ju të kultivoni veten me vetëdije të plotë. Dikush më thosh gjithmonë: “Mësues, sapo mbydh sytë trupi fillon më kolovitet.” Unë do të thojë se nuk është e thënë të jetë kështu. Ti ke zhvilluar zakonet e braktisjes së Ndërgjegjes Kryesore. Sapo mbydh sytë ti do e vësh Ndërgjegjen Kryesore në gjumë dhe ajo do të zhduket. Ti ke zhvilluar tashmë këtë zakon. Ndërsa rrin ulur këtu, pse nuk kolovitet trupi jot? Kur ti mban gjendjen e njejtë me atë kur i ke sytë të hapura, a do të kolovitet trupi jot me sytë paksa të mbydhur? Jo aspak. Ti mendon se qigongu duhet të praktikohet në këtë mënyrë dhe ke formuar këtë koncept. Me të mbydhur sytë, ti do të zhdukesh pa e ditur se ku ndodhesh. Ne kemi thënë se Ndërgjegja juaj Kryesore duhet të jetë e vetëdijshme, sepse kjo praktikë kultivon veten tënde. Ju duhet të përparoni me mendje të vetëdijshme. Ne gjithashtu kemi dhe një ushtrim meditimi. Si praktikojmë ne meditim? Ne kërkojmë

nga secili që pamvarësisht nga sa thellë që mediton, ju duhet të dini që jeni ju duke praktikuar aty. Ju jeni absolutisht të ndaluar të bini në një gjendje kllapie ku nuk dini asgjë. Më pas çfarë gjendje e veçantë do të shfaqet? Ndërsa rrini i ulur aty, ju duhet të jeni në një gjendje të mrekullueshme dhe shumë të rehatshme sikur jeni ulur brenda një veze; ju do të jeni të vetëdijshëm se ju po praktikoni ushtrimet, por ndjeni se gjithë trupi nuk mund të lëvizë. Kjo duhet të ndodhë në praktikën tonë. Ka dhe një gjendje tjetër, ku ndërsa personi rrin ulur në meditim për ca kohë, atij i duket sikur i kanë ikur këmbët dhe nuk mund të mendojë dot se ku i shkuan; trupi gjithashtu i ikën; krahët i ikën; po ashtu dhe duart—mbetet vetëm koka. Ndërsa ai vazhdon praktikën, ai sheh se dhe koka i ikën duke lënë vetëm mendjen e tij dhe pak vetëdije se ai po praktikon aty. Është e mjaftueshme nëqoftëse ju mund të arrini këtë gjendje. Pse? Kur dikush praktikon në këtë gjendje, trupi po i transformohet plotësisht dhe është gjendja më optimale. Kështu ne kërkojmë që ju të arrini këtë gjendje qetësie. Por ju nuk duhet të bini në gjumë apo të humbisni ndërgjegjen, përmdryshe dikush tjetër po i praktikon gjërat e mira.

Të gjithë praktikuesit tanë duhet të sigurohen që të mos sillen kurrë anormal mes njerëzve. Nëqoftëse jep shembull të keq në mes njerëzve, të tjerët mund të thonë: “Pse njerëzit që mësojnë Falun Dafën sillen të gjithë kështu?” Është njësoj sikur të sabotosh emrin e Falun Dafës, kështu sigurohuni t’i kushtoni vëmendje kësaj çështjeje. Në çdo gjë dhe gjatë praktikës kultivuese secili duhet të sigurohet që të mos zhvillojë vesin e zellit të tepruar. Ky mentalitet mund të shfrytëzohet me lehtësi nga djajt.

Kultivimi i të Folurit

Kultivimi i të folurit kërkohej dhe nga fetë në të kaluarën. Megjithatë, kultivimi i të folurit që kërkonin fetë i përkiste kryesisht disa praktikuesve profesionistë—murgjëve Buddhistë dhe Taoistë të cilët nuk do e hapnin gojën për të folur. Meqenëse ishin praktikues profesionistë, ata donin të braktisnin dëshirat njerëzore në një shkallë më të madhe. Ata besonin se me të krijuar një mendim, ai është karmë. Fetë e kanë klasifikuar karmën si “karmë të mirë” dhe “karmë mëkatore”. Pamvarësisht në është karmë e mirë apo mëkatore, si nga pikëpamja e zbrazëtisë në Shkollën e Buddhës apo të asgjësë që mësohet nga Shkolla Tao, karma nuk duhet të krijohet. Prandaj, ata thonin se nuk do të bënin asgjë meqenëse nuk mund të shikonin lidhjet karmike të gjërave, domethënë, nëse gjërat ishin të mira apo të këqija, apo çfarë lidhje karmike ekzistonte diku. Një praktikues i zakonshëm i cili nuk ka arritur ndonjë nivel të lartë nuk mund t’i shikojë këto gjëra, kështu ai do të kishte frikë se megjithëse diçka dukej e mirë në sipërfaqe, ajo mund të ishte diçka e keqe kur bëhej. Prandaj, personi duhet të bëjë çmos të praktikojë wuwei dhe të mos bëj asgjë në mënyrë që të evitohet prodhimin e karmës. Kjo ndodh sepse me t’u prodhuar karmë, ai duhet ta eliminojë atë dhe të vuajë për të. Për shembull, për praktikuesit tanë është e paracaktuar në cilin nivel do të arrijnë lartësimin shpirtëror. Nëqoftëse ju pa qenë nevoja fusni diçka në mes të rrugës së kultivimit, ajo do të shkaktojë vështirësi për gjithë praktikën tuaj kultivuese. Kështu personi praktikon wuwei.

Kur Shkolla Buddhës kërkon kultivimin e të folurit, do të thotë që të folurit e personit kontrollohet nga mendja e tij dhe për pasojë të menduarit e personit ka qëllime. Nëqoftëse mendja e dikujt dëshiron të mendojë sado pak, shprehë diçka, bëjë diçka apo të drejtojë organet e shqisave dhe katër gjymtyrët, kjo mund të përbëjë një dëshirë njerëzore. Për shembull, ekzistojnë konflikte mes njeri tjetrit, si “ti je i mirë, ndërsa ai nuk është”, apo “kultivimi jot është i mirë, por i tij nuk është”. Këto janë konflikte. Le të flasim për diçka që është e zakonshme, si “Unë dua të bëj këtë apo atë gjë”, apo “kjo gjë duhet të bëhet tani në këtë mënyrë apo atë mënyrë.” Mbase pa dashje ajo do të dëmtojë dikë. Meqenëse konfliktet ndërpersonale janë të gjitha shumë të ndërlikuara, personi mund të prodhojë karmë pa dashje. Si pasojë, ai do ta mbyllë gojën plotësisht dhe nuk do të thotë asgjë. Në të

kaluarën, fetë e trajtonin kultivimin e të folurit si diçka shumë serioze dhe kjo është ajo që mësonin ato.

Shumica e praktikuesve tanë të Falun Dafës (domethënë përveç atyre praktikuesve profesionistë) praktikojnë kultivim në mes të njerëzve. Për pasojë ata nuk mund të evitojnë të bëjnë një jetë normale në shoqërinë njerëzore dhe të ndërveprojnë me shoqërinë. Secili ka një punë dhe duhet ta bëjë atë mirë. Disa njerëz duhet ta kryejnë punën nëpërmjet të folurit. Pra a nuk është ky një konflikt? Nuk përbën ndonjë konflikt. Pse jo? Kultivimi i të folurit që i referohemi ne është shumë i ndryshëm nga ai i të tjerëve. Për shkak të dallimeve në mënyrat e kultivimit dhe kërkesat janë të ndryshme. Ne duhet të gjithë të flasim sipas karakterit të një praktikuesi në vend që të krijojmë konflikte apo themi diçka të papërshtatshme. Si kultivues, ne duhet ta masim veten me standartin e Ligjit për të përcaktuar nëse duhet të themi diçka. Ajo që do të thuhet nuk do të sjellë probleme nëse personi është në përputhje me standartin e karakterit për një kultivues në përputhje me Ligjin. Po ashtu, ne duhet të flasim për të përhapur Ligjin, kështu është e pamundur të mos flasim. Kultivimi i të folurit që mësojmë ne i referohet: asaj që lidhet me famën dhe përfitimin personal të personit nga e cila ai nuk don të heqë dorë ndërsa është në shoqërinë njerëzore; ajo e cila nuk ka të bëjë aspak me punën aktuale të praktikuesve në shoqëri; thashethemet pa bazë në mes të praktikuesve në të njëjtën shkollë kultivimi; dëshirat që e bëjnë dikë të mburret; shpërndarja e asaj që dëgjohet apo e thashethemeve; apo ato diskutime në rrethe shoqërore që e ngacmojnë personin. Unë them se të gjitha këto janë dëshira të njerëzve të zakonshëm. Unë mendoj se në këto raste ne duhet të kemi kujdes çfarë themi—ky do të thotë kultivim i të folurit për të cilin ne flasim. Murgjit në të kaluarën i merrnin këto gjëra shumë seriozisht sepse sapo dikush fillonte të mendonte ai do të krijonte karmë. Prandaj, ata kultivonin “trupin, të folurin dhe mendjen”. Kultivimi i trupit për të cilin flisnin ata do të thoshte që dikush nuk duhej të kryente vepra të liga. Kultivimi i të folurit do të thoshte që dikush nuk do të fliste. Kultivim i mendjes do të thoshte që ai as dhe nuk do të mendonte. Në të kaluarën, kishte kërkesa të rrepta për këto gjëra në kultivimin profesionist në tempuj. Ne duhet të sillemi sipas standartit të karakterit të një kultivuesi. Duhet të jemi në rregull për aq kohë sa ne kuptojmë çfarë duhet e çfarë nuk duhet thënë.

LEKSIONI I NËNTË

Qigongu dhe Ushtrimet Fizike

Në një nivel të zakonshëm, njerëzit e marrin qigongun si diçka të lishur drejtpërdrejt me ushtrimet fizike. Sigurisht, në një nivel të ulët, qigong dhe ushtrimet fizike janë të njehta përse i përket arritjes së një trupi të shëndoshë. Megjithatë metodat e saj specifike të ushtrimeve dhe mënyrat që ajo përdor ndryshojnë shumë nga ato të ushtrimeve fizike. Që ta bëjë trupin të shëndetshëm nëpërmjet ushtrimeve, një individ duhet të rrisë sasinë e ushtrimeve dhe intensifikojë stërvitjen fizike. Ndërsa praktika qigongut është krejt e kundërta, sepse ajo nuk kërkon që të lëvizësh. Nëqoftëse ka ndonjë lëvizje, ajo është e butë, e ngadaltë dhe e hijshme. Madje është dhe pa lëvizje apo e ngrirë—kjo ndryshon shumë nga ushtrimet fizike përse i përket formës. Nga një perspektivë e lartë, qigongu nuk është i kufizuar vetëm me shërimin dhe mbajtjen e trupit në formë, sepse ai përfaqëson diçka të niveleve të larta dhe me përmbajtje më të thellë. Qigongu nuk është për ato gjërat e vogla në nivelin e njerëzve të zakonshëm. Ai është supernormal dhe ka manifestime të ndryshme në nivele të ndryshme. Është diçka që shkon përtej njerëzve të zakonshëm.

Përse i përket natyrës së ushtrimeve, ato gjithashtu ndryshojnë thelbësisht. Për ta përgatitur trupin për nivelin modern të konkurrencës dhe për të arritur ato kritere, një atleti, veçanërisht një atleti sot, i kërkohet që të rrisë sasinë e të ushtruarit. Prandaj, individ i duhet ta mbajë trupin gjithmonë në formë perfekte. Për të arritur këtë qëllim, individ i duhet të rrisë sasinë e ushtrimeve për ta bërë gjakun të qarkullojë siç duhet në trup, të përshpejtojë metabolizmin e tij dhe ta mbajë trupin gjithmonë në një gjendje që vjen duke u përmirësuar. Pse duhet të përshpejtohet metabolizmi? Sepse trupi i një atleti duhet të përmirësohet vazhdimisht dhe duhet të jetë në kushtet më të mira për konkurim. Trupi njeriut përbëhet nga qeliza të panumërta. Ato ndjekin të gjitha këtë lloj procesi: Jeta e qelizës së sapo ndarë është shumë e fuqishme dhe qeliza shfaq një gjendje rritjeje. Kur rritet në pikën më të lartë, ajo nuk rritet më dhe veç mund të bie në pikën e vet më të ulët. Një qelizë e re do e zëvendësojë atë pastaj. Për shembull, le të përdorim dymbëdhjetë orët e ditës për ta përshkruar këtë. Një qelizë ndahet në orën 6 të mengjesit dhe fillon të rritet. Kur arrin orën 8, 9 apo 10, këto janë të gjitha periudha të mira. Në kohën kur arrin dreka, ajo nuk mund të ngrihet më lart por vetëm mund të bjerë poshtë. Në këtë pikë, qelizës i ka mbetur akoma gjysma e jetës, por gjysma e mbetur është e papërshtatshme për gjendjen konkurrese të një atleti.

Çfarë duhet bërë atëhere? Individ i duhet të intensifikojë stërvitjen dhe të rrisë qarkullimin e gjakut dhe pastaj qelizat e sapo ndara mund të zëvendësojnë të vjetrat. Ndoth në këtë mënyrë. Kjo do të thotë se përpara se qeliza të mbaronte tërë kohën e saj apo kur vetëm të kishte jetuar gjysmën e jetës së saj, ajo do të zëvendësohej. Trupi kështu do ta ruante gjithmonë fuqinë dhe do të bënte përmirësime. Megjithatë qelizat njerëzore nuk mund të ndahen kështu pafundësisht, sepse numri i ndarjeve të qelizës nuk është në pafundësi. Supozojmë se një qelizë mund të ndahet vetëm njëqind herë në jetën e një personi. Në fakt mund të ndahet më shumë se një milion herë. Dhe supozojmë se kur qeliza ndahet njëqind herë për një person normal, ai mund të jetojë njëqind vjet. Por tani kjo qelizë ka jetuar vetëm gjysmën e jetës së saj, kështu ai mund të jetojë vetëm për pesëdhjetë vjet. Megjithatë ne nuk kemi parë ndonjë problem të madh t'u ndodhë atletëve, sepse atletët sot duhet të dalin në pension para moshës tridhjetë vjeç. Veçanërisht, tani niveli i konkurrencës është shumë i lartë dhe numri i atletëve të dalë në pension është gjithashtu i madh. Kështu një atlet mund të vazhdojë një jetë normale dhe kjo nuk duket t'i ketë ndikuar shumë. Teorikisht, është në përgjithësi kështu. Ushtrimet fizike mund të aftësojnë një individ të mbajë një trup të shëndetshëm, por do t'i shkurtojnë jetën. Nga paraqitja, një atlet adoleshent duket si një në të njëzetat, ndërsa një në të njëzetat duket si

një në të tridhjetat. Një atlet zakonisht duket sikur moshohet më shpejt. Nëqoftëse ka një avantazh nga njëra anë, nga një perspektivë tjetër është disavantazh. Në fakt kjo është rruga që ata marrin.

Praktika qigong është pikërisht e kundërta e ushtrimeve fizike. Ajo nuk kërkon lëvizje të sforcuara. Nëqoftëse ka ndonjë lëvizje, ajo është e butë, e ngadaltë dhe e hijshme. Është kaq e butë dhe e ngadaltë sa kthehet në pa lëvizje apo si e ngrirë. Ju e dini se metoda kultivuese e të qëndruarit në meditim kërkon arritjen e qetësisë. Çdo gjë, si për shembull rrahja e zembrës dhe qarkullimi i gjakut do të ngadalësohen. Në Indi, ka shumë mjeshtër Yoge të cilët mund të qëndrojnë në ujë apo të varrosur në tokë për ditë me rrallë. Ata mund ta bëjnë veten plotësisht si të ngrirë dhe madje të kontrollojnë rrahjet e zembrës. Të supozojmë se qelizat e një personi ndahen një herë në ditë. Një praktikues mund t'i bëjë qelizat e trupit të tij të ndahen një herë në dy ditë, një herë në javë, një herë në gjysmë muaji, apo madje dhe një herë për një periudhë më të gjatë. Atëhere ai e ka zgjatur tashmë jetën e tij. Kjo i referohet vetëm atyre praktikuesve që kultivojnë vetëm mendjen pa kultivuar trupin sepse ata mund ta arrijnë këtë dhe të zgjasin jetën e tyre. Dikush mund të pyesë: “A nuk është jeta e personit e paracaktuar? Si mund të jetojë dikush më gjatë pa kultivuar trupin?” Kjo është e vërtetë. Nëqoftëse niveli i një praktikuesi arrin përtej Tre Hapësirave, jeta e tij mund të zgjatet por nga jashtë ai do të duket shumë i plakur.

Një praktikë e vërtetë që kultivon trupin do të grumbullojë vazhdimisht energji të lartë të mbledhur në qelizat e trupit dhe vazhdimisht do të rrisë densitetin e energjisë për të kontrolluar gradualisht dhe për të zevëndësuar ngadalë qelizat e personit. Në këtë kohë do të ndodhë një ndryshim cilësor dhe ky person do të qëndrojë përgjithmonë i ri. Sigurisht, procesi i kultivimit është një proces shumë i ngadaltë dhe gradual dhe personi duhet të sakrifikojë shumë. Nuk është shumë e lehtë për një person të kalisë veten fizikisht dhe mendërisht. A mundet ai të qëndrojë i qetë në një konflikt me të tjerët që vë në provë karakterin e tij? A do t'i mbetet atij zemra e patunduar kur interesat e tij personale të jenë në rrezik? Është shumë e vështirë për ta bërë këtë, kështu nuk është se kur dikush don që ta arrijë këtë, ai mund ta arrijë. Vetëm kur karakteri dhe virtyti juaj janë përmirësuar mundeni ju ta arrini këtë.

Shumë njerëz e kanë konsideruar qigongun të jetë një ushtrim i zakonshëm fizik, kur në fakt ndryshimi është jashtëzakonisht i madh; ato nuk janë aspak e njejtë gjë. Vetëm kur praktikoni qi në nivelin më të ulët, që është për shërim dhe mbajtje trupi në formë dhe për të pasur një trup të shëndoshë, është ai i ngjashëm me ushtrimet fizike. Në nivel të lartë, ato janë plotësisht gjëra të ndryshme. Pastrimi i trupit në qigong ka gjithashtu qëllimin e tij dhe për më tepër, praktikuesve u kërkohet të ndjekin parime supernormale në vend të parimeve të njerëzve të zakonshëm. Ndërsa ushtrimet fizike janë diçka vetëm për njerëzit e zakonshëm.

Mendimet

Përsa i përket mendimeve, kjo i referohet aktiviteteve të mendjes sonë njerëzore. Në komunitetin e kultivuesve, si shikohen aktivitetet mendore në tru? Si i shikojnë ata format e ndryshme të të menduarit të njeriut? Dhe si shfaqen ato? Shkenca moderne akoma nuk mund të zgjidhë shumë pyetje në studimin e vet të trurit njerëzor, sepse nuk është aq e lehtë sa studimi i sipërfaqes së trupave tanë. Në nivele më të thella, dimensione të ndryshme marrin forma të ndryshme. Por gjithashtu nuk është si thonë disa mjeshtër qigongu. Disa mjeshtër qigongu nuk e dinë as vetë çfarë ndodh dhe as nuk mund ta shpjegojnë ata atë qartë. Ata mendojnë se me të përdorur mendjen e tyre dhe të kenë një mendim, ata do të mundin të bëjnë diçka. Ata pretendojnë se këto gjëra arrihen nga mendimet e tyre apo nga qëllimi që kanë në mendje. Në fakt, ato gjëra nuk kryhen aspak nga mendimet e tyre.

Para së gjithash, le të flasim për origjinën e mendimeve të njeriut. Në Kinën e lashtë, ekzistonte shprehja “të mendosh me zemër”. Pse quhej se zemra mendon? Shkenca e lashtë kineze

ishite shumë e përparuar sepse kërkimet e saj kishin për objekt studimi të drejtpërdrejtë gjëra të tilla si trupin e njeriut, jetën dhe universin. Disa njerëz me të vërtetë ndjejnë se mendojnë me zemer, ndërsa të tjerë ndjejnë se mendojnë me tru. Pse ndodh kjo situatë? Është shumë e arsyeshme kur disa njerëz flasin për mendim që vjen nga zemra. Kjo ndodh ngaqë siç e kemi konstatuar ne, Shpirti Primordial i një personi është shumë i vogël dhe mesazhet nga truri i njeriut nuk janë funksion i vetë trurit të njeriut—ato nuk prodhohen nga truri, por nga Shpirti Primordial i personit. Shpirti Primordial i personit nuk qëndron vetëm në Pallatin Niwan. Shkolla Taoiste quan Pallatin Niwan atë që shkencë moderne e quan gjendër pineale. Nëqoftëse Shpirti Primordial i personit është në Pallatin Niwan, atij do t'i duket se është truri ai që mendon apo po dërgon mesazhet. Nëqoftëse Shpirti Primordial është në zemrën e personit, atij do t'i duket se është zemra që po mendon.

Trupi i njeriut është një univers i vogël. Shumë qenie të gjalla në trupin e një praktikuesi janë të afta të shkëmbejnë vendet. Kur Shpirti Primordial ndryshon vendin e vet, nëse zhvendoset në bark, personit do t'i duket se është barku ai që mendon. Nëqoftëse Shpirti Primordial zhvendoset tek pulpa apo thembra, personit do t'i duket sikur me të vërtetë po mendon me pulpë apo thembër. Është e garantuar të jetë kështu, megjithëse duket shumë e pabesueshme. Edhe kur niveli juaj i kultivimit nuk është dhe aq i lartë, ju do ta ndjeni kur kjo ndodh. Nëqoftëse trupi i njeriut nuk ka Shpirtin Primordial dhe gjëra si temperamentin, karakterin dhe personalitetin, është vetëm një copë mishi dhe jo një person i plotë me individualitet. Kështu çfarë funksionesh ka truri i njeriut? Po të më pyesni mua, në këtë dimension fizik, truri i njeriut është vetëm një fabrikë përpunuese. Mesazhi në fakt prodhohet nga Shpirti Primordial. Megjithatë, ajo që transmetohet nuk është gjuhë, por një mesazh që ka një kuptim të caktuar. Me të marrë këtë komandë, truri ynë do e përpunojë atë në gjuhën e tanishme apo në formë të tjera të shprehjes; ne e shprehim atë nëpërmjet lëvizjeve të duarve, kontaktit me sy dhe me gjithë lëvizjet e trupit. Truri bën vetëm këtë. Në fakt komandat dhe mendimet vijnë nga Shpirti Primordial i personit. Njerëzit zakonisht mendojnë se ato janë funksione të drejtpërdrejta dhe të pavarura të trurit. Në fakt, Shpirti Primordial ngandonjëherë është në zemër kështu disa njerëz me të vërtetë ndjejnë sikur mendojnë me zemër.

Në kohën tonë, njerëzit që kryejnë kërkime mbi trupin e njeriut besojnë se ajo që transmeton truri i njeriut është diçka si një valë elektrike. Ne nuk do flasim tani për çfarë transmetohet faktikisht, por ata e kanë pranuar se është një lloj ekzistence materiale. Kështu, nuk është supersticion. Çfarë efekti ka ky material? Disa mjeshtër qigongu pretendojnë: “Unë mund të lëviz gjëra me forcën e mendjes time.” apo “Unë mund të hap Syrin tuaj Qiellor.” apo “Unë mund të shëroj sëmundjet tuaja.” etj. Në fakt, përse i përket disa mjeshtërve qigong, ata as vetë nuk e dinë dhe as janë të qartë se çfarë aftësish supernormale kanë. Ata vetëm dinë që mund të bëjnë çfarë të duan vetëm duke e menduar atë. Në realitet, është mendja e tyre në punë: Aftësitë supernormale drejtohen nga qëllimi mendor dhe ato kryejnë veprime të caktuara nën komandën e mendjes. Megjithatë mendja nuk mund të kryejë gjë vetë. Kur një praktikues bën diçka specifike, janë aftësitë e tij supernormale që e kryejnë veprimin.

Aftësitë supernormale janë aftësi të mundshme të trupit të njeriut. Me zhvillimin e shoqërisë sonë njerëzore, mendja e njeriut po bëhet gjithnjë e më e komplikuar, duke i dhënë më rëndësi “realitetit” dhe duke u bërë më e varur nga të ashtuquajturat vegla moderne. Për pasojë, aftësitë e lindura njerëzore janë atrofizuar gradualisht. Shkolla Tao mëson kthimin në veten e vërtetë dhe origjinale. Gjatë kursit të praktikës kultivuese, ju duhet të kërkoni të vërtetën dhe në fund të ktheheni në origjinë, tek vetja tuaj e vërtetë dhe tek natyra juaj e brendshme. Vetëm atëherë mund t'i zbuloni këto aftësi të lindura tuajat. Sot, ne i quajmë ato “aftësi mbinatyrë” kur në fakt ato janë të gjitha aftësi të lindura njerëzore. Shoqëria njerëzore duket sikur ecën përpara, por në fakt po ecën prapa dhe po shkon më larg karakteristikës së universit. Dje përmenda se Zhang Guolao i jepte gomarit mbarsht, por njerëzit mund të mos e kenë kuptuar çfarë do të thoshte kjo. Ai zbuloi se të ecësh përpara do të thotë të shkosh prapa dhe se njerëzimi është duke ju larguar akoma më shumë karakteristikës së universit. Gjatë kursit të evolucionit të universit dhe veçanërisht pas hyrjes në

rrymën e madhe të ekonomisë materialiste, shumë njerëz janë bërë shumë të korruptuar moralisht dhe ata po shkojnë gjithnjë e më larg Zhen-Shan-Ren (Ndershmërisë-Mirësisë-Tolerancës), karakteristikës së universit. Ata që shkojnë me rrymën e njerëzve nuk mund ta kuptojnë shkallën e korrupsionit moral të njerëzimit. Kështu disa njerëz madje mendojnë se gjërat po shkojnë mirë. Vetëm ata njerëz, morali i të cilëve është ngritur nëpërmjet kultivimit, do kuptojnë se vlerat morale njerëzore janë prishur deri në këtë shkallë të tmerrshme.

Disa mjeshtër qigongu pretendojnë: “Unë mund të zhvilloj aftësi supernormale.” Çfarë aftësish supernormale mund të zhvillojnë ata? Pa energji, aftësitë supernormale të personit nuk do të kenë efekt. Si mund t’i zhvilloni ju ato pa energji? Kur aftësitë supernormale nuk formohen dhe mbështeten nga energjia juaj, si mund t’i zhvilloni ju ato? Është plotësisht e pamundur. Ajo që thonë ata, se mund të zhvillojnë aftësi supernormale, nuk është gjë tjetër veçse ata lidhin aftësitë e tua supernormale tashmë të formuara me trurin tuaj. Atëhere ato do të veprojnë nën komandën e trurit tuaj. Këtë bëjnë ata përsa i përket zhvillimit të aftësive supernormale. Në fakt, ata nuk kanë zhvilluar ndonjë prej aftësive tuaja supernormale, por veçse kanë bërë kaq pak gjë.

Për një praktikues, është mendja ajo që i komandon aftësitë supernormale për të kryer veprime. Për një person të zakonshëm, mendja drejton katër gjymtyrët dhe organet e shqisave, ashtu si një zyrë drejtuese në një fabrikë: Zyra drejtorit lëshon urdhërat për çdo repart me funksione të ndryshme për të kryer detyra të caktuara. Apo është si shtabi i një ushtrie që jep urdhërat dhe e drejton gjithë ushtrinë për të kryer një mision. Kur unë dilja jashtë qytetit për të dhënë leksione, unë shpesh e diskutoja këtë çështje me administratorët e shoqatave lokale të qigongut. Ata u habitën të gjithë: “Ne diskutojmë sa potencial energjie dhe vetëdijë ka mendja njeriut.” Në realitet, nuk është ashtu. Ata ishin larg së vërtetës që në fillim. Unë kam thënë se që të studjojnë trupin e njeriut, njerëzit duhet të ndryshojnë të menduarit e tyre. Që të kuptojë gjërat supernormale, një person nuk mund të aplikojë metodat deduktive të njerëzve dhe mënyrat e tyre të të kuptuarit të gjërave.

Me që flasim për mendimet, ka dhe shumë forma të tjera. Për shembull, disa njerëz ngrenë çështjen e vetëdijes, të nën-ndërgjegjes, frymëzimit, ëndrrave, etj. Të flasim për ëndrrat, asnjë mjeshtër qigongu nuk don t’i shpjegojë ato. Kur ti linde, në të njejtën kohë, lindi një “ti” në shumë dimensione të universit dhe ata përbëjnë një qenie të plotë dhe të integruar dhe janë të ndërlidhur duke qënë mendërisht të lidhur. Po ashtu, në trup ju keni Shpirtin Kryesor, Shpirtin Ndihmës dhe qenie të tjera. Si forma ekzistence në dimensionet e tjera, çdo qelizë dhe të gjitha organet e tua të brendshme kanë mesazhin e imazhit tënd. Kështu, është jashtëzakonisht komplekse. Në ëndërr, gjërat janë kështu për një moment dhe ndryshe në një moment tjetër. Nga vijnë ato? Thuhet në mjekësi që kjo ndodh ngaqë korteksi cerebral i personit ka pësuar ndryshime. Ky është reaksion që manifestohet në këtë dimension fizik. Në fakt, ajo rezulton nga marrja e mesazheve nga një dimension tjetër. Prandaj, kur ëndërroni ju ndjeheni me kokë të turbullt. Kjo nuk ka fare të bëjë me ju dhe ju nuk keni pse i kushtoni vëmendje. Është një lloj tjetër ëndrre që ka lidhje direkt me ju. Ne nuk duhet ta quajmë një ëndërr të tillë “ëndërr”. Ndërgjegjja juaj Kryesore apo Shpirti Kryesor mund të ketë parë në ëndërr që një pjesëtar i familjes ka ardhur tek ju, sikur ju keni pësuar diçka, apo sikur ju keni parë apo bërë diçka. Në këto raste, ndodh me të vërtetë që Shpirti juaj Kryesor ka bërë apo parë në fakt diçka në një dimension tjetër ndërsa ndërgjegjja juaj ishte e qartë dhe reale. Këto gjëra ekzistojnë në fakt, veçse ato ndodhin në një dimension tjetër fizik dhe kryhen në një hapësirë kohore tjetër. Si mund ta quani ju atë ëndërr? Ajo nuk është ëndërr. Trupi juaj fizik është në fakt këtu në gjumë, kështu ju vetëm mund ta quani atë ëndërr. Vetëm ëndrra të tilla kanë të bëjnë direkt me ju.

Përsa i përket frymëzimit njerëzor, nën-ndërgjegjes, vetëdijes e kështu me radhë, unë do thoja se këto terma nuk janë krijuar nga shkencëtarët. Ato janë terma të sajuara nga shkrimtarë dhe bazohen në gjendjet mendore që njeh njeriu—ato nuk janë shkencore. Çfarë është “vetëdija” të cilës i referohen njerëzit? Ajo është e vështirë të shpjegohet qartë dhe është shumë e papërcaktuar meqenëse shumë mesazhe të ndryshme të njeriut janë komplekse dhe ato duken si copa kujtimesh të turbullta.

Përsa i përket nën-ndërgjegjes së cilës i referohen njerëzit, ne mund ta shpjegojmë atë me lehtësi. Sipas përkufizimit të nën-ndërgjegjes, ajo i referohet zakonisht asaj kur një person bën diçka pa e ditur. Njerëz të tjerë do të thonë zakonisht se ky person e bëri këtë pa vetëdije dhe jo me qëllim. Nën-ndërgjegjja është e njejtë me Ndërgjegjen Ndihmëse për të cilën kemi folur. Kur Ndërgjegjja Kryesore e personit rilaksohet dhe nuk e kontrollon trurin, personi nuk ka ndërgjegje të qartë dhe është sikur ka rënë në gjumë. Në ëndërr, apo në një gjendje të pandërgjegjshme, personi do të kontrollohej lehtësisht nga Ndërgjegjja Ndihmëse apo Shpirti Ndihmës. Në atë kohë, Ndërgjegjja Ndihmëse është në gjendje të bëjë disa gjëra që do të thotë se ju do të bëni gjëra pa qënë i vetëdijshëm. Megjithatë këto gjëra shpesh kanë tendencë të bëhen shumë mirë, sepse Ndërgjegjja Ndihmëse mund të shikojë nga një dimension tjetër esencën e materies dhe nuk do të gënjehej nga shoqëria jonë njerëzore. Prandaj, pasi individit sheh çfarë ka bërë, ai do e rishikojë e thotë: “Si e bëra kaq keq?” Nuk do ta kisha bërë kështu me mendje të kthjellët.” Tani ti mund të thuash se nuk është e mirë, por kur e rishikon pas dhjetë ditësh apo gjysmë muaji më vonë ju do të thonit: “Uau! Qënka bërë kaq mirë! Si e bëra unë këtë atëhere?” Këto gjëra ndodhin shpesh. Ngaqë Ndërgjegjja Ndihmëse nuk don t’ja dijë për rezultatin në atë moment, ajo do të ketë rezultat të mirë në të ardhmen. Ka gjithashtu disa gjëra që nuk kanë efekt në të ardhmen dhe vetëm kanë një farë efekti në atë moment. Kur Ndërgjegjja Ndihmëse i bën këto gjëra, ajo mund të bëjë një punë shumë të mirë në atë kohë.

Ka dhe një formë tjetër: Domethënë, ata prej jush që kanë cilësi të lindur shumë të mirë mund të kontrollohen nga qenie të larta me lehtësi për të kryer gjëra. Sigurisht, kjo është një çështje tjetër dhe nuk do ta trajtojmë këtu. Ne kryesisht diskutojmë mendimet që vijnë nga vetja jonë.

Përsa i përket “frymëzimit”, edhe ky është një term i sajuar nga shkrimtarët. Në përgjithësi besohet se frymëzimi, si grumbullim i njohurive të personit gjatë gjithë jetës, shpërthen për një sekondë si një shkëndijë që shkëlqen. Unë do të thoja se sipas perspektivës materialiste, sa më shumë njohuri individit grumbullon në jetë, aq më shumë ai përdor mendjen dhe aq më e mprehtë bëhet ajo. Në kohën kur personi e përdor mendjen, ajo duhet të prodhojë në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk duhet të ketë nevojë për frymëzim. Ajo që njerëzit quajnë frymëzim, kur vjen, nuk është në këtë formë. Zakonisht kur një person përdor mendjen, ai vazhdon ta përdorë derisa atij i duket sikur i është sosur dija dhe sikur i janë shteruar mendimet. Ai do të jetë i paaftë të vazhdojë të shkruajturit, i janë shteruar idetë për të kompozuar një pjesë muzikore, apo do të jetë i paaftë të mbarojë një projekt kërkimi shkencor. Në këtë pikë, një person zakonisht ndjehet i lodhur me trurin të mpirë dhe bishta cigaresh të shpërndara në dysheme. Ai ka ngecur, ka dhimbje koke dhe akoma nuk i vjen ndonjë ide. Së fundi, në cilat kushte shfaqet frymëzimi? Nëqoftëse ai është i lodhur, ai do mendojë: “Harroje. Do bëj pak pushim.” Ngaqë sa më shumë që Ndërgjegjja Kryesore kontrollon trurin e tij aq më pak qenie të tjera mund të ndërhyjnë, me këtë pushim dhe shplodhjen e mendjes, menjëherë ai mund pa dashje të kujtojë diçka nga truri i tij. Shumica e frymëzimeve vjen kështu.

Pse vjen frymëzimi në atë kohë? Sepse kur mendja individit kontrollohet nga Ndërgjegjja Kryesore, sa më shumë ai e përdor trurin, aq më shumë kontroll ka nga Ndërgjegjja Kryesore dhe aq më pak mundet Ndërgjegjja Ndihmëse të ndërhyjë. Kur dikush po mendon, ka dhimbje koke dhe vuan, Ndërgjegjja Ndihmëse gjithashtu vuan dhe ka një dhimbje koke shumë të madhe. Si pjesë e këtij trupi dhe i lindur në të njejtën kohë nga e njejtja nënë, ai gjithashtu kontrollon një pjesë të këtij trupi. Kur Ndërgjegjja Kryesore e personit rilaksohet, Ndërgjegjja Ndihmëse do të projektojë çfarë din në tru. Meqenëse mund të shohë natyrën e materies në një dimension tjetër, puna do të bëhet siç duhet, artikulli do të shkruhet apo muzika do të kompozohet.

Disa njerëz do të thonë: “Në se është kështu, ne duhet ta fusim në punë Ndërgjegjen Ndihmëse.” Kjo është e njejtë me çfarë dikush sapo pyeti në një letër: “Si të komunikojmë me Ndërgjegjen Ndihmëse?” Ju nuk mund të kontaktoni me të sepse ju sapo keni filluar praktikën dhe ju nuk keni aftësi. Ju më mirë të mos e kontaktoni sepse qëllimi juaj me siguri do të jetë ndonjë dëshirë. Disa njerëz mund të mendojnë: A mund ta përdorim Ndërgjegjen Ndihmëse për të krijuar pasuri për

ne dhe për të përshpejtuar zhvillimin e shoqërisë njerëzore?” Jo! Pse jo? Sepse atë që din Ndërgjegja juaj Ndhimëse është përsëri shumë e kufizuar. Me kompleksitetin e dimensioneve dhe kaq shumë nivele, struktura e universit është tepër komplekse. Ndërgjegja Ndhimëse mund të dijë vetëm ato që janë në dimensionin e vet dhe nuk do të dijë gjë jashtë atij dimensionit. Po ashtu, ka dhe shumë nivele dhe dimensione të ndryshme vertikale. Zhvillimi i njerëzimit mund të kontrohet vetëm nga jetët më të larta të një niveli shumë të lartësuar dhe përparon sipas ligjit të zhvillimit.

Shoqëria jonë njerëzore përparon sipas ligjit të zhvillimit të historisë. Ju mund të doni të zhvillohet në një mënyrë të caktuar dhe të arrini një qëllim të caktuar, por ato jetët e larta nuk e mendojnë ashtu. Pse nuk menduan njerëzit në kohë të lashta për avionët, trenat dhe biçikletat e sotme? Unë do të thoja se do ishte e pabesueshme që ata të mos i kishin menduar ato. Ngaqë historia nuk u zhvillua deri në atë shkallë, ata nuk mund t’i shpiknin ato. Në sipërfaqe, apo nga perspektiva e teorive konvencionale dhe njohuritë e sotme njerëzore, kjo ndodh ngaqë shkenca njerëzore në atë kohë nuk e kishte arritur akoma këtë nivel dhe kështu ata nuk mund t’i shpiknin ato. Në fakt, si shkenca njerëzore duhet të zhvillohet është gjithashtu e caktuar sipas planit të historisë. Nëqoftëse ju dëshironi të arrini një qëllim të caktuar si njeri, ai nuk mund të arrihet. Sigurisht, ka njerëz Ndërgjegja Ndhimëse e të cilëve mund të luajë një rol me lehtësi. Një shkrimtar pretendon: “Unë mund të shkruaj dhjetëra mijra fjalë në ditë për librin tim pa u lodhur fare. Po të dua, unë mund të shkruaj shumë shpejt dhe të tjerët mund ta konsiderojnë shumë të mirë kur ta lexojnë.” Pse ndodh kështu? Ky është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Ndërgjegjes së tij Kryesore me Ndërgjegjen Ndhimëse, sepse Ndërgjegja Ndhimëse e tij gjithashtu mund të marrë përsipër gjysmën e punës. Por nuk është gjithmonë kështu. Shumica e Ndërgjegjeve Ndhimëse nuk përzihen fare. Nuk është mirë nëqoftëse ju doni që të bëjë diçka sepse ju do të merrni rezultatet e kundërta.

Një Mëndje e Kthjellët dhe e Pastër

Shumë njerëz nuk mund të arrijnë të qetësojnë mëndjen gjatë praktikës dhe ata shkojnë kudo për të pyetur mjeshtërit qigong: “Mësues, nuk arrij dot qetësinë sido që të praktikoj. Sapo ulem, do filloj të mendoj për çdo gjë, përfshirë mendime dhe idera të kota.” Është njësoj sikur ke kthyer lumenj dhe dete përmbys dhe çfarë ishin poshtë, dalin sipër dhe personi nuk e arrin dot aspak qetësinë. Pse është një individ i paaftë të arrijë qetësinë? Disa njerëz nuk mund ta kuptojnë këtë dhe besojnë se duhet të ketë ndonjë marifet sekret. Ata do të gjejnë mjeshtër të njohur: “Të lutem me mëso ndonjë mënyrë të përparuar që unë të arrij të kem mëndje të qetë.” Sipas mendimit tim, kjo do të thotë të kërkosh ndihmë nga jashtë vetes. Nëqoftëse dëshironi të përmirësoni veten, ju duhet ta kërkoni brenda vetes tuaj dhe të punoni fort me mëndjen tuaj—vetëm atëhere mundet që me të vërtetë të ngriheni lart dhe të arrini qetësinë në meditimin ulur. Aftësia për të arritur qetësinë është gong dhe thellësia e meditimit tregon nivelin tuaj.

Si mundet një njeri i zakonshëm të arrijë qetësinë kur të dojë? Personi nuk mund ta bëjë këtë aspak veçse nëqoftëse ai ka cilësi të lindur të mirë. Me fjalë të tjera, arsyeja kryesore pse dikush nuk arrin dot qetësinë nuk është çështje teknikash, por fakti se mëndja dhe zemra juaj nuk janë të pastra. Në shoqërinë njerëzore dhe në konflikte me të tjerët, ju konkuroni dhe luftoni për përfitim personal, mbi të gjitha llojet e sentimentalizmave njerëzorë dhe mbi përndjekjet tuaja për të plotësuar dëshira. Po nuk i latë këto gjëra dhe t’i merrni ato lehtas, si mund të arrini qetësinë me aq lehtësi? Ndërsa praktikoni qigong, dikush thotë: “E pabesueshme. Më duhet të arrij qetësinë dhe të ndaloj mendimet.” Me të thënë këtë, gjithë llojet e mendimeve do dalin përsëri, sepse është mëndja juaj që nuk është e pastër. Prandaj ju nuk arrini të keni një mëndje të qetë.

Disa njerëz mund të mos jenë dakort me mua: “A nuk i mësojnë disa mjeshtër qigongu disa teknika njerëzve? Si personi mund të përqendrohet, vizualizojë diçka, të përqendrojë mëndjen në

dantian, të shikojë nga brenda në dantian, të këndojë emrin e Buddhës e kështu me radhë.” Këto janë lloje teknikash. Megjithatë ato nuk janë vetëm teknika, por gjithashtu reflektime të aftësive të personit. Për pasojë, këto aftësi janë të lidhura direkt me kultivimin e karakterit dhe me nivelin e përmirësimit tuaj. Për më tepër, dikush nuk mund të arrijë qetësinë duke përdorur vetëm teknika të tilla. Po nuk e besuat ju mund ta bëni një provë. Me dëshira dhe vese të ndryshme të forta dhe duke mos qënë i aftë të hiqni dorë nga çdo gjë, ju mund ta provoni nëse mund të arrini qetësinë. Disa njerëz thonë se jep rezultat të këndosh emrin e Buddhës. A mund të arrish ti qetësinë duke kënduar emrin e Buddhës? Dikush pretendon: “Është e lehtë të praktikosh shkollën e praktikës së Buddha Amitabhës. Jep rezultat vetëm duke kënduar emrin e Buddhës.” Pse nuk e provoni të këndonit? Unë do ta quaja atë aftësi. Ju thoni se është e lehtë, por unë them se nuk është e lehtë, sepse asnjë shkollë praktike nuk është e lehtë.

Të gjithë e dinë se Sakyamuni mësoi “samadhi”. Çfarë mësoi ai para samadhit? Ai mësoi parimet dhe braktisjen e të gjithë dëshirave dhe veseve derisa të mos mbetej asnjë—atëhere një person mund të arrijë qetësinë në meditim. A nuk është ky parimi? Por samadhi është gjithashtu dhe një aftësi, sepse ju nuk jeni në gjendje të arrini braktisjen e gjithë përndjekjeve tuaja menjëherë. Me braktisjen graduale të të gjithë gjërave të këqija, aftësia e personit për t’u përqëndruar në meditim gjithashtu do të përmirësohet nga e cekët në të thellë. Kur dikush këndon emrin e Buddhës, ai duhet ta bëjë atë pa asgjë tjetër në mendje derisa pjesët e tjera të trurit të mpihen dhe ai bëhet i pavetëdijshëm për gjithshka me një mendim që zëvendëson njëmijë të tjerë, apo derisa çdo fjalë e “Buddha Amitabha” shfaqet para syve të tij. A nuk është kjo një aftësi? A mund ta bëjë dikush këtë që në fillim? Jo, ai nuk mundet. Nëqoftëse një person nuk mund ta bëjë këtë, ai sigurisht nuk do jetë i aftë të arrijë qetësinë. Po nuk e besuat bëjeni provë. Ndërsa këndonit emrin e Buddhës pa pushim me gojë, mendja do të mendojë për çdo gjë: “Pse nuk më do fare përgjegjësi në punë? Shpërblimi për këtë muaj është kaq i vogël.” Sa më shumë mendon personi për këtë gjë, aq më i zemëruar bëhet ai, ndërsa goja e tij vazhdon të këndojë emrin e Buddhës. A mendoni se ky person mund të praktikojë qigong? A nuk është kjo çështje aftësie? A nuk është kjo çështje e të pasurit të një mendjeje të papastër? Syri Qiellor i disa njerëzve është hapur dhe ata mund të shikojnë brenda trupit të tyre në dantian. Përsa i përket dan-it që grumbullohet në pjesën e poshtme të barkut të personit, sa më e pastër të jetë kjo lëndë energjie aq më e shkëlqyeshme bëhet ajo. Sa më pak e pastër që të jetë, aq më pa shkëlqim dhe e errët është ajo. A mundet dikush të arrijë qetësinë vetëm duke parë brenda dan-in në dantian? Ai nuk mundet. Nuk varet nga vetë teknika. Çelsi është se mendja dhe mendimet e personit nuk janë të kthjella dhe të pastra. Kur ju shikoni brenda vetes në dantian, dan-i duket i ndritshëm dhe i bukur. Në sekond ky dan kthehet ne apartament: “Kjo dhomë do jetë për djalin kur të martohet. Ajo dhomë është për vajzën. Si çift i vjetër ne do jetojmë në dhomën tjetër dhe dhoma në mes do bëhet dhomë ndenje. Mrekulli! A do ma japin mua këtë apartament? Duhet të mendoj një mënyrë si ta marr. Çfarë duhet me bërë?” Njerëzit janë të dhënë pas këtyre gjërave. A mendoni se mund të arrini qetësinë në meditim në këtë mënyrë? Thuhet: “Kur vjen në shoqërinë njerëzore, është tamam sikur të zësh hotel për pak ditë. Pastaj ikën me nxitim.” Disa njerëz janë thjesht të obsesuar me këtë vend dhe kanë harruar shtëpitë e tyre të vërteta.

Në praktikën e vërtetë kultivuese personi duhet të kultivojë zemrën dhe vetveten e vet. Ai duhet të kërkojë brenda vetes e jo jashtë. Disa shkolla praktike thonë se Buddha është në zemrën e personit dhe kjo ka diçka të vërtetë. Disa njerëz e kanë keqkuptuar këtë thënie dhe thonë se ka Buddha në zemrën e tyre, sikur ata vetë të ishin Buddha apo sikur ka një Buddha në zemrën e tyre—ata e kanë kuptuar atë kështu. A nuk është kjo e gabuar? Si mund të kuptohet ashtu? Ajo do të thotë se ju duhet të kultivoni zemrën tuaj nëse doni t’ja arrini në kultivim—tregon këtë parim. Si mund të ketë një Buddha në trupin tuaj? Ju duhet të praktikoni kultivim që t’ja arrini.

Arsyeja që ju nuk arrini qetësinë në meditim është se mendja e juaj nuk është bosh dhe ju nuk keni arritur atë nivel të lartë që mund të arrihet vetëm gradualisht. Kjo shkon dora dorazi me

përmirësimin tuaj. Kur ju hiqni dorë nga dëshirat, niveli juaj do të ngrihet dhe aftësia juaj për t'u përqëndruar gjithashtu do të përmirësohet. Nëqoftëse dëshironi të arrini qetësinë gjatë meditimit nëpërmjet disa teknikave apo metodave, unë do ta quaja këtë të kërkosh ndihmë nga jashtë. Në praktikën qigong, njerëzit që kërkojnë ndihmë nga jashtë konsiderohen se kanë shkuar dëm dhe ndjekin një mënyrë të ligë. Në veçanti në Buddhizëm, nëse ju kërkon ndihmë nga jashtë, thuhet se ju keni marrë rrugën e djallit. Në praktikën e vërtetë kultivuese personi duhet të kultivojë zemrën: Vetëm kur ju përmirësoni karakterin tuaj, mundeni ju të arrini një mendje të kthjellët e të pastër dhe një gjendje të paqëllimshme (*wuwei*). Vetëm kur karakteri juaj përmirësohet mundet që ju t'i asimiloheni karakteristikës së universit dhe të hiqni dëshirat e ndryshme njerëzore, veset dhe gjëra të tjera të këqija. Vetëm atëherë do mundeni ju të braktisni gjërat e këqija në veten tuaj dhe të ngjiteni, kështu ju nuk do të kufizoheni nga karakteristika e universit. Atëherë substanca e virtytit mund të shndërrohet në gong. A nuk janë këto të ndërlydhura? Ky është parimi!

Kjo është arsyeja për praktikuesin pse ai nuk arrin dot qetësinë, sepse ai nuk arrin standartin e një praktikuesi. Përsa i përket faktorëve të jashtëm, ka tashmë një situatë që seriozisht ndërhyt me praktikën tuaj kultivuese drejt niveleve të larta dhe seriozisht ndikon tek praktikuesit. Ju e dini që me reformat dhe politikën e dyerve të hapura, ekonomia është ripërtërirë dhe politikat janë bërë më liberale. Shumë teknologji të reja janë futur dhe standartet e jetesës së njerëzve janë përmirësuar. Njerëzit mendojnë se kjo është një gjë e mirë. Por gjërat duhet të shihen nga të gjitha anët. Me reformat dhe hapjen, janë importuar dhe gjëra të këqija të formave të ndryshme. Nëse një pjesë letrare nuk shkruhet me përbërje pornografike, libri duket se nuk shitet dhe kjo do të lidhet me sasinë e shitjeve. Nëse filmat dhe programet televizive nuk tregojnë pamje me skena dhomash gjumi, askush nuk duket se i shikon ato dhe lind problemi i numrit të shikuesve. Përsa i përket artit, askush nuk e merr vesh nëse është art i vërtetë apo diçka tjetër. Nuk kishte gjëra të tilla në artet tona tradicionale të lashta kineze. Trashëgimia e popullit kinez nuk u shpik apo u krijua nga çfarëdolloj njerëzish. Kur fola për kulturën parahistorike, përmenda që çdo gjë ka origjinën e vet. Vlerat morale njerëzore janë shtrembëruar dhe ndryshuar. Standartet që përcaktojnë të mirën dhe të keqen kanë ndryshuar të gjitha. Kjo është situata me njerëzit. Megjithatë karakteristikat e universit, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), mbetet e pandryshuar si kriteri i vetëm i dallimit të njerëzve të mirë e të këqinj. Si praktikues, nëse ju doni të ngriheni mbi çdo gjë, ju duhet të përdorni këtë kriter—jo standartin e njerëzve të zakonshëm—për të vlerësuar gjërat. Kështu, ekziston kjo ndërhyrje nga jashtë. Ka dhe gjëra të tjera, si homoseksualiteti, lirija seksuale e abuzimet me drogë.

Kur shoqëria njerëzore ka arritur në këtë pikë, mendojeni pak: Çfarë do të ndodhë nëqoftëse vazhdon kështu? A mund të lejohet të ekzistojë kështu përgjithmonë? Njëqoftëse njerëzimi nuk bën diçka për këtë, do ta bëjë qielli. Sa herë që njerëzimi kalon katastrofa, ato ndodhin gjithmonë në këto kushte. Në kaq shumë leksione, nuk e kam përmendur çështjen e katastrofave të mëdha të njerëzimit. Kjo pikë interesante është diskutuar nga fetë dhe nga shumë njerëz të tjerë. Po ja ngre këtë pyetje të gjithëve, kështu mendojeni pak: Në shoqërinë tonë njerëzore, standartet e moralit njerëzor kanë ndryshuar kaq shumë! Tensionet ndërmjet njerëzve kanë arritur këtë pikë! A nuk mendoni që ka arritur në një pikë të rrezikshme? Prandaj, ky ambient i sotëm ndërhyt seriozisht tek kultivimi i praktikuesve tanë drejt niveleve të larta. Fotografitë lakuriqe janë të vendosura kudo, e janë të vendosura në mes të rrugës. Me të ngritur kokën ju do i shihni ato.

Lao Zi pat thënë një herë: “Kur një njeri i mençur dëgjon Taon, ky person do ta praktikojë atë me zell.” Kur një person i mençur mëson Taon, ai mendon: “Më në fund kam marrë një metodë të vërtetë. Pse të pres dhe të mos filloj të praktikoj sot?” Ambienti kompleks sipas mendimit tim, është një gjë e mirë. Sa me kompleks të jetë ai, aq më të mëdhenj njerëzit që do të nxjerrë. Njëqoftëse individi mund ta ngrejë veten mbi çdo gjë, kultivimi i tij do të jetë dhe më i qëndrueshmi.

Për një praktikues që është me të vërtetë i vendosur të praktikojë kultivim, unë do të thoja se do të ishte një gjë e mirë. Pa konflikte apo mundësira për të përmirësuar karakterin tuaj, ju nuk mund

të përparoni. Nëse të gjithë janë të mirë me njeri tjetrin, si mund të praktikoni ju kultivim? Përsa i përket dikujt që është një praktikues mesatar, ai është “një njeri mesatar që dëgjon Taon,” dhe dikush që mund të praktikonte me hope; me siguri që ai do të dështojë në kultivim. Disa njerëzve, që po më dëgjojnë kur flas këtu, u duken këto çfarë thotë Mësuesi të arsyeshme. Por me t’u kthyer në shoqërinë njerëzore, ata do të mendojnë përsëri se përfitimet e menjëhershme janë më praktike dhe reale. Ato janë të vërteta. Jo vetëm ju, por edhe shumë milionerë perëndimorë dhe njerëz të pasur kanë zbuluar se nuk mbetet agjë pas vdekjes. Pasuria materiale nuk sillet me vete kur lind dhe as nuk vjen me ty kur vdes—të gjithë ata njerëz u ndjenë bosh brenda. Megjithatë pse është gongu kaq i çmuar? Sepse i bashkangjitet trupit të Shpirtit tuaj Primordial dhe vjen me ju në lindje dhe shkon me ju në vdekje. Ne kemi thënë se Shpirti Primordial i personit nuk zhduket dhe ky nuk është supersticion. Pasi qelizat në trupin tonë fizik vdesin, grimcat më të vogla sesa qelizat në dimensione të tjera fizike nuk janë zhdukur. Vetëm një guackë është hequr.

Të gjitha këto për të cilat sapo kam folur i përkasin çështjes së karakterit të personit. Sakyamuni pat thënë një herë, po ashtu dhe Boddhidarma: “Kjo toka orientale e Kinës është një vend ku mund të dalin njerëz me virtyte të mëdha.” Gjatë historisë, shumë murgjër and plot kinezë kanë qenë shumë krenarë për këtë; duket se sugjeron se ata mund të kultivojnë gong të nivelit të lartë dhe kështu shumë njerëz kënaqen dhe ndjehen të lavdëruar: “Bravo ne kinezët! Kjo toka e Kinës mund të nxjerrë njerëz me cilësi të mëdha të lindura dhe virtyt të madh.” Në fakt, shumë njerëz nuk e kanë kapur kuptimin prapa thënies. Pse nxjerr toka e Kinës njerëz me virtyt të madh dhe nivel gongu të madh? Shumë njerëz nuk e kuptojnë kuptimin e vërtetë të asaj që patën thënë këta njerëz të niveleve të larta dhe ata as nuk mund ta kuptojnë mëndjen e atyre njerëzve të niveleve të larta dhe në mbretëri sublime. Le të mos themi se çfarë do të thotë kjo. Mendojeni pak, të gjithë: Vetëm duke qënë në mes të grupit më kompleks të njerëzve dhe në ambientin më kompleks mundet që dikush të kultivojë gong të nivelit të lartë—do të thotë këtë.

Cilësia e Lindur

Cilësia e lindur e personit përcaktohet nga sasia e substancës së virtytit në një trup të tij në një dimension tjetër. Me më pak virtyt dhe me më shumë substancë të zezë, fusha karmike e personit do të jetë e madhe. Në këtë rast, personi është me cilësi të lindur të dobët. Me shumë virtyt apo substancë të bardhë, fusha e tij karmike do të jetë e vogël. Kështu, ky person është me cilësi të mirë të lindur. Substanca e bardhë dhe substanca e zezë mund të konvertohen në njëra tjetrën. Si konvertohen ato? Kur kryen vepra të mira merr substancën e bardhë, sepse substanca e bardhë merret nëpërmjet durimit të vështirësive, vuajtjeve apo nga kryerja e veprave të mira. Substanca e zezë krijohet kur i bën njerëzve keq dhe kur kryen vepra të këqija dhe ajo është karmë. Ndodh ky proces transformimi. Ndërkohë, mund dhe të trashëgohet. Ngaqë shkojnë drejtpërdrejt pas Shpirtit Primordial të personit, nuk janë diçka vetëm nga një jetë por grumbullohen nga një kohë e largët. Prandaj, njerëzit flasin për akumulim karme dhe grumbullim virtyti. Po ashtu, ato mund të merren dhe nga paraardhësit. Shpesh, më kujtohet çfarë thonin kinezët e lashtë apo të moçmit: “Të parët e dikujt kanë grumbulluar virtyt, grumbullo apo humb virtyt.” Kjo që thuhej ishte shumë e saktë! Është shumë e drejtë me të vërtetë.

Cilësia e lindur e mirë apo e varfër e personit mund të përcaktojë nëse cilësia e tij e ndriçimit shpirtëror është e mirë apo e varfër. Cilësia e varfër e lindur e një personi mund ta bëjë dhe ndriçimin e tij shpirtëror shumë të varfër. Pse ndodh kjo? Ndodh sepse një person me cilësi të mirë të lindur ka plot substancë të bardhë që asimilohet në univers dhe në karakteristikën Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë) pa kurrfarë pengese. Karakteristika e universit mund të shfaqet direkt në trupin tuaj dhe të jetë në kontakt të menjëhershëm me trupin tuaj. Ndërsa substanca e zezë është pikërisht e kundërta. Meqenëse merret nga kryerja e veprave të këqija, ajo shkon në drejtim të

kundërt nga karakteristika e universit tonë. Prandaj, kjo substancë e zezë ndahet nga karakteristika e universit tonë. Kur kjo substancë e zezë grumbullohet në një sasi të madhe, ajo do të formojë një fushë që e rrethon trupin e personit dhe e mbështjell atë nga brenda. Sa më e madhe fusha, aq më i madh densiteti dhe trashësia e saj dhe kjo do ta bëjë cilësinë e ndriçimit shpirtëror të varfërohet. Kjo ndodh ngaqë personi nuk është në gjendje të jetë në kontakt me karakteristikën e universit Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), ngaqë ai e ka marre substancën e zezë nga kryerja e veprave të këqija. Zakonisht, është më e vështirë për një individ si ky të besojë në praktikën kultivuese. Sa më e varfër cilësia e tij e ndriçimit shpirtëror, aq më e madhe rezistenca karmike që ai do të gjejë. Sa më shumë vështirësi që ai kalon, aq më pak do ta besojë ai atë dhe aq më e vështirë do jetë për të që të praktikojë kultivim.

Është më e lehtë për dikë me shumë substancë të bardhë për të praktikuar kultivim. Kjo ndodh ngaqë gjatë kultivimit, për aq kohë sa ky person i asimilohet karakteristikës së universit dhe përmirëson karakterin të tij, virtyti i tij do të transformohet drejt e në gong. Por për dikë me shumë substancë të zezë ka një procedurë shtesë. Është si një produkt që bën fabrika: Të tjerët vijnë me material të gatshëm, ndërsa ky person vjen me lëndë të parë që duhet të përpunohet. Duhet të kalojë një proces shtesë. Prandaj, ai duhet së pari të vuajë në vështirësi dhe të eliminojë karmë, në mënyrë që ta transformojë atë në substancë të bardhë dhe formojë këtë substancë virtyti. Vetëm atëhere mundet ai të zhvillojë gong të nivelit të lartë. Por një person si ky zakonisht nuk ka cilësi ndriçimi shpirtëror të lindur të mirë. Po t'i kërkohet që të vuajë më shumë, ai do e besojë atë më pak dhe do jetë më e vështirë për të ta durojë atë. Prandaj, është e vështirë për dikë me shumë substancë të zezë të praktikojë kultivim. Prandaj, Shkolla Tao apo një shkollë praktike që mëson vetëm një dishepull kërkonte që mjeshtri të kërkonte për një dishpull e jo e kundërta. Kjo përcaktohej nga sa nga këto gjëra kishte trupi i këtij dishepulli.

Cilësia e lindur përcakton cilësinë e ndriçimit shpirtëror të personit, por kjo nuk është absolute. Disa njerëz nuk kanë cilësi shumë të mirë të lindur, por ambjenti i tyre familjar është shumë i mirë; shumë pjesëtarë të familjes praktikojnë kultivim. Disa prej tyre janë gjithashtu besimtarë fetarë dhe besojnë shumë në praktikën kultivuese. Në këtë ambjent, personi mund të kthehet në besues dhe kjo e bën cilësinë e ndriçimit të tij shpirtëror të përmirësohet. Pra nuk është absolute. Disa njerëz kanë shumë cilësi të mirë të lindur, por për shkak të arsimimit me ato pak njohuri nga shoqëria dhe veçanërisht për shkak të metodave absolute të edukimit ideologjik pak vite më parë, ata janë bërë me mendje shumë të ngushta dhe nuk do besojnë asgjë përtej njohurive të tyre. Kjo mund ta influencojë seriozisht cilësinë e tyre të ndriçimit shpirtëror.

Për shembull, unë mësova hapjen e Syrit Qiellor në ditën e dytë të një klase. Menjëherë, një personi me cilësi të mirë të lindur ju hap Syri Qiellor në një nivel shumë të lartë. Ai pa skena të shumta që shumë njerëz të tjerë nuk mund t'i shihnin. Ai i tregoi të tjerëve: “Uau, pashë Falun që binin si flokë bore mbi trupat e publikut në gjithë auditorin. Pashë si duket Trupi i Vërtetë i Mësuesit Li, aurorën e Mësuesit, si duken në të vërtetë Falunët dhe sa Fashen janë këtu.” Ai pa se Mësuesi po jepte mësim në nivele të ndryshme dhe se si Falunët po rregullonin trupat e praktikuesve. Ai gjithashtu pa se gjatë leksionit *gongshen*¹ të Mësuesit po jepnin mësim në çdo nivel të ndryshëm. Po ashtu ai pa bukuroshet qiellore që hidhnin lule rreth e rrotull e të tjera gjëra si këto. Ai pa disa gjëra kaq të mrekullueshme si këto, që tregonin se cilësia e tij e lindur ishte shumë e mirë. Ndërsa ai vazhdonte kështu e ashtu, së fundi ai tha: “Nuk i besoj këto gjëra.” Disa nga këto gjëra janë provuar tashmë nga shkenca dhe shumë gjëra gjithashtu mund të shpjegohen nga shkenca moderne; ne i kemi diskutuar disa prej tyre këtu. Kjo ndodh ngaqë ajo që mund të kuptohet nga qigongu është me të vërtetë përtej kuptimit të shkencës moderne—kjo është e sigurtë. Në bazë të kësaj, cilësia e lindur e dikujt nuk përcakton të gjithë cilësinë e ndriçimit shpirtëror të personit.

¹ *gongshen*—trup i përbërë prej gongu.

Ndriçimi dhe Lartësimi Shpirtëror

Çfarë është “ndriçimi dhe lartësimi shpirtëror”? Ndriçimi dhe lartësimi shpirtëror janë terma nga fetë. Në Buddhizëm do të thonë të kuptuarit nga ana e një praktikuesi të Mësimeve Buddhiste, ndriçim shpirtëror në kuptimin e aftësisë për të kuptuar të vërtetat e Ligjit ndërsa lartësim shpirtëror do të thotë lartësimi shpirtëror përfundimtar apo arritja e mençurisë. Megjithatë, përdoren sot nga njerëzit e zakonshëm për të nënkuptuar që një person është shumë i zoti dhe mund të lexojë mëndjen e manaxherit të tij. Ai ja merr dorën gjërave shpejt dhe din si t’ja bëjë qejfin menaxherit të tij. Njerëzit e quajnë këtë cilësi të mirë të kuptuari dhe zakonisht kuptohet kështu. Megjithatë, sapo dikush ngrihet pak më lart se niveli i njerëzve të zakonshëm, ai do të kuptojë se parimet në këtë nivel siç kuptohen nga njerëzit janë zakonisht të gabuara. Kjo nuk është aspak aftësia për të kuptuar të cilës i referohemi ne. Përkundrazi, cilësia e ndriçimit shpirtëror të një personi të zotë nuk është diçka e mirë, sepse një person që është shumë i zoti do të bëjë vetëm punë sipërfaqësore në mënyrë që të vlerësohet nga menaxheri apo përgjegjësi i tij. Në këtë rast a nuk do të bëhej puna nga dikush tjetër? Kështu ky person do t’i detyrohesh të tjerëve. Ngaqë ai është i zoti dhe din si të kënaqë të tjerët, ai do të marrë më shumë përfitime ndërsa të tjerët do të pësojnë më shumë humbje. Ngaqë ai është i zoti, ai nuk do të pësojë humbje dhe ky person as nuk do të humbë kollaj gjëra të tjera. Për pasojë të tjerët duhet të pësojnë humbje. Sa më shumë që ai kujdeset për këtë pak përfitim praktik, aq më mëndje ngushtë bëhet ai dhe aq më shumë ai mendon se përfitimet materiale të njerëzve janë diçka që ai nuk mund t’i lejojë t’i ikin nga dora. Kështu ai do ta ndjejë veten se është shumë praktik dhe nuk do të pësojë humbje.

Disa njerëz madje e kanë zili këtë person! Po ju them të mos e keni zili atë. Ju nuk e dini sa jetë të lodhshme ai bën: Ai nuk ha apo fle mirë; ai ka frikë mos i dëmtohen interesat edhe në gjumë dhe ai bën çdo gjë për përfitim personal. A nuk do thonit dhe ju se ai bën një jetë të lodhshme sepse e tërë jeta e tij i është përkushtuar kësaj? Ne themi se kur ju bëni një hap mbrapsht në një konflikt, ju do të gjeni një det e qiell të pa kufi dhe patjetër kjo do të sjellë një situatë tjetër. Por një person si ai nuk do të heqë dorë dhe bën jetën më të lodhshme. Ju nuk duhet të mësoni prej tij. Thuhet në komunitetin e kultivuesve: “Një person i tillë është plotësisht i humbur. Ai është komplet i humbur në mes të njerëzve dhe përfitimeve materiale.” Nuk do jetë e lehtë për të që të ruajë virtyt! Po t’i thuash të praktikojë kultivim, ai nuk do t’ju besojë: “Të praktikoj kultivim? Si praktikues, ju nuk kundërpërgjigjeni kur ju godasin apo shajnë. Kur të tjerët ju sjellin probleme, në vend që t’i trajtoni në të njëjtën mënyrë, ju madje duhet t’i falenderoni ata. Ju jeni bërë të tërë budallenj! Të gjithë jeni të sëmurë mendorë!” Një person si ky nuk mund ta kuptojë praktikën kultivuese në asnjë mënyrë. Ai do të thotë se ju jeni i paimagjinueshëm dhe i metë. A nuk do të thonit ju se ai është i vështirë për t’u shpëtuar?

Ky nuk është ndriçimi shpirtëror të cilit i referohemi ne. Përkundrazi, është ajo çfarë ky person e quan “budallallëk” përse i përket interesit personal që quhet ndriçim shpirtëror nga ne. Sigurisht, një person i tillë nuk është me të vërtetë i metë. Ne thjesht e trajtojmë çështjen e interesave personale me indiferencë, ndërsa në aspektet e tjera ne jemi shumë të mençur. Përse i përket kryerjes së projekteve kërkimore shkencore apo kryerjes së detyrave nga menaxherët apo detyra të tjera, ne jemi mëndje mprehtë dhe i kryejmë ato shumë mirë. Vetëm kur është fjala për përfitime personale apo për konflikte me të tjerët, ne nuk i vëmë atyre rëndësi. Kush do t’ju quaj juve të lënë nga mendtë? Askush nuk do të thotë se jeni të lënë nga mendtë—është e garantuar të jetë kështu.

Le të flasim për një person me të vërtetë të metë, sepse e vërteta e kësaj situatë është plotësisht e kundërt në nivele të larta. Mundësia që një i metë të kryejë ndonjë vepër shumë të keqe në mes të njerëzve të zakonshëm është shumë e vogël dhe as nuk do të konkuronte apo luftonte ai për

interes personal. Ai nuk kërkon famë e nuk humb virtyt, ndërsa të tjerët do t'i japin atij virtyt dhe kjo substancë është jashtëzakonisht e vlefshme. Në universin tonë, ekziston ky parim: pa humbje nuk ka fitim. Që të fitosh, duhet të humbësh. Kur të tjerët e shikojnë këtë person kaq budalla, ata do ta shajnë atë: “Ej budallë.” Me këto sharje, një copë virtyti do t'i jepet atij. Duke e marrë nëpër këmbë atë ju jeni pala fituese, kështu që ju duhet të humbni diçka. Nëqoftëse dikush shkon dhe e godet atë me shkelm: “Ti je idiot.” Epo mirë, një copë e madhe virtyti do t'i kalojë atij. Kur dikush e mërzit apo e godet atë, ai vetëm do buzëqeshë: “Jepini. Ju po më jepni mua virtyt dhe unë nuk do të refuzoj as dhe një copë prej saj!” Atëhere sipas parimeve të niveleve të larta, mendoje pak, kush është i mençur? A nuk është ky person i mençur? Ai është më i mençuri sepse ai nuk humb virtyt. Kur ju i jepni atij virtyt, ai nuk e refuzon atë aspak. Ai do e marrë të gjithë atë dhe do e pranojë me një buzëqeshje. Ai mund të jetë i metë në këtë jetë, por jo në tjetrën—Shpirti i tij Primordial nuk është i metë. Thuhet nga fetë që kur ka shumë virtyt, një person do të bëhet zyrtar i lartë apo do të bëjë pasuri të madhe në jetën tjetër; këto shkëmbehen me virtytin tënd.

Ne themi se virtyti mund të transformohet direkt e në gong. A nuk varet lartësia nivelit të kultivimit tënd nga transformimi i këtij virtyti? Ai mund të transformohet direkt e në gong. A nuk transformohet gongu që përcakton nivelin e personit dhe fuqinë e gongut të tij nga kjo substancë? A nuk do të thonit ju se ai është shumë i vyer? Mund të vijë me ju kur lindni dhe ju shoqëron në vdekje. Thuhet në Buddhizëm se niveli juaj i kultivimit është Shkalla juaj e Arritjes. Sa më shumë që ju do të sakrifikoni, aq më e madhe është edhe ajo që do të fitoni—pikërisht, ky është parimi. Thuhet në fe se me virtyt, personi do të bëhet zyrtar i lartë apo do të bëjë pasuri të madhe në jetën tjetër. Me pak virtyt, ai do ta ketë të vështirë dhe për të lypur për ushqim sepse nuk ka virtyt për të shkëmbyer. Pa humbje nuk ka fitim! Kur nuk ka fare virtyt, personi do të zhdukej me trup e shpirt; ai do të vdiste me të vërtetë.

Në të kaluarën, ishte një mjeshtër qigongu niveli i të cilit ishte shumë i lartë kur ai doli në publik për herë të parë. Ky mjeshtër qigongu më vonë u dha pas famës dhe interesit personal. Mësuesi i tij ja mori Shpirtin Ndihmës meqenëse ai i përkiste atyre që kultivojnë Shpirtin Ndihmës. Kur Shpirti i tij Ndihmës ishte akoma i pranishëm, ky person kontrollohej nga Shpirti Ndihmës. Për shembull, një ditë vendi i tij i punës po shpërndante apartamente. Përgjegjësi tha: “Të gjithë ata që kanë nevojë për apartament të vijnë këtu të përshkruajnë kushtet e tyre dhe të shpjegojnë pse keni nevojë për apartament.” Të gjithë dhanë arsyet e tyre ndërsa ky person nuk tha asnjë fjalë. Së fundi, përgjegjësi mori vesh se ky person kishte nevojë më të madhe sesa të tjerët dhe se apartamenti duhej t'i jepej atij. Të tjerët thanë: “Jo, apartamenti nuk duhet t'i jepet atij. Duhet të më jepet mua sepse unë kam më shumë nevojë.” Ky person tha: “Atëhere merre ti.” Një person i zakonshëm do ta quante atë të metë. Disa njerëz e dinin që ai ishte praktikues dhe e pyetën: “Si praktikues, ti nuk don asgjë. Çfarë dëshiron ti?” Ai u përgjigj, “Unë do marr çfarëdo që nuk e duan të tjerët.” Në fakt, ai nuk ishte aspak i metë përkundrazi, ishte shumë i zgjuar. Vetëm përse i përket interesave personale sillej ai ashtu. Ai besonte në ndjekjen e rrjedhës së natyrshme të gjërave. Të tjerët e pyetën atë përsëri: “E çfarë është ajo që njerëzit nuk e duan sot?” Ai u përgjigj: “Asnjëri nuk dëshiron copat e gurit në tokë që goditen andej e këtej. Kështu unë do t'i mbledh ato.” Njerëzit e zakonshëm e shohin një gjë të tillë si të pakonceptueshme dhe nuk mund t'i kuptojnë praktikuesit. Ata nuk mund t'i kuptojnë ata sepse nivelet e tyre të menduarit janë shumë larg dhe ndryshimi ndërmjet niveleve të tyre është gjithashtu tepër i madh. Sigurisht, ai nuk do të mblidhte gurët. Ai tha një parim që një njeri i zakonshëm nuk mund ta kuptojë: “Unë nuk do të kërkoj asgjë në mes të njerëzve.” Le të flasim pak për gurin. Ju e dini që thuhet në shkrimet e shenjta të Buddhizmit: “Në Parajsën e Lumturisë Absolute, pemët janë prej floriri dhe po kështu është toka, zogjtë, lulet dhe shtëpitë. Madje dhe trupi i Buddhës është prej floriri dhe plot shkëlqim.” Nuk mund të gesh as dhe një copë guri atje. Monedha që përdoret atje thuhet se është guri. Ai nuk do të shkonte atje dhe të merrte me vete një copë gur, por ai tha një parim që një njeri i zakonshëm nuk mund ta kuptojë. Me të vërtetë, praktikuesit do të thonin: “Njerëzit e

zakonshëm kanë gjërat e tyre që ata përndjekin dhe ne nuk i kërkojmë ato. Përsa i përket atyre gjërave që njerëzit kanë, ne nuk jemi të interesuar. Megjithatë atë që ne kemi është diçka që njerëzit e zakonshëm nuk mund ta marrin dot edhe sikur të donin.”

Në fakt, ndriçimi shpirtëror për të cilin sapo folëm i referohet akoma llojit të ndriçimit shpirtëror gjatë kursit të praktikës kultivuese dhe kjo është pikërisht e kundërta me atë për të cilën flasim njerëzit e zakonshëm. Ndriçimi shpirtëror të cilit i referohemi ne do të thotë, nëse gjatë kursit të praktikës kultivuese një person mund të arrijë të kuptojë dhe pranojë Ligjin e mësuar nga mjeshtri apo Taon e mësuar nga mjeshtri Taoist, nëse ai mund sillet si praktikues kur has në vështirësi dhe nëse ai mund të sillet në përputhje me Ligjin kur praktikon kultivim. Përsa i përket disa njerëzve, pamvarësisht si ja shpjegon këtë, ata nuk do ta besojnë dhe do të mendojnë se është më praktike të jesh njeri i zakonshëm. Ata do të kapen fort pas mendimeve të tyre dhe kjo i bën ata që të mos besojnë dot. Disa njerëz vetëm duan të shërojnë sëmundje. Sapo unë përmend këtu se qigong nuk përdoret aspak për të shëruar sëmundje, mëndja e tyre do të reagojë negativisht dhe për pasojë ata nuk do të besojnë çfarë mësohet më pas.

Disa njerëz nuk mund ta përmirësojnë fare cilësinë e të kuptuarit të tyre. Ata shkruajnë mbi librin tim si t’u teket. Praktikuesit tanë me Syrin Qiellor të hapur mund të shikojnë që ky libër është i shumëngjyrshëm, i artë dhe me shkëlqim. Çdo fjalë ka imazhin e Fashen-it tim. Nëqoftëse do t’ju thoja gënjeshtër, unë do t’ju mashtroja juve. Ajo shenjë që ti bëre duket shumë e errët. Si guxon të shkruash mbi të si të të teket? Çfarë po bëjmë ne këtu? A nuk po ju udhëheqim që të praktikoni kultivim drejt niveleve të larta? Ka disa gjëra që dhe ju duhet t’i mendoni. Ky libër mund të udhëheqë praktikën tuaj kultivuese. A nuk mendoni se është i çmuar? A mundeni ju që me të vërtetë të praktikoni kultivim duke ju falur Buddhës? Ti je shumë adhures dhe nuk guxon as dhe ta prekësh pak statujën e Buddhës për të cilën djeg erë të mirë çdo ditë, megjithatë ti guxon të prishësh Dafën që mund të udhëheqë me të vërtetë praktikën tënde kultivuese.

Me që po flasim për çështjen e cilësisë së ndriçimit shpirtëror të personit, kjo i referohet thellësisë së të kuptuarit të diçkaje që ndodh në nivele të ndryshme gjatë kursit të praktikës kultivuese, apo të atij Ligji që mjeshtri ka mësuar. Megjithatë, ky nuk është lartësimi shpirtëror themelor të cilit i referohemi ne. Lartësimi shpirtëror themelor për të cilin ne flasim do të thotë që gjatë jetës, nga fillimi i praktikës kultivuese, personi do të ngjitet vazhdimisht lart dhe heqë dorë nga përndjekjet njerëzore dhe nga dëshirat e ndryshme dhe gongu i tij gjithashtu do të rritet derisa arrin në hapin final të praktikës kultivuese. Kur substanca e virtytit të jetë transformuar plotësisht në gong dhe udhëtimi i kultivimit të këtij personi i përgatitur nga mjeshtri të ketë arritur fundin, “Bam!” të gjithë çelsat do të shpërthehen e hapen në sekond. Syri i tij Qiellor do të arrijë pikën më të lartë të nivelit të tij dhe ai mund të shikojë në nivelin e tij të vërtetën e dimensioneve të ndryshme, format e ekzistencës së qënieve dhe materieve të ndryshme në hapësira-kohe të ndryshme dhe të vërtetën e univesit tonë. Të gjitha fuqitë e tij hyjnore do të shfaqen dhe ai do të mund të kontaktojë lloje të ndryshme jete. Tashmë, a nuk është ky person një person i shumëlartësuar shpirtërisht apo një person i lartësuar shpirtërisht nëpërmjet praktikës kultivuese? E përkthyer në gjuhën e lashtë indiane, ai është një Buddha.

Lartësimi shpirtëror të cilit i referohemi ne është ky lartësim shpirtëror themelor që i përket formës së arritjes së lartësimit shpirtëror të menjëhershëm. Lartësim shpirtëror i menjëhershëm do të thotë që një person është i kyçur gjatë viteve të kultivimit të tij dhe ai nuk din gjë sa i lartë është niveli i gongut të tij apo në çfarë forme shfaqet gongu i kultivuar prej tij. Ai nuk ndjen asgjë fare dhe të gjitha qelizat në trupin e tij janë të kyçura. Gongu që ai ka kultivuar është kyçur deri në hapin final dhe vetëm atëherë ai mund të çlirohet. Vetëm dikush me cilësi shumë të mirë të lindur mund ta bëjë këtë, sepse një praktikë kultivuese e tillë është shumë e dhimbshme. Personi duhet ta fillojë duke qënë njeri i mirë. Ai duhet të përmirësojë vazhdimisht karakterin, gjithmonë të vuajë përmes vështirësive, të ngjitet vazhdimisht në kultivim dhe gjithmonë të kërkojë të përmirësojë karakterin

edhe pse ai nuk mund ta shikojë gongun e tij. Kultivimi është tepër i vështirë për këtë person dhe ai apo ajo duhet të jetë dikush me cilësi shumë të mirë të lindur. Ky person do të praktikojë kultivim për shumë vite pa ditur gjë.

Ekziston dhe një formë tjetër lartësimi shpirtëror i quajtur lartësim shpirtëror gradual. Që nga fillimi, shumë njerëz e kanë ndjerë rrotullimin e Falunit. Po ashtu, unë i kam hapur atyre Syrin Qiellor. Për arsye të ndryshme, disa njerëz do të mund të shohin në të ardhmen nëqoftëse nuk shohin tani. Ata do të jenë në gjendje të shikojnë nga të shikuarit e gjërave turbullt në të shikuarit më qartë dhe ata do të kalojnë nga paaftësia për ta përdorur atë në diturinë si ta përdorin. Niveli i personit do të rritet vazhdimisht. Ndërsa karakteri juaj përmirësohet dhe përndjekjet e ndryshme braktisen, do të zhvillohen aftësi supernormale të ndryshme. I gjithë procesi i transformimit të praktikës kultivuese dhe procesi i transformimit të trupit do të ndodhë në kushtet kur ti mund t'i shikosh apo ndjesh ato. Ndryshimet do të vazhdojnë deri në hapin final kur ti mund të kuptosh plotësisht të vërtetën e universit dhe kur ti të kesh arritur pikën më të lartë që duhet të arrish në kultivim. Transformimi i trupit dhe përforcimi i aftësive supernormale do të kenë arritur secili një shkallë të caktuar dhe kjo do të arrihet gradualisht. Ky është lartësimi shpirtëror gradual. Dhe metoda e kultivimit të arritjes së lartësimi shpirtëror gradual nuk është e lehtë. Me aftësi supernormale të shfaqura, disa njerëz nuk heqin dorë dot nga dëshirat e tyre dhe ka mundësi të mburren para të tjerëve apo të bëjnë vepra të këqija. Ju do të humbisni kështu virtyt dhe praktika juaj kultivuese do të shkojë dëm e ju do të përfundoni të shkatërruar. Disa njerëz mund të shikojnë manifestimet e jetëve të ndryshme në nivele të ndryshme. Dikush mund t'ju kërkojë të bëni këtë apo atë gjë. Ai person mund t'ju kërkojë të praktikoni gjërat e tij dhe t'ju marrë si dishepull, por ai nuk mund t'ju ndihmojë të arrini Shkallën e Duhur meqenëse ai vetë nuk e ka arritur Shkallën e Duhur.

Po ashtu, të gjitha qëniet në dimensione të larta janë qenie hyjnore që mund të bëhen shumë të mëdhenj dhe të shfaqin tërë fuqitë e tyre mbinatyrale. Nëqoftëse mendja juaj nuk është e pastër, a nuk do t'i shkoni ju atyre nga prapa? Me t'i ndjekur ata, praktika juaj kultivuese do të shkojë dëm. Edhe sikur ajo qenie të jetë një Buddha apo Tao e vërtetë, ju përsëri duhet ta filloni praktikën kultivuese nga e para. A nuk janë ato qenie qiellore pamvarësisht nga cili nivel i qiellit vijnë? Vetëm kur dikush arrin një nivel shumë të lartë kultivimi dhe ja arrin qëllimit, mundet ai të ngrihet mbi gjithshka. Megjithatë, një personi të zakonshëm, një qenie qiellore mund t'i duket me siguri e lartë, gjigande dhe shumë e zonja. Megjithatë kjo qenie mund të mos e ketë arritur Shkallën e Duhur. Me ndërhyrjen e mesazheve të ndryshme dhe me tërheqjen e vëmendjes nga skena të ndryshme, a mundet të mbeteni të paturbulluar? Prandaj, është gjithashtu e vështirë të praktikosh kultivim me Syrin Qiellor të hapur dhe është më e vështirë të kontrollosh karakterin tënd. Për fat të mirë, shumë nga praktikuesit tanë do t'i kenë aftësitë e tyre supernormale të çbllokuara në gjysmë të procesit të kultivimit të tyre dhe ata pastaj do të arrijnë stadin e lartësimi shpirtëror gradual. Syri Qiellor i të gjithëve do të hapet por aftësitë supernormale të shumicës nuk lejohen të shfaqen. Kur karakteri juaj të arrijë gradualisht një nivel të caktuar dhe ju të mund të silleni mirë e me mendje të qëndrueshme, ato do të shpërthehen hapur të gjitha menjëherë. Në një nivel të caktuar, ju do të hyni në gjendjen e lartësimi shpirtëror gradual dhe në atë kohë do të jetë më e lehtë për ju të silleni mirë. Aftësi të ndryshme supernormale do të shfaqen. Ju do të ngjiteni në kultivim vetë derisa në fund të gjitha ato do të çbllokohen. Juve do t'ju lejohet t'i keni ato në gjysmë të praktikës suaj kultivuese. Shumë nga praktikuesit tanë i përkasin këtij grupi, kështu ju nuk duhet të jeni të paduruar të shikoni gjëra.

Të gjithë mund të keni dëgjuar që sekti Zen flet gjithashtu për dallimet ndërmjet lartësimi shpirtëror të menjëhershëm dhe atij gradual. Huineng, patriarku i gjashtë i sektit Zen, mësoi lartësimin shpirtëror të menjëhershëm ndërsa Shenxiu² nga Shkolla Veriore e sektit Zen mësoi lartësimin shpirtëror gradual. Mosmarrëveshja ndërmjet të dyve mbi studimet Buddhiste zgjati një

² Shenxiu—themelues i Shkollës Veriore të sektit Zen në Dinastinë Tang.

kohë shumë të gjatë në histori. Unë e quaj atë të kotë. Pse? Sepse ajo të cilës i referoheshin ata ishte vetëm të kuptuarit e një parimi gjatë procesit të praktikës kultivuese. Përsa i përket këtij parimi, disa mund ta kuptojnë atë menjëherë, ndërsa të tjerët mund ta arrijnë e kuptojnë atë gradualisht. A ka rëndësi si dikush arrin lartësimin shpirtëror? Është më mirë kur ai mund ta kuptojë të gjithën menjëherë, por është gjithashtu mirë nëqoftëse dikush arrin gradualisht të lartësohet shpirtërisht. A nuk janë të dyja rastet lartësim shpirtëror? Të dyja janë lartësim shpirtëror, kështu asnjëra nuk është e gabuar.

Njerëzit me Cilësi të Lindur të Madhe

Çfarë është një person me “cilësi shpirtërore të lindur të madhe”? Ka dallim edhe ndërmjet dikujt me cilësi shpirtërore të lindur të madhe dhe dikujt me cilësi shpirtërore të lindur të mirë apo të varfër. Është jashtëzakonisht e vështirë të gjesh dikë me cilësi shpirtërore të lindur të madhe, sepse do të duhej një periudhë shumë e gjatë historike që të lindte një person i tillë. Sigurisht, një person me cilësi shpirtërore të lindur shumë të madhe duhet së pari të ketë një sasi të madhe virtyti dhe një fushë shumë të madhe të kësaj substance të bardhë—kjo është e sigurtë. Ndërkohë, ky person duhet gjithashtu të jetë i aftë të durojë vështirësinë e vështirësive. Ai gjithashtu duhet të ketë një mendje me durim të madh dhe të jetë në gjendje të sakrifikojë. Ai duhet të jetë i aftë të ruajë virtyt, të ketë cilësi ndriçimi shpirtëror të mirë e kështu me rallë.

Cila është vështirësia e vështirësive? Besohet në Buddhizëm se të jesh njeri do të thotë të vuash—për aq kohë sa ju jeni njerëz, ju duhet të vuani. Besohet se jetët në gjithë dimensionet e tjera nuk kanë trupa si trupat njerëzore. Prandaj ata nuk sëmuren dhe as nuk kanë problemet e lindjes, plakjes dhe vdekjes. As që do të kenë vuajtje të tilla. Njerëzit në dimensione të tjera mund të ngrihen në ajër, sepse ata janë pa peshë dhe është me të vërtetë një mrekulli. Për shkak të këtij trupi, njerëzit e zakonshëm do të hasin në vështirësi. Ata nuk mund të durojnë të ftohtët, të nxehtët, etjen, urinë apo lodhjen e për më shumë kanë lindje, plakje, sëmundje dhe vdekje. Sidoqoftë ata nuk do të kenë rehati.

Unë lexova në një gazetë se në kohën e tërmetit në qytetin Tangshan, shumë njerëz u vranë nga tërmeti, por disa i sollën në jetë nga vdekja klinike. Një anketim i veçantë u krye me këtë grup njerëzish. Ata u pyetën: “Si ndjeheshit në gjendjen e vdekjes?” Për habi, këta njerëz të gjithë folën për të njejtën situatë të veçantë. Domethënë, pikërisht në momentin e vdekjes ata nuk ndjenë frikë; përkundrazi, ata papritmas ndjenë një ndjenjë lehtësimi, me një lloj gëzimi në nën-ndërgjegje. Disa njerëz u ndjenë të çliruar nga barra e trupit dhe mund të ngriheshin në ajër me lehtësi dhe me një ndjenjë mrekullie; ata gjithashtu mund të shihnin dhe trupat e tyre. Disa njerëz mundën të shihnin gjithashtu dhe jetë në dimensione të tjera dhe disa të tjerë shkuan në vende të ndryshme. Të gjithë përmendën një ndjenjë lehtësimi në atë moment dhe një lloj gëzimi në nën-ndërgjegje pa ndonjë ndjenjë vuajtjeje. Kjo sugjeron se me këtë trup fizik njeriu, personi do të vuajë, por ngaqë të gjithë dalin nga nëna në këtë mënyrë, askush nuk e din se kjo është vuajtje.

Unë e thashë më parë se personi duhet të kalojë vështirësinë e vështirësive. Dje thashë se koncepti i hapësirë-kohës së njerëzimit është i ndryshëm nga ai i një hapësirë-kohe tjetër më të madhe. Këtu, një shichen është dy orë, që është një vit në atë hapësirë. Nëqoftëse një person praktikon kultivim në kushte të tilla të ashpra, ai do të quhej me të vërtetë i jashtëzakonshëm. Kur këtij personi i lind në zemër Tao dhe dëshiron të praktikojë kultivim, ai është thjesht i madh. Me vështirësi të tilla, ai akoma nuk e ka humbur natyrën e tij origjinale dhe dëshiron të kthehet në origjinë nëpërmjet praktikës kultivuese. Pse mund të ndihmohen praktikuesit pa rezerva? Është pikërisht për këtë arsye. Kur ky person ulet në meditim për një natë rresht në këtë dimension, me ta parë këtë, ata do të thonë se ai është me të vërtetë i jashtëzakonshëm sepse kjo do të thotë atje që ai

ka ndenjtur ulur për gjashtë vjet. Kjo ndodh ngaqë një shichen e joni është një vit atje. Dimension i njerëzimit është jashtëzakonisht i veçantë.

Si i duron një person vështirësitë e vështirësive? Për shembull, një ditë personi shkon në punë dhe vendi i punës nuk po shkon mirë. Situata nuk mund të vazhdojë sepse njerëzit nuk po bëjnë punën. Ndërmarrja do të riorganizohet dhe do të përdorë punëtorë me kontratë. Personeli i tepërt do të hiqet nga puna dhe ky person është një nga ata të cilëve i hiqet buka e gojës papritur. Si do ndjehet ai? Nuk ka vende të tjera pune. Si mund ta sigurojë ai jetesën? Ai nuk ka aftësi të tjera kështu ai shkon në shtëpi i mërzhitur. Sapo ai arrin në shtëpi, gjen prindin e moshuar të sëmurë në shtëpi dhe në kushte serioze. I shqetësuar, ai do të nxitojë ta shpjerë prindin në spital. Ai heq gjithë ato vështirësi e merr para borxh për shtrimin në spital. Ai do kthehet pastaj në shtëpi që të përgatisë ushqim për prindin. Sapo kthehet në shtëpi, një mësues do vijë e trokasë në derë: “Fëmija juaj ka dëmtuar dikë në përleshje e sipër dhe duhet të vish menjëherë ta shohësh vetë.” Pasi ai merret me këtë situatë dhe kthehet në shtëpi, sapo ulet, i thonë në një telefonatë: “Bashkëshortja jote po e dredh me njërin.” Sigurisht, ju nuk do të hasni në të njëjtin skenar. Një person i zakonshëm nuk mund ta durojë vuajtjen nga këto probleme dhe do të mendojë: “Për çfarë jetoj unë? Pse nuk marr një litar e të var veten e ti jap fund të gjithave?” E kam fjalën se personi duhet të jetë i aftë të vuajë vuajtjen e vuajtjeve. Sigurisht, ato nuk është e thënë të jenë njëlloj me këto. Megjithatë konfliktet midis njerëzve, përplasjet që kalisin karakterin tënd dhe konkurenca për përfitim personal nuk janë më të lehta se këto. Shumë njerëz vetëm jetojnë për të provuar se kanë të drejtë apo për të mos u turpëruar dhe do e varnin veten kur nuk ja dalin dot më gjërave. Kështu ne duhet të praktikojmë kultivim në këtë ambjent kompleks dhe të jemi të aftë të durojmë vështirësinë më të madhe. Ndërkohë, ne duhet të kemi një zemër me durim të madh.

Çfarë është një “zemër me durim të madh?” Si praktikues, gjëja e parë që ju duhet të bëni është të mos luftoni mbrapsht kur ju godasin apo shajnë—ju duhet të jeni tolerant. Përndryshe çfarë lloj praktikuesi jeni ju? Dikush thotë: “Është shumë e vështirë të jesh tolerant dhe unë kam një temperament të keq.” Nëqoftëse temperamenti juaj nuk është i mirë, ju duhet ta ndryshoni atë, sepse një praktikues duhet të jetë tolerant. Disa njerëz e humbin gjakftohtësinë kur disiplinojnë fëmijët dhe i ulërijnë atyre duke krijuar një skenë të keqe. Ju nuk duhet të jeni ashtu në disiplinimin e fëmijëve dhe as nuk duhet që ju vetë të mërzhiteni me të vërtetë. Ju duhet t’i edukoni fëmijët me arsye kështu që t’i mësoni ata të sillen mirë. Nëqoftëse ju nuk kaloni as dhe një gjë kaq të vogël dhe e humbni gjakftohtësinë kaq shpejt, si doni që të rrisni gongun tuaj pastaj? Dikush thotë: “Nëqoftëse dikush më bie me shkelm ndërsa po kaloj në rrugë e askush rreth e rrotull nuk më njeh, unë mund ta duroj atë.” Unë them se kjo nuk është e mjaftueshme. Mbase në të ardhmen ty mund të të bien me shuplakë në futyrë dhe ti do turpërohesh para dikujt që ti nuk do të deshe kurrë ta shihje këtë. Kjo ndodh që të shohim si do ta trajtojnë këtë situatë dhe nëse mund ta durosh atë. Nëqoftëse ti mund ta durosh por prapsepër të mbetet mëndja aty, kjo nuk është e mjaftueshme. Siç e dini, kur një person arrin nivelin e Arhatit, ai nuk ka asnjë shqetësim në zemër. Ai nuk shqetësohet aspak për problemet njerëzore dhe gjithmonë është i qeshur dhe në humor. Pamvarësisht sa humbje pëson, ai përsëri do të jetë i buzëqeshur dhe me humor pa asnjë shqetësim. Nëqoftëse ju mund ta bëni me te vërtetë këtë, ju keni arritur nivelin e hyrjes të Shkallës së Arrijtes së Arhatit.

Disa njerëz thonë, “Po të praktikojmë toleranca deri në këtë shkallë, njerëzit e zakonshëm do të thonin se ne jemi frikacakë dhe mund të merremi nëpër këmbë me lehtësi.” Unë nuk e quaj këtë të jesh frikacak. Mendojeni pak: Edhe në mes të njerëzve të zakonshëm të moshave të thyera e atyre me arsim të lartë ushtrohet vetpërmbajtje dhe kufizim në zënkat me të tjerët, jo pastaj të flasim për praktikuesit tanë. Si mund të merret kjo se je frikacak? Unë them se është reflektim i një durimi të madh dhe një shprehje vullneti të fortë. Vetëm një praktikues mund të ketë një zemër të tillë durimi të madh. Ekziston kjo thënie, “Kur një njeri mesatar turpërohet, ai do nxjerrë shpatën të luftojë.” Për një njeri të zakonshëm, është vetëm e natyrshme që nëqoftëse ti më shan mua, unë të shaj ty dhe po më

godite mua unë të godas ty. Ky është një njeri i zakonshëm. A mund të quhet ai praktikues? Si praktikues, pa vullnet të fortë dhe pa vetkontroll, ju nuk do jeni në gjendje të veproni si duhet.

Ju e dini që në kohë të lashta ishte një njeri i quajtur Han Xin,³ i cili thuhej se ishte shumë i aftë si gjeneral i lartë për Liu Bang⁴ dhe mbështetje për vendin. Pse i pati ai gjithë ato arritje? Thuhet se Han Xin ishte një njeri i rrallë që në moshë të re. Është një histori për Han Xin ku thuhet se ai duroi përluljen e zvarritjes në mes të këmbëve të dikujt. Han Xin-it i pëlqente të praktikonte artet marcialë kur ish i ri dhe një ushtrues i artit marcial zakonisht mbante shpatë. Një ditë ndërsa po ecte në rrugë, një rrufian i bllokoi rrugën me duart në mes: “Për çfarë e mban atë shpatë? A ta mban të vrasësh njeri? Po ta mbajti, prite kokën time.” E ndërsa thonte këtë, ai zgjati kokën. Han Xin mendoi: “Pse të ta pres kokën?” Në atë kohë të vrisje dikë raportohej tek qeveria dhe personit do i duhej ta paguante jetën e marrë. Si mund të vriste njeriu tjetrin kur t’i tekej? Kur rrufiani pa që Han Xin nuk guxonte ta vriste, ai tha: “Po nuk ta mbajti të më vrasësh, do të të duhet të zvarritesh në mes të këmbëve të mia.” Han Xin me të vërtetë u zvarrit në mes të këmbëve të tij. Kjo tregon se Han Xin kishte një zemër me durim të madh. Meqenëse ishte i ndryshëm nga njerëzit e zakonshëm, ai mundi të realizonte gjithë ato arritje. Është motoja e një njeriu të zakonshëm që njeriu duhet të jetojë për të provuar se ka të drejtë apo për të mos u turpëruar. Pa mendojeni pak: Të jetosh për të provuar se ke të drejtë apo për të mos u turpëruar—a nuk është e lodhshme kjo? A nuk është e dhimbshme? A ja vlen? Megjithatë Han Xin ishte një njeri i zakonshëm. Si praktikues, ne duhet të jemi shumë më lart se ai. Qëllimi ynë është të dalim mbi nivelin e njerëzve të zakonshëm dhe të çajmë përpara drejt niveleve të larta. Ne nuk do të biem në një situatë të ngjashme. Megjithatë përlulja dhe turpi që një praktikues duron në mes të njerëzve nuk është e thënë të jenë më të lehta se ajo. Unë do të thoja se grindja në mes njerit tjetrit që kalit karakterin tuaj nuk është më e lehtë sesa ajo dhe madje mund të jetë më e vështirë—është me të vërtetë e zorshme.

Ndërkohë, një praktikues duhet gjithashtu të bëjë sakrifica, të braktisë përndjekjet e ndryshme dhe dëshirat e njerëzve të zakonshëm. Është e pamundur të jesh i aftë ta arrish këtë menjëherë, kështu ne e arrijmë këtë gradualisht. Po ta arrije ta bëje këtë sot, ju do ishit tani një Buddha. Praktika kultivuese merr kohë, por ju nuk duhet të dembeloseni. Ju mund të thoni: “Mësuesi ka thënë se praktika kultivuese merr kohë—le ta marrim shtruar.” Kjo nuk bën! Ju duhet të jeni i rreptë me veten. Në kultivimin e Ligjit të Buddhës, ju duhet të çani përpara me këmbëngulje.

Ju duhet gjithashtu të jeni të aftë të ruani virtytin, të mbani lart karakterin tuaj, dhe të mos bëni gjë sipas dëshirës. Ju nuk duhet që të bëni çfarë të doni dhe duhet të jeni të aftë të ruani karakterin tuaj. Tek njerëzit e zakonshëm, dëgjohet shpesh kjo thënie: “Të kryesh vepra të mira grumbullon virtyt.” Një praktikues nuk praktikon të grumbullojë virtyt, sepse ne besojmë në ruajtjen e virtytit. Pse besojmë ne në ruajtjen e virtytit? Sepse kemi konstatuar këtë situatë: Të grumbullosh virtyt është besimi i njerëzve të zakonshëm sepse ata duan të grumbullojnë virtyt dhe të kryejnë vepra të mira kështu që ata mund të jetojnë mirë në jetën tjetër. Por ne nuk e kemi këtë problem. Nëqoftëse ju arrini sukses në praktikën kultivuese, ju do keni arritur Taon dhe nuk do të keni problemin e jetës tjetër. Kur ne flasim këtu për ruajtjen e virtytit, ka dhe një nuancë tjetër kuptimi. Dhe pikërisht, këto dy substanca që mban trupi jonë nuk janë grumbulluar në një jetë—ato janë trashëguar nga një periudhë e hershme. Edhe sikur t’i binit qytetit kryq e tërthor me biçikletë, ju mund të mos hasnit asnjë vepër të mirë për të bërë. Edhe sikur ta praktikoni një gjë të tillë çdo ditë, ju mund të mos hasnit në mundësira të tilla.

Kjo përmban akoma dhe një nuancë tjetër kuptimi: Duke u përpjekur për të grumbulluar virtyt, ti mund të mendosh se diçka është vepër e mirë, por po ta bësh, mund të dalë që është e gabuar. Po të ndërhysh në diçka që ti e konsideron si diçka të keqe, ajo mund të dalë se ishte gjë e mirë. Pse? Sepse ju nuk mund të shikoni lidhjen karmike. Ligjet rregullojnë punët e njerëzve të

³ Han Xin—gjenerali kryesor për Liu Bang.

⁴ Liu Bang—perandori dhe themeluesi i Dinastisë Han (206 B.C. - 23 A.D.).

zakonshëm, e kjo nuk paraqet ndonjë problem. Por të jesh praktikues do të thotë të jesh mbinjerëzor, kështu si njeri mbinjerëzor, ju duhet të silleni sipas parimeve mbinjerëzore në vend që ta masni veten me standartet e njerëzve të zakonshëm. Nëqoftëse ju nuk e dini lidhjen karmike të një gjëje, ka shumë mundësi që ju ta trajtoni atë në mënyrë jo korrekte. Prandaj, ne mësojmë wuwei dhe ju nuk duhet të bëni diçka vetëm sepse keni dëshirën ta bëni. Disa njerëz thonë: “Unë dua vetëm të disiplinoj njerëzit e këqinj.” Do të thoja se ju më mirë bëhuni polic. Por ne nuk ju kërkojmë juve të qëndroni jashtë gjërave kur ju hasni ndonjë vrasje apo vënie zjarri. Po ju them të gjithëve se kur ndodh ndonjë konflikt midis personave apo kur dikush shkelmon apo godet dikë tjetër, ka shumë mundësi që këta njerëz ia kishin borxh njeri tjetrit në të kaluarën dhe po lajnë një borxh. Po të ndërhyri që ta ndaloni, ata nuk do të kenë mundësi ta lajnë borxhin dhe duhet të presin për një rast tjetër. Kjo do të thotë se nëqoftëse ju nuk mund të shikoni lidhjen karmike, ju mund të kryeni vepra të këqija me lehtësi dhe të humbisni virtyt si pasojë.

Nuk ka rëndësi nëse një person i zakonshëm ndërhyr në punët e njerëzve të zakonshëm, sepse ai apo ajo do të zbatojë parimet e njerëzve të zakonshëm për ta zgjidhur situatën. Ju duhet të përdorni parimet e larta për të gjykuar gjërat. Është çështje karakteri nëse ju nuk ndihmoni të ndaloni një vrasje apo zjarr me qëllim kur i shihni ato. Përndryshe si do të demonstroni se ju jeni një njeri i mirë? Po të mos ndihmoni të ndaloni një vrasje apo vënie zjarri, në çfarë gjëje tjetër do të ndërhyri ju? Megjithatë duhet theksuar një pikë: Këto gjëra me të vërtetë nuk do të kenë të bëjnë me praktikuesit tanë. Ato mund të mos jenë planifikuar që t’i hasni ju. Ne kemi thënë se ruajtja e virtytit e bën dikë të evitohet bërjen e gabimeve. Mbase nëqoftëse ti bën diçka, ti mund të kryesh një vepër të keqe dhe atëherë do të humbasësh virtyt. Me të humbur virtyt, si mund ta rrisësh ti nivelin tënd pastaj? Si mund të arrish qëllimin tënd përfundimtar? Kjo ka lidhje me këto çështje. Po ashtu, ti duhet të kesh dhe cilësi të mirë ndriçimi shpirtëror. Cilësia shpirtërore e mirë e lindur mund ta bëjë dikë që të ketë ndriçim të mirë shpirtëror. Ndikimi i ambjentit gjithashtu mund të ketë një lloj ndikimi.

Ne gjithashtu kemi thënë se nëse të gjithë ne kultivojmë veten tonë të brendshme, ekzaminojmë karakterin tonë për të parë për shkaqet e gabimit në mënyrë që të veprojmë më mirë herën tjetër dhe të marrin në konsideratë të tjerët para se të bëjmë ndonjë veprim, shoqëria njerëzore do të bëhet më e mirë dhe standartet e saj etike do të ngriheshin përsëri. Qytetërimi shpirtëror⁵ do të përmirësohet dhe po ashtu dhe sigurimi publik. Mbase nuk do të kishte polici. Askush nuk do të kishte nevojë që të qeverisej sepse të gjithë do të disiplinonin veten dhe do ta kërkonin arsyen brenda vetes. A nuk do thonit ju që kjo do të ishte e hatashme? Ju e dini se ligjet janë bërë më përmbledhëse e më të perfeksionuara. Megjithatë pse ka njerëz që akoma kryejnë vepra të këqija? Pse nuk zbatojnë ata ligjet? Sepse ju nuk mund të qeverisni zemrat e tyre. Kur nuk i sheh njeri, ata përsëri do të kryejnë vepra të këqija. Nëqoftëse dikush kultivon veten e vet të brendshme, do të jetë plotësisht ndryshe. Nuk do kishte nevojë për askënd që të siguronte drejtësi.

Ky Ligj mund të jepet vetëm deri në këtë nivel. Varet nga kultivimi juaj që të merrni ato që janë në nivele të larta. Pyetjet e bëra nga disa persona janë bërë më specifike. Nëqoftëse unë ju shpjegoj të gjitha pyetjet në jetën tuaj, çfarë do të mbetet që të kultivohet nga ju? Ju duhet të praktikoni kultivim dhe të lartësoheni shpirtërisht vetë. Po t’ju tregoj çdo gjë, nuk mbetet asgjë për t’u kuptuar gjatë kultivimit tuaj. Për fat të mirë, Dafa është bërë tashmë publike dhe ju mund t’i bëni gjërat në përputhje me Dafën.

* * *

⁵ qytetërim shpirtëror—term popullor ne Kinën e kohës së sotme që do të thotë lartësim i mendjes së njerëzve dhe moralit. Në Kinë, ky term përdoret si kontrast ndaj “qytetërimit material”.

Unë mendoj se koha ime për të shpërndarë Ligjin ka ardhur praktikisht në përfundim. Prandaj, unë dua t'ju lë të gjithëve gjëra autentike kështu që të ketë Ligj për të udhëhequr secilin në praktikën e ardhshme kultivuese. Gjatë gjithë periudhës së mësimit të këtij Ligji, unë kam dashur t'i bëj gjërat sipas parimit të të qenit i përgjegjshëm para secilit dhe shoqërisë. Në fakt, ne kemi ndjekur këtë parim. Përsa i përket rezultatit, unë nuk do të bëj ndonjë koment. E ka në dorë publiku ta gjykojë. Qëllimi im është ta bëj këtë Ligj të Lartë publik dhe të bëj më shumë njerëz të përfitojnë, duke i aftësuar ata që me të vërtetë duan të praktikojnë kultivim të përparojnë në praktikën kultivuese të tyre duke ndjekur këtë Ligj. Në të njejtën kohë që ju mësojmë Ligjin, ne gjithashtu kemi shpjeguar parimet e të qenit njeri dhe shpresojmë që nëse pas kësaj klase ju nuk do të mund të ndiqni këtë Ligj të Lartë për të praktikuar kultivim, ju të paktën do të bëheni një njeri i mirë. Prej kësaj do të përfitojë shoqëria jonë. Në fakt, ju tashmë e dini si të bëheni njeri i mirë and pas kësaj klase ju do të jeni njeri i mirë.

Gjatë kursit të mësimit të Ligjit, ka pasur gjithashtu dhe gjëra që nuk kanë shkuar vaj dhe ndërhyrje të ndryshme kanë qënë shumë të mëdha. Në sajë të mbështetjes së madhe prej organizatave ftuese, administratorëve në profesione të ndryshme dhe përpjekjeve të stafit tonë, klasat tona kanë qënë plotësisht të suksesshme.

Të gjitha ato që kam trajtuar ne leksione janë për të udhëhequr secilin që të praktikojë kultivim drejt niveleve të larta. Në të kaluarën, askush nuk i dha këto gjëra në mësimet e tyre. Ajo që ju kemi mësuar është shumë e qartë dhe ka inkorporuar shkencën moderne dhe bashkëkohore të trupit të njeriut. Po ashtu, ajo që ju është mësuar është e një niveli shumë të lartë. Pikë së pari ka për qëllim të aftësojë çdo njeri që të mësojë Ligjin në të ardhmen dhe të ngjitet nëpërmjet praktikës kultivuese—ky është qëllimi im. Gjatë kursit të mësimit të Ligjit dhe ushtrimeve, shumë njerëzve u duket se Ligji është shumë i mirë, por shumë i vështirë për t'u zbatuar. Në fakt, unë mendoj se varet nga personi nëse është i vështirë apo jo. Për një person të zakonshëm i cili nuk dëshiron të praktikojë kultivim, do t'i duket praktika kultivuese shumë e vështirë, e pakonceptueshme apo e pamundur. Si njeri i zakonshëm ai nuk dëshiron të praktikojë kultivim dhe do t'i duket ajo shumë e vështirë. Lao Zi pat thënë: “Kur një njeri i mençur dëgjon për Taon, ky person do ta praktikojë atë me zell. Kur një njeri i mesëm e dëgjon atë, ky person do ta praktikojë atë me hope. Kur një person i metë e dëgjon atë, ky person do të qeshë me të madhe. Nëqoftëse ky person nuk qesh me të madhe, nuk është Tao.” Një praktikuesi të sigurtë, unë do t'i thoja se është shumë e lehtë dhe jo diçka tepër e lartë për t'u arritur. Në fakt, shumë praktikues veteranë të ulur këtu apo që nuk janë prezent kanë arritur shumë nivele të larta në praktikën e tyre kultivuese. Unë nuk ja u kam thënë këtë, që të mos zhvillonit ndonjë dëshirë apo të kënaqeshit me veten. Kjo do të ndikonte pastaj në zhvillimin e fuqisë së gongut tuaj. Si praktikues me të vërtetë të vendosur, ju do të jeni të aftë të duroni çdo gjë dhe të hiqni dorë apo të mos merakoseni fare për dëshirat apo para interesave personale të ndryshme. Për aq kohë sa ju mund ta bëni këtë, nuk do të jetë e vështirë. Atyre personave i duket e vështirë sepse ata nuk mund të heqin dorë nga këto gjëra. Vetë praktika kultivuese nuk është e vështirë dhe as përmirësimi i nivelit të personit nuk është i vështirë. Ngaqë ata nuk mund të heqin dorë nga mëndja njerëzore, ata e quajnë atë të vështirë. Kjo ndodh sepse është shumë e vështirë të lësh diçka me fitim praktik. Përfitimet janë para syve, pra si mund t'i braktisni ju këto dëshira? Është në fakt për shkak të kësaj që do t'i duket e vështirë. Kur ndodh një konflikt me persona të tjerë, nëqoftëse ju nuk praktikoni tolerancë apo trajtoni veten si kultivues kur hasni me të, unë do të thoja se kjo do të ishte e papranueshme. Kur unë praktikoj kultivim në të kaluarën, shumë mjeshtrë të mëdhenj më thanë këto fjalë: “Kur është e vështirë të durosh, ti mund ta durosh. Kur është e pamundur për t'u bërë, ti mund ta bësh.” Në fakt, është kështu. Pse nuk e provoni njëherë kur të ktheheni në shtëpi. Kur të jesh duke kapërcyer një vështirësi reale apo problem, ti provoje njëherë. Kur është e vështirë të durosh, përpiqu ta durosh. Kur duket e pamundur dhe thonë se është e pamundur, bëje provë dhe shiko në është e mundur.

Nëqoftëse e provon me të vërtetë, ti do të gjesh se: “Pasi të kalosh shëlgjet me hije, do të ketë lule të mrekullueshme e një fshat tjetër më tutje!”

Ngaqë kam folur kaq shumë, do të jetë shumë e vështirë për secilin të mbajë mend kaq shumë gjëra që janë thënë. Unë kryesisht do të bëj pak kërkesa: Shpresoj se të gjithë ju do ta trajtoni veten si praktikues në praktikën kultivuese të ardhme dhe me të vërtetë do të praktikoni kultivim. Shpresoj se si praktikuesit veteranë ashtu dhe ata të rinj do të jenë të aftë të praktikojnë kultivim në Ligjin e Lartë dhe të dalin me sukses! Shpresoj se pasi të shkoni në shtëpi, secili do të bëjë perpjekjen më të madhe të tij e të saj për të praktikuar me të vërtetë kultivim.

.....

Në sipërfaqe, *Zhuan Falun* nuk është elegant përse i përket gjuhës. Mund të mos jetë as konform gramatikës moderne. Po të përdorja gramatikë moderne për të organizuar këtë libër të Dafës, do dilte një problem serioz ku megjithëse struktura e gjuhës së librit mund të ishte sipas standartit dhe elegante, ai nuk do të përfshinte një përmbajtje më të thellë dhe të lartë. Kjo ndodh ngaqë terminologjia moderne e standartizuar nuk mund të shprehë udhëheqjen e Dafës në nivele të ndryshme të larta dhe manifestimet e Ligjit në çdo nivel; dhe as do të mundte të kryente transformimin e trupit dhe të gongut të praktikuesve apo ndryshime të tjera themelore si këto.

.....

Li Hongzhi
5 janar 1996

Përmbjedhje e Termave

- Ah Q** (ah kju)—një personazh budalla në një novelë Kineze.
- Arhat**—Qënie e Shumëlartësuar me Shkallë Arritjeje në Shkollën e Buddhës dhe një që është jashtë “Tre Hapësirave”.
- asura**—shpirtra të këqinj (nga gjuha Sanskrit).
- baihui**—pikë akupunkte në majë të kokës.
- benti**—trup fizik i njeriut dhe trupat e tij në dimensionet e tjera.
- Bian Que**—mjek i mirënjohur i mjekësisë kineze në histori.
- bigu**—një term i lashtë që do të thotë të heqësh dorë nga ushqimi dhe uji.
- Bodhisattva**—Qënie e Shumëlartësuar me Shkallë Arritjeje në Shkollën e Buddhës dhe një që është më lart se Arhati dhe më poshtë se një Tathagata.
- Bodhisattva Avalokitesvara**—e njohur për dashamirësinë e saj, ajo është një nga dy Bodhissattvat e Mëdha në Parajsën e Lumturisë Absolute.
- “bota e dhjetë drejttimeve”**—sipas konceptit Buddhist universi ka dhjetë drejttime.
- Caocao**—Perandor i një prej Tre Mbretërive (220 e.r.-265 e.r.).
- Da Ji**—një konkubinë e ligë e perandorit të fundit në Dinastinë Shang (1765 p.e.r.-1122 p.e.r.). Ajo mendohet se ka qenë zotëruar nga një shpirt dhelprë dhe se shkaktoi rënien e Dinastisë Shang.
- Dafa**—Fa do të thotë Ligj i Universit, Dafa do të thotë Ligj i Lartë, parime; që këtej e tutje do t’i referohemi me Ligj i Lartë.
- dan**—grumbull energjie në trupin e një kultivuesi i mbledhur nga dimensione të tjera.
- dantian**—“fushë dan-i”; pjesa poshtme e barkut.
- Dharma**—mësimet e Buddhës Sakyamuni.
- Sutra Diamant**—një shkrim i shenjtë i lashtë në Buddhizëm.
- Dinastia Ming**—periudhë ndërmjet 1368 dhe 1644 p.e.r. në historinë e Kinës.
- Dinastia Tang**—një nga periudhat më të zhvilluara në historinë kineze (618 e.r. - 907 e.r.).
- Fa**—ligjet dhe parimet e Shkollës Buddhës; që këtej e tutje do t’i referohemi me “Ligj”.
- Fashen**—“trup ligji”; trup i përbërë prej gongu dhe Ligj.
- fengshui**—praktikë e lashtë kineze e të jetuarit në harmoni me energjinë e ambientit rrethues; një lloj arti i interpretimit të truallit dhe natyrës.
- gong**—1. energji e kultivuar; 2. praktikë që kultivon këtë energji.
- gongshen**—trup i përbërë prej gongu.
- guanding**—hedhje energjie mbi majën e kokës së personit; rit i fillimit të praktikës; tip baptizimi në Buddhizëm.
- Han**— shumica etnike e popullit kinez.
- Han Xin**—gjenerali kryesor për Liu Bang në Dinastinë Han (206 p.e.r. - 23 e.r.).
- heche** (he-she)— “mjet lumi.”
- hegu**—pikë akupunkte në kurriz të dorës, ndërmjet gishtit të madh dhe gishtit tregues.
- Hetu**—diagram parahistorik që u shfaq në Kinën e lashtë dhe mendohet të tregojë të vërtetën e ndryshimeve të kursit të natyrës.
- Hinayana**—“Buddhizmi i Portës së Vogël.”
- Huatuo**—mjek i mirënjohur i mjekësisë kineze në histori.
- huiyin**—pikë akupunkte në qendër të perineut (pjesa ndërmjet organit të jashtëqitjes dhe organeve gjenitale).
- Inaugurimi i Zotëve**—një vepër klasike artistike kineze.
- Jiang Ziya**—një personazh në *Inaugurimi i Zotëve*.
- Jigong**—murg i njohur Buddhist në Dinastinë Song të Jugut (1127 e.r.-1279 e.r.).

Kalpa—periudhë që zgjat dy miliard vjet; këtu termi është përdorur si numër.

kanale energjie—në mjekësinë kineze thuhet se ato janë përçues të qi-së dhe formojnë një rrjet të komplikuar për qarkullimin e energjisë.

Kanuni Taoist—tekst klasik kinez për praktikë kultivuese.

karmë/a—një substancë e zezë në trup me ekzistencë materiale në një dimension tjetër që mblidhet nga veprimet e këqija të personit.

“krijimin e një mbajtëse dhe furre trupore për të prodhuar dan duke përdorur barëra mjekësore të mbledhura”—metaforë Taoiste për alkiminë e brendshme.

Lao Zi—themelues i Shkollës Tao dhe autor i *Tao Te Ching (Dao De Jing)*, që mendohet të ketë jetuar dhe dhënë mësim në Kinë rreth shekullit të V apo IV p.e.r..

laogong—pikë akupunkte në qendër të pëllembës së dorës.

Lei Feng—shembull i një personi me moral të lartë në vitet 1960 në Kinë.

li—një njësi kineze gjatësie (=0.5 km). Në gjuhën kineze, “108 mijë li” është një shprehje e zakonshme që përdoret për një distancë shumë të largët.

Li Shizhen—mjek i mirënjohur i mjekësisë kineze në histori.

Libri i Elikzirit—tekst klasik kinez për praktikë kultivuese.

Libri i Ndryshimeve—libër profecie i lashtë kinez që daton nga Dinastia Zhou (1100 - 221 p.e.r.).

Ligj-Në-Botën-Trefishe—sipas Buddhismit dikush duhet t’i nënshtrohet samsarës (ciklit të ringjalljes) nëse ai nuk ka arritur kultivimin në Ligj-Përtej-Botës-Trefishe.

Liu Bang—perandori dhe themeluesi i Dinastisë Han (206 B.C. - 23 A.D.).

Lu Dongbin—një nga Tetë Shenjtorët në Shkollën Tao.

Luoshu—diagram parahistorik që u shfaq në Kinën e lashtë dhe mendohet të tregojë të vërtetën e ndryshimeve të kursit të natyrës.

Mah Jong—lojë tradicionale kineze që luhet me katër veta.

Mahajana—“Buddhizmi i Portës Madhe.”

maoyou—kufiri ndarës ndërmjet anëve të yin dhe yang të trupit.

Mbreti Majmun—një personazh në veprën klasike artistike kineze *Udhëtim për në Perëndim*.

mingmen—“Porta e jetës”; një pikë akupunkte që ndodhet në mes të pjesës së poshtme të kurrizit.

mo ding—siç pretendojnë disa mjeshtër qigongu, prekje e majës së kokës së dikujt për t’i dhënë energji.

Nëna Mbretëreshë—në mitologjinë kineze, femra perëndi me nivelin më të lartë brenda Tre Hapësirave.

nirvana—(nga Sanskrit) lënia e botës njerëzore pa trupin fizik; mënyra e përfundimit të kultivimit në Shkollën e Buddhës Sakyamuni.

niwan (ni-uahn) apo Pallati Niwan—term Taoist për gjendrën pineale.

Perandori Gurçmuar—në mitologjinë kineze, perëndia që kujdeset për Tre Hapësirat.

Periudha e Fund-Dharmës—sipas Buddha Sakyamunit, kjo periudhë do të fillonte 500 vjet pasi ai të kish ndrruar jetë dhe Dharma e tij nuk mund të shpëtonte më njerëzit.

Pesë Elementet—metali, druri, uji, zjarri dhe dheu.

Pëllembë e Hekurt, Pëllembë Merkuri, Këmbë Diamanti dhe Këmbë Arhati—lloje teknikash të artit marcial kinez.

qi (çi)—në kulturën kineze besohet të jetë “energji jetësore”; në krahasim me gongun është formë më e ulët energjie.

qiankun—“qiell dhe tokë.”

qigong (çigong)—formë ushtrimi tradicional kinez që kultivon qi apo “energji jetësore”

qiji (çi-xhi)—“mekanizma energjie”.

Qin Hui—një zyrtar i keq i oborrit mbretëror në Dinastinë Song të Jugut (1127 e.r - 1279 e.r).

Ren—tolerancë, durim.

Revolucioni i Madh Kulturor—një lëvizje politike komuniste në Kinë që dënonte vlerat dhe kulturën tradicionale (1966-1976).

Shkallë e Duhur—realizimi i Shkallës së Arritjes në Shkollën e Buddhës.

Sakyamuni (sakiyamuni)—Buddha historik, Guatama Siddhartha.

samadhi—në Buddhizëm do të thotë meditim në pavetëdije, në kllapi.

samsara—shtatë rrugët e ringjalljes në Buddhizëm (Dikush mund të lindi njeri, kafshë, bimë apo formë tjetër e materies nëpërmjet ringjalljes.)

Shan—zemërmadhësi, mëshirë, mirësi.

shangen—qendër akupunkte që ndodhet në mes të vetullave.

Sekti Guanyin—një kult i quajtur sipas Bodhisattva Avalokitesvarës, “Perëndeshës së Mëshirës”.

Shen Gongbao—një personazh xheloz në *Inaugurimi i Zotëve*.

Shenxiu—themelues i Shkollës Veriore të sektit Zen në Dinastinë Tang.

shichen (shiçen)—një njësi kineze kohe prej dy orësh.

shishen—një term Taoist për Shpirtin Kryesor të personit.

Shkalla e Arritjes—niveli i arritjes së individit në kultivim në Shkollën e Buddhës, psh. Arhat, Bodhisattva, Tathagata, etj.

Shkatërrimi i Fundit—komuniteti i kultivuesve beson se universi ka tre faza evolucioni, (Shkatërrimi Fillestar, Shkatërrimi i Mesëm, Shkatërrimi i Fundit) dhe se tani është periudha përfundimtare e Shkatërrimit të Fundit.

Shkolla Qimen—shkollë kultivimi jo konvencionale.

Shpirti Kryesor—ndërgjegja kryesore e njeriut.

Shpirti Ndhimës—shpirti/shpirtrat dytësor(ë); ndërgjegja ndihmëse e njeriut.

Shpirti Primordial—ky ndahet në Shpirtin Kryesor (*zhu yuanshen*) dhe Shpirtin Ndhimës (*fu yuanshen*). Në mendimin tradicional kinez, besohet se shumë shpirtra ekzistojnë në trupin e njeriut dhe janë përgjegjës për funksione e procese të caktuara (psh. shumë besonin se një shpirt qëndron në mëlçi dhe rregullon funksionet e saj).

Sun Simiao—mjek i mirënjohur i mjekësisë kineze në histori.

svastika—“Rrotë drite” nga Sanskrit, simboli origjinal mbi 2,500 vjet më parë dhe është zbuluar në gërmimet tokësore të relikeve kulturore në Greqi, Peru, Indi, Kinë etj.. Për shekuj ka pasur kuptimin e fatit të mirë, ka simbolizuar djellin dhe mbahej si shenjë positive.

Syri Qiellor—gjithashtu i njohur si “syri i tretë” i ndodhur në mes të ballit pak sipër vetullave.

Taiji (tai-çi)—simboli i Shkollës Tao, që njihet gjërësisht në Perëndim si “simboli yin-yang” (jin-jang).

Tantrizëm—një mënyrë kultivimi mistik në Buddhizëm.

tanzhong—pikë akupunkte që gjendet afërsisht në qendër të gjoksit.

Tao (dao)—1. shkruhet dhe Dao, term Taoist për “thelbin e natyrës dhe univesit”; 2. qenie e lartësuar shpirtërisht që ka arritur Taon.

Tathagata—një qenie e lartë me Shkallë Arritjeje të Shkollës Buddhës i cili është më lart se nivelet e Bodhisattvës dhe Arhatit.

Tetë Shenjtorët—Tao të mirënjohur në historinë kineze.

Tetë Triagramet—nga *Libri i Ndryshimeve*, një diagram parahistorik që mendohet të tregojë të vërtetën e ndryshimeve të kursit të natyrës.

“të gërmosh në bririn e demit”—një shprehje kineze që do të thotë të shkosh drejt një fundi pa krye apo një qorrrokaku.

Tiananmen—“Porta e Paqes Qiellore” përballë Qytetit të Ndaluar në Beijing.

tianzi zhuang—një formë ushtrimi qigongu në këmbë në Shkollën Tao.

tofu—ushqim tradicional kine që përgatitet nga qumështi i sojës. Duket si djathë por nuk ka të njëjtën shije.

Trup Qumësht i Bardhë—një trup i pastruar pa qi.

Trup i Tej Pastërt—trup transparent në nivelin më të lartë të kultivimit në Ligj-Në-Botën-Trefishe.

Udhëzues për të Gjetur Naturën dhe Jetëgjatësinë—tekst klasik kinez për praktikë kultivuese.

Vajra—një fjalë e papërkthyeshme nga Sanskrit që do të thotë diamant, i pandryshueshëm, i pathyeshëm dhe fuqi madhore. Në Buddhizëm është simbol i një mirësie të madhe dhe i fuqisë më madhore në univers dhe i referohet trupit hyjnor që kultivohet apo ndryshe trupit të një Buddha.

virtyt—“meritë”, një substance e bardhë e çmuar.

wuwei (uu-uei)—“pa veprim”, “pa qëllim”, duke ndjekur rrjedhën e natyrshme të gjërave.

xinxing (shin-shing)—term kinez që do të thotë cilësi e mendjes dhe e zemrës; karakter, moral. Për thjeshtësi do t’i referohemi këtu gjithmonë me karakter.

yin (jin) dhe **yang** (jang)—Shkolla Tao beson se çdo gjë përmban forca të kundërta të yin dhe yang të cilat përjashtojnë njëra tjetrën por dhe varen nga njëra tjetra, psh. femërore (yin) kundrejt mashkullore (yang).

yuan (ju-en)—njësi monetare kineze (afërsisht = USD\$0.12).

yuzhen—pikë akupunkte që ndodhet në rrëzë të kokës prapa.

Zhen—vërtetësi, ndershmëri.

Zhen-Shan-Ren—Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë.